AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

STUDIME FILOLOGJIKE SHQIPTARE

Konferencë shkencore, 21-22 nëntor 2007

PRISHTINË
2008

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

THE ACADEMY OF SCIENCE OF ALBANIA

ALBANIAN PHILOLOGICAL STUDIES

Scientific Conference, 21-22 November 2007

EDITORIAL BOARD:

Besim Bokshi
Eqrem Basha
Mehmet Kraja

PRISHTINA
2008

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

STUDIME FILOLOGJIKE SHQIPTARE

Konferencë shkencore, 21-22 nëntor 2007

REDAKSIA:

Besim Bokshi
Eqrem Basha
Mehmet Kraja

PRISHTINË
2008

PËRMBAJTJA

Besim BOKSHI
Fjala e hapjes 9
Rexhep ISMAJLI
Studimet filologjike shqiptare sot 11
Alfred UÇI
Kaosi terminologjik në fushën e kulturës estetiko-artistike 25
Matteo MANDALA
Teoria e rezultateve dhe rezultati i teorive: për përcaktimin e statusit epistemologjik të filologjisë shqiptare 43
Sabri HAMITI
Metodat e studime 63
Seit MANSAKU
Trajtim shkencor dhe qëndrim kombëtar në studimet për historinë e gjuhës shqipe 71
Wilfried FIEDLER
Disa mendime rreth sistemit rasor të gjuhës shqipe 81
Mark MARKU
Albanologjia në zanafillë ose imazhi i krijuar së jashtmi 91
Robert ELSIE
Të reja nga fusha e albanologjisë 97
Bardhyl DEMIRAJ
Në gjurmë të "Mesharit" të Gjon Buzukut: të dhëna për një njohje të mëhershme të tij 101
Ali ALIU
Poezia si mision 109
Jani THOMAI
Leksikologjia shqipe – arritje dhe probleme 121
Floresha DADO
Studimi i letërsisë sot: problem teorik apo subjektivizëm spontan? ... 135

Zeqirja NEZIRI
Letërsia shqipe e barokut....143
Irena SAWICKA
Studime filologjike albanologjike në Poloni....163
Alexander RUSAKOV
Vendi i Mitrush Kutelit në historinë e letërsisë shqipe: vështrim nga Rusia....177
Fadil RAKA
Rreth disa problemeve të historisë së shqipes letrare....185
Enver HYSA
Veçori tipologjike dhe probleme të formimit të fjalëve në shqipen e sotme....199
Resmije KRYEZIU
Aspekte të mendimit kritik në vitet '30....205
Remzi PËRNASKA
Sprovë për formalizim të disa vlerave të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe....211
Persida ASLLANI
Sprova të munguara të kritikës letrare....249
Gëzim GURGA
Për botimin kritik të fjalorit italisht-shqip të Francesco Maria Da Leçe-s (1702)....263
Marko SNOJ
Origjina e emrit të vendit Prishtinë....277
Elton PRIFTI
Qëmtime mbi angloamerikanizmat riemigrues të gjuhës shqipe nën prizmin e kontaktit gjuhësor midis saj dhe anglishtes....283
Idriz AJETI
Kopitar e Mikloshiç në studimet e gjuhës dhe të kulturës shqiptare....297
Kristaq JORGO
Mbi kuantifikimin harmonik në poezi....309
Besim BOKSHI
Emrat e ditëve të javës - dëshmi e një gjendjeje të lashtë të fleksionit emëror të shqipes....315
Lindita TAHIRI
Strategjitë gjuhësore për analizën e letërsisë....331

Kolec TOPALLI
Trysnia ideologjike në studimet për historinë e gjuhës shqipe 341
Shefkije ISLAMAJ
Filologjia shqiptare dhe tekstologjia 349
Mehmet ÇELIKU
Arritje, probleme dhe detyra në fushën e kërkimeve sintaksore të shqipes 359
Mustafa IBRAHIMI
Drejt objektivave madhore në sociolinguistikën shqiptare 371
Bahri BECI
Përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare të pasluftës për lëvrimin e shqipes së shkruar 383
Shefki SEJDIU
Çabej i diskutimeve në kongreset dhe konferencat shkencore 397
Gjovalin SHKURTAJ
Ngjyresa krahinore të standardit si tregues të relativizmit të normës dhe kaheve të mundshme për pasurim e përditësim të mëtejshëm 403
Thoma DHIMA
Mbi subjektin e formave të pashtjelluara foljore 417
Begzad BALIU
Sprovë për një histori të albanologjisë 423
Dhurata SHEHRI
Synimi i autoritetit në rrethanat e izolimit dhe deformimit ideologjik 435
Enver GJERQEKU
Në 70-vjetorin e botimit të "Yllit të zemrës" të Lasgush Poradecit 443
Sala AHMETAJ
Foljet këpujore dhe foljet funksionale në gjuhën shqipe 449
Rrahman PAÇARIZI
Parametrat psikolinguistikë të nxënies së gjuhës standarde dhe ndikimi i tyre në prodhimin gjuhësor 455
Hava QYQALLA
Format foljore perifrastike të shqipes në veprën e Pjetër Bogdanit 465
Bardh RUGOVA
Dizajni i audiencës 473

Shaban DEMIRAJ
Vlera e shumanshme e defterëve osmanë të regjistrimit të popullsisë.....479
Enver HYSA
Fjala e mbylljes 489

Besim BOKSHI

FJALA E HAPJES SË KONFERENCËS SHKENCORE "STUDIME FILOLOGJIKE SHQIPTARE", 21-22 NËNTOR 2007

Të nderuar studiues të gjuhës shqipe e të letërsisë shqiptare!

Të nderuar pjesëmarrës, zonja e zotërinj!

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë e kanë parë të nevojshme ta organizojnë këtë konferencë shkencore, që studiuesve të çështjeve të filologjisë shqiptare t'u ofrohet mundësia të takohen e të trajtojnë problemet që shtron aktualiteti i gjendjes së këtyre studimeve, që të bëhen rivlerësime të mundshme të rezultateve të gjertanishme si dhe të sillen trajtesa të reja që qëndrojnë në kahet e studimeve filologjike bashkëkohore, mbështetur në metodat e kohës si në studimet e gjuhës ashtu edhe në studimet e letërsisë.

Studimet filologjike shqiptare në rrugën e zhvillimit të tyre kanë arritur mjaft rezultate të qëndrueshme shkencore. Ne të gjithë çmojmë lart punën e gjeneratave të shkuara të studiuesve shqiptarë e të huaj, që energjinë e tyre krijuese ia kushtuan studimeve të shqipes e të letërsisë shqiptare dhe që i përparuan ato shkallë-shkallë. Në mes tyre ka pasur edhe vepra të mëdha që kanë shënuar kapërcime epokale në këto studime. Dihet, ndërkaq, se "Ajo që është sot e re dhe interesante, pasnesër nuk do të jetë më e tillë". Por, siç është shënuar: "Nderimi për atë që tashmë ka mbijetuar për një kohë të gjatë deri në ditët tona, që ende nuk është harruar dhe nuk ka perënduar, nuk do të pësojë ndonjë thyerje as edhe në rrjedhën e jetës sonë". Të gjitha rezultatet e shënueshme janë arritur kur këto studime janë mbështetur në teoritë gjuhësore e letrare të kohëve përkatëse, domethënë kur çështjet e shqipes dhe të letërsisë shqiptare janë trajtuar nga nivelet e gjuhësisë dhe të filologjisë evropiane.

Në një kohë shqyrtimet e çështjeve të shqipes në qarqet e studiuesve vendorë u shkëputën nga deduksioni i teorive gjuhësore të

shekullit XX. U kultivua e ashtuquajtura gjuhësi tradicionale që dha rezultate në gjuhësinë shqiptare ende të pazhvilluar, sidomos në plotësimin e nevojave praktike me dominim të veprave me karakter preskriptiv. Kjo u çmua si metodë e denjë për të qenë e përhershme. Në studimet e letërsisë, siç dihet, dolën pengesa të rënda ideologjike për trajtime të mirëfillta shkencore. Këto mënyra trajtimi ende nuk kanë arritur të jenë të papraktikueshme. E është thënë se "askush nuk shkruan më keq se idhtarët e ideologjive të vjetëruara". Mbetja mbrenda trajtimeve të tilla studimore pat shkaktuar në atë kohë ngecjen e filologjisë shqiptare vendore brenda një qarku joproduktiv.

Në këtë konferencë pritet të shihet edhe se sa është shkalla e relacionit të studimeve të reja filologjike shqiptare me studimet përkatëse evropiane e botërore. Qëllimi ynë, i gjeneratave të tanishme të filologëve është të ndihmojmë që të arrihet sa më shpejt kohezioni i qëndrueshëm permanent me zhvillimin e teorive gjuhësore e letrare.

Shpresojmë që kjo konferencë të bëjë një shtytje të vlefshme në këtë drejtim.

Në fund dua të them se kolegët tanë nga vendet e ndryshme, që gjithnjë gëzojnë respektin tonë si ata para tyre, mund të kenë satisfaksion që energjinë krijuese po ia falin një gjuhe që Pederseni e ka cilësuar si gjuhë të bukur dhe të fuqishme, "e cila lipset të jetë mburrje për folësit e saj dhe një vegël e shenjtë për rritjen mendore dhe arsimtare të kombit të vjetër shqiptar".

Zonja e zotërinj, shprehim keqardhjen tonë të thellë e pikëllimin që u nda nga jeta studiuesja e vyer e gjuhës shqipe zonja Irina Voronjina, e cila sapo qe ftuar me dëshirë të veçantë për të marrë pjesë në këtë konferencë. Po ashtu e kujtojmë me dhembshuri e respekt gjuhëtarin dhe albanistin e dalluar Giovani Battista Pellegrini që u nda nga ne para pak kohësh.

Rexhep ISMAJLI

PËR STUDIMET FILOLOGJIKE SHQIPE SOT

Në shqyrtimin e një teme kështu të gjerë, kolegë të nderuar, nuk më doli e përshtatshme të bëja raportin e tipit 'rezultate dhe probleme', po m'u duk më e mbarë të ndalesha në pika të veçanta, duke iu referuar vlerësimeve të mëhershme. Derisa në një kuptim, që ndeshet shpesh në kulturën tonë, filologjia ngërthen "tërësinë e shkencave që studiojnë gjuhën dhe krijimtarinë letrare të një populli" (*Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006), në kuptim më të specifikuar e më shkencor filologjia është dije historike që ka për synim njohjen e qytetërimeve të kaluara përmes dokumenteve të shkruara që na kanë lënë ato. Në këtë vështrim botimi i teksteve do të ishte preokupimi themelor i filologëve. Në traditën shqiptare përdorimi në kuptimin e parë, edhe pse i paplotë, ka qenë më i përhapur. Duke vështruar arsyetimet e Këshillit organizues, supozoj se as në këtë konferencë nuk është synuar vetëm kuptimi i ngushtë. Studimet filologjike shqiptare në kuptimin e gjerë të fjalës janë lidhur me studimet për gjuhën shqipe, por në fakt ato edhe në këtë kuptim do të duhej të përfshinin dhe veprimtari të tjera.

Në raportin për të arriturat e gjuhësisë shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore më 1979, Mahir Domi bënte dallimin midis historisë së studimit të gjuhës shqipe të krijuar nga *një traditë gjuhësore vendëse*, e cila "u muar me mbledhje të materialeve e me botimin e një pjese të tyre, me hartim gramatikash dhe fjalorësh, me probleme aktuale të gjuhës letrare e me çështje të praktikës gjuhësore", dhe të *albanistikës së huaj*, të përfaqësuar në radhë të parë prej specialistësh të gjuhësisë indoevropiane, të romanistikës, sllavistikës, të orientuar "nga studimi historik i gjuhës shqipe, duke vështruar në radhë të parë raportet e saj me gjuhët e tjera. Pati kërkime... për probleme të veçanta të historisë së gjuhës sonë, po në një masë shumë të kufizuar vepra të përgjithshme e sintetizuese".[1] Me këtë adresoheshin dy interesime: ato që duhej të zgjidhnin dhe çështje të natyrës praktike në funksionimin e gjuhës në jetën shoqërore, dhe ato që mund të qëndronin më anash, për t'u marrë kryesisht me çështje të listorisë së gjuhës dhe të raporteve të shqipes me gjuhët e tjera.[2] Çlirimi i vitit 1945 i gjeti studimet e gjuhës shqipe me një zhvillim të pabarabartë, "me zbrazëti të shumta, me shumë fusha ose probleme pamjaftësisht të studiuara ose fare të pastudiuara, me realizime të ndryshme, po të një vlere të pabarabartë". Krahasimi me

[1] Domi (1979), 3-14, këtu 4.
[2] Domi, aty.

raportimet e këtij lloji më herët sikur bën të kuptohet se kemi të bëjmë në radhë të parë me orientime të përgjithshme të vështrimit në suaza të vendit, për të nxjerrë në pah të arriturat e tij.[3] Në këto raportime për të arriturat e gjuhësisë në Shqipëri në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore është theksuar gjerësia e ndërmarrjeve të realizuara, duke përmbushur brenda një kohe të shkurtë zbrazëtitë ekzistuese. Vështrimi kritik i drejtohet trashëgimisë, për të theksuar kështu hapjen e shtigjeve të reja, "ndryshimet e thella në metodologjinë e metodat kërkimore", që mëtohej të vinte në dy baza: në një anë, nga mbështetja në "materializmin dialektik e në teorinë e gjuhësisë marksiste, si dhe ngritja e nivelit teorik", dhe, nga ana tjetër, nga "vështrimi i fakteve gjuhësore jo në mënyrë statike e të ngurtë, por në sistem dhe në dialektikën dhe dinamikën e tyre, në lidhjet e raportet reciproke si elemente të një tërësie, dhe në tendencat e zhvillimit të tyre". Kjo bëri të mundur një ide më të plotë e më të saktë për gjuhën shqipe. Vëmendje iu kushtua fakteve, mbledhjes e sistemimit të tyre në kartoteka, arkiva etj.

Gjithë duke lënë anash nevojën që ndjen lexuesi për të saktësuar se ç'kuptohej me 'sistem', 'dialektikë', etj., më duket se aspekti i fundit, pra ai i 'grumbullimit të materialit faktik, grumbullimit e sistemimit të tij në kartoteka, arkiva, etj.', mund të quhet e arritura e rëndësishme e asaj periudhe. Aspekti i metodologjisë, meqenëse në këtë vështrim kjo çështje përsëritet disa herë, le ta themi, nënkuptonte *materializmin dialektik e historik... teorinë gjuhësore marksiste-leniniste*, për të cilat në këtë konstelacion vështirë se mund të gjenden shpjegime më të gjera se të kohës.[4]

Mahir Domi dallonte tri etapa të këtyre studimeve: 1944-1954, 1955-1966 dhe 1967. Në *etapën e parë*, mbisundonte puna për kodifikimin e gjuhës letrare, me orvatjet e para për përcaktimin e terminologjisë shkencore shkollore; në *etapën e dytë* "ndërmerren studime të veçanta në fushat e gramatikës, fjalëformimit, leksikologjisë, krijohen bazat tekniko-shkencore... për to e për veprat që do të sintetizojnë rezultatet e tyre". Këtu nis "kërkimi sistematik dhe studimi i të folmeve të vendit tonë", por nuk mbetet pa vëmendje problematika e historisë së gjuhës shqipe. Në *etapën e tretë* ai vendoste "punën efektive

[3] Shih p. sh. Kostallari (1970), 99-115.

[4] Domi, aty. Në vështrimin e Kostallarit theksohej "atomizmi që ishte zbatuar në hulumtimet historiko-gjuhësore nga gramatikanët e rinj" si tipar i albanistikës së huaj, shquhej orientimi i gjuhësisë së re shqiptare që objekt të saj themelor të kishte "studimet e gjuhës bashkëkohëse shqipe, strukturën e saj të gjallë, në tërësinë e varianteve të saj dialektore dhe në procesin e kristalizimit si gjuhë unike letrare kombëtare. Ajo e zhvendosi vëmendjen nga historia e jashtme e shqipes... te struktura e saj e brendshme bashkëkohëse". f. 101. Në çështje metode, ai e theksonte mbështetjen te "konceptet materialiste të metodologjisë marksiste-leniniste", ndërsa në rrafshin e metodologjisë së hulumtimit "gjuhësia bashkëkohëse shqiptare... e ka tejkaluar metodën atomiste-diakronike të gramatikanëve të rinj... është kombinuar në mënyrë dialektike sinkronia me diakroninë, analiza strukturore e sistemit të gjuhës dhe të nënsistemeve të saj me elementet më pozitive të metodës krahasuese historike".

për hartimin e disa veprave madhore, si Fjalori njëvëllimësh, Fjalori shumëvëllimësh, fonetika e gramatika e plotë shkencore, studimet etimologjike". "Në këtë kohë kurorëzohet veprimtaria kodifikuese e gjuhës letrare". Veçonte se dialektologjia shqiptare kishte përfunduar eksplorimin e studimin e parë të gjithë territorit të RPSSH-së dhe se studimi historik i gjuhës kishte arritur rezultate për prejardhjen e shqipes dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët ballkanike. Në fund të kësaj etape, gjuhësia i shtronte vetes detyra të reja: "thellimi i studimit teorik të një sërë problemesh e kategorish të strukturës gramatikore, të fjalëformimit e të leksikologjisë, realizimi i studimit të mëtejmë të përbërjes tingullore të gjuhës shqipe, ndërmarrja e Atlantit dialektologjik.".[5]

Mahir Domi jepte paraqitje të saktë dhe vlerësim të qëndrueshëm për rezultatet e shënuara në pikat konkrete, me kufizimin e rëndësishëm në dy drejtime: *gjuhësi shqiptare*, të bërë nga shqiptarët (duke lënë anash të huajt), në një anë, dhe *gjuhësi brenda RPSSH*-së (duke lënë jashtë shqiptarët e tjerë dhe arbëreshët e diasporën tjetër), nga ana tjetër. Kjo, ndërkaq, mund të prekte diçka thelbësore – pamjaftueshmërinë e konceptimit separat për gjuhën shqipe dhe për shqiptarët duke u nisur nga identifikimi i shtetit me kombin dhe atributet e tij të tjera. Ndarjet në 'albanistikë të huaj' dhe 'albanistikë shqiptare' dhe pastaj 'shqiptare' dhe 'jashtë Shqipërisë' dukeshin të papranueshme në veprimtari me synime praktike, sidomos sa i përket standardizimit. Vështrimi i ngjashëm më herët te Kostallari dhe të tjerët tregon se mund të ishte fjala për diçka që shkonte përtej mendimit individual të autorëve.

Do të themi se deri te *Konsulta gjuhësore* (1968) në Kosovë dhe te shqiptarët e ish-Jugosllavisë zhvillohej një veprimtari për t'u shënuar në disa pika dhe drejtime në fushën e standardizimit të shqipes. Bëheshin terminologji, hartoheshin fjalorë dygjuhësh, botoheshin vepra të veçanta, si ato të autorëve të njohur Riza e Ajeti, botoheshin tekste të vjetra, etj. Botoheshin vepra letrare e shkrime për to, mblidhej trashëgimia kulturore. Edhe pse vetëm 2 vjet, kishte vepruar Instituti Albanologjik, ndërsa pas vitit 1960 kishte nisur punën Katedra e Gjuhës Shqipe, për të themeluar revistën *Gjurmime albanologjike* qysh më 1963, të kaluar pas vitit 1968 në Institutin Albanologjik. Në të njëjtën kohë, mund të shënohen veprimtari studimore për gjuhën dhe veprimtari të tjera lidhur me të në diasporë.

Në qëndrimet e atëhershme, që nuk vareshin nga vullneti i studiuesve, mbetet pa shpjegim përpjekja serioze, me arritje nistore thelbësore drejt

[5] Hartimi i Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe kishte nisur në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shqipërisë; nga fundi i viteve '70 ishte bërë projekt i përbashkët i saj me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Puna e përbashkët u ndërpre në vitin 1981. Përgatitja dhe finalizimi vazhdoi në Tiranë. Vëllimi I i Atlasit doli në vitin 2007 si vepër e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Università degli Studi di Napoli L'Orientale, Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale, ff. 464.

kapërcimit të asaj ndarjeje dhe me pasoja për vetë studimet: qëndrimi bashkues i mbajtur në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës (1968) mbylli përfundimisht rrugët e ndara të veprimit në fushën e standardizimit të gjuhës, bëri të mundur hapin e hedhur në Kongresin e Drejtshkrimit (1972) dhe zgjidhjen e çështjes së standardit të gjuhës shqipe në shkallë kombëtare, me këtë edhe përqendrimin në studime me një perspektivë të vetme: të strukturës së shqipes standarde, për të realizuar në vijim vepra të rëndësishme si *Gramatika*, *Fjalori*, *Fjalori drejtshkrimor*, etj., prapë vetëm nga një qendër, sepse vetëm atje ishte dhënë urdhri dhe mbështetja financiare institucionale shtetërore për projekte të tilla. Nuk është e rastit që në atë kohë u ndërmor hartimi i përbashkët Tiranë-Prishtinë i *Atlasit dialektologjik*, i cili më në fund doli nga shtypi si vepër e Akademisë së Shqipërisë. Krahas hulumtimeve me perspektivë paralele, përshkrimeve të të folmeve, studimeve të strukturës së shqipes, hulumtimeve në fushën e listorisë së gjuhës, teksteve të vjetra, në atë kohë dhe në Prishtinë lindi nevoja për një institucion si *Qendra e Kulturës Shqiptare për të Huajt/ Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, që vijon edhe sot. Një nga synimet e këtij institucioni ishte dhe vazhdon të jetë tejkalimi i njatij hendeku midis gjuhësisë shqiptare ashtu të ndarë për arsye jashtë saj dhe gjuhësisë së huaj për shqipen drejt studimeve të integruara, ndërsa rezultatet kanë sjellë begatim. Botimi i *Seminarit* është bërë i rëndësishëm.

Krahas studimeve të veçanta për çështje të ndryshme të shqipes, me natyrë monografike a tjetër, hartimi i veprave të mëdha gramatikore: i *Gramatikës së Akademisë*, i *Standard Albanian* nga Newmark, Prifti, Hubbard, i *Albanische Grammatik* të rëndësishme të Buchholz-Fiedler, paraqesin arritje pikërisht në rrjedhat pas marrëveshjeve standardizuese. *Gramatika* e Camajt, ndërkaq, shprehte më parë nevojat e mësimdhënies dhe përpjekjet për të paraqitur tërësinë e shqipes standarde dhe të varieteteve gege e arbëreshe në një vend, duke implikuar dhe një koncepcion të 'shqipes së përbashkët'. Ndërkohë botohen dhe *Gramatika* e N. Ressulit, *Manuali* i Solanos, etj.

Sado që mëtohej që çështjet e metodës të ishin shtruar në mënyrë të shtjelluar, në pajtim me vlerësimin e E. P. Hamp, mund të thuhet se metodat mbisunduese të përshkrimit të gjuhëve në shekullin 20 gjetën hapësirë vetëm të pjesshme në filologjinë dhe në gjuhësinë shqiptare deri vonë: mungojnë përshkrimet gramatikore strukturale, mungojnë tërësisht depërtimet gjenerative-transformacionale, etj. Drejtimi institucional i centralizuar dhe mbisundimi ideologjik përjashtues për to, mbase, luajtën një rol në këtë aspekt, edhe pse qysh herët kemi disa nisma të mbara, si përshkrimi struktural i shqipes së jugut nga Newmark, përshkrimi apo studimi gjenerativ për përsëritjen e kundrinës nga Buchholz, fonologjia gjenerative e Bevington, etj. Pati depërtime

që duan përmendur, si analizat fonologjike (Dodi, Ismajli, Beci, Gjinari), depërtime në fushën e sintaksës si gjymtyrimi aktual i fjalisë (Floqi), sprovat për zbatimin e teorisë së thënies (Kelmendi, Përnaska), ndonjë analizë tekstore (Ismajli), etj. Në studimet e historisë së gjuhës konceptimet strukturale si ato të Bokshit, për ne tepër të rëndësishme, vazhduan të gjëllinin në skaje, për çudi, edhe ndër albanistët e huaj. Por edhe studime tradicionale, si ato të Rizës për foljet, po dilnin në pah me shumë vonesë.

Qysh me depërtimet e Eqrem Çabejtë në fushën e historisë së gjuhës dhe të studimeve etimologjike, në fakt, me rritjen e cilësisë, në këto fusha të studimeve filologjike shqiptare praktikisht po kapërcehej ndjeshëm ndarja artificiale midis vendësve dhe të huajve, që ndonjëherë mund të implikonte dhe çështje niveli studimesh dhe formimi teorik.

Gjithë duke sjellë sintezën e tij të dijeve të traditës Hahn-Meyer-Jokl, përfshirë Nopçën, Pedersenin e të tjerët, Çabej çështjet themelore të historisë së shqipes si prejardhja e saj dhe raportet me gjuhët e tjera indoeuropiane i shtroi në një nivel të ri, duke theksuar lidhjen e saj me ilirishten dhe autoktoninë relative në hapësirat ku flitet sot. Mbështetja në bagazhin shpjegues të ndërtuar mbi historinë e gjuhës, studimet onomastike, vrojtimet historiko-kulturore e arkeologjike, mundësuan krijimin e një vështrimi të tërësishëm. Studimet e Çabejt sollën saktësim sa i përket vendit të shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane. Studimet e tij etimologjike krijuan bazë të re për interesimet e etimologëve indoeuropianistë dhe, bashkë me hulumtimet e autorëve si Tagliavini, Desnickaja, Cimochowski, Xhuvani, Ajeti, Hamp, Huld, Klingenschmitt, Ölberg, krijuan gjendjen në të cilën, një shekull pas fjalorit etimologjik të Meyerit, tashmë kemi sprovën e Huldit (rreth 200 baza), disa fjalorë të rinj etimologjikë: të B. Demirajt 1997 (mbi 400 baza), të V. Orelit 1998 më të gjerë dhe të J. Erat. Dhe kemi veprat sintetizuese për historinë e shqipes të një faze të parë nga Riza (1952), Bariq (1955), Çabej (1961), Domi (1962), Ajeti (1965), Mann (1977), për të kaluar te *Gramatika historike* e Demirajt (shqip e gjermanisht), te *Historia e tij e shqipes*, *Fonologjia historike*, te veprat me karakter sinteze të Bokshit për zhvillimin e sistemit të rasëve, për nyjat, për pjesoren dhe për vetorët, te vepra sintetizuese e K. Topallit *Fonetika historike e shqipes* pas një sëre monografish të veçanta të tij në këtë fushë, gjithnjë me vështrim tradicional në aspektin e studimeve gjuhësore, a te *Hyrjet* e dobishme të Pellegrinit dhe të Matzingerit. Studimet e veçanta të Hampit, Cimochowskit, Desnickajës, Mansakut, etj.

Vështrim tjetër në këtë horizont nga brezi i mëparshëm i albanistëve shqiptarë është ai i Idriz Ajetit "Gjendja e sotme e studimeve albanologjike – rezultate dhe probleme". Ajeti rrokte një hark të gjerë të studimeve albanologjike, duke mos i parë të ndara në shqiptare dhe të huaja, por duke bë-

rë dhe vlerësime konkrete për zhvillimet dhe gjendjen e këtyre studimeve në Kosovë e ish-Jugosllavi. Pas Luftës së Dytë Botërore, ai fliste për zhvillimet 'në Gjithëbashkësinë e re Jugosllave' në dy faza. E para kishte të bënte me nevojat më të ngutshme të arsimit e të jetës kulturore, kur "shtrohen dhe diskutohen probleme të gjuhës shqipe; hartohen fjalorë dygjuhësor[ë].., gjallërohen studimet në fushën e historisë së gjuhës shqipe", botohet manuali i Bariqit *Hymje në historinë e gjuhës shqipe* (1955), studimet e I. Popoviqit për 'karakterin dhënës të gjuhës shqipe' dhe 'bëhen përpjekje të kodifikohet drejtshkrimi i gjuhës letrare shqipe'. Në fazën e dytë theksonte studimet e dialekteve, në aspektin sinkronik dhe diakronik, pastaj themelimin e institucioneve shkencore-universitare, të instituteve Albanologjik e të Historisë, Konsultën gjuhësore të Prishtinës, organizimin e studimeve albanologjike në disa bërthama, sidomos të mbledhjes dhe botimit të folklorit, të hulumtimeve dialektologjike, me theks të veçantë të ndihmesës për Atlasin dialektologjik, etj. Në studimet historike ai theksonte se ishin shënuar rezultate të mira pune. Vlerësimi i përgjithshëm ishte ky: "Në pikëpamje institucionale, shkencat albanologjike këtu tek ne, janë organizuar mirë, janë mbuluar shumica e degëzimeve të tyre – madje edhe me kuadër të specializuar". Më pastaj theksonte rezultatet sintetizuese në studimet e romantizmit (Qosja), botimin e revistave *Gjurmime albanologjike*, *Buletin i Fakultetit Filozofik*, *Studia humanistica*, organizimin e *Seminarit* e arritje të tjera.[6] Bënte kritika për zhvillimet, që mund të duken rezultat i konformizmit të kohës.[7] Pas numërimit të dobësive, bënte vërejtje për 'fushatën e ngritur e sistematikisht të zhvilluar kohët e fundit kryesisht në publicistikën tonë dhe te ndonjë akademi shkencash e artesh këtu te ne – me synime të qarta për të realizuar bile edhe për të hedhur poshtë pa mbështesë të duhur argumentuese, edhe rezultatet më të patundura të shkencave albanologjike', çka 'shtron nevojën e të mbajturit qëndrim sa më objektiv'. Këto e shpjegojnë kontekstin, por hetohet kapërcimi mbi disa aspekte zhvillimesh.[8]

Në brezin e Domit e Ajetit, Eric Hamp bënte një raport për studimet e shqipes më 1972 në kuadër të serisë *Current trends in linguistics*, nga perspektiva e një albanistike të integruar. Ai rikujtonte raportin e N. Joklit më 1917, në të cilin thuhej: "Gjuha e albanëve apo shqiptarëve deri sot ka mbetur fëmijë jetim i gjuhësisë indoeuropiane. Derisa në fushën e disa gjuhëve

6 Nuk janë shënuar studimet që tashmë ishin bërë apo po bëheshin në fushën e teksteve të vjetra dhe të filologjisë, në fushën e historisë së gjuhës, në çështje të leksikut, etj.

7 "Brezi ynë i ri shkencor është krijesë e Gjithëbashkësisë sonë jugosllave. Edhe ai vuan nga sëmundja foshnjore, rrëmbehet ndonjëherë nga entuziazmi romantik, lëngon nga mangësia e formimit shkencor, por, do të mbahet parasysh se inteligjencia jonë e re shkencore është formuar dhe ngritur në Gjithëbashkësinë tonë jugosllave me një potencial që krijoi një qendër shkencore e cila, me gjithë mangësinë e përmendur, në degëzimet e shkencave albanologjike, s'ka qerthull tjetër shkencor ndër universitetet dhe institucionet shkencore të mbarë Jugosllavisë që mund t'i kryente punë me më kompetencë", f. 25.

8 Ajeti (1987), 15-30.

motra një tufë e tërë hulumtuesish në një garë të rreptë shtron gati të gjitha problemet që i dalin përpara historisë dhe përshkrimit të gjuhës dhe shpesh jep zgjidhje, në fushën e shqipes një numër jashtëzakonisht i madh detyrash ende pret zgjidhjen". Hamp përpiqej të krijonte një pasqyrë të tërësishme për këto studime, duke raportuar për të gjitha mjediset ku studiohej shqipja me këtë vlerësim themelor: "Këto fjalë, të shkruara më se gjysmë shekulli më parë nga Norbert Jokl-i (1917:109), ruajnë edhe sot proporcionalisht vlerën që kanë pasur në kohën kur janë thënë... Kjo nuk do të thotë se asgjë nuk ka ngjarë ndërkohë, Siç do të shihet në vazhdim të këtij punimi, ka pasur një numër të konsiderueshëm studimesh, sidomos gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit, ndërsa në disa fusha studimi ka pasur përparim të dukshëm. Gjatë dhjetë a më shumë vjetëve të fundit, një punë shumë e rëndësishme dhe e gjerë është kryer në Tiranë dhe në Kosovë, ndërsa rezultate të rëndësishme dhe të qëndrueshme mund të regjistrohen edhe në disa qendra të Perëndimit, në Bashkimin Sovjetik dhe nga disa studiues në qendër të Ballkanit, veçanërisht në Rumani dhe në Bullgari".[9]

Por, përtej synimit mbase thjesht IE të Joklit, fushë në të cilën studimet e shqipes do të jenë detyrimisht prapa, për shkak të ndryshimeve ndërkohë dhe regjistrimit të vonë të saj me shkrim, Hampi mendonte që "ne ende e gjejmë veten në të njëjtën pozitë relative sa u përket gjuhëve të tjera dhe specialiteteve, siç i kishte konstatuar Jokl-i gjysmë shekulli më parë. Në këtë kuadër, shqipja mbetet tmerrësisht e mjegullt, praktikisht një libër i mbyllur për botën e shkencës në përgjithësi. Sa u përket mjeteve kryesore të studimit dhe të referimit, në tërë Europën, për nga varfëria shqipes ia kalojnë vetëm bretonishtja dhe mbase gaelishtja skoceze apo makedonski...". Dhe përmendte mungesën e një gramatike të madhe të tipit klasik tradicional, mungesën e përshkrimeve gjithëpërfshirëse në ndonjë prej traditave të mëdha strukturale të shekullit XX, mungesën e këndvështrimit transformativ-gjenerativist, mungesën e trajtimit voluminoz të tipit monografik për cilindo segment të gramatikës, të një punë sintetike krahasuese të vijës së neogramatikanëve, mungesën e një fjalori të Akademisë, dhe të një burimi të përditësuar për dijet etimologjike. Ka një mungesë të fjalorëve teknikë të specializuar. Nuk ka atlas dialektologjik, nuk ka studime të detajuara eksperimentale fonetike për asnjë varietet të shqipes.

E vërteta, 30 vjet më vonë, po edhe qysh në vitet '80, në shumë pika të raportimit të tij të gjerë mund të gjenden studime dhe për disa fusha vepra sintezë të një niveli që nuk bën të nënçmohet, ku lamenti i këtillë nuk del i mbështetur. Megjithatë, ka pika në të cilat gjuhësia jonë thjesht nuk i

[9] Raportime te **Akten (1977)**: Pllana; Jochalas; Cimochowski; Dodić; Fiedler; Gut; Jucquois; Lochner von Huettenbach; Polák; Reiter; Vraciu; Žugra.

ka prekur rrjedhat e gjuhësisë së shekullit 20. Qysh në vitet '70 sikur na ishte ngulitur bindja se gjërat donin shpënë më tej paralelisht, duke nxitur të menduarit teorik, ndaj pati ndërmarrje hapash për përhapjen e zbatimin e ideve të gjuhësisë strukturale në studimet vetanake për shqipen, interpretime të gjuhësisë strukturale dhe përkthime veprash të autorëve të rëndësishëm, si Saussure, Martinet, Trubeckoi, Sapir, etj. Në mileniumin e ri një veprimtari e gjerë e përkthimit të veprave të autorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë ka nisur në Tiranë. Ndërkohë kanë nisur dhe studime sintaksore të këtyre horizonteve, kështu që mund të priten depërtime të tjera për shqipen.

Në kohën tonë shohim interes për studimet në fushat sociolinguistike, tekstore e stilistike. Kontaktet e shqipes me gjuhët e tjera, por edhe analizat kontrastive po bëhen gjithnjë e më tërheqëse. Ka fusha në të cilat tanimë kemi depërtime serioze, si studimi i huazimeve të shqipes nga latinishtja (pas Çabejt kemi ndihmesat e autorëve Mihăescu, Haarman, Rossi-Landi, Bonnet, etj), huazimet orientale-turke (Boretzky, Dizdari), huazimet sllave dhe vice-versa (Ajeti, Gjinari, Svane, Stanišić, Ylli, Murati, Blaku, Ismajli, etj.), ndërsa priten dhe të tjera. Ky mund të jetë një shans për ndërlidhje më intensive me rrjedhat teorike të kohës. Studimet sociolinguistike lidhur me pozitën e statusin e shqipes, me proceset e standardizimit dhe të funksionimit të shqipes standarde në mjedise të ndryshme shoqërore kanë nisur pas viteve '90 dhe po duket se në këtë hapësirë po ecet më tej (pas Kostallarit vijnë me vrojtime jo vetëm preskriptiviste, po sociolinguistike, Ismajli, Beci, Nuhiu, Shkurtaj, Munishi, Paçarizi, Çeliku, Lafe, Osmani, Vehbiu, etj). Ndër arbëreshët e arvanitët ka pasur depërtime në këtë drejtim studimesh (Altimari, Tsitsipiis, etj.).

Studimet dialektologjike të shqipes tani kanë arritur në një fazë ku janë bërë dhe përgjithësime në bazë të përshkrimeve në një gjerësi gati prej 5 dekadash dhe me kritere afërsisht të ngjashme monografike (Ajeti, Gjinari, Newmark, Beci, Totoni, Çeliku, Shkurtaj, Agani, Halimi, Badallaj, Raka, Nesimi, Osmani, etj.). Për arbërishtet e Greqisë e të Italisë kemi pasur veprimtari të gjerë përshkruese dialektologjike (shquhen Haebler, Hamp, Sasse, Jochalas, Camaj, Altimari, Giordano, Solano, Savoia, Turano, etj), ndërsa në diasporën tjetër Kotova, Sokolova, Voronjina. Në fushën e studimeve fonetike, pos teksteve sintetizuese të Dodit e Becit, studimeve të thelluara të Hampit, atyre me perspektivë fonologjike të autorit të këtyre radhëve, të H. Halimit, të G. Belluscios, kemi pasur studime të para akustike nga Boriçi, Belluscio, J. Kolgjini, Halimi (Halit). Kjo është fushë që do shpënë më tej.

Studimi i teksteve të vjetra të shqipes ka tërhequr vëmendjen e albanistëve. Pas Roques, Mjeda, Rrota kishim kryesisht rezultatet e brezit Çabej-Ressuli-Riza-Camaj-Ashta-Ajeti, ndërsa studimi dhe botimi i 'Mesharit' nga Çabej kishte vendosur standarde dhe kritere. Ndërkohë pati dhe sprova për

depërtime më tepër linguistike, por edhe botime të përmbledhura, kështu që paralelisht u zhvilluan interesimet filologjike për tekstet e vjetra dhe studimet gjuhësore e të tjera të tyre. Në këtë kohë pati dhe studime më specifike letrare lidhur me këto tekste. Vetë kemi anuar më tepër drejt trajtimit tekstor-linguistik. Vepra e Matrëngës ka tërhequr në këto dekada vëmendjen e më shumë studiuesve-botuesve të saj: Riza, Sciambra, Sulejmani, Mandala, Matzinger, prej të cilëve botimi i Mandalasë shquhet për trajtimin e pastër filologjik; do veçuar me këtë rast botimi me konkordanca i veprës së Budit nga Svane; është botuar poezia e Budit me faksimile, transkriptime e komente, pastaj Dorëshkrimi i Grottaferratës; është bërë interpretimi gjuhësor-tekstor i Kuvendit të Arbënit, janë bërë dhe paraqitje të gjera kritike të teksteve të vjetra bashkë me komente, interpetim dhe studime (Ismajli); A. Omari, pas botimeve të pjesërishme apo filologjikisht të kufizuara të Arapit, Camajt, Sedajt, Ismajlit, ka bërë një botim të plotë kritik të veprës së Bogdanit, B. Demiraj bëri botimin e veprës së Kazazit, bashkë me një studim të thelluar. Buzukologjia ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e studiuesve, ndërsa kohët e fundit kemi veprën me peshë të Fiedler-it për foljet te Buzuku. Tani kemi një version elektronik të veprës së Buzukut e të Bardhit. Me sa di, me vlerë është dhe projekti i Schumacher-Matzinger për foljet e autorëve të vjetër, të cilët tashmë njoftojnë se kanë avancuar në designimin e veprës së Budit. Mund të thuhet se në fushën e studimit të teksteve të vjetra në dekadat e fundit ka përparim dhe pritet kalimi në një nivel cilësisht të ri të njohjes së tyre. Përpunimi elektronik tani është bërë i domosdoshëm. Në përshkrimet e strukturës gjuhësore të tyre ka mjaft hapësirë studimi. Gëzon fakti se interesimet e studiuesve të letërsisë për këto tekste në dekadat e fundit nuk kanë qenë të vogla. Janë bërë studime për veprën e Bogdanit, për humanistët, për Buzukun, Budin, Varibobën, etj (Rugova, Sedaj, Hysa, etj.).

Dua të theksoj në mënyrë të veçantë depërtimet që kanë bërë studiuesit arbëreshë në studimet e mirëfillta filologjike shqiptare. Do të përmend këtu posaçërisht punën me konkordancat dhe përpunimin elektronik të teksteve, fillimisht si ato të Naimit nga Altimari, po edhe të autorëve të tjerë arbëreshë, si Variboba nga Belmonte, studimet e Mandalasë për tekstet arbëreshe siciliane, të Fortinos, etj. Në albanistikë sot me kënaqësi priten ndihmesat botuese sistematike të teksteve arbëreshe, si De Rada, etj. Për autorët shqiptarë të shekujve 19-20 mbetet të presim botime kritike, të cilat do t'i ndihmonin ndjeshëm studimet. Tekstet me shkrim arab kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të brezit para nesh (Myderrizi, Ajeti, Kaleshi) dhe të të tashëm (Hamiti, etj.), kështu që priten botime me vlerë në këtë fushë.

Aspekt me vlerë në këto studime është vështrimi i shqipes në raport me gjuhët ballkanike, që në raportet e përmendura përfshinte klasikët e ball-

kanistikës, ndihmesën e Çabejtë, Xhuvanit, Domit, Ajetit, por që ndërkohë ka marrë vështrime e dimensione të reja me studimet e Demirajt, Bokshit, Friedmanit, Fiedlerit, Brianit, Sawickas, Mansakut, Thomait, Ismajlit, etj. Ndërkaq studimet onomastike, në të cilat më herët përmendej kryesisht ndihmesa e Çabejtë, tani kanë marrë gjallëri tjetër: do të përmenden ndihmesat e Ajetit, Cimochowskit, Demirajt, Sejdiut, Doçit, Ushakut, Lukës, etj.

Studimet filologjike në hapësirat e letërsisë kanë zgjuar interesim. Më parë me peshë merreshin veprat *Historia e letërsisë*, dhe të tilla ka pasur disa. Historia e Akademisë në versionin e vitit 1983, e kritikuar për ideologjizimin, pastaj Historia e Schiroit, Historia e Qosjes për romantizmin, vështrimet e Pipës, studimet e Rugovës, Aliut, Hamitit, etj. Para disa vjetësh ndër studiuesit në Akademi ishte vlerësuar e nevojshme të ndërmerrej hartimi i një historie të re, por dështoi. Në fushën e studimeve letrare edhe përgjithësisht ka pasur për një kohë më të gjatë ndikime të theksuara ideologjike. Në Prishtinë kanë nisur orientime më të hapura në këto studime qysh në vitet '70, ndërsa në Tiranë kjo u bë e mundshme vetëm pas viteve '90.

Sa u përket qendrave të studimeve filologjike shqipe sot mund të lavdërohemi me numrin e tyre: përveç Tiranës, Prishtinës, qendra tashmë të specializuara si ai i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Instituti Albanologjik, departamente studimesh në universitetet, qendra të tjera, botues të fuqishëm, janë rritur dhe po forcohen qendrat universitare si Shkodra, Elbasani, Korça, Gjirokastra, Tetova, Shkupi, universitetet e Kalabrisë dhe të Sicilisë, pastaj i Napolit, Barit e Romës, i Mynihut, Sankt Peterburgut, i Torunjit, i Chicagos, etj. Nga ana tjetër, në të gjitha këto qendra ndjehen vështirësitë e natyrës materiale, të shkaktuara nga transicioni i vështirë. Por ka edhe vështirësi të përshtatjes në klimën dhe horizontet e reja shoqërore. Janë shpëtuar revistat si *Studime filologjike, Studia albanica, Gjurmime albanologjike*, *Seminari, Buletin i Shkodrës, Gjuha jonë, Gjuha shqipe,* por jo edhe *Recherches albanologiques*, *Shêjzat* apo *Albanica*. Ndërkohë kemi të reja si *Filologji*, *Studime*, *Studime albanologjike* etj. Kemi dhe botime të tjera, pra një rrjet dukshëm më të fuqishëm organesh ku diskutohet problematika e filologjisë shqiptare. Hetohet pamjaftueshmëria e bashkërendimit në të tilla botime, si në punë të tjera në këtë fushë. Me një fjalë, studimet filologjike shqiptare në një kuptim të gjerë të fjalës, megjithë vështirësitë jo të vogla të natyrës së jashtme, sot mund të marrin një elan të ri, që nuk është ai i organizimit të centralizuar të dikurshëm, po me një shpërndarje të gjerë. Në këto rrethana ndërmarrjet si hartimi i fjalorëve me pretendime pak më të mëdha apo i gramatikave me synime më të gjera kërkojnë bashkërenditje të forcave që veprojnë në qendra të ndryshme, çka paraqet vështirësi jo të vogla.

Në fushën e hartimit të fjalorëve ka pasur rezultate dhe ngecje.

Për këtë mbase do të kemi dhe një vështrim kritik në këtë takim.

Dua të përmend këtu dhe veprimtaritë që ndërmerr ASHAK-u në këtë fushë. Akademia e Kosovës dhe Akademia e Shqipërisë kanë themeluar Këshillin Ndërakademik të Gjuhës Shqipe. Synimet e Këshillit ishin hulumtuese sa i përket gjendjes aktuale, ndërsa praktike në rastet ku do të hetohej nevoja për ndonjë ndryshim sa i përket standardit të shqipes. Kjo e fundit theksohej sidomos në fushën e kulturës së gjuhës dhe të leksikut. Ndërkohë Këshilli u ballafaqua me vështirësitë e ristrukturimit të institucioneve përkatëse dhe të Akademisë në Tiranë, kështu që gjatë tërë vitit 2007 nuk arriti të mblidhej.

Në përpjekjet për të përmbushur mungesat e informimit është ndërmarrë botimi i serisë së veprave të albanistëve të traditës: deri tash kanë dalë Riza, Ajeti, Pedersen, Cimochowski, Miklošič, pritet të dalë Hamp, ndërsa në punë është vepra e Joklit. Shpresojmë se për një periudhë jo shumë të gjatë mund të kemi një korpus relativisht të plotë të këtyre botimeve. Projekt tjetër në formësim e sipër është ai krijimit të bazës së të dhënave të shqipes së shkruar.

Larg vetëkënaqësisë, nuk duket se duhet të mbetemi te pesimizmi i shprehur në vitet '70. Vështrimi ngastrërues në albanistikë vendëse e të huaj dhe në albanistikë të Shqipërisë dhe tjetër, në albanistikë përballë studimeve linguistike a filologjike mund të mos jetë baza më e mirë jo vetëm për t'i parë realisht të arriturat dhe mangësitë, po edhe për të ecur përpara në këto studime me ritme realisht të mundshme. Vështrimi integrues brenda albanistikës dhe brenda filologjisë me ndërlidhjet teorike e të tjera aktuale është baza më e mirë. Nëse dimë të përfitojmë nga modernizimi elektronik, shpejt mund të vijë koha për një fazë të re punimesh sintetizuese me bashkëveprim qendrash të ndryshme. Le të jetë kjo edhe një thirrje më shumë në këtë drejtim.

Shënim bibliografik

Agani (1981), Hilmi: **Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit në dritën e shqipes së Rahovecit e të Gjakovës**, Prishtinë, 383.

Ajeti (1987), Idriz: *Gjendja e studimeve albanologjike – rezultatet dhe detyrat*, në **Çështje të studimeve albanologjike I**, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1987, 15-30.

Ajeti (1997, 1998, 2002): **Vepra I, II, III, IV**, ASHAK, Prishtinë.

Akten (1977)**. Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums 1972**, Innsbruck 1977.

Altimari (1986), Francesco: Gli Arbëreshë: significato di una presenza storica, culturale e linguistica, në Altimari et alii (Eds.): **L'esilio della parola. La minoranza linguistika albanese in Italia**, Roma.

Altimari/ Savoia (Eds.): **I dialetti italo-albanesi. Studi linguistici e storico-culturali sulle communità arbëreshë**, Roma.

Ashta 1996, Kolë: **Leksiku historik i gjuhës shqipe I**, pa vit botimi, Shkodër, 496.

Ashta 2000, Kolë: **Leksiku historik i gjuhës shqipe III**, Shkodër, 303.

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, Vëllimi I, 2007. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Università degli Studi di Napoli L'Orientale, Dipartimento di Studi dell' Europa Orientale, 464.

Bariq, Henrik: **Hŷmje në historín e gjuhës shqipe**, Prishtinë, 1955.

Beci (2000), B.: **Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri**, Pejë, 231

Beci (2002), Bahri: **Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre**, Tiranë.
Bevington (1974), Gary Loyd: **Albanian Phonology**, Albanische Forschungen, Wiesbaden.
Bokshi (1978), Besim: **Rruga e formimit të fleksionit nominal të shqipes së sotme**, ASHAK, Prishtinë, bot. II, 2005.
Bokshi (1984), Besim: **Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike**, Prishtinë, 1984.
Bokshi (1998), Besim: **Pjesorja e shqipes** (vështrim diakronik), ASHAK, Prishtinë, 217
Bokshi (2002), Besim: **Për vetorët e shqipes**, ASHAK, Prishtinë, 195 .
Bonnet (1998), Guillaume: **Les mots latins de l'albanais**, Paris.
Boretzky (1975/76), Norbert: **Der türkische Einfluss auf das Albanische I, II**, Wiesbaden.
Buchholz (1977), O.: **Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen**, Berlin.
Buchholz, Oda/ Fiedler, Wilfried (1987): **Albanische Grammatik**, Leipzig.
Byron (1976), J.: **Selection among Alternates in Language Standardization: the Case of Albanian**, The Hague.
Byron (1979), Janet: *Language Planning in Albania and in Albanian-Speaking Yugoslavia*, **Word** vol. 30, nr. 1-2, April-August.
Çabej (1976), Eqrem: **Studime gjuhësore** I, Rilindja, Prishtinë.
Çabej (1976), Eqrem: **Studime gjuhësore** II, Rilindja, Prishtinë.
Çabej (1976), Eqrem: **Studime gjuhësore** III, Rilindja, Prishtinë.
Çabej (1977), Eqrem: **Studime gjuhësore** IV, Rilindja, Prishtinë.
Çabej (1977), Eqrem: **Studime gjuhësore** V, Rilindja, Prishtinë.
Çabej (1977), Eqrem: **Studime gjuhësore** VI, Rilindja, Prishtinë.
Camaj (1960), Martin: **Il 'Missale' di Gjon Buzuku**, Roma.
Camaj (1966), M.**: Albanische Wortbildung,** Wiesbaden.
Camaj (1971), M.: **La parlata albanese di Greci in provicia di Avellino**, Firenze.
Camaj (1977), M.: **Die albanische Mundardt von Falconara Albanese**, München.
Camaj (1984), M.: **Albanian Grammar**, Wiesbaden.
Çeliku (2000), M.: **Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe**, Tiranë.
Çeliku (2000), M.: **Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe**, Tiranë.
Cimochowski (1977), W.: *Die Albanologie in Polen*, në Akten (1977), 96-99;
Cimochowski (2004), Waclaw: **Studime albanistike**, ASHAK, Prishtinë.
Demiraj (1988), Sh.: **Gjuha shqipe dhe historia e saj**, Tiranë.
Demiraj (1986), Shaban: **Gramatikë historike e gjuhës shqipe**, Tiranë.
Demiraj (1993), Shaban: **Historische Grammatik der albanische Sprache**, Wien.
Demiraj (1994), Shaban: **Gjuhësi Ballkanike**, Shkup.
Demiraj (1996), Shaban: **Fonologjia historike e gjuhës shqipe**, Toena, Tiranë, 1996;
Demiraj (1997), Bardhyl: **Albanische Etymologien**, Amsterdam/ Atlanta.
Desnickaja (1968), Agnja: **Albsanskyj jazyk i ego dilekty**, Leningrad; shqip Prishtinë 1972.
Desnickaja (1984), A. V.**: Sravniteljnoe jazykoznanie i istorija jazykov**, Leningrad.
Desnickaja (1987), A. V.: **Albanskaja literatura i albanskij jazyk**, Leningrad.
Dodi (1985), A.: **Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe**, I (Fonetika). Tiranë.
Dodić (1977), L.: *Das albanische Lektorat an der Ruhr-Universitaet,* **Akten** (1977), 100-106;
Domi (1961), Mahir: **Morfologjia historike e shqipes**, dispensa, Tiranë.
Domi (1976), Mahir et al.: **Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare**, v. II. Tiranë.
Domi (1979), M.: *Gjuhësia shqiptare në 35-vjetorin e çlirimit*, **Studime filologjike**, 4, Tiranë, 3-14.
Elsie (1995), Robert: **History of Albanian Literature**, New York.
Erat (2008), Janez: **Etimološki sulovar albanskega vezika. Albanian Etymological Dictionary**, Second online publication, cf. Janez_si@yahoo.com, 146.
Fiedler (1977), W. *Albanologische Publikationen von Albanologen der Deutschen Demokratischen Republik,* në **Akten** (1977), 107-112;
Fiedler (2005), Wilfried: **Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555),** ASHAK, Prishtinë, 812
Fiedler (2007), Wilfried: **Pluralbildung im Albanischen**, ASHAK, Prishtinë.
Friedman (2004), Victor: **Studies on Albnaian and other Balkan Languages**, Pejë.
Gjinari (1989), Jorgji: **Dialektet e gjuhës shqipe**, Tiranë.

Gut (1977), C. : *L'état présent des études albanologiques en France,* **Akten** (1977), 113-118;
Haarmann (1972), Harald: **Der lateinische Lehnwotschatz im Albnaischen**, Hamburg.
Haebler (1965), Claus: **Albanische Grammatik von Salamis**, Harrassowitz, Wiesbaden.
Halimi (1985), Mehmet: **Kërkime dialektologjike**, Prishtinë.
Halimi (1993), Mehmet: **Vështrime gjuhësore**, Instituti Albanoklogjik, Prishtinë.
Halimi (1994), Halit: **Description phonétique et phonologique de l'albanais (dialecte guègue)**, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 204
Hamp (1992, nga 1954), Eric P.: **Vaccarizzo Albanian Phonology: The Sound-System of a Calabro-Albanian Dialect**, botuar bashkë me versionin italisht nga G. Belluscio: **Il sistema fonologico della parlata di Vaccarizzo Albanese**, Rende 1993.
Hamp (2007), Eric P.: **Studime krahasuese për shqipen**, ASHAK, Prishtinë.
Historia e letërsisë shqipe I-II 1971, ribotim, Prishtinë.
Historia e letërsisë shqiptare 1983**,** Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë.
Huld (1984), Martin: **Basic Albanian Etymologies**, Los Angeles.
Ismajli (1982), Rexhep: **Gramatika e parë e shqipes**, Prishtinë.
Ismajli (1985), R.: **Gjuha shqipe e 'Kuvendit të Arbënit'** (Grafi-fonet.-fonologji), Prishtinë.
Ismajli (1987), R.: **Artikuj për gjuhën shqipe**, Prishtinë.
Ismajli (1991), R.: **Gjuhë dhe etni**, Prishtinë.
Ismajli (1998), R.: **"Në gjuhë" dhe për "gjuhë"**, Pejë.
Ismajli (2005), R.: **Gjuhë standarde dhe histori identitetesh**, AShSh, Tiranë.
Janson (1986), Bernd: **Etymologische und chronologische Untersuchungen zu den Bedingungen des Rhotazismua im Albanischen unter Berücksichtungen der griech. Und lat. Lehnwörter**, Frankfurt/ Bern/ New York.
Jochalas (1977), T.: *Gli studi albanologici in Grecia,* në **Akten** (1977), 85-95;
Joseph (1983), Brian: **The Balkan Infinitive**, Cambridge.
Jucquois (1977), G.: *Les études albanologiques en Belgiquee,* **Akten** (1977), 119-121;
Kelmendi (1993), Tafil: **Funksionet e kohës foljore të pakryer të dëftores në shqipen e sotme letrare**, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 288
Klingenschmitt (1994), Gert: *Das Albanische als Glied der indogermanischen Sprachfamilie*, në Rasmunssen (Hrsg.): **In honorem Holger Pedersen**, Wiesbaden, 221-233.
Klingenschmitt (1994a), Gert: *Die Verwandschaftsverhältnisse der indogermanischen Sprachen*, Rasmunssen (Hrsg.): **In honorem Holger Pedersen**, Wiesbaden, 235-257.
Kolgjini (2004), Julie M.: **Palatalization in Albanian: an Acoustic Investigsation of stops and Affricates**, The University of Texas at Arlington, dorëshkrim i doktoratës, 263
Kostallari (1970), A.: *Les études linguistiques en Albanie*, **Studia albanica**, 2, Tirana, 99-115.
Kostallari (1972), A.: *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, në **Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj**, v. I, Tiranë.
Kostallari (1973), A.: **Gjuha letrare e sotme shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj**, Tiranë.
Lafe (1998-99), Genc: *Der italienische Einfluss auf das Albanische*, **Ponto-Baltica** 8-9, 47-172 e **Ponto-Baltica** 10, 31-120.
Landi-Rossi (1989), A.: **Gli elementi latini della lingua albanese**, Napoli.
Lloshi (1997), Xhevat: **Mbështetje për gjuhën letrare**, Tiranë, 157.
Lochner von Huettenbach (1977), F.: *Gustav Meyers Beitrag zur Erforschun des Albanischen,* **Akten** (1977), 122-155;
Mann (1977), Stuart: **An Albanian Historical Grammar**, Hamburg.
Mansaku (1997a), Seit: *Rreth parimeve të drejtshkrimit të Komisisë Letrare shqipe në Shkodër*, **Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1996),** Shkodër.
Mansaku (2004), Seit: *Historia e shqipes së shkruar dhe përkthimi i Biblës në shqipen standarde*, **Bibla shqip dhe traditat tona**, Tiranë, 29-37.
Matranga 2004, Luca: **E mbsuame e krështerë**, Edizione critica dei testi manoscriti e a stampa (1592), a cura di Mattero Mandalà, Sciascia Ed. Caltanissetta, 571.
Matzinger (2006), Joachim: **Der Altalbanische Text Mbsuame e Krështerë (Dottrina cristiana) des Lekë Matrënga von 1592,** Dettelbach., ss. 306.

Mihăescu (1966), Haralambie: *Les éléments latins de la langua albanaise*, në **Revue des études sud-est-européennes** 1-4, Bucureşti.
Mulaku (1968), Latif: **Govor Albanaca Bajkorske Šalje**, Prishtinë.
Mulaku (1998), Ragip: **Parashtesat e prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrime të vjetra (shek. XV-XVIII)**, Instituti Albanologjik, Prishtinë.
Orel (1998), Vladimir: **Albanian Etymological Dictionnary**, Leiden/ Boston/ Koeln.
Orel (2000), V.: **A Concise Historical Grammar of the Albanian Language**, Leiden/ Boston/ Koeln.
Pedersen (2004), Holger: **Studime për gjuhën shqipe**, ASHAK.
Pellegrini (1998), Giovan Battista: **Avviamento alla linguistica albanese**, Cosenza.
Pipa (1978), Arshi: **Albanian folk verse: structure and genre**, München, 191
Pipa (1978a), Arshi: **Hyeronimus De Rada**, Trofenik, München, 290
Pipa (1989), Arshi: **The Politics of Language in Socialist Albania**, New York, 283.
Pllana (1977), Sh.: *Albanologische Forschungsstaetten im Kosovo*, në **Akten** (1977), 77-84;
Polák (1977), V.: *Tschekoslovakische Albanologie,* në **Akten** (1977), 156-162;
Qosja (1971), Rexhep: **Historia e letërsisë shqipe. Romantizmi**. Prishtinë.
Raka (1997), F.: **Historia e shqipes letrare**, Universtieti i Tetovës, Tetovë.
Reiter (1977), N.: *Das Institut fuer Balkanologie an der Freien Universitaet Berlin,* **Akten** (1977), 167-171;
Ressuli (1985), Namik: **Grammatica albanese**, Torino.
Riza (1996), S.: **Vepra 1**, ASHAK, Prishtinë.
Riza (1997), S.: **Vepra 2**, ASHAK, Prishtinë.
Riza (2002), S.: **Vepra 3**, ASHAK, Prishtinë.
Riza (2004), Selman: **Vepra 4**, ASHAK, Prishtinë.
Sasse (1991), Hans-Jürgen, **Arvanitika**, **Die albanischen Sprachreste in Griechenland**, Teil 1, Harrassowitz, Wiesbaden, 548.
Schirò Junior 1959, Giuseppe: **Storia della letteratura albanese**, Milano.
Sejdiu (1979), Shefki: **Fitonimia shqipe e Kosovës**, Instituti Albanologjik, Prishtinë.
Shkurtaj (1996), Gj.: **Sociolinguistika**, Shtëpia botuese "Libri universitar", Tiranë, 274.
Shuteriqi (1978), Dh. S.: **Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850**, Tiranë, 1976, Prishtinë.
Shuteriqi DH., Bihiku K., Domi M., Bala V., Kodra Z. dhe Sako Z. 1971: **Historia e letërsaisë shqipe I-II**, Prishtinë.
Shuteriqi 1955, Dh. S.: **Historia e letrësisë shqipe**, Tiranë.
Sokolova (1983), Bojka: **Die albanische Mundardt von Mandrica**, Wiesabaden.
Solano, Francesco: **Manuale di grammatica albanese**, 1976.
Sulejmani (1979): **Embsuame e krishterë e Lekë matrëngës**, Prishtinë, 1979.
Svane 1982, G.: **Pjetër Budi, Rituale romanum 1621,** Concordence 1-2, Aarhus.
Svane 1985a, G.: **Pjetër Budi, Dottrina Christiana 1618,** with a trenscription in to modern orthography and a concordance, Aarhus.
Svane 1985b, G.: **Dottrina Christiana 1618,** Concordence 1-2, Aarhus.
Svane 1986, G.: **Pjetër Budi, Speculum Confessionis 1621**, with a transcription in to modern orthography and a concordance, Aarhus.
Svane 1986b, G.: **Pjetër Budi, Speculum Confessionis 1621**, Concordence 1-4, Aarhus.
Tagliavini (1965), Carlo: **La srtratificazione del lessico albanese**, Bologna.
Topalli (2006), Kolec: **Fonetika historike e shqipes**, Tiranë, 2006.
Tsitsipis (1981), Lukas: **Language Change and Language Death in Albanian Speech Communities in Greece: A Sociolinguistic Study**, University of Wisconsin-Madison, disertacion i pabotuar.
Tsitsipis (1998), Lukas: **A Linguistic Anthropology of Praxis and Language Shift. Arvanitika (Albanian) and Greek in Contact**, Oxford, Clarendon Press.
Vehbiu (1992), Ardian: *Albanese standard: peccatto originale e reduzione*, **Katundi yn**ë, 81,3, dhe **Albanica**, 3-4, 1992.
Vraciu (1977), A.: *Les études de linguistique albanaise et balkaniques en Roumanie*, **Akten** (1977), 172-203;
Žugra (1977), A. V.: *Bibliographie der albanologischen Arbeiten der sowjetischen Sprach-forscher*, **Akten** (1977), 204-210.

Alfred UÇI

KAOSI TERMINOLOGJIK NË FUSHËN E KULTURËS ESTETIKO-ARTISTIKE

Midis problemeve gjuhësore, ka rëndësi edhe *saktësimi terminologjik* i disa koncepteve, që kanë të bëjnë me shkencat estetiko-artistike të kohës sonë dhe me debatet e përplasjet e opinioneve të shumta, të ndryshme e të kundërta në këto fusha, por edhe të shumë *keqkuptimeve terminologjike*, të cilat instrumentalizohen, me ose pa keqdashje e vetëdije, në të mirë jo vetëm qëllimesh jashtartistike, por edhe artistiko-estetike. Situata bëhet më kaotike dhe më e turbullt po të kemi parasysh pështjellimet e panumurta terminologjike, rrjedhën e të cilave nuk janë në gjendje ta ndjekin e ta qartësojnë jo vetëm shqiptarët, por as të huajt. Kultura jonë u gjend e papërgatitur përballë trysnisë gjuhësore, terminologjike e kulturore, që rodhi pas mënjanimit të izolimit dhe pas hapjes dhe vendosjes së kontakteve me kulturat e tjera perëndimore, gjë që shtoi pasigurinë e dyshimet ndaj sistemit të miratuar zyrtarisht të shqipes standarde me të mirat e kufizimet e tij s'kish si t'i kishte shpëtuar kësaj trysnie edhe fusha e terminologjisë estetiko-artistike.

Situata të përafërta me këtë ka pasur edhe në të kaluarën, prandaj edhe mendimtarë të shquar për saktësi matematike në filozofi prej kohësh i kanë kushtuar vemendje të veçantë problemit të qartësisë së terminologjisë shkencore në përgjithësi. Qysh më 1704 G.V. Lajbnic pat paralajmëruar: *"Njerëzit kanë nocione të ndryshme, që i përdorin për të njëjtët terma. Dhe është e vështirë të kapet kuptimi i termave nga njerëzit e kohës sonë; ka vështirësi edhe më të mëdha për t'u gjetur kuptimin autentik librave antikë"*. Pra, ne mendojmë se ekziston një situatë konfuze e kaotike terminologjike; në këtë konstatim na ka bindur edhe puna që kemi bërë në hartimin e serisë së "Universit estetik", vëllimi i tretë i të cilit dëshmon sidomos për shek. XIX e XX se sa e larmishme, pluraliste ka qenë krijimtaria artistike dhe teoritë e interpretimet filozofike, estetike e kritiko-teorike të arteve, prirje që janë përcjellë edhe me konfuzion të madh terminologjik. Në një mënyrë më të drejtpërdrejtë mund të themi se

kaosi e konfuzioni terminologjik përcillet dhe ka nxitur për mirë e për keq polarizime ideologjike, shartime eklektike dhe kundërthenie absurde. Këtë fakt e ka vënë në dukje edhe esteti perëndimor Moris Vajtc: "*Shumë diskutime mund të shmangeshin,* -pohon ai, - *sikur termat estetike të mos aplikoheshin në të njëjtën temë të teorisë estetike, por të zbatoheshin veçmas ndaj pikpamjesh të ndryshme, për përbërës të ndryshëm të përvojës estetike*". Sigurisht, kjo rrugë do të ishte rezultative sikur të mënjanoheshin zhurmat kakofonike të terminologjisë themelore, përndryshe do të rrëshqitej në një empirizëm retrograd e do të humbiste vlera universale, e përgjithshme e termave të sferës së hulumtimeve estetiko-artistike. Saktësimi i kësaj terminologjie specifike nuk është një punë thjesht gjuhësore dhe kryesisht e gjuhëtarëve, është një problem **metateorik** i estetikës në radhë të parë, por edhe i raporteve të ndërsjellta të filozofisë, shkencave artistike dhe gjuhësisë. Po përmend një varg termash të vjetra e të reja, që e kanë humbur kuptimin e saktë dhe notojnë përgjithësisht në ujërat e subjektivizmit dhe arbitraritetit personal të përdoruesve: *epoka artistike*, idea estetike, vlera estetike, *objekti, subjekti, pasqyrimi, mimesisi, katarsisi, e vërteta artistike, idea estetike, realiteti virtual, stili, paradigma e sintagma estetike, drejtimi artistik, shkolla artistike, estetikja, metoda artistike, klasike, neoklasike, moderne, modernitet, modernizmi, bashkëkohësia, trilli, fiksioni artistik, poetika, letrariteti, struktura estetike, teksti, interteksti, konotacioni, epistemologjik, referencial, magjike, antiromani, aletërsia, informacioni, metateoria, shenja artistike, gjuha estetike, gjuha letrare* e shumë të tjera.

Fusha e terminologjisë estetiko-artistike është mjaft e gjerë, por prirja më e përgjithshme, që ndeshet në studimet bashkëkohore reduktohet kryesisht në atë **çka** përftohet nga raporti mbizotërues midis **modernizmit**, **postmodernizmit** dhe **klasikes** e **postnonklasikes;** këtij formacionit të fundit i premtohet të jetë edhe e ardhmja e sigurt e kulturës artistiko-estetike, që mbështet edhe parashikimin e muzgut ose të vdekjes së paralajmëruar të artit. Unë do të ndalem vetëm në disa aspekte të këtij raporti me karakter terminologjik, duke e trajtuar nga përgjithësimi i përvojave estetike të serisë sonë "Universi estetik" i botës moderne, që porsa u botua.

Te mjaft studime serioze bashkëkohore konkluzioni përfundimtar e përmbledhës i përmbajtjes së historisë së estetikës së kohës moderne pranohet si thelb i saj kalimi radikal e i pakthyeshëm nga kultura artistike e estetike ***klasike*** drejt një kulture artistike estetike ***nonklasike*** *(joklasike);* dhe me këtë pohim duket sikur u jepet përgjigje edhe pyetjeve, që qëndrojnë në vatrën e diskutimeve se cili është kuptimi i termit "*nonklasike*" në botën e sotme?

Qysh në krye pranojmë se koncepti i "Kohës së re" është relativ jo vetëm në kuptimin që mund të zbritet pak më tutje nga e kemi nisur ne ose duke e mbyllur deri aty nga mesi e fundi i shek. XIX, kur përmendet "*kriza*" në filozofi, në estetikë dhe në artet klasike, kur nis, sipas mjaft studiuesish, epoka e *nonklasikës*, pastaj e *modernizmit* dhe e vazhdimeve të mëtejshme. Koha e re nuk është identike me *kohën fizike*, *kronologjike*, por është nocion, i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me *përmbajtjen social-historike* dhe kjo përmbajtje nuk përkon plotësisht me *epokat e* kulturës artistiko-estetike të njerëzimit. Për shkak të pavarësisë relative, autonomisë që gëzon arti në shoqëri, ai ka qenë zhvilluar në shpërpjestime të përhershme dhe pabarazi të dukshme, qoftë me rrjedhat e kohës fizike, qoftë në hapësirë. Këtë e provon edhe universi estetik i kohës së re, siç e kemi paraqitur ne. *Kur* dhe *ku* ka filluar klasicizmi e *kur* i ka lëshuar vendin iluminizmit, *kur* dhe *ku* ka nisur *sentimentalizmi* dhe r*omantizmi* apo *realizmi* dhe kështu me radhë - *natyralizmi, impresionizmi, modernizmi, postmodernizmi* e më tej, nuk puqen as në kohë e as në vende, përkundrazi kanë qenë e janë të ndryshëm në Angli e Itali, në Francë e Gjermani, në Poloni e Rumani, në Rusi e në Shqipëri etj.

Nga ana tjetër, analizat e zhvillimit historik të universit artistiko-estetik tregojnë se nuk bën të pranohet një vijimësi absolute e pandërprerë, sepse s'do të mund të përcaktonim gjithë rrethanat e faktorët vendimtarë të kalimeve nga njëra etapë në tjetrën, nga njëra epokë artistike në tjetrën, s'mund të parashikoheshin *ndërprerjet, degradimet, përmbysjet e humbjet* që pëson procesi i zhvillimit historik të kësaj kulture. Përse vonohet hyrja e klasicizmit artistik në Angli dhe përse zgjatet ekzistenca e neoklasicizmit në Gjermani e Rusi, përse romantizmi në një kohë merr vrrull në Angli e nuk ndjehet në Kinë atë shekull, përse dominon në Gjermani e Itali dhe nuk ka këtë shtrirje të gjerë në Spanjë ose në Amerikë, etj. etj.; këto

fenomene janë të ndryshëm, sepse ekziston një raport dialektik midis *vazhdimësisë* e *ndërprerjeve diskrete*, sepse edhe drejtimet artistike kanë një lindje e kulm, por kanë edhe një të tatëpjetë, pas së cilës mund të vijë gjallërim e përtëritje në vende të tjera.

Dhe këtu vijmë në saktësimin edhe të kuptimit të një termi tjetër, të konceptit të "***klasikës**", "**klasicizmit***". Prejardhja e këtyre dy termave është nga fjala e latinishtes "*Classicus*", me të cilën shënohej *klasa e parë*, më e larta e qytetarëve të Romës antike, domethënë klasa "shëmbullore". Që këtej filluan të përdoren termat me ngarkesë estetike – "*klasika*", si një etapë e zhvillimit të artit dhe "*klasicizmi*", si një paradigmë parimesh e mënyrash të krijimtarisë artistike. Kështu, në Greqinë antike ekzistoi një kulturë artistike gati 2000-vjeçare, por shekulli IV p.e.r. është quajtur etapa "klasike", që dallohet nga periudha pararendëse e "*arkaikës*" dhe më pas nga ajo "*helenistike*", pasardhëse. Në qytetërimin romak modelet e letërsisë dhe arteve të Greqisë antike quheshin "*klasike*", "*shembullore*", domethënë modele që meritonin të ndiqeshin, të imitoheshin, pavarësisht se në qytetërimin romak u krijuan edhe vepra të shquara e origjinale artistike, që formuan "*klasikën romake*".

Termi "**klasika**", po me këtë kuptim pakashumë u përdor për të karakterizuar edhe periudha të mëvonshme të historisë së artit. Pas shek. XV dhe deri në shek. XX, termat "*klasika"* dhe "klasicizmi" janë përdorur për të shënuar përsosmërinë, mjeshtërinë e lartë, bukurinë e madhështinë e veprave të veçanta shkrimtarësh ose artistësh të shquar, madje edhe të ndonjë zhanri ose gjinie të tërë artistike, që ka qenë në etapa të caktuara estetikisht shumë produktive, siç pat qenë eposi, skulptura e arkitektura në antikitet. Po kështu, termi "*klasike*" ka karakterizuar edhe *doktrina teorike estetike*, si të Platonit, Aristotelit, Kantit, Hegelit etj., që përfaqësonin modele të mendimit estetik dyfish "*klasik*".

Në fillimet e veta klasicizmi identifikohej me përsosmërinë artistike dhe me kriterin absolut të shprehjes letraro-artistike. Ideali estetik i klasicizmit nënkuptonte bukurinë, qartësinë stilistike, elegancën e harmoninë e shprehjes artistike, përkushtimin e artit ndaj idesë e detyrës qytetare e morale. Ai quante të përkryer modelet e klasikës greko-romake dhe e nënkuptonte domosdoshmërinë e imitimit të dyfishtë të modeleve antike dhe të natyrës, ndonëse në

shumë raste përvoja e praktikave artistike dilte edhe përtej këtij parimi. Klasicizmi pranonte hierarkinë e zhanreve (në krye vendoseshin epopea, tragjedia, tabloja historike, fabula), domethënë ai njihte zhanre e stile "të larta" e "të ulëta". Më tej u ruajt koncepti i klasicizmit, por herë ngushtohej, herë zgjerohej disi kuptimi i tij, duke reflektuar pjesërisht edhe ndryshime të praktikave artistike të tipit klasik, herë për mirë e herë për keq. Kështu, për shembëll, Vinkelmani, Lesingu, Gëte ose Shileri etj. patën futur kuptime specifike në klasicizmin, ndonëse këta shkrimtarë nuk mbetën robër të kësaj platforme origjinale artistike, por përdorën edhe parime e orientime të tjera estetike, si për shëmbëll, *sentimentalizmin, realizmin, romantizmin*. Në traktatin estetik "Letra mbi edukimin estetik" Shileri u përpoq të argumentojë lidhjen e ngushtë të idealit estetik me lirinë, që e ndihmoi shkëputjen e ithtarëve të neoklasicizmit gjerman prej këtij dhe kalimin e tyre drejt platformës së romantizmit.

Duke pasur disa anë të përbashkëta, epokat artistike të antikitetit, rilindjes europiane dhe klasicizmit francez, me këtë prirje ndikoi që termi i klasicizmit shumë herë të identifikohej me idealin estetik të këtyre epokave. S'ka dyshim se ato karakterizoheshin gjithsesi edhe nga dallime të rëndësishme historike, duke qenë epoka të mëdha e të veçanta të historisë së kulturës artistike të njerëzimit. Imitimi ose ndjekja e estetikës së klasicizmit në vende të tjera të Europës gjatë shek. XVIII-XIX është quajtur **"neoklasicizëm**", që ka shënuar degëzimet e tij kryesisht në vende të tjera, në Gjermani, Angli, Austri, Rusi, Poloni e gjetkë. Shpesh veprat artistike, që përfshihen në qarkun e "neoklasicizmit", nuk patën atë shkëlqim e origjinalitet që kishin modelet më të arrira dhe estetika e klasicizmit.

Neoklasicizmi ka qenë identifikuar edhe me "**akademizmin**", që u përdor për të karakterizuar imitimin e neoklasicizmit francez dhe për të shënuar qendrime të vjetëruara, dogmatike, konservatore në art, largimin nga novatorizmi e origjinaliteti. Tani pranohet nga shumë studiues se në çdo drejtim të rëndësishëm artistik ka një *bërthamë* krijimesh të përsosura artistike, që quhet "*klasike*", si pjesa më përfaqësuese e arritjeve më të mira të këtij drejtimi. Në këtë kuptim mund të flitet për "klasikën" *e romantizmit, të simbolizmit, të realizmit*. Pavarësisht nga qendrimet nihiliste të avangardës artistike të fillimit të shek. XX ndaj kulturës dhe estetikës klasike, sado

paradoksale mund të duket, edhe **modernizmi** ka pjesën e vet "*klasike*", pjesën më të mirë, cilësitë e veprave më të përsosura, modelet më përfaqësuese të tij.

Ky pohim ka rëndësi jo vetëm në plan terminologjik, por edhe për të kuptuar se, në fund të fundit, edhe *përsosmëria moderniste* e arteve është realizuar jo në kundërshtim me gjithë vijimësinë e kulturës artistike, pra klasike, por në lidhje me të dhe modernizmi s'ka qenë një "*novacion absolut i kulluar"*. Ky konstatim na afron te idea se nuk ka një shkëputje të plotë, absolute nga traditat e klasikës, por ka një plotësim, përvijim dhe pasurim të saj me modele të reja e ripërtëritëse sipas kushteve e ndryshimeve të jetës. Përvijimi i klasikës edhe brenda modernizmit është një artefakt i rëndësishëm, që ndihmon për të kuptuar edhe atë gjerësi, atë hapje që u vu re në **postmodernizmin**, hapje drejt gjithë praktikave e ideve estetike me peshë të së kaluarës, traditave të mëparshme, madje edhe të dukurive që bartnin të parealizuara mundësi potenciale për zhvillim e pasurim ripërtëritës në aktualitet ose në të ardhmen e pritme. Kështu, piktura bizantine u zhvillua jo vetëm në një degë me frymë figurative, që kundërshtohej nga platforma ikonoplaste jofigurative, por edhe në ato trajta që përputheshin me këtë platformë, domethënë me modele të pikturës abstrakte, dekorativo-ornamentale, e cila gjeti shumë më vonë një ripërtëritje te piktura jofigurative, abstraksioniste të modernizmit.

Periudhat klasike, si kulme lulëzimi durojnë pak kohë, pas së cilave fillon rënia. Kështu, klasicizmi degradoi në "akademizëm", ose renesansa në muzgun e saj u përvijua me tipare të tjera të manierizmit, barokut ose me variante të klasicizmit francez. Janë të mundshme edhe kalimet nga platforma e një klasike, për shembëll, e romantizmit, te një platformë e klasicizmit antik (Gëte), ose Pushkini nga romantizmi te realizmi, ose Pikaso nga klasicizmi te kubizmi, abstraksionizmi, romantizmi, sendëzimi estetik e përsëri kthim te klasicizmi. Fakte të tilla flasin për *dinamizmin e brendshëm,* që paraqitet si një gjenerator i përhershëm i artit, që realizon kalime të çuditshme, të pabesueshme nga një platformë klasike, që vjetërohet, drejt një platforme të re, novatore, ose drejt shfrytëzimit e shartimesh të përvojave të larmishme përtëritëse. Kuptohet se pjesët, periudhat, segmente klasike gjatë kërkimeve të përtëritjes, kur zënë e vyshken, kryqëzohen e shartohen edhe me përvoja, që konsideroheshin

"primitive" nga këndvështrimi klasik. Dikur krijimet artistike të fiseve të prapambetura quheshin si modele primitivizmi, si të kundërta me vlerat klasike, kurse në shek. XX disa nga variantet më origjinale e të reja moderniste shfrytëzuan pikërisht elemente të disa kulturave artistike primitive. Dhe kështu u arrit që brenda modernizmit të ekzistonte si e barabartë estetikisht edhe piktura naiviste moderniste; madje është përthithur brenda klasikës bashkëkohore edhe baroku e manierizmi, gotika, ndonse dikur vlerësoheshin si anomali, si largime nga thelbi estetik i artit. Pas zhgënjimit në idealet demokratike të barazisë, vëllazërimit, lirisë e drejtësisë, pas revolucioneve demokratike borgjeze, nisi një periudhë kontestimi i rregullave dhe i parimeve normative të klasicizmit e neoklasicizmit nga ithtarët e romantizmit. Kulmi i këtij kontestimi u shfaq në Francë në vitet 20-30 të shek. XIX, që drejtohej kundër dogmave klasiciziane, të cilat e ndrydhën lirinë krijuese në art e në jetën publike. Prandaj esteti H. Kloc shkruan: *"Xh. de Kiriko, pas vitit 1920 i kthehet klasicizmit të shenuar subjektivisht, derisa Pikaso, paralelisht me objektivitetin e ri, pas vitit 1919, po ashtu sërish merr klasicizmin dhe njëkohësisht me pikturat kubiste-abstrakte pikturon edhe pikturat e tij klasiciste, në të cilat mbizotërojnë grupet e trupave të rëndë, të cilët kërkesën për vetkrijim të fazës së tij avangardiste e shndërrojnë në ngjarje të përkohshme. Piktori më i shquar i modernizmit është edhe pluralist par exellence. Për Pikason nuk ka tabu dhe shembëlli i tij provon se në klasikën moderne, bashkëkohore kanë qenë të mundshme të gjitha zgjedhjet referenciale, madje edhe ato historike".*

S'ka kubizëm të njëtrajtshëm, s'ka impresionizëm të njëllojtë, s'ka një stil të vetëm ekspresionist, prandaj është e mundur që brenda larmisë stilistike të secilit drejtimi të modernizmit të dallohen variante që kanë qëndruar më larg a më pranë asaj që përfshihet në **klasikën bashkëkohore** ose që kanë mbetur jashtë kufijve të saj. Nuk është për t'u çuditur që të njohim se ka edhe *realizëm ekspresiv*, *impresionizëm realist.* Aq më tepër që edhe përfaqësuesit më të shquar të çdo varianti të modernizmit, gati asnjëri prej tyre nuk ka krijuar vetëm në një mënyrë, sado e fuqishme të ketë qenë prirja e tyre për të parapëlqyer platformën e modernizmit, por kanë praktikuar procedime e forma të ndryshme të shprehjes artistike. Nuk është mëkat të dallosh periudhat "blu", "rozë", "kubiste", "klasike", "realiste" të Pikasosë, siç ka

ndodhur edhe me ithtarë të ekspresionizmit, që kanë kultivuar edhe stilin realist, natyralist, formalist, etj. Pastaj drejtimet e modernizmit nuk kanë qenë ndërtuar mbi një platformë të vetme ideoestetike, përkundrazi, ato kanë kritikuar e kanë mohuar njëra-tjetrën. Ithtarët e ekspresionizmit e kanë kundërshtuar stilin e procedimet krijuese impresioniste, ashtu si dhe pasuesit e kubizmit, duke dashur të kapërcenin "cektësinë", "sipërfaqësinë", "momentalitetin" impresionist e pretendonin se me procedimet e tyre kubiste, ekspresioniste synonin të kapnin e të shprehnin "thelbet", "thellësitë", "shumanësinë", brendinë "metafizike" të dukurive të realitetit, të shpirtit e të karaktereve njerëzore e të sendeve.

Në këtë kohë koncepti i neoklasicizmit filloi të identifikohej me një lloj dogmatizmi estetik, që pengonte novatorizmin, me ca rregulla strikte që absolutizoheshin nga racionalizmi, "*akademizmi*". Barazimi i "akademizmit" dhe i "klasicizmit", si dukuri negative të mendimit estetik dhe të praktikave artistike në shek. XIX e XX u përdor për të përligjur sulmet kundër tyre nga të dy krahët, si me thënë, nga "e majta" dhe nga "e djathta", domethënë nga pozitat e romantizmit, realizmit kritik, simbolizmit, formalizmit, natyralizmit, modernizmit etj.

Romantizmi vlerësohej si diçka, që i kapërcente kufijtë e vlerave estetike, si dukuri që dilte përtej masës së klasicizmit, kurse Viktor Hygoi, shkrimtar realist e romantik njëherazi e përfshinte në artin e vërtetë, krahas ose bashkë me gjithë variantet e mundshme të klasikës: *"Muza e re zë t'i shikojë sendet me një shikim më të lartë e më të lirë. Ajo e ndjen se jo gjithçka në këtë botë është e bukur nga pikpamja njerëzore, se në të e shëmtuara ekziston krahas të bukurës, e ulta krahas bukurisë, grotesku krahas së madhërishmes, e mira me të ligën, errësira me dritën. Në letërsi s'ka as* ***klasike****, as* **romantike***; këtu ka, si gjithkund, vetëm dy ndarje – të mirë e të mangët, të bukur e të shëmtuar, të vërtetë e të pavërtetë. Dhe në këtë gjë ne i kërkojmë vetes të ngulim këmbë, sepse ne kemi treguar një veçori karakteristike, dallimin kryesor, që i kundërqëndron, sipas mendimit tonë, arti bashkëkohor – artit antik, forma e sotme – formës së vdekur, ose, po të përdorim terma më pak të qarta, por më të përparuara, letërsinë romantike – letërsisë klasike. Asgjë nuk rritet pa rrënjë; epoka e*

pasuesja janë të përfshira gjithnjë në formë embrioni në epokën e mëparshme".

Kjo do të thotë se çdo kulturë artistike klasike mund të jetë e tillë, duke përthithur përvoja përsosmërie që mund të jenë të ndryshme deri edhe të kundërta me variantet klasike të mëparshme. Shpesh ka ndodhur që të tilla formacione artistike të jenë konsideruar "*mish i huaj*" për artin e estetikën klasike, ngaqë klasicizmi merrej si një tërësi rregullash, ligjsorish të pandryshueshme, ngaqë arti dhe vlerat e tij estetike shikoheshin si të përjetshme dhe nuk shikoheshin dinamizmi i brendshëm dhe shtytjet e jashtme që e ndryshojnë. Në të tilla raste potenciali asimiliues, që është edhe ndryshim, edhe begatim estetik, arritje e humbje, realizohen, në fund të fundit, si proces normal, kur struktura e re aktualizohet si një formacion i ri vital. Dhe kështu ndodh, sepse një kulturë vërtet klasike dhe estetikisht e vetmjaftueshme është e aftë të përthithë vlerat ushqyese të një kulture tjetër klasike e nonklasike, por të *vetmjaftueshme*. Edhe në shek.XX ka pasur e ka ende ithtarë të "klasicizmit", si për shembëll T. S. Elioti, A. Blloku, etj. Ndoshta më mirë do të ishte, që të tillë të mos quhen ithtarë të "klasicizmit", por të modeleve më të mira të "*klasikës*" së re e të vjetër, të harmonisë, rregullsisë, bukurisë dhe vërtetësisë artistike, të një ideali, që nxit lirinë krijuese, që s'krijon asnjë prangë e pengesë drejt idealit të përsosmërisë artistike. Edhe tek ne E. Haxhiademi, Adreni, Poradeci, Migjeni, A. Buza, Odhise Pasakali, Shijaku etj., prandaj veç termit "*klasicizëm*", ne e quajmë të dobishme të përdoret edhe termi "*klasika",* me të cilin shënohen gjithë arritjet më të mira të mendimit teorik estetik dhe të përvojave më pozitive artistike të çdo kohe, edhe të gjithë shkollave e drejtimeve kryesore të kulturës artistike të re të shek. XX, pra, të kulturës artistike të gjithë njerëzimit, që çon drejt një estetike *integrale, globale, pluraliste e të hapur*.

Në mendimin e sotëm estetik ka rëndësi të kthjellohet edhe koncepti i "**epokës artistike**", që lidhet me kategoritë që i përmendëm më sipër, por nuk është identik me to. Koncepti i "epokës artistike" nuk përkon me konceptin e "epokës historike" as *fizike*, as sociale, sepse historia e estetikës dëshmon për shpërpjestime midis tyre. Brenda një epoke të mirëfilltë social-historike (Koha e re, shek. XVII-XX), mund të ketë disa epoka artistike të ndryshme, ose e kundërta, brenda një "epoke historike" mund të ekzistojë më shumë se një

"epokë artistike". Mjafton, të kujtojmë shek. XIX dhe shek. XX për të ilustruar këtë që thamë. Por edhe më shumë ka rëndësi t'i afrohemi saktësimit të konceptit të "*epokës **së re** artistike*", e cila shënon, nga *njëra anë*, një formacion c*ilësisht të ri* artistik, me *kahe e përmbajtje* tjetër estetike, domethënë *ndryshe* edhe në *formë*, që porsa ka nisur ose që është në zhvillim *bashkëkohor* dhe, *nga ana tjetër*, që ende nuk ka përfunduar, nuk është mbyllur, por tregon krijime vërtet *të përsosura*.

"Epoka **e re** artistike" është në proces, vazhdon të ndryshojë para syve tanë dhe prandaj s'mund ta përfytyrojmë si diçka që ka mbërritur në stacionin e fundit të lëvizjes së saj. Se ç'po ndodh dhe çfarë po ngjizet në kazanin e kulturës bashkëkohore në përgjithësi dhe në sferën e mendimit estetik e të praktikave artistike bashkëkohore, në veçanti, gjithë kjo është e lidhur me sqarimin edhe të karakterit të shoqërisë, qytetërimit modern, edhe të vetë mundësive, vartësive dhe të vetmjaftueshmërisë të asaj që po ndodh. Në këtë rast kanë rëndësi të njihen e t'u jepet përgjigje problemeve të identitetit të "epokës **së re** artistike", të kufijve të shtrirjes kohore, të përmbajtjes dhe veçorive dalluese të saj. Nga analiza e historisë së estetikës mendojmë se njerëzimi ndodhet përballë fillimeve të një "*epoke të re artistike*". Ç'është ajo, nga se dallohet? Ajo ka filluar si një formacion që nuk mund të identifikohet tërësisht me epokat e klasikës, as me ato të nonklasikës (modernizmi e postmodernizmi) dhe po përdoren përcaktime verbale të ndryshme, që kanë karakter konvencional, si *postnonklasike*, *postkulture*, ose "*globalo-dixhitale*", "*informacionalo-dixhitalo-teknologjike*". Kjo quhet edhe "*moderne", "bashkëkohore*", por jo "*moderniste*", term që përdoret për të karakterizuar vetëm disa dukuri artistike të modernizmit ose postmodernizmit.

Shpeshherë thelbi, përmbajtja kryesore e "epokës së re artistike" ka qenë identifikuar dhe identifikohet vetëm me praktikat artistike të modernizmit, me pretendimin se vetëm brenda tij kanë qenë krijuar e përmblidhen vlerat kryesore artistike e estetike të reja, novatore, zbulimet e arritjet më të qëndrueshme, më të çmuara të kulturës artistike të shek. XIX-XX.

Kjo pikpamje nuk është e saktë dhe e deformon kuadrin e përgjithshëm të kulturës artistike të kësaj epoke, jo vetëm se ka pasur e vazhdon të ketë interpretime shumë të ndryshme të këtij termi, por

sidomos ngaqë struktura e kulturës artistike ka qenë shumë më komplekse, më heterogjene dhe prandaj nuk reduktohet vetëm në modernizmin. Edhe brenda vetë modernizmit ka pasur shkolla e drejtime shumë të ndryshme nga ekstremi i formalizmit tek ekstremi i natyralizmit; brenda kësaj game të gjerë e të përbërë ka pasur edhe dukuri ekstravagante, snobe, eksperimentale e të përçudnuara, që s'u ka mbetur as nam, as nishan, që janë mënjanuar pa lënë gjurmë ndonëse janë shfaqur nën etiketën e "modernitetit" të dukshëm në historinë e arteve e të letërsisë së epokës në fjalë. Por ka pasur edhe dukuri të qëndrueshme, vërtet novatore, që gjithsesi janë afirmuar dhe përbëjnë vlera që përfshihen në përmbajtjen e epokës së re artistike.

Përveç varianteve të modernizmit, në këtë epokë janë përfshirë edhe shumë drejtime, shkolla e rryma të tjera, madje jo vetëm realiste, të cilave nuk mund t'u mohohen vlerat e shquara konsistente, të qëndrueshme artistike, të cilat i përkasin fondit të artë të kulturës artistike botërore dhe që s'mund të konfondohen me modernizmin.

Qysh në fillim të shek. XX, kur porsa po nisnin betejat midis klasikës dhe nonklasikës, kur B. Kroçe mendonte për sintezat e përvojave të dy drejtimeve historike të estetikës, shpallte nevojën e pasurimit të përmbajtjes së estetikës klasike me përvoja të reja, me qëllim që kjo disiplinë progresiste të *mos* humbiste objektin e saj, që të përballonte çfarëdo përpjekje për të aktualizuar zhdukjen e objektit të saj, për të sintetizuar të gjithë përvojat e mundshme, që s'mund të parashikoheshin as me intuitë. Si neohegelian, ai i njihte fjalët e atij që kish paralajmëruar "vdekjen e artit", të cilën e pat përkthyer Niçe si "vdekje të perëndive", fjalë që deri sot keqinterpretohen me paralajmërime të kobshme jo vetëm për artin, por edhe për estetikën. Por në ato kohë kur pat qenë si aksiomë e padiskutueshme ideja se estetika është filozofia e bukurisë, filozofia e artit, Kroçe e kuptoi para të tjerëve atë që kishin ndjerë intuitivisht disa mendimtarë pararendës, - difektin e kësaj ideje, e këtij *përcaktimi*, nga që dihet se çdo përkufizim është ngushtim, por, ndryshe nga të tjerët, ai dha përcaktimin e artit si "**ekspresivitet**", që nuk u pranua nga shumë, aq sa edhe tani me të drejtë mund të dyshosh në universalitetin që desh t'i jepte ai formulës së tij, prandaj patën qenë të shumtë ata që e akuzuan se po largohej nga estetika klasike hegeliane; në të vërtetë ai parandjeu se po të mbrohej formula klasike, do të duhej të ndryshonte **objekti** i

estetikës dhe i artit, kurse ai ndjente se objekti i saj nuk do të ndryshonte, nuk "do të vdiste", por do të begatohej me dukuri të reja. "Ekspresiviteti" i hapte portat e estetikës dhe të artit, nuk varroste asgjë të panevojshme. Kroçe paralajmëronte domosdoshmërinë e estetikës për t'i zgjeruar sinoret e objektit të saj, për të përthithur, siç po bënte edhe vetë arti, pa paralajmërime të estetikës klasike përvoja të reja estetike moderne.

Para se të kishte përfunduar sqarimi i kalimit nga modernizmi te postmodernizmi në shkencën e estetikës u ngrit diskutimi mbi proceset që janë në zhvillim dhe që kanë të bëjnë me një përplasje midis estetikës klasike dhe përvojave të *nonklasikës*, të transformuara drejt një krijimtarie e mendimi estetik, që është shkëputur ose që e konsideron veten një etapë cilësisht të ndryshme jo vetëm nga nonklasika moderniste, por edhe nga ajo postmoderniste në kushtet e qytetërimit të sotëm teknologjik informativo-dixhital. Kalime nga një formacion ose epokë në një formacion ose epokë artistiko-estetike cilësisht të ndryshme kanë ndodhur edhe shumë herë të tjera, kur një epokë artistike është zëvendësuar nga një epokë tjetër. Por veçoria e kalimit në realizimin e tanishëm e drejt një gjendjeje të pritme qëndron në karakterin edhe më të thellë, më radikal të përmbajtjes së kthesës. Kjo kthesë po ndodh pasi është tashmë e njohur si praktikë e si teori nonklasike, pasi janë njohur pak a shumë paradigmat e sintagmat e drejtimet e saj. Tani janë duke ndodhur ndryshime, të cilat prekin themelet e estetikës, objektin, parametrat themelorë, metodat e hulumtimeve edhe gjithë instrumentarin me qëllim që arti të mbijetojë në paradigmën e re të qenies aktuale, që të kujtojnë ulërimat nihiliste të avangardizmit; por nuk është thjesht kështu, është më i rëndë ndryshimi dhe më i lidhur me atë çka i përket qenies aktuale. Gjithë përvoja e jokulturës së gjithë shekullit nuk dëshmon për zhdukjen e estetikës, as vjetërimin e saj, ajo e arti s'kanë përse të vdesin. Estetika ruan objektin e saj specifik – **estetikèn** kudo, por ajo ndodhet para zbulimesh të reja të mëdha, ngaqë estetikja e ka zgjeruar hapësirën jetësore që po mbulon qytetërimin e teknologjizuar; janë përgatitur edhe metoda e mënyra moderne të studimit të dukurive të reja estetike të këtij qytetërimi. Objekti i estetikës nuk ka humbur gjatë shek. XX, kur u zhvilluan procese kundërvënëse nga nonklasika ndaj klasikës. Tani janë mundësitë të mbijetojë e të konsolidohet e përtërirë porsa ka

dalë nga betejat e këtij shekulli dhe kur është çliruar nga shumë dokra teorike ekstravagante antiestetike, që nxitnin përsendëzimin e artit, kur tashmë janë të qarta disfatat e ideve të skajshme, mospërfillëse ndaj estetikës dhe artit të mirëfilltë, të atyre parimeve që të paradigmës "anti"-klasiko-artistike" deri në mohimin e idealit estetik në përgjithësi. Pas betejës me kohën, është bërë një seleksionim i madh, që ka sjellë edhe firo, edhe arritje, që ka hedhur sajesa të dyshimta estetike në koshin e historisë, që ka ndarë shapin nga sheqeri dhe që ka trashëguar *pjesët* ***klasike*** të drejtimeve estetike të modernizmit e postmodernizmit. Tashmë janë pastruar "hauret e Avgjisë" të shek. XX.

Nga ndeshjet, shtrëngimet e dhimbjet e lindjes së të resë, edhe përvojat e nonklasikës dëshmojnë se objekti i estetikës dhe arti u përket *universaleve qenësore* të ekzistencës dhe të kulturës njerëzore, se më fort kërcënohet ekzistenca e njerëzimit se sa e artit, e estetikës, që në betejat e mbijetesës së njerëzimit në fillimet e qytetërimit të pritshëm të shek. XXI e më tej. Ato janë një nga mjetet, një super-gjenerator i mbështetjes e i zhvillimit të vlerave njerëzore, humane në gjithë hapësirat e ekzistencës së njerëzimit dhe e një qëndrimi njerëzor ndaj botës deri përtej tokësore, planetare. Situata e qytetërimit të sotëm e të pritëm do të zgjerojë hapësirat e artit dhe estetikës, duke qenë të pavarura nga vullneti edhe i atyre që përpiqen ose ta injorojnë këtë zhvillim edhe i atyre, që duan, pas rrëzimit të mbetjeve estetike, të krijojnë mure, pengesa, monizma dhe dogmatizma për t'i mbyllur portat e zhvillimt, për të ngritur postblloqe të rinj, kinse për ta "modernizuar" më tej ose për ta dogmatizuar. Procesi që përputhet me prirjet objektive të zhvillimit të jetës, të qenies, përputhet me prirjet për pluralizëm teorik, metodologjik e krijues, tolerancë dhe demokraci, përtëritje rijsore të kulturës artistike e estetike. Përvojat e begata e të pandalshme ekspeimentesh radikale në gjithë sferat e kulturës, artit dhe diskursit teorik e metodologjik të estetikës gjatë gjithë shek. XX, pro ose kundra klasikës e nonklasikës, krijonë mundësinë për të saktësuar shprehjen verbale të objektit aktual të estetikës, në bazë të strategjive të reja racionale dhe të krijimtarisë konkrete të një shoqërie të hapur, e cila ndodhet në një rrugë transformimesh, që nuk kryhen me porosi, me urdhër nga ata që ngrenë tabu, mosbesim, që duan ringjallje vlerash "hyjnore", "të

përjetshme", "të patundshme", jashtë lëvizjes e dinamizmit të jetës, me absolutizimet e tyre për ringjallje inkuizicionale, survejuese, persekutuese, censuruese. Siç e pat shprehur Shileri në veprën e tij monumentale "Letra mbi edukimin estetik", ne duhet të shpresojmë në ardhjen e Aleancës së Shenjtë midis Bukurisë dhe Lirisë.

Edhe etapa e postmodernizmit nuk pat qenë thjesht vetëm një varg aktesh varrimi të artit, as një majë e panjohur lavdërimesh në historinë e estetikës. Në këtë etapë, nga fundi i shek. XX u integrua në estetikë një sistem i tërë parakategorish, që nuk ekzistonin më parë, por u bë një rivlerësim edhe i klasikës në kushtet e reja historike, të fillimit të shekullit XXI, duke u kthyer edhe te disa fillesa të para të kësaj historie, nga të cilat kanë qenë larguar prej tyre nga vetë zhvillimet e reja të klasikës, që, sipas nesh, hap shtigje për një integrim të zgjeruar gjithpërfshirës, një integrim për gjithë llojet estetikisht të vetmjaftueshme të së kaluarës, për të ecur drejt një *estetike integrale dhe pluraliste,* që disa studiues e kanë quajtur edhe "neoklasicizëm", që merr përsipër edhe akte katarsisi, spastrimi nga ca ide tejet radikale antiklasike të dekonstruktivizmit, poststrukturalizmit në drejtim të klasikës, duke rehabilituar sidomos funksionet komunikative të gjuhës, duke e zbehur, zbutur diçka thelbin e saj referencial, pasqyrues të shenjave të tij dhe duke rikthyer diçka nga e shënuara, domethënë realiteti. Theksi vihet në parimin e lojës së tekstit të subjektit dhe komunikimit subjektiv, në të cilën rikthehet funksioni i transmetimit të një kuptimi të caktuar, që e refuzonin dekonstruktivistët më të skajshëm. Ky është proces i kthimit drejt universaleve filozofike klasike, që u eliminuan në etapën e parë të posmodernizmit. Kjo s'do të thotë se kemi një kthim të plotë te paradigma klasike, por një orvatje për të shartuar dhe për të gjetur nivele kontakti komunikimi të estetikës postmoderniste me traditën klasike, domethënë me kategoritë e së madhërishmes, tragjikes, kanunit, stilit dhe pjesërisht pa ato cilësi, që në mungesë të të cilave ndërgjegja njerëzore e ndjen veten havadan. Sigurisht, në procesin e formimit të estetikës postnonklasike shfrytëzohen edhe dukuri të nonklasikës - të së bukurës, mimesit, pa humbur kuptueshmërinë e shenjave, kur zbythet paksa loja, ironia, e shëmtuara; ndërkohë disa kategori të nonklasikës ruhen me vlerën e kategorive të tilla si absurdi, labirinti, rëndomsia, trupësia, sendi, simulimi, ezoteria, dekonstruktivizmi etj.

Pavarësisht të pëlqen ose jo, nonklasika moderne ka kryer disa korektiva në kategoritë e artit, që nuk mund të mos përfillen. Në këtë drejtim ndikojnë elektronika, që e ka mundësuar krijimin e realiteteve virtuale, që luan një rol të madh në lojërat kompjuterike dhe të kontakteve me sitet përmes internetit. Në perspektivë do të rriten realitetet e situatat virtuale dhe spektatorë e personazhe në një mjedis artistik principielisht të ri, në një mjedis kuazireal, ku veprojnë mekanizma dixhitale, që qysh tani kanë filluar të sjellin rezultate. Dhe brenda një sistemi të tillë komunikimi përsëri do të qëndrojë "e zgjidhur" pyetja se ç'është e ç'do bëhet me të? Njerëzimi është në pragun e një të qenuri tjetërsoj të përvojës estetike, të ndërgjegjes estetike, të shkencës së estetikës të **postnonklasikes**. Dhe në qoftë se **klasikja** lëvizi në kufijtë e së *bukurës, së madhërishmes, harmonisë, mimetikes, shpirtërores*, e **nonklasik**ja evoluoi në kuadrin e së *shëmtuarës, dizharmonikes, rëndomësisë, trupores*, **postnonklasikja**, e mbështetur edhe në përvojën *klasikes* dhe *nonklasikes*, do të zhvillohet në rrafshin e **përgjithësimeve sintetike** të reja**,** të mbështetur edhe te *loja, rastësitë, ironia* etj., kurse *kontakti* dhe *komunikimi* midis tyre do të jenë lëvizje e një *kulture artistike gjithpërfshirëse, integrale, të hapur e pluraliste, por gjithnjë mbi themelet estetike të një kozmosi të ri estetik*.

Nonklasikja, duke mohuar shumë dukuri e parime të përvojës estetike edhe të klasikës, e ka zgjeruar shumë fushën e estetikës moderne. Problemet që lindin nga avancimi i përvojave nonklasike të estetikës bashkëkohore, me të cilat është e angazhuar fort e parasëgjithash estetika bashkëkohore, por mesa duket përvoja e re nonklasike e saj nuk shemb themelet metateorike të estetikës, por ngjall interesimin e saj për dukuri të panjohura, që sjellin përvoja raportesh të reja empirike me realitetin, krijimtari estetike dhe realitetesh virtuale.

Ashtu si klasika, edhe nonklasika, që e kanë afirmuar veten si vatra të përqendruara të përvetësimit estetik të realitetit, të qenies bashkëkohore të njerëzimit, kanë krijuar një realitet tjetër estetik, imagjinar, virtual, i cili as e mohon, as e shpërfill realitetin objektiv, por me të është siç ka qenë arti gjithnjë. Mënyrat e këtij kontakti të përhershëm nuk kanë qenë të njëjta, ato kanë ndryshuar. Dhe në çdo kalim ka pasur dukuri që mendohej se ishin të kundërta e të

papajtueshme me të kaluarën, që zhduken pakngapak si atomet radioaktivë, që shkrihen duke rrezatuar nga mënyra e tyre e të qenit. Mjafton të kujtojmë kalimin nga lashtësia antike pagane në artin fetar të mesjetës, që dukeshin si krejtësisht të huaja e të papajtueshme me njeri-tjetrin, por u ruajt i përbashkët thelbi "hyjnor" i njeriut e natyrës, i paraqitur në art dhe dallimi midis politeizmit e monoteizmit, por që gjithsesi e mundësuan kalimin nga hyjnitë e antropomorfizuara në Krishtin-Njeri-Perëndi. Sa e sa herë është përsëritur ky proces, do të jetë i pashmangshëm edhe drejt së ardhmes, si një raport midis realitetit objektiv e virtual dhe artit. Pse ndodh kështu? Sepse vetë realiteti, kozmosi dhe shoqëria njerëzore janë antinomike, kontradiktore. Atëhere përse të mos ishte edhe arti një realitet kundërthënës, por specifik estetik? Arti dallohet si dukuri specifike me *thelbin e tij estetik,* por ky thelb është sajuar nga njeriu me lëndë natyrore, me lëndë të parë realiteti dhe me shpirt, mendje, intuitë, ndjenja, me ideal social-estetik etj.; ky thelb estetik shquhet që është materializim i një ideali estetik, domethënë i përsosmërisë. E pse duhet të vdesë se ekziston si unitet kundërthëniesh? Po aty qëndron edhe vatra ku ngjizet kjo "*materie e përsosur, harmonike estetike e mrekullishme*", ky produkt i "lojës" magjike të intelektit dhe të imagjinatës, burim i pashtershëm eliziri, kënaqësie edhe kur tregon bukuri, edhe kur tregon shëmtimin e asaj që na rrethon. Ja përse nuk vdes e nuk meriton të vdesë arti!

10. Analiza objektive e zhvillimit të mendimit estetik dhe e praktikave artistike të dy shekujve të fundit të çon drejt idesë së sintetizimit të një **estetike integrale**, e cila do të duhej të ishte një teori e **hapur, e gjerë, gjithpërfshirëse**, **pluraliste** që të mbështetej në frymën antidogmatike, antinormativiste, në frymën e dialektikës e së vërtetës estetike. Pranimi i estetikës integrale pluraliste, si kurorëzim për piknisje të mëtejshme estetikisht produktive të këtij zhvillimi, nuk është një hipotezë jona subjektive e arbitrare, nuk është shteg drejt një konceptimi eklektik të mendimit e të përvojave teorike, artistike të larmishme e të kundërta. Edhe në të kaluarën ka pasur estetë, që në vend të kundërvënieve të drejtimeve e rrymave artistike kanë parapëlqyer një konceptim të tyre të gjerë, të hapur dhe integrues. Në një mënyrë më eksplicite për një estetikë integrale ka qenë shprehur esteti i mirënjohur franez Sh. Lalo, aty nga mesi i shek.

XX, kur njihej tashmë karakteri heterogjen i strukturës së kulturës artistike bashkëkohore. Ai e kundërshtonte dogmatizmin e vjetër të tipit "akademik", të cilin e quante "apologji të traditës së vdekur", por po kështu nuk pajtohej me dogmatizmin modernist, që e konsideronte "apoteozë të trillit që ngutet për të vdekur nesër". Lalo pranonte se estetika e së ardhmes do të duhej të orientohej nga parimi metodologjik i maksimumit të unitetit në pajtim me maksimumin e ndryshimit, i unitetit në larmi, prandaj ai e quante të rëndësishme që estetika integrale "*duhet t'u bëjë apel gjithë metodave të vlefshme, por për secilën duhet të caktojë kufijtë e sakta", që është thirrje për shkencën e estetikës. Në një mënyrë figurative ai thoshte se "estetika shkencore integrale do të ishte me radhë: matematikë apo mekanikë, fiziologji, psikologji dhe socilogji", sepse, sipas tij, "çdo ide është forcë" dhe prandaj "estetika duhet t'i zgjerojë idetë që duhet të jenë forca... Estetika duhet t'i kuptojë fort mirë të gjitha shkollat, - ka shkruar Sh.Lalo, - si klasicizmin, ashtu edhe romantizmin, si primitivët, ashtu edhe dekadentët"*.

S'bën të pritet e kërkuar nga estetika shkencore të japë atë që s'mundet; është si puna e mjekësisë që s'mund të shpallim falimentimin e saj, nga që ka të sëmurë e të shëndoshë që vdesin. Edhe estetika s'është garancia e vetme për krijimin e veprave të frymëzuara e të përsosura, por ajo ka shumë në dorë për mbarë. "Nga pikpamja shkencore, - shkruante në kohën e vet Sh. Lalo, - duhet thënë se realizmi dhe idealizmi, ekspresionizmi e konstruktivizmi përbëjnë dukuri të natyrshme, dhe shkollat e papajtueshme, sipas së cilave njerëzit ndahen; kjo ndarje vjen edhe për shkak të paditurisë dhe paragjykimeve. Eklektizmi i sotëm mundet e duhet të shfrytëzojë gjithë shfaqjet e vrrullit krijues tek njeriu". Ky zë nuk është arbitrar, por kishte të bënte me atë qëndrim, që pa e kuptuar, formulohej brenda estetikës integrale shkencore, që pranonte nën emrin e romantizmit ose realizmit kritik krijimtari me orientime shumë të ndryshme estetike, ashtu siç u përsërit në shek. XX pranimi i një baze të përbashkët metateorike të drejtimeve të ndryshme dhe të kundërta brenda modernizmit ose neorealizmit, klasikës e nonklasikës. Estetika nuk mund të qëndrojë indiferente as ndaj jetës, as ndaj zhvillimit të praktikave të larmishme estetikisht të vetmjaftueshme të artit bashkëkohor, që e favorizojnë edhe përparimin e shkencës së

estetikës. Do të vazhdojë të aktualizohet ajo që parashikonte Hegeli, i cili pat thënë:

"Unë jam i bindur, - shkruante Hegeli, - *se akti më i lartë i arsyes, që pushton gjithë idetë, është akt* ***estetik*** *dhe e vërteta dhe mirësia bashkohen me shpërgajt amëtarie te* ***bukuria****. Filozofi, ashtu si poeti, duhet të zotërojë dhunti estetike. Filozofia e frymës është filozofia* ***estetike****". Kësaj kërkese bën t'i përgjigjemi për të saktësuar edhe shumë terma të vjetër e të rinj, duke lidhur e përputhur racionalisht kuptimet e tyre në harmoni e në shërbim të "filozofisë estetike".*

Matteo MANDALÀ

TEORIA E REZULTATEVE DHE REZULTATI I TEORIVE: PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT EPISTEMOLOGJIK TË FILOLOGJISË SHQIPTARE

Pjesa kryesore e kumtesës sime fillimisht synonte të përvijonte një histori panoramike të studimeve filologjike të kryera në Itali dhe njëkohësisht të qëmtonte në diakroni elementet teorike dhe rezultatet praktike të arritura gjatë rreth një shekulli e gjysmë persiatjesh dhe përvojash në lëmin e ekdotikës. Mirëpo pas leximit të programit të këtij tubimi shkencor, u detyrova ta ndryshoj versionin origjinal të kumtesës, sepse më tërhoqën vëmendjen dy fakte:

Së pari, se vetëm pesë-gjashtë kumtesa nga 50 të parashikuara trajtojnë çështje që lidhen me filologjinë, kuptuar si kritikë teksti, ndërsa të tjerat që përbëjnë pjesën dërrmuese të kumtesave trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me fusha të afërta të ekdotikës, por që dallohen prej kësaj për nga objekti i analizës, metodologjia dhe synimet.

Së dyti, se këto kumtesa mbahen nga studiues që vijnë kryeshisht nga qendra kërkimore të Evropës Perëndimore. Në vështrim të parë mund të duket se kemi të bëjmë me fakte dytësore e ndoshta pa rëndësi. Mirëpo në të vërtetë nuk është kështu, sepse nëse ia hyjmë të zbulojnë shkaqet e këtij dallimi, dalin qartë përmasat e vërteta epistemologjike të asaj që unë do ta quaja pa ngurruar një anomali të madhe.

Shumëllojshmëria e interesave shkencorë si edhe mungesa e baraspeshës që rrjedh soje gjatë këtij debati nuk janë fryt i një rastësie të paparashikueshme, por ato përbëjnë një konstante që ka karakterizuar të gjitha tubimet me objekt "studimet filologjike" shqiptare. Është e hidhur ta thuash, por gjendja aktuale e studimeve filologjike në fushë të shqipes, duke qenë e paqartë dhe e papërcaktuar suaza shkencore ku këto vendosen, nuk paraqet ende as njësim qëllimesh e as metodologji të përbashkëta. Hulumtimi i rrënjëve të

vërteta të dallimit kulturor dhe shkencor që ende sot kundërvë Lindjen dhe Perëndimin e Europës, parakupton analizën e zhvillimeve që kanë dalluar jo vetëm teoritë mbi filologjinë, por edhe praktikën që lidhet me këtë lëmë, e natyrisht, edhe rezultatet që rrjedhin nga këto teori. Për të arritur tek çasti kur zuri fill ky dallim mjafton t'i përgjigjemi një pyetjeje thelbësore: ç'është filologjia?

Në Perëndim përgjigjja e kësaj pyetjeje mund të hasë në vështirësi të shumta që kanë të bëjnë me përkufizimin e metodave në përsosje e sipër, por jo me përcaktimin e objektit të punës, që është teksti kritik apo me përshkrimin e synimeve, që u përgjigjen rindërtimit të transmetimit dhe botimit kritik të tekstit. Në fakt objekti dhe synimet në Perëndim kanë mbetur të pandryshuara qysh prej themelimit, aty nga shekujt III-II para Krishtit, të filologjisë si shkencë e tekstit a, thënë ndryshe, të kritikës së tekstit. Duke lënë mënjanë shtjellimin e fazave të ndryshme që kanë karakterizuar zhvillimin historik të lëmit të ekdotikës, po kujtojmë këtu se afirmimi i një metode të posaçme dhe moderne për hetimin filologjik e zë fillin qysh nga mesi i shek. XIX. Ishte merita e filologut gjerman Karl Lachmann, i cili në vitin 1850 me botimin e veprës së Lukrecit *De rerum natura* i dha emrin e tij metodës së rindërtimit të traditës së dorëshkrimeve sipas mënyrës stematike[1]. Në vitin 1928 filologu frëng Joseph Bédier[2] bëri një përpjekje për të revizionuar metodën lachmanniane, por vetëm me ndihmesën vendimtare të filologut italian Giorgio Pasquali në vitin 1934 u rivlerësuan mësimet e themeluesit të filologjisë moderne dhe u zhvillua e pasurua më tej metoda[3]. Dallimet

[1] (Karl Lachmann) Caroli Lachmanni *in T. Lucretii Cari De rerum natura libros commentarius*, Quartum editus, Typis et impensis Georgii Reimeri, Berolini 1882.

[2] Joseph Bédier, *Le Lai de l'Ombre*, Extr. des L'Index lectionum quae in Universitate Friburgensi, anni 1890 habebuntur. Joseph Bédier, "La tradition manuscrite du *Le Lai de l'Ombre.* Réflexions sur l'art d'éditer les anciens textes" në *Romania*, LIV, 1928, f. 161-198.

[3] Giorgio Pasquali, *Storia della tradizione e critica del testo*, Firenze, Sansoni, 1974 (I ed. 1934). Shih Paul Maas, *Critica del testo*, Firenze, Le Monnier, 1984. Silvio D'Arco Avalle, *Principî di critica testuale*, Antenore, Padova, 1972. Gianfranco Contini, *Breviario di ecdotica*, Torino, Einaudi, 1992. Giorgio Inglese, *Come si legge un'edizione critica. Elementi di filologia italiana*, Carocci, Roma, 2006. Lorenzo Renzi - Alvise Andreose, *Manuale di linguistica e filologia romanza*, Il Mulino, Bologna, 2006. Alfredo Stussi (a cura di), *Fondamenti di critica testuale*, Il Mulino, Bologna, 1998. Alfredo Stussi, *Introduzione agli studi di*

metodologjike më të rëndësishme kishin të bënin me parimet mbi bazën e të cilave duhej zgjedhur varianti tekstor që do të futej në botimin kritik, por filologët e lartpërmendur pajtoheshin në një pikë: filologjia është shkenca që merret me tekstet, me transmetimin dhe me rindërtimin e tyre, ndërsa shkencat e tjera (kryesisht gjuhësia, por edhe letërsia), ndihmojnë gjatë analizës ekdotike. Kështu mund të pohojmë se ndërsa filologu është njëherazi edhe gjuhëtar, posaqë njeh historinë e gjuhës së tekstit që shqyrton, gjuhëtari nuk është i detyruar të studiojë tekstin për të përgatitur një botim kritik. Këtej rrjedh dallimi thelbësor që haset në kuadrin epistemologjik të filologjisë që zbatohet në Perëndim, një kuadër ky që i ka njohur filologjisë një objekt kryesor, duke e bërë kështu të marrë pamjen e «një shkence dhe një disipline që synon hetimin e një kulture, të një qytetërimi letrar, të lashtë apo të ri, përmes studimit të teksteve letrare dhe të dokumenteve gjuhësore, duke i rindërtuar ato në formën origjinale e duke qëmtuar syresh aspektet dhe tiparet gjuhësore e kulturore» (De Felice-Muro, *Dizionario della lingua e delle civiltà italiana contemporanea*).

Në Europën Lindore janë përvijuar dy konceptime të ndryshme të *ancilla studiorum*. I pari, përgjithësisht i njëjtë me konceptimin perëndimor, dëshmohet nga studimet dhe punimet filologjike që u botuan edhe në Shqipëri gjatë viteve '30 të shekullit të shkuar[4]. Ky konceptim gjendet madje edhe në përkufizimin që në vitin 1954 jep *Fjalori i gjuhës shqipe*, sipas të cilit filologjia përfshin një fushë kërkimi të përcaktuar qartë si «dija që studion veprat letrare dhe gjuhën në lidhje me kritikën e teksteve dhe me gramatikën», pra si një shkencë që, duke synuar studimin e veprave letrare dhe të gjuhëve përkatëse, shihte në "kritikën e tekstit" mjetin kryesor për hetimin shkencor. Këtij konceptimi i përgjigjen kërkimet dhe studimet e disa studiuesve shqiptarë, të gjithë gjuhëtarë, që i kushtuan një pjesë të

filologia italiana, Bologna, Il Mulino, 1994. Franca Brambilla Ageno, *L'edizione critica dei testi volgari*, Padova, Antenore, 1984. Armando Balduino, *Manuale di filologia italiana*, Firenze, Sansoni, 1979. Bruno Bentivogli, Paola Vecchi Galli, *Filologia Italiana*, Milano, Bruno Mondadori, 2002. Alfredo Stussi, *Fondamenti di critica testuale*. Bologna, Mulino, 1998.

[4] Shih Justin Rrota, "Shkrimtari mâ i vjetri i italo-shqyptarvet: Lukë Matranga (1592), në *Hylli i Dritës*, vjeta VII, Shkodër, 1931, f. 505-522; teksti i dorëshkrimit të Matrangës gjendet në f. 510-522.

mirë të përpjekjeve të tyre botimit kritik të monumenteve gjuhësore të shqipes. Dua të kujtoj këtu Eqrem Çabejn, që në vitin 1958 përgatiti botimin paradigmatik të *Mesharit* të Gjon Buzukut[5]; Selman Rizën, që i kushtoi studimit të dokumenteve të vjetra të traditës letrare shqipe energjitë e tij më të mira[6]; por edhe Kolë Ashtën[7], Ziaudin Kodrën[8], Osman Myderrizin[9], Shaban Demirajn[10], Idriz Ajetin[11], Rexhep Ismajlin[12], Fadil Sulejmanin[13]. Këta studiues patën dy merita: mbajtën gjallë praktikën filologjike që bazohet mbi analizën e tekstit e që synon botimin më të mirë kritik të tij, por edhe ditën të ndërtojnë një urë lidhjeje ideale me traditën e studimeve filologjike shqipe të zhvilluar qysh nga fundi i shek. XIX, duke u mbështetur në konceptin epistemologjik të filologjisë europiane.

---

[5] Eqrem Çabej, *«Meshari» i Gjon Buzukut (1555). Botim kritik: Pjesa e parë - Hyrje dhe Transliterim; Pjesa e dytë - Faksimile dhe transkribim fonetik*, Tiranë, 1968.

[6] Selman Riza, "Disa teza mbi tre dorëshkrimet e katekizmit të Matrëngës", në *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, Tiranë, 1962, nr. 1, f. 76-81.

[7] Kolë Ashta, "Shënime e vërejtje rreth gjuhës dhe leksikut të Lekë Matrëngës", në *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, nr. 2, Tiranë, 1957, f. 85-86. Kolë Ashta, "Në kërkim të anës letrare të Matrëngës (1592)", në *Shkodra*, viti V, nr. 5, Shkodër, 1965, f. 189-190.

[8] Zef Skiroi, *Mino. Elegji*, përgatitur nga Ziaudin Kodra, drejtor i shkollës normale, Elbasan, 1939. Gavril Darë i Riu, *Kënka e sprasme e Balës.* Redaktuar dhe pajisur me shënime nga Ziaudin Kodra, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1955.

[9] Osman Myderrizi, "Letërsia shqipe me alfabetin arab" në *Buletin për shkencat shoqerore*, 1955, nr. 2, Tiranë, 1955, f. 148-155.

[10] Mes shumë studimeve me karakter filologjik të prof. Demirajt, dua të veçoj ato mbi veprën e Gavril Darës: Gavril Dara i Riu, *Kënga e sprasme e Balës* e pabotuar e përshtatur në shqipen e sotme nga Sh. Demiraj, Naim Frashëri, Tiranë, 1961; Gavril Dara i Riu, *Kënga e sprasme e Balës,* transkribuar e përshtatur nga Shaban Demiraj, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1994. Shaban Demiraj, "Rreth autorësisë së poemës *Kënka e sprasme e Balës*", në *Studime Filologjike*, nr. 3-4, Tiranë, 2003, f. 63-74. Interes të posaçëm filologjik paraqet edhe botimi i veprës së Naim Frashërit, *Lulet'e verësë*, redaktuar dhe pajsur me shënime nga Shaban Demiraj, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve Naim Frashëri, Tiranë, 1961.

[11] Idriz Ajeti, *Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX*, Rilindja, Prishtinë, 1960 ribotuar në *Studime dialektore dhe etimologjike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1968, f. 217-302; Idriz Ajeti, *Dokumenti ma i vjetër i shqipes së Kosovës, shkrue me alfabetin arab*, në *Rilindja* nr. 1-2-3, janar 1960, Prishtinë, 1960.

[12] Rexhep Ismajli, *Gramatika e parë e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

[13] Fadil Sulejmani, *E Mbsuame e Krështerë e Lekë Matrëngës,* Prishtinë, 1979.

Konceptimi tjetër diametralisht i kundërt me të parin, është po ai që gjëllin ende sot, me gjithë ndryshimet ideologjike, politike e kulturore të këtyre dy dhjetëvjeçarëve të fundit. Për të nxjerrë në pah tiparet e këtij konceptimi, po nisemi edhe në këtë rast nga përkufizimi i *Fjalorit të gjuhës shqipe* botuar në 2006, ku me filologji kuptohet «tërësia e shkencave që studiojnë gjuhën dhe krijimtarinë letrare të një populli» (f. 273). Ky përkufizim është marrë nga *Fjalori i shqipes së sotme* i vitit 1984, që nga ana e tij e trashëgon nga *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* i vitit 1981. Sipas këtij përkufizimi filologjia përfshika fusha kërkimesh sa të shumta aq edhe të ndryshme, pak a shumë sa ç'janë shkencat shoqërore në tërësinë e tyre. Ky karakter gjithëpërfshirës dhe i papërcaktuar i hapësirës epistemologjike që i jepet filologjisë, sikundër dihet, është huazuar prej vizionit sovjetik që iu imponua shqiptarëve qysh nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Prej asokohe, studimet filologjike, përfshirë ato shqiptare, në vendet që sundoheshin ideologjikisht nga komunizmi, reflektojnë të njëjtin konceptim parashkencor që e konsideron filologjinë si një lloj "shkence të shkencave", duke i njohur asaj pak a shumë të njëjtin rol që Aristoteli dhe Hegeli i veshin metafizikës në gjirin e shkencave filozofike.

Dallimi mes konceptimit të parë, apo perëndimor, dhe të dytit, atij lindor, nuk ka të bëjë aspak, sikundër më ka rënë rasti të dëgjoj, me një dallim thjesht semantik, mes një kuptimi të ngushtë dhe një tjetri më të gjerë të termit. Këtu kemi të bëjmë me një dallim, së pari, ideologjik dhe, së dyti, epistemologjik. Ta konstatosh atë nuk është një hollësi pedante, por një domosdoshmëri që të lejon të rrokësh edhe pasojat që rrjedhin soje qoftë në fushë të organizimit të arsimit të lartë universitar, qoftë edhe në fushë të kërkimeve dhe punimeve filologjike. Diskutimi i kësaj çështjeje në këtë tubim më duket me vend, sepse ajo hyn mes atyre që duhen trajtuar me përparësi, në funksion të një procesi të suksesshëm integrimi shkencor, duke filluar natyrisht nga përvijimi i disiplinave homogjene dhe simbiotike. Është e papranueshme, fjala vjen, që fakultetet albanologjike të kësaj pjese të Europës të mos përfshijnë mësimdhënien e një lënde me objekt kritikën e tekstit. Po ashtu, është e papranueshme që dikush që merr një diplomë në "shkencat filologjike" të mos ketë idenë se ç'do të thotë të përgatitësh një botim kritik, të punosh një aparat kritik, të

rindërtosh përmes hetimit të përçimit të teksteve një *stemma codicum*, të kërkosh vullnetin e fundit të autorit, të përcaktosh autorësinë, të datosh dhe të pasqyrosh zhvillimet grafiko-alfabetike të një vepre, të një autori, të një epoke a të një treve kulturore. Së fundi, është e papranueshme mungesa e një terminologjie shkencore të përbashkët, çka bën që edhe studiues të shquar, si shumica e të pranishmëve këtu mes nesh, të rrezikojnë, nga njëra anë, të keqkuptohen teksa gjykojnë zhvillimet dhe problemet e "studimeve filologjike" të kryera në të shkuarën e afërt e të largët në vende që kanë konceptime të ndryshme, në mos të kundërta, të filologjisë, e nga ana tjetër, të marrin mbi vete barrën e projektimit të perspektivave të këtyre studimeve kur në të vërtetë nuk janë në gjendje të kontrollojnë e të mbajnë qëndrim ndaj dukurive të shthurjes shkencore, sidozot ato që po vihen re kohët e fundit. Përndryshe shpallja, për shembull, e zbulimit të një vepre dorëshkrim të shek. XIII, që më pas doli një mashtrim i vërtetë në dëm të komunitetit shkencor, nuk do të kishte zgjatur me vite, e as do të ishte tepruar me lëvdimin e botimit të fletoreve të albanologut Reinhold, një punë kjo e bërë sidokudo e pa asnjë lloj metode filologjike. Një herë e një kohë para fakteve të tilla, filologët do të kishin ngritur zërin, siç bënë kur Gaetano Petrotta[14] kritikoi ashpër Michele Marchianò-në për të metat e shumta e gabimet e rënda në botimin e *Kodikut të Kieutit*, apo kur Francesco Solano dhe Qemal Haxhihasani protestuan me forcë kundër akuzës për plagjiaturë që iu bë Jeronim de Radës, duke dëshmuar me fakte dhe argumente filologjike gabimin ku kishte rënë zbuluesi i të ashtuquajturit "dorëshkrim i Frashinetos"[15]. Nëse përhapja e këtyre lajthitjeve u

[14] Shih Gaetano Petrotta, *A proposito di un Catechismo Albanese del secolo XVIII pubblicato per cura del Prof. Michele Marchianò*, në *Roma e l'Oriente*, anno II, n. 16, Febbraio 1912, Roma, 1912, f. 246-259 dhe n. 17, Marzo 1912, f. 303-320.

[15] Studiuesi arbëresh Giuseppe Ferrari, duke botuar një libërth dorëshkrim që u gjet në shtëpinë e Vincenzo Dorsa-s në Frascineto dhe iu atribua Michele Bellusci që jetoi mes fundit të shek. XVII dhe viteve të para të shek. XVIII, doli në përfundimin se *Këngët e Milosaos* përbënin në të vërtetë një plagjiaturë të mirëfilltë (Shih Giuseppe Ferrari, *Canti albanesi. Raccolta di Michele Bellusci del 600,* Bari, 1963). Këto përfundime fillimisht u morën si të vlefshme nga Dhimitër S. Shuteriqi (shih *Këngët e Milosaos dhe poezia popullore*, në *Nëndori,* nr. 2, X, Tiranë, 1963). Shuteriqi, duke rimarrë hipotezat e Ferrarit, erdhi në përfundimin se përkimet e shumta mes dorëshkrimit të Frashinetos dhe poemës së De Radës dëshmonin ndikimin e poezisë popullore mbi poezinë rinore të De Radës. Falë ndërhyrjes së Solanos dhe të Haxhihasanit u bë e mundur që një

ndalua në kohë, kjo ishte meritë e mjeshtërisë dhe e përgjegjësisë me të cilën këta studiues të rafinuar e rigorozë, përmes analizës së tekstit, ditën të ftillonin lëmshin e ngatërruar të përcaktimit të autorësisë së një dokumenti dhe të dëshmimit të autenticitetit të një teksti.

Për filologjinë rëndësia parësore e tekstit, e dokumentit të shkruar, është thelbësore, po aq sa ç'janë si procedurat që i lejojnë filologut të vërtetojë origjinalitetin e veprës edhe shtysat që e çojnë drejt objektivit kryesor që është përgatitja e tekstit kritik të veprave. Filologu fillimisht nuk do të merakoset "të interpretojë" një vepër letrare për të zbuluar nëse është artistikisht e arrirë apo jo, e as do t'ia hyjë punës për të dalluar nëse një traktat shkencor i së shkuarës përmban pohime të sakta apo të pasakta. Puna e tij i ngjan, për të përdorur krahasimin e filologes italiane Lucia Cesarini Martinelli, doracaku didaktik i së cilës është e vetmja vepër mbi filologjinë, botuar deri më sot në Shqipëri, «asaj të restauruesit të pikturave të vjetra që rreket të ndreqë dëmet e kohës e t'i rijapë pikturës ngjyrat dhe pamjen origjinale»[16]. Për të kryer këtë restaurim, filologu ka nevojë për ato dije të shumëfishta që zë ngoje Eqrem Çabej qysh në vitin 1959[17]. Jeta e autorit, konteksti kulturor, shtysat, historia e librit,

---

gabimi kaq trashanik i cili do të kishte cenuar rëndë historinë e romantizmit shqiptar, t'i vihej freri. Në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe me argumente të ndryshme, qoftë Solano (shih Francesco Solano, *Bellusci o De Rada? (Osservazioni su un manoscritto di canti albanesi),* estratto da *Shêjzat* (Le Pleiadi). n. 7-8, 1966, anno X, Roma, 1966), qoftë Haxhihasani (Qemal Haxhihasani, "Rreth dorëshkrimit të Mikel Belushit dhe disa çështje të folklorit arbëresh" në *Studime filologiike,* nr. 1, Tiranë, 1966, f. 163-199), dëshmuan katërçipërisht se dorëshkrimi i Frashinetos nuk ishte i Michele Bellusci-t, por i Jeronim De Radës. Veçanërisht Solano vuri në dukje tiparet ortografike, alfabetike e leksikore që dëshmuan autorësinë e dorëshkrimit. Argumentet e pakundërshtueshme kritiko-filologjike të Solanos e detyruan më vonë Shuteriqin (Dhimitër S. Shuteriqi, *Gjurmime letrare,* Tiranë, 1974, f. 29) ta pranonte gabimin e tij e të Ferrarit, e të njihte vlefshmërinë e interpretimeve të Solanos e të Haxhihasanit.

[16] Shih Lucia Cesarini Martinelli, *La filologia. Dagli antichi manoscritti ai libri stampati*, Editori Riuniti, Roma, 1984, f. 11-12.

[17] Çabej Eqrem, "Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre", në *Buletini i Shkencave Shoqërore*, nr. 2, Tiranë, 1959, ribotuar në, *Studime gjuhësore*, vëll. i VI-të, Prishtinë, 1977, f. 334-336; Po ai, *Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes*, në *Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1974, f. 119-128, ribotuar në, *Studime gjuhësore*, vëll. i V-të, Prishtinë, 1988, f. 220-227.

teknikat tipografike, lloji i letrës, boja, stili, gjuha, botimi, kopjet, transmetimi i varianteve përbëjnë fazat që duhet të përshkojë filologu, para se të nisë punën me tekstin kritik. Këto janë të dhëna paraprake që më pas mund të shërbejnë për të komentuar tekstin gjithmonë në funksion të synimit kryesor: rindërtimi i një teksti që të pasqyrojë sa të jetë e mundur vullnetin e autorit. Kjo kërkon zotërimin e një rrjeti dijesh shumëfushëshe që e detyron filologun të matet me disa disiplina ndihmëse, nga gjuhësia historike deri në analizën e elementeve letrare (sidomos të atyre metriko-prozodike), nga historia kulturore deri në atë shoqërore. Me fjalë të tjera, filologu duhet të ketë profilin e një studiuesi poliedrik që shpesh i mbivendoset atij të kritikut letrar, të historianit të kulturës e të gjuhëtarit, por që, ndryshe nga këta, nuk do të largohet kurrë nga synimi qendror i punës së vet, që mbetet përherë e gjithsesi teksti dhe problemi i origjinalitetit të tij[18].

Këtij impostimi i përgjigjen punimet që janë botuar në Itali në këta dhjetëvjeçarët e fundit, si vijim i një tradite që e zë fillin nga viti 1866, kur Demetrio Camarda botoi Shtojcën e Gramatikës së tij (*Appendice al Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*). E konceptuar si një «shtojcë që synonte të jepte disa copa në gjuhën shqipe e të ndihmonte kërkimet etimologjike mbi të»[19], kjo vepër e gjuhëtarit arbëresh hyri në histori si përpjekja e parë serioze e përgatitjes së botimit kritik të teksteve që vinin nga treva të ndryshme shqipfolëse përmes zbatimin të metodave më të përparuara të kohës. Disa dhjetëvjeçarë më vonë modeli gjuhësor-tekstor i Kamardës u rimor e u përsos nga Imzot Paolo Schirò në studimet e tij mbi veprën e Buzukut, që kanë mbetur ende të pabotuara[20], nga i lartpërmenduri Gaetano Petrotta[21] dhe nga Marco La Piana në botimin kritik të tre

[18] Lucia Cesarini Martinelli, *La filologia*, vep e cit., f. 12-15.

[19] Camarda Demetrio, *Appendice al Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866 (r. a. Palermo – Piana degli Albanesi, 1989), f. III.

[20] Shih Matteo Mandalà, "Buzuku në Sicili: studimet gjuhësore dhe filologjike të Mons. Pal Skiroi-t, Gaetano Petrottës dhe Marko La Pianës", në *Nach 450 Jahren. Buzukus "Missale" und seine Rezeption in unserer Zeit*, 2. Deutsch-Albanische kulturwissenscahfliche Tagung in München vom 14. bis 15. Oktober 2005. Herausgegeben von Bardhyl Demiraj, Albanische Forschungen 25, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2007, pp. 225-234.

[21] Gaetano Petrotta e Paolo Schirò, "Il più antico testo di lingua albanese: Gjon Buzuku (1555)", në *Rivista indo-greco-italica di filologia, lingua e antichità*, 1935.

varianteve dorëshkrim të veprës *E mbsuame e krështerë* të Lukë Matrangës[22]. Po kësaj periudhe i përkasin botimet e pjesshme të *Kodikut të Kieutit* përgatitur nga Michele Marchianò[23]. Më pas studimet ekdotike në mjedisin arbëresh pësuan një ndërprerje të përkohshme që u shkaktua nga dy luftërat botërore, për t'u ringjallur gjatë gjysmës së parë të viteve '60 të shekullit të shkuar me daljen në dritë të disa botimeve kritike të rëndësishme të veprave të autorëve arbëreshë. Me rëndësi të posaçme qenë disa botime, mes të cilave përmendim atë të tri dorëshkrimeve të veprës së Matrangës[24], variantin e parë të veprës *Mbi malin e trundafilevet* të Francesco Crispi Glavianos[25], të dyja këto të përgatitura nga Matteo Sciambra, botimin e *Këngëve të Milosaos* përgatitur nga Giuseppe Gradilone[26], si edhe atë të poemës *Këthimi* të Zef Schirò-it, përgatitur nga Giuseppe Schirò-Clesi[27].

Këto punime patën sigurisht meritën se e çuan më tej këtë shkencë dhe siç e kam vënë në dukje gjetkë, sollën një kontroll shkencor më rigoroz mbi tekstet dhe mbi cilësinë e botimit. Megjithatë, vështruar në kushtet e sotme, nuk mund të mos themi se

---

[22] Shih Marco La Piana, "Il catechismo albanese di Luca Matranga (1592)", në *Roma e l'Oriente. Rivista criptoferratense per l'unione delle Chiese*, anno II, vëll. III, aprile 1912, Badia Greca di Grottaferrata, fash. XVIII, f. 395-411; anno II, vëll. IV, maggio-ottobre 1912, fash. XIX, f. 23-32; fash. XXI, f. 151-160; fash. XXII, f. 303-314. Marco La Piana, *Il Catechismo albanese di Luca Matranga (1592), da un antico manoscritto vaticano*, Grottaferrata, 1912.

[23] Shih Michele Marchianò, *Poesie sacre albanesi con parafrasi italiana o dialettale la più parte inedite pubblicate da un codice manoscritto della I metà del sec. XVIII, parte prima*, Napoli, 1908; Michele Marchianò, *Canti popolari albanesi delle colonie d'Italia*, Foggia, 1908 (r. a. A. Forni, 1986), Michele Marchianò, *Il Cristiano albanese. (Da un codice manoscritto del XVIII secolo)*, në *Bessarione*, Gennaio-Marzo 1911, fash. 115, Serie III, vol. VIII, 1911, f. 187-217. Markianoit i detyrohet edhe botimi i poemthit në arbërisht: shih Michele Marchianò, *La Rondinella. Carme nuziale albanese inedito con parafrasi pubblicato da un manoscritto del secolo XVIII con prefazione e traduzione juxtalineare*, Foggia, 1906.

[24] Shih Matteo Sciambra, *La «Dottrina Cristiana» albanese di Lekë Matranga. Riproduzione, trascrizione e commento del Codice Barberini Latino 3454*, Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1964.

[25] Shih Francesco Crispi Glaviano, *Mbi malin e trundafilevet*, a cura di Matteo Sciambra, Palermo, 1963.

[26] Shih Girolamo De Rada, *I canti di Milosao*, a cura di Giuseppe Gradilone, Firenze, 1965.

[27] Giuseppe Schirò, *Këthimi*, a cura di Giuseppe Schirò-Clesi, Firenze, 1965.

qasja ekdotike e atyre viteve përmbante në vetvete disa kufizime të ndjeshme metodologjike. Më i rëndi nga të gjitha ishte pa dyshim ai që i shtyu disa studiues të atëhershëm t'i trajtonin tekstet arbëreshe sikundër filologët klasikë trajtonin tekstet e trashëguara nga tradita e lashtë greke e latine, pra si vepra të shkruara në një gjuhë të vdekur. Vetëm aty nga fillimi i viteve '80 të shekullit të shkuar u shënua një kthesë që përveç përshpejtimit të procesit të punës falë teknologjive të reja informatike, mbështetej në një bazë të fortë teorike. Protagonistë të kësaj kthese në studimet filologjike arbëreshe u bënë dy studiues, të cilët luajtën një rol parësor në riorganizimin e albanologjisë në Itali: Antonino Guzzetta[28] dhe Francesco Solano[29]. Falë përpjekjeve të tyre u bë i mundur rithemelimi i filologjisë shqipe në Itali mbi baza krejtësisht të reja e me një qasje metodologjike risore.

Qe viti 1994 kur Françesko Altimari teksa hartonte projektin për botimin kritik të veprave të letërsisë arbëreshe që e pagëzoi me shkurtesën BETA (Biblioteka Elektronike e Teksteve Arbëreshe), vendosi ta përuronte atë me botimin e një vepre paradigmatike të letërsisë romantike shqiptare, me *Bagëti' e Bujqësija* të Naim Frashërit[30]. Zgjedhja e një vepre "shqiptare" dhe jo e një vepre "arbëreshe", shpaloste në të vërtetë dëshirën për të ringjallur edhe në mjedisin shqipfolës të Ballkanit. Më shumë sesa një sfidë ajo e Altimarit konfigurohej si një hipotezë kërkimi largpamëse[31] që do të

[28] Antonino Guzzetta, "Per una storia della «Questione Alfabetica» dell'albanese in Sicilia", nxjerrë nga *Atti del convegno di studi su "Lingua parlata e lingua scritta"*, nxjerrë nga *Bollettino del Centro di Studi Filologici*, Palermo, 1970.

[29] Përveç punimeve të Solanos që do të përmenden më poshtë, shih edhe Bonifacio Tamburi, *Il catechismo di San Basile*, edizione del manoscritto con trascrizione e interpretazione linguistica a cura di Francesco Solano, Quaderni di Zjarri, San Demetrio Corone, 1983.

[30] Shih Naim Frashëri, *Bagëti' e Bujqësija (I pascoli e i Campi)*, Introduzione, edizione critica, traduzione italiana e concordanza a cura di Francesco Altimari, Centro Editoriale Librario dell'Università degli Studi della Calabria, Rende, 1994.

[31] Shih Francesco Altimari, "Un progetto di concordanze elettroniche di testi letterari albanesi. Origini di una ricerca", në *Lingua, mito, storia, religione, cultura tradizionale nella letteratura albanese della Rilindja: il contributo degli Albanesi d'Italia*, Atti del XVII Congresso Internazionale di Studi Albanesi (a cura di Antonino Guzzetta), Palermo, 1995, e Idem, "Ndihmesa e disa drejtimeve të reja metodologjike për përtëritjen e albanologjisë bashkëkohore: Leksikografia Tekstuale e Kompjuterizuar", në *Le prospettive dell'albanologia: il contributo degli Albanesi di Sicilia e di Calabria*, Atti del XX Congresso Internazionale di

jepte rezultate shumë të mira dhe do të sendërtonte të tjera marrëdhënie të dobishme të bashkëpunimit shkencor ndëruniversitar.

Ky projekt u mbështet i gjithi nga katedrat e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në universitetet e Kalabrisë e të Palermos, të cilat e kanë përqendruar veprimtarinë e tyre kërkimore në lëmin e filologjisë arbëreshe me qëllimin e dyfishtë, që, nga njëra anë, t'i bëjnë të njohura me botime kritike veprat e botuara e të pabotuara të shkrimtarëve arbëreshë, e nga ana tjetër, t'ia nënshtrojnë tekstet e këtyre veprave përpunimit kompjuterik për të mbërritur kësisoj te hartimi i një fjalori të arbërishtes së dëshmuar historikisht nga tradita letrare arbëreshe.

Tash, pas 13 vjetësh, një bilanc i parë i projektit BETA na bën të shpresojmë se jemi drejt realizimit të tij të plotë. Po të marrim parasysh numrin e botimeve të bëra deri më tani dhe të punimeve të kryera nga studentët e diplomuar pranë katedrave të lartpërmendura universitare, mund të pohohet se kemi mbërritur në një fazë të përparuar e se janë për t'u lëvduar rezultatet e arritura. Mes tyre bien në sy ato që kanë të bëjnë me letërsinë e vjetër arbëreshe, e në mënyrë të veçantë veprat e Lekë Matrangës[32], Nikollë Brankatit[33], Nikollë Filjës[34], Jul Varibobës[35], Nikollë Ketës[36], Joakin Qarqarit[37] e Karlo

Studi Albanesi (a cura di Antonino Guzzetta), Albanica 11, Palermo, 1996.

[32] Shih Luca Matranga, *E mbsuame e krështerë. Edizione critica dei testi manoscritti e a stampa (1592)* a cura di Matteo Mandalà, Albanica 21, Salvatore Sciascia editore, Caltanissetta, 2004.

[33] Shih Matteo Mandalà, "Due varianti inedite del c. E.XIII del *Codice Chieutino*", në *Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia. Giornate di studi offerte a Antonino Guzzetta, Atti del XXVIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi*, 16-19 maggio 2002, a cura di Matteo Mandalà, AC. Mirror, Palermo, 2003, f. 373-395.

[34] Shih Nicolò Figlia, *Il codice chieutino*, edizione critica e concordanza a cura di Matteo Mandalà, Palermo, 1995; Shih Matteo Mandalà, "Mbi Nicolò Figlia-n dhe mbi një vepër të tij të pabotuar: *Vajtim' i Zonjësë Shën Mërī Virgjërë mbi Malt Kalvarie* (1755)" në *Romània Orientale*. Nuovi studi balcanici. Contributi italiani al IX Congresso Internazionale dell'Association Internationale d'Études du Sud-Est Européennes Tirana, 30 agosto – 3 settembre 2004, a cura di Alberto Basciani e Angela Tarantino, XVII, 2004, Bagatto Libri editore, Roma, 2004, f. 181-205 dhe Matteo Mandalà, "*Vajtim' i Zonjësë Shën Mërī Virgjërë mbi Malt Kalvarie*: vepër e pabotuar (1755) e Nicolò Figlia-s", in *Studime filologjike*, nn. 3-4, viti LVIII (XLI), Tiranë, 2004, f. 109-150.

[35] Shih Giulio Variboba, *Gjella e Shën Merīs s'Virgjër (1762) - Vita della Beata Vergine Maria*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Vincenzo

Dolçes[38], e po ashtu edhe tekstet e letërsisë popullore të trashëguara nga një mori dokumentesh të shtypura e në dorëshkrim. Për disa nga këto vepra, mes të cilave *E mbsuame e krështerë*, *Kodiku i Kieutit*, *Gjella e shën Mërīs Virgjërë*, tekstet e të cilave qenë botuar edhe më parë, ndonëse pa një metodë korrekte ekdotike, u bë i nevojshëm një ribotim kritik më i kujdesshëm. E kjo jo vetëm për të ndrequr të metat dhe gabimet, nganjëherë edhe të rënda, që karakterizojnë botimet e para të këtyre teksteve, por edhe për të përvijuar një perspektivë të re e më solide të studimeve të filologjisë arbëreshe, një perspektivë thellësisht risore. E në fakt, falë botimeve të të mësipërme të cilat kanë rikthyer tekstet e veprave të autorëve më në zë të letërsisë romantike arbëreshe, nga Jeronim de Rada[39] te Zef Serembe[40], nga Andrea

Belmonte con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2005.

[36] Shih Nicolò Chetta, *Testi letterari in albanese*, edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Albanica 22, Salvatore Sciascia editore, Caltanissetta, 2004.

[37] Shih Gioacchino Chiarchiaro, *Likasë*, edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Albanica 20, Salvatore Sciascia editore, Caltanissetta, 2004.

[38] Shih Matteo Mandalà, *Le poesie inedite di Carlo Dolce*, Quaderni di Biblios, Comune di Piana degli Albanesi, Palermo, 1996.

[39] Elio Miracco, "Varianti nella edizione del 1843 nei *Canti di Serafina Thopia* di Girolamo De Rada", nxjerrë nga *Miscellanea di albanistica* (a cura di Giuseppe Gradilone), Roma, 1997. Girolamo De Rada, *I Canti Premilosaici*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 1998. Girolamo De Rada, *I canti di Serafina Thopia*, edizione critica delle tre versioni dell'opera (1839, 1843, 1898) a cura di Fiorella De Rosa, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Luigi Pellegrini editore, Castrovillari, 2003. Francesco Altimari ka hartuar një projekt për botimin kritik të *Veprave të Plota* të Jeronim De Radës, që parashikon botimin e 12 vëllimeve, nga të cilat deri më tani kanë dalë në dritë vëllimet: I (Girolamo De Rada, *I Canti Premilosaici (1833-1835)*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2005), III (Girolamo De Rada, *I canti di Serafina Thopia*, testo critico delle tre edizioni dell'opera (1839, 1843, 1898) a cura di Fiorella De Rosa, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2006), VI (Girolamo De Rada, *Scanderbeg sventurato – Skanderbegu i pafān*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Vincenzo Belmonte, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2005), X (Girolamo De Rada, *Opere grammaticali*, introduzionme di Leonardo Maria Savoia, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007); IX (Girolamo De Rada, *Opere filosofiche e politiche*,

Dara[41] te Gavril Dara[42], nga Françesko Antonio Santori[43] te Zef Skiroi[44], nga Françesko Krispi Glaviano[45] te Salvatore Braile[46], filologjia arbëreshe ka arritur suksese të shënuara të cilat sot e paraqesin me një fytyrë të re në panoramën e kërkimeve albanologjike bashkëkohore.

Këto suksese besojmë se kanë ndikuar edhe disa zhvillime të tjera të filologjisë shqipe, jashtë mjedisit arbëresh. E kemi fjalën për daljen në dritë tash së fundi të disa botimeve të rëndësishme kritike si ai i *Cuneus prophetarum* të Pjetër Bogdanit osë të *Doktrinës së krishterë* të Gjon Nikollë Kazazit, të përgatitura me akribi të vërtetë

introduzione di Anton N. Berisha, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007); XII (Girolamo De Rada, *Epistolario*, a cura di Michelangelo La Luna, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007).

[40] Shih Vincenzo Belmonte, *Omaggio a Giuseppe Serembe*, edizione critica dei testi, Cosenza, 1988; Giuseppe Gradilone, *Contributo alla critica del testo dei canti di Giuseppe Serembe*, Roma, 1989; Vincenzo Belmonte, *Alla ricerca del Serembe perduto*, Cosenza, 1991.

[41] Francesca Di Miceli, *I manoscritti* danesi *di Andrea Dara*, edizione critica, Albanica 19, Sciascia editore, Caltanissetta, 2004.

[42] Gabriele Dara Junior, *Kënga e sprasëme e Ballës* (Il Canto Ultimo di Bala), Edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Albanica 27, Palazzo Adriano, Grafiche Geraci, 2007.

[43] Shih Francesco Antonio Santori, *Il Canzoniere Albanese*, a cura di Francesco Solano, Corigliano Calabro, 1975; Francesco Antonio Santori, *Panaini e Dellja - Fëmija pushterjote*, editio princeps a cura di Giuseppe Gradilone, Roma, 1979; Francesco Altimari, *Un saggio inedito di F. A. Santori sulla lingua albanese e i suoi alfabeti*, Cosenza, 1982; Francesco Antonio Santori, *Alessio Ducagino*, Melodramma, Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura di Francesco Solano, Castrovillari, 1983; Francesco Antonio Santori, *Tre novelle*, Prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Italo Costante Fortino, Carmine Stamile, Ernesto Tocci, Cosenza, 1985. Botimet e tjera të veprave të Santorit përgatitur nga Italo Costante Fortino (*Brisandi Lletixja e Ulladheni*, a cura di Italo Costante Fortino, Cosenza, 1977 dhe *Le kalimere di Francesco Antonio Santori, Prolegomeni, trascrizione, apparato critico e concordanza*, Brenner, Cosenza 2004) përmbajnë të meta dhe gabime të rënda metodologjike. Në veçanti në botimin kritik të veprës *Kalimere* nuk përfillet ekzistenca e një varianti dorëshkrim autograf të ndërmjetëm që ruhet në fondin *Albansk Samling* të Bibliotekës Mbretërore të Kopenhagës.

[44] Giuseppe Schirò, *Opere*, a cura di Matteo Mandalà, vol. I-IX, Rubettino editore, Soveria Mannelli, 1998.

[45] Francesco Crispi Glaviano, *Opera poetica*, a cura di Matteo Mandalà, Albanica 28 (në shtyp e sipër).

[46] Shih Giuseppe Faracco, *Salvatore Braile, poeta italo-albanese (1872-1961)*, Cosenza, 1991.

filologjike, përkatësisht, nga Anila Omari[47] dhe Bardhyl Demirajt[48]. Po ashtu presin të konkretizohen në monumente gjithaq të vyera shkencore me ribotime të kujdesshme të teksteve kritike edhe vepra të letërsisë së vjetër e bashkëkohore shqiptare. Nëse edhe ky objektiv do të arrihet, siç urojmë e siç na lënë të shpresojmë përpjekjet e deritashme, jo vetëm që do të përmbushet plotësisht dëshira profetike e të ndjerit Eqrem Çabej për të pasur një brez filologësh «trashëgimtarë të denjë të atyre brezave që prodhuan ato tekste»[49], por edhe filologjia shqiptare do të mund ta shohë më me besim të ardhmen e vet.

[47] Shih Pjetër Bogdani, *Cuneus prophetarum* (Çeta e profetëve), botim kritik me një studim hyrës, faksimile të origjinalit, transkriptim e shënime përgatitur nga Anila Omari, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005.

[48] Bardhyl Demiraj, *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Botime të veçanta LXIX – Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 30, Prishtinë, 2006. Mikut dhe kolegut Bardhyl Demiraj i detyrohet ringjallja e studimeve filologjike pranë katedrës së albanologjisë në Mynih: shih Bardhyl Demiraj, "Viti i zbulimit të 'Mesharit' të Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të", në *Biblos, Servizio di informazione culturale e bibliografico della biblioteca comunale "G. Schirò" di Piana degli Albanesi*, anno X, nr. 23-24, Palermo, 2005; Bardhyl Demiraj, "Jeta dhe veprimtaria e Gjon Pagëzues Nikollë Kazazit (në materialet e Arkivit Historik të Kongregatës së Shenjtë)", në *Studime 11*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë 2005.

[49] Çabej Eqrem, "Tekstet e vjetra shqip", f. 334.

Bibliografia

Ajeti Idriz, *Dokumenti ma i vjetër i shqipes së Kosovës, shkrue me alfabetin arab*, në Rilindja nr. 1-2-3, janar 1960, Prishtinë, 1960.

Ajeti Idriz, *Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX*, Rilindja, Prishtinë, 1960 ribotuar në *Studime dialektore dhe etimologjike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1968, f. 217-302.

Altimari Francesco, "Ndihmesa e disa drejtimeve të reja metodologjike për përtëritjen e albanologjisë bashkëkohore: Leksikografia Tekstuale e Kompjuterizuar", në *Le prospettive dell'albanologia: il contributo degli Albanesi di Sicilia e di Calabria*, Atti del XX Congresso Internazionale di Studi Albanesi (a cura di Antonino Guzzetta), Albanica 11, Palermo, 1996.

Altimari Francesco, "Un progetto di concordanze elettroniche di testi letterari albanesi. Origini di una ricerca", në *Lingua, mito, storia, religione, cultura tradizionale nella letteratura albanese della Rilindja: il contributo degli Albanesi d'Italia*, Atti del XVII Congresso Internazionale di Studi Albanesi (a cura di Antonino Guzzetta), Palermo, 1995.

Altimari Francesco, *Un saggio inedito di F. A. Santori sulla lingua albanese e i suoi alfabeti*, Cosenza, 1982.

Ashta Kolë, "Shënime e vërejtje rreth gjuhës dhe leksikut të Lekë Matrëngës", në *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, nr. 2, Tiranë, 1957, f. 85-86. Kolë Ashta, "Në kërkim të anës letrare të Matrëngës (1592)", në *Shkodra*, viti V, nr. 5, Shkodër, 1965, f. 189-190.

Avalle D'Arco Silvio, *Principî di critica testuale*, Antenore, Padova, 1972.

Balduino Armando, *Manuale di filologia italiana*, Firenze, Sansoni, 1979.

Bédier Joseph, "La tradition manuscrite du *Le Lai de l'Ombre.* Réflexions sur l'art d'éditer les anciens textes" në *Romania*, LIV, 1928, f. 161-198.

Bédier Joseph, *Le Lai de l'Ombre*, Extr. des L'Index lectionum quae in Universitate Friburgensi, anni 1890 habebuntur.

Belmonte Vincenzo, *Omaggio a Giuseppe Serembe*, edizione critica dei testi, Cosenza, 1988.

Belmonte Vincenzo, *Alla ricerca del Serembe perduto*, Cosenza, 1991.

Bentivogli Bruno, Galli V. Paola, *Filologia Italiana*, Milano, Bruno Mondadori, 2002.

Bogdani Pjetër, *Cuneus prophetarum* (Çeta e profetëve), botim kritik me një studim hyrës, faksimile të origjinalit, transkriptim e shënime përgatitur nga Anila Omari, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005.

Brambilla Ageno Franca, *L'edizione critica dei testi volgari*, Padova, Antenore, 1984.

Çabej Eqrem, "Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre", në *Buletini i Shkencave Shoqërore*, nr. 2, Tiranë, 1959, ribotuar në, *Studime gjuhësore*, vëll. i VI-të, Prishtinë, 1977, f. 334-336.

Çabej Eqrem, *«Meshari» i Gjon Buzukut (1555). Botim kritik: Pjesa e parë - Hyrje dhe Transliterim; Pjesa e dytë - Faksimile dhe transkribim fonetik*, Tiranë, 1968.

Çabej Eqrem, *Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes*, në *Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1974, f. 119-128, ribotuar në, *Studime gjuhësore*, vëll. i V-të, Prishtinë, 1988, f. 220-227.

Cesarini Martinelli Lucia, *La filologia. Dagli antichi manoscritti ai libri stampati*, Editori Riuniti, Roma, 1984.

Chetta Nicolò, *Testi letterari in albanese*, edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Albanica 22, Salvatore Sciascia editore, Caltanissetta, 2004.

Chiarchiaro Gioacchino, *Likasë*, edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Albanica 20, Salvatore Sciascia editore, Caltanissetta, 2004.

Contini Gianfranco, *Breviario di ecdotica*, Torino, Einaudi, 1992.

Crispi Glaviano Francesco, *Mbi malin e trundafilevet*, a cura di Matteo Sciambra, Palermo, 1963.

Crispi Glaviano Francesco, *Opera poetica*, a cura di Matteo Mandalà, Albanica 28 (në shtyp e sipër).

Dara Gabriele Junior, *Kënga e sprasëme e Ballës* (Il Canto Ultimo di Bala), Edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Albanica 27, Palazzo Adriano, Grafiche Geraci, 2007.

Dara Gavril i Riu, *Kënga e sprasme e Balës* e pabotuar e përshtatur në shqipen e sotme nga Sh. Demiraj, Naim Frashëri, Tiranë, 1961.

Dara Gavril i Riu, *Kënga e sprasme e Balës,* transkribuar e përshtatur nga Shaban Demiraj, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1994.

De Rada Girolamo, *I canti di Milosao*, a cura di Giuseppe Gradilone, Firenze, 1965.

De Rada Girolamo, *I canti di Serafina Thopia*, edizione critica delle tre versioni dell'opera (1839, 1843, 1898) a cura di Fiorella De Rosa, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Luigi Pellegrini editore, Castrovillari, 2003.

De Rada Girolamo, *I canti di Serafina Thopia*, testo critico delle tre edizioni dell'opera (1839, 1843, 1898) a cura di Fiorella De Rosa, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2006.

De Rada Girolamo, *I Canti Premilosaici (1833-1835)*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2005.

De Rada Girolamo, *I Canti Premilosaici*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 1998.

De Rada Girolamo, *Opere filosofiche e politiche*, introduzione di Anton N. Berisha, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007); XII (Girolamo De Rada, *Epistolario*, a cura di Michelangelo La Luna, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007).

De Rada Girolamo, *Opere grammaticali*, introduzionme di Leonardo Maria Savoia, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2007.

De Rada Girolamo, *Scanderbeg sventurato – Skanderbegu i pafān*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Vincenzo Belmonte, con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2005.

Demetrio Camarda, *Appendice al Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866 (r. a. Palermo – Piana degli Albanesi, 1989.

Demiraj Bardhyl, "Jeta dhe veprimtaria e Gjon Pagëzues Nikollë Kazazit (në materialet e Arkivit Historik të Kongregatës së Shenjtë)", në *Studime 11*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë 2005.

Demiraj Bardhyl, "Viti i zbulimit të 'Mesharit' të Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të", në *Biblos, Servizio di informazione culturale e bibliografico della biblioteca comunale "G. Schirò" di Piana degli Albanesi*, anno X, nr. 23-24, Palermo, 2005.

Demiraj Bardhyl, *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Botime të veçanta LXIX – Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 30, Prishtinë, 2006.

Demiraj Shaban, "Rreth autorësisë së poemës *Kënka e sprasme e Balës*", në *Studime Filologjike*, nr. 3-4, Tiranë, 2003, f. 63-74.

Di Miceli Francesca, *I manoscritti* danesi *di Andrea Dara*, edizione critica, Albanica 19, Sciascia editore, Caltanissetta, 2004.

Faracco Giuseppe, *Salvatore Braile, poeta italo-albanese (1872-1961)*, Cosenza, 1991.

Ferrari Giuseppe, *Canti albanesi. Raccolta di Michele Bellusci del 600,* Bari, 1963).

Figlia Nicolò, *Il codice chieutino*, edizione critica e concordanza a cura di Matteo Mandalà, Palermo, 1995.

Frashëri Naim, *Bagëti' e Bujqësija (I pascoli e i Campi)*, Introduzione, edizione critica, traduzione italiana e concordanza a cura di Francesco Altimari, Centro Editoriale Librario dell'Università degli Studi della Calabria, Rende, 1994.

Frashëri Naim, *Lulet'e verësë*, redaktuar dhe pajsur me shënime nga Shaban Demiraj, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve Naim Frashëri, Tiranë, 1961.

Gradilone Giuseppe, *Contributo alla critica del testo dei canti di Giuseppe Serembe*, Roma, 1989.

Guzzetta Antonino, "Per una storia della «Questione Alfabetica» dell'albanese in Sicilia", nxjerrë nga *Atti del convegno di studi su "Lingua parlata e lingua scritta"*, nxjerrë nga *Bollettino del Centro di Studi Filologici*, Palermo, 1970.

Haxhihasani Qemal, "Rreth dorëshkrimit të Mikel Belushit dhe disa çështje të folklorit arbëresh" në *Studime filologiike,* nr. 1, Tiranë, 1966, f. 163-199

Inglese Giorgio, *Come si legge un'edizione critica. Elementi di filologia italiana*, Carocci, Roma, 2006.

Ismajli Rexhep, *Gramatika e parë e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

La Piana Marco, "Il catechismo albanese di Luca Matranga (1592)", në *Roma e l'Oriente. Rivista criptoferratense per l'unione delle Chiese*, anno II, vëll. III, aprile 1912, Badia Greca di Grottaferrata, fash. XVIII, f. 395-411; anno II, vëll. IV, maggio-ottobre 1912, fash. XIX, f. 23-32; fash. XXI, f. 151-160; fash. XXII, f. 303-314.

La Piana Marco, *Il Catechismo albanese di Luca Matranga (1592), da un antico manoscritto vaticano*, Grottaferrata, 1912.

Lachmann Karl Caroli Lachmanni *in T. Lucretii Cari De rerum natura libros commentarius*, Quartum editus, Typis et impensis Georgii Reimeri, Berolini 1882.

Mandalà Matteo, "Buzuku në Sicili: studimet gjuhësore dhe filologjike të Mons. Pal Skiroi-t, Gaetano Petrottës dhe Marko La Pianës", në *Nach 450 Jahren. Buzukus "Missale" und seine Rezeption in unserer Zeit*, 2. Deutsch-Albanische kulturwissenscahfliche Tagung in München vom 14. bis 15. Oktober 2005. Herausgegeben von Bardhyl Demiraj, Albanische Forschungen 25, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2007, pp. 225-234.

Mandalà Matteo, "Due varianti inedite del c. E.XIII del *Codice Chieutino*", në *Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia. Giornate di studi offerte a Antonino Guzzetta, Atti del XXVIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi*, 16-19 maggio 2002, a cura di Matteo Mandalà, AC. Mirror, Palermo, 2003, f. 373-395.

Mandalà Matteo, "Mbi Nicolò Figlia-n dhe mbi një vepër të tij të pabotuar: *Vajtim' i Zonjësë Shën Mërī Virgjërë mbi Malt Kalvarie* (1755)" në *Romània Orientale*. Nuovi studi balcanici. Contributi italiani al IX Congresso Internazionale dell'Association Internationale d'Études du Sud-Est Européennes Tirana, 30 agosto – 3 settembre 2004, a cura di Alberto Basciani e Angela Tarantino, XVII, 2004, Bagatto Libri editore, Roma, 2004, f. 181-205.

Mandalà Matteo, "*Vajtim' i Zonjësë Shën Mërī Virgjërë mbi Malt Kalvarie*: vepër e pabotuar (1755) e Nicolò Figlia-s", in *Studime filologjike*, nn. 3-4, viti LVIII (XLI), Tiranë, 2004, f. 109-150.

Mandalà Matteo, *Le poesie inedite di Carlo Dolce*, Quaderni di Biblios, Comune di Piana degli Albanesi, Palermo, 1996.

Marchianò Michele, *anti popolari albanesi delle colonie d'Itali*a, Foggia, 1908 (r. a. A. Forni, 1986).

Marchianò Michele, *Il Cristiano albanese. (Da un codice manoscritto del XVIII secolo)*, në *Bessarione*, Gennaio-Marzo 1911, fash. 115, Serie III, vol. VIII, 1911, f. 187-217.

Marchianò Michele, *La Rondinella. Carme nuziale albanese inedito con parafrasi pubblicato da un manoscritto del secolo XVIII con prefazione e traduzione juxtalineare*, Foggia, 1906.

Marchianò Michele, *Poesie sacre albanesi con parafrasi italiana o dialettale la più parte inedite pubblicate da un codice manoscritto della I metà del sec. XVIII, parte prima*, Napoli, 1908;

Matranga Luca, *E mbsuame e krështerë. Edizione critica dei testi manoscritti e a stampa (1592)* a cura di Matteo Mandalà, Albanica 21, Salvatore Sciascia editore, Caltanissetta, 2004.

Miracco Elio, "Varianti nella edizione del 1843 nei *Canti di Serafina Thopia* di Girolamo De Rada", nxjerrë nga *Miscellanea di albanistica* (a cura di Giuseppe Gradilone), Roma, 1997.

Myderrizi Osman, "Letërsia shqipe me alfabetin arab" në *Buletin për shkencat shoqerore*, 1955, nr. 2, Tiranë, 1955, f. 148-155.

Pasquali Giorgio, *Storia della tradizione e critica del testo*, Firenze, Sansoni, 1974 (I ed. 1934).

Paul Maas, *Critica del testo*, Firenze, Le Monnier, 1984.

Petrotta Gaetano e Schirò Paolo, "Il più antico testo di lingua albanese: Gjon Buzuku (1555)", në *Rivista indo-greco-italica di filologia, lingua e antichità*, 1935.

Petrotta Gaetano, *A proposito di un Catechismo Albanese del secolo XVIII pubblicato per cura del Prof. Michele Marchianò*, në *Roma e l'Oriente*, anno II, n. 16, Febbraio 1912, Roma, 1912, f. 246-259 dhe n. 17, Marzo 1912, f. 303-320.

Renzi Lorenzo - Andreose Alvise, *Manuale di linguistica e filologia romanza*, Il Mulino, Bologna, 2006.

Riza Selman, "Disa teza mbi tre dorëshkrimet e katekizmit të Matrëngës", në *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, Tiranë, 1962, nr. 1, f. 76-81.

Rrota Justin, "Shkrimtari mâ i vjetri i italo-shqyptarvet: Lukë Matranga (1592), në *Hylli i Dritës*, vjeta VII, Shkodër, 1931, f. 505-522.

Santori Francesco Antonio, *Alessio Ducagino*, Melodramma, Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura di Francesco Solano, Castrovillari, 1983.

Santori Francesco Antonio, *Brisandi Lletixja e Ulladheni*, a cura di Italo Costante Fortino, Cosenza, 1977

Santori Francesco Antonio, *Il Canzoniere Albanese*, a cura di Francesco Solano, Corigliano Calabro, 1975.

Santori Francesco Antonio, *Le kalimere di Francesco Antonio Santori, Prolegomeni, trascrizione, apparato critico e concordanza*, a cura di Italo Costante Fortino, Brenner, Cosenza 2004.

Santori Francesco Antonio, *Panaini e Dellja - Fëmija pushterjote*, editio princeps a cura di Giuseppe Gradilone, Roma, 1979.

Santori Francesco Antonio, *Tre novelle*, Prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Italo Costante Fortino, Carmine Stamile, Ernesto Tocci, Cosenza, 1985.

Skiroi Zef, *Mino. Elegji*, përgatitur nga Ziaudin Kodra, drejtor i shkollës normale, Elbasan, 1939. Gavril Darë i Riu, *Kënka e sprasme e Balës.* Redaktuar dhe pajisur me shënime nga Ziaudin Kodra, Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, Tiranë, 1955.

Schirò Giuseppe, *Këthimi*, a cura di Giuseppe Schirò-Clesi, Firenze, 1965.

Schirò Giuseppe, *Opere*, a cura di Matteo Mandalà, vol. I-IX, Rubettino editore, Soveria Mannelli, 1998.

Sciambra Matteo, *La «Dottrina Cristiana» albanese di Lekë Matranga. Riproduzione, trascrizione e commento del Codice Barberini Latino 3454*, Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1964.

Shuteriqi S. Dhimitër, *Gjurmime letrare,* Tiranë, 1974.

Shuteriqi S. Dhimitër, *Këngët e Milosaos dhe poezia popullore*, në *Nëndori,* nr. 2, X, Tiranë, 1963.

Solano Francesco, *Bellusci o De Rada? (Osservazioni su un manoscritto di canti albanesi),* estratto da *Shêjzat* (Le Pleiadi). n. 7-8, 1966, anno X, Roma, 1966.

Stussi Alfredo (a cura di), *Fondamenti di critica testuale*, Il Mulino, Bologna, 1998.

Stussi Alfredo, *Fondamenti di critica testuale*. Bologna, Mulino, 1998.

Stussi Alfredo, *Introduzione agli studi di filologia italiana*, Bologna, Il Mulino, 1994.

Sulejmani Fadil, *E Mbsuame e Krështerë e Lekë Matrëngës,* Prishtinë, 1979.

Tamburi Bonifacio**,** *Il catechismo di San Basile*, edizione del manoscritto con trascrizione e interpretazione linguistica a cura di Francesco Solano, Quaderni di Zjarri, San Demetrio Corone, 1983.

Variboba Giulio, *Gjella e Shën Merīs s'Virgjër (1762) - Vita della Beata Vergine Maria*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Vincenzo Belmonte con edizione ipertestuale su CD-Rom realizzata in collaborazione con Francesco Iusi, Rubbettino editore, Soveria Mannelli, 2005.

Sabri HAMITI

METODA E STUDIME

I. TRADITA NJËSHEKULLORE

Kritika letrare në shqip, në vështrimin modern të fjalës, ka traditë njëqindvjeçare, kurse shkrimi letrar shqip katër shekuj më shumë. Theksi këtu bie mbi vetëdijen e krijuar që letërsia është *krijim*, kurse kritika, në rastin më të mirë, *interpretim* i krijimit. Prandaj, edhe kritika shqipe, sado e tërhequr pas universalizimit në metodë, ka mbetur përgjithnjë e kushtëzuar nga dominantat themelore të letërsisë shqipe simbas rendit të shfaqjes: perspektiva morale, perspektiva nacionale, perspektiva sociale, perspektiva ideologjike. Në sprovimet e modernitetit edhe letërsia edhe kritika shqipe janë përpjekur që të tejkalojnë perspektivat e përmendura dominante.

Duke përkufizuar natyrën dhe funksionin e vet, letrar e shoqëror, kritika shqipe, e ndeshur edhe me rrymimet mendore e letrare përtej letërsisë e kulturës shqipe, ka kaluar nëpër fazat e formulimeve, si: *lexim, interpretim, komentim, studim, klasifikim, vlerësim e sistematizim*. Këto pamje të saj nuk lidhen vetëm me formën e saj, po ndoshta më tepër me destinimin, përherë në varshmëri me kohën dhe shfaqjet letrare.

Natyra dhe statusi i kritikës shqipe kanë mbetur përgjithmonë të kushtëzuara nga natyra dhe statusi i letërsisë shqipe në botën e në kulturën shqiptare. Që nga fillimet e deri më sot, letërsia shqipe nuk ka pasur vetëm statusin e veprës së artit, por edhe të mediumit të preferuar të krijimit të identitetit kulturor, madje nacional të shqiptarëve. Ky fenomen i provuar si përvojë krijuese në një histori e në një gjeografi të diferencuar, problemet më të mëdha, nganjëherë të pakalueshme, ia ka sjellë kritikës me ambicie të sistematizimit dhe të rrokjes së tërësisë. Kështu çështja bartet përtej veçantive letrare, në rrafshin e identitetit e të integritetit nacional. Edhe sot kritikët me drojë i përmendin formulimet *letërsi e Kosovës* apo *letërsi arbëreshe*. Tash së voni një njeri me plot moskuptime për problemin, klasifikimin

e një Qarku letrar të Prishtinës, e pa me mllef si akt të çintegrimit, jo vetëm letrar, të shqiptarëve.

1. Fillimet: Konica

Të gjitha këto çështje i kishte njohur që në fillime themeluesi i kritikës shqipe, Faik Konica. Në mënyrë të veçantë dallimin ndërmjet *letërsisë* e *atdhesisë* si vlerë në përkufizimin nacional. Është i njohur luciditeti e qëndrimi i Konicës për këto çështje, por shoqëria shqiptare e leximit nuk e kuptoi atëherë, ndërsa zbatimin e teorisë së tij te Naim Frashëri, shoqëria shqiptare e leximit nuk e ka kuptuar as mbas një shekulli. Është me rëndësi të parë që Konica preku thelbin e kritikës letrare e po ashtu kontekstin kulturor shqiptar, për të treguar në nismë sa punë e rëndë profesionale, etike e shoqërore është puna e kritikut. Këtë përvojë e ndjesi do ta provojnë e artikulojnë më vonë kritikë të tjerë: Kuteli, Vangjel Nirvana, Krist Maloki e të tjerë.

Pra, Konica hodhi themelet: dalloi letërsinë nga atdhesia, dëshmoi që kritika kërkon vlerat letrare po nuk thotë të vërteta universale, që i detyrohet individit e kulturës së tij, që vlera letrare është universale dhe duhet të matet me kultura të tjera, po vlera e vendit e përcakton jetën e saj. Në traktatin e tij *Kohëtore e letrave shqipe* (1906) ai sistematizoi me koncepte praktikën e teorinë e vet kritike, duke e nisur kritikën shqipe në udhën e modernitetit.

2. Shpalimi i metodave

Në gjysmën e parë të shekullit XX letërsia shqipe njohu zhvillime gjuhësh e stilesh letrare të panjohura më parë, e shkruar nga autorë që u formuan në qendra të njohura kulturore në Europë e Amerikë, duke njohur në kontakt të drejtpërdrejtë rrymat ideore e stilistike të kohës. Për pasojë, kritika shqipe e këtyre dekadave u shkrua në një ballafaqim me letërsinë shqipe të kohës, ashtu dhe me idetë letrare të kohës. Produkt i kësaj është shpalimi i metodave bashkëkohore në kritikën letrare, që vinin nga bota letrare apo nga dijet humanitare. Nëse metodat nuk ishin zhvilluar deri në konsekuencat e fundit, atëherë si shfaqje iniciale ato u duken me rend

në kritikën shqipe: *formaliste, psikanalitike, kulturo-historike, tematike, sociologjike, imanente,* me autorët – kritikë shqiptarë: Mitrush Kutelin, Krist Malokin, Eqrem Çabejn, Vangjel Koçën, Dhimitër Shuteriqin, Fan S. Nolin.

Pra, shumësia e metodave kishte një kushtëzim të mbrendshëm, nisjen e modernitetit letrar, ku dominojnë poetikat individuale e jo normative; dhe një kushtëzim të jashtëm, njohjen me rrymat letrare e mendore të shekullit bashkëkohës. Një element i tretë, që lidhet me kulturën letrare vendëse, është shfaqja e revistave letrare e kulturore, që po përpiqeshin të specifikonin pikëpamjet e tyre.

Në këtë kohë, krahas metodave të ndryshme, kritika shqipe ndërron dhe trajat e veta, nga shënimi, në ese, trajtesë e studim, duke arritur në trajtën e monografisë, madje dhe të librit të sistemuar kritik. Janë parasysh studimet e Kutelit, Koliqit e Malokit, *Introduktat* e Nolit, *Për gjenezën e literaturës shqipe* të Çabejt, apo *Shënimet letrare* të Kutelit.

Kritikën e kësaj kohe, më në fund, e karakterizon shkrimi për veprat e bashkëkohësve, që është kënaqësi e mund i zbulimit të parë letrar, i cili mbetet kriter universal i kritikës letrare.

3. Metoda si doktrinë

Nënshtrimi i poetikës nga pragmatika, ishte kërkuar në diskutimet letrare të Dhimitër Shuteriqit që në vitet ’30-të të shekullit XX. Kjo teori në nisje u kthye në praktikë në pamjet e letërsisë shqipe pas Luftës së Dytë. Tanimë diskutimet për metodën (krijuese dhe interpretuese) u kthyen në doktrinë të kodifikuar.

Kjo metodë e thjeshtëzuar i mbyti të gjitha alternativat, duke i shpallur të rrezikshme. Ajo nuk mundi të krijojë as variantet brenda vetëvetes, duke përforcuar klishenë. Shkretërimi i metodës, që u konvertua në ideologji, pati një ndikim të tmerrshëm paraveprues, dhe ç’është më keq, prapavështrues. Jo vetëm shpalli kanonet për krijimet e pritshme, po përjashtoi nga harta e vlerave autorët e veprat e traditës që nuk mund të hynin në këto kanone.

Ngushtimi nisi në vlerësimin individual, por u bë tërësisht i rrezikshëm për lëtërsinë e kulturën shqipe kur u përgjithësua deri në

nivelin e sistematizimit të vlerave, për të marrë pamjen e historisë së letërsisë. Metoda po shkonte kah karikatura, kurse letërsia e traditës u shtrua në shtratin e Prokrustit.

4. Kërkimet letrare

Një kahje krejt tjetër mori kritika letrare shqipe në Kosovë, veçmas nga vitet '70-të të shekullit XX. Një kritikë e hapur në metodë, duke njohur zhvillimet mendimtare bashkëkohore, dhe duke u përqendruar në letërsinë aktuale nacionale, për të zbritur shkallë-shkallë në të shkuarën. Kjo kritikë njohu format e thjeshta e të ndërliqshme: esenë, trajtesën, monografinë. U shfaq si kombinim metodash duke synuar integralitetin te Rexhep Qosja; e mbështetur në strukturalizëm e semiologji te Ibrahim Rugova; në psikanalizën strukturale te M. Raifi, apo në leximin imanent te Ali Aliu. Të gjitha këto metoda të aplikuara në analizën e shkrimtarëve shqiptarë: Naimit, Bogdanit, Migjenit, Fan Nolit, Petro Markos. Dy kritikët më në zë e më sistematikë: Rexhep Qosja e Ibrahim Rugova studimet e veta i çuan në nivel monografish, i pari për Naimin, i dyti për Bogdanin. Dhe në hapin e fundit të dytë shkuan kah historia letrare: Rexhep Qosja me Historinë e romantizmit, kurse Ibrahim Rugova me Historinë e kritikës letrare shqipe.

Kjo dëshmon që kritika letrare në Kosovë, që kishte filluar si interpretim fenomenesh konkrete letrare, po mbërrinte te vetëdija për tërësinë, te vetëdija e nevoja për sistematizim letrar, duke synuar, në pikën e fundit, një vlerësim tjetër letrar.

5. Përmbysjet e të nëntëdhjetave

Përmbysja e doktrinës letrare ideologjike në vitet nëntëdhjetë të shekullit XX, si dhe rikthimi i Koliqit, Kutelit, V. Koçës e A. Pipës, solli gjithë dramaticitetin e njohjeve e të rinjohjeve në dijet letrare shqiptare. Kjo ndeshje u bë herë me temperament, herë me heshtje të habitshme. Nuk është që nuk u zbuluan të mbuluarat, po duheshin autorë të rinj, kritikë të tjerë, që s'duhet ta kishin më me vete grindjen e mbrendshme etike.

Këto vite shfaqën në Shqipëri emra të tjerë e të rinj, si Plasari, M. Marku, P. Asllani e Dh. Shehri, që nisën studimin e autorëve të ndaluar, që po ktheheshin, duke pasur për barrë edhe zbulimin e metodës vetiake të kërkimit letrar. Në Kosovë, prapë më tepër si kontinuitet, u artikuluan emrat e Kujtim Rrahmanit, Kujtim Shalës, Nysret Krasniqit e Femi Cakollit, me pretendimet interpretuese e teorike.

Të gjithë këta kritikë, në nisje apo të artikuluar fuqishëm, i bashkon dëshira që të rindërtohet duke u rigjetur moderniteti shqiptar, qoftë në mënyrë të natyrshme, qoftë të sforcuar. Dhe një gjest i çmuar i tyre: përpjekja për të zbuluar pararëndësit e vet në gjiun e kulturës e të kritikës shqipe, përballë mallit për të njohur teoritë letrare bashkëkohore.

II. TEORIA LETRARE

Secili kërkim empirik përfundon në teori, në përgjithësim. Secili interpretim letrar mbaron në vlerësim e në sistematizim. Kësaj skeme të njohjes e të vetënjohjes nuk i shpëton as kritika shqipe. Kështu, kritikë të fazave të ndryshme përfundojnë në hartime apo në prova hartimesh të traktateve teorike: Konica, me *Kohëtoren e letrave shqipe*; Çabej me *Gjenezën e literaturës shqipe*; Koliqi me *Shkollat letrare shkodrane*; Qosja me *Eseun për modernitetin*, Grupi i Prishtinës, me *Vox clamantis in deserto*, Rugova me *Refuzimin estetik*.

Dëshirën për teoritizim e pason dëshira e nevoja për vlerësim të përgjithshëm e sistematizim. Këtu hyjnë antologjitë, qofshin të natyrës shkollore apo akademike, të cilat, në fund të fundit, shpiejnë në hartën e përgjithshme të vlerësimeve, në histori letrare.

Ngase të gjithë e nisin me Abetare për të synuar një Enciklopedi. Këto janë kaq të lidhura dhe kërkuesin e fascionojnë gati njësoj: e para me elementaritetin e kulluar, e dyta me kompleksivitetin e arsyetuar.

III. TRADITA E RE

U provua tashmë që ka një traditë shekullore të kritikës shqipe. Përmbysjet kulturo-historike e zhvillimet e mbrendshme letrare, kërkojnë ngritjen e një tradite të re. Kurrkush nuk mund të marrë guximin e marrë të bëjë parashikimin e kësaj tradite të re. Po, dija letrare, që është mbrapavështruese, që tani mund të hetojë disa evidenca:

1. Nevojën për trajtimin e letërsisë si *differentia specifica*;

2. Mallin e pashuar për të rikrijuar terësinë e letërsisë shqipe me pamjet specifike dhe vlerat e sistematizuara;

3. Studimin monografik të fenomeneve letrare në tërësinë e kësaj letërsie, ashtu dhe autorët e mënjanuar ideologjikisht;

4. Rimarrja e autorëve të rikthyer;

5. Dhe, ndoshta, më së pari botimi i plotë i letërsisë shqipe, shkrimet dhe dorëshkrimet.

Këto duken si sprovat e së kaluarës kulturore shqiptare, që i dalin para kritikut të ri pasionant.

IV. FENOMENI SHQIPTAR

Është fenomen i kulturës shqipe, që kritikën letrare e shkruajnë me sukses të veçantë shkimtarët. Nëse e kujtojmë De Radën në shekullin XIX që shkroi *Parimet e estetikës*, gati të gjithë shkrimtarët e mëdhenj të shekullit XX kanë shkruar me sukses kritikën letrare.

Kjo e dhënë, ky fenomen kulturor e letrar, ka dhe pasojat e veta. Shkrimtarët e ruajnë egon e vet personale edhe në kritikë, ku kërkohet egoja e *cogitos*, prandaj shkrimet e tyre shkojnë kah origjinaliteti duke iu mënjanuar konvencës. Po ashtu, të kushtëzuar nga kjo shkrimet e tyre më vështirë bëhen sistematike, aty ku egoja sprovuese do të duhej t'ishte dominante.

Ndoshta, pasojë e kësaj është gjendja e studimeve letrare shqipe, që edhe sot shkojnë me tepër kah natyra e esesë, se sa kah natyra e

rrjetit sistematik të arsyetimit. Një si ndeshje e përhershme e shkrimit krijues me shkrimin akademik ndodh edhe më në fushën e kritikës letrare shqipe.

Më në fund, ne vetëm mund ta provojmë edhe njëherë, që kritika është bijë ilegjitime e letërsisë.

Seit MANSAKU

TRAJTIM SHKENCOR DHE QËNDRIM KOMBËTAR NË STUDIMET PËR HISTORINË E GJUHËS SHQIPE

Dihet se misioni i studiuesit është të kërkojë dhe të njohë me të gjitha mjetet dhe metodat shkencore që ka në dispozicion, të vërtetën mbi objektin që studion, të thellohet mbi të dhe ta pohojë atë ashtu siç i rezulton nga studimi. Si artisti që nuk mund të krijojë pa të bukurën, ashtu edhe shkencëtari nuk mund të bëjë shkencë pa të vërtetën. Kjo do të thotë që studiuesi duhet të jetë i pavarur nga paragjykime ideologjike, politike e nacionaliste të çdo lloji dhe të gjykojë vetëm mbi bazën e kritereve shkencore. Mirëpo kështu duket sikur studiuesit i kërkohet të izolohet nga mjedisi shoqëror e kulturor që e rrethon dhe të mbyllet e të krijojë në kullën e fildishtë, gjë që është e pamundur, sidomos për studiuesit e shkencave shoqërore, të cilët në punën e tyre kërkimore përveç misionit të mirëfilltë shkencor, kanë edhe angazhime të tjera shoqërore, kulturore, edukative etj. Kështu që mendimi i pavarur shkencor i studiuesit në çdo vend dhe në çdo kohë, ku më shumë e ku më pak do të ndeshet me trysni të natyrave të ndryshme që ndikojnë për ta orientuar atë drejt interesave të caktuara etnike, kulturore, politike, etj. të cilat jo gjithmonë janë në pajtim me përfundimet që dalin nga kërkimet e mirëfillta shkencore, madje ndonjëherë ndikojnë në shmangien e tyre. Studiuesit, duke mos qenë krejt të pavarur nga vendi dhe koha ku dhe kur zhvillojnë veprimtarinë e tyre shkencore, duke marrë pjesë në procesin e njohjes dhe të vlerësimit të vlerave të kombit të tyre dhe të kohës së tyre, jo rrallë bien viktimë e ideologjive të ndryshme dhe i shmangen pohimit të të vërtetave shkencore ashtu siç u rezultojnë nga kërkimet e tyre ose i orientojnë kërkimet e tyre sipas parapëlqimeve ideologjike.

Ka shumë mënyra, ka shumë faktorë që mund të ndikojnë për t'i shmangur kërkimet dhe përfundimet shkencore nga misioni i tyre për të pohuar të vërtetën, por besoj se dy janë ato më kryesoret: ideologjitë politike sunduese dhe ideologjitë nacionaliste, të cilat sigurisht nuk janë të ndara me thikë, sepse mund të jenë të gërshetuara e të përfshira te njera-tjetra. Të dy këta faktorë mund të çojnë në

shtrembërimin e të vërtetave shkencore, ushqejnë diletantizmin dhe amatorizmin, e shndërrojnë prodhimin shkencor në publicistikë politiko-shoqërore, ose në retorikë nacionaliste. Të kushtëzosh mendimin shkencor nga një ideologji e caktuar politike, ta vësh atë në funksion të saj, do të thotë të humbasësh pavarësinë shkencore dhe të ideologjizosh shkencën. Një mendje e pavarur shkencore duhet t'i shmanget çdo ideologjie partiake. Preokupimi i përhershëm i kërkuesit shkencor duhet të jetë të ruajë dhe të zhvillojë vetëdijen e një kërkimi të pavarur e objektiv duke qëndruar larg ndikimeve politike. Kështu rezultatet e kërkimeve të tij nuk vjetrohen me ndryshimin e sistemeve politike. Kështu duhet të jetë, por për fat të keq, është një realitet i njohur që studimet shkencore sidomos ato të shkencave shoqërore janë lënduar nga politika në çdo kohë.

Shkalla e trysnisë politike varet nga forma e regjimit në fuqi, nga sistemi politik, ndërsa shkalla e trysnisë nacionaliste varet edhe nga shkalla e emancipimit shoqëror e kulturor të komunitetit ku zhvillohet kërkimi shkencor dhe nga detyrat shoqërore që shtrohen për zgjidhje para tij.

Është jashtë çdo dyshimi se në një sistem jodemokratik, siç ishte ai që sundoi në viset shqiptare për një gjysmëshekulli, kërkimet shkencore, sidomos ato në fushën e shkencave shoqërore, ku përfshihen edhe shkencat filologjike nuk mund të ishin të pavarura nga politika. Pushteti i kohës nuk e ka fshehur synimin e tij për t'ia nënshtruar kërkimin shkencor synimeve politike. Sigurisht është e dobishme të bëhen analiza për të vërejtur deformimet që mund të jenë bërë për shkak të trysnisë politike për t'i ndrequr ato dhe për të nxjerrë mësimet e duhura që në të ardhmen kërkimet shkencore të zhvillohen në mënyrë të pavarur nga ideologjitë partiake të çdo formacioni politik.

Studimet në fushën e historisë së gjuhës besoj se kanë qenë më të mbrojtura nga ideologjizimet dhe politizimet e skajshme banale për disa arsye.

Së pari, vetë fusha e kërkimeve, studimi i evolucionit historik të gjuhës, kryesisht në periudhën antike e mesjetare deri në Rilindje, nuk ka qenë afër problemeve aktuale të politikës së ditës. Problemet më themelore të kësaj fushe si ato që kanë të bëjnë me etnogjenezën e popullit shqiptar, me origjinën e shqipes dhe autoktoninë e shqiptarëve

në trojet e tyre, me marrëdhëniet e shqipes me gjuhë të tjera gjatë shekujve etj., mund ta bënin studiuesin që të rrëshqiste më shumë drejt qëndrimeve nacionaliste sesa drejt politizimeve të mirëfillta. Do të duhej një zell i tepruar politik i studiuesit për të futur politikën e ditës në trajtimin e evolucionit historik të tingujve të shqipes dhe të kategorive gramatikore të saj.

Së dyti, studimet në fushën e historisë së gjuhës shqipe patën një trashëgimni shkencore serioze që vinte nga shkolla gjuhësore të njohura e gjuhëtarë të shquar të gjuhësisë historike krahasuese të gjysmës së dytë të shekullit XIX e të fillimit të shekullit XX, të cilat operonin me metoda rigoroze shkencore dhe prandaj patën arritje të qëndrueshme, që ndikuan fuqishëm në zhvillimet e mëtejshme të gjuhësisë historike e të gjuhësisë së përgjithshme deri në ditët tona. Kështu që edhe studimet tona për historinë e gjuhës shqipe hynë në një hulli shkencore të çelur me dorë të sigurt.

Së treti, një rol të rëndësishëm luajti edhe faktori subjektiv; studiuesit që u morën me studimin e historisë së gjuhës shqipe gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, kur rreziku i politizimit ishte më i madh, kishin një formim shkencor të lakmueshëm, të marrë në shkolla dhe universitete evropiane të njohura, kishin një integritet qytetar, atdhetar e profesional të lartë që i mbronte dhe i ndihmonte që t'i qëndronin trysnisë politike dhe të mos binin në nivele diletanteske. Të tillë qenë brezi i parë që vunë themelet e gjuhësisë historike shqiptare si A. Xhuvani, E. Çabej, S. Riza, M. Domi, I. Ajeti, Sh. Demiraj, B. Bokshi etj. Këta studiues të shquar sollën në gjuhësinë tonë arritjet më të spikatura të gjuhësisë historike krahasuese në studimin e gjuhës shqipe, zbatuan metoda shkencore në punën e tyre studimore dhe krijuan një traditë dhe modele që do të imponoheshin edhe për brezat e mëpastajmë. Ishte brezi i atyre studiuesve që, me gjithë kushtet e pafavorshme politike, mbajti lidhje me qendrat albanologjike të Evropës dhe me albanologë të vendeve të ndryshme të botës, sidomos nëpërmjet organizimit të konferencave albanologjike në Tiranë dhe të seminareve ndërkombëtare për gjuhën dhe kulturën shqiptare në Prishtinë dhe pjesëmarrjes në kongrese e konferenca shkencore të organizuara në kryeqytete të ndryshme të Evropës. Besoj se ka qenë mençuria, autoriteti shkencor dhe integriteti qytetar i këtyre studiuesve të shquar, të cilët edhe në kushtet e izolimit politik të

Shqipërisë nga bota perëndimore mundën të mbanin dritare të hapura ndaj botës shkencore perëndimore. Janë pa dyshim edhe studiuesit e shkencave albanologjike që kanë kontribuar në krijimin e një imazhi të mirë në botë për kombin shqiptar. Siç thotë I.Kadareja: "Gjatë diktaturës gjysmëshekullore komuniste, ndërsa regjimi fitoi përçmimin e gati gjithë botës, kombi shqiptar, i mbyllur si në zhguall prej këtij regjimi, mbeti përgjithësisht i paprekur"[1].

Kjo nuk do të thotë aspak që izolimi i vendit gjatë periudhës komuniste, literatura e kufizuar dhe e kontrolluar që hynte në bibliotekat tona, kontaktet e ndrojtura ose të munguara me albanologë të vendeve me të cilat Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike, ndalimi i prerë e i rreptë i çdo kontakti me studiues shqiptarë emigrantë politikë etj., nuk u kanë sjellë dëme kërkimeve filologjike shqiptare. Mjafton të përmendim se ishte i ndaluar çdo lloj kontakti me studiues të afirmuar si Martin Camaj, Namik Resuli, Ernest Koliqi, Mustafa Kruja etj. N.Resuli punonte në Itali për transkriptimin dhe botimin e plotë të "Mesharit" të Gjon Buzukut, i cili doli më 1958, E.Çabej punonte në Tiranë mbi të njejtin tekst, pa asnjë shkëmbim informacioni e mendimi me njeri tjetrin. Botimi i E.Çabejt doli 10 vjet më vonë më 1968, por cilësisht i ndryshëm nga i pari.

Nëse hedhim një vështrim përmbledhës mbi tërësinë e studimeve për historinë e gjuhës shqipe për të parë se si qëndron raporti midis trajtimeve shkencore dhe qëndrimeve kombëtare për çështjet themelore dhe sa ka ndikuar anësia atdhetare apo romantizmi nacional në objektivitetin shkencor të tezave të mbrojtura, mund të pohohet në mënyrë të përgjithshme se studimet në këtë fushë i përshkon deviza e formuluar nga E.Çabej: "Të jemi objektivë, por jo indiferentë", e cila edhe pse duket si kontradiktore besoj se ka qenë plotësisht e përligjur për rrethanat tona historike e kulturore. Studiuesit tanë janë përpjekur të bashkojnë objektivitetin shkencor me qëndrimin atdhetar kombëtar, por nuk kanë munguar rastet kur shkencëtari ia ka lëshuar vendin atdhetarit. Dhe nuk mund të ishte ndryshe. Studiuesi sado mendjeftohtë të jetë nuk mund të qëndrojë duarkryq kur popullit të tij i mohohet identiteti, i vihet në dyshim historia, i përçmohet gjuha dhe vlerat e tjera kulturore, i grabiten

[1] Ismail Kadare, *Poshtrimi në Ballkan, sprovë*, Tiranë, Onufri, 2004, f.29.

heronjtë kombëtarë dhe personalitete të kulturës. Madje është detyrë qytetare dhe atdhetare e tij t'i mbrojë këto vlera duke përdorur argumente të shëndosha shkencore pa rënë në qëndrime nacionaliste dhe diletanteske. Dhe në përgjithësi kështu ka ndodhur me studiuesit tanë të historisë së gjuhës.

Për të ilustruar këto ide do të ndalem shkurt në tri probleme themelore: Problemi i origjinës së gjuhës shqipe, problemi i traditës së shkrimit të shqipes dhe marrëdhëniet e shqipes me gjuhë të tjera, qëndrimi ndaj huazimeve.

Problemit të prejardhjes së gjuhës shqipe dhe autoktonisë shqiptare gjuhësia jonë i ka kushtuar një vëmendje të veçantë dhe me të drejtë. Këto janë në radhë të parë probleme shkencore që lidhen me etnogjenezën e popujve të Ballkanit dhe probleme me rëndësi kombëtare, sepse janë të lidhura me identitetin tonë si popull. Midis tezave të formuluara për origjinën e gjuhës shqipe, shkencat tona historike e gjuhësore kanë mbrojtur tezën ilire në radhë të parë, sepse ajo mbështetet në argumente historike dhe gjuhësore, ndërsa teza trake vetëm në disa argumente gjuhësore; në radhë të dytë, sepse për ne kjo tezë ka edhe një rëndësi kombëtare: është e lidhur me përkatësinë etnike e territoriale të shqiptarëve, me autoktoninë e tyre në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Prandaj shkencës sonë krahas angazhimit shkencor për të ndriçuar prejardhjen e njerës prej gjuhëve të vjetra të Evropës, i takonte edhe një angazhim kombëtar për të mbrojtur të drejtat historike të popullit të saj. Në trajtimin e këtij problemi besoj se nuk ka asnjë lloj qëndrimi nacionalist, siç duan ta paraqesin disa kritikë. Madje do të thosha se synimi i shkencës sonë për ta sqaruar origjinën e popullit shqiptar e të gjuhës së tij ishte një detyrë shkencore e mirëfilltë dhe një kontribut jo vetëm për shkencën e kulturën tonë kombëtare, por edhe në historinë e përgjithshme botërore.

Studiuesi i njohur kroat Radoslav Katičić, duke folur për etnogjenezën e shqiptarëve, midis të tjerash, pohon: "nuk ekziston vend tjetër, trualli i të cilit të jetë i lidhur më ngusht se ky (është fjala për Shqipërinë – S.M.) me botën e vjetër ilire në vështrimin e saj më të mirëfilltë". Dhe më tej autori shton: "Prandaj kompleksi ilir në vështrimin e zakonshëm që kishte në kohën e Perandorisë Romake, përbën për të gjithë popujt e Jugosllavisë së sotme (është fjala për

Jugosllavinë e vitit 1972) një kapitull të historisë së tyre kombëtare. Dhe kjo jo vetëm në vështrimin gjeografik. Por në një kuptim më të ngushtë dhe në vështrimin e tij të parë, entiteti ilir përfshihet sidomos në historinë kombëtare të popullit shqiptar"[2].

Në trajtimin e këtij problemi studimet shkencore serioze janë përpjekur të qëndrojnë larg trajtimeve romantike e nacionaliste dhe "folklorizmave", siç shprehen pa përgjegjësinë e duhur shkencore disa kritikë, që mendojnë se sjellin një qëndrim emancipues, modern e europianist, të orientuar nga globalizmi, kur angazhimet e qëndrimet atdhetare i konsiderojnë si të vjetruara e të prapambetura ose të bezdisshme, siç pohon I. Kadareja[3]. Përkundrazi shkenca jonë gjuhësore është shkëputur pakngapak nga ngjyrimet romantike që kishte marrë problemi i origjinës së shqiptarëve gjatë periudhës së Rilindjes, duke mbrojtur tezën pellazgjike plotësisht e përligjur për atë kohë. Madje shkenca historike gjuhësore i është kundërvënë tezës pellazgjike, duke përballuar edhe kritika nga rrethe zyrtare të periudhës komuniste që e kishin për zemër këtë tezë.

Edhe sot kanë dalë mjaft ithtarë të tezës pellazgjike në emër të mbrojtjes së lashtësisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tyre dhe bëjnë presion në emër të mbrojtjes së interesave kombëtare për t'i afirmuar si teza shkencore. Dua të ju kujtoj se teza pellazgjike, e lidhur me origjinën e përbashkët të shqiptarëve dhe grekërve, më shumë se kujtdo tjetër i ka shërbyer politikës asimiluese greke ndaj arvanitasve të Greqisë në radhë të parë, por edhe më gjerë. Propagandimi i idesë se shqiptarët dhe grekët kanë të njëjtën origjinë dhe të njëjtin besim ka bërë që arvanitasit të mos i ndjejnë të nevojshme të bëjnë përpjekje për të ruajtur identitetin e tyre etnik e gjuhësor, ndonëse në kushtet e politikës greke e kanë pasur të vështirë.

Si përfundim i kësaj pike do të thosha se nuk më duket i mbështetur etiketimi që i bëhet tezës së prejardhjes ilire të shqiptarëve si tezë zyrtare në emër të një qëndrimi antikomunist. Ajo është në radhë të parë tezë shkencore, në radhë të dytë tezë kombëtare, por jo zyrtare. Në udhëheqjen më të lartë të shtetit komunist teza më e përkrahur ka qenë teza pellazgjike. Për këtë edhe vetë jam dëshmitar.

---

[2] Radoslav Katiçiç, *Antroponimia ilire dhe etnogjeneza e shqiptarëve*, në: "Kuvendi I i Studimeve Ilire", Tiranë, 1974, f.95.

[3] I.Kadare, *Poshtrimi....., vep. cit.,* f.33.

Një tjetër problem themelor i historisë së gjuhës shqipe ku shfaqet dukshëm marrëdhënia (barazpesha) midis trajtimit shkencor dhe angazhimit kombëtar është ai i traditës së shkrimit të shqipes. Lidhur me këtë problem në gjuhësinë tonë janë mbrojtur dy teza të ndryshme: sipas tezës më të përhapur të mbrojtur nga shumica e gjuhëtarëve (Dh. Shuteriqi, M. Domi, E. Çabej, Sh. Demiraj, I. Ajeti etj.) shqipja duhet të ketë qenë shkruar edhe para shekullit XV, kur kemi dokumentet e para, të paktën që nga shekulli XIV, duke sjellë për këtë disa argumente të tërthorta siç është dëshmia e Guilelm Adës, Marin Barlecit, niveli gjuhësor i "Mesharit" të Gj. Buzukut, zhvillimi kulturor i qyteteve shqiptare gjatë mesjetës, e ndonjë tjetër. Në mbrojtjen e kësaj teze autorët e saj janë shtyrë pa dyshim edhe nga një motiv atdhetar kombëtar: të provojnë se shqipja nuk është një gjuhë e shkruar aq vonë, sepse shqiptarët nuk ishin popull pa zhvillim kulturor të hershëm. Ndoshta ka qenë motivimi atdhetar që i ka çuar këta autorë në kërkim të argumentimit shkencor.

Selman Riza, përkundrazi, është përpjekur të rrëzojë tezën e mësipërme dhe të provojë se shqipja ka filluar të shkruhet në shekullin XV dhe se libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe është "Meshari" i Gjon Buzukut. Autori i kësaj teze niset nga argumentimi shkencor dhe pastaj përfundimet që dalin prej tij përpiqet t'i motivojë edhe nga pikëpamja atdhetare kombëtare. S.Riza e ka ndjerë se teza e tij mund të jetë e kritikueshme nga ana kombëtare, prandaj për të mënjanuar çdo keqkuptim, e motivon tezën e tij edhe nga kjo pikëpamje. Ai shkruan se prirja për të paradatuar me çdo kusht fillimet e shkrimit të shqipes nuk është vetëm shkencërisht e papranueshme, por edhe kombëtarisht e shkëshillueshme, sepse duket sikur bëhet për të superkompensuar shpifjet se populli shqiptar nuk paska zhvilluar ndonjë krijimtari kulturore në të kaluarën e tij kombëtare. Kjo prirje, sipas autorit, "përbën një dëshmi, qoftë edhe të tërthortë, se ndërgjegja e ndonjërit prej nesh ende sot e kësaj dite nuk është spastruar sa duhet nga çdo mbeturinë e kompleksit të inferioritetit kombëtar"[4].

Çështja e fundit ku gërshetohet trajtimi shkencor me qëndrimin kombëtar që unë dua të prek shkurt këtu, është çështja e qëndrimit ndaj ndikimeve të gjuhëve të tjera në gjuhën shqipe. Kur lexon

[4] S.Riza, *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2002, f.25.

punimet historike që i kushtohen kësaj teme, të krijohet përshtypja se ka një reagim të vetëdijshëm kombëtar ndaj ndikimeve të huaja, sidomos kur është fjala për ndikime në fushën e strukturës gramatikore. Ky qëndrim sigurisht vjen si kundërreagim ndaj atyre studiuesve të huaj që ose me qëllime të caktuara, ose nga njohja e pamjaftueshme e gjuhës shqipe, e kanë mbiçmuar elementin e huaj, sidomos elementet latino-romane deri në atë shkallë sa ta quajnë shqipen gjuhë e përzier gjysmëromane. Kundërshtimi i këtij pohimi të Gustav Meyer-it nga H.Pederseni me përfundimin se ndikimi i latinishtes në fleksionin e shqipes është barazi me zero sigurisht që është provuar si i drejtë. Megjithatë përsëritja e këtij përfundimi si refren sa herë që bie fjala për ndikimin latin në strukturën gramatikore të shqipes nuk besoj se është gjithmonë i përligjur.

Është një gjë e njohur që ndikimi në fushën e fonetikës dhe të gramatikës është shumë më i vështirë se në fushën e leksikut, por jo i pamundur. Një simbiozë shumëshekullore e shqipes dhe e latinishtes është vështirë të mos ketë lënë gjurmë edhe në strukturën gramatikore të saj. Po kështu kur flitet për romanizimin e Ballkanit e kemi pasur të vështirë të pranojmë ekzistencën e një popullsie latino-romane në qytetet bregdetare të Arbërisë mesjetare kur është krejt e mundur që këto qytete kanë themele ilire, më pas marrin trajtë helene dhe në mesjetë kanë fytyrë romake. Po kështu kur trajtojmë tiparet ballkanike të shqipes, të gjithë i pranojmë këto tipare, por kur vjen puna për të shpjeguar prejardhjen e tyre, ose do të përpiqemi të argumentojmë burimin e tyre në gjuhët e tjera nga shqipja ose të provojmë se në shqipe janë zhvillime të pavarura gjë që teorikisht do ta vinte në dyshim karakterin ballkanik të tyre.

Një farë mosbesimi dhe fobie ndaj të huajve dhe elementit të huaj në gjuhën dhe në kulturën shqiptare duket se është krijuar gjatë shekujve te ne shqiptarët në rrethanat e sundimeve shumëshekullore të pushtuesve të huaj e në mënyrë të veçantë një qëndrim gjuhësor purist e kemi trashëguar nga periudha e Rilindjes Kombëtare kur mendohej se elementet e huaja në gjuhë dhe në kulturë cënonin identitetin kombëtar. Një qëndrim i tillë ishte krejt i përligjur në atë kohë kur rilindësit e mëdhenj po luftonin për mbrujtjen e forcimin e vetëdijes kombëtare dhe për arritjen e Pavarësisë, por në kohën tonë po çlirohemi nga kjo fobi, por kapemi nga të tjera semundje të modës e të

globalizmit të përqafimit të çdo gjëje të huaj pa kaluar në asnjë lloj kritike shkencore për të penguar atë që është e panevojshme, madje e dëmshme dhe e papajtueshme me traditat e rrethanat tona historike e kulturore.

Mendoj se studimet tona historike për gjuhën shqipe duhen çliruar plotësisht nga ndikimet politike, mund të çlirohen ende nga disa retorizma të panevojshme kombëtariste, komente atdhetare jashtëshkencore, për të forcuar gjithnjë e më shumë metodat dhe trajtimet shkencore, por gjithsesi është ende shpejt për t'u shkëputur tërësisht nga qëndrimet kombëtare dhe angazhimi kombëtar në studimet albanologjike.

Wilfried FIEDLER

DISA MENDIME RRETH SISTEMIT RASOR TË GJUHËS SHQIPE

(një alternativë për përshkrimin e tij tipologjik)

Në një artikull të botuar në revistën General Linguistics tipologu Nimrod Barri i Universitetit Hebraik të Jerusalemit pyet: "How many Albanian cases?", duke i shtuar pyetjes nëntitullin: "An exercise in syntactic morphology".[1] Nga konteksti i këtij punimi duket qartazi, se autori nuk ka ndërmend të përdorë termin "syntactic" në kuptimin e definicioneve, siç i gjejmë p.sh. në fjalorë modernë të gjuhësisë:[2] "A general distinction can be made between (a) **casus rectus** (nominative) and **oblique cases** (genitive, dative, accusative, etc.), and (b) syntactic and semantic cases. The syntactic cases such as nominative and accusative encode primary syntactic functions such as subject and object and do not have any specific semantic function". Gjithashtu fokusi i Barrit nuk është ai i gramatikës funksionale ose asaj të rasave ("case grammar" Fillmoret). Këndvështrime të tilla kanë karakter të përgjithshëm dhe mund të ishin të vlefshme sidomos për përshkrimin e sistemeve si të italishtes ose të anglishtes. Mendimi i Barrit, i cili duket i drejtë dhe të cilin dua ta zgjeroj këtu, del qartazi nga kjo fjali: "The grammars have been mistaken only in presenting Albanian cases as a distinction between forms of words, i.e., within morphology." Me rëndësi më duket të theksohet, se sipas konceptit të autorit nuk mjaftojnë ndryshime vetëm në rendin e fjalëve ose në theksin e tyre në fjali, por duhen marrë parasysh edhe elemente jashtë vetë sistemit emëror dhe me karakter fjale.

Pikënisja e autorit është paraqitja e sistemit të rasave të shqipes, siç gjenden p.sh. në gramatikën e Boissinit - me pesë rasa: nominativ-vokativ, akusativ, genitiv, dativ, ablativ, dhe e cila nuk i përgjigjet

[1] Barri, Nimrod (1992): How many Albanian Cases? An Exercise in Syntactic Morphology. In: General Linguistics, Vol. 32, No. 1, f. 58-66. I jam shumë mirënjohës kolegut Besim Kabashi, i cili më ka hequr përmendjen për këtë punim.

[2] Bussmann, Hadumod (ed.) (1996): Routlage Dictionary of Language and Linguistics, London and New York.

strukturimit të kategorisë, sidomos nga shikimi i balkanologjisë tradicionale, i cili përmbledh genitivin dhe dativin në një rasë. Këtë problem do ta rrokim më poshtë.

Historia e fleksionit të shqipes, të cilën Besim Bokshi e ka përshkruar me një metodë shumë interesante strukturale,[3] karakterizohet për një lëvizshmëri shumë të madhe të mbaresave, në mënyrë të posaçme te shprehja e kategorive të rasës dhe të shquarësisë, sikurse edhe për një sinkretizëm jashtëzakonisht të zhvilluar, që shpeshherë lë vetëm pak tipare që lejojnë diferencimin e rasave nga njëra-tjetra. Nga ana tjetër që në fillim bie në sy edhe ndërlidhuria me "atributivitetin", me "sintagmën atributive", e cila përbëhet prej "pronës" - e quajmë *Kernnomen (emër bërthamë)* dhe "pronarit", d.m.th. atributit që në sistemin rasor del me mbaresën e gjinores-dhanores së një emri ose një mbiemri të paravendosur. Unë këtu nuk dua të rishkruaj zhvillimin e sistemit; do të përqendrohem vetëm te përshkrimi tipologjik i shqipes moderne, por duke përfshirë në raste të caktuara edhe ndonjë dukuri jashtë gjuhës së njësuar letrare.

Analizën e të dhënave do ta bëjmë, së pari, në tri dimensione, në tre hapa:

1. Hapi i parë: analiza e mbaresave dhe e strukturës "horizontale" të tyre me nga katër trajta: trajta e pashquar dhe e shquar njëjës; e pashquar dhe e shquar shumës.

Disa probleme të këtij lloji dalin qysh në skemën e lakimit që Barri fiton nga gramatika e Boissinit: si trajta të shumësit të shquar kemi mbaresa me *-t* në fund në genitiv, dativ dhe ablativ. Këto trajta tashmë pas Kongresit të drejtshkrimit të vjetëruara, na dëshmojnë lëvizshmerinë e madhe në sistemin e mbaresave të lakimit edhe në gjuhën e sotme shqipe. Një dukuri tjetër të kësaj skemës - mundësinë e supozuar të këmbimit të lirë te trajtat ablativale *(prej) ca gurësh/gurëve* do ta shqyrtojmë më poshtë. Është vënë në dyshim nga vetë Barri. Do të shohim se ajo vlen vetëm për një pjesë të vogël të përdorimeve. Nga punimi i Barrit del se nga pesë rasat e Boissinit vetëm nominativi mund të mjaftohet me një karakterizim thjesht morfologjik. Megjithatë, edhe

[3] Bokshi, Besim (2005): Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes. Botim i dytë. Prishtinë.

nominativi i shqipes ka karakter shumë specifik, por këtë gjë nuk do ta trajtojmë këtu.

Dy gjymtyrë të tjera si "kandidate" brenda sistemit të lakimit, të cilat nuk i përmend as Boissini as Barri, por që hëpërhë mund të karakterizoheshin me mjete morfologjike - janë lokativi (vendorja) dhe vokativi (thirrorja).

Në fillim do të merremi vetëm me lokativin; te vokativi do të kthehemi krejt në fund. Ekzistenca e një lokativi në shqipen moderne, edhe pse nuk njihet në gjuhën standarde, sipas mënyrës së përshkrimit që kam zgjedhur këtu, nuk mund të mohohet. Në gramatikat më të vjetra lokativin e shquar me mbaresën *-t* e gjejmë shpeshherë, p.sh. në gramatikën e Pekmezit: "[ekziston]...në njëjësin dhe në shumësin e shquar një lokativ, të cilin, në lakimin e pashquar e zëvendëson trajta e nominativit-akuzativit"[4] Prandaj si shembuj Pekmezi në skemat e tij të lakimit në faqet 95 vv. gjejmë - vërtet Pekmezi na sjell vetëm trajtat e shquara të njëjësit si: *màlt, gàst, mìkt, kruat; gruat* etj. Ai sjell vetëm trajtat e shquara të njëjësit. Nuk plotëson kështu kërkesën tonë teorike - paraqitja e katër trajtave "horizontale", qofshin edhe në shikim të parë, identike me trajta të rasave të tjera. Të gjitha trajtat që na sjell Pekmezi zëvendësohen në gjuhën standarde me trajta pa *-t*. Pra, në gramatikat e reja, pas rënies së trajtave me mbaresën *-t,* lokativi nuk përmendet më, edhe pse - fund i fundit - reduktimi i *-t*-së i ngjan reduktimit te trajtat p.sh. të dativit *gjuhëve(t), maleve(t)* etj., Këtu hyn në lojë problemi i **sinkretizmit**. Sepse ndryshe paraqitet çështja, nëse merren parasysh - në mënyrë konsekuente - nga një anë shquarësia si kategori e emrit në gjuhën e sotme, sinkretizmi edhe veçoritë e "sintagmës atributive" dhe, nga ana tjetër, parimi se çdo trajtë flektive, d.m.th çdo gjymtyrë p.sh. brenda sistemit nominal ose verbal, duhet të ketë nga një marker, një shënjues të secilës kategori nominale, gjegjësisht verbale, qoftë edhe zero. Kjo do të thotë, se p.sh. trajta *gjuhëve* tani është edhe trajta e pashquar, edhe trajta e shquar e dhanores shumës të fjalës *gjuhë,* dhe e përjashton mendimin se tani ekzistuaka vetëm një trajtë, pra trajta e pashquar.

[4] "... sowie im bestimmten Singular und Plural nach bestimmten Präpositionen ein Lokativ, den in der unbestimmten Deklination die Form für den Nom., Akk. vertritt." (Pekmezi (1908), S. 94).

Dukuria që po përshkruaj quhet zakonisht "lokativ", por mund të emërtohej, si fenomeni paralel p.sh. i rusishtes, "prepozitiv", sepse haset vetëm pas parafjalëve si *në, nëpër, mbi, nën, për*. Një qëndrim të veçantë [e] gjejmë p. sh. te parafjala *me*: mund të thuhej se lokativi përdoret me kuptim instrumental: *pres me thikë, vij me autobus...*, kurse akusativi me kuptim komitativ (përcjellës): *me dimrin vjen edhe të ftohtit, vij me djalin, vij me papagallin*,[5] por në të dyja rastet trajta është e njëjtë (si ajo e aksativit), kur kemi një atribut (*...me thikën e mprehtë, me autobusin e mëngjesit; me dimrin e sivjetëm, me djalin e profesorit...* Paradigma e lokativit paraqitet, pra, si vazhdon: tr. e pashquar: *mal*, trajta e shquar gjithashtu *mal*, por, po të kemi një "sintagmë atributive": [Präp. +] *malin [e...]*[6]. Shihet, se në këtë rast, nuk mjaftojnë katër gjymtyrë "horizontale", por duhet një e pestë, ajo me atribut.

Përshkrimi i rasës që quhet zakonisht ablativ (rrjedhore) paraqitet edhe më i ndërlikuar, edhe pse njihet përgjithësisht si një rasë gjoja e mbyllur në sistemin nominal të shqipes. Unë mendoj se funksionet e tij duhet të përshkruhen veç e veç, meqenëse dalin ndryshime morfologjike.[7] Hëpërhë dukuria ndahet në "katërsh", por thënë që në fillim, se këtu duhen analiza më të thella:

1) Funksioni atributiv: Edhe këtu lipset të kemi parasysh "sintagmën atributive" qysh te hapi i parë, por në ndryshim nga rasti i sipërm mjaftojnë katër gjymtyrë. "Horizontalisht" trajtat paraqiten kështu: Në njëjës trajta e pashquar i përgjigjet trajtës së gjinores-dhanores: mish *lope*, por trajta e shquar kërkon "sintagmën atributive" si të gjinores: mishi *i lopës.* Këtu Barri,[8] sipas mendimit tim, gabon, duke menduar se paska trajta të shquara të tipit *guri malit, kampionati*

[5] Ka një konditë këtu: dihet se udhëtoj nganjëherë me një papagall të caktuar!

[6] Në shumës ky problem duhet të analizohet veçmas, khs. p.sh. përkthimin e Biblës - Marku V, 5. Kristoforidhi (botimi i Manastirit) ka: *...ishte ndëpër varret e ndëpër malet dyke bërtiturë...*, kurse te Filipaj gjejmë: *...nëpër varre e nëpër male bërtiste*. Ndoshta në raste të këtilla, shumë specifike, kategoria funksionale-semantike e shquarësisë është neutralizuar (por khs. edhe gjermanisht: "er war... auf den Bergen und in den Gräbern, schrie..." (Luther-Bearbeitung), it. "in mezzo alle tombe e sui monti...urlando..." (Traduzione interconfessionale), frz. "dans les tombes et sur les montagnes, criant..." (Nouvelle version). Këtu nuk marrim parasysh rastet, ku në vend të "sintagmës atributive" përdoren atribute të tjera, apozicione etj.

[7] Khs. sidomos Buchholz-Fiedler, Albanische Grammatik, Leipzig 1987, f.223-226; Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe. II. Tiranë 1976, f. 82 v.

[8] Barri, v. e c., f.63.

futbollit. Këta shembuj, të cilët Barri [i] ka gjetur në një tekst të shtypur, janë kontaminacione ose haplologji dhe duhet të lexohen *guri i malit, kampionati i futbollit*, se nuk mund të kishte gjetur shembuj si **forca e menduarit*. Në shumës kemi, si trajtë të pashquar, detyrimisht mbaresën e veçantë *-sh*: mish *lopësh,* dhe përjashtohet *mish *lopëve*, trena *mallrash*, jo trena *mallrave*. Kurse trajta e shquar tingullon përsëri si trajta përkatëse e gjinores: mishi *i lopëve*, trenat *e mallrave*.

2) Në funksionin pas parafjalëve trajtat e njëjësit janë sinkretike me ato të gjinores-dhanores: *ballë një muri,* gjithashtu: *afër shkollës*, *buzë liqenit*. Shumësi i pashquar mund të jetë me mbaresën *-sh,* por në këtë funksion haset edhe mbaresa e gjinores-dhanores, pra *-ve*. *prej vitesh, pas disa orësh, para dy ditëve, pas dy orëve* (shembujt nga FG II, 83). Trajta e shquar në gjuhën standarde mund të jetë vetëm me *-ve* (*afër të gjitha shkollave*, kurse në "idioma "arkaike" edhe me *-shit*: te Buzuku p.sh. *e ën gjithë kafshëshit të gjalla dyy e dyy t i bainsh bashkë*[9]; *Parë e parë pas faqeshit, sumbulla pas gjinjëshit*[10]. Në qoftë se pas parafjalëve përkatëse gjejmë në kontekst sintagmën atributive, nuk kemi të bëjmë me trajtën e shquar, por me atributin e fjalës në trajtën e rrjedhores (së shquar ose të pashquar): *ballë një muri të lartë*; *afër shkollës së fshatit, buzë liqenit të afërt*.

Vetëm këto dy variante të para kanë vërtet vlerën e dukurive rasore, kurse dy të tjerat janë me shumë kufizime, para së gjithash leksikore. Prandaj nuk do të futen në skemën më poshtë (shih faqen...).

3) Në funksionin e mirëfilltë ablativ[or], i cili në gjuhën standarde është mjaft i rrallë dhe del kryesisht pas përemrave dhe në disa shprehje të ngurosura, gjejmë në njëjës të emrit (ndryshe nga përemrat, p.sh. posesivë) sinkretizëm me mbaresat e gjinores-dhanores, p.sh.: duhet ta *heqim qafe* këtë punë, por edhe *e hoqi qafës* "e dëboi"; me trajtën e shumës *-sh* kemi p.sh. *luajti mendsh.* Me këtë funksion trajta e shquar shumësi është problematike. Sipas Çabejt[11] trajta e vjetër me *-shit* që është paralele me trajtat e tjera të shquara në shumës me *-t*, del jo vetëm te shkrimtarët e vjetër dhe në arbërishte, p.sh. te Matranga: *lijrona gjithë së keqiashit* (transkribimi i Ç.T), por si relikt edhe në disa të folme të Jugut: *më dolli hundëshit*, *të iku balta këmbëshit* (Gjirokastër) etj. Sipas

[9] Ressuli, 220, 79 v. Transliterimi im, W.F.
[10] Këngë popullore nga Korça, khs. Çabej, v. e cit., 118.
[11] E. Çabej, Gjon Buzuku (4). Në: Bul.p. Shk. Sh. 4, 1955, f. 117 v.

përdorimit pas parafjalëve do të pritej se tani mund të përdoret trajta me *-ve*, por, siç duket, kemi edhe trajtën me *-sh* atje ku ka shquarësi, p.sh. *Krishti u ngjall së vdekurish*, d.m.th. ka rënë mbaresa e shquarësisë *-t* si në rastet e përshkruara më lart. Por kjo më duket një punë disi problematike!

4) Me në fund në funksionin adverbial, me kuptim temporal ose lokal në të gjitha ngjyrimet (inessiv,...; allativ,illativ...; distributiv[12]) gjejmë trajta rrjedhore në njëjës të pashquar dhe të shquar. Në shumës ka defektivitet - ekziston, siç duket, vetëm trajta e shquar me *-ve* dhe jo trajta e pashquar me **-sh*: *aso kohe ishte rektor*, *kësaj* (gjindhan.>rrjedh.) *vere do të vete në Durrës*; *dimrit, verës...*; *mbrëmjeve, mëngjeseve* (por jo **disa mbrëmjesh...*); *Një copë herë u sorrolata trotuarit/një trotuari...*; *Pali endej fshatrave* [*...*fshatrash,...disa fshatrave...*]. Edhe këtu duhen analiza të mëtejshme.

2. Hapi i dytë: përfshirja e "sintagmës atributive"

Dy herë jemi përgatitur për të marrë vrull drejt hapit të dytë, te ablativi i shquar njëjës dhe shumës në funksionin atributiv, dhe te lokativi i shquar njëjës: (sh. më lart!).

Kuptohet se dukuria kryesore këtu është trajta e gjinores, e cila në çdo rast përcillet prej nyjës atributive, trajta e së cilës këtu, ndryshe nga rastet e përmendura - caktohet prej kategorive jo të "pronarit", d.m.th. të trajtës së atributit, por të pronës, të "emrit bërthamë" (në gramatikën Buchholz-Fiedler: *Kernnomen* - gjini, numër, rasë, shquarësi dhe "distancë"). Mund të thuhet se gjinorja me këtë veti sintaksore, me praninë e nyjës së përparme të diferencuar sipas kategorive të emrit bërthamë, tashmë njihet përgjithësisht si fenomen i sistemit të rasës. Si pasojë duhet të përshkruhet nga këndvështrimi i morfologjisë.

3. Pak ndryshe qëndron puna e pranimit të përgjithshëm të një hapi të tretë, të cilin po bëjmë tani: përfshirjen e të ashtuquajturave trajta të shkurtëra përemrore në sistemin rasor. Kushti paraprak i përshkrimit si pjesë të sistemit rasor është njohja e tyre si pjesë përbërëse të grupit verbal. Si pasojë kjo do të thotë se nuk janë më trajta përemrore.[13] Ky

[12] Sepse mund të përmblidhen në kategorinë *në* + lokativ, por jo me kuptim ablativ[or] (sh. më lart!), në këtë rast nuk kemi *në* +, por do të duhej një parafrazë *nga* + nom./*prej* + abl.

[13] Ashtu si shenja e shquarësisë *-i, -u, -a...* nuk mund të konsiderohet në gjendjen e sotme të shqipes, si nyjë, se s'është fjalë.

mendim bazohet para së gjithash në topologjinë dhe në pandashmërinë e tyre nga folja. Pastaj, sipas mendimit tim, nuk ka vështirësi të posaçme teorike, se edhe kategori të tjera nominale pasqyrohen në trajta foljore: numri bile, siç duket, në të gjitha gjuhët indoevropiane, ndërsa gjinia në formimin e perfektit p.sh. të gjuhëve sllave. Prandaj: pse të mos ketë reflekse të kategorisë nominale të rasës në grupin verbal? Për karakterizimin e dativit dhe për veçimin e tij prej gjinores dhe rrjedhores e ka përdorur këtë argument e para, siç vë në dukje Barri - kolegia ime Oda Buchholz; në gramatikën tonë të përbashkët teorinë e kemi përdorur dhe e kemi zgjeruar.[14] Për këtë dukuri kemi përdorur termin *Objektzeichen ("shenjë kundrinore")*, gjë që tani mua nuk më duket ideale, sepse me rëndësi të veçantë është pikërisht fakti se çdo dhanore, pavarësisht nga funksioni, pra edhe jashtë kundrinës, kërkon pasqyrimin në grupin verbal, p. sh.: *Fqinji* ***i bërtiti djalit*** [kundrinë e zhdrejtë]*; Mësuesi* ***i dha babait*** *një libër* [k. e zhdr. + kundrinë e drejtë], por edhe në përdorime të tjera si posesivitet: *Sytë* ***po i mësoheshin*** *dalngadalë me gjysmëterrin*, shprehja e agjentit: ***Mua****, ç'është e vërteta,* ***më qeshej*** dhe të tjera. Mund të quhej më mirë "shenjë rasore".

Por, nga ana tjetër, një shenjë e tillë nuk na del vetëm në dhanore, por edhe në kallëzore, dhe këtu nuk e përcjell çdo kallzore. Kemi dy mundësi teorike; ose ta quajmë shenjën e akusativit vërtet "shenjë kundrinore" ose të ndajmë rastet ku mund të dalë - sipas rregullave të caktuara - kjo shenjë nga rastet, ku nuk mund të dalë, pra ta diferencojmë akkuzativin në një "kallzore kundrinore" (në rastet ku, sipas rregullave të caktuara, duhet ose nuk duhet të përdoret "shenja rasore" (si në fjalinë *Ia ktheva librin mësuesit/* (me të dyja shenjat rasore njëkohësisht)*/I ktheva librin një mësuesi* dhe një "kallzore jokundrinore" *Kam hyrë një të dielë/ të dielën e parë të marsit*. Pra, edhe akusativin duhet ta ndajmë në dy "nënrasa". A mund të themi tani, se me këtë procedurë çdo ish-trajtë e shkurtër përemrore është karakterizuar sipas rasës? Jo, na mbetet edhe një rast shumë specifik i shqipes: Ka folje që kërkojnë po këtë shenjë të bashkuar *dativ+akusativ*, por në versionin e plotë të fjalisë del, si referent, vetëm trajta e dativit, dhe një emër në

[14] O. Buchholz (1968): Zur Frage der Verdoppelung der Objekte im Albanischen. In: Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes. VI, 711-724; O. Buchholz u. W. Fiedler (1987): Albanische Grammatik. Leipzig. F. 217 vv., 439-452 dhe passim. Shembujt në tekst janë marrë nga kjo gramatikë.

akusativ nuk ekziston. E kemi karakterizuar këtë dukuri në gramatikën tonë, dhe Menella Totoni e ka trajtuar në një punim të hollësishëm, por në të dyja këto botime nuk janë rrokur pasojat për sistemin rasor.[15] Mënyra më e lehtë e përshkrimit do të ishte supozimi, se kemi një lloj të veçantë të dhanores. Shikuar nga pikëpamja e valencës mund të thuhet se foljet *arrin, del, hipën, bën* në raste si *gëzohem që ia arrite kësaj dite*, *nuk ia del dot atij*, *Ia hipi kalit*, *Si t'ia bëj kësaj pune?*, kërkojnë foljen me shenjën e dativit, të zgjëruar me shenjën e akuzativit, kurse referent i vetmi i këtyre konstrukteve në fjali mund të jetë vetëm emri në dativ. Një vështirësi e posaçme përshkrimi mbetet për karakterizimin gramatikor të konstrukteve me kombinimin e shenjave rasore të dativit dhe akusativit i rasteve të tjera, ku nuk ka fare referent nominal në fjali, si *Ia behu vëllai në derë, Ia vlen të përpiqesh*, *Ia nisi të fliste*, *Ia shtruam me të ngrëna e me të pira*, të gjithë shembujt nga punimi i Totonit. Nëse elementet *ia behu, ia vlen...* në këto raste i përcaktojmë thjesht si trajta foljore, të paradigmës së foljes që pasqyrojnë rasa, por në këtë rast të veçantë pa referent adekuat, d.m.th. pa referent në rasën/në rasat kallzore dhe dhanore, atëherë kemi njëfarë paraleliteti: veprojnë si trajta foljore *agon*, *bubullon*, ku mungon referenti adekuat në nominativ, kemi njëfarë ngjashmërie strukturore. Gjuhë të tjera veprojnë ndryshe, khs. gjerm. *es donnert,* fr. *il tonne,* ku formalisht nuk mungojnë këto gjymtyrë të fjalisë. Mendoj se këtu i jam më afër mendimit të kolegut Përnaska, i cili thotë - ndryshe nga Totoni[16] - se "trajtat e shkurtra të shqipes nuk mund të jenë në gjendjen e sotme përemra".

Gjithë sistemi i përshkruar këtu mbulon vetëm një pjesë të sistemit që na duhet për karakteriziminin e valencës në gjuhën shqipe. Fakti që kemi këtu p.sh. një ndërvarësi me rasat parafjalore u duk sheshit te përshkrimi i lokativit, i cili lidhet në mënyrë të domosdoshme me parafjalë të caktuara. Nga ana tjetër, çdo lloj përshkrimi të valencës ka si kusht paraprak caktimin e sistemit rasor siç jam përpjekur ta jap.

4. Më në fund, si një shtojcë, duhet të kthehemi te një fenomen, i cili përmendet në shumë gramatika të shqipes, te thirrorja ose vokativi. Ndryshe nga ablativi, por edhe nga lokativi, një rasë "vokativ" nuk mund të quhet gjymtyrë e plotvlershme e sistemit rasor të shqipes. Megjithatë,

[15] Menella Totoni (1993): Një ndërtim idiomatik i shqipes. Në: Studime Filologjike 1-4, 1993, f. 77-91.
[16] Totoni, v. e c., f.89.

ka disa mënyra të shprehuri që mund të interpretoheshin si hapa drejt krijimit e një rase për shprehjen e "vokativitetit". Ato i kemi paraqitur në f. 214 v. të gramatikës sonë si "funksion vokativ i nominativit". Kanë të bëjnë edhe me mjetet morfologjike, edhe me ato sintaksore: shpeshtësia e përdorimit të pasthirrmave si *o* (që bile mund të prapavendoset në raste si *bir-o, nën-o*) ose *moj, more, bre* (me diferencim sipas kategorisë së gjinisë), raste si *shokëni, burrani* që tregojnë lidhje me sistemin foljor etj.

Si rezultat del kjo skemë për sistemin rasor të gjuhës së sotme shqipe:



Rreshti i parë tregon gjymtyrët e sistemit që mund të përkufizohen me anë të një serie mbaresash. Këtu, hëpërhë, nuk merret parasysh mundësia e pranisë së parafjalëve, gjegjësisht e kombinimit me parajalë që shërbejnë për krijimin e rasave parafjalore.

Rreshti i dytë tregon, nëse gjymtyra përkatëse shpreh atributivitet (=gjinoren) resp. dëfton të sjellurit e saj në lidhje me atribute.

Rreshti i tretë tregon a kërkon gjymtyra përkatëse [me kondita të përkufizueshme] pasqyrimin e rasës në trajtën foljore.

Shenja ▉ e fundit në çdo radhë vertikale tregon te cili hap plotësohen tiparet e nevojshme morfologjike/morfologjike-sintaksore për karakterizimin e gjymtyrës së dhënë në sistemin rasor.

Pas numrit rendor jepen katër trajtat paradigmatike horizontale të gjymtyrës së dhënë (trajta e pashquar njëjës, trajta e shquar njëjës, trajta e pashquar shumës, trajta e shquar shumës).

Nuk janë karakterizuar, tani për tani, Ablativi 3 (funksioni "ablativ[or]" në kuptimin e mirëfilltë) dhe Ablativi 4 (funksioni adverbial), se në shqipen e sotme kanë karakter idiomatik dhe janë të lidhur me kufizime leksikore. Vokativi këtu nuk merret parasysh, sepse nuk paraqet rasë e plotvlershme në sistemin e shqipes së sotme.

[Gërmat e mëdha në skemë simbolizojnë një "mëkëmbës" (*Platzhalter*), i cili mund të zëvendesohet nga elemente të tjera të kësaj klase.]

Mark MARKU

ALBANOLOGJIA NË ZANAFILLË OSE IMAZHI I KRIJUAR SË JASHTMI

Nuk është e rastit që akti i parë i dokumentuar i aventurës së zbulimit të Shqipërisë dhe shqiptarëve në botë është një akt gjuhësor: Fjalorthi shqip i Arnold von Harfit. Kalorësi nga Këlni, udhëtar i dhënë pas aventurës së njohjes me tjetrin, duke kaluar nëpër Ulqin, Durrës e Sazan nuk harron ta dokumentojë zbulimin e tij të ri: gjuhën shqipe. Regjistron disa fjalë, si prova të zbulimit të tij të cilat mbetën pa botuar disa shekuj, derisa Dr. Von Groote, i boton në vitin 1860 në Këln.

Viti i botimit të shënimeve të Von Harfit përkon me një epokë historike të kulturës evropiane që mund të quhet pa frikë epoka e filologjisë. Siç vëren Eduard Said, në këtë periudhë filologjia është një shkencë mjaft atraktive dhe moderne. Sipas Said "Detyra e filologjisë në kulturën moderne është vështrimi i qartë i realitetit, duke hequr dorë nga çdo gjë e mbinatyrshme, duke ecur kështu përkrah zbulimeve të shkencave ekzakte... Por përveç kësaj, filologjia na mundëson një vizion të përgjithshëm të jetës njerëzore..."[1] Ai për të argumentuar idenë e tij thërret në ndihmë Renanin i cili shkruante në vitin 1848 teksa përfundonte librin e tij të famshëm *E ardhmja e shkencës* (1848) se "filologët, janë krijuesit e mentalitetit modern" dhe se "racionalizmi, shpirti kritik, dhe liberalizmi janë krijuar njëkohësisht me themelimin e filologjisë.... Filogjia është shkenca ekzakte e përfytyrimeve mendore, ajo është për shkencat humane në të njëjtat marrëdhënie siç janë kimia dhe fizika me shkencat filozofike të trupave".[2] Ashtu sikurse epoka e zbulimeve gjeografike solli zbulimin e botëve të reja edhe epoka e zbulimeve filologjike solli zbulimin e gjuhëve të reja.

[1] Eduard Said. Orientalismo. L'imagine europea dell'Oriente (Imazhi evropian për Lindjen). Feltrinelli. 1992. Faqe 135.

[2] Cituar sipas Eduard Said, Orientalismo. Imazhi europian për Lindjen. (Imazhi evropian për Lindjen), Feltrinelli. 1992. Faqe 135.

Arnold von Harfi është i pari që nëpërmjet fjalorthit të tij, e dokumenton historikisht zbulimin e vet. Më vonë, siç dihet gjuha shqipe do të bëhet objekt i eskursioneve apo i vëzhgimit të shumë filologëve e dijetarëve si Malfioti, Celebiu, Leibniz, Da Lecce, Herder, Spencer, Hobhouse, Boué, Pouqueville, Hahn dhe të tjerëve. Qëllimi i këtij punimi nuk është studimi i punëve të tyre pasi këtë e kanë bërë dhe e bëjnë shumë mirë studiuesit e gjuhësisë, por vështrimi i asaj dukurie komunikimi që ka të bëjë me krijimin e imazhit të Shqipërisë dhe shqiptarëve në botë. Është fjala pikërisht për atë dukuri komunikimi që ka të bëjë me zbulimin e tjetrit, me tjetrin si bartësi i një identiteti kulturor të ndryshëm nga i yti, me tjetrin si botë dhe si vehte, si zbulim dhe si rikrijim.

Imazhi i tjetrit zbulohet në një shumësi tekstesh të ndryshme filologjike, historike, gjeografike, letrare, të organizuara në forma ligjërimi që nga ato studimore, letrare e deri tek shënimet e udhëtimit që na transmetojnë informacione, gjykime, realitete në të gjitha gjuhët dhe për të gjitha kombet. Në lashtësi ishte pikërisht elementi gjuhësor ai që bën dallimin mes "tanëve", dhe "të huajve". Ata që nuk dinin gjuhën e tjetrit konsideroheshin "barbaros", domethënë të huaj. Barbari, i huaji, duhej përbuzur pikërisht sepse nuk fliste gjuhën e grekëve. Këtej rrejdh edhe ajo traditë imazhologjike ku imazhi i tjetrit krijohej sipas paragjykimeve të një qytetërimi apo të një kulture.

Nga tërë larmia e teksteve të përmendura më sipër tekstet filologjike janë studimet që realizojnë më mirë funksionin e tyre imazhologjik. Filologjia si shkencë moderne mori një kahje historiko-krahasuese gjë që e bëri atë një instrument të rëndësishëm shkencor dhe të paanshëm në kërkim të tjetrit. Më sipër thamë se që nga mesi i parë i shekullit të 19-të, filologjia kishte pretendimin e një shkence ekzakte. Si e tillë ajo do të ishte një shkencë deri diku neutrale nga pikëpamja ideologjike. Kjo gjë verifikohet edhe në rastin e studimeve të autorëve të huaj për shqipen. Këta autorë bëjnë përpjekje për studimin e sistemit të shqipes dhe për vendosjen e saj në sistemin e gjuhëve evropiane. Disa prej tyre përqendrohen në regjistrimin e leksikut, të sistemit dhe të studimit të shqipes nëpërmjet fjalorëve dhe këtu kam parasysh përveç Arnold von Harfit, Da Leccen ose Evla Celebiun. Të tjerë mundohen të vërtetojnë shkencërisht prejardhjen e saj, t'i gjejnë asaj një vend në sistemin e gjuhëve evropiane dhe me

këtë fillon edhe periudha e studimit shkencor të shqipes. Këtu jo rrallëherë kemi të bëjmë me atë dukuri që Said e quan strukturë objektive të të dhënave dhe rindërtim subjektiv të tyre. Rasti i Leibnizit është i tillë. Ai në letrën e parë që i dërgon mikut të tij La Croze mendon se gjuha shqipe është një variant i gjuhëve sllave. Në letrën e dytë ai ndërron mendim pasi ka studiuar një tekst të shqipes, por prapseprapë argumentimi i tij është më tepër një opinion i përciptë rreh të dhënave që i ofrohen nga shqipja. Kështu, një nga shkencëtarët më të mëdhenj të kohës së vet bëhet autor i një rikonstruktimi subjektiv të një realiteti gjuhësor. Megjithatë Leibnizi me ndikimin e tij do të bëhej shkas që shumë albanologë gjermanë të mëvonshëm si George von Hahn-, Franc Bopp-i Gustav Majer-i apo Norbert Jokl-i t'i qaseshin me metoda më rigorozisht shkencore shqipes. I pari albanolog që iu përkushtua në mënyrë tërësisht shkencore studimit të shqipes është George von Hahn. Me Hahnin kemi modelin e dijetarit të huaj që do ta eksplorojë botën shqiptare në tërësinë e vet. *Studimet shqiptare* të botuara në vitin 1854 në Vjenë përmbajnë një sasi shumë të madhe dhe të larmishme informacioni për traditat dhe zakonet, mënyrën e jetesës, për psikologjinë dhe karakterin e shqiptarëve, për këngët popullore, gjuhën dhe shkrimin e shqipes. Pavarësisht problemeve që vërehen, me veprën e Hahnit kemi një shkëputje nga vështrimet sporadike dhe të gabuara të autorëve të huaj për shqipen, dhe kalim në fazën e studimeve sistematike dhe shkencore të gjuhës shqipe, të kulturës dhe historisë së shqiptarëve. Vetëm një vit më vonë në vitin 1855, Karol Reinhold-i botoi një vepër të rëndësishme për studimin e shqipes të quajtur *Netë Pellazgjike* gjë që dëshmonte se bota shqiptare po bëhej gjithnjë e më shumë joshëse për mendimin shkencor të evropianëve.

E vërteta shkencore ka një rol shumë të veçantë dhe të rëndësishëm në komunikimin e imazhit të tjetrit. Pavarësisht efekteve të kufizuara pasi, duke kërkuar një marrës shumë të kualifikuar, ajo e ka shumë të vështirë ta gjejë një të tillë, e vërteta shkencore është metoda më efikase e një strategjie komunikimi afatgjatë. E vërteta e saj është gjithnjë aty, si kur duket, edhe kur nuk duket, e gatshme të zhbëjë falsifikimet në momentin e duhur. Pavarësisht se falsifikimeve u vihen në dispozicion shumë mjete dhe shumë mundësi, të vërtetat

shkencore rezistojnë, e përhapin dritën e tyre dhe ndonjëherë bëhen edhe mbizotëruese.

Metodologjia e studimeve shkencore filologjike si një trajtim subjektiv i fakteve objektive, është krejt e ndryshme nga metodologjia e shkrimeve të tjera. Në ndryshim nga tekstet filologjike që janë një studim diakronik minimalisht i ideologjizuar i një vendi, kulture, populli apo historie, tekstet letrare, historike, apo ato të shënimeve të udhëtimit janë një vështrim sinkronik, i sipërfaqshëm shpeshherë i deformuar i një vendi dhe maksimalisht të ideologjizuara të të njëjtave subjekte.

"Imazhologjia, - shkruan studiuesja Nora Moll, është studimi i imazheve, paragjykimeve, klisheve, steriotipeve dhe në përgjithësi i opinioneve për popuj e kultura të tjera që transmetojnë shkrimet e ndryshme duke u nisur nga bindja se këto imazhe siç quhen zakonisht, kanë një rëndësi që shkon përtej rëndësisë që kanë si fakte letrare të thjeshta. Interesi më i madh për studimet imazhologjike buron nga fakti se këto imazhe kanë edhe një vlerë ideologjike dhe politike"[3].

Shqiptarët dhe trevat e banuara prej tyre që herët janë bërë objekt inkursionesh njohëse nga udhëtarët e huaj. Nëpërmjet shënimeve dhe librave të botuara prej tyre ndërtohet pak nga pak imazhi i shqiptarëve jashtë, i cili për shkak të mungesës së shkrimeve në gjuhën shqipe dhe për shkak të mosekzistencës së një elite kulturore vendase mbetet për një kohë të gjatë i vetmi imazh për Shqipërinë dhe shqiptarët. E thënë shkurt, krijohet një imazh së jashtmi nga të huajt dhe për të huajt.

Të huajt vizitorë të Shqipërisë ndahen në tri tipologji për nga marrëdhëniet që krijojnë me realitetin që pështkruajnë. Është pak a shumë e njëjta tipologji që prëcakton Todorov në librin e tij, *Zbulimi i Amerikës*. Kur flet për tipologjinë e raporteve me tjetrin vëren se: "ka tre akse rreth të cilit sillet problematika e raporteve me tjetrin. Në radhë të parë ka një gjykim vlerash: tjetri është i mirë ose i keq, është i njëjtë me mua apo është më inferior se unë. Më pas vjen aksioni i afrimit apo i largimit nga tjetri: unë i pranoj vlerat e tjetrit, identifikohem me të, ose e asmimiloj tjetrin për vete, i imponoj

[3] Nora Moll. Immagini dell'altro. Imagologia e studi interkulturali. Në Introduzione alla letteratura comparata. Mondadori 2000. Faqe 213.

pamjen time. Mes nështrimit ndaj tjetrit dhe nënshtrimit të tjetrit qëndron një mundësi e tretë që është shpërfillja ose ftohtësia ndaj tjetrit. Aksi i tretë ka të bëjë me shkalljen e njohjes që kam unë për tjetrin e këtu kemi të bëjmë me një përshkallëzim të pafundmë të shtresave njohëse më të vogla dhe më të mëdha të tjetrit",[4].

Pjesa më e madhe udhëpërshkruesve shqiptarë i përkasin rastit të parë. Ata paraqiten si përfaqësues të një kulture sipërore dhe si misionarë qytetërimi. Ata shkojnë në vende të tjera, në rastin konkret në Shqipëri për të gjetur të vërtetën por siç thotë po Todorov për të konfirmuar një të vërtetë të njohur më parë ose për shndërrimin e dëshirave të tyre në realitet. Modeli tipik i tillë është François Pouqueville, i cili në të dy librat e tij, por sidomos në librin e tij të dytë *Udhëtimi i Greqisë* vizaton një imazh të shqiptarëve si primitivë. Ata për Pouquvilin janë të shëmtuar, të këqinj, hajdutë, të ndyrë. Për të hajdutëria e shqiptarëve është e vetmja industri kombëtare. "Sifilizi, kanceri, skrofula, neurostenia janë të rralla në Shqipëri dhe fort pak të përhapura. Por natyra u ka dhënë sëmundje të tjera: marrëzia, verbëria, epilepsia"[5]. Të njëtin imazh ka për shqiptarët edhe Ibrahim Manzour i cili pasi kishte qëndruar në oborrin e Ali Pashës nga viti 1816 deri në vitin 1819 boton një libër të titulluar *Kujtimet për Greqinë dhe Shqipërinë gjatë sundimit të Ali Pashës*. Për këtë studiues shqiptarët s'dinë të bëjnë gjë tjetër veçse "të pijnë duhan, të këndojnë këngë duke bërtitur me sa zë kanë, të flenë shtrirë në diell dhe të kërkojnë morrat me të cilët trupi dhe petkat e tyre janë kurdoherë plot"[6].

Një vizatim i tillë i shqiptarëve është pak a shumë i shpeshtë. Edhe pse në shumë raste përshkrime të tilla kanë bazë reale, ato transmetojnë një imazh të gabuar për shqiptarët. Shqiptarët i kanë shumë prej këtyre që thonë të huajt, por e njëjta gjë mund të thuhet për kombet e tjera madje edhe për kombet e qytetëruara evropiane, përfaqësues të të cilëve janë udhëpërshkuesit. Mendoni sikur për të përkufizuar francezët të merrnim parasysh skenat e përshkruara nga Viktor Hygo tek romani i tij *Të mjerët* apo nga Dikensi tek *Oliver*

[4] Tzvetan Todorov. La conquista dell America. Il problema dell'altro. Einaudi, 1992. Faqe 226.

[5] Cituar sipas Lumo Skendos. Në Udhëtarë të huaj në Shqipëri. Pouqueville. Eurorilindja. Tiranë 1999. Faqe 50.

[6] Cituar sipas Lumo Skendos. Në udhëtarë të huaj në Shqipëri. Ibrahim Manzour, 1999. Faqe 104.

Tuisti. Bëhet fjalë për skena të shekullit të 19-të, e pra aty shkruhet për fëmijë që jetojnë në kushtet më çnjerëzore, për njerëz të varfër dhe të pastrehë, për njerëz të pashpirt dhe kriminelë etj. Janë skena që zhvillohen në vendet e zhvilluara shumë vite pas kohës kur shkruan Toqueville apo Henry Holland. Nëse imazhi i këtyre vendeve do të ndërtohej vetëm mbi këtë bazë informacioni, atëherë merret me mend se ç'përfytyrim do të krijohej për këto vende.

Në këto raste bëhet fjalë për raportet e komunkimit që krijohen mes vendasve dhe vizitorëve. Duke e konsideruar Shqipërinë si territor të panjohur ata kanë të njëjtën marrëdhënie që kishte Kolombi me indigjenët e Amerikës. "I vetmi komunikim efikas që ai (Kolombi), arrinte të kishte me indigjenët mbështetej thjesht në njohjen e yjeve si në rastin kur me një gjest të denjë për Tintin, përfitonte nga rasti për të njohur më parë datën e një eklipsi të hënës. I mbetur që prej tetë muajsh në bregdetin xhamaikian, ai nuk po arrinte t'i bindte më indigjenët që ta furnizonin me ushqime. Për këtë i kërcënon ata se do t'u vjedhë hënën, dhe mbrëmjen e 29 shkurtit 1504, fillon ta vejë në zbatim kërcënimin e tij... Suksesi qe i menjëhershëm". [7] dhe më tej: "Kolombi flet për njerëzit që sheh vetë sepse ata janë pjesë e peisazhit".[8] Ai e mbyll përshkrimin e indianëve i çuditur se edhe pse ata rrinë zhveshur, ngjajnë më shumë me njërëzit se me kafshët.

Kemi këtu një rast shembullor se si i ardhuri ka përparësinë e njohjes së sistemit të vlerave që orienton jetën e përditshme të banorit vendës. Kjo njohje i shërben atij për ta vënë në një pozitë të pabarabartë vendësin pasi ai nuk i njeh vlerat e tij. Në këtë rast kemi një përballje të pabarabartë të dy vetjeve ku njëri prej tyre "i ardhuri" pasi e ka njohur një vlerë të tjetrit e përdor atë kundër tij.

[7] Tzvetan Todorov. La conquista dell'Amerika. Il problema dell'laltro. Einaudi. Milano 1992. Faqe 23.

[8] Po aty. Faqe 42.

Robert ELSIE

TË REJA NGA FUSHA E ALBANOLOGJISË

Me gjithë pjesëmarrjen e madhe të albanologëve dhe të shkencëtarëve të nderuar në këtë sallë, mund të themi se albanologjia është dhe mbetet një fushë ku veprojnë pak njerëz dhe ku mbetet jashtëzakonisht shumë për t'u bërë në mënyrë që kultura shqiptare të njihet më mirë në botë. Krahas punës së mirëfilltë shkencore ka shumë dorëshkrime dhe libra që duhen urgjentisht të botohen apo të ribotohen.

Do të doja të shfrytëzoja këto pak minuta për të paraqitur shkurtimisht disa projekte botimore për të cilat kam një interes të veçantë. Pa humbur kohën tuaj, do të filloj me një projekt mjaft konkret, një libër i cili parashikohet të botohet në Londër brenda dy-tre javëve që vijnë. Është fjala për një ribotim anglisht të përshkrimit në formë ditari të udhëtimit të poetit dhe piktorit anglez Eduard Lir (Edward Lear, 1812-1888), që kam marrë përsipër. Aty Lir-i përshkruan udhëtimin e tij të vitit 1848 nga Manastiri deri në Shkodër dhe nga Shkodra deri në Prevezë dhe Arta me shumë vëzhgime të mprehta dhe me një humor të këndshëm. Libri do të pajiset me të gjitha pikturat dhe akuarelat e tij nga Shqipëria. Kuptohet se vëllimi i ri do të mbajë titullin e mirëfilltë të caktuar prej Lir-it: *Edward Lear in Albania*: *Journals of a Landscape Painter in Albania and Illyria* (Eduard Lir në Shqipëri: ditari i një piktori pejzazhist në Shqipëri dhe Iliri) dhe jo titulli i përdorur në disa ribotime të shekullit të njëzet: *Edward Lear in Greece* (Eduard Lir në Greqi). Përkthimi shqip i këtij libri po përgatitet tani nga përkthyesja Majlinda Nishku në Londër.

Një projekt tjetër tepër ambicioz i konceptuar nga kolegu Bejtullah Destani, drejtori i Qendrës për Studime Shqiptare në Londër, është një ribotim i tërësishëm i revistës *Albania* të Faik bej Konicës (1875-1942). Kjo revistë shumë e rëndesishme për kulturën shqiptare, organi kryesor i shtypit shqiptar në fillim të shekullit të njëzet, me rreth 2500 faqe, parashikohet të dalë në tre vëllime, kuptohet nëse gjejmë fondet e duhura.

Vitin tjetër kam ndërmend të ribotoj, bashkë me kolegun Destani, veprën e njohur *Researches in Greece* (Kërkime në Greqi, 1814) të diplomatit anglez Uilliam Martin Lik (William Martin Leake, 1777-1860), e cila trajton në një masë të madhe shqiptarët dhe përfshin jo vetëm një gramatikë të hershme të shqipes, por edhe një fjalor greqisht-anglisht-shqip prej 2000 fjalësh.

Një figurë mjaft e njohur në fushën e albanologjisë është antropologia skoceze Margaret Hasluk (Margaret Hasluck, 1885-1948) e cila nga viti 1935 jetoi për trembëdhjetë vjet në Elbasan. Ajo është autore e disa librave, përfshirë studimin e parë anglisht për Kanunin. Kam në shtëpi një dorëshkrim të saj që do të dëshiroja të botoja. Është fjala për një koleksion të madh përrallash shqiptare të përkthyera prej saj në anglisht, një vepër prej më shumë se 500 faqesh të daktilografuara.

Ndër botimet e Qendrës për Studime Shqiptare në Londër do të dalë së shpejti edhe një vëllim tjetër për Hasluk-un me titullin e bukur: *Our Woman in Albania: the life of Margaret Hasluck, Scholar and Spy* (Gruaja jonë në Shqipëri: jeta e Margaret Hasluk-ut, shkencëtare dhe spiune).

Aubrey Herbert (1880-1923) është një figurë shumë e rëndësishme për Shqipërinë në Angli. Ai ishte vëllai i Lord Carnarvon-it i cili kishte zbuluar thesarin e famshëm të Tutenkhamen-it në Luginën e Mbretërve të Egjiptit në vitin 1923. Si deputet në parlamentin britanik në vitin 1911, Herbert-i luftoi për çështjen shqiptare dhe themeloi Komitetin Shqiptar i cili ka përkrahur çështjen shqiptare në Konferencën e Londrës. Ishte miku i ngushtë i Isa Boletinit. Më vonë ai themeloi dhe bashkë me Edith Durham-in drejtoi Shoqatën Anglo-Shqiptare. Pak njerëz sot dinë se një fshat i Kavajës mori emrin e tij, Herberti, tani Helmasi. Herberti vdiq herët, por la një dorëshkrim me rëndësi albanologjike, ditarin e tij. Shpresoj se do të mund të botojmë edhe këtë ditar mjaft interesant për historinë shqiptare gjatë periudhës së pavarësisë.

Mbase më pak i spikatur është diplomati dhe shkrimtari anglez Vandaleur Robinson (1902-1990), autori i librit të njohur *Albania's Road to Freedom* (Rruga e Shqipërisë drejt lirisë, Londër 1941). Si ushtarak dhe diplomat në Shqipëri në vitet 1945-1946, ai pati mundësi të marrë pjesë si vëzhgues në proceset gjyqësore komuniste gjatë të cileve u dënua ajka e inteligjencës shqiptare. Unë kam veprën e tij anglisht në formë

dorëshkrimi të daktilografuar për këto procese të frikshme politike në vitet e para të pushtetit komunist dhe do të dëshiroja ta botoja.

Dervish Duma (1908-1998) nga Borshi i Himarës erdhi në Angli në vitin 1933. Ai punoi për legatën shqiptare në Londër në kohën e Zogut dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore transmetoi programin shqip të BBC-së. Deri në vdekjen e tij në vitin 1998, Dervish Duma njihej si figurë qendrore e komunitetit shqiptar në Angli. Para një muaji, emri i tij hyri, i pari shqiptar, në botimin prestigjioz *Dictionary of National Biography* (Fjalori i Biografisë Kombëtare) botuar në Oksford. Parashikojmë të botojmë shkrimet e tij në një vëllim me titullin *Letters in Life* (Jetë në letra), ku përfshihet letërkëmbimi i tij ndër të tjera me Mid'hat Frashërin, Edith Durham-in dhe Margaret Hasluk-un.

Ndër vepra të tjera që parashikohen të botohen në Londër nga Qendra e Studimeve Shqiptare janë: korrespondenca e arkeologut të njohur britanik Sir Arthur Evans (1851-1941) e cila lidhet shumë me Shqipërinë dhe Kosovën, artikujt e Elena Gjikës (1828-1882), një histori të Shqipërisë anglisht prej Gjençe Naçit, një histori tjetër të Shqipërisë anglisht prej Tahir Zavalanit (1903-1966) dhe një vepër të panjohur anglisht nga Vaso Pasha (1825-1992).

Gjermanisht duhet të përmendet një vepër tepër interesante e Ekrem bej Vlorës (1885-1964). Ekrem beu, pinjolli i derës së madhe të Vlorajve, njihet si autor i memoareve të bukura *Lebenerinnerungen* (Mynih 1968, 1972), përkthyer shqip me titullin *Kujtime* (Tiranë 2002), dhe së fundi edhe turqisht (Stamboll 2006). I pabotuar mbeti dorëshkrimi i tij i fundit. Është fjala këtu për veprën *Beiträge zur Geschichte der Türkenherrschaft in Albanien: eine historische Skizze* (Kontribut për historinë e sundimit turk në Shqipëri: një skicë historike). Kjo skicë prej 1200 faqesh (!) është në fakt një vepër monumentale e hartuar prej tij dhe baroneshës Marie Amalie von Godin (1882-1956) në Romë në vitin 1956. Libri sapo u daktilografua si version elektronik dhe mbetet për t'u parë nëse mund të botohet gjermanisht, mbase më vonë edhe shqip.

Do të doja të thoshja edhe dy fjalë për fotografinë shqiptare, sepse është një fushë e veçantë e albanologjisë e cila më intereson shumë kohët e fundit. Sapo botova në Prishtinë një album të madh me disa koleksione të fotografive historike të Shqipërisë. Koleksioni më i vjetër është ai i fotografit hungarez Jozef Sekeli (Josef Székely, 1838-1901), i cili shoqëroi babain e albanologjisë Johan Georg fon Han (Johann Georg von

Hahn, 1811-1869) në ekspeditën e tij nëpër viset e Drinit e të Vardarit në vitin 1863. Pesëdhjetë fotografitë e bëra në atë vit prej Sekelit janë nga më të hershmet në Ballkanin Jugperëndimor. Të përfshirë në botimin tim me titullin *Writing in Light / Dritëshkronja* janë edhe koleksionet e albanologut hungarez Baron Franc Nopça (Franz Nopcsa, 1877-1933) dhe të albanologut austriak Maks Lamberc (1882-1963), si dhe shumë fotografi të oficerëve të Misionit Ushtarak Holandez në Shqipëri në vitin 1914.

Një koleksion tjetër të paktën po kaq i bukur është koleksioni i parë fotografik me ngjyra i Shqipërisë dhe Kosovës. Kam ndërmend të botoj këtë koleksion francez gjatë muajve që vijnë. Ai përfshin pamje të mahnitshme të Durrësit, të Tiranës, të Shkodrës, të Prishtinës dhe të Prizrenit në vitin 1913, një kohë vendimtare për historinë shqiptare.

Ekzistojnë edhe koleksione të tjera fotografike që mund të ishin mjaft interesante për botim qoftë si album, qoftë në internet. Ndër ato janë fotografitë e Dervish Dumës, fotografitë e ushtarakut anglez Derëll Ouklli-Hill (Dayrell Oakley-Hill, 1898-1985) të viteve 1930, koleksioni i Margaret Hasluk-ut - rreth 40-50 fotografive të Shqipërisë nga vitet 1930 dhe albumi fotografik i Vandeleur Robinson-it të viteve 1945-1946.

Para një muaj në Londër pata kënaqësi të shihja për herë të parë koleksionin fotografik të Edith Durham-it, pothuajse të panjohur deri tani. Prej saj ka një kuti prej 50 diapozitivësh nga vitet 1903-1914 me titullin *Scutari and the Tribes of Northern Albania* (Shkodra dhe fiset e Shqipërisë së Veriut). Ka edhe rreth 50 fotografi të tjera të Shqiperisë në letër me dimensione të ndryshme, si dhe shumë fotografi të Malit të Zi (1901-1908), të Bosnjes, të Hercegovinës, të Kosovës, të Serbisë dhe të Ohrit.

Pra, këto janë disa ide projektesh, me të cilat shpresoj të frymëzoj edhe albanologët e pranishëm këtu për të vazhduar punën tuaj të rëndësishme në mënyrë që Shqipëria, Kosova dhe shqiptarët në përgjithësi të kuptohen dhe të vlerësohen në mënyrë të duhur kudo në botë.

Hagë, 13 nëntor 2007

Bardhyl DEMIRAJ

NË GJURMË TË "MESHARIT" TË GJON BUZUKUT TË DHËNA PËR NJË NJOHJE TË MËHERSHME TË TIJ

Fallem nddersë t'Arbrit,
ghiacu˜t culluam farëmirit
(Chetta *Tesoro* 1777, § 250)

1. Qerthulli problematik dhe diskutimi përkatës

Eruditi arbëresh atë Nikollë Keta (= P. Nicolò Chetta) që u formua dhe punoi vite të tëra në Seminarin Italo-Arbëresh të Palermos, po ravijëzon ndërkohë gjithnjë e më bindshëm konturat jo vetëm "të njërës prej figurave më të rëndësishme të historisë letrare dhe kulturore italo-arbëreshe në shek. XVIII, por është intelektuali që me veprat e tij ka orientuar dhe nxitur studimet në shekujt e mëvonshëm." Lejohem të huazoj kështu që hyrje të këtij studimi të shkurtër vlerësimin më se të qëlluar të kolegut dhe mikut tim prof. Mateo Mandala (= Matteo Mandalà)[1], i cili mbetet sot për sot biografi më i plotë dhe njohësi më i thelluar i trashëgimisë shkencore dhe letrare të Ketës[2]. Orientues dhe nxitës i këtij shkrimi është gjithsesi një kumtim i çmuar që mundëm ta qëmtojmë gjatë këndimit të thesarit të vyer "Tesoro di Notizie su de' Macedoni" (1777 – dsh.; 2002), të cilin mjeshtri i madh na e ka lënë trashëgim në dorëshkrim, por që gjeti së fundi dritën fatlume të botimit, falë punës ngulmuese të Xhuzepa Fukarino-s (= Giuseppa Fucarino).

Kumtimi në fjalë fshihet në librin e tretë të "Thesarit": "Nella Magnagrecia le colonie degl'albani". Në kreun e katërt të këtij libri, titulluar: "Catalogo delle siciliote famiglie albane", pos hyrjes së

[1] Chetta 2002 (Introduzione di Matteo Mandalà) f. 9: "Nicolò Chetta, nato a Contessa Entellina nel 1742, non è solo una delle figure più importanti della storia letteraria e culturale italo-albanese del XVIII secolo, ma è l'intellettuale che con le sue opere ha orientato e sollecitato le ricerche nei secoli successivi."

[2] Mandalà 2003

thukët (§§ 250-252), autori ynë sython një fjalës onomastik të familjeve arbëreshe që gjëllinin atëbotë në ngulimet e tyre në Sicili. Regjistrimi i këtyre emrave në rendin e zakonshëm alfabetik përvijon gjithsesi vetëm njërin ndër synimet e autorit. Në bashkëvajtje me këtë qëllim, Keta rreket t'i përcjellë lexuesit edhe variante simotra onomastike me shmangie të vogla grafike, që i kish grumbulluar ndërkohë gjatë lëçitjes së burimeve të ndryshme shkrimore, të hershme dhe të vona. Për shumë syresh Keta nuk ngurron të syzojë afëri farefisnore të drejtpërdrejta, të cilat jo rrallë e ndihmojnë të ndërmarrë zbërthimin e strukturës fjalëformuese burimore të njësive onomastike, madje në ndonjë rast ai mëton edhe etimonin e njësive leksikore bazë.

Një qerthull të tillë persiatjesh e përjetojmë më së miri në rubrikën e emrit *Bischitini*[3], ku në përputhje me qëllimin e punimit tonë fitojnë interes të veçantë kryesisht dy momente, të cilat po i përcjellim të përkthyera shqip për të ndërmarrë më pas edhe shqyrtimet përkatëse:

A: "*Bischitini*, të cilin Giovio dhe Dominichini e quajnë thjesht *Boschetmio* dhe *Bischetto*, d.m.th. *Bys-Chetto*, i përbërë prej *Bosa* ose *Bossen* apo *Bosna* [...] që do të ishte *busa,* apo *buza* d.m.th. "buza", nga ku edhe kompozita tjetër *Busecco, Bosichia, Buzuku*, ose të jetë "buzë ujku", thënë ndryshe *Bisulca*. [...]".

B: "Në këtë seminar ruhet një dorëshkrim ritual në gjuhën tonë, i transkriptuar prej origjinalit të [Kongregacionit të Shenjtë të – B.D.]

[3] Teksti i plotë italisht, i transkriptuar sipas tekstit burimor: "*Bischittini,* che il Giovio, ed il Domenichini la nomaron pure Boschetmio, e Bischetto, cioè Bys-Chetto, composto da Bosa, o Bossen, o Bosna, [vedi §§ - B.D.] 7 92 102 104 131 141 170, che sarebbe *busa,* o *buza,* cioè labbro, onde poi l'altro composta *Busecco, Bosichia, Buzucu,* o sia labbro lupo, altrimenti detto *Bisulka.* Così forse da *Bosa,* e *Dara,* ne fu composto il cognome *Bosdario,* e *Bischetmio* è addiettivato. Al pari di Musacchino presso il medesimo Giovio, che col Guicciardini cel encomiò 104 179 188 192 194 198. Vedi Cresìu. Il Cantacuzeno ci nota[8], che Chrale Dusciano contro dell'imperator Andronico Paleologo spedì una mano di Triballi, de' quali eran duci Bozice (gr. …), e Stefano. Il Contarini notò[9], che in Cipri contro di Solimano eravi con Moretto Calabrese e di Candia, Baldissare Boschetto, capitan di Sua Santità con 200 fanti. In questo seminario si conserva un manoscritto rituale di lingua nostra, trascritto dall'originale di propaganda per mons. Zassi, e composto da Donich Buzucu. Il Rodotà per Boschetto di Candia scrisse corrottamente Moschetto. Bishittiini fu capitolante della P. Busicchia della C. Bisulca. (Chetta *Tesoro*, lib. III, kr. IV § 252)

Propagandës prej imzot Zassi-t, dhe i hartuar nga <Donich Buzucu> [...]"

Një lexim sado i shpejtë i copëzave të mësipërme mundëson fillimisht të deduktojmë se ato i bashkëlidh me njëra-tjetrën emri i familjes *Buzuku*, i mirënjohur në analet e kulturës shqiptare dhe të shkencës sonë albanologjike si mbiemri i atij meshtari shqiptar që na la trashëgim librin e parë shqip që njohim deri më sot. Parë nga kjo perspektivë copëzat e përzgjedhura të tekstit fitojnë rëndësi të veçantë, andaj le të ndalemi më hollësisht në secilën syresh.

2. <Buzuku> = *{buzë} + {ujku}

Në copëzën e parë mësojmë se si Keta i përkushtohet përqasjes formale të këtij emri me simotrat e menduara *Busecco* (= |buzekol), *Bosichia* (= |bozikia|) e sidomos *Bisulca* (= |bizulka|). Gjithashtu ai nuk mungon të shestojë këtu as motivin etimologjik, duke syzuar për të gjitha bashkë ndërtimin burimor kompozicional: *{buzë} + {ujku}. Duhet të shtojmë gjithashtu, se ky syzim është për Ketën një argument shtojcë që tumir zbërthimin e strukturës fjalëformuese dhe analizën etimologjike të emrit *Bischitini* (= |biskitinil), i cili – sipas tij – së bashku me simotrat e menduara *Boschetmio* (= |bosketmiol) dhe *Bischetto* (= |bisketol) lejon të zbërthehet në strukturën e përbashkët kompozicionale *Bys-Chetto*, ndërsa vetë gjymtyra e parë *Bys-* përqaset më tej me emrat *Bosa* (= |boza|), *Bossen* (= |bosen|) dhe *Bosna* (= |bosna|), duke u bashkëlidhur më pas kështu të gjithë me njësinë e thjeshtë leksikore *busa* (= |buza|) ose *buza* "(it.) labbro".

Pa dashur të ndalemi gjatë e të shtjellojmë më tej se sa e qëlluar do të mund të jetë përqasja e dy strukturave kompozicionale të mësipërme, lidhur me gjymtyrën e parë {buzë}[4], për rastin tonë mund të pohojmë me të drejtë se vetë zbërthimi i strukturës fjalëformuese dhe interpretimi etimologjik i emrit *Buzuku* e bashkon Ketën me shumicën e filologëve dhe të albanologëve të kohës sonë që mëtojnë

[4] Me këtë fjalë shpjegon Keta në të njëjtin paragraf edhe emra të tjerë, khs.: „*Budeu*, e *Buzeu*, per noi labbro nero […] Il Giovio ci encomiò i cavalieri *Labaro*, *Buseo*, e *Barbatio*. […] *Buzeo* 201 *Busiki* fu capitolante nella Contessa."

gjithashtu formimin zanafillës kompozicional *{buzë}+{ujku}[5]. Gjithsesi Keta meriton tash të radhitet pa kurrfarë hezitimi në vendin e parë sa i përket përsiatjes dhe historikut së kësaj teze.

3. Autori <Donich Buzuku> dhe "Rituali" i tij

Në analet e historisë së albanologjisë emri i familjes *Buzuku* citohet gjithherë si mbiemri i Gjonit, birit të Bdekës[6], si i pari autor i njohur në historinë e librit shqip. A bëhet fjalë në "Thesarin" e Ketës pikërisht për Gjon Buzukun? Një pyetje kjo më se e motivuar, kur përcjellim copëzën e dytë të tekstit, në të cilën Keta ynë përmend emrin e një shkrimtari të quajtur <Donich> që paska shkruar, "në gjuhën tonë", e që bart, ndoshta jo më kot, pikërisht mbiemrin *Buzuku*. Dyshimndjellës mbetet gjithsesi emri krejt i pazakonshëm <Donich>, i cili të kujton më fort një paraqitje të latinizuar të një grafie të mundshme sllave, përkatësisht të një mbiemri sllav (/të sllavizuar)[7]. Një shpjegim të mëtejshëm kërkon gjithashtu edhe kumtimi i Ketës mbi një kopje "dorëshkrimi ritual" që ruhej atëbotë në ambientet e Seminarit Italo-Arbëresh të Palermos.

Sa i përket çështjes së emrit <Donich>, jemi më se të vetëdijshëm që – në pamundësi të verifikimit të kësaj grafie në dorëshkrimin origjinal të "Thesarit" e aq më pak në kopjen e shumëdëshiruar "të dorëshkrimit ritual" – çdo shpjegim, qoftë edhe në ndonjë detaj, vështirë se i kapërcen sot për sot caqet e hipotezës. Duke ecur gjithherë në këtë hulli, mendojmë se Keta duhet të ketë njohur dhe lëçitur atëbotë pikërisht një kopje në dorëshkrim, marrë prej "Mesharit" të Gjon Buzukut. Parë nga kjo perspektivë, grafia "sllave" <Donich> rezulton më fort si shformëzim i grafisë autentike <Donih> që lexojmë në tekstin burimor të "Mesharit", e cila s'është gjë tjetër veçse titulli i meshtarit katolik: *Dom*, ashtu siç na e kumton vetë Gjoni Buzuku që në rreshtin e parë të pasthënies së "Mesharit", khs.:

---

[5] Shih në mënyrë të detajuar Çabej 1968 I 17vv.; SE II 404v. me një bibliografi shteruese të studimeve të deriatëhershme.

[6] Shih ndër të tjerë Çabej *loc. lit.*

[7] I tillë paraqitet p.sh. në shkrimet e kohës edhe mbiemri i Gjon P. Nikollë Kazazit, khs. Johannes B. Niccolouich Casasi. Shih më hollësisht Demiraj 2006 31vv.

<8 Donih ħoni biri hi bdech Buɛuchut>

|U Doni Gjoni, biri i Bdek Buzukut|

Në këtë rast mbetet për t'u verifikuar më tej, nëse shtimi i panevojshëm i shkronjës <c> tek emri <Donich> në "Thesarin" e Ketës, është një lapsus i përftuar ose prej vetë Ketës, ose gjatë transkriptimit të dorëshkrimit të tij, ashtu siç e lexojmë sot në versionin e botuar (Chetta 2002 506). Si opsion i fundit mbetet edhe mundësia e një lapsusi të përftuar në dorëshkrimin burimor, të cilin Keta e paska kaluar dikur në duart e tij.

Argumentin tonë në të mirë të mendimit, që autori ynë <Donich Buzucu> duhet të jetë pikërisht Dom Gjon Buzuku, shkruesi i parë i letrave shqipe, nuk e rëndon aspak emërtimi i tekstit burimor të Buzukut si "Ritual" (= <manoscritto rituale>) prej vetë Ketës. Pa dashur të ndalemi më gjatë në këtë çështje, po përmendim këtu shkurt që shumëkush që njeh sado përciptas historikun e "Mesharit" të Buzukut, ka mësuar ndërkohë se emërtimi i tij si "Meshar" është krejt fiktiv, përkatësisht që ky emërtim përvijon traditën në shkencën tonë filologjike, e cila deri sot njeh Gjon P. Nikollë Kazazin si "zbuluesin" dhe pagëzuesin e librit të Buzukut si "Meshar". Sigurisht që traktati i Buzukut merr në pjesën më të vëllimshme të tij tiparet e një meshari, por në të nuk mungojnë kurrsesi pjesët katekistike e aq me pak ato të ritualit romak[8].

4. Dorëshkrimi i "Ritualit" dhe autori i tij

Përderisa Keta dorëshkrimin shqip që kish kaluar nëpër duar nuk e quan "Meshar" por "Ritual", këtë pohim mund të sjellim fare mirë si

[8] Khs., ndër të tjera, hyrjen e letrës: "Esemplare | di una memoria antichissima albanese che si tro|va nel fine di un antichissimo Messale Albanese | e per l'antichità tutto già stracciato, il quale | si conserva nella Libreria del Ven: Colle|gio della Propaganda in Roma. | È stampato in caratteri come Gotici: con le lettere che | sono proprie dell' idioma Albanese nella | maniera che sono qui espresse | con ogni fedeltà."; më tej "Nell'istesso eran molte altre cose. Tutto ciò che si contiene nel catechismo, nelli | Rituali, le hore, li vespri, sette salmi penitenziali, & con altre cose. Delle quali una | si mette in questione il modo che havevano alhora di fare il matrimonio e di celebrare | avanti il sacerdote." Shih më hollësisht Mandalà 1994; Demiraj 2005 47vv.

argument që do të kundërshtonte një supozim të mundshëm se mos ndoshta edhe në këtë rast kemi të bëjmë me letrën e mirënjohur të Gjon P. Nikollë Kazazit dërguar Gjergj Guxetës (= Giorgio Guzzetta), apostullit të arbëreshëve të Sicilisë në vitin 1743, ku janë kopjuar nga teksti burimor pasthënia dhe rituali i celebrimit të martesës në kishë (Demiraj 2005 47v.). Në këtë kuadër është më se domethënës vetë emri i shkruesit të dorëshkrimit, të cilin Keta e përmend me titullin ipeshkëvor imzot Zasi. Bëhet fjalë pa dyshim këtu për imzot Filoteo Zasin (= monsignor Philoteo Zassi – 20.01.1654 - 24.07.1726), i mirënjohur në analet e historisë së Urdhërit Bazilian: a) më parë – që në nëntor 1668 – si murg në manasitirin bazilian të Munxifit (= Mezzojuso) në Sicili; b) më pas – 1693 - 1715 – në misionin papnor në provincën kishtare të Himarës, fillimisht si misionar i thjeshtë e shoqërues i imzot Nilo Catalano-s dhe më vonë si vikar apostolik i Himarës e arqipeshkëv i Durrësit; c) duke i kaluar vitet e fundit të jetës – 1716 - 1726 – pranë Kolegjit të Shën Vasilit në Romë, pikërisht në kishën e këtij kolegji si zëvendës i Imzot Onofrio Costantini-t[9].

5. Përfundim

Jo vetëm dorëshkrimi në fjalë, por edhe rrethanat e njohjes e të kopjimit të tekstit burimor, i cili duhet të ketë qenë – përse jo! – " Meshari" i Gjon Buzukut, hapin një dritare të re në historinë e librit të parë shqip që njohim deri më sot, meqë parësinë në zbulimin e tij jemi të detyruar t'ia përcjellim tash me nderim klerikut arbëresh imzot Filoteo Zasit, ndërsa vetë kohën e këtij zbulimi duhet ta shtyjmë më thellë, pikërisht në një periudhë, kur Zasi ynë gëzonte në Romë vitet e fundit të jetës së tij. Sigurisht që për këtë dhuratë informative i mbetemi mirënjohës farëmirit Keta, i cili na la trashëgim një "Thesar", që ruan sot e gjithë ditën funksion orientues dhe nxitës në kërkimet e mëtejshme filologjike.

[9] Nilo Borgia (sidomos 1942 38vv.; 45vv.; 63vv.) mbetet sot për sot biografi më i plotë dhe më i thelluar si i imzot Filoteo Zasit, ashtu edhe i imzot Nilo Catalano-s, që njihet në historinë e albanologjisë si autor i një gramatike shqipe si edhe i një fjalori të vëllimshëm shqip – italisht, të cilët për fat të keq konsiderohen ende të humbur.

Bibliografi

Altimari, Francesco

Studi linguistici arbëreshë, nr. 12 i serisë "Radhonjtë e zjarrit" 1988

Bartl, Peter

Zur Topographie und Geschichte der Landschaft Himara in Südalbanien, në: Münchener Zeitschrift für Balkankunde, Bd. 7.-8., München 1991 311-354

Borgia, Nilo

- *La missione dei monaci basiliani d'Italia in Albania*, në: "Roma e l'Oriente" 3 [1913] (5) 97 – 117, 159-166

- *La missione dei monaci basiliani d'Italia in Albania*, në: "Roma e l'Oriente" 3 [1913] (6) 209 – 231

- *Contributo alla storia del rito greco in Italia*, në: "Roma e l'Oriente", 4 [1914] (7) 272-285; 340 – 352

- *I monaci basiliani d'italia in Albania. Appunti di storia missionanaria (Secoli XVI-XVIII). Periodo secondo*, Roma 1942

Chetta, Nicolò (= Nikollë Keta)

Tesoro di Notizie de' Macedoni. (1777 – ms.). *Introduzione di Matteo Mandalà. Trascrizione di Giuseppa Fucarino*; Contessa Entellina 2002

Crispi, Giuseppe (= Sepë Krispi)

- *Memorie storiche di talune costumanze appartenenti alle Colonie Albanesi di Sicilia,* Palermo 1853.

Çabej, Eqrem

- "Meshari" i Gjon Buzukut (1555). Botim kritik; bl. I, Tiranë 1968

- *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, bl. II: A-B, Tiranë 1976

Demiraj, Bardhyl

- *Viti i zbulimit të 'Mesharit' të Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të*, në: "βίβλος" 26 [2005] 47 – 53

- *Zef Skiroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII*; "Studime" 12 [2005] 52 – 67

- *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*; Prishtinë 2006

Mandalà, Matteo (= Mateo Mandala)

- *La lettera inedita (1740) di Mons. Nicola Kazazi a P. Giorgio Guzzetta*, në: "βίβλος" 1994

- *Nicolò Chetta; Nel bicentenario* (1803-2003), Palermo 2003

- *Luca Matranga, E Mbsuame e krështerë (a cura di Matteo Mandalà)*, në serinë: "Albanica", nr. 21, Caltanissetta 2004

Petrotta, Gaetano

- *Studi di storia della letteratura albanese. Popolo lingua e letteratura albanese*, Palermo 1931.

Rrota, P. Justin

- *Monumenti mâ i vjetri i Giûhës Shqype. D. Gjon Buzuku (1555).* Shkodër 1930.

Rodotà, Pompilio

- *Dell'origine, progresso, e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi*, vol. III, Roma 1758

Schirò, Giuseppe

- *Opere* (a cura di Matteo Mandalà), vol.VIII: Saggi; Catanzaro 1997

Schirò, Paolo

- *Më i Vjetëri Shkronjës Shqiptar i Njohur; 1555*, në: "Dielli" Boston, 18 mars 1910, nr. 51, f. 1.

- & Petrotta, Gaetano: *Il più antico testo di Lingua Albanese*, në: "Rivista indo – greco - italica di filologia – lingua – antichità", 16 [1932] 44vv.

Sciambra, Matteo

- *Paolo Maria Parrino, scrittore siculo-albanese*, në: „Shẽjzat (le plejadi)" 11 [1967] (1-4) 134-156, 281-301, 393-434.

- *Wörterbuch des Christentums*, Gütersloh – Düsseldorf 2001

Ali ALIU

POEZIA SI MISION

A ka, përkatësisht a pretendon medoemos mision poezia? Mos vallë edhe e ashtuquajtura poezi e pastër e emërtuar si e tillë që nga fillimet e lirikës moderne evropiane, përkatësisht që lidhet me emrin dhe poezinë e Merimesë, vetvetiu, objektivisht ka të ngarkuar mbi vete një mision, apo mos vallë, në rastet e këtij lloji të lirikës, atë ngarkesë misionarizmi e kërkojmë ne, lexuesit e saj? Nëse funksioni i tillë i poezisë është i pranishëm vetvetiu, cila është çfarësia e tij, e misionit, origjina, natyra, reflektimi? Janë këto e shumë pyetje të tjera që lexuesi, që nga fillimet, ia shtron poezisë lirike, e cila është e pakapshme në shumëllojshmërinë e vet: kufizon që me të emërtuarën lirikë e angazhuar dhe skajin e zënies së saj në gjendje zero angazhim. Brenda kësaj hapësire, laryshia e formave lirike, e artikulimit lirik, siç dihet është e madhe. Përkatësisht kjo shumëllojshmëri prek pragun e lirikës së padeshifrueshme, të mjegullt, deri somnabulike – por me një sistem, të njohur vetëm për të, sistem i artikuluar si lindje misterioze edhe për vetë zërin lirik, vargje çfarë kanë krijuar shumë poetë të mëdhenj – të përmendim Iluminacionet e Rembosë, etj. dhe atë që frymëzohet nga ngjarje të mëdha të epokave, përkatësisht që vihet në funksion të tyre... Dilemat e kësaj natyre lidhur me poezinë lirike, siç thashë janë të lashta, të diskutuara dhe të rrahura sidomos në gjirin e letërsive me tradita të lashta. Në epokën tonë, kur flitet aq shumë për krizën e leximit të poezisë dhe të moskërkimit të saj në treg, shtrohet edhe më dilema: cili krah i lirikës në të vërtetë e siguron më lehtë përjetësinë? E përmenda fare shkurtimisht në fillim të fjalës sime këtë çështje, për të shtruar disa përshtypje dhe dilema lidhur me ndonjë klasifikim të ngjashëm të mundshëm edhe në poezinë lirike shqipe, sidomos në atë të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, pra atë të sotmen...

Duhet përmendur po ashtu se, sidomos kohëve më të fundit, edhe te ne, janë bërë disa sprova për lexim perspektivash të tilla të poezisë lirike, përkatësisht sprova përzgjedhjesh antologjike të lirikës së pastër, të ashtuquajturës puro lirika, të lirikës me zero mision - të

përmendim atë të Gazmend Krasniqit dhe Nehas Sopajt. As njërit as tjetrit të paktën në pjesën dërmuese të vargjeve të përzgjedhura, në mos në tërësi, nuk u ka shkuar përdore të jenë bindës në pretendimet e veta – të ofrojnë poezi që nuk rrezaton kurrfarë misionarizmi...

Në poezinë tonë, edhe të traditës moderne, edhe pos mbizotërimit të hapësirës sonë letrare nga lloji i lirikës së angazhuar, që nga poetët më të mëdhenj, De Rada, Naimi, Serembe, Mjeda etj, kemi edhe poezi lirike të shkarkuar nga angazhimi kolektiv, vargje në frymën e dalldisjeve e trazimeve intime, siç kemi edhe lirikë refleksesh persiatëse, meditative. Është e ditur tani edhe për dijen letrare të shqipes se lloji i dytë dhe i treti i zënë ngoje artistikisht është më i qëndrueshëm. Le të përmendim këtu katër strofat treshe nga kënga 15 e ciklit *Bukuria* e Naim Frashërit që rrezatojnë freski shprehjeje dhe ndjenje, që ofrojnë kënaqësi estetike të rrallë, këngët një, dhjetë, tridhjetë etj. nga Millosao, disa sonete të Serembes, Mjedës, etj... Por gati gjithandej lind dilema: shumica, në mos në tërësi, edhe kjo pjesë e lirikës tonë, s'mund të thuhet se nuk ka një mision, pavarësisht përjashtimit të lexuesit nga vëmendja, nga synimi i poetit në çastin e zënies së vargjeve. Në poezinë refleksive, të lirikës që s'është as patriotike, as shoqërore, as politike, as erotike, përkatësisht që persiat për kategoritë e ekzistencës, për vdekshmërinë, për paqartësinë e fatit, për kuptimin dhe absurdin e jetës, e të tjera, pra kur e përvetëson lexuesin me thellësinë filozofike, me urtinë e të menduarit, ka në të vërtetë apo s'ka mision? Fundja edhe kënaqësia estetike lëviz diç për të mbarë në qenien e lexuesit. Edhe pse fjala është për poezi lirike që u kanë rezistuar vardisjeve kolektive, joshjeve të jashtme, përkatësisht vargje të sfiduara nga emocione intime, nga situata shpirtërore si dhembje, gëzim, mall e pikëllim etj., Por edhe me këtë rast, nuk mund të përjashtohet mundësia që ngarkesa gjatë komunikimit bartet tek lexuesi. Natyrisht çfarësia, rrugët e bartjes, po ashtu janë më të shumta. Do të shohim më pas, duke veçuar këtë dorë poezish lirike nga letërsia bashkëkohore, se edhe nxitjet frymëzuese me prejardhje shqetësimesh kolektive te poetët e mëdhenj shpesh artikulohen si lirikë refleksive. Në natyrën e këtij lloji të poezisë lirike, pra edhe atëherë kur objekti nxitës i frymëzimit, edhe akti i zënies është lehtësisht i fiksueshëm, ai, objekti pra, lënda bruto, e gjendur brenda zonës rreptësisht të pastër të poezisë, në zonën sovrane

të saj, ajo, lënda, margjinalizohet, mbetet hije e padallueshme në periferi, mbetet prani e pavërejtshme, që do të thotë e përtypur, e bluajtur nga substrati estetik... Në këto raste, zëri lirik gjatë kulmit të koncentrimit vë në veprim armët e veta shprehëse, nëse i ka, i vë në funksion mundësitë më të mëdha, më të pashterura të gjuhës, të cilat në fakt i vinë në ndihmë vetvetiu poezisë, pa i kërkuar, se po të ndodhte ndryshe, do të flitej për një funksion mekanik jo kreativ. Ky arsenal gjuhësor ekspresiv që prore është i zgjuar, tek lirika jo e angazhuar, nuk ngarkohet me poentime të afishuara, përkatësisht nëse është natyrë poetike ajo rrezaton vetvetiu si e tillë, si mesazh.

Është kjo pjesë e poezisë lirike e traditës, por edhe në tërësi që, para së gjithash, u ka siguruar, përkatësisht do t'u sigurojë prani të pandërprerë në kohë autorëve të tyre, njësoi siç ka ndodhur me letërsinë përgjithësisht.

Për të shtruar disa dilema lidhur me praninë, përkatësisht mospraninë e misionit në këtë lloj të poezisë lirike, në vazhdim le të përmendim disa nga poezitë e autorëve bashkëkohorë vargje të të cilëve do të marrim në shqyrtim, vargje që duken, tingëllojnë si puro poezi, siç janë *Lirikë me shi* prej Azem Shkrelit, *Vdekja e gjyshes* dhe *Asgjë përtej harabelave*, të Fatos Arapit, *Pikëllimë, Diku në botë, Ç'gurron guri, Një fyel e një yll në një pyll* të Ali Podrimjes, *Dhjata, Vetmia* të Sabri Hamitit, *Lumi i thellë* i Besim Bokshit, *Stinë e akullt* e Eqrem Bashës, etj.

Poezia lirike lë gjurmë të kohës, edhe kur artikulohet duke e përjashtuar unin, duke e heshtur atë, përkatësisht edhe atëherë kur flet zë i paidentifikuar. Meqë poezia flet me fjalë, e gjuha, fjala, është edhe identitet edhe rrënjë etnie, edhe trashëgimi shpirti e folësit, vetë kjo etimologji është po ashtu shenjë në funksion të një misioni.

Poezia *Lirikë me shi* është njëra nga më të bukurat në letërsinë shqipe. Le ta lexojmë njëherë:

Shi, apo sheshit të qiellit shoje shoje
Shushurimë po vjen, mos shtojzavallet
Vesh më vesh po i pështërisin të fshehtat
Shi, apo grurë i verdhë po i rrjedh nga shtjerra
Shoshës së kumtrit përmbi Bjeshkë të Shtedimit

Shi, apo qiellit të shqepur, kah shpendaria
Me kashtë e kashtërrojë po i ngjitet bari
Shi, apo toja uji, lot të teltë mallëngjimi
Shpirtërat na dërgojnë nga lartësi të lashta
Shi, apo i fëshfërijnë diç shqip shqiponjat
Shoqjashoqes në Shkumbin e në Mal të Sharrit
Shi apo fytyrë e frymë na zu me flokë Rozafa
Bimëve në Shkodër po i shëngjergjet shtati
Shi 'asha të madhin, shi e jo thashethëna
Shi, i eqtë, gjol etjesh, lum ai lumë që s'plasi
Çplanju të kaltër, mëkatesh të kaltra, çplanju
Shihni, shpirtrat, shtonat plot po mbushe
Shkruajni të gjorë, simfoninë e shtatë të shiut

Jemi në mes, brenda hapësirës së paanë ujore, brenda, bashkë me një lëvizje gjithësie, me një rrjedhë biblike qiellit shoshë, të cilën sapo e paralajmëruan veshmëvesh shtojzavallet këtë parapërgatitje universi, këtë pritje të njeriut që nga zanafilla, këtë ardhje gjoledet ujore, si qortim përkëdhelës qiellor, si shpëlarje përfundimtare të njeriut, të botës nga mëkatet, nga të ligat... Fillon qetë-qetë, vërshueshëm por jo përmbytës, përmasash nojane por jo shkatërues, por çlirues, pastrues, rrjedh si gurrgurinë podriane, antike, iliriane e njerëzore... Dhe ne s'mund të ngulim këmbë nëse ka ndodhur, ndodh a do të ndodhë dikur një shilarje totale e kozmosit njerëzor, nëse ka parë e s'ka parë syri poetik në realitet një të tillë shi, një rrjedhë gjol përmasash të tilla pos me syrin e brendshëm. Mbase ai, poeti, parandjen një të tillë shi, apo na thërret të prehemi në pamjen e ofruar, ose ta marrin si të duam, si vërshimë ndëshkuese a çliruese, pastruese, si të duam, apo ta parandjejmë, të vëmë vesh e ta dëgjojmë atë rrjedhë në ne, brenda nesh, si na e vërshon cepmëcep botën përreth, si ka vendosur përfundimisht të na pastrojë botën, jashtë dhe brenda. Vërshon gjithandej vrushkuj-vrushkuj dhe ne s'nginjemi së sodituri, së dëgjuari rrjedhën e mëndafshtë, magjindjellëse - vetëpastrimin tonë... Shpërlarjet e mëkateve dhe ligësive, që nga Adami, në këtë lirikë me shi të Shkrelit, hapen si një portë qiellore dritare që u ndodh vetëm poetëve të mëdhenj... Është kozmosi i etnisë vallë ai që e ngacmon dhe na ngacmon, që e nxit këtë vizion pastrues. Është fundi i

shek. 20 kur është shkruar poezia, është ajo nismë historike e përgaditur moteve, shekujve, ajo buçitje e brendshme, ai kuvend e kuvendim i brendshëm engjëjsh e shtojzovallesh, si një gjymim pështpëritës zogjsh e shpendësh, yjesh e zanash e univers... Një pritje, mbase, vizion gjeniu që mbase edhe mund të ndodhë, meqë ne asnjëherë s'pushojmë së prituri një shpëlarje, një pastrim total të njerëzimit, pastrim nga mëkatet adamiane që nga fillimi dhe gjatë shekujve, pritje për një pastrim të madh....

Asnjëherë s'mjaftohemi së rilexuari dhe së rishtruari pyetje të pafundme: ç'botë alternative është kjo që ofron poezia *Lirikë me shi?* Është bota jonë përreth, apo e ëndërruara, biblike, mitologjike? është ky shi sa yshtës e ungjillor sa i rreptë, që rrjedh madhërisht, qiellor sa paralajmërues dhe kërcënues, përmbytshëm dhe pastrues...? Varet, mbase, e ka të qartë poeti, nëse do të ndodhë njëra apo tjetra, nga vetë njeriu, njerëzimi. Dhuratë a ndëshkim gjithsesi do të sjellë ky shi, kjo rrjedhë qiejsh e papërsëritshme. Vetëm një kryepoezi, si kjo arrin t'i bëjë bashkë – shi që vjen rrëmbyeshëm e qetë njëherësh, që të përmbytë dhe të pastrojë – të na nxjerrë të pastër, ta pastrojë universin njerëzor...

Është po ajo pritje si rrjedha mermer antik, ilirik në poezinë "Ç' gurron guri" e Ali Podrimjes, përkatësisht si rritja e lumit të Besim Bokshit për një kthesë madhore, olimpike, për një katarakt pastrues, shpëtimtar që, po ashtu s'do të ndodhë:

Ç'gurron guri në gurinë
Gur guri ndër gurë më i gurti

Gur i gurëzuar pranë gurit
Gurth i gurruar rreth gurit

Gurron guri në gurë gurësh
Guro guroje gurin në gurinë

Ç'gur pranë gurit gur guri
Vrimë e parë e fyellit tim

Shfaqet në horizont një pamje madhështore, para së cilës mrekullohet poeti në klithje "Ç'gurron guri"! Në hapësirën pafund buron, rrjedh kristalisht gjallëruesëm guri, e shtron, e stolis atë bardhësi sovrane, gurron lashtësi antike, zanafillëse, e ku secili gur më i gurtë e pranepranë... Pamje që i hapet si alef borhesian poetit... Kjo rrjedhë është ajo që e ushqen muzën e poetit... Natyrisht që frymëzimi i Podrimjes lidhet me lashtësinë e etnisë, me pastërtinë dhe kreninë e saj, por tetë vargjet e poezisë në fjalë mund të lexohen – mbase ajo do ketë nëpër kohë dhe hapësirë lexues të tillë, pra edhe si një ëndërr njerëzore, universale, për një rrjedhë bardhësi kristalore, që shpëlan brenda dhe jashtë botën, gjithësinë, për një bardhësi virgjëre, për një vërvitje në përsosmëri majash sizifiane, ëndërr të cilën nuk do të pushojë së ëndërruari njeriu...

Kur, këtu e gjysmë shekulli të shkuar, kur u shkrua poezia Lumi i thellë, e ngjizur edhe ajo, si shumë poezi tjera të kohës në Kosovë, nga ëndrra shekullore e etnisë për një kthesë të madhe historike, për realizimin e ëndrrës shekullore të rilindësve, ëndrra e Lumit tonë, e lumit në qenien tonë për një katarakt, lexohej nga kjo perspektivë misionare, meqë përfytyrimi ynë për lumin si fenomen natyre zhduket vrikthi pas vargut të tretë...

Rrëshqet ngadal drejt detit të pafund
Me gurgullimë të mbytur
Si zë i shterur i mortjes.

- Është lutje e moçme për një katarakt-
- Pëshpërisin të trandura fushat pranë.

Lart, në majat e veta,
Yjtë qeshin e luhaten.

Kam provuar ta lexoj me studentët e sotëm, që kohën kosovare të para gjysmë shekulli e përjetojnë si histori të largët dhe, kryesisht e komentonin – lumin pra, si një metaforë që lidhet po ashtu me ëndrrën shekullore të botës për një kthesë, për një kthesë të madhe që do të linte pas atë rrjedhë gjysmë të sëmurë të botës, atë ankim e përgjërim ëndërror të gjithësisë, që do të linte pas atë qesëndisje dhe cinike perëndish me ëndrrat

e pashuara të njeriut... Lumi metaforë e rrjedhës kohë-jetë e njeriut, përkatësisht bartëse e ëndrrës së tij për kthesën e madhe, për lexuesin e ardhshëm me siguri do të përjetohet si një pritje e madhe e njerëzimit, si një mrekulli që mund të ndodhë vetëm brenda vizionit lirik të poezisë...

Në një poezi nga më të bukurat të Fatos Arapit dhe të poezisë shqipe, me ngjyrim refleksiv melankolik, pa poentim dhe adresim referencial, thjesht një rrëqethje e brendshme, e padukshme dhe e pazëshme e shpirtit, vjen gjithnjë me një model të vetin mbi botën njerëzore:

ASGJE PERTEJ ARABELAVE

Mos kërko asgjë përtej arabelave të janarit.
As unë nuk e di përse kujtesa ime
vjen e ndalon përherë aty. Më tutje – asgjë.
Nëpër këmbë ndizen
ciatjet diellore, pikëpyetjet
e sqepave qëmtojnë farëza, pikëla kohe.
Ushqehet uria guximtare e rrugës.
Mos kërko asgjë përtej tufave të arabelave,
ndalu këtu me mua mbi këto rrënjë,
gjurmëza zogu që lëvrijnë e mpleksen
mbi ngricën e bortë të qytetit të murmë.
Hutimi guximtar i jetës së zogut.
Ti do të largohesh prej këndej,
E në sytë e tu janë përherë ata,
Shpupuritja e një guximi të trishtë,
Ankime zërash të dridhshëm
Të shpirtit të muzgut, që tani shkrumbon qiellin.
Mos kërko asgjë përtej – ose më mirë –
që ti të kalosh mbi vdekjet e egra të tua,
të duhen zogjtë e janarit,
që tani ushqehen me plagën e hapur,
dashurinë tënde të arabeltë.

Shpupuritin e shkundin sqepat e përgjakur
në trishtimet e tua.

Një zhgënjim i madh i zërit lirik jehon nga thellësitë e kësaj poezie, njërës ndër më lucidet dhe më të thellat në poezinë shqipe. Janë bërë grimca tretëse ëndrrat e tij për ta parë mbarë qytetin (botën, njerëzimin): e kotë ka qenë, e kotë është të kërkosh më shumë dhe përtej arabelave të janarit (të shushatur urie dhe acari të janartë), shkrep një jehonë rezignimi nga thellësia e qenies së poetit. Çdo gjë përreth s'është pos një guxim shpupuritës tufash, arabelash – asgjë më shumë. Asgjë pos hutim zogjsh nga acari dhe uria – një guxim shpupuritës i trishtë... Dhe ata – që është trishtimi më dhimbës, të gatshëm të shpupurisin edhe mbi dashurinë tënde të arabeltë...Një metaforë e përkryer për shpupuritjen njerëzore moteve mbi botëglobin tonë? Një model gjithsesi individual, origjinal i universit njerëzor, mbase pa fare insistimi, hyn në qenien e pranuesit të tekstit lirik. Prandaj sikur pajtohemi me atë pandemë se nuk ka tekst letrar që të mos jetë në funksion të një misioni...

Në mos sugjerim a sugjestion, qoftë edhe më të tërthortë, më të heshtur të mundshëm, teksti lirik, jashta pleksevje të dhe me realitetin konkret, të paktën në vete ndrydh e ofron në të njëjtën kohë një tjetër model të botës njerëzore, të vetin dhe origjinal. Oferta e një modeli intim, lirik që ai e reflekton vetvetiu, do të thotë prani e një misioni, drejt një vetëdijësimi mbi pozitën, mbi gjasat e pranuesit të tekstit përballë modelit që i hapet përpara, të cilin e refuzon a përqafon si alternativë të botës që e rrethon. Pse vetë modeli që qëndron i qerthuar në vete, pa iu imponuar askujt, megjithatë reflekton vullnetin e tekstit lirik drejt një modeli të caktuar...

Dashuria, bie fjala, në tekstin lirik të Azem Shkrelit (Natë në kështjellë, Në vend të përshëndetjes...) që reflekton emocion e kënaqësi estetike, e ndrydh, e vë në heshtje të paktën vetjakmërinë, banalitetet e përditshmërisë, smirën, urrejtjen; ngjashëm edhe me lirikën intime-refleksive, persiatëse që, nga ana e vet, pa e zënë ngoje, pa e shqiptuar, ta përkujton përkohshmërinë në jetë, përkatësisht, tërthorazi ta përkujton, ta ofron modelin e botës më njerëzore – të qenit më njerëzor. Fundja vetë artikulimi i bukurisë së objektit te teksti lirik përjetohet si ndjenjë që vetvetiu funksionon në të mirë të fisnikërimit të shpirtit...

Teksti lirik, brenda pleksjes së reflekseve emocionale, intelektuale, në vetvete kodifikon urti e kuptimësi të botës së

koncentruar dhe kondensuar në vizionin subjektiv – të zërit lirik që bartet tek marrësi. Bota a fiksioni kështu, në tekstin lirik, fundja edhe ndërdijshëm zgjon botën e pranuesit që për një çast të paktën shkoqet nga përditshmëria që e rrethon, vendoset brenda një modeli të ofruar, të cilin mbase të fjetur e ka patur brenda vetes. Vargjet e poetëve të mëdhenj, botët e tilla i përjetësojnë si pamje, si modele, si vizione të papërsëritshme në asnjë formë tjetër shprehëse. Pa hetuar, lexuesi shkëputet, përkatësisht shkrihet brenda një bote që s'është as e përditshmja, as e ëndërruara; ka përballë një botë që i ofron hapje vizionesh pafund, vizione urtishë duke u luhatur dehshëm i bindur se prek të fshehta, mistere, mrekulli, mite. E çliruar nga diktati i jashtëm, lirika, e zënë dhe lindur si zë i vet, jashta zhurmës përreth, përkatësisht e hapur ndaj universit, përjetësisë, ajo e çliron edhe marrësin nga prangat e përditshme... Shkurt, mund të supozohet se çdo vepër letrare, edhe lirika e pastërt pra, për nga vetë natyra është e angazhuar. Fjalën e kemi për lirikë që e lehtësuar nga bara e ngarkuar si detyrë shtëpie, si obligim familjar, për poezi që në krahët e veta rrezaton vetëm shkëndijime intime, thellësisht të veta dhe që vetëm si të tilla mund të duken modele të një bote tjetër njerëzore...

Në një poezi të shkurtër, të këtij lloji (Një fyell e një yll në një pyll), Ali Podrimja sjell këto vargje:

Në Pyll
'i fy'll

në fy'll
'i yll

ç'yll zot
volli 'i Pyll

kalli 'i fy'll

Është poezi e veçantë edhe për natyrën krijuese të Podrimjes. Me siguri që edhe ajo ofron një model. Cili mund të jetë ai? Në horizont shfaqet një fyell, një yll dhe një pyll... Dhe është zëri lirik që ndriçon, që shquan dhe magjepset nga zëri i fyellit, është ylli

udhërrëfyes qiellor-tokësor, i afërt i largët, i prekshëm i paprekshëm, shpëtimtarin e mosërfillësin, të gjitha brenda universit pyll, brenda gjithësisë... Ja pra Podrimja si e përjeton për një çast botën, - somnabulshëm, "cungueshëm", por përmes një sistemi kristalisht të qartë nga brenda...

Pjesërisht, në mos tërësisht cikli *Vetmia, Dhjata, Moshat* të Sabri Hamitit mund të radhiten në këtë sërë tekstesh lirike:

Tjetërsimi

Ku di unë tash si ke hyrë në mua
Nëpërmjet shirave të përvajshme të nëntorit
Mbas udhëtimeve të gjata sa brenga
E mjerimeve të luleve të ditëlindjes njëzet
Mbas mikut të arratisur mbas dashurisë
Vërshimeve të fundit që shkundën shpirtin
Tërmeteve që prishën drejtpeshimin
Ndërmjet harrimit e mëkatit të parë
Nëpër korridoret e vetmisë së verdhë si pritja
E verdhësisë së gjetheve të fundit në vjeshtë
Nëpërmjet vetjeve përrallave dhe librave
Vdekjeve të hershme të gjakut të shprishur
Ndërmjet valëve të shkumës së kuqe të diellit
Shkrumës së malit qeshjes së liqenit
Apo nëpërmjet harrimit të mëkatit
Ku di unë si ke hyrë në mua
Në vallen e gjakimit në fund të vetes
Ha veten si mollën e parëvjeme zbres
Shpaloj palët ngadalë pluhurin shkund
Nga vetja e mjerë nga vetja e harruar
S'kam nga të ik pa fjalë ha veten
Dhe dhëmbin e drojës pagjumësisë
Jam dru i thatë ku prehen stuhitë
Dru që nuk gjethon shtatë vera një vjeshtë
Gur i rreshkun vetëm që s'e prek vala
Pa prekje se lëngu avullohet ngadalë
Fjalët s'i ndjej janë humbur kuptimet

Thëniet e moçme porositë e harruara
Telat s'punojnë kanë grevë urie
Dru i tharë gur i paprekur nga vala
E ti si ke hyrë në mua nuk e diel
Nëpër vjetët që na ndrydhin shtrydhin
E rrugët e shtruara me therra
Përmes shkrimeve e leximeve të mitura
Apo si zemërimi krenar si sëmundja
Me këngën për vdekjen e hershme
S'po mund të gjej pos ta ha veten
Dhe sëmundjen e shpirtit të shëndoshë
Asnjë pikë lëngu as fjalë as letër e bardhë
Kurrkund adresat e udhëtimeve përqafimeve
Vetëm dru i thatë gur që s'e prek vala
Pa asnjë kuptim për shqetësim zemërim
Ku di unë si ke hyrë në mua

Është koha (jonë...), janë motet që ta ndrydhin e shtrydhin shpirtin, që s'të lënë as fjalë as letër të bardhë,- thatësi shpirti. Dru i thatë e gur që s'e prek uji, pa kuptim, pa aftësi për t'u shqetësuar, për t'u zemëruar... Rrugët përmes së cilave paskësh depërtuar kjo thatësi, kjo shtrydhje shpirti (nuk) i di zëri lirik, duke supozuar shumë nga ato...Përkatësisht përmes pyetjeve retorike kërkohen rrugët e avullimit të lëngshmërisë së shpirtit...Nga paskësh hyrë aq tinëzisht, dinakërisht, mbase nga të gjitha anët e ditës, të motit...Dhe të mos harrojmë: zëri lirik që alarmon me kaq ulërimë tjetërsimin, të vetin, tonin, i ka të zgjuar sendorët shpirtërorë që i vë përpara si kështjellë mbrojtëse...

Ç'botë model mbase gjakon zëri lirik, ç'model ndjell dhe cilit i vë përpara mekanizmin mbrojtës?

Jani THOMAI

LEKSIKOLOGJIA SHQIPE – ARRITJE DHE PROBLEME

Është e pamundur që brenda kufijve të një kumtese të japim e të vlerësojmë gjithë arritjet e gjithë problemet e leksikologjisë shqipe që nga fillimet e saj e deri sot, prandaj na mbetet të parashtrojmë këtu në mënyrë të përgjithësuar vetëm disa nga arritjet themelore në këtë fushë studimi dhe pastaj disa nga problemet më të mëdha që presin të lëvrohen në përmasat e në cilësinë shkencore të kohës. Jemi të bindur që lexuesit tanë të interesuar i njohin tashmë studimet kryesore leksikologjike shqiptare; ndërkaq, një pjesë të zgjedhur prej tyre do ta gjejnë të cituar në fundfaqet e kësaj kumtese.

Në krye do të theksojmë që leksikologjia shqipe si fushë më vete studimi ka filluar të lëvrohet e të kristalizohet relativisht vonë te ne, jo vetëm krahasuar me gjuhësinë europiane, por edhe me degët e tjera të gjuhësisë shqiptare. Nuk mund të flasim për një cak themelimi a për një themelues të vetëm të saj, por mund të themi se periudha e Rilindjes Kombëtare, kur në rrafsh të gjerë dhe në mënyrë të ndjeshme e të vetëdijshme u lëvrua gjuha shqipe, është periudha e parë kur u lëvrua nga mjeshtrit e letërsisë e të gazetarisë edhe leksiku i shqipes me vlerat e tij shënuese e shprehëse, u pastrua e u pasurua ai me fjalë shqipe nga ligjërimet popullore dhe me krijime të reja në përputhje me natyrën e shqipes.

Karakteristikë e parë e rrugës së formimit të leksikologjisë shqipe si shkencë, d.m.th. në rrafsh teorik, ka qenë fillimi *me elemente të veçuara* e plotësimi më tej shkallë-shkallë i dijeve nëpërmjet studimeve të nënsistemeve të tjera të gjuhës, si etimologjia, gramatika, dialektologjia, formimi i fjalëve, leksikografia e stilistika gjuhësore. Të dhënat e tërthorta leksikologjike të këtyre fushave u plotësuan më pas me studime të drejtpërdrejta për kategori, klasa e aspekte të mirëfillta leksikologjike, që çuan në krijimin e një sistemi të mjaftueshëm e të organizuar konceptesh e dijesh shkencore në këtë fushë. Ky sistem është tregues e motivues për shkallën e kristalizimit të shkencës së leksikologjisë shqipe. Po përmendim këtu ndër të tjera

disa nga konceptet themelore të leksikologjisë si shkencë[1], si koncepti për fjalën si njësi leksikore, koncepti për vlerat e veçoritë e saj në gjuhën shqipe, për kuptimin leksikor, për lëvizjet kuptimore, për elementet e kuptimit dhe për tipologjinë semantike në gjuhën shqipe, për leksikun, paradigmat leksikore e shtresat e leksikut, për njësinë frazeologjike si barasvlerëse e fjalës etj. Rreth këtyre sot kemi një bibliografi të gjerë studimesh[2], të lidhura ngushtë me lëndën leksikore të shqipes, përveç bibliografisë së pasur leksikografike prej më shumë se 500 titujsh[3], që vijon të pasurohet pa ndërprerje me vepra leksikografike më të plota e shkencërisht më cilësore.

Si karakteristikë të dytë të rrugës së formimit të leksikologjisë shqipe mund të përmendim fillimin e studimeve *nga forma* e njësive leksikore dhe nga *klasifikimi* formal i tyre. Kështu, në studimet për formimin e fjalëve u vështrua klasifikimi strukturor (fjalë të thjeshta, të prejardhura, të përbëra e të përngjitura); në studimet për leksikun dialektor e krahinor u klasifikuan fjalët sipas shtresave leksikore (dialektore, krahinore; të botës bimore, shtazore, shoqërore, etnokulturore, shpirtërore etj.); në studimet për fjalët si pjesë ligjërate u vështrua klasifikimi leksiko-gramatikor (paradigmat emërore, mbiemërore, foljore, ndajfoljore…), klasifikimi semantiko-strukturor (paradigmat sipas ndajshtesave të specializuara dhe sipas kuptimeve leksikore kategoriale, si: emra me kuptimin abstrakt të *veprimit,* me prapashtesat *–im* dhe *-je;* emra që shënojnë *vepruesin,* me prapashtesat *–(ë)s / -ues, -ar / -tar, -or / -tor…;* emra që shënojnë *vendin* sipas bimës që rritet aty a sipas sendit që prodhohet, me prapashtesat *–ishte, -ore…;* emra që shënojnë *banorin* sipas vendbanimit, me prapashtesat *–an, -as, -ak, -at, -or, -ian…* etj.)[4].

---

[1] Një pasqyrë të shkurtër të sistemit konceptor të leksikologjisë shqipe e kemi dhënë te *"Leksikologjia e gjuhës shqipe",* Tiranë, 2006, f. 349-351.

[2] Shih P.Daka, *"Bibliografi e gjuhësisë shqipe"* (nga fillimi deri më 1984), Tiranë, 1985; po ai, *"Bibliografi e gjuhësisë shqipe",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1985-1989, numrat 4; *"Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe",* Tiranë, I (496 faqe), II (400 faqe) 1972; III (843 faqe) 1989; J. Thomai, *"Leksikologjia…",* f. 353-361 etj.

[3] *"Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë",* Tiranë, 2005, 371 faqe; për bibliografinë e fjalorëve shih aty P. Haxhillazi - A. Goga – F. Zeqo, *"Bibliografi e leksikografisë shqipe"* (1635-2004), f. 328-371.

[4] Shih A. Xhuvani – E. Çabej, *"Parashtesat e gjuhës shqipe",* në "Buletin i shkencave shoqërore", Tiranë, 1956, 4; po ata, *"Prapashtesat e gjuhës shqipe",*

Le të përmendim një karakteristikë të tretë të rrugës së formimit të leksikologjisë shqipe: studimet në këtë fushë kanë nisur e kanë vijuar për një kohë të gjatë të lidhura kryesisht me *kërkesat e praktikës gjuhësore,* të shkollës, të leksikografisë (të hartimit të fjalorëve) etj. Mund të themi që leksikografia, *hartimi i fjalorëve* të shqipes a me shqipen, ka pasur synime kryesisht praktike, por gjithsesi ka qenë shtysë e fortë për analiza leksikologjike. Arritjet e problemet në fushën e leksikografisë shqipe u trajtuan gjerë në konferencën e përbashkët, që organizuam në Tiranë në dhjetor 2004, punimet e së cilës janë përmbledhur e janë botuar tashmë[5]. Duke i kapërcyer këtu ato të dhëna, do të kujtojmë vetëm që në vetë fjalorët, më shumë në fjalorët shpjegues kombëtarë[6], janë mishëruar në mënyrë të brendshme, implicite, elemente të teorisë leksikologjike e leksikografike, vetë zgjidhjet leksikografike mbështeten në koncepte të rëndësishme të leksikologjisë si shkencë, si: në konceptin për fjalën si njësia themelore e leksikut dhe si strukturë e mbyllur, në konceptin për kuptimin leksikor si njësia themelore e për strukturën kuptimore të

Tiranë, 1962; *"Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe. Morfologjia II",* Tiranë, 1976; A. Kostallari, *"Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe",* në "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore", Tiranë, 1961, 3; po ai, *"Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese",* në "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore", Tiranë, 1962, 3; I; A. Dhrimo, *"Formimi i mbiemrave në gjuhën shqipe",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1972, 3; E. Hysa, *"Formime me prapashtesa në shqipen e sotme letrare",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1970, 1; po ai, *"Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe",* në "Studime filologjike", 1973, 3; J. Thomai, *"Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe",* Tiranë, 2004, 243 faqe; L. Buxheli, *"Formimi i foljeve në shqipen e sotme"* (në shtyp); studime të tjera për formimin e fjalëve në gjuhën shqipe nga A. Xhuvani, K. Cipo, I. Ajeti, J. Kole etj., te *"Studime mbi leksikun …",* I, II, III etj.

[5] "*Leksikografia…",* 371 faqe; Xh. Lloshi*, "Formimi i emrave përmbledhës nga tema të shumësit",* në "Sudime filologjike", Tiranë, 1976, 2; shih edhe M. Samara, *"Hulumtime në leksikografi",* Tiranë, 2000, 305 faqe.

[6] *"Fjalor i gjuhës shqipe",* Tiranë, 1954, me rreth 25 000 fjalë; *"Fjalor i gjuhës së sotme shqipe",* Tiranë, 1980, me rreth 41 000 fjalë; *"Fjalor i shqipes së sotme",* Tiranë, 1984 (i ripunuar dhe i ribotuar më 2002), me rreth 34 000 fjalë; *"Fjalor i gjuhës shqipe",* Tiranë, 2006, me rreth 48 000 fjalë; shih edhe A. Kostallari, *"Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme",* në "Buletin i shkencave shoqërore", Tiranë, 1955, 4 dhe po ai, *"Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1968, 2.

fjalës si njësia më e madhe e semantikës, në konceptin për shtresën leksikore si paradigmë strukturalisht e plotë dhe e veçueshme (e identifikueshme), në konceptin për valencat leksiko-semantike si "mjedisi" a "rrethi" gjuhësor ku sendërtohen vlerat e funksionet e fjalëve, në konceptin për shkallëzimin (për gradacionin) semantik (si: barasvlerësia ose afria / sinonimia, kundërvënia / antonimia, ndryshmëria / homonimia[7] dhe, në rend me to, lëvizjet kuptimore e polisemantizmi si kategori qendrore të semantikës, që kanë çuar në zgjerimin e vëllimit të strukturës kuptimore pothuajse të të gjithë leksikut të shqipes me njësi semantike shumë herë më shumë se vetë fondi i fjalëve[8]) e në shumë koncepte të tjera thelbësore. Po të ndjekim këtë hulli, na lejohet të mbërrijmë te pohimi se elementet më të para të leksikologjisë shqipe si shkencë, sido që fare fillestare, i kemi që te *"Fjalori latinisht-shqip"* i Frang Bardhit[9].

Edhe pse studimet leksikologjike në hapat e parë kanë qenë *të kufizuara, të pjesshme e për dukuri të thjeshta,* ato vunë gurin e

[7] Shih ndër të tjerë Sh. Islamaj, *"Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe",* Prishtinë, 1985; po ajo, *"Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1964, 4; M. Samara, *"Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe",* Tiranë, 1985; I. Goci, *"Antonimet në gjuhën shqipe",* Prishtinë,1985; Xh. Lloshi, *"Vëzhgime mbi homoniminë në gjuhën shqipe",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1964, 2; A. Dhrimo - E. Tupe - E. Ymeri,*"Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe",* Tiranë, 2002, 609 faqe; J. Thomai – M. Samara – H. Shehu – Th. Feka, *"Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe",* Tiranë, 2004, 1084 faqe; M. Samara, *"Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe",* Shkup, 1998, 418 faqe; J. Thomai, *"Leksikologjia…"* etj.

[8] E. Çabej, *"Studime etimologjike në fushë të shqipes",* Tiranë, I 1982, II 1976, III 1987, IV 1996, V (në shtyp), VI 2002, VII 2006; A. Kostallari, *"Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes",* në "Konferenca e parë e studimeve albanologjike", Tiranë, 1965; po ai, *"Kompozitat dëshirore e urdhërore të shqipes",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1968, 4; J. Thomai, *"Mbi mënyrën e pasqyrimit të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1964, 4; po ai, *"Rreth semantikës së foljeve veprore, pësore e vetvetore në gjuhën shqipe",* në "Gjuha jonë", Tiranë, 1984, 3; po ai, *"Rreth vlerave të fjalëve në gjuhën shqipe",* në "Gjuha jonë", Tiranë, 1989, 2; po ai, *"Prejardhja semantike në gjuhën shqipe",* Tiranë, 1989; po ai, *"Rreth përmbajtjes leksikore të fjalëve në gjuhën sahqipe",* në "Lëndët shoqërore në shkollë", Tiranë, 1989; po ai, *"Për një tipologji leksiko-semantike në ligjërimin naimian",* në "Naim Frashëri dhe kultura shqiptare", Prishtinë, 2001; V. Memisha, *"Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe",* Gjirokastër, 1999 etj.

[9] F. Bardhi, *"Dictionarium latino-epiroticum",* Roma., 1635.

themelit në ndërtesën e leksikologjisë shqipe, që u ngrit më tej duke u mbushur me njohuri të reja më të plota e më shkencore, duke zgjeruar këndin e vështrimit për fjalët e gjuhës shqipe, duke thelluar analizën e duke zbatuar parime teorike më të qëndrueshme, të provuara e të pranuara për gjuhë të tjera indoeuropiane, por të përshtatshme e të pranueshme edhe për shqipen. Le të themi që formimin e leksikologjisë shqipe si fushë studimi e ka karakterizuar *modeli "i mozaikut",* për të mbërritur deri te gjurmimet e studimet leksiko-semantike të organizuara institucionalisht dhe me gjini shkencore më të larta, të hapëta, monografike. Ky zhvillim shpreh qartë vendosjen e dijeve në këtë fushë sipas një përvijimi sistemor, çka është tipar i domosdoshëm për një shkencë të kristalizuar tashmë. Ky sistem u plotësua me vëllimin e nevojshëm të dijeve dhe, një zhvillim shumë i qenësishëm, u strukturua sipas degëzimeve të natyrshme e sipas shkallëzimit strukturoro-semantik të lëndës shqipe që trajton: *fjala* / formimi i fjalëve - *kuptimi* leksikor / ndërtimi / zhvillimi / tipologjia – *ngyrimet* / emocionuese / shprehëse / stilistike / të përdorimit[10] – *leksiku* / përbërja / shtresimi – *frazeologjia* / formimi / klasifikimi – *leksikografia* / fjalorët njëgjuhësh e dygjuhësh etj. Kryesisht gjatë dy-tre dhjetëvjeçarëve të fundit studime të veçanta u bënë për "trekëndëshin" *leksiku krahinor – leksiku terminologjik – leksiku i standardit.* Në studimet për leksikun krahinor janë diferencuar kategoritë *"dialektizëm"* e *"krahinorizëm",* janë nxjerrë në dritë pasuritë e vlerat e këtij leksiku dhe fushat e përdorimit etj.[11] Edhe

[10] Veçanërisht me studimet e Xh. Lloshit: *"Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika",* Tiranë, 2001, 360 faqe; po ai, *"Mbi studimin e veçorive stilistike të shqipes",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1970, 1; po ai *"Gjuha, stili dhe redaktimi në shtyp",* Tiranë, 1977; po ai, *"Vështrim stilistik për mjetet e shprehjes në gjuhën shqipe",* në "Gjuha jonë", Tiranë, 1981; po ai, *"Zhvillimi i leksikut politiko-shoqërornë gjuhën shqipe pas Çlirimit",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1979, 4; J. Thomai, *"Teksti dhe gjuha",* Tiranë, 1991, 200 faqe; po ai, *"Tipare të gjuhës së shtypit në kohën tonë",* në "Studime filologjike", Tiranë, 194, 4; po ai, *"Çështje të leksikut potencial në gjuhën shqipe",* në "Gjuha jonë", 1986, 2; Sh. Islamaj, *"Gjuha e Jakov Xoxes",* Prishtinë, 1995; po ajo, *"Gjuha e harruar: veçori leksiko-semantike dhe stilistike",* Prishtinë, 2000; po ajo, *"Gjuha, ligjërimi dhe fjala",* Prishtinë, 2004; N. Sotiri, *"Fjalor i gjuhës së Ismail Kadaresë",* Tiranë, 2007 etj.

[11] Shih botimin serial *"Dialektologjia shqiptare"*, Tiranë, I 1971, II 1974, III 1975, IV 1982, V 2005; J. Thomai, *"Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme",* Tiranë, 2001, 323 faqe.

leksikut terminologjik, përveç numrit të madh të fjalorëve terminologjikë shumëgjuhësh[12], i janë kushtuar studime të veçanta në rrafsh përgjithësues[13] dhe për klasa të ndryshme, si për leksikun e detarisë, të gjuhësisë, të ushtrisë etj.[14]

Një shtysë e veçantë për zhvillim ka qenë *kërkesa e shkollës së lartë* për ngritjen e një lënde të leksikologjisë shqipe sipas programeve të profilit filologjik. Siç dihet, në universitetet shqiptare në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoni leksikologjia shqipe jepet si lëndë e veçantë, kur në universitete të disa vendeve të tjera kjo lëndë nuk është në programet mësimore. Fillimet e veta kjo lëndë i ka që në vitin 1959 në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Natyrisht, ka edhe rrugë të tjera që njohuritë leksikologjike, të shpërndara e pjesë-pjesë, t'u përcillen studentëve e nxënësve të shkollave të mesme e të përgjithshme, por përvoja jonë ka treguar se bashkimi i këtyre njohurive, të organizuara në një lëndë mësimore më vete[15], sipas kërkesave të një sistemi të vetëm shkencor, ka dhënë fryte të mira. Përballë kësaj lënde studimet leksikologjike kanë fituar një përbërëse të rëndësishme: karakterin praktik e konkret, lidhur ngushtë me lëndën leksikore të shqipes dhe me funksionimin e saj në të gjitha format e ligjërimit gjuhësor, veçanërisht në standard.

---

[12] Shih *"Leksikografia shqipe…",* f. 329-371.

[13] Shih, p.sh., A. Duro, *"Terminologjia si sistem",* Tiranë, 2001, 147 faqe dhe *"Termi dhe fjala",* Tiranë, 2007 (në shtyp), në të cilat zbatohen metodat konceptologjike të Shkollës Terminologjike të Vjenës, veçanërisht analizat konceptologjike në veprën e E. Vüsterit.

[14] L. Dodbiba, *"Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e tij të pahuazuara",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1967, 1; po ai, *"Leksiku detar i shqipes dhe etnogjeneza e popullit tonë",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1972, 4; po ai, *"Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore nga Rilindja e deri sot",* në "Konferenca e parë e studimeve albanologjike", Tiranë, 1965; F. Leka, *"Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko-shkencore pas Çlirimit",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1970, 1; R. Ushaku, *"Një kontribut për studimin e leksikut detar të shqipes",* në "Studime mbi leksikun…", III; E. Lafe, *"Terminologjia e matematikës dhe e mekanikës teorike",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1965, 2; H. Pasho, *"Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe",* Tiranë, 2005; H. Çipuri, *"Zhvillimi i terminologjisë ushtarake pas Çlirimit",* në "Studime filologjike", Tiranë, 1984, 4; M. Samara, *"Rret leksikut politiko-shoqëror në gjuhën shqipe",* Tiranë, 2007 (në shtyp) etj.

[15] Pas disa botimesh që nga vitet '60 të shekullit të kaluar e deri sot, është tash në qarkullim *"Leksikologjia e gjuhës shqipe",* Tiranë, 2006, tekst i ripunuar e i përditësuar me arritjet në këtë fushë deri në vitin 2004, 364 faqe.

Nga fundi i shekullit XX edhe në leksikologjinë shqipe, sikundër në fushat e tjera të gjuhësisë shqiptare, u hodh një hap i madh cilësor, ndryshoi "qendra e rëndesës": pas studimit të leksikut, mund të themi kënaqshëm, në rrafshin horizontal, në formën e shprehjes, nisën studimet në boshtin vertikal, në përmbajtjen a në semantikën leksikore. Ky hap në gjuhësinë europiane ishte hedhur i plotë e i sigurt që nga fundi i gjysmës së parë të atij shekulli. Me këtë hap cilësor në leksikologjinë shqipe nuk ndryshoi vetëm objekti i studimit, por, ç'është më e rëndësishme, ndryshoi, në fillim me disa elemente e më tej tërësisht, metodologjia shkencore e studimit, burimi i informacionit shkencor dhe vështrimi objektiv i lëndës në analizë. Studimi i semantikës leksikore që, siç dihet, është një fushë abstrakte dhe e vështirë, u pastrua nga gjurmët e interpretimeve ideologjike, u pasurua me mendimin shkencor të kohës dhe me arritjet e semasiologjisë botërore, u bë më objektiv e i pavarur. Një pjesë e mirë e mendimit semasiologjik erdhi nëpërmjet studimeve historiko-etimologjike[16], për formimin e fjalëve[17] dhe për kategori të tjera të gjuhës shqipe. Veçanërisht studimet historiko-etimologjike të E. Çabejt kanë sjellë një pasurim të madh të mendimit semasiologjik shqiptar, nëpërmjet gjurmimit të zhvillimeve semantike të fjalëve gjatë shekujve si një nga rrugët kryesore për të shkuar hallkë pas hallke në thellësi të kohës deri te primitivi i fjalëve. Ndërkaq tregues i qartë i drejtimit të studimeve kah semantika leksikore është ndërmarrja e hartimit të artikujve shkencorë dhe të monografive kushtuar posaçërisht kësaj fushe. Këto studime përpunuan teorikisht edhe konceptet themelore të semantikës leksikore, ligjësitë e ndryshimeve dhe vaçantitë e zhvillimit, metodologjinë shkencore të analizave semasiologjike dhe më tej përshkruan dukuritë specifike të shqipes për kuptimin leksikor, për strukturën kuptimore të fjalës dhe për strukturimin e kuptimit leksikor, për lëvizjet në semantikë dhe prejardhjen e kuptimeve, për tipologjinë e zhvillimeve kuptimore, për elementet semantike të mbishtresuara dhe për shumë çështje të tjera[18]. Sot studimet semasiologjike, të kushtëzuara edhe nga kërkesat për hartimin e fjalorëve shpjegues

[16] Shih E. Çabej, *"Studime etimologjike…"*.

[17] Shih studimet e K. Cipos, A. Xhuvanit, A. Kostallarit, E. Hysës etj. në "Studime mbi leksikun…", I-III.

[18] Një përmbledhje e këtyre çështjeve, në rrafsh teorik të përgjithshëm e në rrafshin e gjuhës shqipe, bëhet te monografia *"Prejardhja semantike…"*.

kombëtarë të gjuhës shqipe[19], janë zgjeruar shumë, mund të themi se kanë zënë vend qendror në studimet tona leksikologjike, duke thelluar edhe analizën e duke zbuluar gjithnjë e më mirë përmbajten leksikore të gjuhës shqipe, këtë pasuri gjuhësore të pafund e shumëvlerëshe. Studime për semantikën e klasave të veçanta leksikore (p.sh. për emërtimet e njerëzve sipas tipareve fizike e morale, për emërtimet e kafshëve sipas ngjyrës etj.[20]) plotësojnë pasqyrën e përgjithshme të semantikës leksikore të shqipes së sotme. Është përvetësuar tashmë parimi se fjala lind a krijohet për përmbajtjen e vet dhe funksionon në ligjërim në radhë të parë me përmbajtjen e vet. Kështu, krahas shtimit të radhëve të leksikologëve, po shtohen edhe radhët e semasiologëve shqiptarë. Me shumë fryt ka qenë zbatimi specifik në fushën e shqipes i metodave tashmë të sprovuara për gjuhët e tjera, si analiza semasiologjike komponenciale, teoria e fushave konceptore, leksikore e semantike, parimi i gërshetimit të kuptimit leksikor me kuptimin gramatikor (kuptimi sintaksor i fjalës) dhe me përbërësit semantikë të mbishtresuar (shprehës, emocionues, stilistikë[21]) etj. Zbatimi i këtyre metodave të analizës semasiologjike në fushën e shqipes dha mundësi që të zbuloheshin vlerat e brendshme të fjalëve, vlera semantike e shprehëse, lehtësoi zbërthimin e përmbajtjes leksikore të fjalëve në kuptime të dallueshme e ndërtimin e strukturës kuptimore dhe më tej përimtimin e çdo kuptimi veças deri te njësia më e vogël semantike, e pazbërthyeshme. Në këtë mënyrë analiza depërtoi në thellësi të

[19] Hartimi i një fjalori shpjegues si punë kryesore njeh ndërtimin e makrostrukturës (zgjedhja e fjalëve që do të përfshijë) dhe të mikrostrukturës (paragrafi leksikografik për çdo fjalë). Në mikrostrukturë zbërthimi kuptimor, ndërtimi i strukturës kuptimore të çdo fjale dhe shpjegimi i kuptimeve përbëjnë "përmbushjen e qëllimit të fjalorit" dhe njëherazi procesin më të vështirë të hartimit. I gjithë ky proces përshkohet nga parime, kritere, analiza e sinteza semasiologjike. Kur flitet për tipologji leksikografike, mbahet parasysh edhe shkalla, gjerësia e thellësia e pasqyrimit në fjalor të përmbajtjes leksikore të fjalëve; f.v. *"Fjalori i gjuhës së sotme shqipe"* (1980) është i tipit të mesëm nga makrostruktura (nga numri e lloji i fjalëve që përmban), por e kapërcen tipin e mesëm nga shkalla e analizave semasiologjike dhe nga gjerësia e strukturave kuptimore: për 41 000 fjalë përmban mbi 180 000 kuptime leksikore – vetëm folja BIE_I ka 44 kuptime, - përveç nuancave kuptimore e kuptimeve të lidhura frazeologjike (shih për këtë edhe A. Kostallari*, "Parimet themelore…"; "Leksikografia…"* etj.).

[20] Monografi të tilla, të hartuara nga I. Metani, V. Memisha etj., janë në proces botimi.

[21] Për këtë të fundit shih Xh. Lloshi, *"Stilistika…"*.

përmbajtjes dhe e bëri më objektiv e më shkencor ndërtimin e strukturës kuptimore të çdo fjale, arritje e rëndësishme kjo veçanërisht për hartimin e fjalorëve shpjegues, por edhe për zotërimin sa më të plotë të semantikës leksikore të gjuhës sonë dhe shfrytëzimin e kësaj pasurie të madhe gjuhësore në ligjërimin e gjallë. Duke e vlerësuar si më të rëndësishmen këtë fushë të re studimi, mund të renditim krahas saj edhe fusha të tjera të reja studimi që u lëvruan në kufijtë e leksikologjisë shqipe, si frazologjia gjuhësore, e konceptuar për herë të parë si klasë njësish shënuese e shprehëse të barasvlershme me fjalën në kuptimin kategorial dhe në vlerat ose aftësitë funksionale. Në studimet për këtë pasuri të madhe të gjuhës sonë u ngulit koncepti për frazeologjinë gjuhësore dhe për njësinë frazeologjike, për kufijtë, vlerat, tipet dhe veçoritë e përdorimit etj.[22] Këto studime dhe mbledhja sistematike e lëndës mundësuan hartimin për herë të parë të një fjalori frazeologjik shpjegues të gjuhës shqipe me rreth 12 000 njësi, me shpjegime e me shembuj[23].

Por leksikologjia shqipe te ne ka pasur edhe kufizimet e veta, disa nga rrjedhojat e të cilave ndihen edhe sot. Sido që me objekt studimi larg ideologjisë e politikës së ditës nga natyra e vet, deri në vitet ’90 të shekullit të kaluar, për shkak të rrethanave politiko-shoqërore të kohës, leksikologjia shqipe te ne nuk ka mundur të ecë me hapin e studimeve leksikologjike bashkëkohore, të përfitonte më shumë prej tyre, sidomos në metodë, kurse në rrafsh të përgjithshëm kombëtar nuk arriti të kompaktësohet e të bashkërendohet me arritjet e të gjitha mjediseve shkencore të botës shqiptare jashtë Republikës së Shqipërisë. “Copëzimi” i studimeve leksikologjike sipas copëzimit politik të trojeve shqiptare ka sjellë dallime në vëllimin e objektit të studimeve, në metodologjinë shkencore të zbatuar dhe rrjedhimisht në prurjet shkencore. Ky pohim nuk synon kurrsesi të mohojë arritjet e çmuara të studimeve leksikologjike shqiptare, por të theksojë se në rrethana të tjera, veçanërisht në kushte të një komunikimi e të një shkëmbimi të lirë të ideve, edhe para viteve ’90 të shekullit të kaluar prodhimi shkencor në këtë fushë do të ishte më i madh e më cilësor.

[22] Ndër të tjera shih J. Thomai, “*Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe”,* Tiranë, 1981.

[23] J. Thomai, *“Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe”,* Tiranë, 1999 (1166) faqe, me një hyrje teorike prej 60 faqesh, ku formulohen konceptet themelore për frazeologjinë gjuhësore dhe parimet e hartimit të fjalorit.

Një shembull mund ta sjellim nga leksikografia: regjistrimi i sistemit leksikor e semantik nuk ka qenë i njëjtë në të gjitha trevat e gjuhës shqipe, kartoteka të leksikut të shqipes nuk ka pasur në të gjitha qendrat shqiptare të kërkimit shkencor, rrjedhimisht ishte krijuar një rrethanë penguese për pasqyrimin përpjesëtimor të shtresave leksikore krahinore në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, rrethanë penguese që është kapërcyer disi me përpjekje për të mbushur zbrazëtitë nëpërmjet vjeljes leksikore të botimeve (letërsi artistike, gazeta, fjalorë krahinorë[24] e shqip – gjuhë e huaj etj.) dhe me organizimin e disa ekspeditave leksikologjike të përbashkëta në të folmet verilindore (në Kosovë) dhe në disa fshatra arbëreshe të Italisë. Kjo ka përmirësuar përpjesëtimin ndërmjet shtresave leksikore të ligjërimit të folur popullor e të gjuhës së shkruar, ka sjellë një zgjerim të ndjeshëm të fondit të fjalëve dhe të përmbajtjes leksikore në *"Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* (1980) dhe në fjalorët shpjegues pas tij, që e kanë përfshirë sipas kriteresh shkencore leksikografike, pa asnjë paragjykim krahinor e aq më pak politik[25].

[24] Është arritje e rëndësishme në leksikografi, por që sjell të dhëna me shumë vlera edhe në leksikologji, hartimi e botimi i disa fjalorëve krahinorë, që nga N. Gazulli, *"Fjalorth i ri",* Tiranë, 1941; P. Tase, *"Fjalorth i ri",* Tiranë, 1941; E. Giordano, *"Fjalor i arbëreshvet t'Italisë",* Bari, 1963 (dhe Castrovillari, 2000); G. Rohlfs, *"Fjalor i ri dialektor i Kalabrisë",* Ravenë, 1977; A. Zymberi, *"Fjalor i fjalëve të rralla",* Prishtinë, 1979; po ai, *"Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve të Malit të Zi",* Prishtinë, 1996; J. Nushi, *"Fjalë popullore nga Myzeqeja",* Tiranë, 1991; M. Elezi, *"Fjalor i gjuhës shqipe",* Tiranë, 2007 e shumë të tjerë (shih *"Leksikografia…",* f. 329-371).

[25] H. Shehu ka vërtetuar me krahasim numrash se në *"Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* (1980), veç fondit të përbashkët, kombëtar, ndërdialektor të fjalëve, në pjesën tjetër të karakterizuar si të burimit dialektor a krahinor zotërojnë fjalët nga të folmet e dialektit të Veriut (shih për këtë artikullin "*Gjuha shqipe, sa e madhe është",* në "Korrieri", Tiranë, 5 prill 2005, f. 19 dhe 6 prill, f. 19, në të cilin shkruan: "Kam lexuar se ka kritika që nga të folmet e Veriut janë përfshirë më pak fjalë e shprehje… Përkundrazi, nga të folmet e Veriut janë marrë më shumë, madje, jo vetëm fjalë e shprehje të caktuara, por edhe klasë a grupe fjalësh… Ndoshta është vendi të thuhet që nuk ka arsye të politizohet problemi, të veçohet Veriu. Fjalori ka nevojë edhe për Veriun, edhe për Jugun. Problemi është shkencor… Çështja është të kuptohet nocioni "fjalë dialektore" e "fjalë krahinore"…); ndërkaq, D. Luka, që ka hartuar një fjalor të veprave të Gj. Fishtës, ka vërejtur (sipas një informacioni gojor) se mbi 80% e leksikut të tij gjendet në *"Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"*. Dhe ky fjalor nuk është as fjalor dialektor e as fjalor autori.

Kufizim të vështrimit plotësisht shkencor në leksikologjinë shqipe krijonte po ashtu orientimi, si pothuaj në gjithë gjuhësinë te ne, kryesisht nga literatura lindore e sidomos ruse, e cila ndikoi në sistemin konceptor dhe në metodologji me metodat e veta tradicionale. Nuk mund të themi se në këtë kohë kanë munguar krejt burimet nga gjuhësia perëndimore. Nuk duhet mohuar gjithashtu që, në fillimet e veta (në vitet "50-'60 të shekullit të kaluar), leksikologjia shqipe përfitoi shumë nga arritjet e studimeve leksikologjike në vendet e lindjes, mund të thuhet madje se në vijat kryesore ndoqi të njëjtën rrugë zhvillimi, porse më tej ajo nuk përfitoi sa duhej, ballazi dhe hapur, nga arritjet e studimeve leksikologjike në vendet perëndimore e në Amerikë, nga përvetësimi e zbatimi i metodave moderne, bashkëkohore, që krijuan sisteme të reja konceptore dhe ndryshuan në shumë pika vështrimin e problemeve të mirëfillta leksikologjike, deri edhe të koncepteve më themelore, si njësia bazë e sistemit leksikor (njësi semantike apo funksionale: fjala – monema), njësia më e vogël e semantikës leksikore (komponenti a tipari i kuptimit, sema, noema etj.), skemat e derivacionit semantik sipas shkollave të ndryshme semantike (komponenciale, distribucionale, semike, e tipareve të ngushtuara etj.) dhe të koncepteve të tjera, të cilat kanë hyrë tashmë në analizat gjuhësore dhe në studimet tona leksiko-semantike[26].

Është e kuptueshme që leksikologjia shqipe te ne deri në vitet "90 të shekullit të kaluar nuk përfitoi gjithashtu sa duhet nga mundësitë që jepte informatika për studimin e leksikut, nga teknika e nga programimet kompjuterike, që mund të shërbenin veçanërisht në leksikografi. Mund të themi që edhe sot jemi prapa përgjithësisht në këtë fushë. Si shembull po e hedhim vështrimin mbi një objekt të punës leksikologjiko-leksikografike:

Themelimi i kartotekës së leksikut të shqipes më 1955 dhe pasurimi i saj i pandërprerë përbën pa dyshim një arritje madhore të gjuhësisë shqiptare. Ajo ka qenë baza më objektive për hartimin e fjalorëve e për studime të tjera gjuhësore në fushë të shqipes dhe një thesar që ruan vlera të pallogaritshme shkencore. Por, siç është thënë edhe në raste të tjera[27], detyrë e ngutshme dhe e domosdoshme e

[26] Shih edhe te J. Thomai, *"Leksikologjia…"*

[27] Po përmend Sh. Islamajt *"Për një leksikografi bashkëkohore",* në *"Leksikografia…",* f. 26-33; J. Thomai,*"Probleme të leksikografisë shqipe:*

gjuhësisë shqiptare është krijimi i një kartoteke elektronike kombëtare të leksikut të shqipe, që të përfshijë kartotekën ekzistuese të leksikut të shqipes pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, kartotekat e lëndën leksikore të mbledhur në Kosovë (Prishtinë), Maqedoni (Tetovë) dhe Itali (Kozencë), si dhe të pasurohet me anën e skanimit të fjalorëve kryesorë të shqipes (sidomos krahinorë), të veprave të autorëve që shquhen për leksik e frazeologji të pasur etj. Me këtë rast po shtojmë që mbledhja e fjalëve shqipe nga ligjërimet popullore, botimi i tyre në fjalorë krahinorë e në rubrika të posaçme të revistave shkencore dhe pasurimi i kartotekës së leksikut të shqipes kanë qenë e mbeten detyra parësore në kërkimet leksikologjiko-leksikografike. Kartoteka elektronike që kërkojmë të ngrihet do të ketë shumë vlera:

a) Do të përfshijë plotësisht e në sistem leksikun, semantikën leksikore, leksematikën dhe frazeologjinë e shqipes në tërësi, të shkruar e të folur, nga të gjitha trevat ku flitet e shkruhet gjuha shqipe dhe nga të gjitha ligjërimet, stilet e të folmet e grupeve të ndryshme sociale, pra do të jetë vërtet kombëtare.

b) Kjo kartotekë do të mundë të vihet me lehtësi në shërbim të të gjithëve, veëanërisht të leksikografëve e të studiuesve të leksikut, të semantikës e të frazeologjisë shqipe, por edhe të gramatikanëve, të historianëve të gjuhës, të etimologëve, të studiuesve të stilistikës gjuhësore etj.

c) Një kartotekë e tillë jo vetëm do ta ruajë pasurinë e madhe leksikore, semantike e frazeologjike të shqipes nga humbja, por edhe do të krijojë bazën për hartimin e një fjalori të madh a "thesaurus" të shqipes, si edhe të një fjalori elektronik; një kartotekë e tillë lehtëson shumë jo vetëm sendërtimin e veprave madhore, që janë në pragun e punëve tona (si fjalori i madh i gjuhës shqipe), por edhe ndërmarrjen e kryerjen e studimeve të hapëta, komplekse e të mbështetura mirë në vështrimin leksikologjik; ajo do të jetë burim lënde e pikë referimi edhe për studime të tjera gjuhësore (historike, etimologjike, fjalëformuese, gramatikore, stilistike etj.).

Fjalori i madh i gjuhës shqipe", kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore të Seminarit I albanologjik të Tetovës, Ohër, 21 shtator 2007.

ç) Në formatin elektronik kartoteka i ka të hapura "rubinetat" për të gjitha rrjedhat e lëndës së re leksiko-semantike e frazeologjike që vijnë të hyjnë në të dhe e pasurojnë pa ndërprerje.

d) Me të gjitha këto vlera kartoteka elektronike do të jetë edhe shprehje e integrimit shkencor të gjuhësisë shqiptare dhe të veprimtarisë së gjuhëtarëve shqiptarë, aq i domosdoshëm për të gjithë ne.

Floresha DADO

STUDIMI I LETËRSISË SOT: PROBLEM TEORIK APO SUBJEKTIVIZËM SPONTAN?

A është studimi i letërsisë sot në krizë? Një pyetje provokuese që, në dëgjim të parë, do të dukej pa vend. Sepse kushdo prej nesh e di që çlirimi i shkencës letrare, në 15 vitet e fundit, nga skematizmi i konceptimit të saj, liria e krijimit dhe kontaktet, e munguara më parë, me studime bashkohore, kanë ndryshuar dukshëm pikëvështrimin dhe interpretimin e letërsisë. Megjithatë, sipas mendimit tim, pikërisht ky realitet i ri i studimeve të sotme, është në krizë. Pse?

Sepse në sfondin e studimeve të kësaj periudhe mund të konstatojmë disa dukuri:

1. Fusha më tërheqëse për studiuesit, sidomos ata më të rinjtë, bëhet **vetëm** analiza semiotike e tekstit, dukuritë narratologjike, vështrimet stilistikore e metrike. Sigurisht kjo është një prirje e vlefshme dhe e re në kritikën tonë letrare, e cila vjen si një vështrim i domosdoshëm, në sfondin e poetikave moderne, të patrajtuara më parë. Por, e parë si qëllim në vetvete ajo mbetet thjesht prirje individuale, jashtë lidhjes me dukuritë thelbësore të zhvillimit të letërsisë sonë, në periudhën ku bën pjesë vepra e analizuar.

2. Autorët më tërheqës janë bërë **vetëm disa**, si Fishta, Koliqi, Konica, Trebeshina. Sigurisht kjo dukuri përfaqëson një tendencë të natyrshme për interpretimin e autorëve të tillë, pak ose aspak të trajtuar nga shkenca letrare e gjysmës së dytë të shekullit të shkuar. Por, në të vërtetë, kritikët apo studiuesit që merren me të njëjtit autorë janë jo një e dy, por disa.

3. Kompensimi i mostrajtimit të këtyre autorëve, dhe të tjerëve, nga pozicione **ekstremisht vlerësuese**. Kompleksi i detyrimit shkencor ndaj tyre përkthehet tashmë në interpretime, ku ndjehet madje një garë në shkallën e mbivlerësimit të njërit e tjetrit.

4. Kjo ka sjellë **copëzimin e studimit të procesit të plotë** të zhvillimit të letërsisë sonë, duke lënë mënjanë, jashtë riinterpretimit shkencor vepra dhe autorë, të cilët vërtet u bënë objekt i studimeve të

mëparshme, por ecën gjithnjë të dhunuar në mënyrën skematike të vështrimit. Cili është problemi më i madh: ta lësh pa interpretuar një autor, apo ta dhunosh veprën dhe individualitetin e tij artistik?

5. Ka edhe botime, ku, pas një terminologjie "bashkohore", nganjëherë tepër të sofistikuar, vijnë amalgamë pohimesh sporadike, të stilit telegrafik, me **pasaktësi konceptesh e terminologji teorike-letrare**. Sa interesante duken në titujt e tyre, aq konfuzë në synimet shkencore. E vetmja ide e qartë është mohimi i realizmit socialist, por, edhe kjo bëhet nga pozita po aq ideore siç bënte edhe shkenca marksiste, që e mbështeste atë.

Në këtë sfond tepër të përgjithshëm, shkenca letrare ndodhet sot, sipas mendimit tim, para disa sfidave:

SFIDA E PARË: Si duhet konceptuar **raporti midis shkencës sonë letrare dhe kritikës bashkohore**? Dhe më konkretisht: si është raporti i analizës së tekstit, si kritika më e parapëlqyer sot, me specifikat e zhvillimit të mbarë letërsisë shqiptare? Nëse flasim sot për studim të ri të letërsisë, kjo lidhet me një ndjenjë të re orientimi dhe qëllimi. Si është marrëdhënia midis *sensit historik të kritikut* dhe *sensit kritik të historianit* të letërsisë? Në këtë vështrim mendoj se vjen në plan të parë shtrimi i çeshtjes: a synon analiza e strukturës së një teksti të zbulojë thjesht dhe vetëm specifikat individuale, apo kjo strukturë duhet parë në një gjenezë më të thellë, në historinë e evolucionit të poetikave letrare?. "Kritika, shkruante Mukarovski, e sheh veprën si një strukturë e fiksuar dhe e realizuar, si një konfiguracion i qëndrueshëm, kurse historiani duhet ta shohë strukturën poetike në lëvizje konstante…" 1). Dukurinë e parë e hasim në formën më të realizuar në analizat tekstore të K.Shalës 2) dhe Dh.Shehrit 3), dy ndër përfaqësuesit më të kualifikuar sot të kritikës semiotike. Ndërsa prirjen për të shkuar drejt funksionit të historianit, i cili prej vitesh ka mbi vete edhe përvojën e kritikut letrar, e gjejmë te studimet e fundit të S.Hamitit, ku hidhen teza shkencore, kritere të reja të karakterizimit të zhvillimit të letërsisë shqiptare. Autori shkruan "kërkesa është të diskutohen ligjshmëri të përgjithshme, që më në fund japin karakteristikat apo identitetin e një letërsie nacionale."4) I prirur të zgjerojë përfytyrimin mbi kuptimin e letërsisë sonë, ai vjen në konkluzionin se vepra nuk mund të jetë një strukturë e

mjaftueshme…dhe kështu hap shtegun për një shtjellim më të gjerë të mjaft çeshtjeve të historisë së letërsisë sonë.

Pra, ndonëse në këtë 10-vjeçar u realizuan interpretime të reja mbi vepra dhe autorë, ato janë shprehje e spontanitetit individual të një kritike të re. Larg përgjegjësisë së shkencës letrare akademike, realiteti i sotëm dëshmon se kjo shkencë është sot në krizën e mosorientimit të shpejtë për nevojën e ndërthurjes së këtyre studimeve spontane, individuale, me problematikën e gjerë që ka hartimi i një studimi madhor mbi specifikat e zhvillimit historik të letërsisë shqiptare.

SFIDA E DYTË: Ekziston brenda vetë studimeve letrare, në raportet e saj me Teorinë e letërsisë. Kjo është dëshmuar, disa herë, në keqinterpretimet, në debatet thellësisht subjektive mbi autorë apo dukuri letrare. Nëse rezultatet e kritikës bashkohore duken më tërheqëse dhe subjektivizmi i tyre mund të pranohet si shprehje e interpretimit individual, teoria e ngushton studiuesin drejt saktësisë dhe objektivitetit. Nëse kritiku prodhon një interpretim, si shprehje e një prej kuptimeve të mundshme që gjenden brenda tekstit (Bart), teoria e orienton shkencën drejt problematikave më të rëndësishme që janë detyrë e saj. Kuptimi teorik i gjenezës së një vepre, qoftë kjo e traditës apo bashkohore, marrëdhëniet midis fenomeneve letrare e joletrare, nga njëra anë; qasjet formale ndaj strukturave dhe funksioneve artistike, tipologjia e formacioneve stilore etj., nga ana tjetër, përbëjnë dy planet themelore, të cilat duhen rivendosur, më në fund, në **ekuilibër shkencor** në studimet e sotme. Nëse historiografia e mëparshme, për vetë thelbin e metodologjisë së saj, mbeti në nivele sipërfaqësore të trajtimit të fenomenit letrar, studimet sot ndodhen para sfidash më të thella dhe thelbësore. Sfida themelore ka të bëjë me vlerësimin e strukturave dhe funksioneve artistike, jo thjesht të një vepre, por të gjithë zhvillimit të letërsisë shqiptare, në proceset e brendshme dhe të jashtme të saj. P.sh., nëse do flitet për evolucionin e letërsisë sonë në vitet e fundit, është në radhë të parë vështrimi teorik që orienton të hetohet ky zhvillim në dy drejtime themelore: 1. Në procesin e formimit dhe stabilizimit të një dominanteje letrare (moderniste, postmoderniste, apo..?), dhe 2. në hetimin e ripërtëritjes, zëvendësimit të normave të vjetra me të reja, etj. Dhe është e

rëndësishme të pranojmë se sfida e vërtetë e studimeve të sotme lidhet me njohjen e faktit se çdo teori letrare është në pozicion kundërshtues me teoritë e tjera, çka përcaktohet nga vetë zhvillimi i letërsisë. Kjo vlen për gjithë fazat e zhvillimit të letërsisë sonë.

SFIDA E TRETË: Qëndrimi i shkencës së sotme mbi çeshtjen: a ndryshon sistemi i vlerave? Problemi del real nëse marrim në vemendje pikëpamjen e Bartit, sipas të cilit "kuptimi letrar nuk mund të stabilizohet plotësisht nga lexuesi (pra studiuesi - F.D) përderisa natyra intertekstuale e veprës e çon lexuesin në një marrëdhënie të re tekstuale". 5). Kjo tezë lidhet drejtpërdrejt me temën e rivlerësimit të letërsisë, për të cilën flitet shumë kohët e fundit. Në vështrimin teorik pyetja ka të bëjë me përcaktimin e raportit midis autonomisë semantike të tekstit, pra që nxjerr në plan të parë aspektin objektiv, dhe vlerësimit sipas kontekstit, rrethanave të interpretuesit. Nëse do i referoheshim pikëpamjes së Hajdegerit, sipas së cilës të kuptuarit nuk është një aktivitet autonom, ahistorik, por një ndërmjetës, përmes të cilit bota vjen te njeriu, i cili në një farë kuptimi karakterizon qenien e tij" 6) Apo tezës së Gadamer se "çdo epokë duhet ta kuptojë një tekst të transmetuar në mënyrën e vet" 7), do dilte pyetja: ç'peshë ka kjo tezë në ristudimin dhe studimin e autorëve dhe veprave letrare? Cili është thelbi i vërtetë i përcaktimit të sistemit të vlerave? Kuptimi i kësaj pyetjeje lidhet pikërisht me konceptimin e raportit midis realitetit historik të vlerave të letërsisë së periudhave të mëparshme dhe realitetit të kuptimit historik të këtyre vlerave sot. Interpretimi i autorëve të tillë si Fishta, Mjeda, apo dhe të periudhave të mëparshme, është padyshim edhe distancë historike. Por, a ndryshon sistemi i vlerave të veprave të këtyre autorëve, dhe në ç'drejtim?. Arti ripërtërin kuptimin tonë mbi jetën (Shkllovski)! Kjo orienton studiuesin në hetimin e aspekteve variabël të letërsisë, në evolucionin e sistemit letrar të momentit përkatës, në funksionet dhe dominantet e saj.

Pra rishikimi dhe rivlerësimi i autorëve dhe veprave të tyre, si pjesë e sistemit letrar, që transformon veten në kohë, nxjerr një ndër sfidat më të vështira të rivlerësimit të sotëm letrar. Sistemi letrar shqiptar vjen deri sot përmes ndryshimeve të vazhdueshme: evolucionare (si letërsia e viteve '30), por edhe më radikale (si letërsia e 10 viteve të fundit). Atëhere, a është autonomia e letërsisë e kufizuar

dhe relative, dhe sa e bën kjo autonominë e historiografisë letrare po aq të kufizuar dhe relative? Ky relativizëm i vlerësimit letrar është problem sa real, aq edhe delikat në praktikën e **vlerësimit,** dhe sidomos **rivlerësimit** të autorëve të traditës dhe bashkohorë. Ta pranosh teorikisht je akoma larg interpretimit konkret të fenomenit letrar. Shumë qëndrime të viteve të fundit, denigruese në ekstrem ndaj ndonjë autori, apo ekstremisht vlerësuese ndaj një tjetri, dëshmojnë se ky problem është i mprehtë dhe se sistemi i vlerave ndryshon! Problemi është: sipas cilave kritere do hetohet ndryshimi i këtij sistemi, dhe sipas cilave kritere do bëhet rivlerësimi i tij?.

SFIDA E KATËRT: Rivlerësim i autorëve dhe dukurive letrare duke iu referuar natyrës **intertekstuale** të veprës letrare.

Vitet e fundit janë realizuar, në disa artikuj apo studime të përmasave jo të gjera, trajtime veprash dhe autorësh në planin intertekstual. Përmendim p.sh. analizën interesante të K.Shalës mbi Kutelin, që sjell një pikëvështrim të ri në praktikën e studimeve tona letrare. Konceptet teorike, që qëndrojnë në themel të këtij pikëvështrimi, orientojnë drejt aspekteve të tjera të strukturave artistike, duke zbuluar ndërvartësi dhe raporte specifike të veprave me tekste të tjera. Një ndër tezat e teorisë moderne është që veprat letrare nuk kanë një kuptim të pavarur, ato duhen parë si pjesë të një rrethi të marrëdhënieve tekstuale. Kuptimi i çdo vepre (Kuteli, Konica, Kadare etj.) na del që ekziston si brenda veprës ashtu dhe në tekste të tjera me të cilat lidhen. Fenomeni është i dukshëm edhe në letërsinë postmoderne të viteve të fundit,(Romani *Një dashuri dhe shtatë faje* i R.Qoses etj.) …) Problemi është: a i jep kjo dukuri gjithë procesit tonë letrar, të traditës apo dhe bashkohor, dimensionin e një përshfaqjeje tjetër? Gjithashtu, interpretimi në një pikëvështrim më të thellë të marrëdhënieve me krijime të tjera a ka në themel shkaqe kontekstuale, domethënë a ka arsye që ka ndodhur ky fenomen te disa autorë? Nëse do të pranonim tezën se "intertekstualiteti është dhe do të mbetet një element kyç për të kuptuar letërsinë dhe kulturën në përgjithësi." 8), atëhere mund të themi se ky lloj vështrim do ishte një sfidë e re për shkencën tonë, në karakterizimin e procesit të zhvillimit historik të letërsisë. Një pikëvështrim i tillë zgjeron konceptin për letërsinë dhe mënyrën e interpretimit të saj. Konstatime shumë interesante do të

dilnin nga veprat jo vetëm të autorëve që zumë në gojë, por edhe të shumë krijuesve të tjerë, që nga fillimet e deri sot. Fjala nuk është, pra, për një lloj vështrimi që të mbetet si qëllim në vetvete, por, për diçka më thelbësore: për hetimin e dukurisë që shpreh, në vetvete, procesin e **rigjenerimit estetik** të letërsisë sonë. A ka vlerë të studiohet se letërsia jonë, në periudha të ndryshme, është realizuar përmes marrëdhënieve të brendshme midis tekstesh, apo me kontekste dhe praktika të ndryshme letrare? Një vështrim i tillë do thellonte kërkimin shkencor drejt gjurmimit të fshehtësisë së tekstit të parë, dhe hetimit të statusit të teksit të dytë (që nga autorë të letërsisë së vjetër, e deri në autorë bashkohorë). Gjithashtu, do të përcaktohej se deri në ç'shkallë të këtyre marrëdhënieve vepra të veçanta janë imitim, apo mohim, apo rikrijim? Janë të identifikueshme apo janë zbehur këto marrëdhënie? Deri në ç'masë e gjejmë këtë dukuri në zhvillimin e letërsisë sonë? Ky pikëvështrim studimi, pak i zbatuar nga shkenca jonë letrare, do hapte thellësi interpretimi për një dukuri që është po aq e lashtë sa dhe vetë letërsia, nga e cila nuk përjashtohet as zhvillimi i letërsisë sonë.

* * *

Duke iu rikthyer temës së këtij vëzhgimi: *Studimi i letersise sot: problem teorik apo subjektivizëm spontan?* mendoj se shkenca e letërsisë përballet sot me një problematikë teorike, sepse edhe pas qëndrimeve ideoartistike, që shfaqen në ditët tona, qëndron një aspekt i rëndësishëm teorik. Në historinë e zhvillimit të shkencave ka momente kthesash të rëndësishme. Mund të themi se ky moment nuk është realizuar akoma në shkencën e sotme letrare, me vepra madhore. Megjithë kontributet e vlefshme të disa studiuesve e kritikëve, të cilët gjatë viteve të fundit kanë sjellë vizione të reja në interpretimin e letërsisë, për mendimin tim jemi akoma në fazën e spontanitetit (një datë përkujtimore e një autori apo vepre është bërë shkas për një studim apo kumtim shkencor…). Brenda kuptimit dhe synimit që ka kjo Konferencë studimet e sotme letrare do të kishin nevojë për një projekt të madh, ndërakademik dhe ndëruniversitar, jo thjesht për të përcaktuar se cilët autorë duhet të trajtohen e cilët jo (ky do ishte aspekti më formal) por, në radhë të parë për të diskutuar dhe zbatuar

*praktikish*t një varg çështjesh teorike të vlerësimit dhe rivlerësimit të letërsisë shqiptare gjatë gjithë zhvillimit të saj historik. Ato çka preka shumë shkurt në këtë referim janë vetëm një pjesë e kësaj problematike komplekse.

Shënime:

1. Mukarovsky, La funzione, la norma e il valore estetico come fatti sociali, në *Il significato dell' estetica*, Torino, Einaudi, 1973, f.46
2. Kujtim Shala, *Shekulli i letërsisë shqipe*, Buzuku, 2004
3. Dhurata Shehri, *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, 2006
4. Sabri Hamiti, *Tematologjia,* Prishtinë 2005, f.53
5. Graham Allen, *Intertextuality*, NY, 2000, f.4
6. Ann Jefferson, David Robey, *Moderm Literary Theory*, London, 1997, f.182
7. Po aty, f.192
8. Graham Allen, *Intertextuality,* London, 2000, f.7

Zeqirja NEZIRI

LETËRSIA SHQIPE E BAROKUT

1. Historia e letërsisë njërin prej problemeve themelorë e konsideron klasifikimin e formave letrare në kontekst bashkëkohor dhe periodizimin e tyre në rrjedhën historike. Këto çështje i përkasin funksionimit dhe jetesës së formave poetike në bashkëkohësinë e tyre, pra në sinkroni; gjegjësisht ecurisë dhe funksionimit të tyre në kohë, pra në diakroni. Është konstatuar nga teorikët e historisë së letërsisë se jetesa e formave letrare si në sinkroni, ashtu edhe në diakroni nuk është e përputhshme dhe nuk shënon ndonjë rrjedhë të njëjtë jo vetëm brenda letërsisë kombëtare të një populli, por edhe brenda letërsive të popujve të ndryshëm, sepse kushtet dhe rrethanat shoqërore politike dhe ekonomike, kulturore e letrare nuk janë të njëjta. Te disa popuj paraqiten më herët, te disa të tjerë më vonë; te disa janë më të avancuara, kurse te disa të tjerë më pak të avancuara. Shpërputhjet e marrëdhënieve shoqërore ekonomike dhe kulturore politike kanë kushtëzuar edhe shpërputhjet letrare. Megjithatë, si në bashkëkohësi, ashtu edhe në rrjedhën historike ekzistojnë disa kufij brenda të cilëve kanë funksionuar veprat letrare të popujve të ndryshëm dhe kanë shënuar, ku më shumë e ku më pak, pika të përbashkëta.

Në kontekst të pikëtakimeve, në letërsinë e përgjithshme, si në sinkroni, ashtu edhe në diakroni janë gjetur emërtues të përbashkët të proceseve letrare. Në shkencën e letërsisë, të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, shumë çështje që kishin të bënin me historinë e letërsisë së përgjithshme gjetën shpjegim të lakmueshëm dhe shumë të tjera u shmangën si të panevojshme. Sa i përket periodizimit dhe emërtimit të periudhave letrare, nëpër të cilat ka udhëtuar procesi letrar, si të panevojshëm u nxorën nga përdorimi, herën e parë, termat që lidheshin me pozitivizmin historik dhe derivimet e tij, pastaj me historicizmin dhe periodizimin e letërsisë sipas matjes mekanike të kohës. Të gjithë termat e tjerë të huazuar nga historia, ekonomia apo politika u treguan të paplotë për ta përthekuar semantikën e jetesës së formave letrare.

Në këtë aspekt edhe diskutimet e zhvilluara për konceptet e periodizimit sipas kriterit të përkatësisë kombëtare, ose kombinimit të tij me kriterin gjuhësor, tematik përmbajtjesor e me kriterin *stilor*; mandej mbështetja e fuqishme në kriterin e matjes mekanike të kohës, janë vetëm disa nga pikat e shumta që e shqetësojnë studiuesin e historisë së letërsisë shqiptare. Po ashtu, atë e shqetëson edhe çështja e emërtimit të periudhave letrare shqiptare sipas kritereve tanimë të pranuar për letërsitë e tjera, sipas kriterit të përkatësisë së ndonjë *stili artistik*.

Një praktikë e ngjashme në studimin e historisë së letërsisë shqiptare të traditës është zbatuar vetëm për periudhën e Humanizmit dhe të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, deridiku edhe të periudhës pasuese të shekullit të 20-të, kurse për periudhën midis Humanizmit dhe Rilindjes Kombëtare, atë të shekujve XVI – XVIII nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme specialistike për ta dalluar si një periudhë të veçantë letrare dhe për ta gjetur tiparin vetanak teorik, i cili do të nënkuptonte edhe kohën edhe karakterin e këtij krijimi. Prandaj synimi i kësaj kumtese është që ta identifikojë pjesën e *letërsisë "së vjetër" shqipe gjashtëmbëdhjetë* – e *shtatëmbëdhjetëshekullore*, ta përfshijë këtë letërsi brenda proceseve dhe rrjedhave poetike të kohës dhe këtë prodhim poetik ta emërtojë me terma përkatës teorikë letrarë. Pra, bëhet fjalë për përveçimin e tipareve të saj dalluese kombëtare, në njërën anë dhe përafruese, në anën tjetër, me letërsitë evropiane dhe si rrjedhojë edhe për *emërtimin* e saj me një term praktik e të përshtatshëm.

Në këtë kumtesë, nuk do të shtrojmë në diskutim çështje që lidhen me tërë periudhën letrare kombëtare të quajtur *letërsi "e vjetër" shqiptare*, por vëmendjen do ta përqendrojmë vetëm në shekujt gjashtëmbëdhjetë e shtatëmbëdhjetë, bile edhe jo në të gjitha çështjet e tij, por vetëm në tri pika, të cilat meritojnë një vëmendje shumë më të madhe të shkencës albanologjike. Domethënë tri janë çështjet që kanë nxitur autorin të merret me to (1) *sistemimi* i kësaj periudhe të historisë së letërsisë shqiptare si letërsi kombëtare; (2) përcaktimi i rrugëve dhe mënyrave të ndërtimit të saj si sistem i veçantë letrar brenda sistemit kombëtar dhe (3) përfshirja e saj në rrjedhat e përgjithshme letrare ndërkombëtare. Si *çështje më* e debatueshme mbetet identifikimi i këtij prodhimi letrar dhe vendosja e

tij brenda kërkesave teorike-tipologjike letrare evropiane. Ky prodhim përthekohet brenda dy figurave qendrore: Buzukut, në fillim të kësaj periudhe dhe Bogdanit, në fund të saj.

2. Arsyet pse **historia e letërsisë** duhet t'i rikthehet këtij problemi i takojnë fushës së plotësimit, të përpunimit, të përsosjes, të freskimit e të begatimit të gjykimeve me njohuri të reja. Periodizimi letrar, në historinë e letërsisë, ka hyrë në zbatim që nga *Rilindja*. Atëbotë Skaligeri (në *Poetikën* e tij të vitit 1561) përdori *periodizimin antropologjik*. Herderi në shekullin e 18-të ndarjen e letërsisë e bëri sipas ***moshave*** në *të vjetër* e *të ri* dhe sipas ***kohëve*** në *antike*, *mesjetare*, *humaniste*. Shekulli i nëntëmbëdhjetë, nuk u largua gjithaq nga parimi i trashëguar antropologjik dhe pranoi periodizimin sipas moshave dhe kohëve në *të vjetër* / *klasikë* dhe *modernë* / *romantikë* (e zbatoi Shlegeli), që, në fundin e tij, sistemimi të bëhet sipas orientimeve *politike* e *kulturore* (e praktikuar nga W. Shereri më 1881) dhe sipas *shekujve*, *shkollave* e *zhanreve* letrare (e praktikuar nga G. Lansoni, në letërsinë frenge të vitit 1894).

Arsyet e zgjedhjes së kritereve të ndryshme kushtëzohen nga një varg faktorësh me të cilët shpjegohet prapambetja ndërkombëtare në kohë ("time – lage"), që praktikisht objektivohet me mospërfshirjen në të njëjtën kohë të vendit A në rrjedhat kohore letrare kur kanë përfshirë vendin B. Këtë fenomen E. R. Kurtiusi e vërtetoi në letërsinë mesjetare (latine) evropiane; Huizingu në letërsinë e Humanizëm / Renesancës; ndërsa Viktor Tapie në librin e tij mbi artet plastike të Barokut dhe në letërsinë e Klasicizmit. Por janë shënuar edhe raste të mohimit të çdo lloj kriteri, që si pasojë solli mohimin e historisë. Domethënë fenomeni i letërsisë kuptohet si preokupim i përhershëm i vazhdimësisë dhe i ndryshimit. Kështu u shpjegua se vepra artistike nuk është "fenomen i pastër" historik, ndaj edhe nuk mund të studiohet duke u mbështetur vetëm në një metodë, si, bie fjala, në metodologjinë e historisë së politikës ose të kulturës (*pozitivizmi*, *historizmi shpirtëror gjerman*, *interpretimi*, *kritika e re angloamerikane*, *historicizmi*) dhe u shtrua nevoja e kërkimit të metodave të reja, të cilat do të mbështeteshin në një pluralizëm metodologjik (Škreb: 149 – 163).

Vështirësia kryesore e periodizimit letrar sot është ekzistimi i përgjithësimeve stilore dhe tejbartja e tyre nëpër vepra të veçanta

letrare, domethënë, ndërlidhja e akcilës vepër letrare me elementet kohore (sinkroninë) dhe jashtëkohore (diakroninë). Në të gjitha letërsitë *ndërthurja* (*interferimi)* e periudhave letrare është dukuri e domosdoshme, siç është i domosdoshëm orientimi stilor në periudha të caktuara, që nënkupton gërshetimin e stileve të një periudhe letrare, por në kohë të ndryshme (*klasicizmi* **francez** është i shekullit të 17-të, kurse *ai* **gjerman** i shekullit të 18-të). Domethënë, është vështirë të ketë periudha "të pastra" letrare, sepse faktorët letrarë janë të veçantë dhe vetjakë për secilën vepër dhe për secilën letërsi.

Historia është selektive dhe konstruktive. Me fjalë të tjera, kategoritë kronologjike dhe periudhat historike përzihen, përputhen ose ndërthuren me vetëdijen e njeriut për ndryshimin. Domethënë do të duhej bërë fjalë sa dhe si "historia" e letërsisë mund t'i vrojtojë periudhat dhe drejtimet letrare si struktura stilore në ecurinë "imanente" të letërsisë dhe si dhe sa si unitete komplekse, në të cilat bëhen gërshetime të ndryshme dhe në të cilat të gjitha veçantitë edhe të karakterit letrar, edhe të karakterit jashtëletrar përbëjnë sistemin e elementeve korelative (Shkreb, 1984: 34).

Në bazë të analizës konkrete të veprave letrare dhe të dukurive letrare janë ndërtuar kategoritë e përgjithshme, mbiindividuale, të njohura nën termat e periudhave dhe të drejtimeve letrare. Studimi i sistemeve zhanrore të periudhave të ndryshme letrare, mënyra e ndryshimit të tyre, studimi i distancës, në të dy aspektet (të poetikës historike dhe të poetikës tradicionale), pra i raportit të shkrimtarëve aktualë ndaj traditës së trashëguar letrare, i raportit të studiuesve aktualë ndaj tyre dhe i raportit tonë ndaj të dyve, shpjegoi paraqitjen e ndryshimeve në poetikë.

Dialektika e historisë letrare anon kah ngjizja me dialektikën e historisë së përgjithshme. Derisa koncepti statik ose sinkronik i periudhës zakonisht varet nga harmonia stilore, përqasja dinamike ose diakronike nis me tendosjen sociale. Frankashteli shtron kuptimësinë diakronike të Barokut (Frankashtel: 146), ngaqë kuptimi i periudhës konceptohet nga pasardhësi në perspektivë. Pra, periudhat janë modele hipotetike (Bart: *Kritika dhe e vërteta*, 58), të cilat te K. Levi-Strosi i nënshtrohen marrëdhënieve strukturale (Levi – Stros: *Totemizmi*, 23), te Umberto Eco dalin në "transaksione" psikologjike (Eco: *Modele dhe struktura*, 11 - 28), ndërsa te Ortega në spastrime të vazhdueshme.

Nuk ekzistojnë sisteme normash, standardesh ose konventash, të cilat janë të gatshme e të përhershme. Kuptimi i *parodisë* dhe i *kompilimit*, i *parafrazës* dhe i *përkthimit*, që, në metodat e moçme krahasimtare të studimit të letërsisë, quheshin "ndikime", ndihmoi të shpjegohet bash-këveprimi i dukurive letrare në një periudhë dhe strukturimi i veçantë, i ri i tyre.

3. Nocioni Barok në letërsitë evropiane përdoret për shenjimin e prodhimit letrar të periudhës midis Rilindjes dhe Klasicizmit (Iluminizmit, Racionalizmit) dhe përfshin një periudhë letrare me tërësi të mëdha ose të vogla stilesh ndërmjet viteve 1570-1670, kur konsiderohet se kalon në Klasicizëm dhe zhvillohet sipas dy pikëpamjeve të funksionit të artit: *estetik* dhe *utilitar – moralizues* e *didaktik*. Në të gjitha letërsitë evropiane është e njohur si letërsi e ***Barokut*** (*religjioz*, a *laik*), edhe pse në të njëjtën kohë, përdoren edhe terma kombëtarë si: *marinizmi* (Itali), *gongorizmi* (Spanjë), *precioziteti* (Francë), *jufjuizmi* (Angli), *shkolla poetike shleziane* (Gjermani). Por ka edhe përjashtime. Me disa karakteristika, Barokut i përkasin edhe përfaqësuesit më të mëdhenj të Rilindjes: Servantesi, Rableu e Shekspiri. Madje në letërsinë franceze është vështirë të tërhiqet ndonjë kufi i prerë midis Barokut dhe Klasicizmit.

Letërsia fetare në qindvjetëshin e 17-të, pasiqë *Përtëritja Katolike* kishte forcuar pozitat e veta të lëkundura në periudhën e Humanizmit e të Rilindjes Evropiane dhe të Reformës, zhvillohet nën kërkesat e *Barokut* si formacion stilor i fundit të shekullit XVI dhe i fillimit të këtij shekulli, që te disa popuj vijon të mbizotërojë gjatë gjithë qindvjetëshit, si është rasti edhe me letërsinë shqipe, kurse te disa, sidomos te evroperëndimorët, zëvendësohet me terma të rinj, si Klasicizmi, Iluminizmi, Racionalizmi; kurse te disa të tjerë vazhdon edhe në shekullin vijues, pra në të tetëmbëdhjetin.

Përtëritja Katolike, pas Koncilit të Trentit (1545 – 1563) duke kultivuar rezultatet e Rilindjes, i jep krah paraqitjes së *Barokut*, si formë e shprehjes artistike të shekullit dhe, në këtë mënyrë, krijon dhe kultivon Barokun religjioz. Ai lind dhe konstituohet në kohën e veprimit të Kundërreformës Katolike dhe karakterizohet me depërtimin e theksuar të mistikës së krishterë mbi paganizmin e kthjellët të Antikës e të Rilindjes Evropiane. Sipas këtij koncepti theksohet dhe rritet distanca midis të gjithëfuqishmit e hyjnisë së

rreptë (Kreatorit) dhe krijesës së tij të vogël, të pakujdesshme e të pafuqishme; por edhe dinamike, e cila duke bërë përpjekje ta hyjnizojë vendnumërimin e pakuptimtë të dinjitetit të vet në histori, shpeshherë harron se është krijesë e varur, se është hi e pluhur. Në këto e përkujton Baroku letrar evropian njeriun e shekullit XVII, që të mos e harrojë pozitën e tij. Prandaj arti, në përgjithësi, si dhe ai letrar, në veçanti, duhej ta përkujtojnë njeriun e vogël për Kreatorin dhe kështu ta përgatisin për gjyqin përfundimtar. Vizioni epik i jetës shpjegohet sipas Virgjilit: ai fiton konotacion teologjik dhe teleologjik (Slamnig: 71).

Format artistike të Barokut paraqiten në fund të shekullit të 16-të në arkitekturë, skulpturë, pikturë, më pas edhe në letërsi. Mbështetjen shprehimore e gjejnë në karakteristikën përshkrimore të marinizmit në art, i cili dallohet me shthurjen e dukshme të harmonisë së artit antik e të Rilindjes Evropiane, depërtimin e shprehjes artistike bizare e sekrete, shprehjen e shpirtit dhe theksueshmërinë e shijes që kanë ndihmuar të vihet në pah spiritualizmi dhe misticizmi në art. Njëra nga shprehjet më të mëdha dhe realizimet më të suksesshme të këtij stili merret piktura "*Dita e gjyqit*" e Mikelanxhelos (1534-41), e vendosur në çatinë e kapelës së Sikstinës në Venedik (Rečnik: 68).

Në *rrafshin zhanror* prodhimi letrar i Barokut përdor forma të ndryshme shprehëse. Tipologjikisht, si forma të trashëguara nga periudhat e hershme konsiderohen: *kënga lirike* dhe *epopeja*, kurse si formë tipike e Barokut merret *poema*. Këto forma të letërsisë së këtij shekulli, kanë qenë më të përdorshme dhe i kanë njohur të gjithë popujt e Evropës.

4. Në aspektin tipologjik kjo letërsi ka të ngjarë të ketë shumë tipare të përbashkëta brendakombëtare dhe jashtëkombëtare. Njohuritë tona teorike letrare për këtë periudhë të shkrimësisë shqipe, ofrojnë të dhëna për ekzistimin e katër llojeve. (1) Në të *parin* do të bënin pjesë veprat *liturgjike,* në të cilat flitet për *mënyrën e mbajtjes së ceremonive fetare të vitit* dhe *shpjegimin e njohurive fillestare të krishterimit* (të kësaj natyre janë veprat e njohura si: doktrina, mesharë e të ngjashme të botuara në përkthim ose të përpiluara nga Gjon Buzuku, Lekë Matranga, Pjetër Budi, Neofito Radinoi, Papa Dhimitër Delvina, Leo A. Kuintiano, Papa Totasi – Teodor Bogomili etj.); në ***të dytin*** do të flitej për *vepra gjuhësore* (si janë fjalorët dhe shënimet e

ndryshme me karakter gramatikor e leksikor filologjik: shënimet etimologjike – gjuhësore të Pjetër Mazrekut, fjalori i Frano Bardhit, si dhe fjalori i Leo Çitadelës, apo ai i Nilo Katalanos); në ***të tretin*** do të përfshiheshin *veprat filozofike teologjike* ose *të kulturës së përgjithshme* (parathëniet e pasthëniet, raportet e ndryshme, *Apologjia* e Bardhit, shënimi gjenealogjik i Bogdanit, letra e krerëve të Gashit etj. dhe mbishkrime të ndryshme); dhe në ***të katërtin*** do të ishin *veprat letrare ose siletrare* (vjershat dhe prozat e Pjetër Budit, vjersha e Dhanil Korteses, Frano Bardhit, Nilo Katalanos, Lukë Sumës e Lukë Bogdanit, Pjetër Bogdanit, anonimit sicilian).

Në kumtesën tonë, jemi përqendruar kryesisht në prodhimin e shkruar në shqip të grupit të fundit, pra në veprat letrare ose siletrare dhe këto, për rastin konkret, përbëjnë strumbullarin themelor dhe më me interes për historinë e letërsisë shqipe. Në ballë të tyre qëndrojnë (1) tekstet siletrare në *Mesharin* e Buzukut; (2) vjersha e Lekë Matrangës; (3) vjershat dhe prozat e Pjetër Budit në *Doktrinë* (1618, 1636, 1664), *Ritualin roman* (1621) dhe në *Pasqyrën e të rrëfyerit* (1621); pastaj vijnë (4) gjashtë vargjet përkushtimore të arbëreshit Dhanil Kortese (1638); (5) një këngë shqipe për ndonjë sulltan e regjistruar në Elbasan (1650); (6) vjershat dhe tekstet e tjera në prozë të botuara në *Çetën e profetëve* (1685, 1691, 1702, 1989) të Pjetër Bogdanit, si nga ai vetë, ashtu edhe (7, 8, 9) nga autorë të tjerë; dhe (10) në fund mbeten *Kënga e Pal Golemit* dhe (11) këngë të tjera të regjistruara në *Fjalorin e Katalanos* (1637-1694); si dhe (12) *vjersha anonime* e arbëreshëve sicilianë me 328 vargje me strofa katërshe në 11 rrokësh.

Në aspektin tipologjik, këto janë vjersha të natyrës së *himnit* (numri më i madh i tyre) *lavdit*, *lutjeve*, *pendesave*, *predikimeve*, *uratave, vajeve pendestare*, madje tekste poetike *përkushtimore*. Shikuar nga ky këndvështrim, të gjitha këto krijime letrare e siletrare përpunojnë tema biblike, janë në shërbim, i nënshtrohen, i kanë në *plan të parë* dhe angazhohen për afirmimin e të vërtetave religjioze; kurse përjetimin estetik e kanë në *plan dytësor*, ndaj edhe strukturalisht afrohen me llojet letrare të letërsisë fetare: *poemthave*, *poemave e pseudopoemave*, *epeve e pseudoepeve mesjetare* e *baroke*.

Vjershat e Budit në *Doktrinë*, si dhe ato të Bogdanit në *Çetën e profetëve* edhe për nga struktura kompozicionale edhe për nga

përshkrimi tematik përmbajtjesor, edhe për nga motivet e përpunuar i përgjigjen kërkesave teorike të Barokut letrar. Zaten edhe mënyra e organizimit gjuhësor poetik në të gjitha këto krijime poetike është në përputhje të plotë me kërkesat teorike të kësaj periudhe letrare. Mirëpo, midis prodhimit letrar mesjetar dhe atij të shekujve të 16 – 17-të, si në prodhimin letrar shqiptar, ashtu edhe në atë evropian qëndron Humanizmi dhe Rilindja Evropiane, që paraqet një prerje, një shkëputje, por dhe i jep një hop të madh përpara zhvillimit të mendimit të ri. Kjo letërsi që krijohet në këta qindvjetsha, edhe pse në kohë është shumë afër praktikës dhe poetikës së Humanizëm – Renesancës nuk vazhdon sipas parimeve të tyre, por sipas praktikës mesjetare, sepse i bën jehonë *Përtëritjes Katolike,* ndaj edhe është shumë më afër strukturave poetike mesjetare se sa atyre humaniste.

Në këtë shekull, si u vërejt, janë botuar vepra letrare, të cilat në tërësi angazhohen për propagandimin dhe afirmimin e religjionit – krishterimit dhe, falë këtij tipari, arritën të botohen e të ruhen deri në ditët tona. Do theksuar se ajo që e dallon letërsinë shqipe prej simotrave evropiane është se angazhimi i krishterë ka qenë më i theksuar, më i fortë dhe më i thellë se sa e kanë njohur prodhimet letrare të popujve të tjerë, te të cilët regjistrohen dy tipa veprash: *religjioze* - si kjo e jona dhe *laike* - që nuk e njeh e jona. Pasiqë letërsia shqipe e kësaj periudhe nuk njeh prodhimin letrar me funksion parësor estetik, por prodhimin letrar institucional - propagandistik, pra me *funksion utilitar – moralizues* dhe *didaktik*, atëherë edhe hulumtimi i prodhimit letrar shqip(tar) duhet të orientohet në këtë drejtim dhe ajo duhet të emërtohet si letërsi e *Barokut religjioz shqiptar*.

5. Ndërlidhja e letërsisë shqipe të kësaj periudhe letrare me letërsitë evropiane na çon në *çështjen e tretë* të kësaj kumtese, në të cilën shtrohet në diskutim ***emërtimi*** i letërsisë shqipe të kësaj periudhe, sipas të cilit, këtë prodhim të shkruar kulturor e letrar ne ende po e quajmë letërsi "e vjetër" shqipe. Shtrohet pyetja pse "e vjetër": (1) Sipas moshës, se i takon një periudhe të hershme historike dhe është shumë larg bashkëkohësisë së konceptit të sotëm të ndërtimit të veprave letrare, (2) se i paraprin periudhës tjetër të quajtur "Rilindje Kombëtare", apo (3) pse ka vlera të atilla artistike e letrare estetike që të konsiderohet "klasike"?

Në qoftë se konceptin e letërsisë e kuptojmë ashtu si Aristoteli i konsideronte personazhet se janë ose mbi ne, ose si ne, ose më të ulët se ne, edhe letërsia "e vjetër" shqipe nuk është e fazës fëmijërore në kuptimin e një faze më të ulët artistike, por është e një faze nismëtare, me cilësi të veçanta artistike dhe nis trasimin e një udhëtimi vetjak letrar shqiptar. Këtë epitet ia japin përbërësit motivorë – tematikë e përmbajtjesorë, lloji letrar, gjuha, stili dhe elementet e tjerë përfaqësues, të përpjekjes për pjesëmarrje dhe përfshirje të identitetit kombëtar shqiptar në rrjedhat e përgjithshme letrare evroperëndimore. Pra, problemi esencial për shkencën e historisë së letërsisë shqiptare mbetet jo sa i ka përcjellë kjo letërsi tendencat mbarëletrare, as si dhe a i ka përcjellë, por sa ajo ka qenë në gjendje atyre t'u japë vlerësim të merituar, t'i vendosë brenda kufijve kohorë të krijimit e të funksionimit dhe sa ka qenë e aftë ta çmojë e ta arsyetojë shkencërisht dhe me të të dalë para historisë kombëtare dhe botërore me rezultate e suksese logjikisht të argumentuara?

Që nga koha e A. Stratikoit e deri në ditët tona janë përdorur terma e kritere të llojllojshme e të ndryshme të emërtimit dhe të sistemimit e të kategorizimit të këtij prodhimi letrar e siletrar. Këta terma shpeshherë e kanë afirmuar, por nganjëherë edhe e kanë kundërshtuar njëri-tjetrin. Ndër më të favorizuarit dhe më të përdorshmit është praktikuar kriteri *i matjes mekanike të kohës* dhe brenda tij ai *rajonal*, madje ai *dialektor,* por nuk ka munguar edhe ai *konfesional* ose një kombinim i çuditshëm i të gjithëve: konfesional, rajonal – dialektor, entologjik, historik. Por ka raste edhe të zhvendosjes kohore të kohëjetesës e kohëzgjatjes së periudhave letrare ose të vazhdimësisë së tyre në pakufi.

Albert Stratikoi (1896) zbaton kriterin kronologjik të matjes mekanike të kohës; gjurmëve të tij kanë ecur Justin Rrota (1925) dhe Gaetano Petrotta (1931). Eqrem Çabej, ndërkaq, këtë kriter e kombinon me kriterin rajonal gjuhësor (Çabej, 1936). Filip Fishta, kriterin kronologjik e kombinon me kriterin gjuhësor-dialektor, rajonal dhe konfesional (Fishta,1931). Ngjashëm veprojnë edhe Ernest Koliqi me Namik Resulin (1941), me një përjashtim të madh se ky i fundit është i pari dhe i vetmi, që, këtë periudhë letrare, e emërton me emrin e saj të vërtetë, pra periudhë e barokut (Ismajli: 14). Prandaj Zef Skiroi vjershat e Budit, në kontekst të letërsisë kombëtare i nivelizonte

me ***Parajsën e humbur*** të Xhon Miltonit, kurse Henrik Lacaj me vjershat poetit italian Andreini (Lacaj: 446).

Pas Luftës së Dytë Botërore, me përjashtim të dy - tre dhjetëvjetëshave të fundit të shekullit njëzet, çështjet nuk do të ndryshojnë në të mirë. Dhimitër S. Shuteriqi (1955) zbaton kriterin e kronologjisë kohore të kombinuar me kriterin rajonal, konfesional e dialektor (si në tekstin e letërsisë shqipe për shkollat e mesme, ashtu edhe në të dy tekstet universitarë të "*Historisë së letërsisë shqip(tare)*" të botuar në Tiranë më l959 dhe l983 e të ribotuar edhe në Prishtinë). Përpjekje për periodizimin e letërsisë shqiptare të kësaj periudhe në dy tri dekadat e fundit kanë bërë dhe Mahmud Hysa (Hysa, 1987/2000: III-VII, 5, 13, 105, 191; 1992: 9, 17, 145, 241-24) me Ali Xhikun (Xhiku, 2003: 23 – 41; 47 - 50), duke e quajtur këtë letërsi *neoklerikale* (i pari) ose *humaniste* (i dyti). Sabri Hamiti (Hamiti, 1986: 8-9; 1989:9-42), ndërkaq, është i vetmi që vë në përdorim një parim krejtësisht të ri të mbështetur në faktorët kryesisht letrarë: në kriterin tematik – përmbajtjesor (Hamiti: 36-40).

6. Kur i hedhim një sy pikëpamjeve të historianëve shqiptarë të studimit të historisë së letërsisë shqiptare të kësaj periudhe letrare, shohim se janë ndjekur kritere të shumta e të llojllojshme, të njohura e të panjohura për historinë e letërsisë. Të habit fakti se ata të gjithë së bashku janë të pranishëm në letërsinë e përgjithshme. Në këtë përpjekje, historianët tanë të letërsisë, kanë përzierë, kanë kombinuar dhe kanë bërë një lloj kompromisi midis kritereve sinkronikë të klasifikimit dhe kritereve diakronikë të periodizimit. Janë përdorur katër kritere kryesore, të modifikuar ndërmjet atij të Stratikoit, F. Fishtës, E. Çabejit dhe N. Resulit: *kriteri kronologjik*, sipas matjes mekanike të kohës dhe brenda tij është zbatuar kriteri *dialektor*, mandej kriteri *rajonal*, kriteri *stilor* dhe kriteri *tematik – përmbajtjesor*. Mirëpo, të gjithë janë të një mendjeje se kjo pjesë e letërsisë shqipe paraqet një periudhë të veçantë dhe dalluese, e cila meriton ta ketë edhe emërtuesin e vet. Por e keqja është se të gjithë e shohin si periudhë vetëm shqiptare dhe asnjëri nuk bën përpjekje ta afrojë me rrjedhat letrare evropiane dhe edhe nëse këtë e bëjnë atëherë e bëjnë në mënyrë parciale dhe jo tërësore e bindëse. Po bëjmë një pyetje: a mund të studiohet prodhimi letrar kombëtar sipas kategorive

ideologjike: shoqërore, politike e religjioze, apo sipas kritereve letrare?

Secili nga këto kritere të periodizimit, në qoftë se zbatohet në mënyrë të pavarur, i ekspozohet rreziqeve të shumta, sepse jo në të gjitha periudhat krijuese mund të zbatohen kritere të njëjta. Kriteret e përkufizimit të përgjithshëm: historikë, ekonomikë, shoqërorë a politikë ideologjikë nuk mund të gjejnë zbatim në përkufizimin e procesit krijues – thotë Sabri Hamiti (Hamiti: 10), ngaqë proceset letrare dallohen shumë prej tyre, edhe pse ushqehen prej tyre, sepse mënyra e kalimit nga njëra periudhë në periudhën tjetër letrare ndjek një rrugë krejtësisht tjetër e të veçantë, ashtu si janë të veçanta edhe veprat letrare. Asnjëri nga këto kritere të emërtimit dhe të periodizimit të kësaj pjese të letërsisë shqiptare, nuk i kënaq kërkesat shkencore për të qenë i pranueshëm dhe bindës. Cilët janë faktorët metodologjikë që përligjin këtë koncept të periodizimit?

I pari është se termat *letërsi mesjetare* ose *letërsi feudale*, mandej *humaniste* ose *neoklerikale* (Hysa, 2000: term i pa mbështetje në shkencën e letërsisë), duke u shtrirë jashtë përkufizimit kohor të veprimit të periudhës letrare, nuk përkojnë me rrjedhën kohore të saj. Letërsitë evropiane periudhën mesjetare e mbyllin me shekullin XIV dhe nuk kemi kurrfarë arsye shkencore ta zhvendosim matjen historike të kohës në shekujt e mëvonshëm, si propozohet, bie fjala nga Mahmud Hysa (1985); ose edhe për dy shekuj t'ia zgjasim jetën *Humanizmit*, si mendon Ali Xhiku (2003).

Kriteri ***i dytë*** është ndarja e kësaj letërsie sipas zonave etnologjike gjuhësore dhe gjeografike. As *dialekti*, aq më pak *nëndialekti*, si është vepruar në disa raste, nuk janë elemente dalluese të përcaktimit të periudhës letrare. Njësoj qëndron çështja edhe me ndarjen dialektore etnologjike (gege – toske) ose rajonale gjeografike (të veriut e të jugut), që nuk përkon me procesin letrar.

Më i palogjikshëm dhe shkencërisht i pambështetje është kriteri ***i tretë***, sipas të cilit letërsia kombëtare dëshirohet të sistemohet sipas ideologjisë, shërbimit dhe angazhimit praktik, pra, sipas kriterit të *përkatësisë konfesionale*. Nuk mund të ketë ndarje të letërsisë kombëtare në: *katolike, ortodokse, myslimane.* Secili prodhim letrar utilitar dhe institucional së pari ka qenë në shërbim të ndonjë ideologjie fetare a politike dhe, varësisht nga parimi që i është

imponuar, ka shërbyer si material ilustrativ për përhapjen e kësaj ideologjie ose të asaj praktike ideologjike, politike a shoqërore. Mirëpo, vlera artistike nuk matet dhe nuk çmohet me mjete të ideologjisë, por me mjete të qenësisë së vet, madje të funksionit të saj në mjedisin e caktuar shoqëror, i cili ia ka përcaktuar edhe orientimin, edhe konceptin e zhanrit, edhe kahen e perceptimit.

Edhe kriteri ***i katërt*** *tematik – përmbajtjesor*, megjithëse është më i qëndrueshmi, plotëson një zbrazëtirë të ndjeshme dhe sjell freski në studimet letrare shqiptare, sepse i shmanget traditës joletrare të periodizimit dhe ndihmon që letërsia t'i kthehet objektit të vet, duke u mbështetur vetëm në faktorin *tematik – përmbajtjesor* dhe duke mos përfillur aspektin motivor dhe kriterin gjuhësor stilor është jopraktik, sepse përjashton faktorët e tjerë të krijimit, të jetesës e të funksionimit të artit letrar[1].

Në këtë aspekt ***kriteri gjuhësor stilor***, mbetet të jetë kriteri dallues i një periudhe nga periudha tjetër letrare. Prandaj edhe kriter më i përshtatshëm do ishte ai ***teorik-letrar e stilor, me emërtime letrare*** e ***jo të shkencave të tjera,*** i cili do të mbështetej në kërkesat artistike, nëpër të cilat ka kaluar letrarësia dhe i ka vënë vulën e vet.

Mbështetur në gjithçka që u tha dhe në kriteret e parashtruara, këtë periudhë të historisë së letërsisë shqipe pa mëdyshje mund ta emërtojmë sipas kërkesave teorike letrare të pranuara e të verifikuara

[1] Vlen të theksohet një gjë: të gjitha kriteret e gjertanishme të periodizimit të letërsisë "së vjetër" shqiptare për gjith]ka tjetër mund të vlejnë dhe gjith]ka tjetër përmbushin, por kriteret historike letrare fort pak. Në këtë drejtim ka bërë një përpjekje të lakmueshme Sabri Hamiti, por ka mbetur zë i vetmuar. Megjithëse, edhe te ai mund të vërehet, se *kodi biblik* dhe *letërsia filobiblike*, si dëshiron ta emërtojë letërsinë "e vjetër" dhe atë ta shtrijë në gjithë fondin letrar shqiptar sikur nuk përkon me termonologjinë letrare, sepse duke u mbështetur vetëm në faktorin tematik – pëmbajtësor ekziston mundësia ta rrezikojë mendimin bazë. Edhe pse termi *kod filobiblik*, në konotacionin e një *kompleksi stilor*, i cili do ta përfshinte kategorinë abstrakte, si i jepet, bie fjala përshkrimit *barok*, *realist*, *romantik* etj. ose edhe të një periudhe të gjatë historike letrare - nga fillimet e deri në periudhën e Rilindjes Kombëtare, mund të jetë i arsyeshëm, vetëm se atëherë sistemimi i materies letrare do të përkufizohej sipas kritereve politike e ideologjike dhe jo sipas kritereve historike letrare. Secili material shkencor kërkon nomenklaturën dhe mjetet vetjake të studimit e të vlerësimit. Edhe materiali historik letrar shqiptar kërkon të vlerësohet, sipas kritereve të veta dhe jo sipas atyre të disiplinave të tjera: të historisë e të kulturës së përgjithshme, të gjuhësisë e të sociologjisë, të politikës e të ideologjisë.

në letërsitë evroperëndimore. Në qoftë se, ajo i përmbush këto kritere dhe nëse është e veçantë, si shqiptare dhe sipas afinitetit nëse është në rrjedhat letrare evroperëndimore, natyrisht, edhe do të jetë në gjendje ta shënjojë periudhën e vet letrare me emërtim të njëjtë si dhe ato[2]. Shi për këtë, letërsia shqipe e kësaj periudhe, pa kurrfarë kompleksesh mund të emërtohet me emërtimin e përbashkët të të gjitha letërsive evropiane, pra letërsi e **Barokut**[3]**.**

7. Kjo periudhë letrare, në të gjitha letërsitë evroperëndimore quhet me emra të ndryshëm, sipas gjuhës, popullit dhe rrethanave të tjera jashtëletrare, por si emërtues të përbashkët ka ***Barokun***, sepse këto letërsi evroperëndimore kanë karakteristika stilore të përafërta, të ngjashme ose të njëjta. Ajo i përgjigjet kërkesave të institucioneve fetare, sipas mësimeve të **Toma Akuinit, Shën Augustinit** dhe të etërve të tjerë kishtarë. Shkrimtarët e *epopesë* ndjekin **Torkuato Tason** dhe veprën e tij *Jerusalemi i liruar*, të ndërtuar sipas *Poetikës* së **Mark Xhirolamo Vidit** dhe *epin* e këtij *Christiada*; ata të *poemës* **Luixhi Tansilo da Nojen** (1510 – 1568) dhe poemën e tij të njohur *Pendesa ose Vaji i Shën Pjetrit* (1587); kurse poetët e *këngës lirike* dhe *epike*, krijimet e poetëve mesjetarë.

Në të gjitha letërsitë evropiane /jo vetëm angleze, franceze, gjermane, italiane, spanjolle; por edhe në letërsinë çeke (HLB 7: 20), daneze (HLB 5: 326), finlandeze (HLB 5: 496 – 97), holandeze (HLB 5: 440 – 441), hungareze (HLB 5: 458), islandeze (HLB 5: 374 – 375), kroate, polake (HLB 7: 136 – 150), portugeze, sllovake (HLB 7: 82 – 83), sllovene, suedeze (HLB 5: 407)/ periudha midis viteve 1570 –

[2] Nuk duhet harruar se kësaj letërsie i ka munguar sistemi i organizuar e i përqëndruar politik në kuptimin shtetëror, siç në Evropë nis të plasohet nga shekulli i 18-të e këndej, kur brenda shtetit politik synohet të kuptohet edhe shteti kombëtar. Me të dëshirohet të tërhiqet vërejtja për ekzistimin e *procesit krijues,* si dukuri e *kulturës së shkrimit poetik,* në trojet të cilat sot i banojnë shqiptarët.

[3] Në historinë tonë të letërsisë qyshkur është trasuar mendimi se vepra e Buzukut, Matrangës, Budit, Bardhit, Bogdanit e të tjerë është në kontekst të kërkesave reformuese të kishës katolike të Romës, sepse ajo pasiqë nga *lëvizja e reformës* së Martin Luterit dhe, sidomos, nga *sukseset e Renesansës së zhvilluar*, kishte pësuar tronditje të madhe, qe detyruar të organizohet shumë shpejt e ta ndërtojë mënyrën e transformimit. Këtë mendim së pari e kanë shprehur Zef Valentini, Martin Camaj, mandej prof. Eqrem }abej (në studimin mbi *Mesharin* e Buzukut) dhe pas tyre e kanë përkrahur studiues të tjerë: E. Sedaj, R. Ismajli, I. Rugova, A. Berisha, S. Hamiti etj.

1670 quhet periudhë e Barokut dhe në të përfshihen të gjitha ato prodhime letrare ose siletrare që kanë disa pikëtakime stilore si përshkrimi i pavdekshmërisë së shpirtit, vdekjesimi i trupit, afirmimi i asketizmit dhe i të vërtetave religjioze – të krishtera, mbështetja e fortë në letërsinë e Mesjetës dhe mohimi i letërsisë së Humanizëm – Renesancës, që shpjegohet me përpjekjen e Kishës, me anë të Këshillit të Trentit e të Përtëritjes Katolike, ta rimarrë pushtetin e tronditur e të lëkundur nga Humanizmi dhe Reforma e Martin Luterit.

Përgjithësisht është e ditur se në vitin 1594, sipas kërkesave të Përtëritjes Katolike ose të Kundërreformës, u ribotuan *Jerusalemi i liruar* i Torkuato Tasos dhe *Christiada* e Xhirolamo Vidit, por të përpunuara dhe të plotësuara sipas porosive të imponuara të Kishës. Këto vepra shërbyen si model imitimi edhe për më tepër se një shekull prapa. Këtu është fjala vetëm për njërin lloj letrar, i cili në kohën e dhënë ishte në krye, në majën më të lartë të kierarkisë zhanrore. Kjo nuk do të thotë se nuk shkruheshin dhe krijoheshin vepra të llojeve të tjera të shkallëve më të ulta të kierarkisë: *poema* të tipit të *vajeve pendestare*, si pat shkruar përgjatë Mesjetës Jacopone da Todi; ose vjersha lirike të tipit të *laudave* (*lutjeve* e *pendesave*), si njiheshin në letërsinë italiane, spanjolle e franceze të Mesjetës, me të cilat përhapej e vërteta e krishterë moralizuese; ose *himne* si shkroi Budi dhe si janë shkruar sibilat e Bogdanit. Kjo do të thotë se nuk duhet gjithmonë të kapemi për majat më të larta të zhanreve letrare e të kërkojmë edhe nga krijuesit tanë t'i provojnë forcat e veta për ngritjen e një gjinie të tillë, kur dihet se për lërimin dhe kultivimin e formave të këtilla nuk kanë ekzistuar as kushtet më minimale shoqërore politike dhe ekonomike kulturore.

8. Nën përshtypjen e rileximit të veprave të autorëve shqiptarë dhe të huaj të kësaj periudhe letrare, përafrimit të letërsisë shqipe me letërsitë evropiane dhe të saktësimit të pikëpamjeve të Resulit, Skiroit dhe Lacajt mendoja: vallë ku qëndron tipari i tyre letrar i Barokut? Pastaj prodhimi letrar shqip(tar) i kësaj periudhe sa dhe deri në ç'nivel afrohet me *Barokun* evropian perëndimor? Nga analiza ballafaquese e veprave të autorëve tanë me autorët e letërsive evropiane kemi arritur të hetojmë pikëtakime në *rrafshin tematik*, *motivor*, *strukturor*, *metrikor* dhe *figurativ gjuhësor*.

Në mënyrë të sintetizuar, mund të thuhet se në *rrafshin tematik* i afron përshkrimi i mëkatit dhe pendesa e mëkatarit me të cilat insistohet në magjishmërinë e pendesës dhe kthimin e mëkatarit në gjirin e kishës. Prandaj parabola e *Djalit plangprishës* e Gjon Buzukut nga studiuesit tanë konsiderohet më tepër përshtatje se përkthim. Pranë pikëtakimeve vërehet edhe futja e vetëdijesimit të identiteti kombëtar, si në katër vjershat e fundit të *Doktrinës* së Pjetër Budit, ashtu edhe shqiptarizimi i sibilave në *Çetën* e Pjetër Bogdanit.

Në *rrafshin motivor* ngjashmëritë midis veprave të Budit dhe Bogdanit me shokë dhe të atyre evroperëndimorë veçohen *pendestari*, *frika*, *reminishenca e mëkatit*, *ambienti i shkretëtirës* dhe i egërsisë *natyrore*, në të cilat gjallon mëkatari; *mohimi i jetës* dhe i gjithçkaje jetësore përballë vdekjes; *asgjësimi i bukurisë fizike* dhe *natyrore* përballë bukurisë hyjnore, kozmogonike e qiellore (dy vjershat e para të *Doktrinës* së Pjetër Budit dhe pjesa e dytë e *Çetës* së Pjetër Bogdanit).

Në *rrafshin strukturor* ngjashmëritë janë pasojë e rrafsheve tematike e motivore: subjekti ndërtohet në mënyrë fragmentare; mungon rrjedha lineare e zhvillimit të subjektit, por përdoret linja ciklike. Pjetër Budi në vjershat e tij tri herë i rikthehet, pra e rimerr motivin e hyjnizimit dhe të kryqëzimit të Krishtit. Vjershërimet ndërtohen sipas shprehshmërisë monologe. Komentet e shkrimtarit birren në minimum ose mungojnë në tërësi.

Afritë në *rrafshin stilistik-poetik* vërehen në grumbullimin dhe përdorimin e figurave etimologjike-sintaktike dhe metaforike: alegorisë, anadiplozës, antitezës e paradoksit, hiperbolës, homotiptonit, *concetto* – ja italiane (lojës grafike me fjalët sipas ngjashmërisë midis dukurive dhe sendeve të ndryshme) është e rregullt, metaforës së llojllojshme (emërore, mbiemërore, përemërore, ndajfoljore), metonimisë, paragmenonit, paralelizmit sintaksor, poliptitonit, epitetit emfatik, anaforës, epiforës, simbolit, sidomos sinalefës (sipas parimit të identitetit, ngjashmërisë e kundërshtisë) dhe ekstravagancat e tjera figurative. Alegoria dhe simboli i Rilindjes fitojnë kuptim të ri dhe krejtësisht tjetër.

Ngjashmëri hasen edhe në *versifikacion*. Zakonisht përdoret vargu strofik katër- ose gjashtëvargësh në tetërrokësh dhe shumë rrallë njëmbëdhjetërrokëshi strofik. Është theksuar nga studiuesit tanë I.

Rugova, R. Ismajli, E. Sedaj, S. Hamiti, Z. Rrahmani e të tjerë (Rugova: 173; Sedaj: 33 - 34) se vargu katren, sekstin ose strofa tetëvargëshe kanë strukturë të rregullt trokaike. Vargu katren me rimë simetrike ose asonancë del me strukturë ABAB, ai sekstin ABABCC, ndërsa ai tetësh simetrik ose jo që e përdor Bogdani del me strukturë ABABABCC. Rima zakonisht del e puthur ose e kryqëzuar. Budi me përpikmëri përdor tetërrokëshin me strofë të rregullt katërshe dhe me rimë të kryqëzuar, po ashtu edhe Lukë Suma e Lukë Bogdani, deri diku edhe Pjetër Bogdani. Po kështu edhe autori anonim i vjershës arbëreshe të Siçilisë, përdor 11-rrokëshin me strofë katërshe (Shuteriqi: 92).

Në *rrafshin leksikor* afritë janë në shprehshmëri, sepse përdoren shprehje të jetës kishtare që lidhen me temat dhe motivet që trajtohen. Kryesisht përdoren ato shprehje që kanë lidhshmëri konotive me figuracionin poetik kishtar. Ngjyrimi i shprehjes, pra, kushtëzohet nga figuracioni që përdoret për përshkrimin e temës a të motivit. Mbizotërojnë shprehjet me konotim të errësirës, natës, pesimizmit, depresionit, frikës, habisë (zia, e keqja, shëmtimi, ferri, helmi, mjerimi, vajtimi).

Është e vërtetë dhe është vështirë të mendosh ta barazosh një letërsi të tipit të Budit e Bogdanit me bashkëkohanikët e afërt evropianë (Shekspirin, Servantesin ose Rableun). Por nëse nuk mund të nivelizohet me ta, atëherë nuk mund të mohohet fakti se ajo mund të përafrohet lehtë dhe të ketë pikëtakime me Lope de Vegën, Xhon Miltonin, Xhirolamo Vidin, Torkuato Tason dhe me bashkëkohanikë të tjerë të tyre në letërsitë e tyre dhe në letërsitë e popujve të tjerë që nuk u përmendën këtu. Fjala është për tipin e Barokut religjioz, të cilin e njohin të gjithë popujt e Evropës dhe e kanë të pranishëm në letërsitë e tyre.

Dihet se donator i veprave të Budit, Bardhit e Bogdanit ka qenë Kisha. Meqë është kështu atëherë edhe prej tyre nuk pritet t'i mohojnë parimet dhe kërkesat e Përtëritjes Katolike, por përkundrazi t'i zbatojnë dhe t'i afirmojnë. Kështu edhe veprat e tyre janë ngushtësisht të lidhura me përhapjen dhe propagandimin e të vërtetës së krishterë, të cilës edhe i kanë shërbyer.

Vjershat e Budit në *Doktrinë* janë në përputhshmëri të plotë me kërkesat letrare të Barokut religjioz, njësoj si janë vjershat dhe prozat

e Bogdanit. Në të dyja këto vepra është i mbitheksuar roli i Krishtit në historinë e krishterimit, që është kërkesa themelore e Përtëritjes Katolike. Por cilat pjesë të jetës së tij dhe cilat pjesë biblike kanë qenë më të avansuara, jo vetëm te këta dy autorë, por edhe te Buzuku ose Matranga përpara tyre. Sa për ilustrim mund të bëjmë një krahasim brenda letërsisë shqipe. Aty afër, gati njëqind vjet prapa edhe Jul Variboba krijon një vepër letrare, po kështu në vargje dhe po kështu të vëna në shërbim të afirmimit të të vërtetave të krishtera. Buzuku, Budi, Bogdani përshkruajnë pjesët e fundit të jetës së Krishtit: kryqëzimin, ringjalljen, fanitjen dhe vajin e shën Mërisë e të dishepujve për të. Te Variboba çështja qëndron ndryshe: ai përshkruan pjesët e lindjes, të fëminisë e të rinisë së Krishtit dhe këtë e vendos në korelacion me përjetimin poetik *të lutjes*, sepse ky i përkiste një periudhe tjetër letrare edhe brenda letërsisë së krishterë. Budi, për shembull, edhe kur përshkruan krijimin e Adamit dhe të Evës, nuk flet për jetën e tyre në parajsë, por përshkruan pjesën e jetës së tyre pas rënies në mëkat. Pastaj në *këngën e nëntë*, ku duhej ta përshkruajë lindjen e Krishtit, nëpër këtë motiv kalon shumë shpejt, duke përdorur vetëm një varg "*Drita iote kur leu / Gjithë qielltë i ndriti* (Budi: 157)", sepse nxiton t'i përshkruajë në hollësira mundimet e tij fizike gjatë kryqëzimit. Në këngët e sibilave, Bogdani, nuk përshkruan lindjen e Krishtit, por himnizon ardhjen e tij, kurse pjesën e historisë së fëminisë së tij e jep nga perspektiva përshkrimore e këndrrëfimit të shën Mërisë. Ndërkaq, në pjesën e dytë të veprës së Bogdanit, jepen pjesët biblike të fundit të jetës së Krishtit, duke i përshkruar përmes vajit të shën Mërisë për humbjen e tij dhe, kështu fuqizon paaftësinë e besimtarit të matet me të Birin e Zotit. Këtë ai e bën, sepse ishte kërkesë e kohës: përshkrimi i zymtësisë, i vdekjes, i errësirës, i të keqes tokësore, meqë e keqja tokësore në përshkrimin emblematik të Barokut, përgjithësisht dhe sidomos të atij religjioz ishte kërkesë e domosdoshme. Kjo bëhej për ta afirmuar jetën e pasvarrit, njësoj si në letërsinë e Mesjetës.

Një grup studiuesish shqiptarë janë të bindur se mendimi teorik letrar është ai i viteve të '50 – '60 të shekullit njëzetë, kur studimet shqiptare ishin në fazën e ndërtimit dhe të konsolidimit të tyre. Sipas kësaj edhe periodizimi letrar shqiptar duhet të mbetet në atë shkallë dhe në atë kohë. Harrohet se ashtu si ka ecur studimi teorik letrar

botëror, ka hapëruar edhe ai shqiptar dhe në këtë kontekst është e nevojshme që edhe periodizimi letrar shqiptar duhet t'i nënshtrohet kritereve të njëjta të studimit, sepse edhe ai ka lindur dhe është formësuar në rrethana në mos të njëjta, atëherë të ngjashme historike politike dhe shoqërore kulturore estetike. Në mosnjohje të këtyre faktorëve historikë letrarë, në studimet tona teorike, bëhen keqinterpretime, rrëshqitje terminologjike dhe natyrisht edhe gabime semantike. Pra, nuk është fjala as për vazhdimësi të Humanizmit, as për Neoklerikalizëm ose Neokrishtenizëm, as për letërsi "të vjetër" (klasike), por për një periudhë letrare, të cilën të gjithë popujt evropianë e njohin dhe e pranojnë për letërsitë e tyre, kurse ne në vend që ta pranojmë si të tillë, për inat shpikim llojlloj termash të çuditshëm, të cilët nuk përkojnë me realitetin letrar.

9. Kumtesa mëton ta shtrojë në diskutim çështjen e emërtimit dhe të sistemimit të periudhës nismëtare të letërsisë shqipe, e cila identifikohet me shekujt XVI – XVII. Janë marrë në shqyrtim të gjitha modelet e deritanishme të kritereve të sistemimit të saj, që ka pasur mundësi t'i sigurojë autori. Mbështetur në faktorët e afrisë dhe pikëtakimeve të prodhimit letrar shqiptar me atë evroperëndimor në rrafshin tematik, motivor, strukturor – kompozicional, metrikor, leksikor, semantik dhe figurativ stilistik nënvizohet, përthekohet dhe vërtetohet se kjo periudhë e letërsisë shqipe duhet të quhet ***letërsi e Barokut***, njësoj si e quajnë edhe letërsitë e popujve të tjerë evropianë.

Aty, gjithashtu argumentohet se asnjëri nga kriteret e deritanishëm të periodizimit të kësaj periudhe të letërsisë shqipe, si ai rajonal – krahinor, gjuhësor dialektor e etnologjik, konfesional – ideologjik nuk tregohet i plotë dhe shkencërisht i argumentuar, sepse mbështeten në faktorë të jashtëm, përveç atij tematik përmbajtjesor, i cili mbështetet vetëm në dy faktorë të brendshëm të letërsisë, por meqë nuk përfillen aspektet e tjera (stilistik e kompozicional, si dhe ai motivor) që nxisin jetesën dhe funksionimin e formave letrare, mbetet të mos jetë i përshtatshëm. Ndaj kjo periudhë e letërsisë shqiptare, në qoftë se i nënshtrohet performansës së artit letrar periodizimin dhe sistemimin e vet duhet t'ia nënshtrojë kritereve më të zbatuara në letërsitë e tjera, dhe të sistemohet e të emërtohet me terma të përshtatshëm për të.

Me këtë mënyrë të sistemimit, të periodizimit dhe të emërtimit të prodhimit letrar shqip, historia e letërsisë shqiptare i shmanget konfuzionit që është krijuar në praktikën e deritanishme historiografike letrare dhe përafrohet me konceptet e shkencës së letërsisë dhe me metodologjinë bashkëkohëse të studimit të saj, të zbatuar praktikisht edhe në letërsitë e popujve të tjerë.

Literatura:

1. Budi, Pjetër (1986), *Poezi (1618 – 1621)*, Prishtinë.
2. Curtius, Ernst Robert (1971), *Evropska književnost i latinsko srednjovjekovlje*, Zagreb.
3. Çabej, Eqrem (1936), *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe,* me pjesë të zgjedhura për shkollat e mesme, Tiranë.
4. Elsie, Robert (2001), *Histori e letërsisë shqiptare*, Prishtinë.
5. Fišta, Filip (1931), "Istorija albanske književnosti", *Misao*, Beograd, knj. 36, sv. 1-2, 1931, 56-69; knj. 36, sv. 3-4, 1931, 215-229; knj. 36, sv. 5-8, 1931, 433-443; knj.37, sv. 1-2, 1931, 74-81; knj. 37, sv. 3-4, 1931, 212-227; knj. 38, sv. 5-6, 1931, 349-369; knj. 38, sv. 7-8, 1931, 456-472.
6. Fishta, Filip (1940), "Për nji pjesëtim mâ të drejtë të letratyrës s`onë", *Shkëndija,* Tiranë 1940, nr. 3, 12-16.
7. Flaker, Aleksandar (1977), *Stilske formacije*, Liber, Zagreb.
8. Frankashtel, *Baroque et classicizme*, 146
9. Giljen, Klaudio (1982), *Književnost kao sistem*, Nolit, Beograd.
10. Grup autorësh, *Historia e letërsisë shqiptare 1,* për shkollat e mesme të përgjithshme, Tiranë 1973 dhe 1985. Deri më 1990 do të përjetojë disa ribotime.
11. Hamiti, Sabri (1986), "Kodet e mëdha të letërsisë shqipe", *Fjala*, Prishtinë, 19/1986, 2(15 janar), 8-9.
12. Hamiti, Sabri (1989), *Vetëdija letrare*. (*Sprova për një Poetikë*) 4, Rilindja, Prishtinë, 9-42.
13. x x x (1984, 1985, 1989), *Historia e letërsisë botërore* 2, 7, 5, Prishtinë.
14. Hysa, Mahmud (1992, 1994), *Autorë dhe tekste nga letërsia e vjetër shqiptare I, II*, Shkup.
15. Hysa, Mahmud (2000), *Hyrje në letërsinë shqipe*, Prishtinë.
16. Hysa, Mahmud (1987), *Krestomaci e letërsisë së vjetër shqiptare,* Prishtinë.
17. Hysa, Mahmud (1986), "Tri pyetje kontestuese nga letërsia e vjetër", *Fjala*, Prishtinë, 1 maj 1986, 8-9.
18. Ismajli, Rexhep (2000), *Tekste të vjetra*, Prishtinë.
19. Jauss, Hans Robert (1978), *Estetika recepcije*, Beograd.
20. Jauss, Hans Robert (1970), *Teorija rodova i književnost srednjega vijeka*, "Umjetnost riječi", Zagreb, 14/1970, 3, 327 – 352;
21. Lacaj, Henrik (1971), "Pjetër Budi vjershëtor i parë i letërsisë sonë", *Probleme të historisë së gjuhës shqipe*, Prishtinë: 437-446.
22. Lešić, Zdenko (1985), "Književni žanr kao tonalitet", *Književnost i njena istorija*, Veselin Masleša, Sarajevo: 122 - 123.

23. Levi – Stros, Klod (1973), *Divlja misao*, Nolit, Beograd, 1973.
24. Martini, Friz (1978), *Istorija nemačke književnosti*, Nolit, Beograd.
25. Pavličić, Pavao (1985), *Književna genologija*, Liber, Zagreb.
26. Petrović, Svetozar (1972), *Priroda kritike*, Liber, Zagreb.
27. Petrotta, Gaetano (1931), *Popolo, lingua e letteratura*, Palermo.
28. Pirjevec, D. (1981), *Strukturalna poetika, kibernetika, komunikacija, informacija*, Zagreb.
29. Pođoli, Renato (1979), *Teorija avangardne umjetnosti*, Nolit, Beograd.
30. *Rečnik književnih termina*, Beograd, 1985,
31. Ressuli, Namik (1940), "Përsëri mi pjesëtimin e historisë së letërsisë shqipe", *Shkëndija,* Tiranë, 1940, nr.6, 23-28.
32. Ressuli, Namik (mbledhë e redaktue)(1941), *Shkrimtarët shqiptarë*, Pjesa I. (1462-1878), Tiranë.
33. Rugova, Ibrahim (1982), *Vepra e Bogdanit*. Rilindja, Prishtinë.
34. Rrota, Justin (1925), *Letratyra shqipe,* Shkodër.
35. Sedaj, Engjëll (1990), *Poezitë origjinale e të përkthyera të Pjetër Bogdanit*. *"Studime filologjike"*, Tiranë, XIIV (XXVII), 1.
36. Slamnig, Ivan (1973), *Svjetska književnost zapadnoga kruga.* Zagreb.
37. Škiljan, Dubravko (1979), *Osnove semiologije komunikacije*, Zagreb.
38. Škreb, Zdenko (1965), *Periodizacija – kamen smutnje*, "Umjetnost riječi", Zagreb, IX/1965, 4, 255 – 264.
39. Škreb, Zdenko (1981), "Sastavine stilskih formacija: O stilskim kompleksima", *Književnost i povijesni svijet*, Školska knjiga.
40. Shkreb, Zdenko (1984), *Pandashmëria e shkencës së letërsisë*, "Jehona", Shkup, XXII/1984, 9 – 10, 34 – 40.
41. Shuteriqi, Dhimitër S. (1955), *Histori e letërsisë shqipe*, doracak për shkollat e mesme, Tiranë.
42. Shuteriqi, Dhimitër S. (1978), *Shkrimet shqipe 1332-1850*, Rilindja, Prishtinë.
43. Velek, Rene – Voren Ostin (1985), *Teoria e letërsisë*, Prishtinë.
44. Xhiku, Ali (2003), *Duke lexuar letërsinë e traditës*, Dituria, Tiranë: 12 – 22; 23 – 41; 47 – 50.

Irena SAWICKA

STUDIME FILOLOGJIKE ALBANOLOGJIKE NË POLONI

Në parim studimet filologjike albanologjike në Poloni mund të ndahen në dy epoka shumë të vobekta: periudha e Cimochowskit dhe periudha pas tij. I ndan këto dy epoka një kufi i madh kohor dhe cilësor.

Në arritjet e albanologjisë polake vendin kryesor e zënë punimet e historianëve. Përsa i përket filologjisë, arritja më e madhe është analiza nga sfera e fonetikës historike dhe e etimologjisë të Waclaw Cimochowskit. Kjo pasuri shkencore njihet mirë dhe në vitet e fundit është trajtuar disa herë, midis të tjerash edhe këtu në Prishtinë. Për këtë arsye, unë nuk do të flas për atë. Ky drejtim i studimeve gjuhësore vazhdon edhe sot e kësaj dite në Poloni. Studiuesi i gjuhëve indoevropiane Leszek Bednarczuk shfrytëzon materialin shqiptar në punimet që u kushtohen çështjeve indoevropiane, si dhe është autor i një studimi të veçantë për zhvillimin e sonanteve në gjuhën shqipe. Arritje albanologjike ka edhe indoevropianisti tjetër polak Krzysztof Witczak, i cili është përkrahës i prejardhjes së shqiptarëve nga fisi ballkanas i besëve, që sipas tij nuk është i njëjtë me trakët. Prejardhjen nga Besët Witczak e vërteton në bazë të disa rrënjë fjalësh që përcaktojnë bimët.

Në përgjithësi punimet albanologjike polake janë relativisht të pakta. Kjo ka lidhje me faktin që deri më tani në Poloni nuk ka pasur studime albanologjike. Materiali shqiptar shumë rrallë ka qenë në qendër të studimeve të filologëve të specialiteteve të tjera. Kur Waclaw Cimochowski tre dhjetë vjet më parë shkroi tekstin „Albanologjia në Poloni“[1], mundi të shkruante vetëm për studimet e tij. Vetëm fillimi i seminareve verore për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare në gjysmën e viteve shtatëdhjetë në Prishtinë u mundësoi filologëve polakë njohjen me problemet e gjuhës shqipe.

[1] Albanologia w Polsce. (Dotychczasowy dorobek badań nad językiem i literaturą albańską), [në:] Bałkanistyka polska, 1974, Wrocław, f. 31-38.

Falë këtij kontakti u botuan disa artikuj për shqipen bashkëkohore (për shembull artikulli i Witold Stefanskit për habitoren e shqipes, apo artikulli i Zdzisław Wąsik për strukturën e pyetjes në gjuhën shqipe). Më gjerë me gjuhën shqipe merren sllavistët, si diçka anësore e studimeve sllavistike dhe ballkanologjike. Kryesoret nga këto janë Jolanta Mindak dhe Irena Sawicka. Jolanta Mindak merret me sintaksën funksionale. Interesohet për çështje albanologjike që kanë të bëjnë kryesisht me semantikën e frazës verbale, në veçanti funksionit të formave verbale. Nga kjo fushë ka publikuar disa artikuj, ku materiali shqiptar është gjuha kryesore e studimeve, ose është material i barasvlershëm. Siç përmenda më lart, më së shumti Jolanta Mindak analizon problemet e frazës verbale, sidomos të kategorisë së temporalitetit dhe modalitetit, duke trajtuar funksionet e formave verbale: e kryera e thjeshtë dhe habitorja. Ajo i analizon edhe nga ana tjetër, pra jo nga forma tek funksioni, por edhe nga funksioni tek forma - nga kjo fushë para së gjithash merret me kategorinë e kohës dhe me modalitetin, midis të tjerave shqyrton shprehjet që shprehin pasigurinë, evidencialitetin, mohimin, aspektin, diatezën etj. Kryesisht kjo tematikë trajtohet në mënyrë krahasuese me gjuhët e tjera ballkanike. Jolanta Mindak ka shkruar gjithashtu disa artikuj që kanë të bëjnë me problemet e lidhura me morfologjinë dhe fjalëformimin, si dhe artikuj informativ me karakter të përgjithshëm, që karakterizojnë në mënyrë të shkurtër sistemin gramatik të shqipes. Gjithashtu është bashkautore e gramatikës së gjuhës shqipe.

Punimet e Irena Sawickës kryesisht kanë të bëjnë me fonetikën dhe në shumicën e rasteve e trajtojnë shqipen, duke e krahasuar atë me gjuhët e tjera të Evropës Juglindore. Temat kryesore të punimeve të saj janë: struktura e rrokjes dhe funksionimi i grupeve *nd*, *ng*, *mb* dhe vendi i fonetikës shqipe në arealin gjeografiko-linguistik të Evropës Juglindore. Irena Sawicka është gjithashtu bashkautore e gramatikës shqipe të përmendur më lart, autore e librit për lakimin në shqip, autore e disa punimeve për prozodinë shqiptare, e disa artikujve që karakterizojnë fonetikën ballkanike në mënyrë të përgjithshme, e disa artikujve informativë për shqipen, si dhe e artikujve që kanë të bëjnë me çështje të tjera fonetike dhe sintaksore të gjuhës shqipe. Si Jolanta Mindak, ashtu dhe Irena Sawicka trajtojnë çështje gramatike në gjuhën letrare si dhe në dialekte (sidomos arbëresh dhe i Kosovës). Të

dyja autoret në vitet nëntëdhjetë të shekullit të kaluar janë marrë me publicistikë të çështjeve shqiptare, sidomos kosovare.

Me fonetikë merret gjithashtu edhe Anna Korytowska, e cila ka publikuar tre artikuj nga kjo fushë.

Tetë vjet më parë në Universitetin Nikola Kopernik u hap dega e filologjisë ballkanike, ku gjuha shqipe është gjuhë kryesore. Janë studentët e parë që kanë mbaruar këto studime, shumë më mirë të arsimuar në degën e ballkanistikës dhe që e njohin shumë më mirë shqipen. Tre nga ata vazhdojnë studimet për doktoratë nga gjuhësia shqipe, gjë që jep shpresë per krijimin e punimeve serioze albanologjike në Poloni. Dy nga këto punime shqyrtojnë fenomenet e morfosintaksës, njëri fonetikën e Kosovës.

Shumë më modest paraqitet studimi i letërsisë shqiptare në Poloni. Kjo ka lidhje me pamundësinë për të gjetur në gjuhën polake tekste të letërsisë shqipe. Ka pak përkthime nga shqipja. Vetëm disa vite më parë në tregun translatorik u shfaq Dorota Horodyska - përkthyesi i parë kompetent i letërsisë shqipe. Ajo përkthen prozën bashkëkohore. Më parë kemi pasur ndonjë përkthim të prozës së realizmit socialist, disa përkthime të Kadares nga gjuha frënge dhe disa përkthime të poezisë, autor i të cilave në shumicën e rasteve ka qenë Mazllum Saneja.

Dorota Horodyska gjithashtu publikon në shtypin polak ese dhe kritikë për letërsinë bashkëkohore shqiptare, sidomos për jetën letrare në Shqipëri pas rënies së komunizmit.

Në fjalorët enciklopedikë polakë autorë të shumicës së artikujve nga fusha e letërsisë shqipe janë: Wacław Cimochowski, Irena Sawicka dhe Robert Elsie. Historia e letërsisë shqipe e këtij të fundit gjithashtu është përkthyer në gjuhën polake.

Siç përmenda më lart, arritjet më të mëdha albanologjike në Poloni i kanë historianët dhe politologët. Përveç punimeve tipike historike, ata merren edhe me çështje të kulturës shqiptare - nga kjo fushë tani krijohen shumë punime me vlerë. Mes të tjerash shumë punime u kushtohen çështjeve fetare dhe lidhjeve të tyre me kulturën dhe letërsinë shqipe, si për shembull artikulli i Wojciech Szczepanskit për rolin e katolicizmit në zhvillimin e kulturës shqiptare: (*Rëndësia e katolicizmit për Rilindjen Kombëtare të shqiptarëve dhe ndërtimin nga*

ata të shtetit të tyre (gjysma e dytë e shekulli të nëntëmbëdhjetë - fillimi i shekullit të njëzet)[2].

Gjatë njëzet viteve të fundit Shqipëria është shfaqur në mënyrë shumë intensive në publicistikën polake. Kjo u shkaktua nga ngjarjet politike - ndërrimi i sistemit në Shqipëri, ngjarjet tragjike në Kosovë si dhe angazhimi i Polonisë në problemin e sigurisë në Evropë. Në këtë mënyrë problematika shqiptare më në fund hyri në sferën e interesimit botëror, kështu dhe të Polonisë. Në shtypin polak filluan të dalin artikuj për çështje shqiptare nga fusha të ndryshme, nga ata që relacionononin ngjarjet politike aktuale, me materiale që paraqisnin historinë e konflikteve, deri tek artikuj seriozë për kulturën shqiptare. Mund të thuhet, se vitet e fundit janë një shpërthim përsa i përket interesimit për kulturën shqiptare, që sigurisht ka lidhje me faktin, që Shqipëria dhe Kosova deri tani ishin tokë e panjohur për gati të gjithë polakët.

Duhet theksuar se edhe para periudhës së izolimit total të Shqipërisë - është fjala për vitet gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë të shekullit të njëzet - për kulturën shqiptare dihej fare pak në Poloni. Por janë botuar pak artikuj për këtë çështje në shtypin e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe gjysmës së parë të shekullit të njëzet. Bibliografia e plotë e studimeve polake nga fusha e letërsisë, historisë dhe kulturës shqiptare u botua në librin *Albanologjia polake* nga viti 2007[3].

Shqiptari i vetëm i njohur përpara ishte sigurisht Skënderbeu, figura e të cilit u shfaq në periudha të ndryshme të letërsisë polake. Funksionoi ai në letërsinë polake si simbol i luftëtarit që lufton për fenë e krishterë. Veprat polake për Skënderbeun deri në shekullin e tetëmbëdhjetë i ka trajtuar shumë Ilona Czamanjska në artikullin: *Skënderbeu - simbol i luftëtarit katolik në shoqërinë e vjetër polake* (në: Balcanica Posnaniensia IX/X, Poznań 1999)[4]. Pastaj Skënderbeu u bë personifikim romantik i patriotit dhe si i tillë u shfaq në

---

[2] Znaczenie katolicyzmu dla Odrodzenia Narodowego Albańczyków i budowy przez nich własnego państwa (druga połowa XIX – początek XX w.), në: Studia z dziejów Rosji i Europy środkowo-wschodniej XLII, f. 5-15.

[3] *Albanistyka polska*, Toruń 2007.

[4] *Skanderbeg – symbol rycerza chrześcijańskiego w społeczeństwie staropolskim,* (në: Balcanica Posnaniensia 1999).

beletristikën romantike polake (Teresa Papi, *Princi i maleve*, Kraków 1899, Teodor Jeż, *Për ekzistencë*, Lwów 1903)[5].

Siç përmenda, aktualisht në Torunj dy vite kanë mbaruar studimet filologjike nga fusha e ballkanologjisë ku shqipja është gjuhë kryesore. Janë këta filologët e parë të arsimuar në Poloni me kompetenca albanologjike, të cilët kanë shans të vazhdojnë punën e Waclaw Cimochowskit dhe të fillojnë studimin e letërsisë shqipe. Gjuhën shqipe e studiojnë edhe tre vite të tjera. Gjithsej tani janë afërsisht 80 persona nga Universiteti Nikola Koperniku, profesioni i të cilëve është ose do të jetë filologjia shqipe.

[5] Teresa Papi *Książę gór*, Kraków 1899, Teodor Jeż, *O byt*, Lwów 1903.

Punime linguistike albanologjike e autorëve polake

Leszek Bednarczuk

- 1982, Rozwój indoeuropejskich sonantów zgłoskotwórczych w bałto-słowiańskim i albańskim, [në:] Z polskich studiów slawistycznych: Językoznawstwo, VI, 43-49
- 1983, On the development of Indo-European syllabic sonants in Balto-Slavic and Albanian, Studia Albanica, XX/2, 89-95
- 1984, Starożytne języki Bałkanów, Balcanica Posnaniensia I, Poznań, 21-37
- 1986, On the development of Indo-European syllabic sonants in Balto-Slavic and Albanian, Acta Baltico-Slavica, XVII, 77-83
- 1986, Indoeuropejskie języki Bałkanów, [në:] Języki indoeuropejskie I, PWN, Warszawa, 469-513
- 1987, Albanian and other Indo-European languages, [në:] Sprach- und Kulturkontakte im Polnischen, (Gesammelte Aufsätze für A. de Vincenz zum 65. Geburstag), 9-15
- 1996, Les rapprochements structurels entre l'albanais et les langues romanes, [në:] Munus Amicitiae (in honorem W. Mańczak), Kraków, 1-9
- 1997, On certain Balkan isogrammatisms in Albanian, [në:] Balkanistica, X (Studies dedicated to the memory of Zbigniew Gołąb), 46-54

Wacław Cimochowski

- 1949, Dwie etymologie albańskie, Lingua Posnaniensis I, 165-188
- 1950, Recherches sur l'histoire du sandhi dans la langue albanaise, Lingua Posnaniensis II, 220-255
- 1950, Alb. *i mbarë*, Lingua Posnaniensis II, 319-322
- 1951, Le dialect de Dushmani. Description de l'un des parlers de l'Albanie du nord, Poznańskie Tow, Przyjaciół Nauk, Prace Komisji Filologicznej, v. XIV, Poznań, pp. 233
- Albanische Etymologien, Lingua Posnaniensis III, 156-168
- 1953, Zur albanischen Wortforschung, Lingua Posnaniensis IV, 189-210
- 1955, (rec.) Max Lambertz, Lehrgang des Albanischen, I Teil: Albanisch-deutsches Wörterbuch, Berlin 1954, Lingua Posnaniensis V, 189-195

- 1958, Prejardhja e gjuhës shqipe, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Shkenc. Shoq. II, 37-53
- 1959, (rec.) D. Detschev, Die thrakischen Sprachreste, Wien 1957, Lingua Posnaniensis VII, 280-284
- 1960, Des recherches sur la toponomastique de l'Albanie, Lingua Posnaniensis VIII, 133-145
- 1961, Albania, [në:] Słownik starożytności słowiańskich, v.I, 11-13
- 1961, Albańczycy, [në:] Słownik starożytności słowiańskich, v.I, 13-16
- 1961, Albańsko-słowiańskie stosunki językowe, [në:] Słownik starożytności słowiańskich, v.I, 16-19
- 1966, Etymologische Miszellen, Acta Baltico-Slavica III, 37-42
- 1968, (rec.) Idriz Ajeti, Istorijski razvitaj gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo 1961, Lingua Posnaniensis XII/XIII, 176-184
- 1972, (rec.) Claus Haebler, Grammatik der albanischen Mundart von Salamis, Wiesbaden 1965, Lingua Posnaniensis XVI, 111-117
- 1973, Die sprachliche Stellung des Balkanillyrischen im Kreise der indogermanischen Sprachen, Studia Albanica X, 1, Tirana, 137-153
- 1973, Pozicioni gjuhësor i ilirishtes Ballkanike në rrethin e gjuhëve indoevropiane, Studime Filologjike XXVII, 2, Tirana, 29-48
- 1974, Albanologia w Polsce. (Dotychczasowy dorobek badań nad językiem i literaturą albańską), [në:] Bałkanistyka polska, Wrocław 31-38
- 1974, Die albanischen Praesensbildungen auf *–iō* und *–niō*, [në:] Studia indoeuropejskie. In honorem J. Safarewicz, Kraków, 43-48
- 1975, Stanowisko języka Ilirów bałkańskich w indoeuropejskiej rodzinie językowej, Lingua Posnaniensis XVIII, 9-28
- 1977, Die Albanologie in Polen, [në:] Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums zum Gedächtnis an Univ. – Dr Norbert Jokl, Innsbruck, 28 September bis 3, October, Innsbruck, 96-99
- 1987, Język albański, Acta Baltico-Slavica XVII, 17-68
- 1988, Gjuha shqipe, Rilindja, Prishtina, pp.102
- 2004, Për gjuhën shqipe, Prishtina, pp.469

Jan Hanusz

- L'albanais en Apulie, [në:] Mémoires de la société de linguistique de Paris, VI, 263-267

Anna Korytowska

- 2004, Two „new" phonetic balkanisms, [në:] Studia Albanica. In honorem Wacław Cimochowski, (bashkautore Irena Sawicka), Toruń, 147-153
- 2004, Sekwencje wokaliczne w języku albańskim, Slavia Meridionalis 4, 249-261
- Z problemów sandhi w języku albańskim, Linguistica Copernicana, në shtyp
- Sandhi në gjuhën letrare shqipe në Kosovë, Gjurmime albanologjoke, në shtyp

Kamila Liberacka

- Reduplikacion i kundrinorit në shqipen, Gjurmime albanologjike, në shtyp

Jolanta Mindak

- 1982, Mbi disa mjete gjuhësore për të shprehur kuptimin e pasigurisë dhe të habisë në konstruktet foljore të gjuhës shqipe dhe të gjuhës maqedone, [në:] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 7, Prishtinë, 229-234
- 1983, Zależności gramatyczno-kategorialne między elementami prostych wypowiedzeń w polszczyźnie i językach bałkańskich, Studia Linguistica Polono-Jugoslavica 3, Sarajevo, 79-85
- 1984, Nomina essendi në gjuhën shqipe, [në:] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 9, Prishtinë, 139-142
- 1984, Remarques sur l'information aspectuelle dans l'énoncé albanais, bulgare, macédonien, néo-grec et polonais (rezime), Cinqième Congrès International d'Études du Sud-Est Européen. Linguistique. Résumés, Beograd, 17
- 1985/1986, Sprawozdanie z przebiegu V Kongresu bałkanologicznego w Belgradzie 11-17. 09. 1984 (bashkautore Irena Sawicka), Biuletyn Slawistyczny X/XI, 102-106
- 1985, Për kategorinë e kohës dhe të aspektit në gjuhën shqipe, [në:] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 10, Prishtinë, 49-55
- 1986, Uwagi o aoryście bałkańskim (jako nośniku treści aspektowych), [në:] Językowe studia bałkanistyczne I, Ossolineum, 87-98
- 1987, O albańskim admiratiwie, Acta Baltico-Slavica XVII, 153-161

- 1988, Морфосинтаксички западномакедонско-албански паралели, Македонски јазик XXXVIII-XXXIX, 151-163
- 1990, O wyrażaniu neutralności rodzajowej w językach bałkańskich na tle romańskim i słowiańskim, [në:] Językowe studia bałkanistyczne II, Ossolineum, 87-112
- 1992, Pogranicze albańsko-macedońskie jako przykład strefy wzajemnego oddziaływania systemów gramatycznych języków bliżej niespokrewnionych, [në:] Słowiańskie pogranicza językowe, Slawistyczny Ośrodek Wydawniczy PAN, Warszawa 95-102
- 1992, Wskazówki dla korzystających ze słownika – Shënime mbi përdorimin e fjalorit, [në:] M. Jeziorski, J. Wiśniewski, Słownik minimum albańsko-polski i polsko-albański, Wiedza Powszechna, 13-15, 143-145
- 1993, Język Albańczyków w diasporze włoskiej, [në:] Balcanica Posnaniensia VI, Wydawnictwo UAM, 335-344
- 1993, Zarys gramatyki języka albańskiego, SOW, Warszawa, pp. 156 (bashkautore Irena Sawicka)
- 1994, Conservation d'aoriste balkanique – un grécisme morphosyntaxique?, [në:] Septième Congrès International d'Études du Sud-Est Européen. Communications. Athènes, 62
- 1994, Quelques remarques sur l'organisation diathétiques des énoncés macédoniens et albanis (dans le contexte linguistique balkanique et néo-latin), Slavia Meridionalis I, 123-138
- 1995, Partykuły negacji a bałkanistyczna typologia dialektalna, Македонски јазик XL-XLI, 327-330
- 1995, Le verbe albanais, [në:] Analecta Indoeuropaea Crakoviensia Ioannis Safarewicz memoriae dicata, Kraków, 257-261
- 1995, Për zhvillimin e morfosintaksës së shqipes, [në:] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 17, Prishtinë, 227-231

Irena Sawicka

- 1976, Problemy albańskiej wymowy literackiej na Kosowie, Biuletyn Polskiego Towarzystwa Językoznawczego, XXXIV, 135-142
- 1983, Użycie czasowników "być" i "mieć" w zdaniach lokatywnych w polskim, serbsko-chorwackim i albańskim, Studia Linguistica Polono-Jugoslavica 3, Sarajevo, 143-151

- 1983, Tipi i sandhit në shqipen letrare në Kosovë, [në:] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 8, Prishtinë, 169-175
- 1983, (rec.) S. Riza, Studime albanistike, Prishtine 1979 - Studia linguistica Vratislaviensia VIII, 104-108
- 1984, Edhe një herë për grupet e bashkëtingëlloreve të tipit nazal+okluziv në gjuhën shqipe, Gjurmime albanologjike, seria filologjike XIII, Prishtina, 79-92
- 1985/1986, Sprawozdanie z przebiegu V Kongresu bałkanologicznego w Belgradzie 11-17.09.1984 (bashkautore Jolanta Mindak), Biuletyn Slawistyczny X/XI, 102-106
- 1986, The syllable structure of Albanian against the Balto-Slavic background, Acta Balto-Slavica XVII, 185-193
- 1986, The problem of the Albanian nasal+stop clusters, [në:] Językowe studia bałkanistyczne I, Ossolineum, 109-119
- 1986, Struktura sloga u balkanskim jezicima, Ossolineum, pp. 122
- 1986, (rec.) B. Bokshi, Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes, Prishtinë 1980 - Acta Balto-Slavica XVII, 393-400
- 1987, Dystrybucja spółgłosek i struktura sylaby w językach bałkańskich, Studia Polono-Jugoslavica, 191-203
- 1988, Theksi në shqipën, [në:] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsine dhe kulturën shqiptarë 13, Prishtinë, 113-118
- 1989, Veçorite tipologjike fonetike të arberishtës së Italisë, [në:] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare XIV, Prishtinë, 33-43
- 1989, Prenasalization of occlusives in Southern Slavonic (rezime), [në:] Sixieme congres international d'etudes du sudest europeen, Sofia 30 aout - 6 septembre 1989, p. 160
- 1990, Bałkańsko-romańskie paralele w zakresie syntagmatyki fonologicznej (bashkautor Jacek Perlin), [në:] Językowe studia bałkanistyczne II, Ossolineum, 123-144
- 1990, Czy istnieja balkanizmy fonetyczne? (bashkautore Alina Petrowa), [në:] Językowe studia bałkanistyczne II, Ossolineum, 145-152
- 1991, Phonetic Balkanisms in Italo-Albanian, [në:] Atti del Congresso Internazionaledi studii sulla lingua, la storia e la cultura degli Albanesi d'Italia, Mannheim 25-26 Giugno 1987, Cosenza, 241-251

- 1991, Is there a Mediterranean phonotactic community? (bashkautor Jacek Perlin), [në:] Studies in the phonetic typology of the Slavic languages, SOW, Warszawa, 51-63
- 1991, The problem of the prenasalization of stops in Southern Slavic, [në:] Studies in the phonetic typology of the Slavic languages, SOW, Warszawa, 113-125
- 1992, Specyfika fonetyki albańsko-włoskiej, Balcanica Posnaniensia VI, 241-245
- 1992, Fonetyczne związki słowiańsko-bałkańskie, [në:] Z polskich studiów slawistycznych VIII, Językoznawstwo, 231-234
- 1993, Zarys gramatyki języka albańskiego, SOW, Warszawa, pp. 156 (bashkautore Jolanta Mindak)
- 1994, Some aspects of the phonetic development of Albanian in Italian diaspora, Slavia Meridionalis I, 47-76
- 1994, The Greek-Romance phonotactic type (rezime), Septième Congrès International d'Études du Sud-Est Européen. Communications. Athènes, 171
- 1995, The Balkan Sprachbund in the light of phonetic features, Proceedings of the XIIIth International Congress of Phonetic Sciences Stockholm 95, 13-19 august, vol. 3, 386-390
- 1995, Intonacja zdaniowa w języku albańskim, Македонски јазик XL-XLI, 1989-1990, 503-511
- 1994, The Balkan Sprachbund in the light of phonetic features, Lingua Posnaniensis XXXVI, 145-148
- 1996, Liga Ballkanike fonetike, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tirana, 517-520
- 1996, (rec.), Nowe jugosłowiańskie prace albano-bałkanistyczne - Studia linguistica polono-meridianoslavica, 243-248
- 1996, Wacław Cimochowski, Głos Uczelni, V (XXI), 31 maja-1 czerwca, 9-10
- 1996, Co wiemy o języku albańskim, Dziennik Polski, Londyn 20 czerwca, p.6
- 1997, The Balkansprachbund in the Light of Phonetic Features, Energeia, pp. 99, Warszawa
- 1998, Charakterystyka fonetyczna centralnego obszaru ligi bałkańskiej, Македонски јазик XLV-XLVII, 169-177
- 1999, Z zagadnień fonetyki bałkańskiej - problem fonologicznej szwy, Prace Filologiczne XLIV, 493-497

- 2000,Vocalic Balkanic Features, [në:] Akten des Internationalen Kongresses „Balkanlinguistik, Synchronie und Diachronie" 30.X.-1.XI.1997, Thessaloniki, Thessaloniki, 207-215
- 2000, Об одном средневековном балканизме, Материалы XXVIII Межвузовской научно-методической конференции преподавателей и аспирантов, вп. 21, Балканские исследования, част 3, март 1999, Санкт Петербург, 25-28
- 2000, A medieval phonetic balkanism, Folia Linguistica Historica XXI/1-2, 155-158
- 2001, Lidhje midis hundorësisë dhe reduktimit në gjuhëve ballkanike, XIX Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 283-286
- 2002, Функционирование групп согласных типа НД в балканских языках, [në:] Материалы конференции посвещенной 90-летию со дня рождения Агнии Васильевны Десницкой, Санкт-Петербург, Наука, 195 –198
- 2002, Z zagadnień fonetyki bałkańskiej, Славистички студии 10, Универзитет Св. Кирил и Методиј, 425-429
- 2004, Z problemów fonetyki toskijskiej gwary Leshnji, AUNC, Studia Slavica IX, 99-105
- 2004, Two „new" phonetic balkanisms, [në:] Studia Albanica. In honorem Wacław Cimochowski, (bashkautore Anna Korytowska) Toruń, 147-153
- 2005, Suche i Wysoka – synteza fonetyki bałkańskiej, Mieczysław Małecki. Człowiek, uczony, organizator, Kraków 2005, 213-219
- 2007, Wacław Cimochowski (1912-1982) – twórca polskiej albanologii, [në:]: Albanistyka polska, Toruń, 85-89
- 2007,Wstęp, [në:] Albanistyka polska, Toruń, 5-15
- 2007, Bibliografia prac językoznawczych albanologicznych autorów polskich, [në:] Albanistyka polska, Toruń, 71-81
- 2007, Charakterystyka fonetyki albańskiej, [në:] Albanistyka polska, Toruń, 183-197
- 2007, Arealines fonetikos (fonetines geografijos) ivadas, Bibliotheca Salensis, Vilnius
- Struktura e rrokjes së shqipes kosovare, Gjurmime albanologjike, Prishtina, në shtyp
- Fonetyczny model sylaby albańskiej, Phonetica Pragensia, në shtyp
- O geografii fonetycznej Europy (na podstawie fonetyki Europy południowo-wschodniej), Linguistica Copernicana, në shtyp

- (rec.), Xhelal Ylli, Andrej Sobolev, Албанский тоскский говор села Лешня (краина Скрапар), Südost Forschungen, në shtyp

Witold Stefański

- 1989, Einige Bemerkungen zum albanischen Admirativ, Balcanica Posnaniensia IV, 407-411

Zdzisław Wąsik

- 1980, Język albański w Jugosławii, sprawozdania Wrocławskiego Towarzystwa Naukowego 33, 28-30
- 1980, Tipet strukturale të interogativit të gjuhës shqipe krahasuar me gjuhët e tjera (të Ballkanit dhe me gjuhët indoevropiane), [në] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 7, 241-243
- 1985, Profesor dr Eqrem Çabej (1908-1980), wybitny filolog, twórca współczesnego językoznawstwa albańskiego, Acta Universitatis Wratislaviensis 777, Studia Linguistica IX, 99-114
- 1986, Zu den strukturellen Frageexponenten im Albanischen (vom vergleichenden Standpunkt aus betrachtet), Acta Baltico-Slavica XVII, 307-328
- 1986, Contrastive features of question exponents in Albanian, Lingua Posnaniensis XXIX, 11-21

Krzysztof Witczak

- 1991, Ancient Epirus and its inhabitants (bashkautor M. Kokoszko), Linguistique Balkanique 34, 1-2, 41-49
- 1994, Proto-Albanian and the problem of the Ethnogenesis of the Albanian nation, Biuletyn Polskiego Towarzystwa Językoznawczego 50, 21-26
- 1995, Were the Bessans ancestors of the Albanians? A new opinion on the Ethnogenesis of the Albanian nation, Thaco-Dacica 16, 1-2, 309-312
- 1995, Some remarks on the Albanian vocabulary in the Paleo-Balkanic and Indo-European view (bashkautor Robert Ignacy Danka), [në] Analecta Indoeuropaea Cracoviensia Ioannis Safarewicz memoriae dedicata, W. Smoczyński ed., Kraków, 123-135
- 1996, New findings in Thracian etymology III-IV, Linguistique Balkanique 38, 1, 3-8
- 1997, Greek and Albanian: new evidence for lexical connections, Zeitschrift für Balkanologie 33, 2, 215-220

- 2002, On the etymology of Hittite kappar ‘vegetable, a product of the garden’ (bashkautor Robert Ignacy Danka), [në] Silva Anatolica. Anatolian studies presented to Maciej Popko on the occasion of his 65th Birthday, P. Taracha ed., Warszawa, 57-62
- 2004, Albanian *kopsht* ‘garden’ and its cognates, Studia Etymologica Cracoviensia 9, 179-186
- 2004, The Indoeuropean origin of Albanian arboreal collectives ending with *–ishtë*, Zeitschrift für Balkanologie

Alexander RUSAKOV

VENDI I MITRUSH KUTELIT NË HISTORINË E LETËRSISË SHQIPE: VËSHTRIM NGA RUSIA

0. Vendi i shkrimtarit në historinë e letërsisë kombëtare si dhe në atë të letërsisë botërore nuk është diçka e pandryshueshme. Shpeshherë shkrimtari që gjatë jetës së tij zinte vendin qendror në sistemin letrar bashkëkohor, pastaj humb këtë vend dhe zë pozitën periferike ose, shpeshherë ne mund të vëzhgojmë një proces të përkundërt (për vendin e shkrimtarit në sistemin letrar sh.: Jorgo 1996; 2004).

Kuptohet se ekziston roli objektiv i një shkrimtari në zhvillimin e procesit letrar: ndikimi që ai ka provuar nga paraardhësit e tij, ndikimet që ai ka ushtruar mbi pasardhësit etj. Por unë kam parasysh tamam vendin e shkrimtarit në *sistemin letrar* dhe në përcaktimin e këtij vendi përfshihet gjithmonë pozita e vëzhguesit me të gjitha rrethanat shoqërore, politike dhe kulturore që karakterizojnë këtë vëzhgues. Ndryshimet e pozitës së vëzhguesit kanë si pasojë ndryshimin në perceptimin e vendit të shkrimtarit në sistemin letrar dhe në përfytyrimin e historisë së letërsisë. Modifikimet e tilla ndodhen përherë, por ato janë veçanërisht të dukshme në kushtet e ndryshimeve të theksuara të situatës politike. Nga kjo pikëpamja sistemi letrar shqiptar përjetoi gjatë 60 viteve të fundit së paku dy ristrukturime të lidhura, i pari me fitoren e komunizmit dhe i dyti me rënien e tij. Nga kjo pikëpamja situata në kulturën shqiptare nuk dallon shumë nga ajo në vendet të tjera ish-socialiste.

Përveç distancës kohore të vëzhguesit ekziston dhe distanca si të thuash gjeografike. Siç dihet mirë, përfytyrimet e ndonjë kulture kombëtare nga brenda dhe nga jashtë shpeshherë dallojnë shumë; këto përfytyrime kanë prioritete të ndryshme etj. Në këtë kumtesë unë dua të shqyrtoj shumë shkurt disa aspekte të lidhura me perceptimin e Kutelit nga pikëpamja e kulturës dhe letërsisë ruse.

1. Mitrush Kuteli hyri në letërsinë shqipe në një moment shumë të rëndësishëm për zhvillimin e saj. Siç ka shkruar Kristaq Jorgo për

fillimin e periudhës së pavarësisë: "Sistemi letrar shqiptar paraqitet sipas të gjithë parametrave i prapambetur në përqasje jo vetëm me letërsitë e mëdha evropiane, por edhe me ato fqinje ballkanike" (Jorgo 1995: 322).

Duhet të them se disa nga letërsitë ballkanike në fillimin e shekullit njëzet tashmë kanë kapërcyer shkallën e *zhvillimit të përshpejtuar* të letërsisë[1]. Për letërsinë shqiptare të kësaj periudhe zhvillimi i përshpejtuar ishte akoma shumë karakteristik. Një nga tiparet e rëndësishme të zhvillimit të përshpejtuar është orientimi i shkrimtarëve jo drejt letërsisë aktuale bashkëkohore botërore, por drejt shembujve të letërsisë më të vjetër. Në lidhje me periudhën e romantizmit për këtë cilësi shumë karakteristike për letërsinë shqiptare shkruante R. Qosja (Qosja 1984). Në vitet 20 – 30 të shekullit njëzet ne mund të shohim këtë tipar në veprimtarinë e disa prozatorëve të asaj kohe, mund të përmendim, për shembëll, veprat e Milto Sotir Gurrës, Helenaut etj.

Por në fillimin e viteve 30 ne vëzhgojmë dy momente shumë të rëndësishme: 1) normalizohet procesi letrar shqiptar i përbashkët[2], dhe 2) në letërsinë shqiptare veprojnë shkrimtare që me fuqinë e talentin e tyre ngrenë këtë letërsi në një nivel të ri. Vendin e parë nga kjo pikëpamje zë, padyshim, Gjergj Fishta, veprimtaria e tij karakterizohet, pra, nga bashkimi i rrymave e stileve të ndryshme – tipari i zhvillimit të përshpejtuar të letërsisë, por fuqia e talentit të tij shkrin këto komponentë në një aliazh shumë organik.

---

[1] Idetë për *zhvillimin e përshpejtuar* të letërsisë në disa vende të Evropës Lindore dhe Jug-Lindore shprehnin shumë shkencëtarë (mund ta përmendim këtu për shembull historianin e letërsisë ruse, mikun e Mikhail Bakhtinit, Lev Pumpjanskun), por në mënyrë më të hollësishme kjo teori është zhvilluar në librin e shkencëtarit, filozofit dhe shkrimtarit rus Georgij Gaçev të kushtuar zhvillimit të letërsisë bullgare të gjysmës së parë të shekullit 19 (Gaçev 1966, 1989).

Sipas kësaj teorie në vendet të cilat kanë tejkaluar në mënyrë të shpejtë disa faza të zhvillimit historik, në letërsinë (dhe në kulturën në përgjithësi) koekzistojnë në të njëjtin moment kohor trajta të etapave të ndryshme të zhvillimit, të cilat zakonisht shkojnë njëri pas tjetrit në mënyrë vijuese në letërsinë e shteteve "të mëdha" evropiane.

[2] *Qarqet kulturore dhe literare* (Çabej 1975) zëvendësohen përfundimisht me rrymat letrare me kuptimin modern të fjalës – procesi, fillimi i të cilit na çon në periudhën e Rilindjes.

Në fillimin e viteve 30 del në skenë brezi i ri i shkrimtarëve me të cilin ne mund të lidhim zakonisht fillimin i modernitetit në letërsinë shqiptare.

2. Fati i Kutelit ishte veçanërisht i komplikuar. Jeta në Rumani, publikimet e para në gazetat e revistat të botuara atje, zhdukja e tirazhit të botimit të parë të "Netëve shqiptare" kanë si pasojë se periudha shumë e shkurtër të lulëzimit të tij si prozator aktiv brenda Shqipërisë bie në kohën e luftës, në vitet 1943-44. Tashmë në fillimin e 1947 ai përjashtohet si krijues nga procesi letrar shqiptar. Meqenëse përjashtimi i tij s'ishte aq total si ai i Fishtës ose Konicës, ai praktikisht s'kishte kohë për të hyrë përfundimisht në panteonin kombëtar letrar shqiptar të përbashkët (është interesant se Koliqi pothuajse nuk e përmend Kutelin në veprat e tij kritike, shih gjithashtu karakteristikën respektivisht të ftohtë, që i jep Kutelit Arshi Pipa (Pipa 1978: 125).

3. Më duket se për lexuesit rus Kuteli do të ishte më i afërt, më i kuptueshëm dhe me interesant nga të gjithë shkrimtarët shqiptarë të kohës së pavarësisë. Shkaku qëndron në faktin e paralelizmit të caktuar midis kërkimeve krijuese të Kutelit dhe atyre të shkrimtarëve rusë të viteve 10 – 30 të shekullit të kaluar.

Pothuajse të gjithë studiuese modernë, që shkruajnë për Kutelin vënë në dukje veçoritë e tij në fushën e strukturës së narracionit (Sabri Hamiti, Jorgo Bulo, Kristaq Jorgo, Blerina Suta). Në këtë lidhje përmendet shpesh termi "skaz"[3] i vënë në përdorim nga formalistët rus.

Do të ishte interesant të krahasojmë veprat e Kutelit me traditën e përfaqësuar në letërsinë ruse. Unë flas për këtë problem vetëm nga pikëpamja tipologjike. Kuteli njihte letërsinë ruse shumë mirë (sidomos letërsinë klasike), por problemi i ndikimeve konkrete duhet të jetë hulumtuar në mënyrë të veçantë. Vija e zhvillimit të letërsisë ruse që mund të këtë interes në lidhje me krijimtarinë e Kutelit, zë fill në tregimet e Gogolit, lulëzon në veprat e Nikolaj Leskovit dhe, pasi

[3] Skazi, sipas përkufizimit të akademikut Viktor Vinogradov është: "një lloj orientimi ndaj monologut gojor të tipit tregimtar, imitimi artistik i të folurit monolog, që mishëron në vete fabulën dhe sikur ndërtohet sipas radhës të zhvillimit të drejtpërdrejtë të saj" (Vinogradov 1980: 48).

bashkohet në fillim të shekullit njëzet me kërkime moderniste (në prozë ato janë shprehur në radhën e parë në veprimtarinë e Andrejit Belyj), ajo shpërthehet me fuqi në vitet 10-20, nga njëra anë si letërsia e "skazit" (veprat e M. Zoshçenkut, E. Zamjatinit, L. Leonovit) nga ana tjetër në të ashtuquajturën "prozë ornamentale" (A. Remizov, I. Babel, V. Ivanov, Leonov). Veprat e shumë shkrimtarëve ruse bashkojnë tiparet e këtyre dy rrymave. Midis novelave të Kutelit dhe veprave të shkrimtarëve rusë të viteve 10-20 ka shumë përkime si nga ana e formës ashtu edhe nga ajo e përmbajtjes.

Nga ana e formës ne duhet të përmendim në radhë të parë vetë karakterin e narracionit në shumicën e novelave të Kutelit:

- rrëfimin nga veta e parë, ku figura e rrëfimtarit gjendet në marrëdhëniet shumë të ndërlikuara dhe jo të njëkuptimshme me figurën e autorit, nganjëherë ata afrohen dhe pothuajse përkojnë, nganjëherë largohen njëra nga tjetra;[4]

- kompozicionin e tregimeve, që është nganjëherë mjaft e ndërlikuar duke përfshirë një rrëfim brenda rrëfimit tjetër (këtë tip të kompozicionit ne mund të shohim, për shembëll, në katër nga tetë tregimet e "Netëve shqiptare", për veçorit e kompozicionit tek Kuteli shih p.sh.: Çali 2005).

Nga ana e stilit veprimtarinë e Kutelit dhe të shkrimtarëve rusë e bashkon tendenca ndaj pasurimit të leksikonit. Ky pasurim realizohet me anë të shfrytëzimit të dialektizmave (nganjëherë "kvazidialektizmave") dhe arkaizmave.[5] Vetë stili i Kutelit karakterizohet nga shkrirja e elementeve të mënyrës së ligjërimit popullor me atë të gjuhës letrare shpeshherë shumë të rafinuar (për disa veçori të stilit kutelian sh. Bulo 2002).

Për sa i përket përmbajtjes për rrymat të lartpërmendura të letërsisë ruse është karakteristike përvoja shumë e fortë ndaj groteskut dhe fantastikes. Kjo tendencë u duk në fillimit të shekullit si një reaksion kundër letërsisë së realizmit kritik dhe vazhdonte të ekzistonte në letërsinë sovjetike deri në mesin e viteve 30, kohës së

[4] "...Kuteli nuk tregon ngjarjet, por tregon rrëfimet për ngjarjet" (Hamiti 2000: 220), shih edhe Suta 2002.

[5] Për gjuhën e Kutelit, ndër të tjera për karakterin e shfrytëzimit të leksikut dialektor, shih Bulo 2002, Lafe 1998.

fitimit të plot të realizmit socialist në letërsinë e censuruar. Tendenca ndaj groteskës që mbështetej sidomos mbi traditën e romantizmit evropian merrte temat dhe subjektet ndër të tjerat nga jeta e fshatit bashkëkohor. Të dy momentet: grotesku fantastik dhe temat fshatarake janë shumë karakteristike për Kutelin (për groteskun kutelian sh. Uçi 2001).

4. Por midis krijimtarisë së Kutelit dhe veprimtarisë së shkrimtarëve rusë të viteve 1900-1920 ekzistojnë, si më duket edhe dallime shumë serioze.

Vija ornamentale në letërsinë ruse ka qenë një rezultat i zhvillimit mjaft të gjatë të artit të shkrimit në Rusi, ajo mbështetej në traditat letrare atdhetare (në radhën e parë në ato të Gogolit dhe Leskovit) dhe botërore. Si një produkt i zhvillimit shumë të vetëdijshëm ajo kishte në veten bile diçka artificiale. Ndikimi i letërsisë gojore, i folklorit mbi të nuk ishte i drejtpërdrejtë, ai mbetej gjithmonë i ndërmjetshëm. Kjo është karakteristikë bile për shkrimtarët më prejardhje fshatare (si për shembull, Sergej Jesenin ose miku i tij, prozator shumë interesant Sergej Kliçkov).

Për shumicën e shkrimtarëve rusë të kësaj periudhe (me përjashtim e grupit të shkrimtarëve fshatarë – Jesenin, Kliçkov, Kljujev), fshati, të cilin ata përshkruanin mbetej si diçka i huaj, nganjëherë bile armiqësor. Kjo është karakteristikë për veprat e Andrej Belijit ("Pëllumbi i argjendt") dhe në letërsinë sovjetike për veprat e hershme të Leonovit. Distanca midis shkrimtarit dhe ngjarjeve që ai përshkruante mbetej mjaft e madhe.

Për Kutelin lidhja me gjuhën e jetën e popullit ishte siç duket më e drejtë dhe më organike.[6] Kuteli, mund të themi, lidh disa arritje të letërsisë moderne (të fituara për hir të njohjes së thellë të kulturës botërore) me traditën popullore, mjaft të gjallë në Shqipëri të asaj kohe. Duke zhvilluar tezën shumë të drejtë të Kristaq Jorgos, që vuri re së në veprën e Kutelit ne kemi "një ekuilibër të mahnitshëm mes

[6] Sigurisht marrëdhëniet e Kutelit, që pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi ose jashtë shtetit, ose në qytetet e Shqipërisë larg vendlindjes së vet, përbëjnë një problem të veçantë. Siç dihet, Arshi Pipa e "akuzonte" Kuteli për vizatimin e jetës fshatarake "from a rather touristik point of view" (Pipa 1978, 125), pikëpamje të paktën e tepruar!

fjalës dhe ngjarjes" ne mund të shtojmë se në letërsinë ruse të "skazit" të asaj kohe mbizotëron fjala.

Nuk do të ishte i padrejtë supozimi së në krijimtarinë e Kutelit (si edhe në atë të Koliqit) ne kemi fazën e fundit, bile ndoshta vetë mbarimin e periudhës së zhvillimit të përshpejtuar të letërsisë shqipe.

Më të vërtet ai lidh elementet e romantizmit kombëtar (për marrëdhëniet e Kutelit me romantizmin – si kombëtar ashtu edhe me atë evropian, sh. Uçi 2001: 107-108) me teknikën moderne narrative dhe – kjo është kryesorja – me botëkuptimin e njeriut që pandërprerë lidhjet me ambientin që përshkruan është në të njëjtën kohë një njëri modern në kuptimin e plotë të fjalës.

Rezultatet janë të ndryshme, kjo dëshmon edhe një herë për fuqinë e shumanshmërinë e talentit të Kutelit. Në disa raste Kuteli i afrohet shumë llojit të letërsisë që quhet tani letërsia e "realizmit magjik"[7], nganjëherë ne kemi diçka shumë të ngjashme me novelat realiste, nganjëherë ne mund të flasim për motivet simboliste (sh. Bashota 2005).

5. Akoma nuk është zgjidhur në mënyrë përfundimtare problemi i ndikimeve letrare që ka provuar Kuteli. Në këtë lidhje shumë interesante është çështja e marrëdhënieve të veprimtarisë letrare të Kutelit me krijimtarinë e prozatoreve bashkëkohore rumunë, ku ne gjejmë nganjëherë një sintezë shumë të ngjashme të temave dhe të teknikave narrative. Mund të përmendim për shembëll tregimet e M. Sadoveanut të viteve 20, ku ne kemi përveç një ngjashmërie në temat e rrëfimit, edhe disa tipare formale të afërta me ata që shfrytëzon Kuteli, për shembull "rrëfimi i dyfishtë" (shih me lart) e ca të tjera.

Por kjo është tema e një studimi të veçantë.

Literatura:

Гачев Г. 1964 (1989). Ускоренное развитие литературы (На материале болгарской литературы первой половины - XIX века). Москва.

Виноградов В. 1980. Проблема сказа в стилистике. Në: Виноградов В. О языке художественной прозы. М., С. 42-54.

[7] Kjo nuk është puna e rastit. Edhe në letërsinë e Amerikës latine "realizmi magjik" është aliazhi i kulturës gaztore popullore (Uçi 2001: 107) dhe kulturës letrare botërore.

Bashota S. 2005. Konica, Koliqi, Kuteli dhe moderniteti. Në: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. 24/2. F. 159-163.

Bulo J. 2002. Për një tipologji e narracionit në proyën e M.Kutelit. Në: Studime filologjike, 1-2. F. 134-137.

Çabej E. 1975. Për gjenezën e literaturës shqipe. Në E.Çabej, Studime gjuhësore, v. V, Prishtinë. F. 101-135.

Çali E. 2005. Letërsia shqipe dhe kritika moderne dhe bashkëkohore e Mitrush Kutelit dhe Kasëm Trebeshinës. Në: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. 24/2. F. 377-387.

Hamiti S. 2000. Letërsia moderne shqiptare. Tiranë.

Jorgo K. 1995. Letërsia shqiptare midis dy luftërave në kontekstin evropian. Në: Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Tiranë. F. 321-328.

Jorgo J. 1996. Fenomeni Fishta në historinë e letërsisë shqiptare. Në: Seminari XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Tiranë. F. 1061-1066.

Jorgo K. 2004. Receptimi i Asdrenit dhe vendi i tij në sistemin letrar shqiptar. Në: Studime filologjike, 1-2. F. 5-18.

Lafe E. Tipare të ligjërimit letrar në veprën e Mitrush Kutelit. Kumtesë e lexuar në seminarin për veprën dhe gjuhën e Mitrush Kutelit në Institutin Universitar Oriental të Napolit (11 dhjetor 1988).

Pipa A. 1978. Albanian Literature: Social Perspectives. München.

Qosja R. 1984. Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi.I. Prishtinë.

Suta B. 2002. Disa aspekte të narracionit në prozën e shkurtër të M.Kutelit. Në: Studime filologjike, 1-2. F. 139-163.

Uçi A. 2001. Estetika e groteskut. Grotesku në letërsinë shqipe. V, IV. Tiranë.

Fadil RAKA

RRETH DISA PROBLEMEVE TË HISTORISË SË SHQIPES LETRARE

1. Në gjysmën e dytë të shek. XX në kuadër të shkencave albanistike kishin zënë të zhvilloheshin me sukses disa disiplina gjuhësore, të cilat ose nuk kishin qenë të njohura më parë, ose kishin pasur një zhvillim jo fort të përfillshëm. Në kuadër të këtyre disiplinave një vend të rëndësishëm zë Historia e gjuhës letrare shqipe, e cila është pasqyruar në një mori artikujsh shkencorë, studimesh më të gjera gjuhësore dhe jo rrallë edhe në studime monografike për disa fusha të veçanta të zhvillimit të saj. Nuk kanë munguar as përpjekjet për hartimin e studimeve sintetizuese për këtë disiplinë shkencore, të cilat kanë qenë gjithnjë individuale ku mund të vërehet shpesh një subjektivizëm i theksuar, sidomos rreth zgjedhjes, seleksionimit dhe komentimeve të këtyre materialeve. Megjithë vlerat që kanë këto studime, të cilat nuk mund të mohohen apriori, jemi të bindur se ende ka boshllëqe të mëdha në studimet nga kjo fushë dhe nuk janë plotësuar kushtet për hartimin e një teksti integral sintetizues të Historisë së gjuhës letrare shqipe, që do të ishte rezultat i një pune të mbështetur kolektive shkencore.

1.1. Është fakt i njohur se Historia e gjuhës letrare shqipe është një disiplinë specifike me karakter të theksuar shoqëror, e cila nuk mund të studiohet e ndarë nga rrethanat konkrete historiko-shoqërore të periudhave të caktuara të zhvillimit të vetë shoqërisë shqiptare. Problemi kryesor qëndron pikërisht te trajtimi i këtyre rrethanave historiko-shoqërore, të cilat shumë shpesh mund të jenë të ngjyrosura me ideologji e botëkuptime të ndryshme të autorëve që i trajtojnë këto çështje. Kështu, bie fjala, një pjesë jo e vogël e këtyre studimeve, të bëra në kuadër të Historisë së gjuhës letrare shqipe nga përfundimi i Luftës II Botërore e këndej, sidomos gjer në vitet ’90, kur në të dy anët e kufirit shqiptar mbizotëronte sistemi monist socialist, kanë qenë të ndikuara herë më fuqishëm dhe herë më pak nga ideologjia politike ekzistuese e kohës. Përzierja e përhershme e kësaj doktrine ideologjike në shumicën dërmuese të shkencave shoqërore, pra edhe

në Historinë e gjuhës letrare shqipe, ka dëmtuar jo rrallëherë objektivitetin shkencor të këtyre studimeve. Kështu mund të thuhet se për shumë çështje që lidhen me standardizimin e gjuhës shqipe, sidomos në të dy gjysmat e shekullit XX shumë shpesh ka pasur vështrime të njëanshme, herë-herë edhe pa mbështetje shkencore. S'ka dyshim se studimet e këtilla duhet të rimerren dhe të vështrohen edhe nga kënde të tjera, por gjithnjë në mbështetje të fuqishme të teorisë dhe të praktikës së shkencës gjuhësore bashkëkohore. Sigurisht që pas një vlerësimi të mbështetur kritik shkencor do të duhej të pranohej çdo gjë që mund t'i përballonte me sukses vlerësimit real të kohës dhe që mund të hynte në punë për studimet e mëtejme në fushë të Historisë së gjuhës letrare shqipe.

1.2. Në këtë kumtesë të shkurtër do të mundohemi t'i prekim disa probleme që i përkasin sferës së Historisë së gjuhës letrare shqipe, të cilat në të kaluarën, veçanërisht në periodën e monizmit, kanë qenë trajtuar në mënyrë të njëanshme. Sigurisht që këto probleme dalin me dimensione shumë të gjera dhe nuk mund të mbërthehen në një punim të shkurtër siç është ky, prandaj këtu do të përpiqemi t'i trajtojmë vetëm dy-tri çështje problemore, të cilat, sipas mendimit tonë, nuk kanë gjetur zgjidhje të kënaqshme në studimet e gjertanishme, të bëra në kuadër të kësaj fushe të studimeve albanistike.

2. Problemi i parë, të cilin dëshirojmë ta prekim, lidhet me periodizimin e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe, sidomos me kohën e saktë të kalimit nga periudha parakombëtare në periudhën kombëtare të zhvillimit të saj. Në studimet e gjertanishme nuk kanë munguar përpjekjet për të bërë një periodizim më të afërm të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe nëpër shekuj. Këto studime shpesh janë mbështetur sidomos në periodizimin e Historisë së popullit shqiptar. Një mbështetje të shpeshtë këto studime e kanë pasur edhe në periodizimin e zhvillimit të Historisë së gjuhës shqipe, sidomos të trajtës së folur të saj. Kështu periudha e zhvillimit të historisë së shkrimit të shqipes është konsideruar si periudhë e fundit e zhvillimit historik të gjuhës shqipe.

Në shumicën dërmuese të këtyre studimeve zhvillimi i gjuhës letrare shqipe është konsideruar si zhvillim që u përket dy periudhave

të mëdha: periudhës parakombëtare[1] dhe të asaj kombëtare, e cila është quajtur edhe periudhë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kjo e dyta, periudha kombëtare e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe, është ndarë më tej në etapën e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe në kohën e Rilindjes, në periodën e Pavarësisë dhe në zhvillimin që ka pasur gjuha letrare shqipe nga mbarimi i Luftës II Botërore e këndej gjer në kohën tonë. Secila nga këto etapa klasifikohet më tej në faza të veçanta të zhvillimit.

Ka edhe studime në të cilat zhvillimi i gjuhës letrare shqipe është ndarë në dy periudha të mëdha dhe si kriter ndarjeje është marrë Lufta e Dytë Botërore. Sipas këtyre studimeve zhvillimi i gjuhës letrare nga "*Meshari*" i Gjon Buzukut e gjer në Luftën II Botërore konsiderohet si zhvillim i paraçlirimit i gjuhës letrare shqipe, ndërsa nga viti 1944, kur Shqipëria ishte çliruar definitivisht nga sundimi nazifashist e këndej, bëhet fjalë për zhvillimin e gjuhës letrare shqipe të pasçlirimit. Një periodizim i këtillë vërehet edhe në studimet e disa disiplinave të tjera gjuhësore, si në fonetikë dhe fonologji, në gramatologji, në leksikologji etj.

Ndonjë autor tjetër konsideron se zhvillimi i gjuhës letrare shqipe ka kaluar nëpër tri periudha të rëndësishme, të cilat janë të lidhura me Rilindjen Kombëtare Shqiptare: periudha e para Rilindjes, periudha e Rilindjes dhe periudha pas Rilindjes[2].

Secili lloj i periodizimit argumentohet në mënyra të ndryshme dhe ka përparësitë dhe të metat e veta. Megjithëkëtë, rreth periodizimit të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe studimet duhet të zgjerohen dhe të thellohen edhe në të ardhmen.

3. Një çështje që ka zgjuar interesim në të kaluarën dhe vazhdon të zgjojë interesim edhe në kohën tonë, lidhet me hetimin e kohës së kalimit nga periudha parakombëtare në periudhën kombëtare. Kjo ka të bëjë me kohën kur konsiderohet të jetë formuar kombi shqiptar, i cili do të ketë filluar të komunikonte në gjuhë letrare kombëtare shqipe. Rreth këtij problemi të rëndësishëm janë shprehur mendime të ndryshme. Disa studiues i kanë kërkuar fillimet e gjuhës letrare

[1] Shih A. KOSTALLARI, Mbi disa veçori strukturore dhe funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë 1972, f. 8

[2] Shih M. SAMARA, Historia e shqipes letrare, Tiranë 2005, f. 63

kombëtare shqipe në veprat e rëndësishme të letërsisë shqipe, të botuara në shekujt XVI-XVII, sidomos në veprën "*Çeta e profetëve*" të Pjetër Bogdanit[3]. Ka pasur përpjekje që fillimet e zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe të kërkohen në arritjet e arsimit dhe të kulturës së disa qendrave të Shqipërisë së Mesme dhe Jugore në shek. XVIII, veçanërisht në Voskopojë[4] ku veç tjerash qenë botuar edhe dy fjalorë të rëndësishëm shumëgjuhësh, njëri i Theodor Kavaliotit(1770) dhe tjetri i Dhanil Haxhiut(1802).

Ndonjë studiues fillet e zhvillimit të gjuhës letrare të periudhës kombëtare i ka kërkuar në letërsinë e bejtexhinjve[5], të shkruar me alfabetin arabo-turk, po ashtu në shekullin XVIII. Në ballë të fillimeve të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe disa studiues e kanë vënë Jeronim de Radën me veprat e botuara të tij në pjesën e parë të shek. XIX, siç ishin "*Këngët e Milosaos*", " *Këngët e Serafino Topisë*" etj. Mirëpo, shumica e studiuesve të shqipes, ndër të cilët edhe arbëreshët e Italisë, mendojnë se midis veprave të De Radës dhe të paraardhësve të tij arbëreshë, sidomos të Jul Varibobës, nuk ka ndonjë dallim të madh cilësor për t'u vënë re, prandaj sipas tyre De Rada nuk mund të konsiderohet si nismëtar i zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe për shkak se veprat e botuara të tij dalin me gjuhë mjaft arkaike për kohën.

3.1. Megjithëkëtë, mendimi më i përhapur, që mund të konsiderohet edhe si mendim zyrtar i gjuhësisë shqiptare, që ka dominuar për një periodë të gjatë kohore, ishte ai, i cili Naum Veqilharxhin e konsideronte si nismëtarin e fillimit të zhvillimit të periudhës kombëtare të gjuhës letrare shqipe[6]. Studiuesit që e mbështesin këtë konstatim gjejnë argumente te "*Ëvetari*" i Naum Veqilharxhit, sidomos në parathënien e tij që dilte me rastin e ribotimit më 1845, ku shpreheshin disa botëkuptime të tij, për të cilat thuhej se paraqitnin aspiratat e qarta kombëtare të një borgjezie të re shqiptare, e cila sapo kishte filluar të lindte. Mbështetjet për një konstatim të këtillë janë kërkuar në alfabetin e përpiluar të tij si dhe në

[3] Grup autorësh, Shkrimtarë shqiptarë I, Tiranë 1941, f. 26
[4] Grup autorësh, Historia e popullit shqiptar II, Prishtinë 1979, f. 41
[5] N. ALPAN, Ndikimet e letërsisë turke në letërsinë dhe gjuhën shqipe, Konferenca I e Studimeve Albanologjike, Tiranë 1965, f. 81
[6] A.KOSTALLARI(1970), M. DOMI(1977), M. ISLAMI(1978);R. QOSJA(1985), E, LAFE(1986)

disa neologjizma të pakta që janë hetuar në shkrimet e tij, të cilat, ç'është e vërteta, nuk kishin ndonjë peshë për t'u vënë re dhe nuk mbetën në fondin leksikor të zhvillimit të shqipes letrare. As alfabeti, të cilin e përpiloi dhe e përdori Veqilharxhi në shkrimet e tij, nuk pati ndonjë përhapje për t'u vënë re. Së paku gjer sot nuk ka dalë ndonjë vepër e botuar me këtë alfabet. Më tej mund të thuhet se Veqilharxhi nuk bëri kurrfarë ndryshimi të rëndësishëm sa i përket vetë përpunimit dhe zhvillimit cilësor të strukturës së gjuhës së shkruar që ishte përdorur me sukses para tij.

3.2. Sipas mendimit tonë merita e veçantë për transformimin e plotë të gjuhës letrare shqipe të shekujve XVI-XVIII dhe të pjesës së parë të shek. XIX i takon Konstandin Kristoforidhit, i cili gjeti zgjidhje të mira për të dy alfabetet që i përdori në shkrimet dhe në përkthimet e tij. Kristoforidhi në veprat që shkroi dhe përktheu i dha gjuhës letrare shqipe një ngjyrim kombëtar krejtësisht origjinal[7]. Ai krijoi baza barabar të rëndësishme për lëvrimin dhe zhvillimin e suksesshëm të gegërishtes letrare dhe të toskërishtes letrare. Nga veprat origjinale dhe përkthimet shumë të rëndësishme të tij mbeti një numër shumë i madh i njësive leksikore, të quajtura neologjizma, të farkuara nga ai, nga të cilat mbi 400 sosh edhe sot qëndrojnë fuqishëm në fondin leksikor të gjuhës standarde shqipe[8]. Pra, ai që e ndyshoi rrënjësisht gjuhën letrare shqipe të përdorur për tre shekuj më parë qe Konstandin Kristoforidhi dhe jo Naum Veqilharxhi. Konstandin Kristoforidhi qe jo vetëm lëvrues shumë i shkathtë i gjuhës letrare shqipe, por edhe studiues i shquar i strukturës së saj. Ai hartoi një gramatikë shkencore të nivelit të lartë shkencor në variantin e toskërishtes, të botuar në Stamboll më 1882. Disa vite më vonë doli Fjalori i gjuhës shqipe (1904), një nga veprat më të rëndësishme të leksikografisë shqiptare. Veprat origjinale dhe përkthimet e Kristoforidhit shërbyen shumë kohë si një shkollë ortografike e shkëlqyer prej nga mund të mësohej shkrimi i drejtë dhe i saktë i gjuhës letrare kombëtare shqipe. Të gjitha këto e bëjnë Kristoforidhin

[7] XH. LLOSHI, Të dhëna dokumentare të reja mbi veprën e V. Meksit, G. Gjirokastritit dhe K. Kristoforidhit, SF 1974, nr. 1, f. 104

[8] K. ASHTA, Neologjizmat e Kristoforidhit, Studime filologjike, Tiranë 1990, nr. 2, f. 118

studiues të shquar të strukturës së gjuhës shqipe dhe linguist të madh të shek. XIX.

Fatkeqësisht veprimtaria e tërësishme e Konstandin Kristoforidhit nuk është studiuar as për së afërmi. Veç dy tri studimeve të bëra nga Çabej[9], Xhevat Lloshi(1974), Kolë Ashta(1990) dhe Mehmet Çeliku(2001) si dhe të disa artikujve të botuar në raste të veçanta përvjetorësh, të cilët gjithsesi kanë rëndësi për njohjen e veprimtarisë së tij, nuk ka studime të plota shteruese monografike të botuara për kontributin e madh që ka dhënë ky rilindës për zhvillimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe. Veç kësaj asnjë institucion nuk ka bërë përpjekje të botonte kompletin e veprave origjinale dhe të përkthyera të Kristoforidhit, siç ka ndodhur me një varg të tërë rilindësish të tjerë shqiptarë, veprat e të cilëve së paku janë botuar dhe ribotuar si komplete disa herë. Nga kjo del se për veprimtrinë e Konstandin Kristoforidhit në të ardhmen duhet të bëhet shumë më tepër, sesa ajo që është bërë gjer më sot. Mund të thuhet se nuk ka studime të plota shteruese as për kontributin e rilindësve të tjerë, veçanërisht për ata që kanë bërë shumë për zhvillimin e gjuhës letrare shqipe gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, siç ishin, bie fjala, Naimi, Samiu, De Rada, Faik Konica e të tjerë. Studime monografike do të duhej të bëheshin edhe për autorët që vepruan para Rilindjes Kombëtare Shqiptare, veçanërisht për Budin, Bardhin, Bogdanin, Kazazin, për arbëreshët e Italisë etj.

4. Në Historinë e gjuhës letrare shqipe janë trajtuar pjesërisht edhe çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e pikëpamjeve të shprehura të autorëve të huaj dhe shqiptarë për mundësinë e formimit të një gjuhe të vetme letrare/standarde shqipe pa variante dialektore. Këto pikëpamje të shpërndara gjithandej në veprat e veçanta të studiuesve të huaj dhe shqiptarë janë klasifikuar në dy grupe të mëdha teorish: teoritë e pohimit të mundësisë së formimit të gjuhës unike letrare dhe teoritë, të cilat e mohojnë një mundësi të këtillë – teoritë e mohimit.

[9] E. ÇABEJ, Rreth disa etimologjive të K. Kristoforidhit, BUSHT, Tiranë 1954, nr. 3, f. 131

Disa nga këto probleme janë rrahur në një studim monografik të Androkli Kostallarit[10], të botuar pak kohë para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe(1972). Në grupin e mohuesve të mundësisë së standardizimit të gjuhës shqipe autori i këtij studimi përfshinte edhe disa studiues të shquar të gjuhës shqipe si Aleksandër Xhuvanin, Eqrem Çabejnë, Osman Myderrizin, Lirak Dodbibën, Injac Zamputin e të tjerë, të cilët në një sesion shkencor të mbajtur në Tiranë më 1952 nuk e kishin përkrahur referatin e Shuteriqit për standardizimin e gjuhës shqipe mbi bazën e dialektit të toskërishtes. Për këtë autori i studimit të përmendur thoshte: " Përballë(*autorëve që përkrahnin referatin e Shuteriqit F.R*) u vu një koncept tjetër se gjuha jonë letrare unike ose nuk do të formohet asnjëherë, ose do të formohet vetëm si gjuhë zyrtare në sferën e ngushtë të institucioneve shtetërore, administrativo-arsimore, por jo në sferën e gjerë të letërsisë artistike; pra sidoqoftë sipas këtij koncepti variantet letrare dialektore do të vazhdojnë të zhvillohen paralelisht e vetvetiu (spontanisht) deri në shkrirjen e plotë të dialekteve të shqipes dhe do të kemi kështu një diglosi letrare, e cila mund të marrë fund vetëm në një të ardhme shumë e shumë të largët e të mjegullt, ndërsa shoqëria jonë e sotme nuk është në gjendje t'i parashikojë e t'i përcaktojë prirjet dalluese të këtij procesi, as të ndikojë mbi to"[11].

Për argumentimin e këtij konstatimi Kostallari kërkonte mbështetje në një varg faktorësh historikë, gjeografikë, filozofikë, gjuhësorë etj. Vlerësimet e këtilla mohuese për këta studiues të shquar shqiptarë nuk kanë asnjë bazë të qëndrueshme, sepse asnjë nga studiuesit e lartpërmendur nuk kishte shprehur pikëpamje të këtilla, të cilat u përshkruhen në këtë studim të përmendur. Mendimet e shprehura në sesionin e përmendur të 1952-s nga Çabej, Xhuvani e të tjerët kishin të bënin me faktin se ishte akoma shumë herët të standardizohej gjuha shqipe, sakohë që nuk ishin bërë as studimet më të përgjithshme për të folmet dialektore të shqipes dhe as nuk ishte studiuar letërsia e trashiguar nga e kaluara për ta parë rrugën e

[10] A. KOSTALLARI, Mbi disa veçori strukturore dhe funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Tiranë 1972, f. 7

[11] A. KOSTALLARI, Mbi disa veçori strukturore dhe funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe vëllimi I, Tiranë 1972, f. 10

zhvillimit që ka ndjekur gjuha letrare shqipe gjatë shekujve, pa të cilat do të ishte punë e ngutshme dhe e gabueshme të caktoheshin norma për një gjuhë standarde çfarëdo që të ishte ajo.

Koha u dha të drejtë të plotë këtyre studiuesve, sepse në vitet ’50 gjuha shqipe nuk u standardizua, por qe e nevojshme të kryheshin më parë një varg punësh paraprake shumë të rëndësishme për standardizimin përfundimtar të gjuhës shqipe që do të ndodhte dy dhjetëvjetësha më vonë. Nga ana tjetër nuk mund të pohohet në asnjë mënyrë që Xhuvani, Çabej e të tjerët paskëshin kundërshtuar standardizimin e gjuhës shqipe dhe nuk e paskëshin parë mundësinë për formimin e saj as në një të ardhme të largët e të mjegullt. Të dy këta, edhe Xhuvani edhe Çabej kanë qenë anëtarë në Komisionin e përheshëm të drejtshkrimit, të emëruar nga viti 1947 dhe kanë punuar gjithë jetën e tyre për standardizimin e gjuhës shqipe. Janë të tjerë ata që e kanë kundërshtuar mundësinë e standardizimit të gjuhës shqipe gjatë zhvillimit historik të shqipes, prandaj nuk mund të qëndrojë e dhëna kinse Xhuvani, Çabej, Dodbiba, Myderrizi e Zamputi paskan qenë përkrahës të kundërshtimit të mundësisë së standardizimit të gjuhës shqipe. Është e çuditshme se si nuk është reaguar asnjëherë gjatë këtyre 50 vjetëve kundër një konstatimi kaq të pavërtetë për veprimtarinë shekncore të këtyre autorëve të shquar, madje as jashtë kufijve administrativë të Shqipërisë. Këto konstatime dhe disa të tjera për zhvillimin historik të gjuhës letrare shqipe në vitet ’50 dhe në fazat e tjera të zhvillimit duhet të bëhen objekt studimesh serioze monografike, sepse janë shumë të rëndësishme për Historinë e gjuhës letrare shqipe.

5. Dëmet që solli ideologjia e politikës shqiptare në zhvillimin e shkencave shoqërore për gjysmë shekulli sa mbretëroi në Shqipëri, mund të vërehen qartë edhe në disa lëmenj të tjerë të zhvillimit të Historisë së gjuhës letrare shqipe, si në rastin kur bëhej përshkrimi i veprimtarisë së klerikëve katolikë shkodranë, të cilët, pasi qenë likuiduar fizikisht ose qenë burgosur masovikisht nga pushteti komunist i kohës, u përlanë edhe nga një propagandë tepër agresive politike, të paparë ndonjëherë në trojet shqiptare. Në studimet e viteve ’60-70, të botuara në Shqipëri për gjuhën letrare shqipe, mund të vërehet qartë se veprimtaria shkencore e klerikëve katolikë shkodranë gjithnjë është minimizuar dhe satanizuar. Në referatin kryesor të

lexuar në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe tekstualisht thuhet: "Nga pozita e zgjidhjes së problemit gjuhësor mbi baza dialektore e nëndialektore të kulluara ose duke e idealizuar gjuhën e teksteve fetare të shekujve XVI-XVII, ato u ngritën kundër vendimeve të Komisisë Letrare e atyre të Kongresve arsimore, kundër një gjuhe letrare të vetme për gjithë kombin dhe e shndërruan këtë çështje në një mjet të shantazhit politik. Flamurin e këtyre forcave reaksionare e morën sidomos krerët e urdhërave katolike"[12]. Në këtë referat, sikurse edhe në shumicën dërmuese të studimeve të hartuara në kohën e monizmit, nuk mund të dëgjohet asnjë fjalë e vetme për kontributin që dhanë klerikët katolikë shqiptarë, si Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Prenk Doçi e më vonë edhe Justin Rrota, Shtjefën Gjeçovi etj. Gjithnjë konstatohet se klerikët katolikë shkodranë paskëshin qenë ata që nuk e paskëshin lënë gjuhën shqipe të njësohej, duke mbrojtur dialektin e tyre krahinor, edhe pse nga veprat që kanë lënë këta klerikë shihet se shumica dërmuese e tyre gjithë jetën ia kishin kushtuar pikërisht njësimit të alfabetit të shqipes dhe drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe. Ndre Mjeda dhe Justin Rrota kërkonin me këmbëngulje të formohet një gjuhë e vetme letrare shqipe e domosdoshme për prosperitet kombëtar; kjo del shumë qartë në studimet e tyre që lanë pas. Edhe në Komisinë Letrare Shqipe të Shkodrës morën pjesë një numër i madh klerikësh katolikë shkodranë, të cilët nuk e penguan, por e ndihmuan fuqishëm standardizimin e gjuhës shqipe mbi bazën e së folmes së Elbasanit. Ambroz Marlaskaj ishte i vetmi klerik, i cili kishte shprehur disa rezerva rreth vendimeve të Komisisë Letrare të Shkodrës pas përfundimit të punimeve të saj[13].

Gabimi më i madh në këto studime të botuara në kohën e monizmit qëndron aty se njolloset i tërë kleri katolik shqiptar dhe nuk flitet asnjëherë me emër e mbiemër për individë të caktuar dhe me fakte bindëse të argumentohet ajo që thuhet kundër tyre. Minimizimi i punës së klerikëve shkodranë në kohën e monizmit mund të argumentohet edhe me faktin se për veprimtarinë shumë të frytshme gjuhësore të Justin Rrotës, e cila kishte zgjatur më tepër se një

[12] A. KOSTALLARI, Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj, Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Prishtinë 1974, f. 33

[13] A. MARLASKAJ, Mbi ortografin e sotme, Hylli i Dritës, Shkodër 1921, nr. 3, f. 112

gjysmëshekulli, janë shkruar vetëm dy-tre artikuj të shkurtër shkencorë që bashkarisht nuk bëjnë as dhjetë faqe të plota shkrimi, edhe pse për veprimtarinë e tij të larmishme do të mund të shkruheshin studime të gjera monografike. Nuk duhet të injorohet as kontributi i madh që dhanë Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Prenk Doçi e të tjerët për formimin e shoqërive "Bashkimi" dhe "Agimi" të Shkodrës, për kontributin e dy të parëve, të dhënë në Kongresin e Manastirit, në të cilin Gjergj Fishta ishte në funksion të kryetarit të Komitetit të këtij Kongresit, ndërsa Ndre Mjeda anëtar i tij. Nuk mund të thuhet se Kongresi i Manastirit ishte një ngjarje e shënuar në veprimtarinë kombëtare të shqiptarëve që solli rezultate të mëdha në shkencën dhe në kulturën shqiptare e njëkohësisht të mohohet ose të mos përmendet asnjëherë kontributi i kryetarit të këtij Komiteti, Atë Gjergj Fishta, siç është vepruar gjer vonë.

Të gjitha këto lëshime, që janë bërë në të kaluarën rreth vlerësimeve të kontributit që kanë dhënë klerikët katolikë shkodranë, duhet të rivlerësohen duke u bërë studime të mbështetura objektive për rëndësinë që ka pasur veprimtaria e tyre për normëzimin e gjuhës shqipe gjatë gjysmës së parë të shekullit XX.

6. Nuk është vetëm veprimtaria e klerikëve shkodranë ajo që ishte minimizuar, madje edhe shtrembëruar gjatë gjysmëshekulli të sundimit monist në Shqipëri. Ka pasur edhe autorë të tjerë që kanë qenë të anatemuar dhe të ndaluar herë plotësisht e herë me ndonjë lëshim varësisht nga erërat politike që frynin në kreun e shtetit shqiptar. Kështu bie fjala, Faik Konica, personalitet i shquar i kohës së Rilindjes dhe të Pavarësisë, ka qenë vënë në shënjestër të kësaj propagande që nga ditët e para, prandaj për veprimtarinë e tij dhe sidomos për ndihmesën e madhe që kishte dhënë ai për zhvillimin e gjuhës letrare shqipe nuk është bërë fjalë asnjëherë. Është një numër i konsiderueshëm i studimeve të tij edhe në fushë të gjuhës letrare shqipe, të cilat ai i kishte hartuar para dhe pas vendosjes së tij përfundimtare në Amerikë, të cilat nuk janë bërë të njohura gjer sot. Kjo flet për një qëndrim jo të drejtë të institucioneve të shkencës gjuhësore shqiptare ndaj veprimtarisë së këtij autori të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe të periodës së Pavarësisë. Për hir të së vërtetës duhet thenë se gjatë sundimit monist ka qenë hartuar dhe mbrojtur me sukses në Fakultetin Filozofik të Prishtinës një tezë

magjistrature për veprimtarinë e Faik Konicës[14] në fushë të gjuhës letrare shqipe, veçanërisht me rëvisten e tij "Albania", ku vlerësohet shumë realisht kontributi që kishte dhënë Faik Konica në Historinë e gjuhës letrare shqipe, por ky studim nuk është botuar, sepse u binte ndesh pikëpamjeve aktuale të gjuhësisë shqiptare. Gjatë viteve '90 qenë hequr ndalesat për studime të këtilla dhe në Shkup një numër i revistës "Jehona"(1992, nr. 6) iu kushtua veprimtarisë letrare dhe gjuhësore të Faik Konicës.

6.1. Edhe më drastik është qëndrimi që është mbajtur ndaj studiuesit të shquar, Selman Riza, i cili tërë jetën ia kushtoi studimit të gjuhës shipe dhe la vepra kapitale edhe për Historinë e gjuhës letrare shqipe dhe për normëzimin aktual të saj, por veprimtaria e tij shekncore u la qëllimisht në harresë të plotë. Të përmendim vetëm faktin se ai standardizimit të gjuhës shqipe ia kushtoi tërë jetën. Riza kishte botuar për këtë qëllim jo një artikull të vetëm, si shumica e atyre që u morën me çështjen e standardizimit të gjuhë shqipe, por studime monografike të plota, siç ishte vepra e njohur "Tri monografina albanologjike"(1944). Megjithëkëtë, veprimtaria shkencore e Selman Rizës në këtë fushë studimesh qe minimizuar qëllimisht, sidomos pas burgosjes së tij pas Luftës II Botërore për shkaqe banale se nuk paska treguar simpati e dashuri për "vëllezërit" serbë dhe malazias. Pas ndryshimeve të ndjeshme në politikën e qeverisë shqiptare, sidomos në marrëdhëniet me Jugosllavinë, Riza në njëfarë mënyre qe rehabilituar dhe u lejua të punonte në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë të Tiranës, por nuk kaloi shumë kohë dhe në zbatimin e revolucionit kulturor shqiptar sipas modelit kinez ai përsëri u dënua dhe u dërgua të punonte në Berat si bibliotekist ku qëndroi gjersa u pensionua në vitet '80. Selman Rizës, i cili kishte merita të jashtzakonshme për studimin dhe standardizimin e gjuhës shqipe, nuk iu sigurua as një vend në mesin e qindra vendeve të rezervuara për pjesëmarrësit e Kongresit të Drejtshkrimit. Atij nuk iu lejua që të shkruante as edhe një artikull të vetëm gjatë kohës kur diskutoheshin Rregullat e drejtshkrimtit të shqipes-projekt(1967) për pesë vite të plota dhe as të diskutonte për ndonjë problem gjuhësor në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

[14] M. BLAKU, Roli i revistës "Albania" në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe(dorëshkrim magjistrature), Prishtinë 1978

Edhe monografia e tij e rëndësishme "*Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*", e cila ishte hartuar në vitet '60, nuk qe lejuar të botohej për tre dhjetëvjetësha me radhë, edhe pse ishte shfrytëzuar maksimalisht nga shumë gjuhëtarë, por pa u cituar asnjëherë. Akademia e Shkencave e Shqipërisë nuk ndërmori asgjë për t'i botuar veprat kapitale të Selman Rizës pas vdekjes së tij, madje as pas përfundimit të sistemit monist. Ç'është e vërteta ASHAK në dekadën e fundit ka bërë një punë të lavdrueshme duke botuar shumicën e veprave të Selman Rizës në katër vëllime të mëdha, mirëpo një punë e këtillë i binte hise Akademisë së Shqipërisë ta bënte, për arsye se pjesën më të madhe të këtyre veprave Riza i kishte hartuar dhe botuar në Shqipëri. Veç kësaj dihet se në truallin e Shqipërisë ai përjetoi të zezat më të mëdha dhe Tirana e kishte borxh t'ia botonte veprat shkencore, së paku për t'i zbutur pak padrejtësitë që ia kishte bërë gjatë gjithë jetës.

Janë këta vetëm disa nga shembujt që tregojnë injorimin e veprimtarisë së disa personaliteteve të shquara të shkencës gjuhësore shqiptare, të cilat sistemi monist nuk i pati për qejfi dhe i shkeli në mënyrën më brutale. Sigurisht që në kohën tonë dalin detyra për përmirësimin e këtyre padrejtësive të krijuara në kohën e monizmit.

7. Shumëçka mund të thuhet edhe për veprimet, gjithashtu të egra, të qarqeve politike të Serbisë, të Maqedonisë dhe të Kosovës dhe për dëmet që kanë sjellë ato gjatë përpjekjeve për standardizimin e gjuhës shqipe në këto anë. Shumë nga këto çështje i ka trajtuar në mënyrë shteruese Rexhep Ismajli në disa studime të tij, veçanërisht në studimin monografik të titulluar "*Në gjuhë dhe për gjuhën*"[15]. Sigurisht që ka vend edhe për studime të tjera të mbështetura për trajtimin e zhvillimit të tërësishëm të gjuhës letrare shqipe në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi në të gjitha periudhat dhe etapat e zhvillimit të saj. Edhe këto punë mbeten për t'u kryer në të ardhmen.

8. Nga sa u tha gjer këtu mund të vërehet qartë se ka shumë punë për t'u bërë gjersa të krijohen kushtet për hartimin e një teksti integral sintetizues të Historisë së gjuhës letrare shqipe. Disa çështje të trajtuara para dhe pas Çlirimit të Shqipërisë mund të shërbejnë si bazë

[15] R. ISMAJLI, Në gjuhë dhe për gjuhën, Pejë 1998

e mirë për këtë qëllim; disa probleme që janë trajtuar në të kaluarën, veçanërisht në kohën e sistemit monist duhet të rishqyrtohen dhe të rivlerësohen në mështetje objektive shkencore për t'u liruar nga shabllonet e gjuhësisë marksiste, të cilat shumë shpesh kanë qenë të ideologjizuara dhe pa mbështetje të nevojshme shkencore. Pas viteve '90 disa çështje kanë filluar të trajtohen mbarë, sidomos sa i përket vlerësimit real të zhvillimit historik të gjuhës letrare në të kaluarën. Edhe studimet e reja që janë bërë pas viteve '90 kanë një mbështetje shumë më të gjerë në gjuhësinë moderne që zhvillohet sot në botën perëndimore. Nuk mungojnë as studimet sociolinguistike, psikolinguistike dhe etnolinguistike nga të cilat do të ketë dobi jo vetëm gjuha standarde shqipe, por edhe Historia e gjuhës letrare shqipe.

Ndërkaq, për shumë probleme të tjera të patrajtuara nga kjo fushë, sidomos për kontributin e atyre që kanë merita për studimet nga fusha e gjuhës standarde shqipe dhe nga fusha e Historisë së gjuhës letrare shqipe, duhet të bëhen studime meritore shkencore. Të gjitha këto do t'i shërbejnë një qëllimi të përbashkët: hartimit të Historisë së gjuhës letrare shqipe, që do të ishte një arritje e madhe shkencore dhe kulturore për kombin shqiptar.

Enver HYSA

VEÇORI TIPOLOGJIKE DHE PROBLEME TË FORMIMIT TË FJALËVE NË SHQIPEN E SOTME

Në gjuhësinë shqiptare struktura e fjalës në kuptimin e gjerë të saj, struktura morfologjike dhe ajo fjalëformuese, në tërësi është trajtuar gjerësisht nëpër gramatikat e shqipes, që nga gramatika e parë e Da Leçes e vitit 1716 e deri në ditët tona.

Struktura e fjalës paraqet në një farë aspekti dhe veçoritë tipologjike e fjalëformuese të shqipes. Është pikërisht kjo arsyeja përse ajo ka tërhequr në mënyrë të vazhdueshme vëmendjen e gramatikanëve dhe të studiuesve të ndryshëm të shqipes. Natyrisht janë kryer shumë studime e të natyrave të ndryshme, por studimet që kanë hedhur themelet në fushën e formimit të fjalëve për shqipen do të mbeten studimet për parashtesat dhe prapashtesat e shqipes të A. Xhuvanit e E. Çabejt[1] dhe punimet e A. Kostallarit për kompozitat e tipave të ndryshëm[2].

Siç pohon me të drejtë prof. M. Domi, i pari studim për fjalëformimin e gjuhës shqipe, pas disa shënimeve të K. Kristoforidhit e disa të dhënave të ndonjë gramatike të gjuhës shqipe, është studimi i A. Xhuvanit *Prejardhja e pjesave të fjalës në gjuhën shqipe,* botuar së pari në disa numra të revistës *"Albania"* të F. Konicës në vitet 1906-1907[3].

Gjuha shqipe, si dihet, është një gjuhë analitike-sintetike, e cila për dhënien e nocioneve të reja përdor në një masë jo aq të papërfillshme edhe togjet e qëndrueshme të tipit *lule blete, lule dielli, lule mosmëprek, panxhar sheqeri etj.* Po ashtu në shqipe gjejnë

[1] A. Xhuvani – E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe,* në "Buletin i Institutit të shkencave", 4, 1956 dhe në "Çështje të gramatikës së shqipes së sotme"II, Tiranë, 1975.

[2] A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në "Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", I, Tiranë 1972; *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese,* po aty; *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes,* po aty, etj.

[3] M. Domi, *Prof. dr. A. Xhuvani (1880-1961). Jeta dhe vepra,* në "A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f. XXIX dhe 589.

përdorim të gjerë edhe trajta analitike, lokucione e trajta perifrastike për të dhënë njësi e kuptime gramatikore të veçanta, siç janë format e veçanta foljore të tipit *kam për të punuar, do të punoja* e *do të kisha punuar, jam* e *isha duke punuar* etj. Por mjeti themelor i zakonshëm i saj për dhënien e njësive të reja mbetet formimi i fjalëve të reja duke përdorur gjerësisht ndajshtesimin dhe kompozimin si dy nga mënyrat më prodhimtare. Vështrimi i veçorive themelore të strukturës fjalëformuese të shqipes, si një nga elementet e strukturës së shqipes në përgjithësi, edhe pse nuk mund të japë ajo vetë një ide të plotë për këtë strukturë, prapëseprapë është me interes sepse nxjerr në dritë specifikën e shqipes në këtë fushë, që, ndër të tjera, mund të shërbejë si bazë për studime krahasuese të kësaj natyre edhe me gjuhë të tjera.

Studimet për strukturën fjalëformuese të shqipes e kanë vështruar formimin e fjalëve si një sistem më vete, të lidhur ngushtë me leksikun, me semantikën dhe me gramatikën dhe përgjithësisht në këto studime janë bërë analiza të thelluara strukturore e semantike, duke zbuluar veçori të rëndësishme tipologjike të shqipes. Studimet e kryera për mjetet themelore të prejardhjes dhe për tipat më të pasur të kompozitave kanë dëshmuar se gjuha shqipe ka mundësi të mëdha reale për formimin e fjalëve të reja nga "mielli" i vet dhe nga kjo pikëpamje mund të krahasohet me të gjitha gjuhët indoevropiane që i kanë të zhvilluara e të pasura këto mënyra, dhe se nga pikëpamja e larmisë së modeleve e të tipave gjuha shqipe ka të njëjtat mundësi si dhe gjuhët e tjera indoevropiane. Në ditët e sotme gjuha shqipe karakterizohet, ndër të tjera, nga pasurimi i vrullshëm i leksikut të saj dhe ky pasurim, ashtu si për gjuhë të tjera, realizohet së brendshmi, do me thënë me mjetet e saj, por dhe së jashtmi, do me thënë nëpërmjet huazimeve.

Si u tha në fillim, shqipja përdor gjerësisht si mjete dhe mënyra analitike ashtu dhe mjete dhe mënyra sintetike. Por duhet theksuar se një përfundim i rëndësishëm që del nga studimet e deritanishme për formimin e fjalëve është se rregullsia themelore që dallon sistemin fjalëformues është gjallërimi shumë i madh i mënyrave dhe mjeteve që sjellin krijimin e njësive leksikore sintetike. Kjo do të thotë se formimi i fjalëve është sot fusha ku duket mjaft më qartë prirja e shqipes drejt sintetizmit strukturor. Në gjallërimin e jashtëzakonshëm të këtyre mënyrave ndikojnë një varg faktorësh, sidomos për sferën e

terminologjisë edhe zgjerimi i kontakteve me gjuhët e huaja, por si faktor themelor që përcakton këtë gjallërim mbetet vetë sistemi fjalëformues i shqipes, me mundësitë e mëdha potenciale, të cilat, siç është pohuar me të drejtë, kanë filluar të vihen në jetë me ritme gjithnjë e më të dendura e në mënyrë më sistematike që nga koha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Një tjetër veçori themelore tipologjike e sistemit fjalëformues të shqipes së sotme, siç është vënë re në studime të ndryshme, është thellimi e zgjerimi i dukshëm i prirjes për një veprim të ndërlidhur e të ndërvarur të mënyrave e tipave të ndryshëm fjalëformues. Kështu, p.sh. vihet re gjallërimi i njëkohshëm i formimit të emrave të vepruesit nga njëra anë, dhe i mbiemrave foljorë nga tema e pjesores së gegërishtes: *dëgjues / i dëgjueshëm, lexues / i lexueshëm*; ose gjallërimi paralel i emrave abstraktë nga njëra anë, dhe i formimeve ndajfoljore me prapashtesën *-(i)sht* nga ana tjetër, si *gjallëri, marrëzi, detyrim* dhe ndajfoljet përkatëse *gjallërisht, marrëzisht, detyrimisht*, ose nga një anë rritja e njëkohshme e prodhimtarisë së mbiemrave të përbërë pronësorë dhe nga ana tjetër rritja e emrave abstraktë që formohen prej tyre me prapashtesa, si *zemërgjerë / zemërgjerësi, shpirtngushtë / shpirtngushtësi*, zhvillimi paralel i mbiemrave dhe i ndajfoljeve me prapashtesën *–shëm,* si *i hareshëm / hareshëm, i këndshëm / këndshëm, i gëzueshëm / gëzueshëm* etj.[4]

Nga pikëpamja e prodhimtarisë mund të pohohet se shqipja e sotme po e rrit leksikun e saj me formime prapashtesore që shënojnë fusha e degë të ndryshme të veprimtarisë ekonomiko-shoqërore, kulturore, shkencore, procese të shumëllojshme të veprimit, tipare, veti e cilësi të përgjithshme. Për të provuar këtë do të mjaftonte t'u hidhej një vështrim i shpejtë fjalorëve të shumtë terminologjikë që janë që janë botuar gjatë këtyre 50 viteve të fundit.

Përsëritja e së njëjtës gjedhe prejardhjeje (derivacioni) në një numër relativisht të madh a relativisht të vogël njësish mund të jetë tregues i prodhimtarisë ose mungesës së prodhimtarisë së këtij ose atij

[4] Shih më gjerësisht për këto A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, në rev. "Studime filologjike", 1970, 2 dhe në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", I, Tiranë, 1972, si dhe E. Hysa, *Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare*, në rev. "Gjuha jonë", 1985, 1.

tipi fjalëformues, i këtij ose atij mjeti fjalëformues. Duke u nisur nga ky kriter mund të pohohet se prodhimtaria më e madhe vihet re te prapashtesat që formojnë emra vepruesi, emra mjetesh, emra abstraktë përgjithësisht e emra veprimi veçanërisht, mbiemra e ndajfolje, si dhe folje të tipave të ndryshëm, sidomos folje veprimi me prapashtesën *-o* e format e zgjeruara të saj *-so,-ro, -ro* etj.

Kështu, po të vështrohen emrat abstraktë në veçanti, do të vihet re se në shqipen e sotme kjo është një nga klasët semantike të fushës së emrave, e cila po pasurohet më tepër. Në shqipen e sotme ka mbi 50 prapashtesa që formojnë emra dhe nga këto mbi 15 prej tyre shërbejnë për të formuar emra abstraktë. Natyrisht jo të gjitha ato janë në të njëjtën masë aktive si për të formuar emra në përgjithësi ose emra abstraktë në veçanti. Në shqipen e sotme duket qartë përqendrimi i gjallërisë fjalëformuese kryesisht te dy grupe prapashtesash që formojnë emra abstraktë: te prapashtesat *-im* dhe *-je*, që formojnë emra abstraktë veprimi nga tema foljore dhe te prapashtesat *-i, -(ë)ri, -(ë)si,* që formojnë emra abstraktë vetie a cilësie, kryesisht nga tema mbiemërore, si *gjallëri, shkathtësi, kalueshmëri* nga mbiemrat përkatës *i gjallë, i shkathtë, i kalueshëm* etj. Rritja e formimeve me emra abstraktë, si pjesë e sistemit fjalëformues të shqipes, lidhet ngushtë me zhvillimin e përgjithshëm të leksikut, i cili kushtëzohet, ndër të tjera, dhe nga faktorë jashtëgjuhësorë. Me këtë shpjegohet dhe prodhimtaria gjithnjë e më e madhe që vihet re në shqipe që nga koha e Rilindjes Kombëtare ose rritja e ndjeshme e formimeve abstrakte në ditët tona.

Përgjithësisht mund të themi se denduria dhe rritja e zhvillimit të formimeve në fushën e emrave, p.sh. për kategori të veçanta semantike, është e lidhur dhe me procesin e mënjanimit të formimeve jondajshtesore, siç janë emrat prejfoljorë asnjanës të paranyjëzuar, karakteristikë kryesisht për periudhën Rilindjes Kombëtare, por edhe për gjuhën e shekujve XVI- XVIII, me formime prapashtesore, që lidhen ngushtë sigurisht edhe me procesin e mënjanimit të asnjanësit në gjuhën shqipe të ditëve tona, proces që ka filluar dhe ky shumë kohë përpara.

Së fundi, do të theksojmë se, krahas mjeteve fjalëformuese të trashëguara të burimit indoevropian dhe mjeteve të reja që janë formuar gjatë zhvillimit të saj si gjuhë më vete, shqipja nëpërmjet kontakteve të shpeshta, të drejtpërdrejta e të shumanshme me gjuhë të tjera së bashku

me fjalët ka huazuar dhe disa mjete fjalëformuese, parashtesa e prapashtesa, të cilat janë integruar në sistemin e mjeteve fjalëformuese të shqipes. Leksiku i huazuar i një gjuhe ndodhet, si dihet, nën ndikimin e trysnisë së përhershme të sistemit gramatikor e fjalëformues të gjuhës marrëse. Në këto kushte shumë parashtesa dhe prapashtesa të shqipes bashkohen me lehtësi me tema të huazuara dhe për më tepër e shtojnë në këtë mënyrë procesin e asimilimit të tyre, ndërsa ndajshtesat e huaja bashkohen më rrallë me tema shqipe dhe kjo bën që ato përgjithësisht të mbeten të izoluara ose të dalin në periferi të përdorimit, duke u zëvendësuar me mjete fjalëformuese vendi. Por natyrisht jo në të gjitha rastet ky zëvendësim, me gjithë përpjekjet, është i mundshëm.

Duke vënë në dukje disa nga veçoritë tipologjike të sistemit fjalëformuese të shqipes, që dalin nga studimet e kryera në këtë fushë, është rasti të theksojmë se para gjuhësisë shqiptare në këtë fazë të studimeve për formimin e fjalëve, kur janë studiuar mënyrat dhe mjetet themelore fjalëformuese - parashtesimi, prapashtesimi e kompozimi fjalëpërbërja), kur është studiuar formimi i pjesëve kryesore të ligjëratës, si emri, folja, ndajfolja e mbiemri, kur janë trajtuar disa nga problemet teorike të kësaj fushe e formime të klasave të veçanta semantike me mjete të ndryshme fjalëformuese, dalin në plan të parë çështje të studimit të gjuhës popullore në planin fjalëformues, çështje të studimit të gjuhës së medies së shkruar dhe elektronike, ku vihen re procese mjaft interesante në krijimin e fjalëve të reja me mjete vendase e të huazuara, çështje të formimit të fjalëve në një korpus të nxjerrë nga letërsia dhe shtypi i Rilindjes e i periudhës së Pavarësisë etj.. Mendoj gjithashtu, se pas hartimit të veprave themelore të gjuhësisë shqiptare, si *Gramatika e gjuhës shqipe*, *Fjalori shpjegues i gjuhës shqipe* e *Atlasi dialektologjik i shqipes*, i cili më në fund doli nga shtypi këto kohët e fundit dhe pas hartimit të një kreu përgjithësues për strukturën e fjalës, hartuar nga prof. E. Lafe, si një kre i veçantë i *Gramatikës së Akademisë*[5], ka ardhur koha dhe është bërë e domosdoshme të hartohet një traktat i formimit të fjalëve, duke u bërë kështu si një nga projektet e ardhshme të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare në këtë fushë studimesh.

[5] Shih *Gramatika e gjuhës shqipe, I, Morfologjia*, Tiranë, 2002, f. Kreu Struktura e fjalës është hartuar nga E. Lafe.

Resmije KRYEZIU

ASPEKTE TË MENDIMIT KRITIK NË VITET ‘30

Në historinë e Shqipërisë dhe përgjithësisht në jetën e saj shoqërore, shpallja e pavarësisë, hap një periudhë të re të të menduarit dhe të të jetuarit. Robëria pesëshekullore kishte lënë të pazgjidhura probleme të mëdha shoqërore. Si pasojë e shkallës së ulët të zhvillimit ekonomik të vendit, edhe shkalla e zhvillimit kulturor ishte, po ashtu, e ulët. Prandaj, kur trajtojmë problemet e shoqërisë shqiptare të kësaj periudhe, është e domosdoshme t’i kemi parasysh edhe këto rrethana.

Klima kulturore në Shqipërinë e viteve ‘30 në përgjithësi karakterizohet nga tendencat e klimës kulturore evropiane, të cilat në atdhe i sollën studentët shqiptarë që studionin nëpër qendrat e Evropës.

Zhvillimi i shtypit ka qenë çelësi dhe shtysa kryesore që do t’u paraprijë e do të shtyjë trajtimin shumë çështjeve me rëndësi kulturore në shoqërinë shqiptare të kësaj kohe. Në vitet ‘30 në Shqipëri botoheshin një numër i konsideruar gazetash, revistash e organesh të specializuara, me përmbajtje politike, shoqërore, fetare dhe letrare, të cilat patën një ndikim të padiskutueshëm në formimin e opinionin publik të kohës.

Këto shkrime, edhe nga këndvështrimi i sotëm kanë rëndësi të veçantë, sepse pasqyrojnë rrjedhat e prirjet e mendimit kritik të inteligjencies së asaj kohe.

Qëllimi i inteligjencies së viteve të 30 ishte që nëpërmjet të ribërjes së ndërgjegjes kombëtare të arrihej një ndryshim cilësor dhe tërësor i botës shqiptare. Për këtë arsye në shkrimet e tyre si temë qendrore do të paraqitet trajtimi i problemeve të mprehta të shoqërisë shqiptare në përgjithësi. Me evidentimin dhe luftimin e plagëve, pasojë të raporteve pararendëse, të trashëguara nga rrethanat historiko-shoqërore, do të synohet zhbllokimi i zhvillimit të Shqipërisë dhe inkuadrimi i saj sa më parë në rrjedhat kulturore e ekonomike të Evropës. I jepej përparësi faktit se kjo mund të arrihej me një mbështetje shumë të nevojshme nga ana e fuqive të mëdha

perëndimore. Ribashkimi me Evropën Perëndimore kërkonte edhe krijimin e një identiteti të ri, qoftë kombëtar, qoftë shtetëror, sepse identiteti evropian i shqiptarëve kishte humbur me shembjen e shtetit të Skënderbeut. E ndarë në dysh ndërmjet forcave që lidheshin me mendësinë otomane nga njëra anë dhe atyre përparimtare në anën tjetër, që e synonin Perëndimin, Shqipëria po vendnumëronte.

Debatet dhe polemikat ndërmjet këtyre dy forcave politike në të shumtën e rasteve, në vend që të ofronin zgjidhje të duhura, prodhonin diskutime shterpe, shumë të dëmshme në rrafshin kombëtar dhe shtetëror.

Mos të harrojmë se kur Shqipëria kërkonte shtigje të afrimit sa më të shpejtë me Evropën, ishte koha e fashizmit dhe e përpjekjes për të penguar përhapjen e komunizmit.

Për dallim nga të tjerë, shqiptarët konceptonin fashizmin dhe nazizmin ndryshe: ata synonin të merrnin nga ato idenë e unitetit dhe të përbashkësisë shumë të nevojshme për ngritjen e vetëdijes kombëtare, mendësi kjo e nevojshme në rrugën e vështirë të ribërjes së shtetit të pavarur shqiptar."Para se të çnderohej nga krimet e tij, fashizmi ka qenë një shpresë. Ai ka joshur jo vetëm miliona njerëz por edhe shumë intelektual".[1]

Me qëllim të reformimit të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare, neoshqiptarizma, lëvizje mendore e kohës, duhej të bëhej ideologji gjithëshqiptare, mbi të cilën do të ndërtohej platforma për veprime politike, ekonomike dhe kulturore.

Branko Merxhani, Vangjel Koça, Ismet Toto, Nebil Çika, Jani Lili e mendimtarë të tjerë liberalë demokratë, ishin ideologët e këtyre përpjekjeve. Qëllimi kryesor i tyre, përmes kësaj ideologjie ishte bashkimi, qoftë edhe në mënyrë virtuale i të gjitha pjesëve të trungut kombëtar, të lëna pa të drejtë jashtë kufijve natyrorë, historikë dhe objektivë të Shqipërisë.

Kjo mendësi shqiptare asnjëherë nuk do të mbështetej në teorinë e racës dhe asnjëherë nuk do të propagandojë mbizotërimin e shqiptarëve ndaj të tjerëve.

---

[1] François Furet, E shkuara e një iluzioni – ese mbi idenë komuniste në shekullin XX, Dukagjini, Pejë 2003, f.13.

Një pjesë e intelektualëve shqiptarë, duke mos pasur fuqinë t'i kundërviheshin ideologjisë fashiste, zgjodhën rrugën për t'u bërë pjesë e superstrukturës së saj, me të vetmin qëllim - ruajtjen dhe zhvillimin e lëvizjes së rimëkëmbjes intelektuale shqiptare në një klimë të brishtë të lirisë shtetërore. Po të pengohej mëkëmbja e nisur, dëmet që do t'i shkaktoheshin ribërjes së Shqipërisë do të ishin shkatërruese.

Ernest Koliqi, duke e marrë postin e ministrit të Arsimit në Qeverinë e Mustafa Krujës nën pushtimin fashist të Shqipërisë, i kishte shtruar vetes qëllimin që nga ideologjia fashiste të nxirrte vlerat e saj thelbësore dhe ato t'i zbatonte te shqiptarët. Dhe ato vlera ishin: organizimi i energjisë kombëtare në drejtim të përparimit, shkëputja nga e kaluara dhe kërkimi i së resë. Mbas Ernest Koliqit do të qëndronin edhe forcat e tjera të inteligjencies shqiptare, të cilat përtej fashizmit shihnin kombëtaren dhe mirëqenien e shtetit shqiptar.

Kështu shqiptarët do të përpiqeshin të modifikonin doktrinën fashiste sipas nevojave kombëtare. Derisa fashizmi italian nuk njihte asnjë vlerë të së kaluarës së afërt dhe forcën e vet e mbështeste vetëm në rrënjët e kulturës romake, shqiptarët forcën e tyre synonin ta mbështesnin në lidhjet me Ilirikumin dhe bashkëkohësinë evropiane. Edhe shenja e Liktorit, stema e fashizmit, mund të përdorej në të mirë të kombëtares, sepse kishte qëllim bashkimin e "thuprave" të shkapërderdhura.

Sëpata, që ishte në mes të shenjës së Liktorit, që në ikonografinë fashiste simbolizonte forcën e armës, me të cilën fashistët e bashkuar rreth idesë së fashizmit do t'i qëllojnë armiqtë pa mëshirë, sado që nuk u drejtohej shqiptarëve, edhe ajo do të mund të komentohej në të mirë të tyre, si armë e nevojshme për përshpejtimin e bashkimit të "thuprave", pjesëve të qenies sonë kombëtare, padrejtësisht të shkëputura nga trungu kombëtar shtetëror. Mbi këtë filozofi vepronin të dy krahët e inteligjencies shqiptare. Njëzëshmëria në rrafshin kulturor dhe në rrafshin politik shqiptar të asaj kohe ishte shprehja më e mirë e angazhimit të përbashkët për rimëkëmbjen e Shqipërisë. Siç thotë Eqrem Çabej se Shqipëria në këtë territor, kishte arritur pas tkurrjeve të mëdha.

Mbështetur në këtë konstatim të drejtë shkencor, mballoma fashiste, në veprat dhe angazhimet e një pjese të inteligjencies

shqiptare të asaj kohe, ishte thirrje për mbrojtje nga forcat centrifugale.

Tendencat e së resë, të hetuara në planin politik, hetohen edhe në planin e krijimtarisë imagjinatave.

Intelektualë të paktë të kohës, të cilët kishin studiuar në vende të ndryshme të Evropës, e ndienin për detyrë dhe obligim moral që dijet e marra atje t'i sillnin dhe t'i bartnin në Shqipëri.

Letërsia kuptohej si një fushë në të cilën intelektualët mund ta jepnin ndihmesën e tyre, me shkrimet letrare e me studimet letrare.

Në Shqipëri asokohe botohen një numër i konsiderueshëm gazetash e revistash, në faqet e të cilave gjithnjë do të botohen një apo dy shkrime për artin dhe letërsinë. Shkrimet e kësaj kohe që i referoheshin fushës së letërsisë, në të shumtën e herëve, do të karakterizohen me qasje subjektive. Shquajnë edhe diskutimet polemizuese, të paliruara nga paragjykimet e përkatësia krahinore apo fetare të autorëve të shkrimit apo nga përkatësia krahinore e fetare e botuesit të gazetës apo revistës.

Shkrimet, diskutimet dhe debatet, sado të menduara nga autorët e tyre si qëllimmira për letërsinë dhe kulturën në përgjithësi, të shumtën e rasteve nuk do të kenë qëllim analiza veprash autorësh të ndryshëm, as qasje me karakter historiko-letrar, por, më tepër, do të synojnë të përcaktojnë "madhësinë" apo "vogëlsinë" e veprave a autorëve të caktuar. Në këtë mënyrë do të paraqiten edhe pamflete të ashtuquajtura letrare, në të cilat do të zhvillohen polemika nëse Ndre Mjeda është poet më i madh se Lasgush Poradeci, nëse Fishta është poet me ***P*** të madhe apo me ***p*** të vogël, apo më në fund nëse shkrimtari më i mirë i të gjitha kohëve është poet Lasgush Poradeci apo Ndre Mjedja *lyriku ma i madhi i Shqipnis*.

Ambienti kulturor i paformuar mirë dhe drejt në Shqipërinë e sapodalë nga robëria, krijonte mundësinë që, pavarësisht nga përgatitja a niveli kulturor, me kritikë të merreshin edhe njerëz të papërgatitur dhe jo të fushës, prandaj në shkrimet e kësaj kohe nuk janë të rralla rastet kur shkrimtarët e vegjël dhe të parëndësishëm shpalleshin të mëdhenj dhe anasjelltas. Prania e qëndrimit subjektiv në përzgjedhjen e autorit dhe të veprës për trajtim bën që në këto shkrime të gjejmë rrallë të trajtuara çështje thelbësore të vlerësimit të letërsisë,

në të vërtetë të gjejmë më shumë të trajtuara çështje krejtësisht joletrare dhe të parëndësishme.

Në periodikun e kohës janë të pakta shkrimet e kritikës analitike, vlerësimet objektive dhe trajtimet serioze. Mungesa e kritikës së mirëfilltë letrare do të paraqitet sfidë jo e lehtë për historianët e letërsisë, për përpunimin e prodhimit letrar të kohës në mbështetje të kritereve shkencore të historisë së letërsisë. Ç'është e vërteta, në këtë situatë të përgjithshme të mendimit kritik, përveç shkrimeve informative dhe thjesht gazetareske lidhur me krijimet letrare, në periodikun shqiptarë të kohës do të gjejmë edhe autorë seriozë, me shkrime vlerësuese objektive për vepra dhe për autorë të ndryshëm.

Në disa nga këto shkrime vërehet përdorimi i metodave të ndryshme analizuese në varësi nga përgatitja e autorit dhe nga njohuritë e tij për letërsinë dhe kritikën letrare. Të shumtën mbizotëron, kritika pozitiviste, ekspresioniste e impresioniste. Autorë të parapëlqyer në të cilët mbështetën kritikët e kësaj kohe janë Sent Bevi, Hypolit Teni e sidomos Benedeto Kroçe.

Edhe pse pikëpamjet e autorëve të këtyre shkrimeve shquajnë për nga niveli me të parat, me shkrimet informative për letërsinë, ose me ato me karakter polemizuese, mund të thuhet se ndër ta do të spikasim mosnjohje, dobësi e lëshime.

Për të qenë më të saktë në vlerësimin e mendimit kritik të kësaj periudhe është i domosdoshëm rivlerësimi i kësaj periudhe, për më tepër kur dihet se heshtja për të ka zgjatur së tepërmi për arsyet e mirënjohura që dalin nga konteksti shoqëror e kulturor. Edhe vetë lënia e tyre anash, larg dritës vezullues të metodës së socrealizmit, me një fjalë ekskomunikimi i tyre i padrejtë, e bën të domosdoshëm një rikthim dhe një rilexim të pjesës dërrmuese të autorëve përfaqësues të denjë të mendimit kritik shqiptar të kohës.

Remzi PËRNASKA

SPROVË PËR FORMALIZIM TË DISA VLERAVE TË SË PAKRYERËS SË DËFTORES NË GJUHËN SHQIPE

Kujtimit të gjuhëtarit premtues kosovar, Tafil Kelmendit.

Tri janë arsyet kryesore që na shtynë të zgjedhim për trajtim këtë temë:

1. Gjuhësia botërore ka hyrë në një fazë të re hetimesh, është duke bërë një hop të ri cilësior, edhe falë tri drejtimeve hetimore: kompjuterizimit, kognicionit dhe origjinës së gjuhës. Drejtimi kryesor tani për tani mbetet kompjuterizimi[1]. Me kompjuterizim nuk duhet

[1] Letërsia shkencore kushtuar këtyre problemeve është shtuar me shpejtësi të madhe dhe po merr përmasa tejet të gjera. Në pamundësi të citohen as për së largu shterueshëm, ja disa botime kryesisht në frëngjisht, sa për fillim: R. Carré, J.-F. Degrémont, M. Gross, J.-M. Pierrel, G. Sabah, *Langage humain et machine*, Paris, 1001; M.-O. Cordier, "Les systèmes experts", *La recherche en intelligence artificielle*, 1, 1987; A. Culioli, "La formalisation en linguistique", *Cahiers pour l'analyse*, n° 9, Paris, 1968; J.-P. Desclés, *Opérateurs/opérations: Méthodes intrinsèques en informatique fondamentale: application à la linguistique et aux bases de données*, Thèse d'Etat en mathématiques, Université de Paris V, 1980; "Mathématisation des concepts linguistiques", *Modèles linguistiques*, tome II, fascicule I, Lille, 1980, "Construction formelle de la catégorie grammaticale de l'aspect (essai)", *Notion d'aspect*, Paris, 1980, "The concept of state, process, event and topology", *General Linguistics*, v. 29, n° 3, The Pennsylvania State University Press, University Park and London, 1990, f. 159-200; *Langue naturelle et cognition*, Paris, 1990; *Langages applicatifs, langues naturelles et cognition*, Paris, 1990; J.-P. Desclés, P. Cintas "Formal representation of the French present tense", *Papers from the XIIth Linguistic Symposiumon romance Languages,* Amsterdam, Philadelphia, 1982; D. Battistelli, J.-P. Desclés, "Aspects, modalités d'action et raisonnements", *Actes du colloque international VEXTAL,* Venise, 1999, f. 351-359; C. Fuchs, *Linguistique et traitements automatiques des langues*, Paris,; R. Grishman, *Computational linguistics. An introduction*, Cambridge University Press, 1986; H. Kamp, "Events, instants and temporal reference", *Semantics from differtent points of view*, Berlin, 1979, f. 376-417; J. Pitrat, *Textes, ordinateurs et compréhension*, Paris, 1985; F. Rastier, "Sémantique et intelligence artificielle", *Langages*, N° 87, Paris, 1987; G. Sabah, *L'intelligence aretificielle et le langage*, dy vëllime, Paris, 1988; R. Schank, P. Childers, *The cognitive computer: on language, learning and artificial intelligence*, Reading Mass., 1984; F. Segond, J.-P. Chanod, "Grammaire

kuptuar vetëm përdorimi i kompjuterit.[2] Në hetime gjuhësore, kompjuterin e përdorin sot edhe ata që nuk bëjnë gjuhësi kompjuterike. Kompjuterizimi si skaj gjuhësor ka shtrirje shumë më të gjerë, është mënyrë të vështruari e gjërave, mënyrë të menduari dhe të vepruari.

Një aspekt i veçantë i kompjuterizimit është kalimi nga një gjuhë natyrore në një gjuhë universale, të kuptueshme jo vetëm prej specialistëve të gjuhësisë, por edhe të logjikës, psikologjisë, matematikës, informatikës, etj.

Njëra prej rrugëve është formalizimi. Albanologjia ka nevojë të ditës, të kompjuterizojë (të informatizojë), dhe në këtë hulli, ndër të tjera, të formalizojë që të kalojë në një fazë më të lartë cilësiore, çka përbën edhe synimin e kësaj Konference.

2. E pakryera është kategori e ndërlikuar, ndaj ka joshur gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj, si nga pozitat e gjuhësisë së përgjithshme, ku ajo shërben si bazë kundërvënieje edhe për hetimin e marrëdhënieve aspektore e të mënyrës së veprimit në gjuhët natyrore, ashtu edhe nga ato të gjuhësive të veçanta.

3. Më jep rastin që t'i bëj homazh kujtimit të gjuhëtarit të talentuar dhe premtues kosovar, Tafil Kelmendit që u ka kushtuar një studim të tërë vlerave të së pakryerës, botuar si libër me titullin *Funksionet e kohës foljore të pakryer të dëftores në shqipen e sotme letrare*, Prishtinë, 1993. Përfitoj gjithashtu nga rasti që të vë në dukje se gjuhëtari tjetër kosovar Zeqir Sadiku ka dhënë ndihmesë shumë të mirë për hetimin e thelluar të sistemit kohor-aspektor të gjuhës shqipe.

---

applicative: traitement informatique à composante morpho-syntaxique", *Mathématiques informatiques et sciences humaines*, n° 103, Paris, 1988; T. Vinograd, "Les logiciels de traitement des langues naturelles", *Pour la science*, n° 85, Paris, 1984; N. Vazov, *L'identification des valeurs aspecto-temporellesdes situations en vue d'un traitement automatique*; S. Gjinushi, *Elemente të logjikës matematike,* Tiranë, 1987, e shumë e shumë të tjerë.

[2] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 2006, f. 478: "kompjuterizoj *kal.* -ova, -uar hedh e përpunoj në kompjuter tekste a të dhëna të ndryshme, sipas një programi të caktuar: *kompjuterizoj kartotekën e leksikut*".

*

* *

Këto forma foljore emërtohen jo sipas kategorisë së kohës, megjithese quhen forma kohore, por sipas aspektit, ndaj edhe quhen të pakryera. Por ky është problem që duhet trajtuar më vete.

Gjithsesi, këtu do të bëhet një përpjekje e përkohshme dhe e pjesshme për të formalizuar vetëm disa prej vlerave të atyre formave foljore që emërtohen si të pakryera të mënyrës dëftore. Për më tepër, e pakryera do të merret e shkëputur prej kohëve të tjera të së shkuarës, nuk do të hetohet në kundërvënie me to. E shkëputur do të merret ajo edhe nga të pakryerat e mënyrave të tjera.

Formalizimi i këtyre vlerave do të jetë me mëtime vetëm lokale, të pjesshme dhe të përkohshme, domethënë vetëm për vlerat espektore-kohore të së pakryerës së shqipes.

Gjuhëtarë të rinj, më të përgatitur për t'ua hyrë këtyre punëve, mund t'i përsosin këto formalizime që po jepen më tej. Dhe të tillë ka tashmë edhe për gjuhën shqipe[3]. Madje edhe tekste mësimore ka për

[3] B. Kabashi, *Modellierung und Implementierung einer LA-Grammatik fuer ein fragment des Albanischen*. Unpublisht manuscript. Computerlinguistik, Univ. Erlangen-Nuernberg,1999, *Automatische Wortformerkennung fuer des Albanische*, Master's thesis in 'Linguistische Informatik' (Computational Linguistics), Univ. Erlangen-Nuernberg, 2003, "Analiza automatike e fjalëformave të gjuhës shqipe", *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, XXXIII, v. 23/1, Prishtinë, 2005, "Disa propozime për modelimin e informacionit në leksikografinë kompjuterike", *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, XXXIV, Prishtinë, 2005*,* "Zeichen für Gjon Buzuku. Die Zusammenarbeit zwischen der albanischen Linguistik, *Nach 450 Jahren. Buzukus 'Missale' und seine Rezeption in unserer Zeit (Albanische Forschungen 25*), Wiesbaden, 2007, "Pronominal clitics and Valency in Albanian. A computational linguistics prespective and modelling within the LAG-Framework*", Valency. Theoretical, descriptive and cognitive issues*, Berlin, 2007; K. Lagji, "Étude sur le statut du mot en albanais dans le cadre des traitements automatiques des langues", Annotation automatique de relations sémantiques et recherches d'informations: vers de nouveaux accès aux savoirs, Paris, 2006; A. Murzaku, Albanian inverse dictionary, në internet http://www.lissus.com/resources_download.htm; O. Piton, R. Përnaska, "Etude de l'albanais en vue de construire des outils pour son traitement automatique", Journées NooJ, Besançon, 2005, O. Piton, R. Përnaska, "Construction de dictionnaires électroniques pour l'albanais, et grammaire du groupe nominal avec NooJ", Belgrade, 2006; O. Piton, K. Lagji, R. Përnaska, "Electronic Dictionaries

këtë lloj gjuhësie në gjuhën shqipe[4].

Për format e së pakryerës ka njoftime me interes në të gjitha gramatikat e shqipes. Edhe punime të veçanta monografike merren edhe me këto forma. Ne jemi mbështetur kryesisht në vlerat e së pakryerës së mënyrës dëftore që përshkruan T. Kelmendi, i cili sintetizon edhe arritjet e të tjerëve.[5]

---

and Transducers for Automatic Processing of the Albanian Language", *Natural Language Processing and Information Systems,* 2007, f. 407-413, etj.

[4] Si, p.sh., K. Lagji, *Hyrje në gjuhësinë kompjuterike. Përpunimet automatike të gjuhëve dhe gjuha shqipe*, Tiranë, 2002, 154 f.

[5] T. Kelmendi, *Funksionet e kohës foljore të pakryer të dëftores në shqipen e sotme letrare*, Prishtinë, 1993, 292 f. Shihni, ndër të tjerë, edhe: Boretzki, "Perfekt und plusquamperfect in einem nordostalbanischen dialekt", *Beiträg ezür Südosteuropa-Forschung*, München, 1966*;* Sh. Demiraj, "Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, Tiranë, 1971, nr. 4, "Rreth kategorive të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, Tiranë, 1971, nr. 3; S. Riza, *Sisemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore,* Tiranë, 1994; Z. Sadiku, "Funksionet semantike kohore, aspaktore dhe modale të imperfektit të gjuhës shqipe", *Gjurmime albanologjike, seria e shkencave filologjike,* (1974), nr. 4, Prishtinë, 1975; A. Dodi, "Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, Tiranë, 1968/1; E. Hysa, "Rreth përdorimeve të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, Tiranë, 1975, nr. 3; R. Ismajli, "Funksionimi i kohëve të foljes", *Shumësia e tekstit*, Prishtinë, 1977, "Rrëfim/koment dhe funksionet e foljeve", *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit* (1706), Prishtinë, 1985;; A. Zhugra, "Mbi disa trajta foljore perifrastike me kuptime aspektore në gjuhën shqipe", *Seminari për Kulturën Shqiptare*, Nr 7 (1979), Prishtinë, 1880; A. Sytov, "Opozicionet aspektore në gjuhën shqipe", *Seminari për Kulturën Shqiptare*, Nr 12 (1984), Prishtinë, 1885; J. Mindak, "Mbi kategorinë e kohës dhe të aspektit në gjuhën shqipe", *Seminari për Kulturën Shqiptare*, (1984), nr. 10, Prishtinë, 1985; F. Agalliu, "Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore", *Studime filogjike*, Tiranë, 1968/2, "Mbi pjesëzën *po* në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1982, 2, "Mbi një dukuri të përshtatjes së kohëve në gjuhën e sotme letrare shqipe", *SF*, 1984, N° 4; A. Dhrimo, "Paralelizma kuptimorë ndërmjet trajtave foljore me *po* dhe *jam+përcjellore*", *Studime për nder të A. Xhuvanit*, Tiranë, 1985, "Bedeutung unds Gebrauch des Aorists im Albanischen" (Kuptimi dhe përdorimi i së kryerës së thjeshtë në shqipen), *Aspekte der Albanologie – Akten des Kongresses 'Stand und Aufgaben der Albanologie heute',* 3. = 5. Oktober 1988, Univerzität zu Köln, Berlin, 1991, f. 89-97, *Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1996; K. Kapllani, "Mbi kuptimet dhe përdorimet e së kryerës së thjeshtë në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1984, N° 2; J. Panolli, "Çështje të sistemit kohor të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1992, N° 1-4; R. Përnaska, "Du présent actuel en albanais, *Cahiers balkaniques*, 1, Paris, 1981, "De l'opposition aoriste/parfait en albanais", *Cahiers balkaniques*, 3, Paris, 1982; M. Rogova, "Përdorimi i kohëve të shkuara të dëftores në shqipen e shkruar (punim magjistrature), Gjakovë, 1978; Z. Sadiku,

*

* *

Nuk kemi mundur të gjejmë një teori të plotë, një kuadër konceptual për një trajtim automatik të gjuhës; kemi gjetur për fat një mënyrë metodologjike trajtimi që synon të analizojë dhe të interpretojë të dhënat gjuhësore me një model pak a shumë të matematizuar:



ku, së pari, shtrohet një problem gjuhësor me anë të një fragmenti (bashkësi thëniesh, parafraza, etj.) në gjuhën natyrore (në rastin tonë, në gjuhën shqipe dhe me folje në të pakryerën e dëftores që bartin vlera të ndryshme) [1]. Analiza e këtyre të dhënave dhe e problemit gjuhësor që ato ndehin, çojnë në përpunimin e një qerthulli konceptual, të një modeli tek e fundit përshkrues [2]. Ky model përshkrues, kur analizohen kategori të tilla si mënyra e veprimit (Aktionsart), aspekti dhe koha, shtie në punë referenciale çasti dhe ndërkohe (interval) topologjike me caqe (borne) të hapura dhe të

"Funksionet semantike kohore, aspektore dhe modale të imperfektit të gjuhës shqipe", *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike,* 1974/4, Prishtinë, 1975; M. Totoni, "Konstrukte me folje aspektive të fillimit të veprimit në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, Tiranë, 1968/1; A. Gut, "De quelques structures exprimant l'inchoativité en albanais", Cahiers balkaniques, N° 1, Paris, 1981; M. Kryeziu, "E pakryera në shqipe dhe sërbishte", *Seminari Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, 25/1, Prishtinë, 2006, etj.

mbyllura. Etapa ndjekëse synon të nxjerrë nga modeli përshkrues një ligjërim të saktë, të përpiktë, formal [3], i cili në të vërtetë s'është veçse metaligjërim ndaj gjuhës natyrore. Pikërisht me këtë ligjërim të përpiktë bëhen përllogaritjet inferenciale dhe parafrastike. Ky metaligjërim duhet, nga njëra anë, të paraqesë të dhënat morfo-sintaksore, dhe, nga ana tjetër, të gjejë interpretim në një model interpretues [4], i cili duhet të jetë i shkueshëm me modelin përshkrues, dhe, në rastin më të mirë, i njënjëshëm me të[6].

Për të paraqitur vlerat e formave kohore të foljes kemi përdorur një model gjuhësor, që ka në themel nocionet elementare të topologjisë së përgjithshme[7] Ky model është njëri nga modelet e mundshme që përdoren për kompjuterizimin e dukurive gjuhësore. Për më tepër, ky model është i shkueshëm me ato të inteligjencës artificiale (zgjuarësi e sendërgjuar), e cila synon të kuptojë dhe të përngjashmojë (simuler) proceset kognitive që shtie në punë njeriu për kryerjen e akteve "të zgjuarësisë", pra ajo vë në punë sisteme përpunimi (manipulimi) simbolesh jo domosdoshmërisht numerike. Inteligjenca artificiale synon të zgjidhë probleme falë përpjekjeve heuristike (të procedurave të zbulimit), strategjive dhe sistemeve paraqitëse a përfaqësuese (de représentation). Në rastin e kumtesës sonë, ajo do të shoqërizojë një vlerë semantike me një shfaqje të së pakryerës në një kontekst të caktuar. Teknika që do të përdoret është ajo e sistemeve eksperte.

Këto janë disa prej arsyeve që, për të paraqitur vlerat e së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe, është zgjedhur dhe është shfrytëzuar modeli gjuhësor i përpunuar prej miqve tanë Zhan-Pjer Deklesë (Jean-Pierre Desclés) dhe Zllatka Gençeva (Zlatka Guentcheva). Ky model ka në bazë nocione fillestare topologjike që lejojnë të përkufizohen konceptet *e gjendjes*, *e procesit* dhe *e ngjarjes* dhe të gjitha konceptet e tjera që kanë të bëjnë me kohën, mënyrën e veprimit dhe aspektualitetin e gjuhëve natyrore. Modeli i tyre është shfrytëzuar prej nesh për hetimin jo vetëm të kohëve dhe të aspektit,

[6] J.-P. Desclés, "Aspects, modalités d'action et raisonnements", *Actes du colloque international VEXTAL,* Venise, 1999, f. 352.

[7] Ky model është paraqitur metodikisht dhe pak a shumë imtësisht, dhe në hulli të shtjellimeve teorike të J.-P. Deklesë, prej D. Marie-Reppert-it, *Les temps de l'indicatif du français en vue d'un traitement informatique: imparfait*, Paris, 1991. Ne e kemi vënë në bazë të parashtrimit.

por edhe për formalizimin e dukurisë së "përsëritjes së kundrinës nga trajta e shkurtër e përemrit vetor" në gjuhën shqipe[8].

*

* *

Modeli aspektor-kohor, që është vënë në bazë të hetimi, mbështetet mbi një konceptim themelvënës të vetë kategorisë gramatikore. Ai e përkufizon atë si një katërshe përbërësish[9]:

(F) sistem formash gramatikore, të organizuara në paradigma,

(∑) sistem domethëniesh (significations),

(R) sistem korrespondencash, si rregull jo biunivoke, midis dy të parave,

(S) strategji hetimi kontekstual, e shprehur në formë rregullash heuristike me synimin e përzgjedhjes së një vlere të ∑-së me një rast të F-së në një kontekst të caktuar.

Në këtë kumtesë nuk do të trajtohet (F) se kjo është bërë shtrueshëm prej të tjerëve. Po shtojmë se në shqipen standarde format e së pakryerës nuk ngatërrohen me ato të kohëve të tjera.

Edhe (∑) nuk do të trajtohet se këtë punë e kanë bërë me cilësi të lartë të tjerët, sidomos Z. Sadiku, E. Hysa e T. Kelmendi. Ne do të bëjmë veç paraqitjen e disa vlerave të së pakryerës, sidomos të asaj vlere që mbahet si përfaqësuese, të së tashmes në të shkuarën, dhe këtë me anë të topologjisë së përgjithshme, domethënë do të bëjmë një sprovë për t'i formalizuar ato, për t'i paraqitur me një gjuhë universale.

Po vërejmë kalimthi, ndër të tjera, se (R) nuk është sistem biunivok sepse për një formë të së pakryerës ka mëse një vlerë, por për një vlerë nuk ka më shumë se një formë të së pakryerës.

Gjithë puna, pra, është të përpunohet një sistem strategjish që lejon të kalohet nga një shfaqje gjuhësore, më ngushtë, nga një formë

---

[8] R. Përnaska, " Du présent actuel en albanais ", *Cahiers balkaniques*, 1, Paris, 1981, pp. 37-45, " De l'opposition aoriste/parfait en albanais ", *Cahiers balkaniques*, 3, Paris, 1982, pp. 139-163, "Sprovë për formalizimin e dukurisë së përsëritjes së kundranorit të drejtë në vetën e tretë", *Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Tiranë, 1996, ff. 651-660.

[9] J. P. Desclés, "Catégories grammaticales et opérations cognitives", *Histoire, épistémologie et langage*, Paris, 1989.

gramatikore te një domethënie në një kontekst të caktuar, meqë njeriu është ndër të tjera makinë që prodhon kuptim.

Puna jonë parashtruese ka të bëjë me sistemin (∑) të domethënieve të formalizuara me ndihmën e toplologjisë së përgjithshme, kushërirë e teorisë së bashkësive të Kantorit. Pra, do të ndalemi kryesisht te (∑)-ja, do të parashtrojmë sistemin (∑) të domethënieve të së pakryerës, domethënë të vlerave të ndryshme të kësaj kohe në gjuhën shqipe me anën e topologjisë së përgjithshme.

Për morfemën e së pakryerës janë dhënë jo më pak se nëntë vlera të mundshme, çka tregon se sistemi (R) i korrespondencës midis formave dhe vlerave nuk është biunivok.

Strategjia e hetimit të thelluar kontekstual (S) përbën thelbin e punës kërkimore, ajo lejon të të zgjidhet një vlerë për një shfaqje të formës në një kontekst të caktuar. Për sa i përket sistemit të vlerave (∑) kemi mundur të gjejmë nëntë vlera themelore: *gjendja përshkruese, gjendja e vijueshme, gjendja e re, procesi në zhvillim, zakoni, e mundshmja, jorealja, mirësjellja, hipokoristikja (përkëdhelësja),* prej të cilave vetëm katër të parat janë zgjedhur për hetim dhe paraqitje topologjike. Dhe kjo vetëm për arsye lehtësie parashtrimi. Vlera e katërt, ajo e procesit në zhvillim, mbahet si vlera karakteristike e së pakryerës, si një farë invarianti, si një e tanishme e tejçuar në të kaluarën, aq sa vlerat e tjera nuk zihen ngoje ndër gramatika. Pesë vlerat e tjera janë të paraqitshme topologjikisht. Dhe le shpresohet se ato do të formazlizohen në një shkrim tjetër.

*

* *

Por më parë po përshkruhet thuktazi modeli aspektor-kohor që do të përdoret për formalizimin e tyre[10]. Ky model bën pjesë në një model gjuhësor më të përgjithshëm: në modelin e Gramatikës Aplikative Kognitive, që ka tri rrafshe paraqitjeje: rrafshin e dukurive morfo-sintaktike, rrafshin e paraqitjeve logjiko-gjuhësore dhe rrafshin

[10] J.-P. Desclés, "State, Event, Proces and Topology", *General Linguistics*, v. 29, N° 3, Pennsylvania State University Press, 1989, f. 159-200; D. Maire-Reppert, *Les temps de l'indicatif du français en vue d'un taitement informatique: imparfait*, CNRS EHESS Paris-Sorbonne, 1991.

e paraqitjeve semantike-kognitive. Përllogaritjet tona do të bëhen thuajse kryesisht në rrafshin logjik-gjuhësor.

Për më tepër, ky model, që përdor topologjinë, është i shkueshëm me një trajtim automatik të problemeve aspektore-kohore në gjuhët natyrore[11].

Topologjia e përgjithshme[12], degë e matematikës, dallohet nga gjeometria euklidiane se është më elementare dhe përdor marrëdhënie cilësiore si: *brenda, jashtë, pranë, në kufi, puq me, ngjitur me*, etj. ndaj atyre sasioreve të gjeometrisë euklidiane si *me të njëjtën madhësi me*, *më i madh se, më i vogël se,* etj. Për ta përkapur më mirë dallimin, le të kujtojmë se për gjeometrinë euklidiane dy figura janë të barabarta në qoftë se i mbishtrohen njëra tjetrës. Nga ana tjetër, për topologjinë dy figura janë ekuivalente (homeomorfike) në qoftë se mund të përftojmë njërën syresh me deformim të vijueshëm të tjetrës. Kështu, në topologji rrethet dhe elipsat janë të barasvlershëm, kurse unaza (rondelja) dhe disku (rrethi) jo, sepse nuk kanë të njëjtat forma cilësiore, përderisa unaza ka dy të jashtme dhe një të brendshme, kurse disku ka vetëm një të brendshme dhe një të jashtme.

Të gjitha këto vetëm sa për të thënë se modeli i përdorur këtu ka për koncepte bazë: *e brendshmja, e jashtmja, kufiri, ndryshimi* (changement), i një bashkësie pikash. E ajo çka është krejt e re është shtënia në këtë topologji e parametrave shtesë që vijnë nga gjuhësia e thënies, si *folësi, dëgjuesi, hapësira referenciale e folësit*, etj.

---

[11] Si e provojnë, ndër të tjera, këto punime doktoratash: S. Chaudiron, *Représentation du système temporel du français en vue d'un traitement informatique*, Thèse de doctorat d'Etat, Paris VII, 1989; D. Maire-Reppert, *Les temps de l'indicatif du français en vue d'un taitement informatique: imparfait*, CNRS EHESS Paris-Sorbonne, 1991; H. G. Oh, *Représentation des valeurs sémantiques du passé composé français en vue d'un traitement informatique,* Thèse de doctorat, Université de Paris IV.

[12] Gjuhëtari i madh teoricien francez Antuan Kylioli është ndër të parët që ndjeu, që më 1968, nevojën e shtënies në punë edhe të topologjisë në hetimet gjuhësore të kohës, mënyrës së veprimit dhe aspektit, dhe madje edhe më gjerë, edhe të semantikës; J.-P. Desclés, "Quelques concepts empruntés par A. Culioli à la logique et aux mathématiques" në: Antoine Culioli, *Variations sur la linguistique*, Paris, 2002, f. 243-253.

*

* *

Modeli i huazuar është topologjik. Koncepti topologjik më fillestar është pika, që, për nevojat e parashtrimit gjuhësor, do të kuptohet si çast. Vijimi i pandërprerë i pikave jep vijën, çaste të pashkëputura. Ky konceptim i vijës si vijim i pandërprerë (i pashkëputur) i pikave ka të bëjë me natyrën e topologjisë, me fytyrën e saj cilësiore. Për më tepër, shënon konceptimin filozofik dialektik të autorëve të modelit që do të shtihet në punë në këtë shkrim. Në rastin tonë vija mund të paraqitë topologjikisht si kohën kronologjike, ashtu edhe atë thënësore. Vija që paraqit kohën kronologjike është e orientuar domosdoshmërisht me një kahje. Tradita botërore, nën ndikimin e gjuhëve indoeuropiane dhe disa gjuhë familjesh të tjera, e orienton domosdoshmërisht nga e majta në të djathtë:

- ---------->

Kjo vijë mund të ndahet me një cak pa kah (të paorientuar):

----------|---------->

cak

në: e kaluar e tashme e ardhme

Caku (borne, Boundary) mund të jetë i hapur

----------]---------->

ose i mbyllur

----------[---------->

Ky koncept i cakut, si edhe ata të tjerët që përdoren këtu, është sajuar për nevojat e analizës matematikore dhe shpesh jo tërësisht i

përshtatshëm për analizën gjuhësore, ka nevojë të "trashet, zgjerohet, të fryhet", të mos mbetet "pa trashësi, pa gjerësi, pa fryrje", të jetë njëlloj nomeslandi (no man's land). E gjithë kjo çon te koncepti cak i hapshëm, cak i zgjerueshëm. Edhe kjo ka të bëjë me fytyrën cilësiore të topologjisë.

Qoka bazë është çasti i ligjërimit që e ndan boshtin kohor në të kaluar, pra në veprime që janë kryer përpara, më parë, në të tashme dhe në të ardhme, pra në veprime që do të kryhen pas, më pas, pastaj. Në çastin e ligjërimit ne dimë ç'është bërë përpara e jo pas, ç'do të bëhet më pas mbetet për t'u ditur, për t'u jetuar. Dhe megjithatë themi: *E kemi të ardhmen përpara* (!!!).

Në qytetërime të tjera kahja është e anasjellë, si te ajmarasit, maoritë, akadienët:[13]

<----------

Orientimi nga e majta në të djathtë, karakteristik për gjuhët indoeuropiane "turbullohet" hera-herës nga anasjellja e tij. Kështu, p.sh. në gjuhën frënge *prédécesseur* "pararendës, paraardhës" që vjen nga latinishtja *prae* "para, përpara" dhe *decessor* "dalësi, ai që del" që vjen nga *decedo* "largohen nga (prej)". Pra *pararendësit*, *paraardhësit* janë ata që largohen përpara. Të tilla janë formimet me parashtesën *para* edhe në gjuhën shqipe: *parafolës, paradita, paradreke, paraelektoral, parakapitaliste, i parakohshëm, pardje*, etj. Po kështu edhe formimet me parashtesën *pas*: *pasardhës, pasdita, pasdarke, pasdreke, paskëtaj, pasnesër*, etj.

Në këtë hulli, le të krahasohen kuptimet II, 2. të parafjalëve *para* e *pas* të dhëna në *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002[14].

---

[13] Ndër të tjerë: R. Nunez, "Pour les Aymaras, le passé est devant soi", *Science et vie*, n° 1067, f. 22; N. Recoursé, "Quand l'ordre du temps s'inverse", *Science et vie*, octobre 2006, f. 9; M. Sahlins, *Des Îles dans l'histoire*, Paris, 1989; E. Cassin, "Cycles du temps et cadres de l'espace en Mésopotamie ancienne, *Revue de synthèse*, 1969, f. 241-257.

[14] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 2002: *Para*. f. 927: II. *parafj*. Përdoret me një emër à me një përemër në rasën rrjedhore që shënon: 1.... 2.... 3. Kohën, ngjarjen, etj., në prag të së cilës bëhet diçka; veprimin që i prin një veprimi tjetër; kohën që ka

Por vija që paraqet kohën thënësore është e orientueshme nga të dyja kahjet:



Koncept tjetër shumë i rëndësishëm për të paraqitur vlerat kohore dhe ato të mënyrës së veprimit e aspektit të së pakryerës së mënyrës dëftore është ndërkoha (intervali), e cila përkufizohet si bashkësi pikash të pashkëputura të një vije të kufizuar nga e majta dhe nga e djathta me dy caqe që ndajnë të brendshmen (pikat midis dy caqeve) nga e jashtmja (pikat që nuk përfshihen midis dy caqeve). Caqet nuk u përkasin as së brendshmes as së jashtmes së intervalit. Çdo ndërkohë ka dy caqe:



Dhe tani, kur kemi një cak nga a majta, janë dy mundësi: a) nëse caku është i hapur, ndërkoha nuk ka pikë të parë, pra ajo është e hapur nga e majta b) nëse caku është i mbyllur, ndërkoha ka një pikë të parë, pra ajo është e mbylluar nga e majta. Kur kemi një cak nga e djathta e ndërkohës, ka gjithashtu dy mundësi: a) nëse caku është i hapur, ndërkoha nuk ka pikë të fundit, pra është e hapur nga e djathta b) nëse caku është i mbyllur, ndërkoha ka një pikë të fundit, pra është e mbyllur nga e djathta. *Pika fillestare* është pika e parë e ndërkohës së mbyllur nga e majta, kurse *pika fundore* është pika e fundit e

kaluar duke u nisur nga e sotmja (nënvizuar prej meje); *kund*. pas. *Para nisjes. Para vitit të ri. Para Çlirimit. Para erës së re. Jemi para festave. Para një jave. Para disa ditëve*.; *Pas.* f. 937: II. *parafj*. Përdoret me një emër à me një përemër në rasën rrjedhore që shënon: 1.... 2. Kohën, ngjarjen etj. që bie më përpara se diçka tjetër; kohën që vijon duke u nisur nga e tanishmja (nënvizuar prej meje) à një kohë që vijon me ndërprerje; *kund*. para. *Pas dreke. Pas mbledhjes. Pas pak kohe. do të vijë pas një jave. Kohë pas kohe. Herë pas here*. 2.

ndërkohës së mbyllur nga e djathta.

Këtej rrjedh se katër lloje ndërkohësh janë të mundshme:

1) ndërkohë e hapur:



Caqet nuk i përkasin ndërkohës ($c1 \notin I$, $c2 \notin I$)

2) ndërkohë e mbyllur:



caqet i përkasin ndërkohës $c1 \in I$, $c2 \in I$)

3) ndërkohë e hapur nga e djathta, e mbyllur nga e majta:



caku i djathtë nuk i përket ndërkohës, caku i majtë po
($c1 \in I$, $c2 \notin I$)

4) ndërkohë e mbyllur nga e djathta, e hapur nga e majta:

caku i majtë i përket ndërkohës, i majti jo.
($c1 \notin c2$, $c1 \in c2$)

Çdo ndërkohe i shoqërizohen dy ndërkohë të tjera: I(nterval) e brendshmja e vet, e përftuar nga përjashtimi i dy caqeve dhe I(nterval) mbyllja e vet, e përftuar nga përfshirja e e dy caqeve.

Kështu, le të jetë një ndërkohë (I) e mbyllur nga e majta dhe e hapur nga e djathta, e brendshmja dhe e mbyllja e vet paraqitet kësisoj:





Në shkrime shkencore për kohën, mënyrën e veprimit dhe aspektin përdoren intuitivisht dhe rregullisht tri nocione: *gjendja*, *ngjarja* dhe *procesi*. Ç'kupton njëri gjuhëtar me secilin prej nocioneve të mësipërme, nuk kupton domosdoshmërisht tjetri, ndaj do të duhet të përcaktohen si kuptohen ato në shkrimin e pranishëm.

Gjendja[15] është vlerë aspektore që karakterizohet nga mungesa e ndryshimit, e ndërprerjes, pra të gjitha fazat janë të njëjta, nuk ka as pikë fillestare, as pikë fundore që shënon ndryshim. Gjendja mund të jetë e pacakëzuar, e vijueshme (Toka është planet i sistemit diellor), ose e cakëzuar, dhe atëherë gjendja është e shkueshme me me një vazhdim të fundmë (Ai ishte në shtëpi nga mesdita në mesnatë). edhe kur gjendja është e cakuar, vetë caqet janë të përjashtuara nga vetë gjendja. Ato janë të jashtme për të. Gjendja mund të paraqitet topologjikisht nga një ndërkohë e hapur:



[15] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f.351: "Gjéndj/e,-a *f.sh.* –e(t) 1. Veprimi sipas foljes. 2. tërësia e kushteve në të cilat është dikush a diçka në një çast të caktuar; tërësia e vetive a e shenjave që e tregojnë këtë".

Procesi.[16] Disa aspektologë i njohin vlerë aspektore vetëm gjendjes dhe ngjarjes, të tjerë pranojnë vlerë aspektore edhe për procesin.[17] Ai karakterizohet nga një fillim, nga një çast fillestar të ndryshimit, shënon, pra, një ndryshim nga një situatë fillestare në një situatë fundore. Procesi mund të paraqitet topologjikisht nga një ndërkohë e mbyllur nga e majta dhe e hapur ose e mbyllur nga e djathta:

----------[/////////////////[---------->

----------[/////////////////]---------->

Ngjarja[18] ose *ndodhia* është vlerë aspektore që shpeh tranzicion midis dy ngjarjeve. që shënon mosvazhdimësi në një gjendje të palëvizshme. Kemi të bëjmë me synim tërësor të aspektit. Çdo shfaqje (secili rast) e ngjarjes është njësi më vete nga ç'paraprin dhe ç'ndjek këtë shfaqje. Ngjarja, që shpaloset në kohë, mund të paraqitet topologjikisht nga një ndërkohë e mbyllur:

----------[-]---------->

Si përfundim, gjendja mbahet si nocion më primitiv se procesi

[16] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 847: procés,-i *m.sh.* –e(t) *libr.* 1. Ndryshim i pandërprerë, zhvillim e shndërrim i diçkaje sipas ligjeve të caktuara; varg veprimesh, ndryshimesh etj. të lidhura, që sjellin një përfundim të caktuar; ecuria e zhvillimit të diçkaje: *proces shoqëror (historik); proceset demokratike; procese fizike (fiziologjike); procesi i prodhimit; procesi mësimor; procesi i sëmundjes*".

[17] H. Kamp, "Events, instants and temporal reference", *Semantics fromm different point of view*, Berlin, f. 3776-417; H. Reichenbach, *Elements of symbolic logic*, New-York, 1947; C. Vet, *Temps, aspects et adverbes de temps en français contemporain*, Genève, 1980, etj. nuk pranojnë vlerë aspektore për procesin. J. Lyons, *Semantics*, v. 2, London/New-York/Melbourne, 1977, f. 192-212; A. Mourelatos, "Events, Process, and States, 1980, etj. pranojnë vlerë aspektore edhe për procesin.

[18] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f.692: "ngjárj/e,-a *f.sh.* -e(t) 1. veprimi sipas foljes. 2. diçka e veçantë që ka ndodhur ose që mund të ndodhë; ndodhi".

dhe ngjarja, sepse, si njëra, si tjetra, zënë vend domosdoshmërisht brenda një gjendjeje të palëvizshme, me fjalë të tjera, brenda gjendjes.

A. Gjendja mund të jetë tipash të ndryshëm: *Gjendja e vijueshme*: gjendje të pakufizuara, të përhershme, të pandërprera, të vijueshme (permanente) dhe *Gjendja kontigjente*: gjendje të kufizuara (të puqshme, të pavijueshme, të mundshme).

Gjendja e vijueshme (permanente), e paraqitshme me një ndërkohë të hapur pa caqe, mbulon të gjithë hapësirën referenciale në të cilën zë vend.

Kështu, thënia:

Toka është planet i sistemit diellor

paraqitet prej ndërkohës:

----------]//////////////////[---------->

kurse thënia:

Toka rrotullohet rreth diellit

me ndërkohën:

----------]**********[---------->

Të dyja thëniet shprehin gjendje të vijueshme, ndaj paraqiten me ndërkohë të hapur, por te thënia e dytë çdo rrotullim i tokës ndaj diellit përbën ngjarje, ndaj ndërkoha e hapur e saj shënon ngjarje të njëjta (të paraqitura me *) pa ngjarje fillestare, as edhe fundore.

Gjendja e mundshme (kontigjente) paraqitet me ndërkohë të kufizuara, të cilat janë copëzime të matshme dhe të fundme të referencës kohore[19]. Marrëdhënia predikative është e vërtetë vetëm brenda ndërkohës.

[19] Në spanjisht përdoren dy këpuja (folja *jam*): *ser* paraqitet nga një gjendje e vijueshme, kurse *estar* nga një gjendje kontigjente. Po e njëja gjë ndodh në irlandisht e në galisht. (B. Comri, *Aspect, an introduction to the study of verbal aspect and related problems*, London, New-York, Melburne,, 1976, f. 104).

Gjendja e mundshme është disa tipash:

1. *Gjendja përshkruese* kur nuk shtrohet pyetja e origjinës, si, p.sh., te thënia:

Ky libër është i bukur.

Paraqitja topologjike jepet me një ndërkohë të hapur, ku caku i parë nuk ka parametër kohor, kurse caku i dytë po: T°.

----------]//////////////////[---------->
T°

2. *Gjendja fundore*, e paraqitshme me ndërkohë të hapur që vjen pas një intervali të mbyllur, i përket ose "pësuesit" ose vepruesit pas plotësimit të veprimit sipas natyrës kalimtare a moskalimtare të procesit. Kështu, paraqitja topologjike e thënies:

Pavarësia e Shqipërisë u shpall më 28 nëntor 1912.

është:

----------[-------]//////////////////[---------->
T°

3. *Gjendja e përftuar (rezultuese)* ka të bëjë gjithmonë me nënanën (subjektin) (me nënanorin, me kryefjalën në ndërtimim vepror dhe me vepruesin, "plotësin e veprimit" në ndërtimin pësor) kur procesi është kalimtar. Subjekti është në zanafillë të gjendjes së përftuar: pa të nuk ka gjendje të tillë. Duhet vënë re, nga ana tjetër, se ngjarja ose procesi dhe gjendja që përftohet janë fqinje, të ngjitura, çka do të thotë se midis gjendjes dhe cakut 2 nuk mund të ndërshtihet kurrgjë. Ndërtimi i gjendjes së përftuar përcaktohet nga vetia e dyfishtë e cakut 2. Kështu, thënia:

Ai e përpunoi studimin gjatë gjithë vitit

paraqitet topologjikisht:



Gjendja e përftuar mund të jetë pjellë e një procesi të papërfunduar, si te thënia:

Ai e përpunoi studimin gjatë dy orëve

që topologjikisht paraqitet:



ku caku T1 (për dallim topologjik paraqitet më "i madh, disi i ndryshëm:]) " shënon çastin e fundit të procesit të përfunduar dhe caku T2 ndërprerjen e procesit. Te kjo thënie asgjë nuk lejon të thuhet nëse T2 mund të njëjtësohet ose jo me T1.

Gjendja e përftuar mund të jetë gjithashtu pjellë e një procesi të përfunduar, si te thënia e mëposhtme:

Ai e përpunoi studimin deri në fund gjatë dy orëve

që topologjikisht paraqitet:



ku çasti i fundit i procesit të përfunduar puqet me çastin e ndërprerjes së procesit.

Paraqitja topologjike e gjendjeve të tjera, (4) e atyre me vlerë përfundimore (inferenciale), (5) me vlerë përvoje (eksperience), (6) pasive dhe (7) të re nuk po shtjellohen fare, meqë, në këtë kumtesë, nuk do të hetohen kësaj here vlerat e tilla të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe. Megjithatë, po shtojmë se g*jendja me vlerë përfundimore*, konkluduese (inférencielle) është domosdoshmërisht e lidhur me gjendjen e përftuar nga një proces (i rindërtuar kësaj here nga një vrojtim), si te thënia:

Pa shih, pa shih, ti paske qarë

që thuhet pasi vihet re se "i ka sytë të kuq, me lot", etj.

B. Tipat e ndryshëm të procesit.

Nocioni i procesit, për nga ana konceptuale, është më i ndërlikuar se ai i gjendjes, i cili paraqitet gjithmonë nga një ndërkohë e hapur dhe ai i ngjarjes, i cili paraqitet gjithmonë nga një ndërkohë e mbyllur, karakterizohet nga një cak i mbyllur nga e majta, që shënon fillimin e procesit, dhe një cak nga e djathta, që mund të jetë i hapur ose i mbyllur. Pra, nga ana konceptuale zë vend midis gjendjes dhe ngjarjes[20].

Ka disa tipa procesesh.

1. *Procesi thënësor* është përbërës i pamungueshëm i analizave të sotme thënësore. Shtënia e detyrueshme në hetimet gjuhësore sot ka të bëjë me shkencueshmërinë vetë. Është faktor *sine qua non* i gjuhësive të klasifikuara globalisht si semantike. E tillë është edhe teoria e operacioneve thënësore e Antuan Kuliolisë që është vënë në bazën e modelit që kemi huajtur për trajtimin formal të vlerave të së pakryerës së dëftores. Dihet se çdo akt thënësor kërkon një farë zgjatjeje në kohë, nuk mund të rrudhet në një pikë kohore. Meqë është kështu e jo ndryshe, skaji gjuhësor "çasti i ligjërimit" nuk ka rreptësi terminologjike, përdoret si *abus de langage*. Procesi thënësor është proces i paraqitur nga një ndërkohë e mbyllur nga e majta dhe e hapur nga e djathta. Caku i djathtë i hapur (T°) është zanafilla e sistemit

kohor referencial. Është me interes të vihet re se është pikë fikse në sistemin metagjuhësor dhe një pikë "rrjedhëse" e boshtit kohor të pavarur prej folësit. Nga kjo rrjedh se çdo marrëdhënie predikative qokëtohet brenda referencialit hapësiror-kohor që folësi ndërton drejtazi ose zhdrejtazi ndaj T°.

2. *Procesi përpjestimor (progresiv)* është procesi që i ka joshur gjuhëtarët që kanë hetuar dhe hetojnë mënyrën e veprimit, aspektin dhe kohën në gjuhë natyrore. Kush merret me hetimin e vlerave të kategorisë gramatikore të kohës, do të ketë të bëjë me të për të përkapur vlerat e mënyrës së veprimit dhe aspektore që ngërthen njëra ose tjetra formë foljore kohore.

Ndaj qokës T, procesi përpjestimor del si proces i pandërprerë në këtë çast ose para tij. Ai mund të paraqitet topologjikisht nga një ndërkohë e mbyllur nga e majta dhe e hapur nga e djathta.

Kështu, nëse caku T përputhet me atë të zanafillës T°, procesi progresiv është i tanishëm (në shqip *Po punoj, Jam duke punuar*; në anglisht *be+ing*; në spanjisht *Sto escribiendo*, etj.). Në këtë rast, T përcaktohet nga T°, domethënë nga thënëzimi.

Por nëse caku T nuk përputhet me atë të zanafillës T°, procesi përpjestimor është i shkuar (ose, si njihet më së forti, i transpozuar) dhe jepet nga e pakryera. Qoka kuptohet nga konteksti, ose nga një deiktik kohor. (Meqë në këtë rast kemi të bëjmë me translatim, le të shihet si paraqitet topologjikisht vlera e së tashmes që do të translatohet. Thënia:

Agimi lexon gazetën

paraqitet topologjikisht:



T përputhet me T°. Të dy proceset, thënësori dhe ai i kyçur në predikim, janë të njëkohshëm.

E tëra kjo translatohet kur T nuk përputhet me T° të zanafillës dhe atëherë kemi vlerë procesi përpjestimor të së pakryerës.

3. Proces i përfunduar dhe jo i përfunduar (accompli et non-accompli)

Procesi përpjestimor mund të ndërpritet duke ndërfutur një qokë kohore, atëherë procesi i ndërprerë është i përfunduar (accompli, Complete aspect). Nga ana e vet, procesi i përfunduar mund të jetë i përkryer (achevé) ose jo i përkryer (non-achevé) dhe kjo në varësi të qokës kohore. Kur qoka kohore shënon çastin e fundit të ndryshimit, procesi është i përkryer. Kur kjo qokë nuk përputhet me çastin e fundit të ndryshimit, procesi është jo i përkryer.

Këtej rrjedh se procesi jo i përfunduar është gjithmonë jo i përkryer, kurse ai i përfunduar mund të jetë si i përkryer ashtu edhe jo i përkryer. Ja paraqitja e tyre topologjike:

- Proces jo i përfunduar:

----------[//////////////////////////////////[---------->

E tillë është paraqitja topologjike për shembullin:

Kur hymë në dhomë, ai (po) shikonte televizorin

- Proces i përfunduar i përkryer:

----------[//////////////////////////]---------->
T1=T2

E tillë është paraqitja topologjike për shembullin:

Ai e piu qumështin

- Proces i përfunduar jo i përkryer:

----------[////////////////////////////////]-------]---------->
T1 T2

E tillë është paraqitja topologjike për shembullin:

Ai piu qumësht

C. Koncepti i ngjarjes mund të përkufizohet nga një tubë vetish:

a) Ngjarja mund të jetë e përpiktë (ponctuel, punctual) dhe paraqitet nga një pikë, ose jo i përpiktë dhe paraqitet nga një ndërkohë me cak dhe që parakupton një farë zgjatjeje. Vetitë topologjike të ndërkohës së mbyllur dhe të pikës janë po ato, të njëjta, përveç largesës (distancës) midis caqeve.

b) Nga njëra anë, mund të ndërshtihen ngjarje brenda një ngjarjeje jo të përpiktë, dhe, nga ana tjetër, vetë ngjarja jo e përpiktë mund të ndahet në një numër të fundmë ngjarjesh.

c) Dy ngjarje nuk mund të ndërliqen (chevaucher) kurrë, ato janë ose të njëkohshme, ose të shkëputura. Kjo veti virtuale nuk shenjohet me shenjues të veçantë gramatikorë në gjuhët natyrore.

ç) Çdo ngjarje përfshihet nga një gjendje.

Dhe së fundi, dy vetitë e para janë rrjedhoja topologjike të ngjarjes, kurse dy të fundit janë thjesht gjuhësore.

D. Regjistrat dhe vërtetësia logjike.

Pikat dhe ndërkohët e vijës janë pjesë e sistemit referencial kohor, i cili, nga ana e vet, përbëhet nga një regjistër thënësor dhe, nga ana tjetër, nga një regjistër i paaktualizuar.

Në vijën që paraqet sistemin referencial kohor, duke u nisur nga zanafilla T°, në të djathtë është kategoria e së realizuarës, domethënë klasa e fjalive (në logjikë) të vërteta për çdo çast (t) para T°, dhe kategoria e prospektivëve (i të ardhshmëve, i të pritshmëve, i të mundshmëve), domethënë klasa e fjalive (në logjikë) të vërteta për çdo çast (t) pas T°. Vetë fakti që në bazë është vënë zanafilla T°

tregon se është ndërtuar kësisoj një referencial thënësor. Topologjikisht referenciali thënësor paraqitet:



Kështu, paraqitja e thënies:

Sivjet jemi në Tiranë

bëhet nga një ndërkohë e hapur (meqë *jemi në Tiranë* shpreh një gjendje) në boshtin thënësor. *Sivjet* është deiktik kohor që referon te situata thënësore:



Regjistri tjetër, ai i paaktualizuari, ku përfaqësohen vlerat e pavarura të T°, është i shkëputur nga regjistri thënësor dhe paraqitet nga një vijë e drejtë me kah nga e majta në të djathtë. Gjithë kjo të kujton kundërvënien e E. Benvenistit: récit (rrëfim, tregim, histori)/discours (koment, ligjëratë).



Le të shihet si paraqitet gjendja e shprehur nga një thënie si kjo:

Dikur Shqipëria ishte një vend që ishte i harruar

Gjendja paraqitet nga një ndërkohë e hapur që zë vend në regjistrin e të paaktualizuarës, meqë është rrëfim (*récit* për Benvenistin) krejtësisht të pavarur nga situate thënësore. Gjendja është para T', e

cila, nga ana e vet, është e njëkohshme me T°. Ja paraqitja topologjike:



Punët janë disi ndryshe te vlerat e së mundshmes, por, meqë kjo vlerë e së pakryerës nuk do të trajtohet fare, nuk po jepet paraqitja e vet topologjike.

Edhe dy vërejtje të tjera.

Ndërkoha e shënuar me vija të pjerrëta tregon se marrëdhënia predikative është e vërtetë për të gjitha pikat (çastet) e ndërkohës dhe e gabuar për të gjitha pikat që nuk i përkasin ndërkohës, domethënë çasteve para ose pas ndërkohës.

*

* *

Si është thënë edhe mësipër, nga punimet e të tjerëve kemi nxjerrë në mënyrë sintetike nëntë vlera për të pakryerën: *gjendje përshkryese*, *gjendje e vijueshme*, *gjendje e re*, *proces në zhvillim, zakon, e mundshmja, jorealja, mirësjellja, përkëdhelësja (hypocoristique)*. Shembujt, për arsye paraqitjeje, janë sajuar prej nesh, por gjithmonë duke u mbështetur te përfundimet e të tjerëve. Ja këtu më poshtë paraqitjet topologjike për secilën prej këtyre vlerave.

Nga gjendjet e mundshme, vetëm tri janë të shkueshme me të pakryerën.

1. *Gjendja përshkruese* (Etat descriptif): Vetë përkufizimi parakupton zgjatje. Të gjitha fazat janë të njëjta (identike). Nuk synohet as fillimi as fundi i situatës. Po e paraqesim me një interval të hapur dhe jo të përpiktë, gjithmonë para T° ose T'°, çka dallon vlerën

e gjendjes përshkruese të së pakryerës prej vlerës së gjendjes përshkruese të së tashmes. Po saktësojmë menjëherë se kemi të bëjmë me raste që dalin vetëm në ligjëratë të drejtë.

Thënia:

Ai ishte i plagosur, kur e arrestuan

Paraqitja topologjike:

s(ituata): jam-i-plagosur

n(gjarja): e-arrestoj

Duhet pasur parasysh gjithashtu se kjo frazë është nxjerrë nga një rrëfim (tregim, histori) ndaj, duke qenë e paaktualizuar, marrëdhëniet predikative të kësaj thënieje nuk i përkasin rregjistrit thënësor, por rregjistrit të paaktualizuar.



Vërtetësia në qokën n(gjarje):

f(jalia)1: ishte-i-plagosur: V(ërtetë)

f2: e-arrestuan: V(ërtetë)



Në këtë shembull, e pakryera lejon të shihet shprehja e njëkohësisë: ndërkoha që shënon ngjarjen përfshihet në ndërkohën që përfaqëson gjendjen. Mirëpo kjo gjendje nuk është sistematike, p.sh., në shembullin:

- *Ku ishe dje pasdite?*
- *Ah, po! Isha në stadium.*

E pakryera shpreh gjendje pa asnjë njëkohësi.

Paraqitja e vet topologjike:

S: jam-në-stadium

Prania e deiktikut kohor *dje*, që çon te T°, lejon të nxirret natyra e referencialit: marrëdhënia predikative paraqitet në regjistrin thënësor.



Le të shohim vlerën e gjendjes përshkruese në ligjëratë të zhdrejtë. Te shembulli:

Ai tha se telefoni ishte mbi tryezë.

E pakryera çon te një gjendje e vijueshme (kontigjente), më veçanërisht te një gjendje përshkruese. Përdorimi i së kryerës për foljen e fjalisë kryesore në ligjëratë (*ai tha*) është shenjues i rregjistrit thënësor. Ndërkoha e hapur që paraqet këtë të pakryer është e njëkohshme me T°.



n(gjarja): ai-them

gj(endja): telefon-jam-mbi-tryezë

Në një rast si ky, përafrimi midis së pakryerës dhe së tashmes kapet lehtësisht si nga ana aspektore, ashtu edhe kohore. E pakryera kushtëzohet nga ligjërata e zhdrejtë dhe nga koha e foljes e fjalisë kryesore. Po ta rindërtojmë ligjëratën e drejtë, e pakryera ndërkëmbehet detyrimisht me të tashmen:

Ai tha: "Telefoni është mbi tryezë".

Është me interes të vihet re se kur folja e fjalisë kryesore është në të kryerën e thjeshtë (shenjues, ndër të tjera, i regjistrit të së paaktualizuarës), ndërkoha që paraqet të pakryerën gjendet para T'°, në të njëjtën kohë me T°



Shkurt, vlera e gjendjes përshkruese, në ligjëratën e drejtë, mund të paraqitet në regjistrin thënësor ose jo të aktualizuar, ndërkoha e hapur i paraprin gjithmonë T° ose T'°. Në ligjëratën e zhdrejtë, ndërkoha e hapur është e njëkohshme me I° në regjistrin thënësor, dhe i paraprin T'° në jo të aktualizuarin. Është e pamohueshme që vlera e gjendjes përshkruese është e përbashkët për të pakryerën dhe të tashmen, po të mënjanohet mospajtimi kohor midis këtyre dy kohëve; ajo është e përbashkët në ligjëratën e zhdrejtë në regjistrin thënësor.

2. *Gjendja e përhershme* (permanente). Dy mundësi dalin po të merren parasysh caqet.

a) Gjendja përshkruese është gjendje e cakuar (borné): largesa (distanca) e matur midis dy caqeve është numër i fundmë. Kështu shpjegohet që gjendja përshkruese i përket si së shkuarës (ndërkoha është para T°), së tashmes (ndërkoha përfshin T°) dhe së ardhmes (ndërkoha është pas T°).

b) Përkundrazi, gjendja e përhershme është gjendje e pacakëzuar: largesa midis caqeve është e pakufishme, çka do të thotë se ndërkoha që paraqet këtë gjendje kap (mbulon) gjithë hapësirën referenciale. Pra, nuk mund t'i përkasë as së tashmes, as së shkuarës, as edhe së ardhmes. Po si shpjegohet atëherë përdorimi i së pakryerës në këtë rast? Me sa duket këtu rol të dorës së parë luan bashkëpërshtatja e kohëve, gjithmonë në ligjëratë të zhdrejtë kur folja e fjalisë kryesore është folje të foluri, të menduari, të ndjeri, etj. dhe në të shkuarën.

Le të kemi thënien:

Ai u përgjigj se toka i përkiste atij që e punon

që në ligjëratë të drejtë të pakryerën e ndërkëmben detyrimisht me të tashmen:

Ai u përgjigj: "Toka i përket atij që e punon"

Përafrimi midis së pakryerës dhe së tashmes është i qartë. Me sa duket, dallimi midis së pakryerës me vlerë të gjendjes së përhershme dhe të tashmes me po këtë vlerë qëndron te natyra e referencialit, domethënë ndërkoha e së tashmes i përket regjistrit thënësor, kurse ajo e së pakryerës i përket regjistrit të paaktualizuar.

Paraqitja topologjike e thënies:

n(gjarja): ai-përgjigjem

gj(endja): toka-i-përkas-atij-që-e-punoj

Shembulli është nxjerrë nga një rrëfim (tregim, histori), pra kemi shkëputje nga regjistri thënësor.



Vërtetësia në qokën që shenjon ngjarjen:

f1: ai-përgjigjem: V(ërtetë)
f2: toka-i-përkas-ai-që-e-punoj: V(ërtetë)



3. *Gjendje e re* ose, si quhet ndryshe, e pakryera e shkëputjes (rupture). Ka karakteristika kundërshtuese: çon njëherazi te veprimi i përpiktë (ponctuel) dhe te zgjatja (durativ), te ngjarje që paraqiten si gjendje, dhe shënon një kuadër të ri përshkrimi. Ajo çon te një ngjarje, e cila më së shpeshti është e përpiktë dhe që përfton gjendje të re përshkrimi, duke shënuar kësisoj shkëputje (rupture) midis gjendjes së vjetër (gj1) dhe gjendjjes së re (gj2). Kështu shpjegohet që kjo vlerë ka njëherazi karakter të përpiktë dhe zgjatës. Është për t'u vënë re se thuajse gjithmonë është i pranishëm një tregues kohor që shërben si qokë për të përcaktuar kohën e ngjarjes. Ngjarjet dhe proceset, madje edhe gjendjet ndjekëse mund të përfshihen në gjendjen e re të referimit. Gjithashtu duhet shtuar se ngjarja dhe gjendja janë të pandashme njëra prej tjetrës. Tani përkapet më mirë dallimi midis së pakryerës dhe së kryerës së thjeshtë: e pakryera shënon njëherazi si shfaqjen e ngjarjes, ashtu edhe të gjendjes së re të përftuar, kurse e

kryera e thjeshtë shënon vetëm shfaqjen e ngjarjes[21].

Kjo vlerë paraqitet topologjikisht me një ndërkohë të hapur (gjendja e vjetër gj1) që ndiqet nga një ndërkohë e mbyllur (ngjarja) dhe një ndërkohë e dytë e hapur (gjendja e re gj2). Këto intervale gjenden para T° dhe mjaft shpesh para T'°, sepse kjo vlerë i përket së shkuarës. Të dy gjendjet gjenden në të njëjtin regjistër, jashtë situatës thënësore.

Thënia:

Gjatë pasditës, forcat e rendit njoftonin se e kontrollonin situatën

mund të paraqitet topologjikisht si më poshtë:



ku:

[21] I. Zamputi, "Aoristi shqip", *Leka*, Shkodër, 1, 1943, f. 18-22; G. Brîncus, "Despre valoarea aoristului în albanezâ, *Studi si cercetari linguistice*, Bucuresti, 1, 1960, f. 61-72; A. Dodi, "De la valeur du passé composé de l'indicatif en albanais", *Studia albanica*, 1, 1970, Tirana, f. 171-184; Z. Sadiku, "Funksionet semantike kohore-aspektore të aoristit të gjuhës shqipe", *Gjurmime albanologjike*, Seria filologjike, VII-1977, Prishtinë, 1978, f. 257-279, "Kuptimet figurative të aoristit dhe të perfektit të gjuhës shqipe", *Zbornik Filozofskog Fakultete u Pristini*, XI, Prishtina, 1974, f. 123-135, "Rreth opozicionit perfekt/aorist në gjuhën shqipe", *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave filologjike, V-1975, Prishtinë, 1976, f. 51-59; R. Përnaska, " De l'opposition aoriste/parfait en albanais ", *Cahiers balkaniques*, 3, Paris, 1982, pp. 139-163.

gj°: gjendja:

T1: pikë qoke që shenjon n(gjarjen): një çast i mbasditës

gj1: gjendja e vjetër: forcat-e-rendit-nuk-kam-njoftoj

gj2: gjendja e re: forcat-e-rendit-kam-njoftoj

n: ngjarja: forcat-e-rendit-njoftoj

4. *Proces në zhvillim*. Për të pakryerën thuhet zakonisht se aspekti i vet durativ-imperfektiv krijon përhitjen e një të shkuare ende të gjallë, dhe se kjo kohë kohore me sa duket i jep folësit fuqinë të ndjellë, sikur ato po zhvillohen, sikur ato të ishin në zhvillim e sipër, procese që, në të vërtetë, janë kryer prej kohësh[22], Kjo nuk mund të vlejë për të gjitha vlerat e të së pakryerës, por i shkon për shtat vlerës që po shqyrtohet. Kështu, në një shembull si: "*Po kaloja në korridor, kur m'u afrua i panjohuri*" e pakryera çon te një proces, domethënë në një ndryshim nga një situatë fillestare deri në një situatë fundore. Caku T1 shënon çastin e fillimit të ndryshimit dhe i përket procesit. Caku T2 është i hapur, ndaj procesi është i papërfunduar.

Paraqitja topologjike e thënies:

Po kaloja në korridor, kur m'u afrua i panjohuri



ku:

n(gjarja): afrohem-i panjohur

p(rocesi): po-kaloj-në-korridor: v(ërtetë)

[22] R. Martin, *Temps et aspect. Essai sur l'emploi des temps narratifs en moyen français*, Paris, 1971, f. 96.

Në shembullin tonë, procesi në zhvillim ndërpritet nga ngjarja. F1 nuk është më e vërtetë pas përftimit të ngjarjes.

Vërtetësia në qokën n(gjarje):

fjalia 1: procesi: po-kaloj-në-korridor v(ërtetë)

fjalia 2: afrohem-i-panjohur v(ërtetë)



Rast tjetër, në thënien

Pak më parë, kur u ngjita në dhomën e tij, ai flinte

"pak më parë" është deiktik kohor që çon (referon) te T° dhe tregon një situatë thënësore. Në fjalinë e varur përdoret e kryera e thjeshtë (në gjuhët e tjera perëndimore e kryera). Kjo thënie mund të paraqitet kështu:

n(gjarja): ngjitem-në-dhomën-e-tij

p(roces): ai-fle

t(emps, koha): *pak më parë* i përket së realizuarës



Vërtetësia në qokën t:

fjalia 1: ngjitem-në-dhomën-e-tij: v(ërtetë)
fjalia 2: ai-fle: v(ërtetë)



Asgjë nuk thuhet për vlefshmërinë e p2 pas shfaqjes së ngjarjes, dhe ai mund të vazhdojë të flejë ose të zgjohet.

Kjo vlerë e procesit në zhvillim e së pakryerës është e mundshme edhe në ligjëratën e zhdrejtë. Kështu, thënia

Ai ka thënë se po hante
mund të paraqitet:



n(gjarja): ai-them
p(roces): po-ha

kurse thënia:

Ai tha se po hante

mund të paraqitet:



Në regjistrin thënësor, kur folja e fjalisë kryesore është në të kryerën, caku i djathtë i ndërkohës që paraqet të pakryerën është i njëkohshëm me T°. Në regjistrin e së paaktualizuarës, ndërkoha i prin T'° si në ligjëratën e drejtë.

Si përfundim, kjo vlerë e procesit në zhvillim e së pakryerës paraqitet nga një ndërkohë e mbyllur nga e majta, e hapur nga e djathta që i paraprin T° dhe T'° ose e njëkohshme me T°, kur kemi rastin e vetëm në ligjëratë të zhdrejtë, kur folja e fjalisë së varur është në të kryerën.

5. *Vlera e zakonit* mund të çojë në përsëritje ngjarjesh ose gjendjesh, që i përkasin së kaluarës, pra para T° ose T'°. E gjithë bashkësia e tyre është gjithmonë e hapur. Le të merren dy shembuj regjistrash të ndryshëm. Në shembullin

Përgjithësisht, të vonuarit nuk kalonin nga kjo rrugë pas mesnatës që ndillte frikë

që është nxjerrë nga rrëfim (tregim, histori), pra me shkëputje nga regjistri thënësor, e pakryera paraqitet nga një klasë ngjarjesh të njëjta. Kjo thënie mund të paraqitet topologjikisht kështu:

n(gjarja): të-vonuar-nuk-kaloj-pas-mesnatë

gj(endja) përshkruese: mesnatë-ndjell-frikë

Le të vihet re gjithashtu prania e ndajfoljeve kuptimi leksikor i të cilave shënon zakon si *përgjithësisht, zakonisht, si zakonisht, sipas zakonit, përherë, si përherë, gjithmonë, si gjithmonë*, etj. Edhe kur ndajfolje të tilla mungojnë në thënie, ato mund të shtihen lehtësisht në to.



Kurse në shembullin

Vitin e kaluar, ai vinte gjithmonë me vonesë në punë

e pakryera çon në një klasë të hapur gjendjesh të njëjta, që gjenden në regjistrin thënësor, si e provon prania e deiktikut kohor "vitin e kaluar".



Në ligjëratën e zhdrejtë (ashtu si për vlerat e gjendjes përshkruese dhe të procesit në zhvillim), kur folja e fjalisë së varur është në të kryerën, ndërkoha që paraqet të pakryerën është e njëkohshme me T°. Kështu, thënia

Ai tha (ka thënë, kishte thënë, pat thënë) se kalonte gjithmonë nga kjo urë

paraqitet kështu:

n(gjarja): *Ai-them*

(k)lasë ngjarjesh identike (të njëjta): nl...e: ai-kaloj



Po të shtohet në fjalinë e varur një "plotës kohe", ndërkoha që paraqet të pakryerën nuk puqet me T°, tamam si në rastin kur folja e kryesores është në të kryerën e thjeshtë

Thënia

Ai tha se vitin e kaluar kalonte gjithmonë nga kjo urë

paraqitet topologjikisht kësisoj:



kurse thënia

Ai tha se kalonte gjithmonë nga kjo urë

paraqitet topologjikisht:



Si përfundim, vlera e zakonit paraqitet me një ndërkohë të mbyllur nga e majta, të hapur nga e djathta (ndërkohë që ngërthen ngjarje të

njëjta ose gjendje të njëjta), para T° ose T'°, me përjashtim të rasteve të ligjëratës së zhdrejtë në regjistrin thënësor, domethënë pa tregues kohorë që lejojnë të qokëtohet ndërkoha ndaj T°.

Katër vlerat e tjera nuk trajtohen fare kësaj here.

6. *Vlera e së mundshmes*. Nuk po ndalemi në të sepse është e studiuar mjaft nga logjikat e ndryshme. Po mjaftohemi vetëm të vëmë në dukje se kjo vlerë e së mundshmes të së pakryerës del më së forti në periudha me fjali të varura kushtore me lidhëzën *në qoftë se*, *nëse*, *po*, *po qe se*, *në rast se*.

7. Vlera e joreales: Edhe kjo vlerë e së pakryerës del më së forti në periudha me fjali të varura kushtore: *Edhe një hap po të bënte, thyente qafën*.

8. Vlera e mirësjelljes (politesse):

- Më falni,- tha Mariana

- Çfarë kishit?

- Nuk e di.

ku e pakryera *kishit* është në vend të së tashmes *keni*.

9. Vlera hipokoristike është karakteristike për dialogun në ligjërimin e folur:

Bebushi po ia merrte shpirin nënokes

në vend të:

Bebush, po ma merr shpirtin!

Me interes do të ishte kërkimi dhe formalizimi i një invarianti të vlerave të së pakryerës së mënyrës dëftore në gjuhën shqipe, çka për arsye vendi nuk trajtohet në këtë kumtesë.

Persida ASLLANI

SPROVA TË MUNGUARA TË KRITIKËS LETRARE

Çdo brez ka demonët e tij. U druhet ose përballet me çështje dhe dilemma që i përkasin bashkëkohësisë së vet. Por ndërkaq, vetë termi problematik "bashkëkohësi" na kujton se rezonimi i ritmit të një brezi me ritmet e nacionit ku bën pjesë nuk është gjithnjë harmonik. Atij i duhet të mendohet për llojin e sfidave me të cilat i takon të përballet, për të kuptuar prirjet dhe emëruesin e përbashkët të bashkohësisë së tij në raport me botën e letërsisë e të artit. Le të kujtojmë çudinë letrare të periudhës 1900-1945, ku, në procesin letrar shqiptar shfaqen e bashkëjetojnë drejtime e rryma letrare nga më të ndryshmet, të cilat, në një kontekst tjetër historiko-letrar do të ishin të pamundura: romantizmi, sentimentalizmi, modernizmi, klasicizmi, impresionizmi, neoklasicizmi, realizmi, esteticizmi, etj, që duket sikur mbushin boshllëkun dhe urinë për sprovat e munguara gjatë në letrat shqipe. Në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX, ngjan se kjo dukuri përfshin në vorbullën e saj edhe kritikën letrare. Një proces i shpejtë rekuperimi plotëson hartografinë e sprovave kritike, por po për shkak të këtij rekuperimi turbullon perspektivën e saj. Prandaj, për të kuptuar bashkohësinë tonë na duhet të shqyrtojmë më parë rrugëtimin që na solli deri këtu.

Në historinë e letrave shqipe nuk mund të flasim për një evoluim të përshkallëzuar të gjykimit dhe refleksivitetit mbi letërsinë, por për ekzistencën e disa cikleve të cilët lindin dhe zhvillohen në momente dhe rrethana të dallueshme qartë. Ato kanë karaktersitikat e tyre specifike, nuk puqen lehtë me njeri-tjetrin dhe u përkasin arealeve kulturor-politike të mirëpërcaktuara. Duket sikur e ashtuquajtura «teori e qarqeve» e Çabejt rivjen si një metaforë e hershme në historinë e kulturës shqiptare dhe jo rastësisht, cilësitë e saj operacionale kanë gjetur shprehje edhe te gjykimet e Rugovës në shqyrtimin që ai u bën *Kaheve dhe premisave të kritikës letrare shqiptare*. Pikërisht, propozimi im personal, për ta këqyrur mendimin letrar shqiptar përmes kohësh ciklike, jo vetëm e merr frymëzimin nga

këto dy vepra, por edhe dëshiron të jetë një homazh ndaj këtyre dy studiuesve të mëdhenj.

Si rrjedhojë, duke shfrytëzuar njëherësh nocionin "teorik" të ciklit dhe karakteristikat e brendshme të mendimit letrar, mund të shquajmë praninë e pesë cikleve të mëdha: Cikli i parë, ai i modernitetit, nis me Konicën dhe merr fund me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore; Cikli i dytë zë fill me vendosjen e rregjimit komunist në Shqipëri dhe bashkë me të, të zëdhënësit të saj ideologjik në kulturë, realizmit-socialist; Cikli i tretë zë fill në Kosovën e viteve gjashtëdhjetë po me realizmin socialist dhe vijon, me thyerje të forta letrare e ideologjike, pak a shumë, deri me rënien e komunizmit në Shqipëri; Cikli i katërt është cikli i gjatë e i pandërprerë i studimeve italo-arbëreshe në të cilin harmonizohet edhe aktiviteti i pasur i diasporës shqiptare; dhe, Cikli i pestë, ai i bashkohësisë, është vorbulla e madhe mbarëshqiptare nga vitet '90 e deri sot e kësaj dite.

Këto cikle përvijohen si të tilla në bazë të karakteristikave të tyre të përsëritshme ose korrelative. Të pranishme ose jo, ato përcaktojnë kufijtë e cikleve dhe tablonë e përgjithshme të produktit kritik të epokës. Kështu, për nga vetë karakteri i tyre ciklik, një nga karakteristikat kryesore mbetet imagjinari i një "kohe zero", prej nga jepet ideja ose, sipas rastit iluzioni, se kjo *gjithçka* nis aty, pa patur një vijimësi me ndonjë traditë të mëparshme. E tillë është vetëdija e Konicës, e tillë është vetëdija e kritikëve shqiptarë ose kosovarë të realizmit socialist. Natyrisht arsyet dhe motivimet janë shumë të ndryshme nga njera-tjetra: nëse Konica niset nga një vetëdije mirëfilli kulturore e letrare, këta të dytët arsyetojnë e ndoshta edhe ndjejnë mbi baza tërësisht ideologjike. Gjithsesi, «koha zero» apo «tradita zero» mbetet një specifikë ciklore.

Natyra ciklike dallon edhe në lidhje me marrëdhënien që krijuan me shkollat dhe metodat e shqyrtimit të tekstit letrar. Ciklet dallohen qartë nga njeri-tjetri për nga prania ose mungesa e eksperimentit metodik apo shfrytëzimit të mjeteve metodologjike të analizës së dukurive letrare. Për më tepër, dukuria e «shkencave leader» që ndryshoi dukshëm relievin e shkencave humane Perëndimore është thuajse e panjohur, e ndaluar ose e pafuqishme në disa prej tyre, por bëhet tipar, deri-diku përcaktues i ndonjë faze tjetër, si për shembull nga fundi i viteve '70 në Kosovë.

Karakterin ciklik ua jep këtyre fazave edhe një element në pamje të parë social-politik, por në thelb, intrinsek për qenien njerëzore, për artin dhe refleksionin mbi të: paradigma e lirisë. Duke shqyrtuar këto cikle do të vërejmë se niveli apo shkallët e lirisë ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e mendimit kritik për letërsinë. Mungesa e lirisë ose një liri e pjesshme, ndonëse mund të mos i prishin dot punë një shkrimtari të talentuar, janë të dhunshme e vrastare për refleksionin teorik dhe shkrimin për shkrimin: është e qartë se duke parashtruar leximin e vet, duke theksuar aspektet metodike të analizës, kritikun nuk e mbron dot figurshmëria e fiksionit.

Por le t'i shqyrtojmë konkretisht këto cikle:

I. Në ciklin e parë, atë të *modernitetit*, spikat lindja e vetëdijshme e kritikës letrare. Mbi parime nga më modernet, në «Kohëtoren e letrave shqipe», Faik Konica hedh bazën dyfishe të procesit kritik shqiptar: në faqet e *Albanisë* përvijohen njëkohësisht kritika e kritikës dhe kritika e veprës letrare[1].

Kësaj aventure do t'i bashkangjiten më pas periodikë gjithnjë e më të specializuar dhe në shkrimet e «Hylli i Dritës», «Leka», «Illyria», «Përpjekja shqiptare», «Bota e re», «Shkëndija», «Kritika», «Revista letrare» etj., ku, krahas gjykimeve për veprat letrare shfaqen qëndrime të qarta botëkuptimore dhe metodike, që na lejojnë sot të kuptojmë parimet estetike mbi të cilat u shkruan këto kritika si dhe shkollat teorike-letrare që u shfrytëzuan për to. Kështu jetojnë krahas njëra-tjetrës, herë në harmoni e herë në përplasje prirja etnopsikologjike e kulturo-historike e «Hyllit të Dritës» me neoklasicizmin dhe estetizmin e «Lekës», romantizmi etno-psikologjik i traditës me filozofinë pozitiviste të «Përpjekjes», sfidat e para të psikanalizës e sociokritikës me programin social e metodën realiste të «Botës së re», prirja e shqyrtimit filologjik të tekstit me efektet impresioniste të leximit, vështrimi krahasimtar e kontekstual i veprës me analizën imanente të tekstit dhe gjurmimet e para tematike. Emra si Konica, Krist Maloki, Eqrem Çabej, Gjergj Fishta[2], Mitrush

[1] Një studim shterrues për këtë çështje mbetet punimi i S. HAMITI, me titull *Faik Konica jam unë*.

[2] Sikundërse edhe më parë, në artikullin Fishta kritik, në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, 23/2, Prishtinë 2004, f. 333, shpreh bindjen se emrave të tillë si Konica, Koliqi, Fishta, Kuteli, Poradeci, Noli, etj, në

Kuteli, Fan Noli, Vangjel Koça, Dhimitër Shuteriqi, Arshi Pipa etj, farkëtojnë përmes kritikave të tyre dy nga karakteristikat më të qënësishme të këtij cikli: diversitetin e skajshëm kulturor e metodologjik dhe kritikën e kritikës. Në të dy rastet vërejmë marrdhënien konkrete që kanë ndërtuar autorët me veprën a dukurinë letrare duke u udhëhequr intuitivisht ose metodologjikisht nga shkolla të caktuara. Kështu prirja filologjike e Çabejit gërshetohet me shqyrtimet krahasimtare e kulturo-historike, te Krist Maloki shfaqet herët përqasja psikanalitike e nivelit të parë, përmes të cilës synohet analiza e procesit krijues dhe një kritikë e kritikës, duke besuar veçanërisht te objektiviteti e metodës[3]; elementë të po kësaj metode gërshetohen te Valgjel Koça me analizën e sistemit filozofik të veprës e të personazheve, veçanërisht të një filozofie sociale, kombinim metodik që i lejon kritikut të përcaktojë lindjen tashmë edhe në letrat shqipe të një letërsie nihiliste, (sipas tij *literaturë e mohimit*), nga shkrimtarë si Spasse dhe N. Bulka; te Fishta, përveçse një sistem unikal estetik për epokën, gjejmë gërshetimin e një sistemi kritik me parime të qarta estetike dhe etike, mbi të cilat mbizotëron kategoria e së bukurës, nga ku përvijohet një metodë pune e shkrimi që u përshtatet karakteristikave të çdo vepre, duke qenë se për Fishtën vepra mbetet një *quid unicum* dhe si e tillë e papërsëritshme as si *ens* e as si ligjërim mbi të[4]; ndërsa për të përkufizuar kritikën e Kutelit bëhet e vlefshme ankesa e vetë Krist Malokit në polemikë me të, teksa shkruan më 1938 se ai përdorte «fjalë dhe kaptime nga shkenca të ndryshme dhe heterogjene: nga filozofija, nga esthetika, nga metrika, nga filologija, nga theozofija, nga metapsyhika, nga fizika, nga teknika, nga gjeografia, nga psyhologija, nga ekonomija politike etj., etj.”[5]. Madje, kohët e fundit, studiuesi A. Plasari[6] e thekson këtë tipar

një histori të mendimit kritk shqiptar, do t’u duhej të qëndronin paralel me vetveten krahas një historie të letërsisë shqiptare.

[3] MALOKI, Krist, (me pseudonimin K. Lepeteni), “Naim Frashëri”, në *Naim Frashërit*!, Graz, 1925, f. 57.

[4] Për më tepër shih ASLLANI Persida, “Fishta kritik” në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, 23/2, Prishtinë 2004, f. 333

[5] MALOKI, Krist, “A asht poet Lasgush Poradeci?” në *Përpjekja shqiptare*, nr. 18-24, 1938, f. 336.

[6] PLASARI, Aurel, në “Shënime përmbi “Shënimet””, te Kuteli – *Shënime letrare*, Shtëpia botuese GrandPrind, Tiranë, 2007, f 16. Plasari e thekson edhe më tepër këtë tipar përfaqësues të kritikës së Kutelit duke e përshkruar larminë e

si veçori përfaqësuese të sistemit kritik të Kutelit. Ndërkohë, në vitet '80, I. Rugova shquante saktë gjurmën e parë formaliste[7] në mendimit kritik shqiptar pikërisht te shënimet e viteve '30 të autorit si dhe aspekte të një teorie intuitiviste kroçiane. Kjo prevalencë e intuitës do të përforcohet te Pipa[8] tashmë në funksion të një kritike të kritikës, me pretendime të qarta ndaj aktit kritik si pretendim mirëfilli estetik; me konceptimin e kritikës së artit si filozofi e artit; gjë që e radhit kështu Pipën përkrah Konicës e Malokit në formulimin e postulateve mbi vetë procesin kritik shqiptar. Ndërkaq, këto prirje drejt një metafizike të krijimit dhe të një arti që buron nga pavarësia estetike e veprës do të kenë edhe kundërpeshën e tyre kulturore: po gjatë viteve '30, në qerthullin e kulturës e të kritikës shqiptare shfaqet prirja shoqërore-realiste, e cila parashtron një botëkuptim mbi baza marksisto-sovjetike[9] për artin dhe kritikën. Përfaqësuesi teorik kryesor i kësaj

ndikimeve dhe marëdhënieve të tij me shkolla ose prirje të ndryshme të shkencave humane si një qendrim preferencial e intuitiv të autorit: "Në këtë kuptim, për ç'i përket shkollës ose rrymës së kritikës letrare në të cilën Kuteli do të përfshihej, mund të pohohet që ai është eklektik: kanë pjesën e vet në "shënimet letrare" të tij shkollat impresioniste, kulturologjike, sociologjike, heraherës edhe ajo psikologjike etj.; dallohen në këto "shënime" elemente të psikologjisë së artit, të estetikës, të sociologjisë letrare, madje të poetikës e të stilistikës, deri edhe të bibliografisë; te një kritik si ai akti fiton autoritet nëpërmjet argumenteve të huazuara prej burimesh informacioni nga më të llojllojshmet: sociologji, filozofi, filozofi, ekonomi, histori, kulturë në tërësi. Shkurt fjala: ka lidhje idesh e parimesh, afilime dhe aderenca me shkolla të ndryshme, porse pa u përfshirë kryekëput në asnjërën syresh".

[7] RUGOVA, Ibrahim, në *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Eurorilindja 1996 (botim i dytë), f. 156. "Kemi bërë përpjekje të informohemi se mos në formalizmin e Kutelit ka ndikuar formalizmi rus, që mund të supozohet se në atë kohë njihej në Bukuresht, ku u formua kritiku, por nuk kemi mundur ta verifikojmë këtë. Pra, mund të ketë refleksione nga kjo shkollë apo nga teoria frënge "explication de texte", që bashkë me formalizmin gjerman përbënin formalizimin europian" […] Pos kësaj, në kritikën e Kutelit ndihet edhe teoria e intuicionit të Kroçes, që në atë kohë ishte e pranishme në Shqipëri, jo vetëm në tekste kririke. Do konstatuar se Kuteli kërkon ta meterializojë intuicionin përmes formalizmit të vështrimit".

[8] PIPA, Arshi, kritika e të cilit tashmë mund të gjendet në përmbledhjen Arshi Pipa, *Kritika* (Esse 1940-1944), botimet Princi, Tiranë, 2006.

[9] Sipas autorëve të *Historia e letërsisë shqiptare*,: "Idetë dhe problemet që do të shqyrtohen në këta artikuj […] vinin përmes revistës frënge Commune (Komuna) që udhëhiqej nga një redaksi ndërkombëtare, që në njëfarë dore ishin jehonë e Kongresit I të shkrimtarëve sovjetikë të mbajtur më 1934, ku u vendos për oficielizimin e metodës së realizmit socialist ", në *Historia e letërsisë*

pikëpamjeje ishte kritiku i ri Dhimitër Shuteriqi dhe tribunë kryesore revista "Bota e re" që botohej në Korçë. Me shfaqjen e kësaj kritike synohtet modifikimi në funksion ideologjik edhe i konceptit "kombëtar" të artit. Nëse për traditën deri diku romantiko-historike, pozitiviste e deri psikokritike, ky nocion përfaqësonte marrëdhënien e shkrimtarit ose të kritikut me një identitet kombëtar, në parimet e kritikës social-realiste ajo shndërrohet në pretendim për gjithëpërfshirje shtresash të popullit, në konkretësi në "qarjen e halleve" të njerëzisë, dhe se kjo nuk mund të bëhej veçse përmes një "realizmi konkret".

Përveç kësaj tabloje, për të shqyrtuar ciklin e modernitetit, duhet të mbajmë prasysh mungesën e tribunës së mirëfilltë të studimit letrar, botën universitare, botimet e specializuara dhe debatin shkencor. Mungesa e tyre jo vetëm që nuk e nxit një prodhim të tillë, por e shndërron këtë produkt në një "luks" të pashpjegueshëm për një epokë. Në kushtet e hapjes së shkollave të para të mesme, dilte e nevojshme të pasurohej "biblioteka" e nxënësit dhe e mësuesit me tekste shkollore ose studimore me karakter ftillues, klasifikues e deri-diku analizues. Dilte gjithashtu e nevojshme të qarkullohej shqip, e sa më parë, pasuria e pafundme klasike, e cila, krahas përkthimit të tekstit letrar do të shtresonte tashmë edhe sistemin klasik të studimit apo edhe shijimit të tekstit. Studimet e para metrike dhe stilistike kanë këtë natyrë. Ndërsa, par sa i takon makroshqyrtimit të letërsisë shqipe, do të bashkëjetojë prirja romantike e kultur-historizmit me metodologjinë e pozitivizmit duke u rrekur të sjellin propozimet e para për klasifikim dhe periodizim në letrat shqipe. Sprovat e Çabejt, botimi ndërkaq me jehonë në botën shqiptare i veprës së G. Petrottas, vëzhgimet e Justin Rrotës dhe përmbledhjet "Shkrimtarë shqiptarë" filluan të plotësonin kuadrin metodik e shkencor të një historie letërsie. Ndërkaq, për arsyet e lartpërmendura, hapësira e vetme e kritikës letrare mbetet shtypi periodik, dhe pikërisht aty kemi edhe sprovat më të mira të saj, së bashku me sfidat dhe debatet e epokës. I takoi pra pikërisht kritikës së modernitetit (moderne) të gjendej mes historisë, shkencës, estetikës dhe ideologjisë. Se cila prej tyre do të merrte përparësinë dhe do të prishte ekulibrin e çuditshëm të ciklit të

shqiptare, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1983, f. 477. Këtë të dhënë e përmend edhe Rugova në veprën e cituar, f. 164.

parë besoj se mund të shihet fare qartë në një përkufizim të bërë po atyre viteve nga vetë Dhimitër Shuteriqi: "Lirija në një vepër letrare është e domosdoshme. Po duhet një liri e kufizuar e jo e plotë"[10].

II. Shpreh bindjen se cikli i dytë, ai i realizmit socialist, zë fill me paradigmën e lirisë (në progresion zbritës) dhe merr fund po prej kësaj paradigme. Jo sepse në ciklin e mëparshëm ndjeshmëria ndaj lirisë ka qenë më e ulët. Kutelit, shkrimar e kritik njëheri, nuk i mjaftonte as ajo e viteve '40 teksa shkruante se "nuk mund të mohohet se në Shqipëri ka munguar kurdoherë elementi i parë nga i cili ka nevojë shkrimtari: *lirija*"[11]. Le të përfytyrojmë tani se ç'mund të ndodhë kur vetë kritikut e shkrimtarit i mbushet mendja se e ka lirinë të tepërt…! Dallimi thelbësor mes lirisë në këtë paradigmë është se nëse në ciklin e parë Kutelit i lejohej të ankohej se atij dhe kolegëve të tij i mungonte liria, në ciklin e dytë një deklarim i tillë publik bëhet i pamundur. Nga ky dallim zë fill edhe imagjinari i "kohës zero" në ciklin e dytë: përsiatjet dhe gjykimet për letërsinë e artin duhej të niseshin krejt nga e para, dhe t'i përshtateshin nocionit marksist-sovjetik për lirinë, vënies me hir e pahir nën dogmën e ngurtësuar e absolutiste ideologjike, domethënë antilirisë. Kuptohet vetiu se sprovat kritike të Konicës, Malokit, Fishtës, Çabejt, Kutelit, Pipës, etj bëheshin të papërdorshme, madje të dëmshme, dhe duheshin flakur në heshtjen e gjatë që pasoi ndaj një pjese të rëndësishme të traditës së modernitetit kulturor shqiptar. Gjithashtu, edhe përbërësi tjetër i karakterit ciklik, marrëdhënia me shkollat e ndryshme teoriko-kritike si dhe "shkencat leader" i nënshtrohet po kësaj paradigme. Nuk do të bëhet kurrë fjalë, përgjatë viteve 1945-1990, për sprova kritike a persiatje teorike të tipit formalist, strukturalist, psikanalitik, gjenetik, antropologjik, mitokritik, semiologjik, poetik, e aq më pak për interdisiplinaritet e "shkenca prijëse" që mund të modifikonin qasjen ndaj tekstit letrar apo vetë kritikën e kritikës. Në këtë listë të mungesave bien në sy më shumë se të tjerat vetë zhvillimet e kritikës marksiste të gjysmës së dytë të shekullit XX. Emri dhe vepra e J-P. Sartrit, L. Goldmanit, Lukashit apo veprat e para të Bartit mbeten një herezi e patolerueshme, duke sjellë një shkreti refleksive dhe kritike të pashoqe. "Koha zero" e ciklit socrealist ishte në thelb koha e një

[10] Cituar nga I. Rugova, në vep. cit., f. 166.
[11] Cituar nga A. Plasari në veprën e cituar, f. 34.

marksizmi fillestar e të ngurtësuar i cili u bë shkak i varfërimit të vetë prodhimit letrar dhe atij kritik. Po të ndjekësh zhvillimet e këtij procesi gjithsesi mund të vëresh edhe disa nga fazat e tij. Kështu, në vitet '45-'60 kritika është e pazhvilluar dhe zhvillohet më tepër fusha e studimeve historiko-letrare, përmes të cilës zë fill procesi i gjatë i censurimit të shumë autorëve e kritikëve të traditës. Ndërsa gjatë viteve '60, lind polemika mes krijuesve, kryesisht poetë, dhe kritikëve, mbi të ashtuquajturin "novatorizëm", si përpjekje për të zgjeruar mundësinë e shprehjes artistike, prirje që nuk gjente dot shprehjen teorike në formulimet e fazës së parë tepër të politizuar e të ideologjizuar të pasluftës. Gjithsesi, po të shqyrtojmë sot ligjërimin e kësaj periudhe, e ta reduktojmë në fjalë-çelësa, atëherë ajo do të përfaqësohet nga formulime të tipit: marrëdhënie përmbajtje-formë, pasqyrim i realitetit, pasqyrim figurativ i realitetit, vlerësim i realitetit, dobi shoqërore, realitet objektit-realitet subjektiv, përmbajtje artistike, kontekst, kontradiktë, forma nacionale, etj, etj. Po t'i shtojmë këtij inventari aventurën e re ku u kuturis teoria dhe kritika letrare në vitet shtatëdhejtë, e përfshirë nga regresi i përgjithshëm e izolues i epokës, atëherë ai pasurohet me koncepte që i kundërshtojnë në thelb edhe këto të parat si shkarje ideologjike, si p.sh.: heroi pozitiv, konflikt i ashpërsuar, shpërdorim i teorisë së pasqyrimit, partishmëri, proletarizëm, taban kombëtar, formë kombëtare e përmbajtje realiste, etj, etj. Duke qëndruar te tiparet e saj ligjërimore ftoj të vihet re edhe trajta urdhëruese "duhet" me të cilën u drejtohet shkrimtarëve e kritikëve kjo kritikë, gjë që dallon kryekëput nga pjesa më e madhe e ligjërimeve kritike të ciklit të parë. Ndonëse tashmë studimet mbi letërsinë dhe kritikën letrare ishin konsakruar si disiplinë shkencore, mund të dalim në përfundimin se debati dhe aktiviteti teoriko-kritik i kishte hyrë një udhe pa krye dhe një bjerrjeje kohe shembullore në historinë e mendimit shqiptar. Indiferente e shpesh armiqësore ndaj çdo ndryshimi, kjo shkollë ia doli mbanë të censuronte pjesën më moderne të traditës shqiptare, arritjet më të mira bashkëkohore në Kosovë, në botën italo-arbëreshe dhe në krejt diasporën shqiptare. Po të përdorim si përkufizim të këtij cikli përkufizimin e saktë të Rugovës, se në rastin më të mirë po "kërkohej një pluralizëm kritik mbi një bazë moniste, mbi bazën teorike në frymën e filozofisë dhe të teorisë së marksizëm-leninizmit, që esencialisht e ngushton zhvillimin

krijues e kritik, si dhe zhvillimin e individualiteteve të ndryshme"[12] atëherë del mëse e qartë përse cikli pasardhës në Republikën e Shqipërisë jo më socialiste, do të ketë sërisht si tipar thelbësor të vetin "Kohën zero". Por le të shqyrtojmë më parë, ciklin e tretë të mendimit teorik e kritik shqiptar, cikël me areal gjeopolitik e kulturor Kosovën.

III. Për kushtet politiko-shoqërore të Kosovës së pasluftës së 1944, mendojmë se "koha zero" e këtij cikli është një kohë e përbërë. Së pari, nuk kemi një traditë të mirëfilltë brenda hapësirës së Kosovës së pasluftës, as në shtyp, as në botime më vete, as ndonjë traditë shkollore të hershme e aq më pak universitare. Në këtë kuptim, në kushtet e një izolimi të imponuar, mund të flasim për vetëdijen e një fillimi konkret në vitet '45-'50. Por, nga ana tjetër, e gjendur nën Jugosllavinë titiste, fryma përfaqësuese e mendimit kritik është ajo e realizmit socialist. Siç ia do zakoni, edhe këtu kjo kritikë e nis nga e para farkëtimin e sistemit gjykues e kështillues për artin. Formula se letërsia duhej të ishte "kombëtare për nga forma dhe socialiste për nga përmbajtja" qarkullon edhe këtu si një nga parimet bazë të realizmit socialist tipik jugosllav, së bashku me ndarjen ideologjike "botë e vjetër – botë e re" ose "luftë e klasave" etj. Këtë lloj "kohe zero" e përmend në studimin e tij edhe Rugova duke e cilësuar si "pasojë e mendimit dogmatik që u shfaq me praktikën e hershme të socializmit"[13]. Edhe gjatë viteve '60, jo shumë ndryshe nga paralelja e saj shqiptare, ato pak koncepte që vinin nga evolucioni marksist u thjeshtëzuan ose shterrën duke mos ndikuar në ndonjë emancipim filozofik e teorik të dukshëm të kësaj kritike. Shembulli më i qartë është ngushtimi (me ose padashje) i nocionit të "angazhimit" sartrian[14]. Një përpjekje për ta ndërthurur këtë me elemente të teorisë së letërsisë dhe gjurmimin intuitiv kemi te kritiku Ali Aliu. Ndërsa Rexhep Qosja si kritik dhe si studies i mbetet besnik çështjes së angazhimit të shkrimtarit duke e gjykuar si angazhim njëheri social e artistik dhe kërkon shqyrtimin e "integralitetit të veprës", gjë që në thelb është një kërkesë për kontekstualizim historik dhe e mban pranë metodës lansoniane të historisë së letërsisë, por me një ligjërim të

[12] Po aty, f. 244.
[13] Po aty, f. 268.
[14] Për më gjerë shih Rugova, I., vep e cituar, f. 278.

çlirët e me patos[15]. Në kapërcyell të viteve '60-'70, në procesin teorik e kritik të Kosovës shfaqet një tjetër "kohë zero": është koha e një vetëdijeje të re mbi letërsinë dhe kritikën, është koha e një thyerjeje magjistrale, rrjedhojat e së cilës vijojnë edhe sot e kësaj dite. Një brez i ri kritikësh e studiuesish, me një konceptim të ri të letërsisë dhe të diskursit mbi të, realizuan, ndoshta për herë të parë në sistem, bashkëkohësinë e mendimit teorik e kritik shqiptar. Në veprën e I. Rugovës, Rexhep Ismajlit, S. Hamitit, M. Raifit letërsisë i kthehet tekstualiteti, imanenca, polivalenca e leximit, ndërsa kritika fiton të drejtën e subjektivitetit, e rikrijimit dhe në disa raste të fiksionalitetit. Në gjegjje të bashkëkohësisë, brenda saj ndërthuren metodologji të ndryshme të tipit strukturalist, semiologjik, mitokritik, psikanalitik, antropologjik, etj. Kështu te Rugova, falë një leximi semiotik të tekstit na rivjen sipas modelit bartian rifunskionalizimi i një prej teksteve më të rëndësishm të letërsisë së vjetër shqipe; te M. Raifi sprovohen lexime psikanalitike mitokritike e deri-diku tematike; në punët e R. Ismajlit teoria sosyriane dhe më tej çështjet metodike të strukturalizmit, të semiologjisë, komunikimit e gjuhësisë moderne, shtresëzimi tekstual i Lotmanit, etj. dalin si çështje teorike ose metoda analize edhe në kritikën shqipare; te S. Hamiti, njëheri shkrimtar, kritik dhe historian letërsie, vjen tipi dialogjik i kritikës, leximi në sistem i modernës (veçanërisht në veprën e Konicës, Poradecit dhe Pashkut) dhe rifunksionalizimi i traditës së modernitetit përmes një teorie leximi që lejon, sipas frymëzimit bartian, një karakter fiksional edhe të vetë tekstit kritik. Madje, falë këtij rifunksionalizimi, ky grupim i kritikës kosovare rinxjerr nga harresa e qëllimshme shkrimtarët e ndaluar apo të cunguar si dhe fakton ekzistencën e një mendimi kritik modern në letrat shqipe të gjysmës së parë të shekullit XX. Në një nga sprovat e tij të fundit (*Tematologjia*), S. Hamiti hap në mënyrë metodike edhe udhën e studimeve tematike.

IV. Jo rastësisht cikli italo-arbëresh u la të shqyrtohej pasi u panë më parë tri ciklet e para: ai përfaqëson në thelb, për nga vijimësia, atë që do të duhej të kishin qenë studimet, kritika letrare dhe filologjia shqiptare në një paradigmë "normale" të lirisë. Besoj se

[15] Një vështrim më të strukturuar e gjen te SHALA, Kujtim, "Kritika shqipe: statuset" në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, 23/2, Prishtinë 2004, f. 300.

titulli i R. Elsie-t për një nga kaptitujt e kushtuar botës arbëreshe në *Historinë e letërsisë shqiptare* të tij, e shpreh këtë paradigmë më së miri: "Sotto il sereno cielo italiano"[16] (nën qiellin e kthjellët italian). Falë kësaj "kthjelltësie", edhe "koha zero" e këtij cikli është një zanafillë e pastër dhe ndryshon kryekëput nga ciklet e tjera duke qenë se karakterizohet nga lindja dhe fuqizimi i mjediseve të mirëfillta arsimore e intelektuale. Me themelues Gjergj Guxetën nga Hora e arbëreshëvet, më 1730 ngrihet seminari italo-shqiptar në Palermo, i cili është që në ngjizje qendër e fuqishme intelektuale për bashkësinë shqiptare të Siqilisë. Këtë qendër e pasoi ngritja e kolegjit të Shën Adrianit në Kalabri, ku më 1849, J. De Radës i jepet katedra e letërsisë shqipe të krahasuar, e krijuar enkas për të, dhe mbasi e rimerr këtë detyrë më 1892, organizon (më 1895) kongresin e parë gjuhësor arbëresh në Koriliano Kalabro. Më 1901 ngrihet katedra e studimeve shqiptare në Institutin Oriental të Napolit, dhe i besohet Zef Skiroit. Shekulli XX njeh lindjen dhe fuqizimin e disa katedrave dhe qendrave të tjera, si në Universitetin e Palermos, të Kalabrisë, dhe në Romë, e cila lindi si qendër e studimeve shqiptare e drejtuar nga E. Koliqi. Në këto kushte, që herët në traditën e studimeve arbëreshe lulëzojnë studimet historike, etnologjike, kulturore dhe veçanërisht filologjike dhe historiko-letrare. Le të kujtojmë bashkëkohësin e De Radës, Dhimitër Kamarda me Gramatikën e tij krahasimtare të shqipes, apo Vinçens Dorsën e Zef Kripsin. Natyrshëm prej këtij mjedisi do të dilte edhe manuali i parë për letrat shqipe (*Manuale di letteratura Albanese*), ndonëse i paplotë, hartuar nga Albert Stratikoi më 1896. Po aq natyrshëm do të vinte dhe studimi i parë i mirëfilltë për një autor shqiptar, përmes botimit më 1902 të studimit M.Markianoit *L'Albania e l'opera di Girolamo De Rada*. Falë kësaj tradite, e cila harmonizonte studimet historike me filologjinë dhe historiografinë letrare, më 1931 Gaetano Petrotta ndërmerr sfidën e madhe të parashtrimit shumëpërmasor të historisë kulturore shqiptare në veprën e mirënjohur *Popolo, lingua e letteratura albanese* – vepër që do të pasohet nga një punim edhe me kompleks më 1952, me titull *Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese*. Gjysmës së dytë të shekullit XX i shtohet një specifikë e re, e cila do t'i bëjë hapësirat italo-

[16] ELSIE, Robert, Histori e letërsisë shqiptare, botim Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997, f. 105.

arbëreshe ciklin e denjë të përfaqësimit shqiptar. Diaspora shqiptare dhe kosovare, si dhe më pas vetë studiuesit e botës akademike kosovare, bashkëpunojnë me katedrat dhe qendrat kulturore arbëreshe, duke bërë kështu të mundur përfaqësimin e plotë të letërsisë shqipe, pikërisht "Sotto il sereno cielo italiano", teksa nuk qe e mundur askund tjetër. Historiografisë letrare shqiptare i bashkangjiten punimet e Koliqit mbi shkollat letrare, analizat krahasimtare për De Radën, Fishtën, Skiroin, Prenushin, Palajn, Harapin, etj., për studimet zhanrore, poezinë popullore, etj., etj. Kësaj vazhde i shtohen edhe studimet filologjike të Martin Camajt. Karakteristikë e brendshme e këtij cikli është ndërthurrja e shqyrtimit filologjik të tekstit me atë historiko-letrar, periodizues e klasifikues.

Po të shprehemi në mënyrë të figurshme do të thonim se protagonistët e ciklit italo-arbëresh kanë luajtur me vetëdije të plotë rolin e "ëngjëllit mbrojtës", duke u bërë ruajtësit e një tradite që rrezikonte të zhdukej, duke e përcjellë atë nën një strukturë shkencore që do ta bënte të vijueshme e të përdorueshme për brezat e tjerë. Botimet e plota filologjike të shumë autorëve të letërsisë arbëreshe e të shoqëruara shpesh me analiza të hollësishme e gjykime kritike, janë trashëgimia e pashlyeshme që pasuron sot kulturën kombëtare. Prej këndej vijnë dhe dy mënyra të qasjes ndaj teksteve letrare edhe në studimet bashkëkohore: në njërën anë, një interes i skajshëm i natyrës filologjike shkencore i gërshetuar me shqyrtime klasike, të tipit të "filologjisë romane", pra në thelb një prirje konservatore-pozitiviste që e vërejmë p.sh. edhe te shqyrtimet krahasimtare mbi marrëdhëniet e letërsisë shqipe me letërsinë klasike të Giuseppe Gradilones, ose punët filologjike të Italo Fortinos; në anën tjetër, shfaqet një ndërthurrje e fortë e studimit filologjik me gjuhësinë e teksit, që e sjell suksesshëm Françesko Altimari; dhe së fundi, punimet e Matteo Mandalasë që ndërthurin kërkesën filologjike me parimet e studimit kulturor (cultural studies) dhe të një kërkimi të imagjinarit krijues përmes shqyrtimit të imët tekstor.

Ndonëse nuk ndodh një thyerje konkrete në vitet '90 në këtë cikël, gjithsesi hapja përfundimtare e botës shqiptare ndaj botës dhe vetvetes sjell një realitet të ri në proceset kulturore e teoriko-letrare mbarëshqiptare.

V. Pikërsisht këtij realiteti i gjegjet konceptimi i një cikli të pestë kritik në letrat shqipe, te i cili, ashtu si në "teorinë e qarqeve" të Çabejt, derdhen prurjet e veçanta të të gjitha cikleve të tjera së bashku. Arritjet më të mira të cikleve të mëparshme formojnë bazën nga lindin dukuritë e reja. Prirjet e modernitetit në mendimin shqiptar, sprovat e sukseshme teoriko-kritike të viteve '70-80 në Kosovë, kontributi shembullor i botës arbëreshe, bëjnë që në këtë cikël të rikthehet diversiteti kulturor e shkencor i filluar vetëm një shekull më parë. Në këtë diversitet përfshihen tashmë dhe emra të rinj të kritikës në Shqipëri, që, përmes studimeve të autorëve të ndaluar apo të cunguar, eksperimentojnë metodologji të ndryshme nga studimet krahasimtare te ato tekstuale, estetike, narratologjike, psikanalitike, të poetikës së tekstit e të leximit, etj. I tillë është kontributi i A. Plasarit, i Ardian Marashit, etj. Njëkohësisht, vijon natyrshëm aktiviteti i shumë prej autorëve të sipërpërmendur të cilët pasurojnë këtë proces të ri me një kritikë që synon shpeshherë personalizimin e leximit dhe fiksionalitetin e shkrimit kritik ose hapin fusha të reja studimore, si në rastin e botimeve të S. Hamitit (që hap udhën e shqyrtimeve tematike), apo studimet komplekse interpretuese të M. Mandalasë mbi veprën e Ismail Kadaresë.

Ndërkaq mund t'i kthehemi dilemës sonë. Krahas rikthimit të autorëve të ndaluar apo anashkaluar, kritikës letrare i duhet të plotësojë kuadrin studimor mbi këta autorë ose autorë të tjerë duke u sprovuar në analiza të tipit strukrural, semiotik e semiologjik, diskursiv, poetik, intertekstual, imagologjik, tematik, etj. Intuitivisht kritikët e këtij cikli e kuptuan domosdoshmërinë e këtij procesi plotësues, i cili, jo vetëm parashtronte mundësi të reja leximi për shkrimtarët dhe dukuritë letrare, por sidomos emancipon vetë kritikën. Për të plotësuar deri-diku hapësirën e sprovave të munguara, në studimet dhe kritikën aktuale po debutojnë dhe do të vijojnë shqyrtimet mbi diskursin, poetikën e tekstit e të leximit, intertekstualitetin, mitin e imagjinarin; do të jetë mjaft e frytshme analiza tematike e imagologjike. Ka mjaft gjasa që këto sprova të kryhen jo më në trajtën e qasjeve të pastra, por në ndërthurrje me njëra-tjetrën, duke pasuruar nga njëra anë leximet tona ndaj letërsisë shqipe, dhe duke thelluar, nga ana tjetër, aktin kritik si një ndjeshmëri shkrimore postmoderne. Gjithsesi, një interdisiplinaritet i mirëfilltë, që

do të lejonte lexime filozofike e fenomenologjike, apo psikokritike, është ende në fillimet e para. Ndërkohë, shpreh bindjen se një nga mungesat më të dukshme, dhe ende të patrajtuara, është shqyrtimi i letërsisë shqipe në marrëdhënie me artet e tjera, qoftë të kontekstit shqiptar, qoftë atë botëror. Besoj se vështrime të tilla do të ripërmasonin përfytyrimin tonë për procesin e thellë kulturor shqiptar e do të lejonin analiza dhe përfundime të reja.

Ndonëse në një farë mënyre mbërritëm në fundin e kësaj analize, duke rrezikuar madje edhe me parashikime mbi procesin kritik shqiptar, na duhet gjithsesi të pohojmë (rrezikojmë!) se, megjithë ndërtimin e kësaj tabloje, ku kryqëzohen perspektiva të ndryshme, ende nuk bëhet e qartë se sa na lejon kjo e ashtuquajtur "kohë plotësimi" përballjen e vërtetë me bashkëkohësinë tonë. Le të kujtojmë se metodat dhe shkollat përkatëse e reflektojnë bashkohësinë e tyre në vitet '70-'80. Madje sot edhe vetë nocioni mbi postmodernitetin po shkon drejt historizimit të tij. Vetë objekti i aventurës kritike po modifikohet me shpejtësi nën ndikimin e teknologjive të reja të komunikimit, bota virtuale e të cilave ushqehej deri vonë nga virtualiteti *par excellence* i letërsisë. Në çmimin Nobel për letërsinë të këtij viti propozohej një *script* filmi, ndërsa faqet e linkuara të internetit propozojnë një lëvizshmëri leximi të paimagjinuar më parë. Lexueshmëria deri më sot lineare e tekstit po i afrohet çuditshëm, si në një botë përrallash, sferës magjike të leximit shumëpërmasor. Ndoshta kritikut të ardhshëm do t'i duhet të punojë ndërdyshaz, mes dy virtualitetesh të mëdha: atij të një realiteti gjithnjë e më virtual falë teknologjisë së vet dhe virtualitetit primordial e të thellë të botës së gjuhës e të artit. Sidoqoftë, pjesë e këtij spektakli të pandalshëm, ai do të vijojë të bartë rolin tragjik të magjistarit të rremë, të atij që e di se pas "magjisë së vet kritike" fshihet "loja" thellësisht njerëzore, e pikërisht prej kësaj hyjnore e artit.

Gëzim GURGA

PËR BOTIMIN KRITIK TË *FJALORIT ITALISHT-SHQIP* TË FRANCESCO MARIA DA LECCE-S (1702)

I pari që njoftoi për ekzistencën e dorëshkrimit me Fjalorin Italisht-Shqip të Da Lecce-s ishte Giuseppe Schirò në vitin 1918, kur duke folur për fjalorin e vëllimshëm shqip-italisht e italisht-shqip të Nilo Catalano-s (1694) që asokohe gjendej në duart e tij e që sot konsiderohet i humbur, përmend shkarazi se ky fjalor nuk ishte më i vogël se ai i Da Lecce-s, të cilin thotë se kishte pasur rastin ta shihte në Palermo 30 vjet të shkuara, por që nuk ia kishte dalë dot ta blinte[1]. Po aty Schirò shton se Imzot Paolo Schiro kishte kopjuar disa faqe nga ky fjalor.

Në vitin 1932 në veprën e njohur "Kërkime mbi tekstet e vjetra shqipe" Mario Roques thotë se "ky fjalor aktualisht ka humbur"[2]. Po atë vit fjalori zihet ngoje nga Gaetano Petrotta në veprën e tij *Popolo, lingua e letteratura albanese*, 1932, ku njofton se përveç Paolo Schirò-it, edhe Camarda kishte kopjuar disa pjesë të fjalorit të Da Lecce-s. Sipas Petrotta-s[3], në vitin 1868 fjalori ishte në zotërim të priftit Filippo Matranga, ndërsa aty nga viti 1890 prof. Giuseppe Petrotta asokohe student i ri, ia dha për shqyrtim Saverio Montalbano-s, që punonte në Bibliotekën Kombëtare të Palermos. Prej kësaj date fjalorit i humbën gjurmët.

Të dhënat e mësipërme janë rimarrë pothuaj në të gjitha manualet dhe tekstet e historisë së dokumenteve te vjetra të shqipes, deri në vitin 1988 kur Biblioteka Rajonale e Palermos, me rastin e pesëqindvjetorit të themelimit të fshatit arbëresh Piana degli Albanesi, boton një katalog me libra e dokumente dorëshkrim që ruhen në

[1] Giuseppe Schirò, *Della lingua albanese e della sua letteratura, anche in rapporto alle colonie albanesi d'Italia*, në "Annuario dell'Istituto Orientale di Napoli, 1918, ribotuar në *Giuseppe Schirò,* "Opere", a cura di Matteo Mandalà, Vëll VIII Saggi, f. 113.

[2] Mario Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais, avec huit fac-similés,* Paris Librarie Orientalist Paul Geuthner, 13, Rue, Jacob, VI[e] MCMXXXII, p. 37.

[3] Gaetano Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese,* a cura di Matteo Mandalà, A. C. Mirror, Palermo, 2003, f. 125.

fondet e saj mbi arbëreshët e Sicilisë, ku përfshihet edhe fjalori i Da Lecce-s.[4]

Pas rizbulimit, Matteo Mandalà qe i pari studiues që tregoi interes për këtë vepër. Kështu në vitin 1995 ai botoi një studim të gjatë mbi "Huazimet turke në fjalorin e Da Lecce-s",[5] ndërsa dy vjet më pas botoi artikullin "Fjalori italisht-shqip (1702) vepër e pabotuar e Francesco Maria Da Lecce-s"[6]. Në këtë artikull autori bën një përshkrim të hollësishëm fizik të dorëshkrimit, përshkruan alfabetin dhe tiparet kryesore të strukturës së veprës si edhe jep të dhëna të reja mbi jetën dhe veprimtarinë e Da Lecce-s si misionar në trojet shqiptare, mbi punën e tij si mësues i shqipes në Romë e përgjithësisht mbi veprën e tij. Përmendim këtu një dokument autograf të Da Lecce-s, që mban datën 14 shkurt 1701, ku ai pohon se përveç Gramatikës, ka shkruar në shqip edhe një Doktrinë Kristiane, vepra këto që ia ka ofruar Kongregatës së Propagandës Fide.

*

* *

Në këtë kumtesë nuk është vendi të trajtojmë çështje që kanë të bëjnë me kuadrin historiko-kulturor në të cilin u ngjiz vepra, apo me aspekte të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë së autorit. Këto do të trajtohen hollësisht në botimin kritik që do të shohë së shpejti dritën e botimit. Këtu po ndalemi vetëm në disa aspekte që kanë të bëjnë me strukturën e fjalorit dhe me parimet leksikografike që ka zbatuar autori, duke u rrekur kështu të japin një pamje sa më të përgjithshme të përmasave dhe të vlerave të fjalësit shqip, si edhe të parashtrojmë përmbledhtazi metodën që kemi ndjekur në përgatitjen e botimit kritik të kësaj vepre.

Sikurse bën edhe në gramatikën e tij, Da Lecce në parathënien shqip të fjalorit titulluar *Shqipëtaarit* shpall hapur synimin mirëfilli

[4] Raccolte librarie degli Albanesi di Sicilia, Palermo, 1998, f. 43.

[5] Matteo Mandalà, *Il Dittionario del Da Lecce e i turchismi nell'albanese (sec.XVII-XVIII)*, në Albanica 10, Quaderni dell'Istituto di Lingua e Letteratura Albanese, Palermo, 1995.

[6] Matteo Mandalà, *L'opera inedita di Francesco Maria da Lecce*: *il Dittionario Italiano – Albanese (1702),* në Quaderni del Dipartimento di Linguistica, nr. 14, Cosenza, 1997.

didaktik dhe pragmatik të kësaj vepre, që do t'u shërbente misionarëve italianë që dërgoheshin në trojet shqiptare për të mësuar shqipen.

Këte Diktionaar, oh Shqipëtaari i dashun, e shkrova jo për zotinii tande, qi di maa fort se unaj, veç për vetëhe, qi jam për së largu, e gjuhënë e shqipëtarëvet e kam posi nji kafshë të huojë. E përse dresha se tue u larguem prej jush, largohet prej meje kjo gjuha: pr'ata lëftova me rjeshtitunë ndë letrë fjalëtë, qi zuna ndër ju. Ndë mos e paça vum mirë, po të lutem, për të mirë tat, mos m'shaa: se as unë qesha kuur këte gjuhë: po për saa paç fuqiin e dijen dëshërova me marrë esapin e gjuhësë sikundrëse ju...

Ndërkohë për të njëjtin qëllim Da Lecce kishte shkruar edhe një gramatikë shqipe, qysh përpara vitit 1702, sikurse pohon vetë në parathënien italisht drejtuar *al curioso lettore,* si edhe një *doktrinë kristiane*, sikurse del nga një dokument që mban datën 1701, botuar nga Mandalà në artikullin e lartpërmendur.[7] Ky dokument konfirmon mendimin e shprehur nga R. Ismajli qysh në vitin 1982 në "Gramatika e parë shqipe", sipas të cilit gramatika shqipe që përmendet në analet e Kongregatës Fide në vitin 1701 mund të jetë shkruar pikërisht nga Da Lecce[8].

Nga pikëpamja leksikografike fjalori pasqyron nivelin, arritjet por edhe kufizimet e kohës kur u shkrua. Në fund të shekullit XVII për sa i përket teorisë dhe praktikës leksikografike të hartimit të fjalorëve shpjegues të italishtes, ishin bërë hapa të rëndësishëm. Mjafton të kujtojmë se në vitin 1691 del në dritë botimi i tretë i fjalorit të gjuhës italiane, hartuar nga Akademia e Kruskës. Ndërsa në lëmin e leksikografisë dygjuhëshe asokohe në Itali hartoheshin dhe botoheshin kryesisht fjalorë kalepinë latinisht-italisht dhe italisht-latinisht që shërbenin për mësimin e latinishtes kishtare. Për sa u përket fjalorëve të mirëfilltë dygjuhësh, Da Lecce së bashku me bashkëkohësin e tij Nilo Catalano – që, sipas të dhënës së Schiro-it, kishte shkruar në vitin 1694 një fjalor të vëllimshëm italisht-shqip dhe shqip-italisht me një

[7] Matteo Mandalà, *po aty.*

[8] Rexhep Ismajli, *Gramatika e parë e gjuhës shqipe, botim kritik, me studim e transkriptim,* Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 12-14.

fjalës shqip me bazë gegërishten, që me gjasa bazohej kryesisht në vjeljen e veprave të autorëve të vjetër, Budit, Bardhit, Bogdanit, e ndoshta edhe Buzukut – bën një punë prej fatosi. Në fakt, fjalorët e parë të mirëfilltë dygjuhësh në Itali do të shfaqen vetëm gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVIII[9].

Fjalori përmban mbi 12.000 zëra ose artikuj. 89 fjalë italisht janë lënë pa u përkthyer në gjegjëset shqipe. Këto janë kryesisht toponime: emra qytetesh, lumenjsh, ishujsh, si *Antiochia – città, Atene – città, Europa - 3-a parte del mondo, Cinosa - città di Candia, Cipro – isola, Eufrate – fiume, Ebro - fiume di Spagna; Filippoli - era città di Macedonia, Giordano – fiume, monte Sina;* emra bimësh si: *basilico – herba, berilla – herba, camomilla – herba, coda di cavallo – erba, dattilo – frutto, dattilo – albero, gratiola – erba, mercorella – erba, ombelico di Venere, polmonaria seconda;* emra shpendësh e peshqish, *boca – pesce, calamaro – pesce, calandra – ucello, camaleonte, golano - ucello grande;* por edhe fjalë të përgjithshme, që me sa gjasa nuk ua gjeti dot gjegjësen në shqipe, si *artificiosamente, anzi che, calcidonia – pietra, calcinaccio, carbonaia, espugnatore, essilio, forziero, pana, testatore* etj.

Fjalët italisht janë renditur alfabetikisht. Ky rend shpeshherë ndërpritet nga disa struktura leksikore taksonomike (grupe hiponimike ose meronimike). Kështu nën zërin *Herba* vijon një listë hiponimike me 312 emra bimësh, që në pjesën italisht janë renditur alfabetikisht. Po ashtu nën zërin *huomo* vijon një strukturë taksonomike me grupe hierarkike meronimesh (gjithsej 225 fjalë) që kanë të bëjnë me pjesë të trupit të njeriut. Nën zërin *archibuggio – pushkë* vijon një listë me 34 fjalë e terma që shënojnë pjesë të pushkës. Nën zërin *cavallo* vijon një listë me rreth 43 fjalë që përbëjnë, si të thuash, fushën semantike të kalorësisë. Fjalori mbyllet me një listë me 27 emra të kremtesh fetare, me një listë me emrat e muajve në shqip, përkrah gjegjëseve përkatëse në italisht dhe hebraisht, si edhe me një listë me 15 emra mineralesh.

Zëri apo artikulli i fjalorit është organizuar përgjithësisht sipas praktikës leksikografike të kohës kur u shkrua. Për hartimin e fjalësit

[9] shih Matteo Mandalà *Gjurmimet leksikografike në mjedisin arbëresh të Sicilisë,* në "Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë", (Konferencë shkencore, Tiranë, 3 dhjetor 2004), Tiranë, 2005, f. 85.

italisht autori do të jetë mbështetur në kalepinë të kohës, por nuk përjashtojmë të ketë shfrytëzuar edhe ndonjë nga tri botimet e para të Fjalorit të Akademisë së Kruskës. Ndryshe nga fjalori i Frang Bardhit, ku siç ka vënë re me të drejtë Pashko Geci, «fjalët latinisht janë vënë vetëm në një kuptim»[10], Da Lecce, në funksion të paraqitjes sa më të plotë të leksikut të shqipes, që përbën edhe synimin kryesor të fjalorit, veçon me anë sinonimesh apo parafrazimesh ato kuptime të fjalës përkatëse italisht që kanë si gjegjëse fjalë të ndryshme shqipe. Kështu p.sh., dallon *accordo, conventione* – që e përkthen me shqipen *godii*; nga *accordo, concordia – paqë*; *apprendere – me marrë;* por edhe *apprendere – me xanë*; *aspettare – me pritunë,* por edhe *aspettare, fermarsi - me u ndalunë*; *aspro, amaro al gusto – i idhun*; por edhe *aspro, agro al gusto – i tharbët*; *attendere – me lëftuem*; *attendere la promessa – me mbajtun fjal*; *attendere alla sanità – me mbajtun shëndetnë*; *attendere, stare attento – me ndiguem*; *attendere; aspettare – me pritunë*; *attendere, imparare – me xanë*; *barba – mjekrë*, por edhe *barba, zio – ungj*; *bollire – me vëluem*, por edhe *bollire, cuocere l'erbe – me ziem laknat*; *bevere – me piim*, por edhe *bevere a poco a poco – me gjerbunë; chiudere – me mbërshellë,* por edhe *chiudere con siepe – me thurunë,* dhe *chiudere, sigillare la lettera – me mihyrdisunë; comprendere, capire – me ndiem,* por edhe *comprendere, ascoltare – me marrë vesht; confinare, metter confini – me vum kunfinjët,* por edhe *confinare, bandire – me qitunë; custode, guardiano – rujtës,* por edhe *custode, angelo – strazëtaar; digiuno - njinim; anjinesë,* por edhe *digiuno, chi non ha mangiato – esëll; discernere, osservare – me këqurunë, me shikuem,* por edhe *discernere; separare – me daam; fallare; fallire; errare – me faisunë,* por edhe *fallare; peccare – me mkatënuem* etj.

Ndryshe nga pararendësi i tij Bardhi që synonte të hartonte një fjalor që do t'u ndihte bashkatdhetarëve të tij të mësonin latinishten, që të mund të lexonin kështu shkrimet e shenjta, Da Lecce e shkroi këtë fjalor për misionarët italianë që shërbenin në Shqipëri, pra pasqyrimi sa më i plotë, i saktë e i detajuar i leksikut të shqipes ishte

[10] Pashko Geci, *Frang Bardhi dhe "Fjalori" i tij latinisht-shqip*, në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe" vëll. II, Tiranë, 1972, f. 299.

shqetësimi i tij kryesor. Për të përmbushur këtë synim autori mblodhi e voli fjalë e shprehje nga të gjitha burimet e mundshme.

Së pari, fjalori dëshmon për një vjelje sistematike të leksikut të veprave të autorëve pararendës, si Budi, Bardhi e Bogdani[11], nga të cilët mori sidomos fjalë të ligjërimit libror. Kështu në fjalor përfshihen fjalë dhe neologjizma që i hasim në veprat e këtyre autorëve, si *letëraar, krijues, baas*, *dijës, hyj, hyjneshë, rruzullim* etj.

Së dyti, pjesën dërrmuese të fjalësit të shqipes e përbëjnë fjalë e shprehje që autori i mblodhi drejtpërdrejt nga goja e popullit. Ndryshe nga fjalori i Bardhit që dallohet për karakterin e kufizuar sektorial të leksikut, ky fjalor është gjithëpërfshirës. Në të Da Lecce mblodhi dhe kodifikoi, pa dallim, fjalë dhe shprehje nga të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore, që nga fjalë vulgare e të ligjërimit të thjeshtë, deri te fjalë të sferës intelektuale e librore. Kjo pasuri e jashtëzakonshme leksikore dëshmon për një njohje të thellë të shqipes nga ana e autorit. Gjithsesi besojmë se gjatë kësaj pune Da Lecce, i cili në vitin 1702, kur e mbaroi shkrimin e fjalorit, kishte kaluar vetëm 8 vjet mes shqiptarëve, do të jetë ndihmuar doemos edhe nga priftërinj vendas që njihnin mirë edhe italishten.

Autori nuk mjaftohet me dhënien e fjalëve në një formë të vetme, por bën shpesh shënime mbi kategoritë gramatikore dhe jep format kryesore morfologjike. Kështu p.sh. emrat i jep fillimisht në emërore të pashquar, pastaj shton mbaresat e formës së shquar për emëroren, dhe për rasat e zhdrejta: *shpirt, i, it; krue, kroi, kroni, kronit; pluer, ori, it; çark, u, ut; lug, u, ut; bulk, u, ut; shamatë, a, së; unazë, a, së; rosë, a, së*; kur e sheh të nevojshme jep edhe formën e shumësit, kryesisht kur është fjala për shumësa të parregullt, si *kungull, kunguj; porrii, ni pl. purrintë; sharqin, i pl. sharqanjë; shkamb, i, pl. shqembe, evet; vargue, oi, it pl. vargjet; detyer, ori, it pl. detojësit; fyell, felli, it - pl. fejtë;* foljet jepen në paskajoren gege, që zakonisht ndiqet nga mbaresa e vetës së parë të së tashmes dhe të së kryerës së thjeshtë, p.sh. *me fituem, onj, ova; me gjaa, gjas, va; me*

[11] Veprën e Bogdanit "Cuneus Prophetarum" jemi të sigurt se Da Lecce e njihte, sepse e përmend në Gramatikën e tij: shih *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese* del P. Francesco Maria Da Lecce. Min. Oss. Rif., Esprefetto Apostolico delle Missioni di Macedonia, In Roma, nella stamperia della Sag. Cong. di Prop. Fede 1716, f. 220.

gogëzuem, onj, ova; me guxuem, onj, ova; me hikunë, inj, ka; me hjekunë, hjek, hoqa etj.

Fjalët janë dhënë në çerdhen e tyre leksikore, pra kemi rregullisht emër të parmë, folje në formën veprore, folje në formën joveprore, mbiemër prejpjesor, mbiemër me prapashtesën *-shim*, emër prejfoljor asnjanës, emër prejfoljor veprimi me prapashtesën *–im*, emër vepruesi me prapashtesat *-ës, -ues, -taar, -tuer,* emër cilësor me prapashtesat *–i, -ni, -si* ndajfolje me prapashtesën *-shim*, ndajfolje me prapashtesën *–isht.* Nuk mungojnë fjalët e përbëra dhe të përngjitura.

Rreth një të gjashtën e lëndës leksikore në fjalor e zënë togjet e qëndrueshme, sidomos ato me vlerë foljore që në ndonjë rast shoqërohen me foljet delokutive përkatëse.

Përkrah fjalëve italisht, veç gjegjëses shqipe ose në vend të saj, shpesh gjejmë shpjegime leksikografike me përshkrim, me perifrazim ose me përkufizim që të kujtojnë formulat kodifikuese leksikografike moderne: lunaria greca – *baar i malit, qi ka veshin gati si gresta;* crapulare – *me ngranë e me piim paa kuer*; credibile – *qi munë besohet;* disputanti – *ata qi merren ndër vete për sen;* aventore – *ai qi ble çpesh mbë nji duganjë;* esattore – ai qi mer haraç; assistente – *ai qi shërben*; Africa – *dheu i Harapëvet;* centauro – *thonë se asht gjyms nierii e gjyms shtansë;* geometria – *dieja për me matunë dhenë;* essequie – *proçesion për të dekunit;* giulio, moneta – *janë dhjet bajok të Romësë;* impetrabile – *kafshë qi mundet me pas ne* etj.

Shpesh autori e sheh të arsyeshme të ftillojë kuptimin e fjalëve shqipe ose të saktësojë përdorimin dhe përhapjen e tyre me shpjegime në italisht: kështu p.sh. në fl. 265r pas zërit italisht *Usare, adoperare* që e jep në shqip në sinonimet: *me vijuem veti; me u shërbyem,* pason shënimi në italisht: *questo però si deve avvertire che se la cosa che si usa si porta del continuo adosso, come vestimenta, o altro simile, si dice: me bartunë* n.g. *uso la camiscia – po e banj kmishënë*. 2. *uso la zappa per la vigna – mi vijen shati.*

Jo rrallë shpjegimet shoqërohen me shembuj ilustrues në shqipe, si p.sh.

da noi si partì e si portò dal Vescovo – *prej shtëpie sonë duolli e vot ke upeshkup*

dal vescovo s'imbriacò e ruppe una boccia – *mb'upeshkup u deei kaa e theu nji kutrove n'botë.*

Në ndonjë rast parantezat shpjeguese për fjalë a kuptime të veçanta shqipe janë aq të gjata e të hollësishme saqë fjalori fiton një përmasë, të themi, enciklopedike. Kështu p.sh. në fl. 164v-165r aty ku i duhet të japë ekuivalentet shqipe për fjalët e masës së peshës, autori hap një parantezë të gjatë ku shpjegon dallimet mes sistemit të masave të peshës në Itali dhe atyre që përdornin shqiptarët në treva të ndryshme. Kështu thotë, fjala vjen, se një okë shqiptare është e barabartë me katër libra e 8 onça italiane. Në Shkodër përdoret si masë drithi *koshiqi* e katër koshiqe bëjnë një *huu,* ndërsa në Krujë dhe Mat përdoret si masë drithi *shiniku*, e katër shinikë bëjnë edhe këtu një *huu*.

Në fl. 210r, nën zërin italisht rete – *rrjet*, pasi rendit fjalët shqip për lloje të ndryshme rrjetash si *rrjetë, lak, mresha, kariq, rjec,* për të shpjeguar fjalën shqipe *kalamer,* perveç shpjegimit italisht "*Rettaccio o rosacchio fiumano con che si pescano l'anguille e cefali*; *bilancia dicono i romani,* anash faqes kemi edhe një ilustrim figurativ, ku është vizatuar një njeri në breg të lumit që mban në dorë një kallam të gjatë me nje rrjetë katrore në skaj, mbështetur në një shkop të ngulur në tokë. Nga vizatimi kuptohet se është fjala për atë lloj rrjete që sot e quajmë *dajlan*.

Mënyra më e zakonshme e shpjegimit të fjalëve në shqipe është sinonimia, pra fjala italisht shpjegohet në shqipe me një varg të tërë sinonimik, si p.sh:

abbattere – *me rëënuem; me çartunë; me prishunë; me dërrëmuem;* accelerare – *me itatunë; me shpjertuem; me çpejtuem;* adulare – *me limaqsuem; me lëbduem; me gëdhelëtuem; me plebduem;* beffare – *me qeshunë; me qestisunë; me përbuzunë; me shpotititunë;* burlare – *me torobacunë; me gjumecunë; me maskaruem; me shallatunë; me majshtruem; me qeshunë;* ad un tratto – *njiças; vëlis; shpjert; shkath; frek;* ammorzare – *me shkimbunë; me shuem; me fikunë; me shkrepunë;* a tastoni – *shandakot; troq; mboq; tue pipatunë;* demonio – *dreq; djaall; thobrik; shpirtmallkuem;* gemito – *gjamë, të gjëmuem, gjëmim.*

Shpesh herë bëhen përpjekje për të shpjeguar dallimet semantike mes sinonimeve të një vargu. Natyrisht, si gjuhë shpjeguese në këtë rast përdoret italishtja:

Kështu p.sh. nën zërin italisht *strada* lexojmë: strada – *udhë*; strada maestra – *vrom, drum, udha e mbrëretit*; strada stretta – *rrugë*; strada di palizzate – *ulicë*; strada per traverso – *hulli*.

Një numër i konsiderueshëm fjalësh shqipe përsëriten më se një herë në fjalor si gjegjëse të fjalëve të ndryshme italisht. Përgjithësisht këto janë fjalë polisemantike dhe sa herë që përsëriten shfaqin nga një kuptim të veçantë. Po të mbledhim të gjitha rastet kur shfaqet e njëjta fjalë shqipe, do të mund të zbulojmë kështu edhe strukturën semantike të saj në kohën e Da Lecce-s. Si gjuhë shpjegimi edhe në këtë rast shërben italishtja. Kështu p.sh. folja *me baam* më vete na del në kuptimet *costruire, fare, fondare, formare,* ndërkohë që shfaqet edhe në përbërje të dhjetëra togjeve të lira e të qëndrueshme që e ftillojnë edhe më tej strukturën e saj polisemantike, si *me baam ndryshej* – abusare; *me baam shamatë* – cavillare; *me baam turrë* – accumular legna; *me u baam* – diventare; *me u baam burr; me u baam i maadh* – crescere in età; *me u baam ditë* – farsi giorno; *me u baam gaati* – apparecchiarsi; *me u baam i fort*; divenir forte, potente; me u baam rajë – mettersi nella protezione; *me baam bee* – giurare; *me baam bee rreeshim* – giurare il falso; *me baam boçe* – far il bottone; *me baam culë* – fardellare; *me baam dhuun* – fare dispetto; fare vergogna; *me baam me dekunë huni* – far morire di fame; *me baam me ditunë* – accertare, avvertir prima, annuntiare, avvisare, dare avviso etj.

folja *me prishun* del me mbi pesëmbëdhjetë kuptime, që në italisht janë abbattere, cancellare, cassare, conquassare, consumare, dirupare, disfare, far collazione la mattina, guastare etj.

folja *me forcuem* del me kuptimet affermare, fermare, stabilire, fortificare, forzare, guarnire etj.

emri *botë* del me kuptimet: battitura, percossa, bitume, creta, botta, colpo.

emri *punë* del me kuptimet: attione, lavoro, coltivatione, affare, agricoltura, cagione, causa, edificio.

Siç vihet re nga shembujt e mësipërm, për një numër të konsiderueshëm fjalësh polisemantike fjalori dëshmon kuptime që sot

kanë humbur ose kanë dalë nga përdorimi, por që dikur kishin shërbyer si tema semantike prej të cilave rrjedhin kuptime që sot ekzistojnë, e që pikërisht për shkak të mungesës së kësaj hallke lidhëse, paraqesin vështirësi motivimi. Prej këtej del qartë rëndësia që merr ky dokument i rëndësishëm gjuhësor edhe për ftillimin e lidhjeve të brendshme të strukturës kuptimore të fjalëve e në përgjithësi në studimin historik të semantikës leksikore të shqipes.

Nga sa thamë më lart del qartë se kjo vepër përbën një burim të paçmuar të dhënash për studimin historik të leksikut dhe përgjithësisht të gjuhës shqipe. Por rëndësia e tij nuk është vetëm gjuhësore, sepse me pasurinë e pashoqe leksikore që përmban, fjalori bëhet një burim i vyer të dhënash edhe për fusha të tjera të kërkimit si etnografia, antropologjia kulturore etj.

*

* *

Kuptohet që pjesa që na intereson në këtë fjalor dygjuhësh është fjalësi shqip. Fjalësi italisht na ndihmon për të kuptuar e sqaruar më mirë aspekte të veçanta të kuptimit dhe përdorimit të fjalëve në shqipe. Pra është e domosdoshme të nxirret nga dorëshkrimi një inventar i plotë i fjalëve shqipe në rend alfabetik, shoqëruar përkrah me fjalën gjegjëse italisht. Për këtë qëllim kemi përdorur një program të përgatitur enkas.[12]

Ky program në thelb është një *data base* shkruar në *Visual basic* që lejon regjistrimin e fjalëve në një skedar *projekt* të Microsoft Access-it.

Çdo zë i fjalorit regjistrohet si një *record* që përbëhet nga fusha të posaçme për çdo njësi leksikore italisht dhe shqip.

Për çdo fjalë shqip regjistrohet në një fushë të veçantë kategoria leksiko-gramatikore, apo shënime të tjera që kanë të bëjnë me përkatësinë stilistikore, fjalëformimin etj. Në këtë mënyrë është më e thjeshtë të përpunohen dhe të nxirren të dhëna statistikore të vlefshme mbi fjalorin.

[12] Programi është shkruar nga Alda Dollani, të cilën përfitojmë nga rasti ta falënderojmë për bashkëpunimin dhe ndihmesën që na ka dhënë.

Çdo zëri të fjalorit programi i jep automatikisht një numër referimi progresiv.

Kështu pas regjistrimit të tekstit të dorëshkrimit, përmes disa komandave të thjeshta programi është në gjendje të gjenerojë dy rezultate të ndryshme. I pari riprodhon tekstin e dorëshkrimit besnikërisht, duke i shtuar çdo zëri të fjalorit një numër progresiv përkrah. Komanda e dytë e përmbys, e kthen fjalorin origjinal italisht - shqip në një fjalor shqip – italisht, duke e renditur alfabetikisht fjalësin shqip me gjegjëset italisht dhe me numrin e referimit përkrah. Ky i fundit na ndihmon për t'iu rikthyer, në rast nevoje, zërit ku shfaqet fjala shqipe në fjalorin origjinal.

Për të realizuar automatikisht renditjen sipas alfabetit të shqipes, që sikurse dihet, për shkak të zanores /ë/, bashkëtingëllores /ç/ dhe të digrameve, nuk përkon me rendin standart të parashikuar nga kompjuteri për alfabetet me bazë latine, kemi përgatitur një *macro* të posaçme. Veç kësaj, nyjat e përparme dhe pjesëzat që paraprijnë disa forma, si fjala vjen mbiemrat e nyjshëm, emrat asnjanës ose paskajoret gege (*me punuem, me thanë*), janë regjistruar në kllapa pas fjalës përkatëse. Në këtë mënyrë këto elemente nuk ndërhyjnë në renditjen alfabetike që bëhet mbi temën morfologjike. Pas konvertimit të fjalorit në një program përpunimi tekstesh, këto nyja dhe pjesëza rivendosen manualisht në vendin e tyre në ballë të fjalës. Ky operacion nuk kryhet mbi pjesën e dytë, pra mbi fjalorin e përmbysur shqip – italisht, sepse kështu do të prishej renditja alfabetike.

Njësitë leksikore shqipe që në fjalor përsëriten më se një herë, në pjesën e përmbysur shfaqen vetëm një herë, duke ruajtur gjithsesi përkrah referimin me të gjitha gjegjëset italisht nën të cilat janë regjistruar.

*

* *

Në përgatitjen e tekstit për botimin kritik jemi përpjekur të ndjekim hullinë e traditës më të mirë filologjike shqipe që e zë fillin me Çabejn, vijon me studiues si Demiraj, R. Ismajli, Fadil Sulejmani, për t'u konsoliduar e arritur fazën e pjekurisë shkencore gjatë këtij dhjetëvjeçari të fundit me botimet e albanologëve të mirënjohur

arbëreshë Francesco Altimari e Matteo Mandalà apo me botimet e fundit të studiuesve shqiptarë Bardhyl Demiraj e Anila Omari[13].

Botimi kritik që po përgatitim e që shpresojmë të dalë së shpejti, përbëhet nga dy pjesë.

Pjesa e parë paraqet tekstin në dy forma: në faqen majtas, në vend të një botimi diplomatik klasik, kemi vënë riprodhimin fototipik të dorëshkrimit origjinal. Kjo zgjedhje është përcaktuar, së pari, nga gjendja fizike relativisht e mirë e dorëshkrimit dhe, së dyti, nga teknologjia moderne, që ka bërë të mundur riprodhimin digjital të tekstit origjinal pa cenuar aspak lexueshmërinë e tij. Përballë kopjes së origjinalit, djathtas, vijon teksti i transkriptuar, me aparatin kritik në fund të faqes.

Pjesa e dytë përmban fjalorin "e përmbysur" shqip – italisht, pra fjalësin shqip të renditur alfabetikisht me gjegjëset italisht përkrah dhe me numrat përkatës që u referohen zërave të fjalorit origjinal.

Teksti italisht është riprodhuar besnikërisht. Ndërhyrjet këtu kufizohen vetëm në plotësimin e disa formave të shkurtuara: □abbandonatam^{te}□ (4v) [abbandonatamente]; □domandare lim^{a}□ (5v) [domandare limosina]; □acconsentim□ (6v) [acconsentimento]; □al tempo n'ro□ (13v) [al tempo nostro]; □canna dell'archibug^{o}□ (18v) [canna dell'archibuggio]. Këto ndërhyrje pasqyrohen rregullisht në aparatin kritik.

[13] Për sa i përket teorisë dhe praktikës së botimit kritik të teksteve shqipe, përveç botimit të "Mesharit" të Buzukut prej Çabejt, mund të themi se kanë bërë shkollë këto vepra: *N. Frashëri, "Bagëti' e Bujqësia" (I pascoli e i campi)* Introduzione, edizione critica, traduzione italiana e concordanza, a cura di Francesco Altimari, Rende 1994; *Girolamo De Rada, I Canti Premilosaici,* edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari, Rubbettino Editore, 1998*; Nicolò Figlia, Il Codice Chieutino,* edizione critica e concordanza a cura di Matteo Mandalà, Comune di Mezzojuso, 1995; *Giuseppe Schirò, Opere* (9 vëllime)*,* a cura di M. Mandalà, Rubbettino Editore, 1997; *Luca Matranga, E mbsuame e krështerë,* Edizione critica dei testi manoscritti e a stampa (1592), a cura di Matteo Mandalà, Salvatore Sciscia Editore, 2004; *Nicolò Chetta, Testi letterari in albanese,* edizione critica a cura di Matteo Mandalà, Salvatore Sciascia Editore, Caltanisetta, 2004; Pjetër Bogdani, *Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve),* botim kritik me studim hyrës, faksimile të origjinalit, transkriptim e shënime, përgatitur nga Anila Omari, Tiranë, 2005; Bardhyl Demiraj, *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij,* Prishtinë, 2006.

Për të mos u zgjatur këtu në kriteret e transkriptimit dhe të përgatitjes së tekstit kritik, mjafton të themi se tekstin shqip e kemi transkriptuar prej dorëshkrimit autograf në alfabetin e shqipes së sotme, duke u përpjekur të ruajmë sa më mirë tiparet strukturore dhe t'i afrohemi sa më shumë gjuhës dhe shqiptimit të autorit për të nderuar kësisoj vullnetin e tij.

Së fundi, do thënë se botimi kritik i këtij fjalori është pjesë e një projekti të hartuar dhe drejtuar nga prof. Matteo Mandalà në katedrën albanologjike të Universitetit të Palermos, projekt që parashikon, veç të tjerash, botimin kritik të të gjitha veprave leksikografike të mbetura në dorëshkrim ndër arbëreshët e Sicilisë, siç janë, sa për të përmendur ato më të rëndësishmet, *Fjalori italisht-Shqip* dhe *Fjalori etimologjik,* hartuar nga Nikollë Keta, variantet e ndryshme në dorëshkrim me fjalorë *Italisht-Shqip* e *Shqip-Italisht* të familjes Dara etj[14]. Pas botimit, kjo lëndë leksikore do t'i nënshtrohet një përpunimi të mëtejmë informatik dhe leksikografik në kuadër të Projektit BETA, hartuar e drejtuar nga Prof. Altimari[15], që sikundër është bërë e ditur, synon hartimin e një fjalori të madh të leksikut të arbërishtes së dëshmuar historikisht nga tradita shkrimore.

Bibliografi:

Altimari, Francesco: *Ndihmesa e disa drejtimeve të reja metodologjike për përtëritjen e albanologjisë bashkëkohore: Leksikografia Tekstuale e Kompjuterizuar*, në "Le prospettive dell'albanologia: il contributo degli Albanesi di Sicilia e di Calabria", Atti del XX Congresso Internazionale di Studi Albanesi (a cura di Antonino Guzzetta), Albanica 11, Palermo, 1996.

Da Lecce, Francesco: *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese* del P. Francesco Maria Da Lecce. Min. Oss. Rif., Esprefetto Apostolico delle Missioni di Macedonia, In Roma, nella stamperia della Sag. Cong. di Prop. Fede 1716.

[14] Për një panoramë të plotë të kësaj pasurie leksikografike shih Matteo Mandalà, *Gjurmimet leksikografike në mjedisin arbëresh të Sicilisë,* në "Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë", (Konferencë shkencore, Tiranë, 3 dhjetor 2004), Tiranë, 2005.

[15] Shih Francesco Altimari, *Ndihmesa e disa drejtimeve të reja metodologjike për përtëritjen e albanologjisë bashkëkohore: Leksikografia Tekstuale e Kompjuterizuar*, në "Le prospettive dell'albanologia: il contributo degli Albanesi di Sicilia e di Calabria", Atti del XX Congresso Internazionale di Studi Albanesi (a cura di Antonino Guzzetta), Albanica 11, Palermo, 1996.

Geci, Pashko: *Frang Bardhi dhe "Fjalori" i tij latinisht-shqip*, në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe" vëll. II, Tiranë, 1972.

Ismajli, Rexhep: *Gramatika e parë e gjuhës shqipe, botim kritik, me studim e transkriptim,* Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 12-14.

- Gjuha shqipe e "Kuvendit të Arbënit". Studime mbi grafinë, fonetikën, fonologjinë dhe tekstin e Kuvendit, Rilindja, Prishtinë, 1985.

Mandalà, Matteo: *Il "Dittionario" di F. M. da Lecce e i turchismi nell'albanese (secoli XVII-XVIII)",* në Albanica 10, Quaderni dell'Istituto di Lingua e Letteratura Albanese, Palermo, 1995.

- L'opera inedita di Francesco Maria da Lecce: *il Dittionario Italiano – Albanese (1702),* në Quaderni del Dipartimento di Linguistica, nr. 14, Cosenza, 1997.

- Gjurmimet leksikografike në mjedisin arbëresh të Sicilisë, në "Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë", (Konferencë shkencore, Tiranë, 3 dhjetor 2004), Tiranë, 2005.

Raccolte librarie degli Albanesi di Sicilia, Palermo, 1998.

Roques, Mario: *Recherches sur les anciens textes albanais, avec huit fac-similés,* Paris Librarie Orientalist Paul Geuthner, 13, Rue, Jacob, VI^{e} MCMXXXII.

Petrotta, Gaetano: *Popolo, lingua e letteratura albanese,* a cura di Matteo Mandalà, A. C. Mirror, Palermo, 2003.

Schirò, Giuseppe: *Della lingua albanese e della sua letteratura, anche in rapporto alle colonie albanesi d'Italia*, në Annuario dell'Istituto Orientale di Napoli, 1918.

Marko SNOJ

ORIGJINA E EMRIT TË VENDIT *PRISHTINË*

Meqë jam, para së gjithash, sllavist dhe komparativist indoevropianist, punimi im do ta prekë shqipen vetëm pjesërisht. Megjithatë, besoj se kjo temë – etimologjia e emrit të kryeqytetit të Kosovës – do të jetë me interes jo vetëm për sllavistët, por edhe për publikun shqiptar.

Përpjekja më e qëndrueshme e publikuar deri tashti lidhur me këtë temë, është paraqitur nga linguisti beogradas Aleksandar Loma, i cili, fillimisht, e supozon toponimin latin **Prisciana* (e shkruar Τρισκίανα nga Procopiusi),[1] prej nga rrjedh **Priştîna* në proto-rumanishte. Forma serbe *Prîština* dhe ajo shqipe *Prishtínë* konsiderohen huazime nga proto-rumanishtja. Kohët e fundit, Loma i është kthyer sërish këtij problemi,[2] pjesërisht pas sqarimit të vjetër etimologjik që është njohur qysh nga viti 1951, kur Maretiqi[3] e pati lidhur toponimin në serbishte me foljen sllave **pryščiti* që do të thotë "të burojë, të dalë (nga uji)" e që është ruajtur në çekishte *prýštiti*, p. sh. në trajtë të pacaktuar *prýskati* dhe *pryskać* të polonishtes. Duke u mbështetur në Maretiqin, Loma e nxjerr toponimin *Prîština* nga apelativi **pryščina* që është ruajtur në moravishten e Çekisë si *prýščina* "burim (uji), pjesë e fushës e vërshuar nga uji". Megjithatë, ai nuk ka hequr dorë plotësisht nga sqarimi i tij i mëhershëm, duke e pasur parasysh se etimoni i vërtetë megjithatë mund të jetë **Prisciana* e latinishtes dhe se fjala slave **pryščina* mund të jetë veçse rimotivim i emrit të lashtë. Sa i përket emrit të lumit *Prištêvka*, ai përmend emrin e lumit të Zlatiborit *Prištevica* dhe e supozon sllavizimin e mëtutjeshëm të këtij etimoni, ashtu që ky emër qenka e mundur të jetë ndikuar nga apelativi i *prišteva trava* që ka kuptimin "Paris Quadrifolia". Gjatë një komunikimi personal gjatë verës së kaluar, profesor Loma thoshte se zgjidhja përfundimtare e toponimit nuk është gjetur ende, kështu që unë e konsideroj të drejtë ta paraqes edhe

[1] Loma, Balkansko ezikoznanie XXXVI/3 (1993), f. 235.
[2] Loma, Onomatološki prilozi XIII (1997), ff. 3–4.
[3] Rječnik hrvatskoga ili srpskoga jezika XII, f. 189.

një përpjekje që do të sillte edhe më shumë informacione rreth këtij studimi.

Së pari të nxjerrim në pah se përse përpjekjet e lartpërmendura nuk duken të jenë të sakta. Argumenti i parë mbështetet në aksentologji. Po të ishte emri serb me origjinë proto-rumune, në dialektin organik të serbishtes së Kosovës do të pritej forma ***Prišt□na* e jo *Prîština* që është forma e vetme e hasur. I njëjti rezultat del edhe nëse e nxjerrim emrin nga apelativi i sllavishtes **pryščin□* (bile edhe më pak i mundshëm është **pryšč□na*), që është ruajtur në moravishten e Çekisë. Pjesa më e madhe e më se njëqind zërave që përfundojnë me *-ina*, të regjistruara nga Elezoviq[4] e kanë theksin në sufiks, p. sh. *druž□na*, *sil□na*. Ndonjëherë, kjo rrjedh nga tipi a i theksit të sllavishtes, në dialektin e shtokavishtes lokale akuti i vjetër është ruajtur si në *st□rina* tok me *star□na* më të re. Siç duket, vendi i theksit në sufiks ka mbizotëruar në të shumtën e rasteve. Theksimi me theks lakor në rrokjen e parë është ruajtur – sipas Elezoviqit – vetëm në gjashtë raste, prej të cilave katër janë toponime: *B□jčina*, *Klînčina*, *P□ntina*, *Sk□čina*, ndërsa dy janë apelativë: *p□dina*, *j□ovina*. Te *B□jčina* e te *Klînčina* mund ta vërejmë refleksin e akutit të vjetër të zgjatur, mbështetur në **b□jьcь* "magjistar" (e ruajtur te mbiemrat *Bajec* të sllovenishtes dhe *Bajac* të kroatishtes), kurse te rastet e tjera duket se theksi lakor rrjedh nga theksi neoakut i sllavishtes së fjalëve bazike siç janë përkatësisht **p□dъ*, **sk□kъ*. Vendi i theksit në *Prishtínë* të shqipes, mund të jetë më arkaik, por nuk ndihmon shumë, meqë të gjitha huazimet e shqipes që mbarojnë me *-ina*, e kanë theksin në sufiks, ndonëse theksi original ka qenë në rrokjen e rrënjës, siç është rasti me toponimin serb *Sl□tina* (kuptimi i parë i të cilit është "burim i ujit mineral") që është përshtatur në gjuhën shqipe si *Sllatínë*. Nga këndvështrimi aksentologjik mund të përfundohet se emri i vendit *Prîština* në serbishte rrjedh nga një rrënjë (emër a apelativ) e proto-shtokavishtes bazike **P/príšć-*, në proto-sllavishten **príš/š(ь/ъ)čь*, **príš/š(ь/ъ)t'ь*, **prýš/š(ъ/ь)čь*, ose **prýš/š(ь/ъ)t'ь* të tipit b të theksit.

Argumenti i dytë kundër sqarimeve të mëparshme është edhe fakti, se emri i vendit *Prîština* dhe çerdhja e saj e fjalëve nuk është

[4] Elezović, Rečnik kosovsko-metohijskog dialekta I–II.

konsoliduar ende në dialektin organik të shtokavishtes.[5] Mbiemri *prištêvski,* emri i banorit *Prištêvac*, si edhe emri i lumit *Prištêvka*, nuk janë formuar nga emri i vendit, por nga baza e tij që mund të rindërtohet, siç është paraqitur në fund të paragrafit paraprak. Që toponimi të mos jetë konsoliduar me pjesëtarët e tjerë të çerdhes, nuk është situatë e shpeshtë, por, megjithatë, ekziston te disa gjuhë sllave. Në Slloveni ekzistojnë disa emra vendesh siç janë: *Gámeljne* < **Gámljine* < shumësi **G□ml'inę* bashkë me mbiemrin *gámeljski* < **g□ml'ьskъjь*; dhe *Skarúčna* < **Skorúčina* < **Skorűt'ina* bashkë me mbiemrin *skarúški* < **skorúčski* < **skorűt'ьskъjь*.[6] Duket sheshazi se në të dyja rastet e përmendura, bazë e tyre është një mbiemër posesiv, përkatësisht **G□ml'ь* dhe **Skorűt'ь*, i formuar nga emrat personalë sllavë **G□mъ* dhe **Skorűtъ*. Të dy toponimet etimologjikisht janë shpjeguar si "vendi ose prona e Gamit" dhe "vendi ose prona e Skorutit". Një rast të ngjashëm e gjejmë te emri i vendit *Ájdovščina* tok me mbiemrin *ájdovski* – vend ky ku janë gjetur plot gërmime të lashta nga kohërat romake. Në sllovenishten, *ájd* do të thotë "pagan",[7] kurse *ájdov* (posesivi) dhe *ájdovski* janë mbiemra. Së këndejmi, **ajdov(sk)a vas* do të thotë "fshati ku kanë jetuar paganët", kurse *Ájdovščina* del me univerbizim**.** Mbiemri *ájdovski* që shpreh objektet e toponimit e ruan formën pa sufiksin *-ina*, kurse emri i banorit *Ájdovec* është formuar nga mbiemri i parmë posesiv *ájdov*.

E njëjta vlen edhe për toponimin e diskutuar të serbishtes *Prîština* me mbiemrin *prištêvski* dhe me emrin e banorit *Prištêvac*, *-vka*. Nga materiali i sllovenishtes mund të përfundohet se sufiksi *-ina* është shtuar gjatë procesit morfologjik të formimit të emrit – dhe jo si apelativ. Ky dallim, në dukje i vogël, ka rëndësi vendimtare për analizë të saktë dhe sistematike etimologjike. Prandaj, ekuacioni i propozuar i toponimit *Prîština* me apelativini e moravishtes së Çekisë

[5] Mbiemri mori formë të prerë në serbishten standarde në favor të emrit të vendit si *prîštinski*.

[6] Ka më shumë, natyrisht, familje të konsoliduara se sa të pakonsoliduara, p. sh. në Slloveni *Dobrína* (nga emri vetjak **Dobrъ/jь/)* bashkë me mbiemrin *dobrínski*, apo në Bosnjë *Bijêljina* (nga mbiemri posesiv i emrit përkdhelës **Bělъjь* > *Bijêlī)* bashkë me mbiemrin *Bijêljinskī*.

[7] Fjala *ájd* është huazuar nga gjermanishtja *Heide*, në gjermanishten e mesme të lartë *heiden,* vetë huazim nga greqishtja, nëpërmjet të gotishtes, (τ□) έ□νη "njerëzit", në Dhjatën e Re "paganët".

prýščina ndonëse duket i barazuar, nuk mund të jetë i saktë. Meqë procesi i fjalëformimit shfaq tipare tipike të sllavishtes,[8] hipoteza e origjinës latine, duhet të hidhet poshtë kufijve të kredibilitetit. Shembujt e sipërpërmendur të sllovenishtes, tregojnë qartazi se emrat e vendeve me tipare gjuhësore, siç janë *Gámeljne*, *Skarúčna* dhe *Ájdovščina* janë burim i mbiemrave posesivë nga emrat personalë ose apelativë që e shënojnë një person; në të dy rastet e kemi kuptimin primar strukturor të emrave të tillë si "vend i banuar nga një person ose grup personazh të shprehur në rrënjë të emrit". Baza e toponimit të serbishtes *Prîština* mund të shihet vetëm si mbiemër posesiv i proto-shtokavishtes **P/príšt-* < **P/príšč-* ose **P/príšć-*, i formuar nga emri personal **Pris/š(a)k/c* ose **Pris/š(a)t/c* apo edhe (që është më pak e mundur) nga apelativët përkatësisht **pris/š(a)k/c* ose **pris/š(a)t/c*, që të gjithë këta me një kuptim dhe origjinë të paqartë. Indikator që mund të shkojë në favor të supozimit për emrin personal **Prisk* ose **Prist*, mund të jetë mbiemri i rrallë kroat *Prišć*, i cili mund të shpjegohet si posesiv.

Nga ana teknike, shpjegimi i mësipërm etimologjik në serbishte i emrit të vendit *Prîština,* prej nga është marrë në shqipen *Prishtínë*, i përmbush të gjithë kushtet. Forma është tipike sllave dhe kuptimi i saj primar në proto-shtokavishten është vënë si "vendi i banuar nga **Pris/š(a)k/c* ose **Pris/š(a)t/c* apo (që është më pak e mundur) **pris/š(a)k/c* or **pris/š(a)t/c*". Shpjegimi etimologjik i morfemës së rrënjës do të ishte i mirseardhur, por është i rrezikshëm. Mund të lidhet edhe me mbiemrin latin *Prīscus*,[9] siç ka supozuar Loma për emrin e vendit **Prisciana*, por kjo nuk është mundësia e vetme. Morfema e rrënjës mund të ketë buruar edhe nga ndonjë emër personi sllav që nis me *pri-*, po e zëmë nga **Pribislavъ* i shkurtuar, siç është në polonishte mbiemri *Przysz*,[10] mbiemrat vendë *Pribš*, *Priš*, *Pśibš*[11]

[8] Një fakt tjetër me rëndësi në favor të prejardhjes së propozuar sllave është se emri i vendit *Priština* haset edhe në një lokalitet tjetër në Ballkan, afër Banjallukës, në Bosnjë, ndonëse unë nuk kam mundur të gjej informacion të detajuar gjeografik dhe gjuhësor për të, gjë që do të ishte e domosdoshme për një shpjegim etimologjik të tij.

[9] Tekstualisht "i vjetër", nga mbiemri *prīscus* "i vjetër, që i përket kohërave të vjetra".

[10] Shpjegimi i mbiemrit polak sipas Rymut, Nazwiska Polaków, f. 224.

[11] Wenzel, Studien zu sorbischen Personennamen II/2, ff. 69, 72.

duke ua shtuar sufiksin *-kъ*, si te mbiemrat polakë *Przyszek* (emra të vjetër njeriu polak *Przyszek*,[12] *Przyszka*, *Przyszkowic*),[13] që mund të gjenden edhe në toponimin rus *Priskovotaja Mogila*[14] dhe ndoshta në toponimin *Pryskovo* afër Tverit.[15] Një mundësi tjetër është të supozojmë nga emri personal sllav **Pristъ* që e ka dhënë mbiemrin patronimik *Pristov*, të gjetur në shumë gjuhë sllave,[16] si dhe në toponimin rus *Pristovja*[17] e ndoshta edhe në toponimet ruse *Pristoj*, *Prisno*, polak *Pristoje*.[18]

[12] Regjistruar nga Słownik staropolskich nazw osobowych IV, f. 386.
[13] Rymut, Nazwiska Polaków, p. 224.
[14] Regjistruar nga Russisches geographisches Namenbuch VII, f. 385.
[15] Regjistruar nga Russisches geographisches Namenbuch VII, f. 426.
[16] P. sh.: mbiemrat sllovenë *Pristov*, *Pristav*, mbiemri rus *Pristov*, emri personal i polonishtes së vjetër *Przystaw* (listed by Słownik staropolskich nazw osobowych IV, f. 386).
[17] Regjistruar nga Russisches geographisches Namenbuch VII, f. 389.
[18] Regjistruar nga Russisches geographisches Namenbuch VII, ff. 389, 387.

Elton PRIFTI

QËMTIME MBI ANGLOAMERIKANIZMAT RIEMIGRUES TË GJUHËS SHQIPE NËN PRIZMIN E KONTAKTIT GJUHËSOR MIDIS SAJ DHE ANGLISHTES

1. Vërejtje teorike mbi makrokontaktin gjuhësor midis shqipes dhe anglishtes

Çështja e anglicizmave në gjuhën shqipe, një aspekt me rëndësi për historinë e saj, ka qenë deri më sot objekt studimi vetëm në mënyrë sporadike[1]. Për çdo analizë të këtij fenomeni, sado sipërfaqësore qoftë, duhet të merret parasysh prania e një sëre dinamikash specifike, të cilat karakterizojnë makrokontaktin gjuhësor midis shqipes dhe anglishtes[2].

Për një hulumtim me karakter sinkronik është thelbësore t'i kushtohet vëmendje edhe diferencimit makrodiatopik, në kuadrin e të cilit ndryshimi i tipit diatopik të mirëfilltë i nënrendohet procesit të standardizimit. Nga njëra anë është e nevojshme të mbahet parasysh ndryshimi i qartë midis shqipes së nuklit ballkanik të tipit *continuum* dhe asaj jashtë tij. Ndërsa brenda vetë *continuum*-it gjuhësor në fjalë duhet bërë dallim[3] së paku midis varieteteve makrodiatopike të shqipes në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni, jashtë tij, ndër varietetet e të njëjtit lloj përfshihen para së gjithash arbërishtja dhe arvanitishtja. Nga ana tjetër, në rastin e anglishtes, duhet marrë parasysh dallimi që bëhet së paku midis varietetit makrodiatopik britanik, atij amerikanoverior[4] apo australian. Pra, brenda *corpus*-it të

---

[1] Le të përmenden KÖDDERITZSCH/ GÖRLACH 2002 dhe PRIFTI 2007a, f. 1-3, ku bëhet një përshkrim më i hollësishëm kritik i botimeve mbi këtë tematikë në përgjithësi dhe mbi aspekte të veçanta të saj në veçanti.

[2] Shih në veçanti PRIFTI 2007a.

[3] Mbi këtë diferencim shih PRIFTI 2005. Përpos kësaj, divergjencat - gjithnjë e më të vogla - midis makrovarieteteve në fjalë mund të vërtetohen edhe me anë të rezultateve të analizës së diferencuar sistematike të anglicizmave në gjuhën shqipe, të kryer në këtë formë në PRIFTI 2007a, me sa duket për herë të parë.

[4] Qysh në vitin 1789 Noah WEBSTER tërheq vëmendjen mbi evoluimin divergjent të anglishtes në ishujt britanikë dhe asaj në Amerikën Veriore: "*The English with*

anglicizmave të shqipes teorikisht është i mundshëm së paku dallimi midis britanizmave, angloamerikanizmave dhe angloaustralianizmave. Në këtë mënyrë, së paku teorikisht, çdo anglicizëm i gjuhës shqipe mbart tipare (makro)diatopike të dyfishta. Zgjerimi i fokusit të hulumtimit nga rrafshi sinkronik në atë diakronik sjell shumëfishimin e aspekteve që duhen marrë parasysh gjatë analizës, aq më tepër nëse në të integrohen dhe diferencimi diastratik e ai diafazik, i cili praktikisht përfshin dhe diferencimin diamedial. Është e nevojshme të theksohet se anglicizmat e gjuhës shqipe duhen trajtuar si një tërësi e rezultateve të përbërëseve të makrokontaktit gjuhësor midis shqipes dhe anglishtes.

2. Mbi kontaktin gjuhësor midis shqipes dhe angloamerikanishtes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Një prej përbërëseve të rëndësishme të makrokontaktit në fjalë është kontakti gjuhësor midis shqipes, apo më saktë i varieteteve të saj diatopike, dhe anglishtes së ShBA-së. Brenda kornizave të tij duhet bërë dallim midis ndikimit adstratik kulturor[5] të angloamerikanishtes mbi shqipen nga njëra anë, dhe kontaktit të drejtpërdrejtë gjuhësor vertikal[6] dhe konvergjent[7] midis shqipes dhe anglishtes amerikanoveriore, nga ana tjetër, i cili zhvillohet në kuadrin e emigrimit të shqiptarëve në ShBA. Me këtë kontakt lidhet në mënyrë

others is suffering continual alterations. America, placed at a distance from those nations, will feel, in a much less degree, the influence of the assimilating causes; at the time, numerous local causes (…) will introduce new words into the American tongue. These causes will produce, in a course of time, a language in North America, as different from the future language of England, as the modern Dutch, Danish, and Swedish are from the German, or from one another.", shih WEBSTER 1789, f. 22, cituar nga KACHRU 1981, f. 24.

[5] Në lidhje me konceptin e adstratit kulturor shih TAGLIAVINI 1972[6], f. 268 ose BUßMANN 1990, f. 49.

[6] Kontakti është vertikal, sepse gjuhët skajore të tij, pra të ashtuquajturat *low* dhe *high variety* karakterizohen nga ndryshime prestigji. Në lidhje me konceptin 'kontakt gjuhësor vertikal' shih STEHL 1990, f. 175.

[7] Kontakti është konvergjent, pra, parë në rrafshin diakronik e folmja shqipe e emigrantëve shqipfolës në ShBA i nënshtrohet tërësisht procesit të shndërrimit gjuhësor konvergjent me angloamerikanishten. Në lidhje me dikotominë 'shndërrim gjuhësor divergjent' vs. 'shndërrim gjuhësor konvergjent' shih në veçanti LÜDTKE 1980b, f. 250-252.

të drejtpërdrejtë dhe çështja e angloamerikanizmave riemigrues të shqipes.

Pra, angloamerikanizma riemigrues në gjuhën shqipe janë ata elementë gjuhësorë, të cilët, si pjesë e pasojave të kontaktit vertikal dhe konvergjent midis shqipes dhe angloamerikanishtes në ShBA ʻriemigrojnëʼ për arsye të ndryshme nga ligjërata e emigrantëve kthimtarë në të folmet shqipe të origjinës, në hapësira të kufizuara gjeolinguistike, ku dhe stabilizohen e, në disa raste, edhe përhapen më gjerë.[8]

Në analizën në vijim, që përvijohet kryesisht nën prizmin teorik-metodologjik të gjuhësisë kontaktuale e variacionale, është e nevojshme të bëhen disa dallime dhe kufizime. Kështu, të vetëdijshëm për përmasat e dukurisë në fjalë, përveç rolit ndikues të faktorëve jashtëgjuhësorë, si dhe të disa rrethanave subjektive, vëmendja do të përqendrohet vetëm mbi varietetin makrodiatopik të shqipes së Shqipërisë në përgjithësi, dhe mbi varietetin diatopik të zonës juglindore të Shqipërisë, të zonës së Korçës në veçanti.

Punimet shkencore mbi emigrimin e shqipfolësve në ShBA janë tejet të pakta dhe sporadike, aq më tepër nëse bëhet fjalë për studime në fushën e gjuhësisë, në të cilën, duke u përqendruar mbi varietetet makrodiatopike shqipe të *continuum*-it ballkanik, pra duke lënë

[8] Del nevoja e një saktësimi teorik. U përmendën më lart konceptet e diferencimit diatopik dhe diastratik, të cilët u formuluan fillimisht nga romanisti norvegjez Leiv FLYDAL (shih FLYDAL 1951, COSERIU 1980, f. 50) dhe u ripërpunuan më vonë nga ky i fundit (shih COSERIU 1958, f. 81), i cili skicoi dhe konceptin e diferencimit diafazik, duke e emërtuar fillimisht ʻ*diaphatisch*ʼ (shih COSERIU 1980, f. 50). Në vijim, autorë të ndryshëm kanë skicuar teorikisht dhe përdorur dhe lloje të tjera diferencimesh, si p.sh. diferencimi diamedial, diabrezor apo diagjinor. Nëse analizohen me kujdes tiparet bazë të këtyre të fundit, së paku teorikisht është e mundur dhe e mjaftueshme që ata të trajtohen brenda kornizave të diferencimit diafazik, pra si regjistra stilistikë të veçantë. Por, për të bërë të mundur hulumtimin më objektiv dhe të saktë të kontakteve gjuhësore të kushtëzuar nga migrimi, del i nevojshëm piketimi i një lloji të ri diferencimi specifik, i diferencimit d i a f l u k t u a l, i cili në thelb bazohet mbi ndryshimet në kompetencën gjuhësore të folësve në momentin e migrimit sipas përkatësisë në flukset apo në segmentet e veçanta të këtij të fundit. Për ilustrim le të kihen parasysh ndryshimet konkrete në kompetencën gjuhësore të grupeve të shqipfolësve të emigruar në gadishullin apenin nga shekulli i XV deri në ditët tona, apo ai i emigrimit të italianëve në ShBA, e të tjerë.

mënjanë p.sh. arbërishten[9], njihet vetëm një seri prej katër punimesh e Vesel NUHIUT[10], ku analizohen disa aspekte të kontaktit gjuhësor midis shqipes dhe angloamerikanishtes. Ndërsa terreni i angloamerikanizmave riemigrues të shqipes ballkanike, me përjashtim të disa shënimeve[11], mbetet ende i pashkelur.

Fenomeni gjuhësor i angloamerikanizmave riemigrues i ka rrënjët në dukurinë e emigrimit të shqiptarëve në ShBA, i cili zë fill në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Për arsye nga më të ndryshmet është ende vështirë të përcaktohet me saktësi fillimi i këtij fenomeni. Pas të gjitha gjasave emigrantët e parë shqiptarë në ShBA duhet të kenë qenë nga zona e Korçës.[12] Pavarësisht luhatjeve emigrimi i shqiptarëve në ShBA vazhdoi deri nga fundi i viteve '30. Duke filluar pak a shumë nga viti 1950, deri në vitin 1990 emigrimi i shqipfolësve nga Shqipëria pësoi një ndërprerje të plotë, ndërsa largimi i shqiptarëve të Ish-Jugosllavisë drejt ShBA-së vazhdoi, ndonëse me modalitete dhe dinamika specifike. Duke filluar nga viti 1990 dukuria e emigrimit të shqiptarëve, edhe drejt ShBA-së, po përjeton një rritje masive.

Domosdoshmëria e integrimit gjuhësor të enklavave të krijuara nga emigrantët shqipfolës në ambientin e ri rrethues aloglot solli si pasojë ngjizjen e menjëhershme të kontaktit gjuhësor midis shqipes

[9] Një përshkrim përmbledhës i studimeve gjuhësore mbi aspekte të ndryshme të së folmes së arbëreshëve në ShBA gjendet në PRIFTI 2007b, f. 273-275.

[10] Shih NUHIU 1995, 1997, 1998a dhe 1998b.

[11] Shih PRIFTI 2007a, f. 9-14.

[12] Bazuar mbi të dhëna gojore Frances TRIX-i (shih TRIX 2001, f. 7) pohon se emigranti i parë shqiptar në ShBA mbante mbiemrin PEPPO dhe mbërriti atje, fillimisht në New York, në vitin 1890. Ndërsa sipas hulumtimeve të *Frosina Information Network* (shih www.frosina.org) është 1886-a viti i fillimit të emigrimit të shqiptarëve në ShBA, dhe Koli KRISTOFER emri i emigrantit të parë, mbiquajtur dhe *Colombus*-i i komunitetit shqiptar të Miçiganit, i cili zuri vend në Boston, ku dhe më pas u vesh prift ortodoks. Kjo e dhënë duket se vërtetohet dhe nga një këngë popullore e fundshekullit e fshatit Katund (zona e Vithkuqit) të rrethit të Korçës: "*Ç'u hap një kurbet-o, një kurbet i ri/ zjarri moj Ameriqi!/ Sebep ç'na u bë Kolë Sotiri/ nuk na mbenë djemë, k'tu në Shqipëri/ zjarri moj Ameriqi!/ na shkuan të tërë, në kurbet të ri/ zjarri moj Ameriqi!/ seç na mbetën nënat, me duart në gji/ zjarri moj Ameriqi!/mbetën grat' e gjora, pa shpres', pa fëmi/ zjarri moj Ameriqi!*" (shih PANAJOTI 1982, kënga nr. 639, f. 571). Përpos këtyre dëshmive mund të shtohet se në *Radhuan e emëravet ndihmëtarë* të botimit të parë të librit *Korça dhe pshatrat për qark* të Nuçi NAÇIT përmendet dhe një shqiptaroamerikan i quajtur N.S. Hristo KATUNDI (shih NAÇI 1901, f. 61).

dhe angloamerikanishtes, tipologjia e të cilit u përshkrua më lart. Gjatë përshkrimit të gjuhëve skajore të këtij kontakti nën prizmin diakronik dhe në kuadër të diferencimit diafluktual, të përkufizuar më sipër, duhet saktësuar se në varësi të momentit të emigrimit (d.m.th. për periudhën deri në fillimin e viteve '40, mbi të cilin dhe përqëndrohet kryesisht vëmendja në këtë shkrim) gjuha e skajit të poshtëm të kontaktit, pra e ashtuquajtura *low variety* paraqitet nga dialekti dhe jo nga shqipja standard, që asokohe gjendej ende në fazë të hershme kristalizimi real. Edhe në rastin e të ashtuquajturës *high variety*, pra të gjuhës së skajit të sipërm të kontaktit, d.m.th. të angloamerikanishtes, duhet pasur parasysh një diferencim i brendshëm, i cili bazohet kryesisht mbi diferencimin diastratik dhe më pak mbi atë diatopik. Është për t'u theksuar se kjo dinamikë ndryshon për valën masive emigruese të 15 viteve të fundit.

Pasojat e këtij kontakti janë interferencat gjuhësore në të gjithë spektrin e rrafsheve gramatikore dhe për çdo gjuhë funksionale[13] të tij, bashkësia e të cilave përbën dhe të ashtuquajturën 'zonë interlektale'. Nëse shqyrtojmë[14] nën prizmin e interferencave gjuhësore në mënyrë të veçantë njërën prej tyre, pikërisht varietetin 'Shqipe me ndikime (të kufizuara) angloamerikane', mund të vihet re lehtësisht një sasi e konsiderueshme të tillash, kryesisht leksikore. Le të përmenden disa prej tyre: *stapoj* < *to stop* 'ndaloj', *sëmërkot*-i < *summer coat* 'pardesy', *brik/ë-a* < *brick* 'tullë' *rentë-a* < *rent* 'qira', ose, interferenca të regjistruara para pak kohësh ndër shqiptaroamerikanë të emigruar në këto 15 vitet e fundit: *supervajzë-a* < *supervisor* 'kontrollues i përgjithshëm', *benefite* (vetëm shumës) < *benefits* 'shpërblime', *bazament/ besment-i* < *basament* 'qilar', *vë pará poshtë* < *to put money down* 'parapaguaj (në bankë)', e shumë të tjera.

Duhet patur parasysh dhe fakti që këto interferenca, fillimisht sporadike, normëzohen së pari brenda kornizave të së folmes së individit apo të (mini)enklavës në të cilën ai bën pjesë, për t'u përhapur më pas gradualisht në shkallë më të gjerë në komunitetin shqiptaroamerikan, duke arritur kështu në një farë mënyre një shkallë standardizimi.

---

[13] Në lidhje me konceptin 'gjuhë funksionale' shih COSERIU 1988, f. 25-28.

[14] Analiza në fjalë bazohet mbi përshkrimin teorik-metodologjik të Th. STEHL-it. Shih në mënyrë të veçantë STEHL 1996.

Qysh nga momenti i shkëputjes gjuhësore të emigrantëve nga ambienti rrethues shqipfolës ballkanik zë fill procesi i pashmangshëm dhe normal i evoluimit divergjent të varieteteve. Është e arsyeshme që këta të konsiderohen nga këndvështrimi i historisë gjuhësore si dy degë të veçanta me lidhje të shumëfishta, të cilat zakonisht sa vijnë dhe dobësohen e rrallohen, sa më shumë kohë të kalojë. Në këtë mënyrë mbruhet gradualisht një identitet i ri, edhe gjuhësor, intensiteti i lidhjeve të të cilit me atë të origjinës përgjithësisht ndryshon sipas përkatësisë së individëve të veçantë në dinamikën gjeneracionale.

3. Mbi gjenezën dhe tiparet themelore të angloamerikanizmave riemigrues në gjuhën shqipe

Ende të panjohura mbeten praktikisht pasojat gjuhësore të dukurisë së kthimit të emigrantëve, tashmë mbartës të një identiteti të ri gjuhësor, të 'modifikuar', në ambientin gjuhësor të origjinës, i cili mund të ketë kohëzgjatje nga më të ndryshmet. Ndikimi gjuhësor i dyanshëm përbën padyshim një prej pasojave të drejtpërdrejta të kësaj dukurie. Ashtu si dhe emigrantët e (ri)kthyer i përshtatin kompetencën e tyre gjuhësore të 'modifikuar' ambientit 'të ri' gjuhësor rrethues, që zakonisht është ai i origjinës, po ashtu dhe ky i fundit përthith sporadikisht, nën ndikimin e disa faktorëve jashtëgjuhësorë kulturorë-shoqërorë, interferenca gjuhësore nga kompetenca teknike e individit, apo të një grupi individësh emigrantësh kthimtarë. Këto interferenca mund të përkufizohen si risi gjuhësore. Të tilla janë për gjuhën shqipe, apo për disa segmentë të caktuar të saj pikërisht dhe angloamerikanizmat riemigrues.

Le të analizohen në vijim disa shembuj[15] konkretë. Një rast domethënës për vetë dinamikën e tij paraqet *etymon*-i *sens-i* (pl. *sense*[16]) < *cents*, për të cilin, në bazë të dëshmive të shkruara, procesi i

[15] Në kuadrin e shembujve në vijim, atje ku ishte e nevojshme janë bërë verifikime në lidhje me gjallësinë dhe tiparet e sakta semantike të tyre, falë mbështetjes dhe dashamirësisë së një numri jo të vogël informatorësh, të cilët i falenderoj. U jam mirënjohës dhe albanologëve Bardhyl DEMIRAJ e Giovanni BELLUSCIO për vërejtjet e tyre.

[16] Forma e shumësit *cents* e matricës angloamerikane *cent* është marrë si formë njëjësi për ligjëratën shqiptaroamerikane, mbi bazën e së cilës dhe me mjetet morfologjike që vë në dispozicion shqipja ndërtohet më tej forma e shumësit. Në mënyrë analoge shpjegohet dhe prania e fonemës [s] (për shqipen) apo morfemës

normëzimit dhe i përhapjes në ligjëratën shqiptaroamerikane kishte përfunduar - siç do të shihet në vijim - pas të gjitha gjasave rreth gjysmës së parë të viteve ’20 të shekullit të shkuar. Më vonë, rreth viteve ’30 e hasim edhe në arealin gjuhësor ballkanik të shqipes, pikërisht në tekstin e një kënge[17] popullore të fshatit të Dishnicës (Korçë).

Pra, në një fazë të parë angloamerikanizmi në fjalë përbënte për shqipen e emigrantëve shqiptaroamerikanë një interferencë leksikore nga angloamerikanishtja, e cila më tej u stabilizua, u normëzua në ligjëratën shqiptaroamerikane. Në fakt, leksemën në fjalë e hasim që në numrat e parë të shtypit shqiptaroamerikan, madje në forma të ndryshme grafike[18], si p.sh. *sénz/é-a*[19], *senx/ë-a*[20] apo *senc/ë-a*[21], fakt ky që vërteton se procesi i normëzimit të këtij emërtimi ishte ende në zhvillim e sipër. Prej së folmes në fjalë, në një fazë të tretë leksema kaloi në arealin gjeolinguistik ballkanik, ku edhe jetoi për pothuajse një shekull. Në këtë mënyrë, së paku deri rreth dy dekada më parë, leksema *senx/ë-a* mbijetonte ende, si arkaizëm, në të folmen e fshatit të Dardhës (Korçë), me kuptimin ʻlekë të vogla, monedhaʼ, ndërsa sot rezulton vetëm sporadikisht e pranishme në dijen gjuhësore pasive vetëm të disa folësve autoktonë të brezit më të vjetër. Rreth 80 vjet më vonë, në rrethana të ngjashme dhe brenda kornizave të fazës aktuale të emigrimit të shqiptarëve në ShBA, në kuadrin e kontaktit të ri gjuhësor midis shqipes bashkëkohore (apo varieteteve të saj diatopike) dhe angloamerikanishtes, në ligjëratën e shqiptaroamerikanëve të kësaj faze të emigrimit, qysh në fillimet e tij është regjistruar interferenca leksikore *sent-i*, me aloformat *sens/ë-a*, *sens-i*, *cent-i*. Duke qenë se në dinamikën e ngjizjes së interferencës në fjalë mund të përjashtohet një mbijetesë e arkaizmit të sipërpërmendur nga faza e

---

<s> (për anglishten) tek format njëjëse të anglicizmave të tjera të shqipes, si p.sh. *kaubojs/i-ët*, *fans/i-ët* apo *skorpjons/i-ët*. Shih mbi këtë edhe PRIFTI 2007a, f. 10, shën. 37.

[17] “*Çupat e Amerikës, marifete kanë/ na morën më qafë djemtë shqiptarë/ nuk u lanë sense, sense as dollarë.* (…)”. Shih PANAJOTI 1982, kënga nr. 642, f. 573.

[18] Bëhet fjalë për realizime të ndryshme ortografike, në varësi të sistemeve të ndryshme alfabetike në përdorim asokohe, të leksemës shqiptaroamerikane ['sɛnts□].

[19] Shih gazetën javore *Kombi*, nr. 70 (17 janar 1908), f. 4.

[20] Shih gazetën javore *Dielli*, nr. 54 (8 prill 1910), f. 4.

[21] Shih gazetën javore *Dielli*, nr. 56 (22 prill 1910), f. 4.

parë e emigrimit, është me vend të flitet për një përsëritje të fenomenit, fakt ky që mund të shërbejë si provë dhe për vazhdimësinë e pranisë së faktorëve jashtëgjuhësorë vendimtarë për mbrujtjen dhe zhvillimin e kontaktit gjuhësor në fjalë. Aktualisht leksema rezulton e përhapur gjerësisht dhe e stabilizuar vetëm brenda caqeve të ligjëratës aktuale shqiptaroamerikane. Duke mbetur në të njëjtën sferë semantike vlen të theksohet se një zhvillim dhe dinamika të ngjashme shpërhapjeje ka pasur dhe fjala *çek-u*[22] < *check*.

Në sferën semantike të produkteve teknike hasen disa angloamerikanizma riemigrues, të cilët gëzojnë një shtrirje gjeolinguistike tejet të kufizuar. Kështu, emërtimi *stim/ë-a* ʻkalorifer, ngrohje me avull ose ujë të nxehtë, që ushqehet nga një central', ende aktiv në varietetin urban të Korçës, rrjedh pas të gjitha gjasave nga leksema shqiptaroamerikane homofone, e cila pasqyron anglicizmin *steam*. Është me interes të nënvizohet se edhe në ligjëratën italoamerikane është regjistruar në mënyrë paralele i njëjti zhvillim: po nga e njëjta matricë angloamerikane rrjedh dhe emërtimi italoamerikan homofon *'a stima*[23] ʻavull'. Po në dialektin urban të Korçës mbijeton dhe fjala *bashikëll/ bashikll/ë-a* < *bicycle*, edhe ky një angloamerikanizëm riemigrues, i cili, si pasojë e futjes – rreth viteve '30 – dhe përhapjes së italianizmit *biçikletë* pësoi gradualisht një modifikim semantik minimal nga njëra anë, duke marrë kuptimin specifik ʻbiçikletë e vjetër, e rëndë, që zakonisht përdoret nga fshatarët për transport', dhe nga ana tjetër duke u veshur në përdorim me një ngjyrim humoristik.

Rreth pesëmbëdhjetë vjet më parë në Dardhë (Korçë) gjente ende përdorim, ndonëse tejet rrallë e vetëm nga më të moshuarit, leksema *llajn/ë-a* < *light* ʻfener, një lloj llambe vajguri, në të cilën poçi që mbulon fitilin pajiset me një kapak special, që shmang shuarjen nga era'. Nga një verifikim i bërë para rreth një viti rezultoi se leksema në fjalë tashmë ishte vetëm në mënyrë të kufizuar pjesë e dijes gjuhësore pasive të brezit më të moshuar. Bashkëtingëllorja

[22] Në shtypin shqiptaroamerikan të kohës leksema në fjalë haset si në gjininë femërore *chék/é-ja* (shum. *chéké-t*) - shih *Kombi*, nr. 70 (17 janar 1908), f. 4 -, ashtu dhe në atë mashkullore *çek-u* - shih *Dielli*, nr. 54 (8 prill 1910), f. 4 -, e cila përkon dhe me formën aktuale.

[23] Shih HALLER 2001, f. 414.

hundore mishëron pas të gjitha gjasave formën e asimiluar të grupit bashkëtingëllor *–tn–*, i cili ka funksion *marker*-i për formën kallëzore njëjës, karakteristike edhe për të folmen e zonës së Devollit[24]. Asimilimi [tn] > [n] në kalimin *llaj**tn**ë* > *llaj**n**ë* haset dhe në raste të tjera, si p.sh.: *të a**tn**ë* > *t'a**n**ë*, *shënde**tn**ë* > *shënde**n**ë*, *kësme**tn**ë* > *kësme**n**ë*, etj.. Ndërsa prania e gjinisë femërore mund të shpjegohet edhe me ndikimin e leksemës më të afërt semantikisht *llamb/ë-a*. Leksema në fjalë emërtonte një risi dhe përmirësim teknik[25] të mjetit ndriçues ekzistues *llamb/ë-a*, së cilës i mungente kapaku i sipërm mbrojtës, pra që mund të shuhej nga era. Në lidhje me faktorët jashtëgjuhësorë që ndikuan konkretisht në formimin e (asokohe) risisë gjuhësore në fjalë ia vlen të përmendet sesi disa ekzemplarë të mjetit ndriçues 'modern', pra të risisë teknologjike, sipas dëshmisë së një informatori[26], u sollën në fshat në nga një grup emigrantësh shqiptaroamerikanë, të cilët ktheheshin nga Bostoni në vendlindje.

Në bazë të hulumtimeve të bëra del se dhe në sferën semantike të veshjeve hasen disa angloamerikanizma riemigrues. Po në zonën e Korçës gjen ende përdorim aktiv, ndonëse më tepër në formë arkaizmi, dhe emërtimi *springje* (vetëm shumës) ʿtirandë elastike pantallonash', i cili rrjedh nga *spring* ʿsustë'. Këtë e gjejmë dhe në brendësi të shprehjes frazeologjike *i ngre bollkat me springje* ʿi ka zënë luga kos'. Përshatja e plotë morfologjike[27] në gjuhën shqipe e këtij angloamerikanizmi përbën një dëshmi të qartë të gjallësisë së tij në shqipe. Elementi leksikor në fjalë plotëson spektrin semantik të italianizmit *tirand/ë-a*, i cili emërton krahoshet, qofshin këto elastike apo jo, që përdoren për të mbajtur veshje, pantallona apo funde. Pothuajse të njëjtat shpërndarje, karakteristika dhe gjallësi ka dhe emërtimi *ovralle/ ovroll/e-ja* < *over all* ʿlloj veshjeje shtëpiake e

[24] Shih XHAÇKA 1958, f. 201, GJINARI 1960, f. 106 dhe GJINARI 1989, f. 259-260.

[25] Si një shembull tjetër i pranisë dhe bashkëjetesës së emërtimeve të dy varianteve teknikisht të ndryshme objektesh të ngjashme me të njëjtin funksion shërben çifti i fjalëve *parmëndë/ parmend/ë-a*, dhe *plug-u*. I pari, një latinizëm i shqipes (shih analizën etimologjike të ÇABEJT në ÇABEJ 1965a, f. 12-13) emërton mjetin e drunjtë e më primitiv për lërimin e tokës, që u zëvendësua gradualisht nga i dyti, i përmirësuar teknikisht për arsye të pajisjes me plor të hekurt, emërtimi i të cilit paraqit pas të gjitha gjasave një gjermanizëm (shih ÇABEJ 1965b, f. 19-20).

[26] Ky informacion plotësues u regjistrua në vitin 1992 në Dardhë, nga një informatore, mbi të tetëdhjetat, e cila kishte përjetuar vetë këtë episod.

[27] Bëhet fjalë për formimin e shumësit me qiellzorëzim të grykores fundore.

përditshme'. Parë nën prizmin e diferencimit diastratik mund të konstatohet se emërtimi në fjalë përdoret në mënyrë aktive pothuajse ekskluzivisht nga shtresa shoqërore e familjeve më të vjetra dhe autoktone e qytetit të Korçës. Elementi *pllov/ër-ri* < *pullover* mund të konsiderohet edhe në bazë të tipareve të tij fonetike si një angloamerikanizëm riemigrues. Emërtimi në fjalë gëzon së paku për të folmen e zonës së Korçës një përhapje të gjerë, dhe përdorimi i tij nuk kufizohet vetëm në regjistrin e gjuhës së folur të brezit më të vjetër, nga i cili dhe përdoret kryesisht. Duke u bazuar në karakteristikat fonetike të elementit leksikor *pllover* mund të përjashtohet një kalim i mundshëm nëpërmjet emërtimit përkatës grek *πουλόβερ* apo atij italian *pullover*, ashtu si dhe një përshtatje dialektore e formës shqipe standard *pulov/ër-ri*, e cila është më e re se angloamerikanizmi riemigrues në fjalë. Në këtë rast mund të bëhet fjalë për praninë e një alotropi[28].

Por ekzistojnë dhe disa elemente të tjera leksikore, si p.sh. *bos-i*[29], *frak-u*, *intervjú-ja*[30], *miting-u*[31] dhe *risk-u*, të cilat gëzojnë një përhapje shumë më të gjerë në arealin gjeolinguistik ballkanik të shqipes, dhe më tej, sesa leksemat e tjera të analizuara pak më lart. Gjatë kryerjes së analizës etimologjike të tyre, përkrah mundësisë së rrezatimit dhe në shqipe, në kuadrin e përhapjes së tyre të gjerë si internacionalizma në gjuhë të ndryshme nuk duhet lënë jashtë vëmendjes dhe dukuria e angloamerikanizmave riemigrues. Në kuadrin e shpjegimit etimologjik të *etymon*-it *frak-u* < *frock*[32] duhet mbajtur parasysh në veçanti mundësia rolit ndërmjetësues të italishtes.

[28] Në lidhje me konceptin e alotropit shih TAGLIAVINI 1972[6], f. 327-328 e 330-331. Një shembull tjetër alotropi në gjuhën shqipe përbën dhe çifti *fre-ri* < (lat.) *frenum* dhe *fren/ë-a* < (it.) *freno* < (lat.) *frenum*.

[29] Shih edhe PRIFTI 2007a, f. 19 e shën. 79.

[30] Aktualisht përhapja dhe përdorimi i leksemës rezultojnë të kufizuara për arsye të gjallësisë së italianizmit *intervist/ë-a*, shih dhe PRIFTI 2007a, f. 17, shën. 68.

[31] Shih në veçanti PRIFTI 2007a, f. 15-16.

[32] Në lidhje me argumentet që mbështetin origjinën angloamerikane të leksemës në fjalë shih edhe LEHNERT 1990.

4. Përfundime dhe desiderata

Angloamerikanizmat riemigrues të shqipes përbëjnë vetëm elementë leksikorë, që zakonisht rezultojnë të përqendruar në areale gjeolinguistike relativisht të ngushta[33]. Një pjesë mirë e tyre hasen aktualisht vetëm në regjistrin gjuhësor të brezit më të moshuar, dhe hyjnë në sferat semantike të produkteve teknike dhe të veshjeve. Përveç shpërndarjes dinamike të kushtëzuar nga diferencimi diabrezor, për disa prej tyre duhet të merret parasysh në veçanti diferencimi diastratik. Ndërsa nën prizmin diafazik bie në sy ngjyrimi humoristik që karakterizon përdorimin e disave prej tyre. Jo rrallë angloamerikanizmat e analizuar më sipër përbëjnë arkaizma gjuhësorë, pra kanë një shtrirje tendencialisht të kufizuar në rrafshin diakronik.

Karakteristikat kryesore të angloamerikanizmave riemigrues të gjuhës shqipe përkojnë në vija të trasha me ato të italishtes[34]. Duhet theksuar se angloamerikanizmat e arbërishtes përpos specifikave të tyre kanë dhe tipare të përbashkëta me ata të italishtes, apo, thënë më saktë, të varieteteve italoromanike meridionale, dhe për vetë faktin që emigrimi i arbëreshëve në ShBA mund dhe duhet trajtuar padyshim si një fenomen *sui generis*, por njëkohësisht dhe si pjesë e pandarë e emigrimit të italianëve jugorë në ShBA[35].

Mbetet një *desideratum* analiza e plotë dhe e njëtrajtshme e angloamerikanizmave riemigrues të shtrirë në gjithë hapësirën e shqipes në gadishullin ballkanik dhe më tutje. Për këtë është i domosdoshëm një analizim i kujdesshëm në të gjithë arealin gjeolinguistik i pranisë dhe i përhapjes së anglicizmave riemigrues të shqipes nga njëra anë, si dhe nga ana tjetër një hulumtim

[33] Pjesa më e madhe e shembujve të sipërpërmendur u regjistrua në varietetet dialektore të zonës së Korçës, dhe kjo jo vetëm për faktin se zona në fjalë mbetet tradicionalisht ajo më e prekura nga dukuria e emigrimit drejt ShBA-së, por dhe për arsyen subjektive të pamundësisë konkrete të hulumtimit të shtrirjes së plotë të fenomenit në gjithë arealin e shqipes për shkak të mungesës konkrete të një sëre veprash elementare dialektologjike në fushë të shqipes, të domosdoshme për studime të këtij lloji.

[34] Në gjuhësinë italiane fenomeni në fjalë është trajtuar nga disa autorë, në mënyrë të veçantë nga Giovanni TROPEA (shih p.sh. TROPEA 1983). Punimi i parë mbi këtë temë mban firmën e Alberto MENARINI-t (shih MENARINI 1940).

[35] Shih edhe PRIFTI 2007b, f. 273 e 286-287.

dialektologjik i hollësishëm i të folmeve të qendrave të banuara urbane dhe të zonave rurale më të prekura nga emigrimi në kontinentin amerikanoverior dhe në Australi, dhe kjo jo vetëm për fazën e parë të emigrimit, por edhe për këto pesëmbëdhjetë vitet e fundit. Një hulumtim i kujdesshëm gjeolinguistik sinkronik, sidomos i disa dialekteve urbane, mund të nxjerrë në pah praninë e një sëre angloamerikanizmash riemigrues të rinj, të cilët lidhen me fazën aktuale të emigrimit të shqipfolësve ballkanikë në ShBA. Vetëm pas një analize të plotë e gjithëpërfshirës të dukurisë së anglicizmave riemigrues mund të vlerësohet objektivisht shpërndarja e tyre nën prizmin e dikotomisë 'dialekt urban' vs. 'dialekt rural'.

Është e nevojshme që një analizë e tillë të kryhet në mënyrë krahasuese në nivelin e varieteteve makrodiatopike të shqipes, duke bërë kështu më të saktë e objektiv përshkrimin e tyre, si dhe duke plotësuar e hedhur dritë më tej mbi këtë aspekt të veçantë të dukurisë së anglicizmave të shqipes në përgjithësi.

Bibliografi:

BUßMANN, Hadumod (1990): *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgart: Alfred Kröner Verlag

COSERIU, Eugenio (1958): *Sincronia, diacronia y historia. El problema del cambio lingüístico*, Montevideo

COSERIU, Eugenio (1980): "Historische Sprache" *und* "Dialekt", në: GÖSCHEL, Joachim/ IVIĆ, Pavle/ KEHR, Kurt (Hrsgg.): Dialekt und Dialektologie. Ergebnisse des internationalen Sprachsymposiums "Zur Theorie des Dialekts" (Marburg, 5.-10. September 1977), Wiesbaden: Steiner Verlag (Zeitschrift für Dialektologie und Linguistik, 26), **f. 45-61**

COSERIU, Eugenio (1988): *Sprachkompetenz. Grundzüge der Theorie des Sprechens (Bearbeitet und herausgegeben von Heinrich WEBER)*, Tübingen: Francke Verlag

ÇABEJ, Eqrem (1965a): *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XVI (O, P)*, në: Studime Filologjike (XIX) II/1, **f. 3-45**

ÇABEJ, Eqrem (1965b): *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XVII (P)*, në: Studime Filologjike (XIX) II/2, **f. 7-53**

FLYDAL, Leiv (1951): *Remarques sur certains rapports entre le style et l'état le langue*, në: Norsk Tidsskrift for Sprogvidenskap XVI, **f. 240-257**

GJINARI, Jorgji (1960): *Mbi të folmen e Devollit*, në: Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës - Seria e Shkencave Shoqërore XIV/4, **f. 103-137**

GJINARI, Jorgji (1989): *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë (Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë): Shtypshkronja "8 Nëntori"

HALLER, Hermann W. (2001): *Il lessico italo-americano tra continuità storica e innovazione semantica*, në: AA.VV.: Semantica e lessicologia storiche. Atti

del XXXII Congresso della Società di Linguistica Italiana, Roma: Bulzoni (SLI, 42), **f. 405-416**

KACHRU, Braj B. (1981): *American English and other Englishes*, në: FERGUSON, Charles A./ HEATH, Shirley Brice (eds.): Language in the USA, Cambridge: Cambridge University Press, **f. 21-43**

KÖDDERITZSCH, Rolf/ GÖRLACH, Manfred (2002): *Albanian*, në: GÖRLACH, Manfred (ed.): *English in Europe*, Oxford: Oxford University Press, **f. 291-300**

LEHNERT, Martin (1990): *Angloamerikanisches im Sprachgebrauch der DDR*, Berlin: Akademie Verlag

LÜDTKE, Helmut (1980a): *Sprachwandel als universelles Phänomen*, në: LÜDTKE, Helmut (Hrsg.): Kommunikationstheoretische Grundlagen des Sprachwandels, Berlin - New York: Walter de Gruyter Verlag, **f. 1-19**

LÜDTKE, Helmut (1980b): *Auf dem Wege zu einer Theorie des Sprachwandels*, në: LÜDTKE, Helmut (Hrsg.): Kommunikationstheoretische Grundlagen des Sprachwandels, Berlin - New York: Walter de Gruyter Verlag, **f. 182-252**

MENARINI, Alberto (1940): *Echi dell'italo-americano in Italia*, në: Lingua Nostra II, **f. 111-115**

NAÇI, NUÇI D. (1901): *Korça бe Пσatrat per qark*, Sofjë: Ndë Cтyпëckroиët cqiпe "Mbroθësia"

NUHIU, Vesel (1995): *Interferencat morfologjike të anglishtes në shqipen e Amerikës*, në: Studime 2, **f. 225-263**

NUHIU, Vesel (1997): *Interferenca sintaksore e anglishtes në shqipen e Amerikës*, në: Filologji 4, **f. 83-103**

NUHIU, Vesel (1998a): *Drejtshkrimi i huazimeve angleze në shqipen e Amerikës*, në: Filologji 6, **f. 65-75**

NUHIU, Vesel (1998b): *Interferenca fonematike e anglishtes në shqipen e Amerikës*, në: Filologji 5, **f. 81-98**

PANAJOTI, Jorgo (përg. nga) (1982): *Këngë popullore të rrethit të Korçës*, Tiranë (Akademia e Shkencave e RPSSh - Instituti i Kulturës Popullore): Shtypshkronja "Mihal Duri"

PRIFTI, Elton (2005): *Kontaktlinguistische Bemerkungen zum Standardalbanischen und zu seinen Varietäten,* në: GENESIN, Monica/ MATZINGER, Joachim (Hrsgg.): Albanologische und balkanologische Studien. Festschrift für Wilfried FIEDLER, Hamburg: Verlag Dr. Kovač (Philologia. Sprachwissenschaftliche Forschungsergebnisse, 73), **f. 131-138**

PRIFTI, Elton (2007a): *Gli anglicismi nell'albanese dei Balcani*, në: ALTIMARI, Francesco (a cura di): XXX. Atti del XXX (Università degli Studi di Cosenza - Facoltà di XXX - Dipartimento di XXX, 7-9 XXX 2006), **f. 1-57** (manuskript)

PRIFTI, Elton (2007b): Zëra puru last week! *Cenni sul comportamento linguistico di una comunità italoalbanese a Philadelphia (USA) dal punto di vista della linguistica contattuale e variazionale*, në: MANDALÀ, Matteo (a cura di): La Sicilia, il Mediterraneo, i Balcani: storia, culture, lingue, popoli: Antiche e nuove emigrazioni e prospettive dell'integrazione socio-economica e culturale. Atti del II Congresso dell'Associazione Italiana di Studi del Sud-Est Europeo (Università degli Studi di Palermo - Facoltà di Scienze della Formazione - Dipartimento di Critica dell'espressione DANAE, 7-9 settembre 2006), Palermo: A. C. Mirror, **f. 271-296**

STEHL, Thomas (1990): *Ansätze einer strukturalistischen Beschreibung der Variation im Französischen und Italienischen*, në: HOLTUS, Günter/ RADTKE, Edgar (Hrsgg.): Sprachlicher Substandard III. Standard, Substandard und Varietätenlinguistik, Tübingen: Niemeyer (Konzepte der Sprach- und Literaturwissenschaft, 45), **f. 172 - 210**

STEHL, Thomas (1996): *Competenza, pragmatica e linguistica della variazione: problemi d'inchiesta e d'interpretazione in geolinguistica*, në: RADTKE, Edgar/ THUN, Harald (Hrsgg.): Neue Wege der romanischen Geolinguistik. Akten des Symposiums zur empirischen Dialektologie (Heidelberg/ Mainz, 21.-24.10.1991), Kiel: Westensee-Verlag (Dialectologia pluridimensionalis romanica, 1), **f. 620-640**

TAGLIAVINI, Carlo (1972[6]): *Le origini delle lingue neolatine. Introduzione alla filologia romanza*, Bologna: Pàtron Editore

TRIX, Frances (2001): *Albanians in Michigan*, East Lansing (Michigan): Michigan State University Press

TROPEA, Giovanni (1983): *Americanismi nei dialetti italiani*, në: BENINCÀ, Paola (a cura di): Scritti linguistici in onore di Giovan Battista PELLEGRINI, Pisa: Pacini, **f. 179-187**

WEBSTER, Noah (1789): *Dissertations on the English Language*, Boston: Isaiah Thomas

XHAÇKA, Vasil (1958): *Një shikim mbi të folmen e krahinës së Devollit*, në: Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës - Seria e Shkencave Shoqërore XII/2, **f. 196-210**

Idriz AJETI

KOPITAR E MIKLOSHIÇ NË STUDIMET E GJUHËS DHE TË KULTURËS SHQIPTARE

Punëmbarë e punështruar, populli slloven me inteligjencinë vet trime dhe energjiplotë, jo mendjengushtë, energjitë e tepërta nuk i konservonte, por, gjithherë ua jepte edhe të tjerëve për të mirën e tyre. Në qoftë se jemi te inteligjencia e popullit slloven kujt s'i kujtohet rasti i dy korifenjve të saj – Kopitar e Mikloshiç; kujt nuk i kujtohet se me sa gëzim Kopitari priti një burrë çalaman, një malësor nga Serbia (Vuk Karaxhiqin), i cili me përkrahjen e parezervë të dijetarit slloven arriti të bënte punë me vlera të mëdha në dobi të kulturës së popullit të vet.

Qysh në vitin 1829, në blenin 46 të Wiener Jahrbücher der Literatur, J. Kopitari shfaq interes të veçantë për probleme nga disiplina të ndryshme të ballkanistikës, duke vënë në spikamë mendimin sipas të cilit rreth Danubit dhe në Jug të tij – nur einte Sprachform herrsht, aber mit dreierlei Sprach materie (sundon vetëm një formë gjuhësore por me tri lloje lënde gjuhësore). Sipas Kopitarit një nga këto tri gjuhëve, shqipja është autoktone ndërsa dy të tjerat janë sjellë nga perëndimi (Rumania) dhe nga lindja (Bullgaria). Zbërthimi i mëtejmë i mendimit të Kopitarit do të tregonte se pas tij kjo formë gjuhësore e tri gjuhëve ballkanike buron nga dy gjuhë fqinjësore dhe të afra midis tyre, përkatësisht ilirishtja dhe trakishtja. Këtë mendim e ndeshim në vitin 1850 tek autoriteti i atëhershëm në gjuhësi – August Schleicheri. Mirëpo, nuk është vështirë të gjykohet se bazën e vërtetë të studimeve të mëtejme ballkanike do ta gjejmë në veprën e Mikloshiçit.

Jernej Kopitar

(Repnje 1780-1844) është i pari autor i gramatikës shkencore të sllovenishtes (1808); po, ndërkaq ai që, sikur e dimë të gjithë, i vuri themelet sllavistikës – kësaj dege të indoevropianistikës, ç'është linguisti i madh Franz Mikloshiç (1813-1891). Ky hartoi gramatikën

krahasuese të gjuhëve sllave (Vergleichende Grammatik der slavischen Sprachen (I-IV, Wien, 1852-1874), më pas Fjalorin etimologjik të gjuhëve sllave (Etymologisches Wörterbuch der slavischen Sprachen, Wien, 1886) me një varg veprash të tjera të ballkanistikës. jemi marrë edhe vetë me veprat albanologjike të këtij dijetari, i cili njihej ndër të parët studiues të huaj që me aq zell e sukses kishte nisur hetimin e elementeve sllave dhe romane dhe formën e foljeve të huazuara të shqipes, me anë tjetër në fjalorët e tij e në kërkimet e ndryshme sllavistike e romane, për herë të parë vuri në pah ndikimin e shqipes a të një shkalle të lartë të saj mbi gjuhët fqinje me të, duke vështruar në pamjen e gjerë elementet turke në gjuhët e Evropës Juglindore e Lindore, një vepër që u plotësua me disa "shtesa" (Çabej, Studime gjuhësore VII).

Fran Miklošiči, një linguist i ri slloven, që do të bëjë emër në fushën e filologjisë e të linguistikës sllave, në ballkanologjinë dhe albanologjinë, lindi më 20 nentor 1813 në Radoneshçak - një vend i vogël në Slloveni, e vdiq më 7 mars 1891 në Vjenë. Mësimet e para e të mesme i vijoi në Varazhdin e Maribor; studimet e larta i mbaroi në Grac. Meqë në kushtet e rrethanat e atëhershme nuk arriti të gjente punë që të ushtronte profesionin e pedagogut të filozofisë, shkoi e u vendos në kryeqytetin e Perandorisë, në Vjenë për t'u regjistruar në Fakultetin e Drejtësisë dhe aty, pasi i mbaroi studimet mori doktoratën më 1840. Së shpejti zuri punë te avokati i njohur Bach ku po gatitej për karrierën e avokaturës. Njohja me Jernej Kopitarin, censor i literaturës sllave në Vjen, zgjoi tek Miklošiči i ri dëshirën t'u kthehet studimeve filologjike dhe u dha i tëri pas tyre. Me ndihmën e Kopitarit e morën nëpunës në Bibliotekën Mbretërore dhe pas vdekjes së tij, ia zuri këmbën atij për censor të librave sllave, greke e rumune. Qëllimi i tij shkallë-shkallë po gjente shprehjen e realizimit definitiv. Në vitin 1849 i jepet profesura e inordinarit, motmot më vonë avancohet dhe merr titullin profesor ordinar duke iu besuar kurset e gjuhësisë dhe të filologjisë sllave në Universitetin e Vjenës.

Në një studim të gjerë mbi veprimtarinë shkencore që ia kushtoi Mik1oshiçit, filologu i njohur kroat Toma Maretiç, Rad, libër CXII, bleni XXXVI, Zgb. 1892, fq. 41-153, shkruan se Mikloshiçin e shquanin zelli i rrallë në punë, shpejtësia dhe talenti, në saje të të cilave cilësi arriti të bëhet sllavisti më i njohur i kohës dhe rezultatet e

tij të korrura në gjurmimet e sllavistikës i bëjnë nder atij vetë dhe studimeve sllavistike të kohës së tij, duke qëndruar në një pjesë të mirë të tyre të palëkundshme edhe sot e gjithë ditën; ç'është e vërteta rrokja e shumë disiplinave të sllavistikes duke ngritur një mori çështjesh që shtroheshin në ato fusha studimesh, nuk i lejuan atij të bënte gjithherë studime të thelluara e prej këndej del që disa sosh nuk mundën t'i qëndrojnë kritikës së kohës dhe të bëhen pronë e pranueshme nga kërkimtare të pastajmë. Historinë e gjuhës shqipe e njihte mirë duke zotëruar dhe përvetësuar çdo gjë që deri atëherë ishte botuar për albanistikën. Në përpjekjet që në kohën e tij bëheshin nga linguistët për të veçuar elementin e huaj nga burimi vetjak i gjuhës shqipe, puna e dijetari nuk mbeti mbrapa nga shokët që punë të tilla bënin për gjuhë të tjera indoevropiane. Është merita e Mikloshiçit që i studio i shtjellueshëm lidhjet e gjuhëve të Ballkanit në dritën e teorisë së substratit thrako-ilir duke theksuar rëndësinë e posaçme të shqipes si e vetmja gjuhë që trashëgon drejtpërsëdrejti strukturën e asaj gjuhe të lashtë, elementet e së cilës pasqyrohen në disa gjuhë ballkanike.

Për sa u përket dukurive fonetike të shqipes, pikërisht kur është fjala për shpjegimin e zhdukjes së vokaleve nistore ndër huazime të shqipes nga latinishtja, Mikloshiçi shfaqi mendim të hollë që vetëm kohët e fundit me zbulimin dhe studimin e veprës së parë të letërsisë shqipe "Mesharit" të Gj. Buzukut (1555) u vërtetua mrekullisht, me fjalë të tjera Mikloshiçi - Albanische Forschungen, II, 1973, "Vuri re se midis bazave latine me zanore iniciale në pozicion nazal ose likuid dhe reflekseve të tyre pazanore në shqipen e sotme duhen supozuar forma të ndërmjeme me *ë* iniciale nazal ose likuid". S'ka dyshim se ky ndërrim fonetik kushtëzohet nga ndikimi i fortë që ushtron mbi zanore të pathekse akcenti i shqipes, ashtu që zanoret e pathekse njëherë dobësohen dhe për pasojë shpeshherë bien fare, me fjalë të tjera zanoret e ballit të fjalëve para se të zhduken kalojnë në *ë*, bie fjala nga baza latine *altare* u përftua *ëltere* sot *lter;* Andress - *Ëndre, Ndre;* Antonius - *Ënduo, Endue, Ndue;* angustus - *ëngusht, ngusht;* armata - *ërmaia, rrmata;* amicus – *mik;* prill nga, *aprilis; ranë* prej *arena.*

Përfundimet e studimeve etimologjike të shqipes të kryera prej Mikloshiçit - Studime shqiptare, I, III, duke ndjekur parimet dhe metodën e gramatikanëve të rinj të kohës në një pjesë të mirë të tyre qëndrojnë edhe sot e gjithë ditën. Me studimet e Mikloshiçit,

etimologjia si shkencë albanologjike u përvijua dhe i përcaktoi detyrat e saj themelore. Në veçanti, sikundër u tha sipër, për mungesë materiali gjuhësor dhe studimesh analitike në fushën e filologjisë dhe të dialektologjisë shqiptare, etimologjia si shkencë albanologjike pati të meta të mëdha. Si në kërkimet e Mikloshiçit, ashtu edhe në hetimet e mëvona të albanologëve rrokej kryesisht historia e jashtme e gjuhës shqipe, ndërsa studimit shkencor të tipareve të strukturës së vetë shqipes së folur e të shkruar, pra, historisë së brendshme të saj iu la një vend shumë i vogël. Studimet etimologjike të kohës së Mikloshiçit si dhe vetë punimet e tij historike të gjuhës shqipe vuanin nga metoda që karakterfzohej nga zbërthimi i leksikut të shqipes duke kërkuar gurrën e fjalëve të saj tek krahasimet më gjegjëse të gjuhëve të tjera - mise të familjes së madhe indoevropiane, duke u larguar nga trualli i shqipes dhe nga kërkimi që secila në shqyrtimin historik, para se të bëhet krahasimi i saj me fjalë të gjuhëve të tjera, të vështrohet njëherë mos lidhet përbrenda shqipes me ndonjë shprehje tjetër; bie fjala *njollë* lidhet me *ngjollë* e ndoshta edhe me *gjollë* e që të gjitha da1in nga folja *ngjyej; ngërthej-gardh;* pranë *pullaz* ka *pllas; përqell-qeil; qëlloi e qëllim.* Duke u zbatuar kjo metodë studimi në çështjet e gjurmimit të leksikut të gjuhës sonë asaj kanë zënë t'i kthehen një mori fjalësh që deri tani vonë nga kërkimtarë të huaj njiheshin të ardhura nga gjuhë të tjera, sidomos prej latinishtes dhe prej gjuhëve të popujve fqinjë.

Fran Miklošiči veproi në dy fronte shkencore që me shumë fije lidhen njëri me tjetrin; është fjala për degëzimet e linguistikës dhe filologjisë sllave me të albanistikës të cilave u kushtoi një jetë të tërë njeriu. Me emrin e Miklošičit një mendje sistematike, lidhen të gjitha nismat në punë të organizimit të studimeve sllavistike. Atij i bie merita të ketë ravizuar një projekt të gjerë e të shumanshëm të studimeve të gjuhëve sllave, të cilin në viset më të shumta kishte arritur ta kryente me suksese të kënaqshme. Me një recensim që ia kishte bërë gramatikës krahasuese të gjuhëve indoevropiane të F.Boppit, Miklošiči tërhiqte vëmendjen e specialistëve të gjuhësisë krahasuese indoevropiane. Së shpejti, pas një gjurmimi.e pune të zellshme, zuri të hartonte vetë një gramatikë krahasuese të gjuhëve sllave që u mirëprit prej ekspertëve sllavistë duke e quajtur vepër monumentale që e ka ruajtur edhe sot e gjithë ditën vlerën e saj.

Miklošičin e kanë mbajtur për autor të mirëfilltë të gramatikës krahasuese të gjuhëve sllave me shpjegime në shkallën e arritjeve shkencore të sllavistikës së kohës, që ishte në zhvillim, por edhe me rezultate të mira e vlera të pamohueshme. Miklošiči me punimet dhe veprat e veta përfaqëson një epokë të tërë në filologjinë dhe linguistikën sllave. Ai linguistikën sllave e vuri në baza të reja me një fuqi krijuese dhe mbi materialin gjuhësor të sllavishteve zbatoi me konsekuencë dhe shkathtësi të të menduari - një prirje e aftësi e veçantë natyrore që e shquan një njëri në një fushë të caktuar.

Në një front tjetër ku Miklošiči u shqua me punime e përfundime shkencore, ishte fusha e studimeve për historinë, për gjuhën dhe për kulturën e popujve të Ballkanit, e quajtur ballkanologji. Linguisti slloven Miklošiči u dallua në shoshitjen etimologjike të thesarit leksikor të shqipes. Në radhën e dijetarëve që drejtpërdrejt dhe vazhdimisht për tërë një jetë njeriu ishin marrë me gjuhën shqipe, figuronte linguisti slloven Fran Miklošičit: Miklošičit – Gustav Meyer Pedersen - Jokl.

Kontakteve gjuhësore të shqiptarëve me sllavët e jugut dhe raporteve gjuhësore ballkanike - siç dihet, u kishte vënë gisht qysh Jernej Kopitari - censor i literaturës sllave në Vjenë, kurse bashkëtakimet dhe gërshetimet e gjuhëve ballkanike në mënyrë sistematike i ka gjurmuar edhe patriarku i atëhershëm i sllavistikës Fran Miklošiči. Si sllavist që ishte, ai në gjuhën shqipe kërkonte huazimet sllave dhe burimin e huaj në këtë gjuhë josllave të Ballkanit. Kjo, pos tjerash, ishte metoda kryesore e hulumtimeve në fushën e shkencës së re albanologjike që më së miri e dëshmojnë studimet albanologjike të Muklošičit: Die slavischen Elemente im Albanischen I. Die romanischen Elemente im Albanischen II. Format e foljeve të huazuara të shqipes dhe të gjuhëve të tjera III. Wien, 1870-71.

Miklošiči në veprat jo të pakta të tij albanologjike, është shprehur në mënyrë të qartë mbi një varg çështjesh të historisë, të fonetikës historike, të trysnisë së huaj në gjuhën shqipe, prandaj, në vija të trasha e përmbledhtas do të përpiqemi t'i paraqesim pikëpamjet e tij rreth disa çështjeve qenësore fonetike të gjuhës sonë. Kushdo që i hedh një sy, bie fjala, studimit jo aq të hapët të tij Die slavischen Elemente im Albanischen – në hyrjen që ka të bëjë me sistemin fonologjik e fonetik, do të bindet se Miklošiči pasi e kishte zotëruar

gjithë literaturën përkatëse që drejtpërdrejt apo tërthorazi i kushtohej shqipes, përpiqej të krijonte një pasqyrë të drejtë mbi natyrën e sistemit fonologjik të saj. Sasia e kësaj literature përfshinte gjithçka me rëndësi e me vlerë që ishte botuar duke nisur me Fjalorin e Frang Bardhit (1635) e duke mbaruar me vitin e botimit të tretë (1868) të Kuvendit të Arbënit. Literatura e zënë ngoje albanologjike Muklošičit i jepte dorë të sigurt për shumë çështje të gjuhës sonë të shprehej me besim të patundur e të shfaqte mendime të pranueshme.

Në parathënien e librit; këtu të përmendur, për sistemin zanor të gjuhës sonë, Miklošiči thoshte se ka shtatë zanore, që mund të jenë të shkurtëra dhe të gjata. Me sa po duket e mbi bazën e paradigmës së tingujve të gjuhës shqipe, Miklošiči në sistemin zanor të dialekteve të shqipës konstatoi dy lloje kuantitetesh të zanoreve: zanore të shkurtëra dhe të gjata; pas mendimit të tij dialektet shqiptare d.m.th. gjuha shqipe nuk kishte kuantitet të mesëm të zanoreve. Çështja e kuantitetit të zanoreve u zgjidh vetëm aty nga fillimi i shekullit XX, me gramatikën e Gjergj Pekmezit-Grammatik der albanesischen Sprache, Vjenë, 1908, që i detyrohej bashkautorit slloven Rajko Nahtigal, i cili në ligjërimet e gjuhës shqipe konstatoi tri radhë gjatësish të zanoreve: të shkurtëra, të mesme dhe të gjata. Albanologut slloven ia dimë për mirë, gjithashtu, që i përudhur nga autorë të shumtë të gramatikave të shqipes dhe prej një numri të madh veprash albanologjike që kishte konsultuar, na njoftoi për praninë e një veçorie të kualitetit të zanoreve të ligjërimeve popullore gege – të quajtur nazalitet i zanoreve të gegërishteve. Në hyrje të veprës së përmendur, faqe 13, Miklošiči, duke bërë fjalë për cilësinë e posapërmendur prozodike të dialekteve gege, përpiqet të caktojë se në ç'farë pozite mund të gjendet një vokal nazal, në trup të fjalës, në pozicion fundor, por pas mendimit të tij zanoret nistore nuk mund të kenë nazalitet: Im Anlaute kennt das Albanische keine Nasalierung: in embastoj sufficio; engarkoj onero wird deutlich emen nicht etwa ê gesprochen. Mirëpo, një mori shembujsh në dialektet gege të shqipës e përgënjeshtrojnë mendimin e dijetarit të madh slloven: **êmën, tosk emër, âsht, tosk është**.

Çështja e zanoreve iniciale ka qenë përherë me interes shkencor të albanistëve. Nga albanistët e shekullit të kaluar F. Miklošiči, Die romanischen Elemente im Albanischen, II është i pari e i vetmi që vuri re se a-ja nistore e pathekse e huazimeve latine të shqipes, para se të

binte, u ndërrua në një zanore të reduktuar: kështu latinizmat **altare, angustus,** para se të arrinin në të sotmet **lter, ngushtë** kaluan nëpër shkallën e ndërmjeme **ëlter, ëngushtë**. Çështjen e zanoreve nistore të pathekse e trajtoi edhe dijetari rumun. A. Balota, në punimin e tij të disertacionit, të mbrojtur më 1925 në Universitetin e Beogradit, para komisionit me mentorin e doktorantit prof. H. Barić "Dëshmia që na jep tani më i vjetri shkrimtar i shqipes, vërteton më së miri mendimin e këtyre dy dijetarëve. Ky proces, ndërkaq, përshkon gjithë zhvillimin e lashtë të shqipes duke përfshirë natyrisht dhe elementet e saj autoktonë", Çabej, Disa aspekte të fonetikës historike të shqipës në dritën e gjuhës së Gjon Buzukut, në Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe 279, Tiranë, 1985.

Për likuidet, do t'i themi medoemos nja dy fjalë, për disa arsye: njëherë, për to janë shprehur një numër i madh i albanistëve që do të thotë se ato paraqesin një problem sa të diskutuar aq edhe të diskutueshëm. Mjafton të merret në një bibliotekë të pajisur mirë e të shikohet fondi i gramatikave të gjuhës shqipe në gjuhë të huaja dhe të vendit dhe i trajtesave për gjuhësinë shqiptare për të parë interesin e madh që ndër linguistë të huaj e shqiptarë ka pasur për gjuhën tonë. Në gramatika e studime të veçanta për gjuhën shqipe, autorët e tyre likuideve u kushtojnë një kujdes të posaçëm. Në gramatika të shkruara në periudha të hershme, ata konstatojnë tre tipa të likuidës **l:** një **l** palatale, një tjetër të quajtur e mesme apo evropiane dhe një të tretë **l** velare; edhe Miklošiči mbajti një qëndrim të tillë, sepse në gramatikat dhe literaturën e konsultuar albanologjike nuk gjeti gjykime të tjera.

Do të pritej të vijë arushani i Kopenhagës Holger Pederseni me studimin e tij të njohur - L-Laute im albanesischen, KZ. 33, fq. 535.551; meqë s'e gjente të drejtë pohimin e save që thoshin se në gjuhën shqipe paskemi tre tipa të bashkëtingëllores **l,** ai në dialektet e shqipes mbi një material të huazimeve latine të shqipes, provoi dy tipa të këtyre konsonanteve: 1,11 (1',). Në këtë mënyrë Pederseni hoqi nga rendi i ditës njëherë e mirë një problem nga fonetika historike e shqipes që shqetësoi mendjen dhe ngjalli për shumë kohë kureshtjen e një pale të mirë dijetarësh - albanologë. Në këtë çështje, po të na falet mungesa e modestisë, do të thoshim që edhe ne kishim hedhur pakëz dritë. Udhëheqësi im prof. H. Barić me rastin e marrëveshjes rreth temës së disertacionit, përveç të tjerash, më thoshte se një sllavist -

njohës i mirë i të folmeve malazeze në ligjërimin shqiptar të Shestanit kishte konstatuar një tipar të veçantë, shumë interesant për studimet albanologjike duke diktuar në atë të folme tre tipa të konsonatit **l,** prandaj ia vleka, mos për asgjë tjetër së paku për këtë shpikje, "të merret e të trajtohet edhe njëherë ligjërimi i arbëneshëve të Zarës, të shkëputur nga djepi i hershëm në Shestan në gjysmën e parë të shekullit XVIII (1726-1733) - bashkë me të folmet e atij vendi. I ramë saherë Shestanit kryq e tërthor, regjistruam lëndë të bollshme, por nuk arritëm të vërtetojmë "shpikjen" e sllavistit e dialektologut të njohur Branko Miletić (e folmja e Cërmnicës, SD Zbornik IX, 1940, fq. 281).

Edhe grykoret qiellzore kanë qenë objekt hetimesh të shpeshta nga studiuesit albanistë; ato në kohë të vona kanë zënë të pësojnë ndryshime kryesisht duke u rrafshuar a tkurrur nga katër tipa në dy: ç-q, xh-gj = c-đ. Në hyrje të studimit këtu sipër të zënë ngoje, Miklošiči i gjen të gjallë katër tipa grykoresh qiellzore: k-g, tš-dš.

Franz Miklošiči spektrin e veprimtarisë shkencore të tij e shtriu tek të gjitha gjuhët e popujve të Ballkanit duke hedhur themelet e studimeve ballkanologjike; po aty me punimet e përqëndruara në fushën e leksikut historik të gjuhës shqipe iu vu një bazë e mirë edhe studimeve etimologjike të saj. Është merita e Miklošičit që i studioi shtjellas lidhjet e gjuhëve të Ballkanit në dritën e teorisë së substratit trako-ilir duke theksuar rëndësinë e veçantë të shqipes si e vetmja gjuhë që trashëgon drejtpërdrejt strukturën e asaj gjuhe të lashtë elementet e së cilës pasqyrohen në disa gjuhë ballkanike.

Nga një shqyrtim sistematik i leksikut të shqipes Miklošiči mbi një material të mbledhur më shumë në diasporën se sa në Shqipërinë në fjalorin e saj gjeti **319**. fjalë me gurrë sllave. Në këtë shoshitje të leksikut të shqipes u bë ndarja e fondit leksikor të shqipes, me një anë fjalët e një trashëgimie të lashtë indeoevropiane, në anë tjetër huazimet. Një punë e tillë, sikundër pohojnë etimologët, ka qenë shumë komplekse e e vështirë, prandaj fjalorët etimologjikë të çdokujt dhe çdo gjuhe qofshin s'janë pa të meta. Në të shumtën e rasteve, Miklošiči ka goditur shenjën mirë, por në shumë vise të veprës së tij, këtu sipër sa herë të përmendur, lë për të premtuar më shumë, pra një mori etimologjish janë të diskutueshme.

Në fund, po të duam të përmbledhim ç'thamë këtu për personalitetin e linguistit madhor Miklošičit, njëherë si sllavist, e

sidomos për Miklošičin si ballkanolog e së fundi si albanolog, së pari duhet të vihen në dukje, po të lihen mënjanë meritat e mëdha të tij në fushë të gjurmimeve dhe të studimeve sistematike të gjuhëve sllave, ku Miklošiči mbetet sllavisti më i njohur i kohës me rezultatet e korrura në një varg degëzimesh sllavistike që i bëjnë nder atij vetë dhe shkencës sllavistike të kohës duke qëndruar me një pjesë të mirë të tyre të palëkundshme edhe sot e gjithë ditën.

Ballkanologjia - tërësia e studimeve për historinë, gjuhën dhe kulturën e popujve të Ballkanit, është merita e studiuesve sllovenë - e Kopitarit dhe sidomos e Miklošičit: - i pari më shumë u vinte gisht problemeve reciproke ndërballkanike - gjuhësore me ç'gjë u lehtësonte punën studiuesve të tjerë të cilët tema të gatshme merrnin e i shtjellonin; kurse i dyti, pasi kishte ndërtuar një sistem studimesh të leksikut historik të gjuhëve ballkanike, u hyri një nga një shoshitjeve etimologjike të fondit leksikor të tyre. Në truall kërkimor të shqipes më shumë u mëshonte sqarimeve etimologjike të elementeve sllave të gjuhës sonë, por nuk i linte mënjanë as elementet e gjuhëve të tjera të shqipes - ato romane e turke.

Për sa u përket dukurive fonetike të shqipes, pikërisht kur është fjala për shpjegimin e zhdukjes së vokaleve nistore të pathekse ndër huazimet latine të shqipes, Miklošiči shfaqi mendim, që vetëm kohët e fundit me zbulimin dhe studimin e veprës së parë të letërsisë shqipe, "Mesharit" të Gj.Buzukut, u vërtetua mrekullisht; me fjalë të tjera Miklošiči, Albanische Forschungen II, "vuri re se midis bazave latine me zanore iniciale në pozicion nazal ose likuid dhe reflekseve të tyre pa zanore në shqipen e sotme duhen supozuar forma të ndërmjeme me **ë** iniciale nazal ose likuid".

Trinomit të njohur në fushën e studimeve albanologjike Gustav Mayer, Pedersen Jokl i printe Fran Miklošiči, ashtu që deri nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore, studimet etimologjike udhëhiqeshin prej katërshit Miklošiči-Gustav Mayer-Pedersen-Jokl.

Raportet në mes Kopitarit e Vukut

Nxitjet e shtytjet që Vukun e bënin që të hidhet në këtë punë i dinim të gjithë fort mirë; e pra, si në këtë edhe në punë të tjera këso dore Vukun e nxiste Kopitari. I flaktë e plot afsh i dhënë pas çështjeve serbe, ai edhe më parë, shpeshherë ndalej duke vrarë mendjen sesa mirë do të ishte sikur ndonjë serb të merrte të paraqiste gjuhën e tij si nga ana gramatikore ashtu edhe nga ana leksikore, natyrisht, Vuku, kishte parasysh anën shkencore të nevojës, por jo vetëm atë. Ai donte të zbardhet publikisht e vërteta se serbët flasin një gjuhë, e cila s'është as gjuhë ruse, as kishtaroruse, e sidomos jo e ndonjë prej gjuhëve me lidhje farefisnore me to. Kjo e vërtetë, sot aq e pakontestueshme në ato kohë kur linguistika evropiane, atëherë në fillimet e para të saj, mbi bazën e teksteve të shkruara nga serbët – në të shumtën jo në gjuhën e tyre, nuk mund të jepte vlerësime mbi gjuhën serbe.

Kopitari, i cili kishte arritur të njihte thellë situatën e vërtetë të gjendjes, besonte se vënia e vijës së barazimit gjuhësor do të ndihmonte që në pikëpamjen kulturore dhe politike serbët të ndahen nga rusët. Ky një personalitet i ndërlikuar kundërshtimesh të shumta të një patriotizmi paralelisht të dyfishtë sllavo-austriak.

Për një kombinacion të tillë ne sot mund të mendojmë ç'të duam, por, ai për Kopitarin ishte një gjë logjike, të cilën e merrte si normë a parim të veprimtarisë publike të tij. Censor austriak i literaturës sllave – Kopitari shekullin e vet e kaloi i bindur se në të njëjtën kohë mund të ishte i dobishëm si për Austrinë edhe për sllavizmin. Austria kishte mision historik serbët t'i bashkonte në pikëpamje të kulturës, t'i ngritte dhe në Evropë t'i integronte. Austria, një vend i madh dhe një shtet përnjëmend i qytetëruar me një populsi në pjesën më të madhe sllave, porse, me anë tjetër kundër interesave të Austrisë qëndronin ambiciet e një vendi tjetër sllav, ç'është e vërteta më pak i qytetëruar, për Kopitarin i huaj - e papëlqyera Rusi. Shtrirja e Austrisë në tokat e jugut sllav ia kishte zënë rrugën sikur një pengesë e fuqishme ndikimit rus mbi serbët. Këta të lidhur nyjesh të dyfishta sllavizimi dhe ortodoksizimi serbët në Rusinë shikonin mbrotje dhe garant se serbizmi nuk do të tretet as të zhduket.

Kopitari ishte i vetëdijshëm se gjërat nuk po zhvilloheshin sikur dëshironte ai, prandaj përpiqej ta përmirësonte gjendjen sa të jetë e mundur. Bënte aq sa mundte që pushteti austriak ndaj qytetarëve sllavë të sillej në mënyrë sa më korrekte e serbët të bënin sa më shumë në mënyrë që kulturën e tyre ta vendosnin në bazë të gjuhës së tyre dhe të largohen nga rusët. Mirëpo, udhëheqja e Vjenës kishte politikën dhe paragjykimet e saj po edhe serbët që i kishte takuar ai para se të piqej me Vukun nuk ishin të gatshëm, as të aftë për t'u hyrë detyrave të mëdha rreth zgjidhjes së gjuhës së tyre. Ja përse Kopitari, posa më në fund e gjeti njeriun e vërtetë, klithi e shpejtoi t'i lajmëronte miqtë me letra, e publikun e gjerë nëpërmjet recensioneve.

Pavle Ivić, *Srpski narod i njegov jezik*, fq.

Kristaq JORGO

MBI KUANTIFIKIMIN HARMONIK NË POEZI
Pyetje për një paraskicë të një filologjie të tretë

Ka *dy* filologji. A mund të ekzistojë një *filologji e tretë*? Një ligjëratë e nisur kështu, me një pohim të turbullt e me një pyetje akoma dhe më të turbullt, lyp në krye të herës një qartësim të termave.

Fare shkurt.

Filologjia, dashuria për fjalën. Nëse e konceptojmë këtë metaforikisht pikturë, *filologjia e parë* shfaqet si restauruese e pikturës (filologjia *stricto sensu*, tekstologjia, kritika e tekstit, ektodika); filologjia e dytë si interpretim i pikturës (filologjia *lato sensu*, i gjithë korpusi metatekstor, përfshirë këtu instrumentari teoriko-metodik). Mes restaurimit të pikturës dhe interpretimit të pikturës, a mbetet vend për një njohje a për një filologji të tretë?

Le të sjellim ndërmend çështjen e imediatësisë në kohë të gëzimit estetik që vepra e artit na fal dhe çështjen e pandërmjetshmërisë logjike të njohjes a gjykimit estetik.

Filologjia e parë s'ka detyrë të na e ndriçojë këto çështje.

Filologjia e dytë është ndërkaq një njohje logjike dhe analitike. Logjika e *filologjisë së dytë* i kundërvihet alogjizmit të gjykimit estetik. Analitizmi i *filologjisë së dytë* dhunon njësinë organike të tekstit poetik, imediatësisht i perceptuar.

Jemi përballë pyetjes njëherësh elementare dhe fundamentale: në ç'mënyrë teksti poetik, krijimi gjuhësor më i ndërlikuar prodhon imediatësisht dhe alogjikisht efektin e tij, gëzimin estetik?

Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje mund të përbënte shkurt objektin e *filologjisë së tretë*.

Sjellim ndërmend Lasgush Poradecin.

Prej tij e kemi frazën monumentale "gabohen përsëri gabimet e gabuara e shtohen të tjera gabime", për shmangjen e të cilave lind filologjia e parë.

Prej tij kemi edhe nënçmimin e analitizmit në procesit të përjetimit dhe të shqyrtimit të tekstit poetik, por pa të cilin nuk mund të bëjë *filologjia e dytë*.

Prej tij kemi ndër shumë të tjera shprehjen se poezia duhet të jetë e përkryer, e tillë që të ngjallë të njëjtat ndjenja e mendime si sot si njëmijë vjet më pas.

Prej tij kemi së fundi edhe pyetjen që ai shpesh e shtronte në biseda me miq: "Që poezitë e mia janë të bukura këtë e di dhe bufi. Çështja është **pse** janë të bukura?"

Është e qartë se përgjigjen e kësaj 'pse'-je Lasgushi nuk e kërkonte dhe nuk mund ta kërkonte nga *filologjia e dytë*. Ne jemi të bindur, ndërkaq, se përgjigjen e kësaj pyetjeje ai, në mos e dinte, e shihte të mundshme, nga një tjetër filologji.

Nëse *filologjia e parë* – kujdestarja e fjalës ka për mision dashurinë *mbrojtëse,* përkujdesëse, flijuese ndaj fjalës (instinkti mëmësor), nëse *filologjia e dytë* – bija legjitime a ilegjitime e fjalës ka për funksion dashurinë nderuese, kuptuese, përfituese ndaj fjalës (instinkti bijësor), *filologjia e tretë* do të duhej të kishte për mision dashurinë par excellence, njësimin e plotë, atë empatik me fjalën.

Dashuria për tekstin bëhet në rastin e *filologjisë së parë* mbrojtëse e tij; dashuria për tekstin bëhet në rastin e *filologjisë së dytë* gjeneruese tekstesh të tjerë, dashuria për tekstin do të duhej të bëhej në rastin e *filologjisë së tretë* ndriçuese e ligjit a kryeligjit të tij formal.

Filologjia e tretë është dashuruese e fjalës-testament, jo për ta ruajtur (si *filologjia e parë*), jo për ta zbatuar (si *filologjia e dytë*), por thjesht për hir të dashurisë vetë.

Theksohet sot gjithnjë e më fort se i mungon shkencës letrare një parim hermeneutik bazë a themelor, i cili të na lejojë të ndërlidhim në një të tërë të integruar të gjithë instrumentat e pafund të retorikës e poetikës, instrumenta të njohjes racionale të tekstit poetik, dija mbi të cilat është në thelb krejt e panevojshme në procesin e gjykim-gëzimit estetik, që kontakti i pandërmjetshëm, i përnjëhershëm me të na fal.

Dhe a mundet thelbi joracional i fjalës (poetike) të rroket njëherësh racionalisht dhe njëherësh pa ndihmë të metafjalës?

Në tërësinë e korpusit të madh të njohjeve racionale të joracionales, të përafrimeve reduktuese të së pareduktueshmes, a

mundet të zbulohet një njohje racionale, më e pranësishmja ndaj botës poetike, e tillë që të reflektojë a, më saktë, të zbulojë racionalisht në një trajtë elementarisht fundamentale thelbin irracional a më saktë të paracionalizueshëm të kësaj bote?

A mund të hamendësohej se në thelb të strukturës super të ndërlikuar të tekstit poetik qendron një matricë superelementare, veçse jo e një natyre sematike, por formale, më saktë abstrakte e tillë tillë që, nga njëra anë të gjenerojë ndërlikim në të gjitha nivelet e tekstit dhe njëherësh të mundësojë reduktimin maksimal të tij të procesin e kontaktit estetik? Një algoritëm i tipit rekursiv, ta zemë.

Numur, matematikë, algoritën rekursiv?

A mundet që "shtëpia e qenies" të jetë e kuantifikueshme, e matshme, e numurueshme?

A nuk pat thënë Vasili Kandinskij se shprehja më abstrakte e gjithë artit është numri?[1] Numri, thamë dhe jo shifra, pasi, a nuk e pat sqaruar vetëm pak më vonë Stanislav Fumet-ja dallimin fundamental mes numrit dhe shifrës? A nuk pat thënë ai se ekziston një raport mes të dukshmes dhe të padukshmes dhe që ky raport është simboli"? – thelbi i artit, dhe se „e dukshmja rri ndaj së padukshmes si shifra ndaj numrit (fenomen misterioz, i brendshëm, i gjallë dhe i lirë ky i fundit?)

Poezia mund të përkufizohet si **tekst i kuantifikuar dhe apo i kuantifikueshëm harmonikisht.**

A mundet që një dukuri *par excellence* qualitative si ligjërimi poetik të ketë një përbërës a një dimension kuantitativ. Dhe a është e përfytyrueshme akoma më tej që ky dimension kuantitativ të mos jetë

[1] "Format e ndryshme që midis tyre e kanë një "si" marrëdhënie, në të vërtetë, tekembramja, kanë mes tyre një marrëdhënie të rëndësishme dhe shumë të përcaktuar. Dhe, për më tepër, këto marrëdhënie mund të shprehen me një formë matematike, vetëm se këtu do të përdoreshin ndoshta më shumë numra të parregullt sesa numra të rregullt. *Në të gjithë artin shprehja e fundit abstrakte mbetet numri*. Është e qartë që ky element objektiv lind nevojën e arsyes, të ndërgjegjes […] si forcë e domosdoshme *bashkëvepruese*. Dhe kjo objektive do t'i lejojë veprës së sotme që, edhe në të ardhmen, në vend që të thotë "unë isha", të mund të thotë "unë jam".", Vasili Kandinski, *Mbi shpirtëroren në art, Shqipëruar dhe pajisur me një Cadri Forever nga Edi Rama*, botime Përpjekja, Tiranë, 1998, f. 104.

thjesht një aspekti i çfarëdoshëm, por bash themeli a bazamenti i dukurisë?

Dhe, në na turbullon termi kuantifikim, le të përdorim termin pjesëzim, i cili a nuk është në thelbin e vet një tjetër trajtë për nyjëtimin, artikulimin [“gjuha mund të quhet lëmi i artikulimeve„ Sosyr] termin që shenjon, me themeluesin e gjuhësisë moderne, mekanizmin fundamental të ligjërimit njerëzor?

Për këtë arsye mëse elementare teksti është jo vetëm dhe, sidomos absolutisht jo për shkaqe të jashme (të themi të metodës së studimit) i kuantifikueshëm; ai është *per se*, një fenomen i kuantifikuar.

Në këtë vijë, teksti poetik ngushtësisht, ligjërimi letrar në përgjithësi, ligjërimi njerëzor në kuptimin e tërësishëm është sado paradoksale që të duket, një objekt, i privilegjuar madje, i shkencës bazë të kuantitetit, matematikës. Për ta përsëritur edhe një herë: asaj (matematikës) nuk i duhet ta kuantifikojë *per forza* këtë objekt, që lind i kuantifikuar.

Ky realitet fundamental i gjuhës dhe i ligjërimit e bënte Ferdinand de Saussure-n që më 1894 të shprehej: „Madhësitë e gjuhës dhe raportet e tyre janë për hir të natyrës së tyre vetanake të shprehshme në një mënyrë të rregullt në formula matematike.“ dhe të pohonte më tej, kur shtronte problemin e shprehjes më të thjeshtë për konceptet gjuhësore se kjo shprehje më e theshtë ose do të jetë algjebrike ose nuk do të mund të ekzistojë ndryshe. Ashtu si Jakobsoni më 1961-shin, i cili duke iu referuar tezës së Bloomfield-it sipas të cilit „Matememetika është më e mira çfarë gjuha mund të bëjë“, vijonte „nëse matematika përdorimi ideal i gjuhës“ është thjesht një mbindërtim i ligjërimit të përditshëm, duhet që edhe raporti i përkundërt i këtij mbindërtimi dhe i bazës së tij të përfaqësojë për matematikanët dhe për gjuhëtarët në të njëjtën masë një interes të dorës së parë.“[2]

Për të vijuar arsyetimin ne mund të shtonim se ‚këtë interes të dorës së parë‘ më saktë *funksionin e matematikës për a në gjuhën dhe*

[2] Shih: Roman Jakobson, *Die Struktur der Sprache und ihre mathematischen Aspekte*, në: Roman Jakobson, *Semiotik. Ausgeëaelte Texte 1919-1982*, Suhrkamp Verlag, Frankfurt am Main, 1988, f. 437-439.

ligjerimin filologjia do mund ta ndriçonjë a zbulonjë vetëm në procesin e kundrimit të tekstit të organizuar në shkallën më të lartë, të atij poetik.

Pohimin e filozofit, matematikanit dhe estetit gjerman Max Bense, sipas të cilit semiotika, matematika dhe estetika janë në thelb të pandashme nga njëra-tjetra le të përpiqemi ta rilexojmë përmes përkufizimit tonë të tekstit poetik: **Poezia është ligjërim (semiotikë) i kuantifikuar (matematikë) harmonikisht (estetikë).**

Nëse një *filologji e tretë* mund të përfytyrohet a do të ishte me vend të themi se *filologjia e parë* pavetëdijshëm dëshmon domosdoshmërinë e saj, ndërsa *filologjia e dytë* vështirësinë e saj ekstreme?

Nëse një *filologji e tretë* është e mundshme të njëmendësohet, a mund të thuhej se në mungesë të saj, qoftë *filologjia e parë*, aq më fort *filologjia e dytë* kanë operuar që në gjenezë e vijimisht mbi bazë të gjysmëtëvërtetave?

Ruajtja e vullnetit të autorit, kryesynimi i *filologjisë së parë*, a nuk do të ishte një argument që do të fshihte a mbulonte një tjetër synim, më të thellë akoma, më të thellë pse i vetëdijshëm për të cilin edhe autori vetë nuk mund të jetë gjer në fund, shkurt e thjeshtë synimin *për ruajtjen e vullnetit e fjalës, a të ligjit të fjalës më saktë*?

Më tej, nëse ekzistenca e një *filologjie të tretë* është e mundur, a do të ishte e udhës të themi se ajo do të mund të shërbente si legjitimuese, verifikuese, korrektuese, zgjeruese, ushqyese e dy të parave?

Nëse është e mundur të provohet se teksti poetik është ligjërim i kuantifikuar harmonikisht dhe i njohshëm si i tillë, apo, akoma më tej, se tekstin poetik e gjeneron p.sh. një algoritëm i tipit rekursiv, përse sprovat në këto drejtime shihen, më së pakti, dyshueshëm.

A qëndron arsyeja kryesore e këtij skepticizmi refuzues në bindjen se estetika eksperimentale a filologjia e kuantifikimit e redukton së tepërmi kompleksitetin e jashtëzakonshëm të tekstit poetik? Në qoftë kështu, a nuk është e mundur të zbulohen rrugë për zvogëlimin, në mos po për eleminimin e këtij reduktimi?

A mund të ekzistojë pra një filologji e tretë misioni i së cilës do të ishte ndriçimi i *misterit të fjalës*, mister të cilin metafjala nuk mund ta zbulojë?

Ligjërata jonë i afrohet këtu fundit. Me një pyetje? Me të njëjtën pyetje madje, të fillimit? Duke qenë e tëra veç një zinxhir pyetjesh, të themi, një pyetje e madhe e vetme? Po përgjigjja, po zgjidhja e problemit?

Me t'u shtruar pyetja – ka thënë i dituri – problemi a nuk është tashmë përgjysmë i zgjidhur?

Besim BOKSHI

EMRAT E DITËVE TË JAVËS
dëshmi e një gjendjeje të lashtë të fleksionit emëror të shqipes

Përftimin e emrave të ditëve të javës ne e kemi trajtuar shkurtimisht në veprën ***Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*** (1984) në kuadër të shqyrtimit të pozitës së nyjës shquese. Këtë temë po e rimarrim për të shënuar përpjekjet e studiuesve për të zbuluar origjinën e emrave *e enjte, e premte* dhe për të zbërthyer nga forma e emrave të ditëve të javës elementet e një strukture të lashtë të sintagmës nominale e të fleksionit emëror të shqipes brenda kohës së huazimeve të vjetra nga latinishtja. Këta emra janë dëshmi e rrallë e gjendjes kur shqipja kishte mbetur pa mbaresa rasore.

Për emrat e ditëve të javës në gjuhën shqipe Gustav Meyeri është shprehur se ***e martë, e mërkurë, e shtunë*** janë emra të huazuar nga latinishtja dhe ***e diel, e hënë*** - të përkthyera nga kjo gjuhë, ndërsa emrat ***e enjte, e premte*** i konsideroi të pasqaruara.[1] Çabej ka shënuar se "Që në periodën e vonë të ndikimit romak, gjuha popullore ka lentuar (krijuar) emrat e ditëve të javës ***(ditë) e diel, d. e hënë, d. e premte*** pas lat. *dies solis, dies lunae, dies Veneris*, ndërsa ***e martë, e mërkurë, e shtunë*** i mori prej latinishtes, dhe te ***e enjte*** ruajti një emër vendi të lashtë"[2].

Shihet se shqipja për emrat e ditëve të javës nga latinishtja ka preferuar kalkimin, d.m.th. përkthimin: Diell, Hënë, ndërsa ka huazuar kur përkthimi nuk ka qenë i mundur: Mart, Mërkur, Saturn. Duket se shqipja nuk i ka huazuar si emra të përveçëm, por i ka marrë përmes shënimit të ditëve të javës: dita e *Martit*, dita e *Mërkurit,* dita *e Saturnit,* si dita e *Diellit*, dita e *Hënës* etj. pa ditur se ç'është Marti, Merkuri e Saturni.

---

[1] Në Albanesische Studien II, f. 76, sipas E. Çabejt, *Studime etimologjike në gjuhën shqipe,* II, f. 86.

[2] *Studime etimologjike në fushë të shqipes,* I, f. 118.

E enjte, e premte nuk i janë nënshtruar ndikimit të latinishten për t'u zëvendësuar nga emrat përkatës të kësaj gjuhe. Para ndikimit të latinishtes a do të ketë pasur shqipja emra të tjerë të ditëve të javës. Ruajtja e këtyre emrave pa u zëvendësuar nga emrat e latinishtes tregon se shqipja ende nuk i kishte krijuar emrat e ditëve të javës, kështu që emrat e ditëve nga latinishtja nuk zëvendësuan emra të shqipes, sepse zëvendësimi do t'i kishte përfshirë edhe emrat **e enjte** dhe **e premte.** Nga ana tjetër këta emra nuk mund të jenë krijuar pas huazimit të emrave të tjerë, që të konsiderohen si zëvendësues të emrave nga latinishtja, por do të jenë më të lashtë se krijimi i ditëve të javës në gjuhën shqipe. Do të kenë qenë emra shenjtërish në ekuivalencë me emrat e latinishtes Jovi (Jupiteri) e Venus (Veneris), për t'u konsideruar të përkthyer si e Hëna, e Diela, siç mendojnë disa studiues, apo do të kenë shënuar ditë jashtë vargut të ditëve të javës, siç mendojnë disa të tjerë? Çfarë do të ketë qenë ajo që këta emra i bëri shënues të emrave të ditëve të javës në kohën kur të gjithë të tjerët po huazoheshin nga latinishtja; ç'ishte ai kuptim i fuqishëm që nuk la të zëvendësoheshin nga emrat latinë më vonë? Një përgjigje na e jep Ndre Mjedja. Ai shënoi se shqipja ka pasur vetëm emrat e dy ditëve: emrin e ditës së parë të muajit (të hënës së re) ***e premte*** dhe emrin e ditës së fundit të muajit (para hënës së re) ***e enjte***. Kur grekët e latinët krijuan "hepdomas", përkatësisht "septimana" që "doshin me thânë nji rresht shtatë ditësh, jo si pjesë mojit, por si rrjedhje shtatë ditësh" e "Kur ká hî edhè nder vênde tona këjo e dame, kena mârrë êmnat e ditvet prei latinishtes, qi mâ shuma ishin êmnat e rrokullojsvet të diellit, si në "e Shtunë","e Martë","e Mërkurë" e tui perkthye dy tjera:"e Dielle" e "e Hanë", por tui mbajtë atò dy êmna qi kishte moji edhè perpara, do me thânë **"e enjte"** e **"e premte"**. [3]

Këto shënime të Mjedjës për përcaktimin e prejardhjes së emrave të ditëve **e enjte, e premte** kanë nevojë të plotësohen me arsyetimin e kalimit të tyre nga emra që kanë shënuar ditë të caktuara të muajit në emra të dy ditëve të javës, gjë që nuk ndodhi në latinishten ku *kalendat*, *nonat* e *idet* nuk u bënë shënuese të ditëve të javës

[3] Në *Leka*, IV, 1932, f. 351.

Te latinët java ka filluar nga *e shtuna* dhe ka përfunduar me *të premten*: 1. *Dies Saturni*, 2, *Dies Solis*, 3. *Dies Lunae*, 4. *Dies Martis*, 5. *Dies Merkurii*, 6. *Dies Jovis*, 7. *Dies Veneris*[4]. Këto shënime të Mjedjës sugjerojnë që te shqiptarët java të ketë filluar me ditën *e premte* e të ketë përfunduar me ditën *e enjte,* duke gjetur kështu arsyen e kalimit të këtyre nga shënimi i ditës së parë e të mbramë të muajit në ditë të parë e të mbramë të javës.

Emrat **e shtunë** dhe **e dielë** tregojnë se huazimi nga latinishtja ishte bërë kur **Saturni dies** e **Solis dies** nuk ishin zëvendësuar ende nga **sabati** e **dominica** që u sollën nga krishterimi. Emrat e planetëve ishin te romakët emra zotësh, që domethënë se me ta u shënuan ditët e javës para krishterimit, në zëvendësim të *kalendeve*, të *noneve* e të *ideve.* Është shënuar se formimi i ditëve të javës nga emrat e planeteve ishte bërë zotërues që në përfundim të kohës së republikës së Romës.[5] Edhe emri **javë,** që rrjedh nga fjala greke έβδομάς - hebdomas,[6] ka hyrë në gjuhën shqipe, sipas disa gjuhëtarëve, përmes latinishtes, d.m.th. se koncepti i javës ishte krijuar para se latinishtja ta zëvendësonte me emrin **septimana.** Këto e bëjnë të dyshimtë mendimin e Çabejt që emrat e ditëve të javës nga latinishtja të jenë marrë "në periodën e vonë të ndikimit romak".

Në bazë të këtyre që u thanë mund të përfundohet së paku se etimologjitë e propozuara, që i trajtojnë këto dy fjalë si shënuese të ditëve të javës edhe origjinalisht, janë të paqëndrueshme.

Emrat **e enjte, e premte**, që me formën e tyre dallohen nga emrat e tjerë të javës, janë trajtuar nga disa studiues, të cilët kanë dhënë mendime të ndryshme për origjinën e tyre.

Dh. Kamarda, që ka shënuar se ***e enjte*** dhe ***e premte*** janë të një etimologjie të errët, ka shfaqur mendimin për origjinën e tyre. Ai është shprehur se "**ε ήντια** duhet të shënojë *lulësinë* (la fiorita) apo *ditën e luleve* në qoftë se i referohet fjalës *enda* (apo *enta*) dhe *end-ja* (lule), por duke iu referuar fjalës *entos, endon dhe* fjalës shqipe *ende* (khs. br-enda=per-enda) do të shënonte mesin e javës si në gjermanisht

[4] Shih M. Skubic, *Uvod u romansku lingvistiku*, Novi Sad, 1990, f. 95.
[5] Shih M. Skubic, vep. e cit., f. 95.
[6] Sipas E. Hamp-it nga έβδομάδα. Shih E. Hamp, *Fjala **javë**, reduktimi i saj fonetik dhe sintaksa* në Gjurmime albanologjike, SSHF,VIII, 1978, ff. 121-129 dhe në veprën e tij *Studime krahasues për shqipen*, ASHAK, 2007, ff. 363-372.

mittwoch për të mërkurën". Këtu do të mund të përmendej edhe shembulli *sreda* nga gjuhët sllave. Për ***të premten*** shënoi: "emri **ε πρήμπτ-εα**, **-εjα** mund të ketë lidhje me avestishten **πρήμε** *mbrëmë, mbrëmja e kaluar,* prej nga duket se rrjedh folja *premto-je* apo *prempto-je, unë bëj gati, përgatit,* pothuajse *e bej në vigjile* e pastaj edhe premtoj …". Por ai shtoi, nga ana tjetër, se kjo fjalë i referohet rrënjës ***pra***, gr. (πρό, πρωί), **πρόμος**, (πρώίμος), dor. **πράμος**, që është numëror rreshtor ~"**i parë"**. duke përfunduar se "***e premptia*** është ekuivalente me fjalën greke **παρασκενή** si për nga kuptimi ashtu edhe për gjënë e shënuar".[7] Për Treimerin ***e enjte*** lidhet me emrin e hyjnisë së zjarrit ***Enji*** te ilirët.[8] Në *Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike* ka thënë se letrari romak *Enius* nga *Rudie e Kalabrisë* mbante emrin e hyut kryesor të ilirëve (e enjte)). Për ***e premte*** ai u shpreh se "Përmes *të premtes, prémte* na kujtohet një perëndeshë **Prema,** etimologjikisht e lidhur me lat. *premo* e cila të kujton krijimin dhe plleshmërinë"[9]. Karl Oshtiri ka menduar se ***e enjte*** lidhet me ****aisnj-*** (zot) apo me ****axnj-*** (zot i qiellit), e afrueshme me etrusken **Uni** apo me paralatinishten **I-anus**,[10] ndërsa M. Lambertzi e afron me ***En***, që ai e krijoi si emër hyjnie ilire.[11] W. Fiedleri,[12] u shpreh se **En-i** i Lambertzit është "një produkt përsiatës" dhe pajtohet me Çabejn se "Ndërtimet e një hyjnie **Enjti** në mitologjinë shqiptare dhe të një **Eni** për mitologjinë ilire janë pjella e fantazisë".[13] Çabej mbështeti vlerësimin e C. Tagliavinit që këto etimologji e të tjera të ngjashme janë supozime tepër të guximshme, që domethënë të pamundura.[14]

Mendimin e Ndre Mjedjës për ditën ***e enjte*** Çabej nuk e paraqiti drejt kur shënoi: "Mjedja e afron fjalën me gr. e vj. ***ένη*** (scil. **ήμέρα**) "e treta ditë, dita e pasnesërme, e dejmja" dhe se "Mendimi që tek "*e enjte*" fshihet një numëror i hershëm përforcohet edhe nga ana morfologjike, me rrethanën që ndër emrat e ditëve të javës vetëm ***e***

[7] = dita e premte, që përmban edhe kuptimin: përgatitje. *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Ristampa anastatica, Livorno, 1989, f. 110-11.
[8] *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju,* I, f. 32.
[9] Arhiv, I, f. 32.
[10] *Arhiv*, II (1924), Beograd 1925, f. 182.
[11] Në *Wöterbuch der Mitologie*, Studgart, 1970.
[12] *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave filologjike. IV, 1974, f. 195.
[13] Vep. e cit., II, f. 87.
[14] Po aty.

enjte dhe ***e premte*** janë formuar me sufiksin ***-të*** që kanë edhe këta numërorë". Për këtë fjalë Çabej vlerësoi se "Më i mbështetur se gjithë krahasimet e tjera për ne është mendimi i Mjedës, me gjithë kritikat që i janë bërë" nga Lambertzi e Ölbergu.[15] E. Çabej i referohet shkrimit të Mjedjës në *Leka*, IV, 351. Ndërkaq këtu Ndre Mjedja flet për ***të premten*** dhe ***të enjten*** si vijon: "Puna mâ e nevojshme kah moji ishte me dijtë kúr bâte *hâna e re,* pse me tê fillote moji, e si mêrret vesht, ajo ishte e para ditë e mojit. Anì mâ shqip na ká mbêtë émni i ksaj ditës së parë: *e premte* si me thânë *e parmë,* greqisht *pramos, promos;* lat. *primus*… Grekët kanë pasë nji *êmën* edhè për të mbrânen ditë të mojit: *èni* qi do me thânë: "e mbrâmja ditë" asè "dita para hânës së re"… Kjo fjalë ká mbetë edhè në shqipen: *e ênj-te*".[16]

Shprehja: "Kjo fjalë ka mbetë edhe në shqipen" do të thotë se është fjalë e huazuar nga greqishtja e vjetër. Kjo e shton shkallën e dyshimit për vërtetësinë e etimologjisë së Mjedjës, sepse, në qoftë se shqipja e ka pasur të veten fjalën *e premte* me kuptimin "ditë e parë e muajit", ajo do të impononte që ta kishte të sajën edhe fjalën me kuptim të kundërt "ditë e fundit e muajit" e jo ta huazonte nga greqishtja. Huazimi i fjalës **éni,** që në shqipen do të ishte fjalë e pamotivuar, na duket se do të tregonte që edhe fjala *e premte* nuk lidhet me numërorin *e parë* (*e parmë*). Atëherë brenda kësaj etimologjie fonetikisht do të pritej që edhe kjo të ishte e huazuar nga greqishtja (*promos – pramos*), gjë që do të ishte e pasaktë, nga shkaku se nuk është e mundur që pranë emrave të huazuar nga latinishtja, shqipja të ketë huazuar edhe emra të ditëve të javës nga greqishtja e vjetër.

Çabej është nisur nga kuptimi që ka fjala e greqishtes **ένην** që përmend Mjedja në formën **ένη**, "dita e pasnesërme", që domethënë "dita e tretë", nga e cila ka rrjedhur **e enjtja.** Mbasi Çabeji e theksoi kuptimin e ditës së tretë e jo të ditës së fundit të muajit, që e theksoi Mjedja, duhet konsideruar mendim të Çabejt, mbasi, siç u shënua, ky i është dukur më i qëlluari. Për **e premte** nuk dimë që Çabej të ketë dhënë arsyetimin e lidhjes kuptimore me **dies Veneris**. Ndre Mjedja me të drejtë ka vlerësuar se "Âsht nji trillim i kotë ai qi thotë Rossi në fjalorin e vet se *e ejte* do me thanë Giove", pra Jovi - Jupiteri,

[15] Po aty.
[16] N. Mjedja, *Prênd e Prêndë*, *Leka*, IV, Tetuer, 1932, N. 10, f. 351.

Duket se është plotësisht e qartë se *e enjte* dhe *e premte* nuk mund të jenë përkthime të *dies Jovi* e *dies Veneris.* Këtë e përforcon edhe fakti se forma e tyre do të ishte e njëjtë me formën e emrave të tjerë të ditëve të javës e jo e veçantë me **-e** fundore.

Me ***-e***-në fundore e me nyjën e përparme ***e enjte*** dhe ***e premte*** nuk mund të jenë me origjinë emërore. Në këtë përbërje ***-e***-ja fundore mund të ketë qenë vetëm mbaresë gjinie e mbiemrit, i cili do ta kishte pasur edhe formën mashkullore me mbaresë gjinie zero: ***i enjt, i premt.*** Këto fjalë do të kenë qenë në funksion epiteti ndaj emrit *ditë* që në kohën kur nuk ishin bërë ende mbiemra të nyjshëm e kur para mbaresës ***-e*** e kishin mbaresën ***-ë*** për gjininë femërore, ashtu si mbiemrat e tjerë që e dallojnë gjininë edhe me mbaresë: *i kuq – e kuq-e* ← **e kuq-ë*, forma mashkullore (e asnjanëse) e të cilëve përdorej edhe si ndajfolje: *kuq, keq* etj.[17] ***-e***-ja është edhe sufiks feminativ tek emrat e gjallesave, që janë edhe mbiemra, domethënë te fjalët emër-mbiemër: ***fisnik-e, punëtor-e. mik-e*** etj. Këta mbiemra, porse, nuk janë asnjëherë të nyjshëm. Sufiksi feminativ **-e** është transformuar në pjesë të temës tek emrat e veglave të përftuar nga leksikalizimi i invariantit të gjinisë femërore të emrave të vepruesit: **varëse, kapëse** etj. Shihet se **e enjte, e premte** nuk janë të kësaj kategorie emrash. Kështu burimi i emrave të ditëve ***e enjte, e premte*** nga emrat nuk është i mundur, prandaj asnjëra nga etimologjitë e shënuara gjer tani për emrin e ditës ***e enjte***: ***end*** (lule), ***Enji*** (hyjni e zjarrit), ****axnj*** (zoti i qiellit), ***En*** (emër hyjnie) etj. nuk mund të jetë e saktë, ashtu si dhe për emrin ***e premte*** kur mendohet ta ketë pasur kuptimin "***mbrëmë"***-***"mbrëmje"***, apo ***Prema*** (perëndeshë e krijimit dhe e plleshmërisë).[18]

Prapashtesa ***-të,*** si tërë sufiksat jo modifikativë, e përcakton funksionin e temës a të rrënjës: me anë të saj fjala bëhet mbiemërore. Kjo do të thotë se kjo prapashtesë mund t'u shtohet emrit, foljes, ndajfoljes, numërorit themelor, për t'i transformuar në mbiemër. Por të gjithë mbiemrat me prapashtesën ***-të*** janë mbiemra të nyjshëm, që nuk e shënojnë gjininë me mbaresë, që do të thotë se ***-ë***-ja e kësaj prapashtese (***-t-ë***) nuk ishte mbaresë gjinie që të zëvendësohej nga

[17] Shih *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, botim i dytë, Prishtinë, 2005, f. 85-101.

[18] Mendimi tjetër i Kamardës se ***e enjte*** mund të lidhet me ndajfoljen ***ndë*** (endë) kundërshtohet edhe nga pengesa të pakapërcyeshme fonetike.

mbaresa ***-e*** (***-t-e***), por ishte pjesë e prapashtesës. Si e tillë ajo nuk do të kishte arsye të kalonte në (***-t)-e*** tek emrat e ditëve të javës ***e enjt-e***, ***e premt-e***, të cilët formën më të lashtë e kanë me ***-t-ë,*** ku ***-ë***-ja zbulohet si mbaresë gjinie me faktin se është zëvendësuar nga mbaresa ***-e***. Tek emrat e gjallesave që nuk kanë edhe përdorim mbiemëror si p.sh.: kunat-ë, zog-ë, plak-ë e ndonjë tjetër, **-ë**-ja është vetëm sufiks feminativ e jo edhe mbaresë gjinie, prandaj nuk është zëvendësuar nga mbaresa dhe sufiksi feminativ **-e**, si te fjalët bikategoriale emër-mbiemër që shënuam më lart: *fisnike,punëtore, mike* etj. Nga kjo që u tha shihet se tek ***e enjte, e premte*** (apo ***e enjëte, e premëte***) nuk kemi të bëjmë me prapashtesën ***-të*** mbiemërzuese, siç ka pandehur Çabej,[19] por kemi të bëjmë me një ***-t*** të rrënjës dhe me ***-ë*** më të lashtë si mbaresë gjinie, të zëvendësuar më vonë nga mbaresa ***-e,*** në opozicion me mbaresën zero të formës mashkullore të mbiemrit: ***i enjt, i premt***. Mbasi askund tjetër nuk është bërë kalimi ***-të > -te,*** pse do të bëhej tek ***e enjte, e premte***? Format me ***-ë***, që janë përdorur rrallë aty këtu e që përdoren në çamërishte e në Salaminë mendoj së nuk duhet konsideruar trajta që e kanë ruajtur formimin e lashtë me mbaresën ***-ë*** të gjinisë, mbetur pa u zëvendësuar nga mbaresa ***-e,*** por duhet konsideruar të përftuara vonë në këto të folme për analogji me emrat e ditëve të tjera të javës: **e hënë, e martë** etj.

Ndre Mjedja në artikullin e shënuar ka sqaruar se trajta e shkodranishtes "e prênde ka ardhë prei trajtës e premte" dhe se nga kjo janë krijuar emrat e personave: Prênd për meshkuj e Prêndë për femra ashtu si Frâng e Frângë, Ndoc e Ndoce, Ton e Tone. Këta emra njerëzish, që edhe nga përbërja fonetike duket se janë relativisht të lashtë, janë formuar në kohën kur forma e emrit të ditës ishte me **-ë**: *e premtë* e jo me **-e :** *e premte,* sepse atëherë forma e emrit femëror do të ishte *Prênde,* siç janë emrat Ndoce e Tone. Kuptohet se emri i mashkullit **Prênd** nuk është formuar nga trajta *premt* që nuk ka shënuar ditën e javës, por do të jetë krijuar pasi janë krijuar emrat e ditëve të javës, pasi ishte krijuar emri Prêndë. Tek emrat e njerëzve (Prênd e Prêndë) -ë-ja është sufiks feminativ si tek emrat kunat~ kunatë, plak~ plakë etj., të cilët nuk kanë edhe përdorim mbiemëror, prandaj nuk kaloi në sufiksin -**e**. Kështu emri Prêndë na dëshmon se emri i ditës përkatëse ishte me **-ë** (e *premt-ë,)* që u zëvendësua nga -**e-**

[19] Po aty.

ja**,** sepse kjo fjalë, ende pa shënuar këtë ditë të javës, ishte mbiemër (pa nyjë të përparme).

Kështu përjashtohet edhe mundësia që këta emra të ditëve të javës të lidhen me numërorët **e parë** (*e parmë* për *e premte*), siç ka menduar Mjedja, apo shumë më herët Kamarda nga *promos, pramos*, ***ένη*** (tre), siç ka menduar Çabej për ***të enjten*** dhe ***προπο-*** (pesë), siç ka menduar Oshtiri për ***të premten.***

Pengesë për të pranuar etimologjinë e Mjedjës është edhe fakti se si mbiemër rreshtor (e parme) s'do të kishte pse ta merrte prapashtesën -**të (***e premtë),* ndërsa pengesë për të pranuar etimologjitë e Çabejt e të Oshtirit nga numërorët e shënuar është edhe fakti që dy ditë njëra pas tjetrës ***e enjte, e premte*** nuk mund të lidhen njëra me numrin **tre** e tjetra me numri **pesë**. Edhe për këtë arsye së paku njëra prej tyre është e pasaktë. Lëre që shënimi me numrat *tre* e *pesë* nënkupton se **e enjte, e premte** janë krijuar kur u krijua java shtatëditëshe, gjë që, siç u shënua, del e pambështetshme. Emërtimi i ditëve të javës me numërorë do të kishte qenë kriter, që do të thotë se kështu do të ishin krijuar edhe ditë të tjera dhe zëvendësimi me fjalët e latinishtes do t'i kishte përmbledhur të gjitha. Kështu edhe nga kjo anë shënimi me numërorë i ditëve të javës në gjuhën shqipe del i paqenë.

Oshtiri tingullin ***-t-*** te ***e premte*** nuk e konsideroi prapashtesë, gjë që, siç thamë, është orientim i drejtë për të zbuluar etimologjinë e këtyre dy fjalëve. Por Oshtiri këtë ***-t-*** e pandehu të përftuar nga emri **ditë** në përngjitje me numrin pesë: ****prō/epn > prōm*** (***pn > m***) ***> preme + ditë > premdtë >premtε*** (a ***e premte***) si në ***so-ditë > sot*** me kuptimin **dita e pestë "Freitag"** ashtu *si edhe te* ***e kremtë*** (apo ***e kremte***) me kuptimin ***ditë feste "Feiertag"***.[20] Kjo etimologji e Oshtirit për ***të premten*** është ndërtuar nga disa supozime të paarsyetueshme: Kështu, për të përftuar tingullin ***-m-,*** formës ***prō/ep-*** iu desh t'i shtonte ***në***-në e kallëzores së shquar njëjës ****prō/ep-n-*** pasi në shqipen ***pn> m*** si te ****supno- >gjumë*** etj. Praninë e mbaresës së kallëzores së shquar **-në** e kishte menduar H. Pederseni për emrin e ditës **e diel.** Ai ka shënuar: "**tə díel'ə** përket te **díeł**, ngase **tə hənənə** është thjesht akuzativi i **hənə**, kështu në **díel'ə** s'mund të pritet gjë tjetër pos akuzativit **díeł**, pra ***díełnə**. Emrat e ditëve të javës zakonisht dalin si

[20] *Arhiv*, II, 1925, f. 182-3.

përcaktorë të kohës në akuzativ; forma nominative **e díel'ə** është natyrisht formë e re. **tə díel'ə** është rasti i vetëm i ndërrimit mes **ł** e **l'** në deklinacion".[21]

A duhet të trajtohet kështu edhe përftimi i formës **diel** (diellnë > diel) për **diell,** që dëshmohet në të folmet e fshatrave të Atikës: Kouvarás, Kioúrka, Áno Liósia, Mándra etj.[22] e në të folmen e Fakovarës të Provincës së Kozencës.[23] Kjo formë ka një difuzion tepër të kufizuar, larg fushës së gjerë dialektore të formës **e diel(ë),** prandaj duket se në të folmet e shënuara është përftuar nga ndikimi i formës së ditës **e diel : diell → e diel : diel.** Neve na duket se vetëm kështu do të mund të sqarohej pse nuk u bë kalimi -ll > -l edhe tek emrat e tjerë si *miell, qiell* etj.

Përveç formës **e diel** (*e dielë*) përdoret edhe forma **e dillë, dita e dillë** në gegërishten verilindore e në mjaft të folme të gegërishtes. Kjo duhet konsideruar formë primare (**e diellë**) e pandikuar nga forma e shënuar e kallëzores. Forma me **-ll-** është ruajtur edhe në disa të folme arbëreshe, si p. sh. në të folmen e Qanës (rrethi i Kozencës): **e djella[24], e dieła, t'diellen, e diell-ja –** në Provincën e Potencës – Kalabri.[25] Duke qenë pra se forma **e diel** është më e re se **e diellë** dhe jo e tërë shqipes, mbaresa e kallëzores së shquar njëjës -**në** nuk mund të ishte shtuar në kohë aq të lashta sa pretendohet me formën ***prō/ep-n-** për *të premten*. Si mbaresë shquarsie -**n**-ja është përftuar, siç dihet, përmes fazave **-nt- > -nd- > -nn- > -n,** kështu që në kohën e formës së menduar nga Oshtiri ***prō/ep** kjo mbaresë shquarsie e kallëzores nuk mund ta ketë pasur formën **-n.**

Pse formës së evoluar të kallëzores, që, sipas Oshtirit, qenka përgjithësuar për të gjitha rasat (**të preme, e preme**) iu përngjit emri **ditë** e jo edhe emrave të tjerë të ditëve të javës? Përngjitja e emrit **ditë**

---

[21] H. Pedersen, *Studime për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2003, f. 39.

[22] Shih E. Hamp, *Mbi dialektet arvanitase të Atikës dhe të Megaridit* në Linguistique balkanique, III, Sofija, 1961 e në *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, 2007, f. 243.

[23] M. Camaj, *Die albaniche Mandart von Fakovara. Alb. im der Prov. Cosenza*, Münich, 1977.

[24] *Dialektologjia shqiptare* VI, f. 460.

[25] Shih M. Camaj, *La parlata arbëreshe di San Constantino albanese in Provinzia di Potenza*, 1993, f. 201 dhe Pasquale Sentari, *Il lessico della parlata arbëreshe di San Constantino*, 2992.

do të mund të pranohej vetëm po të ishte realizuar me të gjithë emrat e ditëve të javës pa përjashtim, sepse do të përdorej parandej në bashkëvajtje me shënuesit e të gjitha ditëve, ashtu siç ka ndodhur në gjuhët neolatine (kujto: fr. *lendi, martedi* etj., ital. *lunedi, martedi* etj.) dhe atëherë nuk do të kishte mundësi që të përdorej prapë emri *ditë* me ta. Nga ana tjetër përngjitja e emrit *ditë* nuk do të mund të bëhej në kohë aq të largët.

Fjala ***pesë*** është çmuar si fjalë e trashëguar nga gjuha e lashtë ie. ****penk^{w}e-*** apo si refleks i një forme parashqiptare ****penk^{w}tja*** a ****pe(n)ktiā*** dhe nuk shihet arsyeja që të ketë pasur edhe një fjalë tjetër për numrin *pesë*, fjalën ***πρõπο-*** të dakishtes. Edhe numrin **tre** shqipja e ka të trashëguar nga gjuha e lashtë indoevropiane *** trej-es**,[26] kështu që s'ka pasur pse ta huazonte nga greqishtja si numëror. Kjo fjalë mund të ishte huazuar jo si numëror, por si shënuese e një dite të javës pa lidhje me kuptimin e numrit tre. Po atëherë do të duhej pranuar e pamundura se disa emra të ditëve të javës u huazuan nga latinishtja, kurse kjo nga greqishtja. Nga ana tjetër kjo sjell edhe nevojën e arsyetimit të zorshëm që java të ketë filluar nga e marta.

V. Orel në fjalorin e tij etimologjik të shqipes[27] për **të enjten** ka pranuar mendimin se kishte një formë më të lashtë **enjtë si** mbiemër me **-të**. Ai thotë se kjo "duket të jetë përkthim nga latinishtja i **Jovis diem,** kështu që **enj-** i shqipes "duhet të jetë një ekuivalent i hershëm në shqip i Jupiterit". Ai shënon supozimin e Treimerit se kjo fjalë "është vijuese e parashqipes ***agni**, që reflekton formën arkaike indoevropiane të fjalës "zjarr"". **Të premten** (f. 343), që del edhe në format **e prempte**, **prende** e konsideron deverbativ nga **premtoj** që kishte kuptimin e padëshmuar "parashikoj, përgatis më herët" dhe paraqet një përkthim të greqishtes **παρασκενή** "të bëhet gati, të përgatitet".

Siç u pa, ne i konsiderojmë të pasakta etimologjitë e gjertanishme për emrat e ditëve **e enjte, e premte**, por, përveç që përcaktuam si më sipër kahet e hulumtimit që nuk sjellin rezultat për origjinën e tyre, edhe vetë nuk jemi në gjendje t'i sqarojmë.

---

[26] Për origjinën e këtyre numrave shih edhe B. Demiraj, *Sistemi i numërimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1997.

[27] *Albanian Etymolog Dictionary*, Boston – Köln, 1998, f. 88.

Përftimi i emrave të ditëve të javës na shpie në një kohë të largët, kur fleksioni nominal i shqipes ishte tepër i ndryshëm nga ky i sotmi a i shqipes së fazës së dokumentuar.

Të gjithë emrat e ditëve të javës në shqipen janë funksionalisht mbiemra. **Dita e hënë, dita e martë, e hëna ditë, e marta ditë**, **e hënë, e martë, e hëna, e marta** etj. janë si **dita e mirë, dita e mbarë, e mira ditë. e mbara ditë. e mirë, e mbarë, e mira, e mbara** etj. Këto forma, duke shënuar ditët e javës, janë të seleksionueshme nga emri **ditë,** prandaj kanë gjini të fiksuar si mbiemra vetëm të gjinisë femërore.

Pederseni vlerësoi se fillimisht emrat e ditëve të javës kanë qenë emra në rasën gjinore.[28] E. Çabej e kundërshtoi këtë vlerësim: "mendimi i tij që *të dielë* të ketë dalë nga genitivi *të diellit*, nuk është i drejtë. Emrat e ditëve të javës në shqipen nuk janë genitive, po mbiemra: *e diel* është një elipsë e *ditë e diel* etj.[29] Nga kjo duket se Çabej konsideroi që edhe burimisht ishin mbiemra, gjë që është e paqëndrueshme, përveç për *e enjte, e premte,* që ne konsiderojmë që burimisht ishin mbiemra. Vetë Çabej, siç shënuam, është shprehur se gjuha shqipe i ka krijuar emrat e ditëve (ditë) **e diel**, (ditë) **e hënë,** pas latinishtes **dies Solis, dies Lunae**. "Pas latinishtes" do të thotë se edhe shqipja i ndërtoi duke e respektuar vlerën gjenitivale të këtyre emrave të përveçëm me mjetet e veta, d.m.th. duke e ruajtur kuptimin: dita e Diellit, dita e Hënës. Forma e gjinores së asaj kohe të fjalëve *diell* e *Hënë* ndikoi që të reflektohen si forma të gjinores në gjuhën shqipe edhe ato të emrave *Mart, Mërkur, Saturn,* që nuk i kishte shqipja, prandaj emrat e tyre do të vinin edhe në gjuhën shqipe në formën e rasës gjinore të atëhershme.

Mendimin se kemi të bëjmë edhe fillimisht me mbiemra Çabej e shoqëroi edhe me renditjen **dita e hënë, dita e diel** etj. si dhe në latinishten: **dies Lunae**, **dies Solis** etj. Gjuhët neolatine i kanë ditët e javës të përftuara nga renditja **Lunae dies, Martis dies, Merkurii dies** etj. në latinishte. Renditjen Emër – Mbiemër dhe Emër – Emër në gjinore të re (të sotme) shqipja e ka krijuar pas përfundimit të

[28] Shih *Tekste shqipe me Glosar* në Holger Pedersen, *Studime për gjuhën shqipe*, f. 286.

[29] E. Çabej, *Studime gjuhësore I,* Prishtinë, 1976, f. 125.

huazimeve latine,[30] kështu që ndikimi i latinishtes është më i lashtë, sepse do të vinte përmes renditjes Emër në gjinore – Emër, që e kishte atëherë edhe shqipja.

Ndërkaq edhe mendimi i Pedersenit se p.sh. **e dielë** ka dalë nga forma e gjinores **e diellit** nuk mund të qëndrojë, sepse kalimi i formave **e diellit, e hënës, e martit, e mërkurit** etj. në **e diellë** *(> e dielë),* **e hënë. e martë, e mërkurë** etj. s'ka pasur mundësi të bëhej. Këtu nuk mund të bëhet fjalë pra kurrsesi për rënie të tingujve: *e Diellit → e dielë, e Martit → e martë* etj. Kështu emrat e këtyre ditëve të javës nuk mund të jenë përftuar nga gjinorja që ka shqipja e sotme. Ata na shpien në kohën para krijimit të gjinores së emrave të formuar nga *nyja + forma e dhanores*.

Emrat e pesë ditëve të javës janë të formuar nga emra të përveçëm të gjinive të ndryshme edhe në gjuhën shqipe (khs. Mars – Martis: Marti, Mercurius: Mërkuri, Saturnus: Shtuni, Dielli, Hëna), kështu që nyja e përparme, që është vetëm e gjinisë femërore, nuk ishte e akordueshme me gjininë e këtyre emrave. Kjo do të thotë se kjo nyjë nuk ishte nyjë e tyre. Ajo kështu ekspozohet si nyjë shquese e emrit **ditë** e vendosur në distancë me të me ndërhyrjen e këtyre emrave të përveçëm. Kur nuk përdoreshin këta emra, nyja **e** qëndronte para emrit **ditë** në të gjitha format e paradigmës**: e ditë = dita, së ditë = ditës** etj.

Këta emra e zbulojnë pra gjendjen kur nyja para tyre ishte nyjë shquese e emrit të përcaktuar (*ditë*) e kur ky emër i përcaktuar qëndronte prapa emrit përcaktues:

e │ Hënë │ ditë, e │ Mart │ ditë, e │ Diell │ ditë etj. me kuptimin **dita e Hënës, dita e Martit, dita e Diellit** etj.

Emrat **Hënë, Mart, Mërkur, Saturn, Diell** në këtë funksion të përcaktuesit, të cilin te dëftorët e realizonte forma e dativit adnominal: *e* **│tij │** *shtëpi* etj., tregojnë se shqipja në këtë kohë nuk kishte fleksion mbaresor emëror, që do të thotë se i kishte humbur mbaresat rasore indoevropiane e nuk i kishte krijuar ende ato që i ka sot. Ky funksion

[30] Shih Rruga…, f. 346.

realizohej nga renditja e detyrueshme para emri të përcaktuar. Nga kjo pozitë e këtyre emrave dilte kuptimi përcaktues i përkatësisë, i cili me emra të përgjithshëm do të mund të realizohej vetëm me prani të nyjës shquese a të përcaktorëve të tjerë. Meqë nyja shquese ishte krijuar, gjë që e dëshmon nyja e emrit të përcaktuar që është emër i përgjithshëm (*ditë*), këta emra tregojnë gjendjen kur nyja shquese ende nuk përdorej me emra të përveçëm, e cila do të dilte në atë kohë në pozitë të përparme: **e │së Hënë │ditë, e │të Mart │ ditë** etj. (= *dita e Hënës, dita e Martit* etj.). Edhe mospërdorimi i nyjës shquese me këta emra flet për një kohë mjaft të hershme të huazimit nga latinishtja. Mbasi **e**-ja nuk ishte nyjë e këtyre emrave të përveçëm, kontakti i saj me këta emra mund ta shprehte funksionin përcaktues adnominal të tyre, sepse kjo nyjë shquese e mbante të katalizueshëm emrin **ditë**, të cilit i takonte, kështu që ai mund të mos përdorej, d.m.th. mund të figuronte me ekspresion zero: **e Mart ø** (= e Martit) etj. Nga kjo mundësi, si me të gjitha rastet e dativit përemëror adnominal, ishte hapur rruga për kalimin e kësaj nyje në nyjë të përparme pa efekt shques, siç është paraqitur në veprën Rruga… (ff. 452-462). Me emra të përgjithshëm konstruktet e tilla me nyjë zero të emrit përcaktues e të përcaktuar kalonin në kompozita të tipit *mëmëdhe, atdhe, hekurudhë* etj.

Emrat e ditëve të javës tregojnë se nyja shquese e emrave përcaktues të përveçëm (Mart, Mërkur etj.) nuk u përdor gjithë kohën sa ishte prepozitive ndaj emrit, d.m.th. edhe kur nyja kishte kaluar në përdorim edhe me emra të përveçëm jashtë këtij përdorimi përcaktues gjenitival. Kontakti i nyjës **e** me këta emra kishte mbetur që atëherë i pacenueshëm në vazhdim të gjendjes së shënuar origjinale, kështu që bashkë erdhën e përbënë një konstrukt sintagmatik arkaik, jashtë zhvillimeve sistemore që ndodhnin në segmentet e sintagmës nominale.

Kontakti i këtyre emrave me nyjën mbeti i pacenuar edhe nga shkaku se me këta emra, si të përveçëm që ishin, nuk përdoreshin mbiemrat (apo kishin përdorim përjashtimor), të cilët do ta prishnin që në fillim këtë kontakt, ngase do të qëndronin para këtyre emrave e prapa nyjës **e**. Dihet se edhe gjuhët neolatine, përveç portugalishtes, në formimin e emrave të ditëve të javës: it. *lunedi, martedi, mercoledi* etj., fr. *lundi*, *mardi, mercredi* etj. nuk e lejuan përdorimin e nyjave bile as me emrin *ditë* në vijim të gjendjes në latinishte. Por kur nyja **e**

e humbi kuptimin konkretizues ndaj emrit *ditë* e kur ky kuptim u ruajt vetëm në kontakt me emrin përkatës, d.m.th. kur u krijua renditja **e hënë e ditë, e mart e ditë, e diell e ditë** etj., format **e hënë, e mart, e mërkur, e saturn, e diell** nuk mund ta kishin më interpretimin si gjinore, sepse kishin mbetur tepër të dallueshme nga gjinorja e të gjithë emrave të tjerë, d.m.th. edhe nga gjinorja e emrave të përveçëm prej të cilëve u krijuan (khs. *e hënë* dhe *e së Hënë* "e Hënës", *e mart* dhe *e të Mart* "e Martit" etj.). Këto forma tani nuk ishin më gjinore të emrave të përveçëm, por shënonim ditët e javës. Në krahasim me grupin nominal të kësaj kohe: **e mirë e ditë** etj., **e hënë** në **e hënë e ditë** funksionalisht do ta kishte vlerën e mbiemrit, sepse tani mund të interpretohej vetëm si segment që ishte në të njëjtën rasë me emrin pasues, gjë që e siguronte forma e njëjtë e të dy nyjave: **e** (*hënë)* **e** (*ditë):* e para - nyjë e përparme pa efekt shques, që bënte që **hënë** të mos shënonte më **Hënën**, por ditën **e hënë**, e dyta - nyjë shquese prepozitive: **e ditë = dita**. Nga kjo kohë ato do të ndjekin zhvillimin që e pësojnë mbiemrat:

e mirë e ditë → e mira ditë
e hënë e ditë → e hëna ditë,

prandaj do të imponohej edhe një adaptim përkatës i temës sipas gjendjes te mbiemrat nën presionin e nyjës së përparme **e:** temat që përfundonin në bashkëtingëllore, si pasojë e burimit të tyre nga emrat e gjinisë mashkullore, morën një **-ë: e mart → e martë, e mërkur → e mërkurë, e shtun → e shtunë, e diel → e dielë** (ortografisht: *e diel*). si mbiemrat e tipit **e mirë,** që e realizojnë gjininë vetëm me anë të nyjës, pa dyshim nën ndikimin e trajtës së shquar: **e marta, e mërkura** si **e hëna** që u krijua pas aglutinimit të nyjës shquese.

Këto forma të shquara e të pashquara kishin kuptim sintagmatik, sepse përmbanin kuptimin e emrit **ditë**: është **e hënë**, **e hëna** etj. dhe prandaj janë shënuese të ditëve të javës përmes funksionimit si mbiemra të substantivuar.

Emrat e ditëve **e enjte**, **e premte** nuk kanë rrjedhur nga gjinore emrash, siç mund të përfundohet nga sa u tha më lart. Ato janë formuar nga mbiemra që në kohën kur nuk ishin bërë ende të nyjshëm,

d.m.th. që në kohën kur qëndronin para emrit *ditë* dhe pas nyjës shquese të këtij emri, e cila gradualisht e humbi fuqinë shquese dhe u bë nyjë e përparme e mbiemrit, siç është trajtuar detajisht në veprat *Rruga* dhe *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike.*

Si përfundim po shënojmë se këta emra na tregojnë se u formuan kur:

1. Shqipja e kishte krijuar nyjën shquese.

2. Nyja shquese ishte prepozitive.

3. Nyja shquese nuk përdorej ende me emra të përveçëm.

4. Shqipja nuk kishte fleksion dezinencial rasor.

5. Shqipja kishte një fleksion rasor të përemrave dëftorë e si pasojë edhe të nyjave, që realizohej jo me mbaresa, por me modifikim të temës.

6. Këta përemra nuk kishin formë të gjinores. Në vend të saj përdorej dhanorja në funksion adnominal.

7. Emrat e përgjithshëm në funksion të përcaktuesit dilnin me formën e nyjës në dhanore (e │ të djalë │ shtëpi, i │së vajzë │vëlla etj.), apo edhe të dëftorit në funksion limitativ (e │(kë)tij djalë │ shtëpi, i │ (kë)saj vajzë │vëlla etj.).

8. Renditja e segmenteve të sintagmës nominale ishte e detyrueshme: nyjë shquese (e emrit të përcaktuar) – emër përcaktues – emër i përcaktuar.

9. Renditja midis nyjës dhe emrit të përcaktueshëm i bënte këta emra të përveçëm përcaktues të emrit pasues me kuptim të përkatësisë: **e │Hënë │ditë, e │Mart │ditë** etj. (= *dita e Hënës, dita e Martit* etj.).

10. Nuk ishte krijuar nyja e përparme e mbiemrit dhe e gjinores.

Lindita TAHIRI

STRATEGJITË GJUHËSORE PËR ANALIZËN E LETËRSISË

Kjo trajtesë nëpërmjet të analizës gjuhësore të letërarësisë të disa llojeve të diskursit ka për qëllim të zbërthejë proceset shoqërore dhe ideologjike të ngërthyera në gjuhë[1]. Synohet të nxiten debate për çështje aktuale të gjuhës së letërsisë në rrethana kur llojet e ndryshme të ligjërimit publik, sidomos gazetaria dhe fushata politike e shfrytëzojnë figurshmërinë dhe tiparet e tjera stilistike letrare me qëllim ndikimi përmes manipulimit dhe kontrollit të shoqërisë. Si ndikon kjo në potencialin letrar të materies gjuhësore të letërsisë?

Kur retorika mekanike e militante atdhetare shfrytëzohet masivisht në ligjërimin politik, a i rikthehet dhe si i rikthehet letërsia shqipe misionit kombëtar i cili historikisht e ka cilësuar atë, përmes himnizimit si rilindësit, përmes dehimnizimit si Konica, përmes promovimit të një ideologjie të caktuar si në socrealizëm, apo përmes refuzimit, shprehjes alternative, dhe cinizmit? A vazhdon lexuesi shqiptar ta shohë shkrimtarin si fuqi publike?

Duke e riformuluar dilemën, në vazhdimësi të artikuluar edhe një gjysmë shekulli pas fitores mbi nacizmin, se "Si mund të shkruhet e si mund të mendohet pas Auschwitz-it", si dhe sa mund të mendohet, të flitet e të shkruhet letërsi pas gjenocidit zyrtarisht të papranuar mbi shqiptarët e Kosovës? Sa ofron gjuha mundësi për ridefinim dhe vetërealizim, dhe a është kjo më e mundshme në realitetin fiktiv, apo në realitetin faktik, të gjuhës propaganduese politike?

[1] Analiza e ideologjisë së konstruktuar në tekst dhe e pozitave dominante që i krijon teksti për lexuesin është zakonisht objekt studimi i stilistikës kritike, dhe, në rastet kur shqyrtohet konstruktimi gjuhësor i ideologjisë të ndasive gjinore, me këto çështje merret stilistika feministe. Një nga gjuhëtarët më të njohur që sidomos është marrë me rolin e strukturave linguistike në konstruktimin e ideologjisë të medias është Roger Fowler (shih p.sh. "Language in the News", Discourse and Ideology in the Press, Routledge, 2003).

Në ndërlidhje me këtë, si ndikon nëpërkëmbja e prestigjit të standardit në gjuhën e letërsisë? Identifikimi i standardit të shqipes me mendësinë ultratotalitare, apo konkretisht në Kosovë me mendësinë anti-multi-etnike, anti-multi-kulturore dhe anti-divresitet europian, a hap shtigje për kreativitet letrar dhe në ç'drejtim e çon letërarësinë?

Së fundi, cila është dobia praktike e analizës gjuhësore gjatë leximit dhe mësimit të letërsisë? Në qoftë se përqasja gjuhësore ndaj letërsisë e shton ndjeshmërinë e nxënësve në shkolla ndaj përdorimit të gjuhës, sa i aftëson ata që ta vërejnë letërarësinë në tekste të llojllojshme dhe jo vetëm në ato që konvencionalisht konsiderohen letërsi? Përmes kësaj strategjie të analizës gjuhësore letrare a aftësohet individi t'i rezistojë vetëdijshëm tekstit të kulturës kolonizuese? A u hap mundësi individëve leximi kritik i letërarësisë në gjuhë që t'i rezistojnë shfrytëzimit përmes manipulimit gjuhësor?

Pyetja që e përshkon këtë tekst është se si e realizon letërarësia lirinë e mendimit në gjuhë.

Analiza e letërarësisë dhe strukturat e ideologjisë në gjuhë

"Tani Kosova ja liri, ja vdekje"[2] është titulli i shkrimit të Andrea Stefanit, një publicisti që analizon aktualitetin politik rreth përcaktimit të statusit të Kosovës.

Kjo fjali e shquan funksionin deiktik të gjuhës, me tiparet e gjuhës që e orientojnë ligjërimin e folësit në kontekstin përkatës dhe që e përcaktojnë referentin sipas raportit të krijuar me bashkëfolësit. Orientimi ligjërimor bëhet nga aspekti kohor, me ndajfoljen e kohës (tani), nga aspekti hapësinor, me emrin e përveçëm (Kosova), dhe nga aspekti i raportit emotiv dhe njohës ndaj situatës folëse, që del përmes shprehjes pothuaj proverbiale të frazeologjisë patriotike të përdorur kësaj here me radhitje të anasjellë (ja liri, ja vdekje). Pozicioni fillestar i ndajfoljes 'tani' i jep efekt dramatik madje dhe solemn thënies, dhe ndjenja e ngutësisë dhe menjëhershmërisë e transmetuar përmes kësaj ndajfoljeje përforcohet me bashkëlidhjen e tre gjymtyrëve të para në një tërësi të pashkëputur (tani Kosova ja liri) pa ndërhyrje me folje,

[2] Andrea Stefani, 31 tetor 2007, Zemra shqiptare.

për shkak të pozicionimit të emrit si kryefjalë, si për shembull (Kosova pret, Kosova kërkon), me parafjalë (në Kosovë) apo me presje (Tani Kosova, ja liri). Dramacitetin e përftuar nga ky kohezion sintaksor e përforcon edhe inversioni i njërës gjymtyrë të klishesë patriotike, që e përmbyll teatralisht thënien, për shkak të kontrastit jo vetëm kuptimor por edhe atij grafologjik- meqë gjymtyra e anasjellë veçohet me presje dhe spikat kundruall pjesës tjetër të fjalisë. Kundërvënia kuptimore dhe vlerore në këtë klishe patriotike është ajo që ia ka dhënë fuqinë dhe efektin gjatë kohës, meqë vetëkuptohet veprimi psikologjik i këtij mekanizmi gjuhësor të përdorur sidomos në gjuhën publike që e ka për qëllim moralizimin dhe propagandën.[3] Prandaj në këtë rast, përdorimi i anasjellës gjatë rimarrjes të kësaj shprehjeje të ngurtësuar e synon ringjalljen e metaforës dhe riorientimin e saj në kontekstin e tanishëm historik e kombëtar të rishfaqjes të kësaj frazeologjie.

Në këtë titull, riartikulimi kreativ i një kushtrimi atdhetar, shndërrohet në gjest ilokucionar të folësit që fton për një rilindje dhe rikuptimësim të një formulimi tanimë të automatizuar. Ky gjest e rizgjon ngarkesën historike të shprehjes të ngurtësuar dhe ironikisht e përkujton nevojën për ta përdorur atë, duke iu rikthyer misionit të stërzgjatur e të papërmbushur kombëtar gjatë cikleve historike, të përsëritura edhe ato sipas klisheve të njëjta, njëlloj si shprehja patriotike.

Në këtë tekst vëmendja e audiencës tërhiqet duke e çrëndomsuar gjuhën dhe duke e shfrytëzuar potencialin e letërarërisë në gjuhë, që rëndom e bën poezia: teksti i shmanget gjuhës denotative, e minimalizon funksionin referencial dhe përqendrohet në domethënien e krijuar në raport me lexuesit. Gjesti deiktik i tekstit është pothuaj vizual: dëftohet 'me gisht' kah Kosova, e dhënë në formë të shquar me paravënien e ndajfoljes 'tani' që thekson ngarkesën e së tashmes, e përshpejton ritmin dhe e forcon shprehësinë e frazës me lidhjen eliptike me gjymtyrën e dytë të parrullës 'ja liri' që përmes inversionit krijon efekt cinik të synimit të zvargur e të papërfunduar të

[3] Një analizë interesante në stilistikën shqiptare lidhur me strategjinë ideologjike të ndërtimit të tekstit është ajo e Rexhep Ismajlit në librin "Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit", Rilindja 1985, Prishtinë (shih "Teksti i Kuvendit të Arbënit", f. 211-241)

përmbushjes të këtij kuptimi, apo më mirë të përmbushjes të kuptimit të gjymtyrës së dytë, lirisë, meqë ajo e para, vdekja, është përsëritur pafundësisht duke e konsumuar kuptimin e frazës dhe duke e detyruar folësin që ta shquajë mosrealizimin e njërës vlerë kuptimore të dyshes të polarizuar. Treguesit gjuhësorë përqendrohen në mesazhin se pikërisht tani Kosova për të satën herë në histori edhe njëherë është e detyruar të zgjedhë vendimtaren "Ja liri, ja vdekje". Organizimi sintaksor i kundërvihet zgjedhjes "Ja vdekje, ja liri" sepse realiteti nuk percepton okupim klasik e as luftë klasike.

Mesazhi i artikuluar tek fjalia "Tani Kosova ja liri, ja vdekje" e zhvendos artikulimin figurativ të misionit kombëtar nga domeni i letërsisë në domenin e ligjërimit që rëndom u vihet në shërbim mekanizmave shtetërorë apo artikulimit të ideologjive të caktuara. Nga një situatë e mëhershme për shqiptarët kur gjuha mediatike ka qenë sinonim i cenzurës njëlloj si të gjitha trajtat e tjera të ligjërimit politik, dhe kur populli i kishte sytë kah i vetmi burim i ndjenjave, idealeve dhe dëshirave të veta, kah letërsia, kah ajo dhe vetëm ajo që ishte në gjendje ta kundërshtojë regjimin politik sundues, sot ndërkaq kemi ardhur në një kontekst të ri ku audienca pret artikulimin e zërit të vet përmes komunikimit masiv. Njëkohësisht, kemi ardhur në një kontekst të ri ku fuqia publike e dikurshme e të qenit krijues e shkrimtar vazhdon, por duke u rishfaqur në një lloj tjetër ligjërimi, përmes atij ligjërimi që letërsia atdhetare e ka kundërshtuar dhe e ka përjashtuar në emër të lirisë, përmes vetë ligjërimit politik.

Një nga përfundimet që mund të dalë nga ky shqyrtim i gjuhës së medias kundruall asaj të letërsisë në raport me artikulimin e misionit kombëtar, mund të jetë ai se më në fund çështja kombëtare u vendos aty ku përket, në ligjërimin politik, duke e lënë gjuhën e letërsisë të lirë nga utilitarizmi dhe të vetëmjaftueshme në universin e pastruar nga misionet. Natyrisht se është e vështirë të flitet për gjuhën e lirë: sikur të përfytyronim një kontinuum të lirisë dhe autonomisë të shprehjes, me njërën skajshmëri të lirisë totale, në këtë pikë të skajshme vështirë se do të mund të vendosej letërsia, artet apo edhe shkenca.

Letërsia si origjinë e gjuhës

Me rikontekstualizimin e kushtrimit të lashtë për liri, cilën liri do ta konstruktojë si imazh mental audienca e shqiptarëve të Kosovës në situatën e tashme të komunikimit gjuhësor, dhe në bazë të cilës përvojë do ta dekodojë semantikisht këtë fjalë? Ligjërimi i figurshëm, këtu del si nevojë, si kod gjuhësor që ka rol njohës në raport me situatën historike kombëtare, dhe njëkohësisht ka rol formues në raport me audiencën. A do ta përjetojë lexuesi çuditshëm të vetmuar emrin e Kosovës në trajtën e shquar, pa praninë e ndonjërës nga shtetet e mëdha e të fuqishme, a do të hutohet nga urgjenca dhe paniku i ndajfoljes 'tani', në kaosin e datave dhe afateve të kumtuara përmes gjuhës politike, a mos ka rrezik ta hedhë poshtë si të vjetruar, të lodhur, dhe të pakohë thënien e ripërdorur patriotike, e ta konceptojë më shumë si kushtrim arkaik se sa si kreativitet të qëllimshëm gjuhësor, pa i ndjerë nuancat konotative të kodit heroik? Si do të perceptohet nga audienca ndjenja e patriotizmit, në kohën kur termi i 'pavarësisë' është nxjerrë në zbritje dhe zbrazje semantike. Sa është bërë viktimë e kulturës masive kjo audiencë, në kohën e mesazheve politike që u gjasojnë reklamave të destinuara për konsumatorët, sa është i gatshëm të interpretojë lexuesi përmes letërarësisë?

Për gjuhëtarin, letërarësia e dëshmon natyrën e proceseve elementare njohëse që e konstruktojnë mendimin dhe gjuhën[4]. Letërsia, duke e shfrytëzuar këtë potencial gjuhësor të kreativitetit e ushqen vazhdimisht procesin themelor të të kuptuarit dhe të menduarit njerëzor. Në diktaturën e gjithëpushtetshme dhe shtrënguese të manifestuar edhe përmes gjuhës së njëtrajtshme si në Shqipërinë totalitare ishte pikërisht shkrimtari (Kadareja), ai që depërtoi në gjuhën e mendimit, atje ku nuk mund të arrinte as Sigurimi komunist. Ishte letërsia ajo që i dha jetë gjuhës në atë botë të mendimit të automatizuar, ishte letërsia ajo që e ushqeu respektin për gjuhën

[4] Një nga teoritë më me influencë në gjuhësinë kognitive është teoria e metaforës konceptuale e gjuhëtarit Lakoff, që e sqaron procesin e të menduarit dhe arsyetimit përmes metaforës dhe metonimisë (shih George Lakoff " Women, Fire, and Dangerous Things: What Categories Reveal abort the Mind", Chicago University Press, 1987, dhe G. Lakoff dhe Mark Turner, "More than Cool Reason", University of Chicago Press, 1989).

intime të njeriut-turmë, ishte letërsia ajo e natyrshmja dhe realja, e jo jeta.

Të shohim një shembull të fushatës publike, ku përsëri letërarësia përpiqet ta ringjallë gjuhën publike të ideologjizuar skajshmërisht: moton e shënuar në fotografinë e kritikut dhe shkrimtarit të njohur Sabri Hamiti 'Njeriu i Kosovës'[5]. Folësi përcaktohet për një formulim që përkujton stilin e gojëdhanave popullore dhe frazeologjinë e tipit Burri i Dheut dhe prandaj ky akt gjuhësor ka gjasa të pranohet më natyrshëm nga audienca. Shquarsia e emrit "njeriu' vepron si metaforë, kur lexohet si përforcim i kuptimit gjenerik të kësaj fjale, dhe njëkohësisht mund të lexohet edhe si metonimi, kur del si shenjë treguese dhe identifikuese e atdheut, Kosovës.

Këto shembuj të kushtrimit për gjuhën e krijimit, për ringjalljen e dinjitetit dhe arsyes kundruall gjuhës së manipuluar të propagandës, mund të shihen dhe të studiohen brenda një sfondi më të gjerë të kontekstit të kulturës së gjuhës publike tek ne, veçanërisht asaj të ligjërimit politik, dhe kjo i tejkalon mundësitë e këtij punimi. Vetëm si shembull dhe si nxitje për studime të mëtejme, mund ta përmendim ligjërimin nganjëherë afatik të figurave publike politike, disa prej të cilave manifestojnë reduktim të përgjithshëm të të folurit, përdorin fjali të gjymta, vështirë e përdorin periudhën dhe sidomos nuk janë në gjendje ta krijojnë periudhën nënrenditëse, ndërsa disa figura të tjera manifestojnë hipergramaticitet dhe organizim të stërngarkuar të fjalisë, të përcjellë me intonacion melodik, por përplot ngatërrime elementare logjike. Të parët nuk janë në gjendje ta artikulojnë atë që e mendojnë, e të dytët nuk janë në gjendje të dëgjojnë e të kuptojnë, gjithmonë sipas simptomave gjuhësore që i kanë dëshmuar studimet në fushën e logopedisë[6]. Siç u tha, një studim i këtillë i gjuhës së sëmurë publike e tejkalon mundësinë e këtij shkrimi, por përmendet si një ndër elementet kryesorë që e përkujtojnë misionin burimor të letërsisë, atë të krijimit të kuptimit me gjuhë. Tek e fundja, shembujt e shkrimtarëve dhe intelektualëve nga më të popullarizuarit dhe më të

[5] Pjesë e fushatës politike, nëntor 2007.

[6] Shih logopeden kroate Dushanka Vuletiç me studimin për elementet e afazisë në gjuhën publike të mediave: "Afazija: Logopedsko-linguistiçki pristup", Shkolska Knjiga, Zagreb, 1996.

respektuarit në Serbi, si Andriqi dhe Qosiqi, që e kanë ushqyer ideologjinë e luftërave serbe kundër Kosovës me memorandume urrejtje-ndjellëse, flasin për fuqinë dhe misionin e gjuhës, në rastin tonë për ta bërë pikërisht të kundërtën, për ta mbrojtur dhe shëruar identitetin gjuhësor që tepër gjatë i është ekspozuar kësaj urrejtjeje.

Klonimi politik i standardit të ri të gjuhës dhe pasojat për letërsinë shqipe

Gjendja e gjuhës së ngulfatur publike dhe raporti i saj me letërsinë komplikohet edhe më shumë me iniciativa të kohëve të fundit për klonimin politik të identitetit të ri kosovar përmes vetëmohimit të identitetit kombëtar shqiptar, që përforcohet me pretendimet për gjuhën e re standarde. Gjuhës standarde në Kosovë po i sulmohet prestigji shoqëror, prestigj normal për çdo gjuhë standarde në botë, dhe po i vishet ngjyrim politik që u shërben grupacioneve me qëllime të caktuara politike e ideologjike. Këto grupe, në emër të vlerave globale dhe diversitetit multietnik e multikulturor, paraqiten si rrënuese të mendësisë totalitare sinonim i të cilës për ta është standardi, dhe si alternativë e ofrojnë përdorimin e gegërishtes si fetishizim të ri, të prezantuar si rikthim të dinjitetit kombëtar. Kështu tërhiqet vëmendja nga problemi kryesor me të cilin ballafaqohemi çdo ditë - mungesa e komunikimit brendakombëtar dhe rrënimi i standardit gjuhësor si identitet i një kombi.

Ashtu siç pohon studiuesi Ardian Vehbiu[7] në një debat të nisur nga "Koha ditore", çështja e rishikimit të standardit, që është proces normal e i vetëkuptueshëm dhe që del nga vetë natyra e gjuhës, sot tek ne po ngatërrohet me çështjen e mungesës së regjistrave apo konfliktit të regjistrave tek folësit që nuk kanë predispozita të mjaftueshme arsimore apo kulturore, dhe si rrjedhojë, ndjehen të margjinalizuar. Çfarë pasojash lë kjo gjendje e standardit në gjuhën e letërsisë?

Po e ilustrojmë këtë situatë me dy shembuj. Poezia moderne shpesh e kombinon vargun e lirë me prozën apo ligjërimin bisedor, dhe rrjedhimisht, si do të ishte kjo e mundshme në mjedisin tonë ku ligjërimi bisedor po reduktohet gjithnjë e më shumë në ligjërim të

[7] "Koha ditore", 20 gusht 2007, fq. 14-15.

shkujdesur që e shtrembëron normën. Apo, si mund të shmanget gjuha poetike nga norma kur vetë shmangja është shndërruar në normë? Meqë në emër të diversitetit dhe demokracisë gjuhësore propagohet uniformiteti dhe reduktimi i potencialit gjuhësor normal të një individi, gjendja e këtillë mund ta rrezikojë rëndë kreativitetin individual letrar. Ky reduktim mund të vërehet për shembull në tekstet e muzikës së popullarizuar, që merren si një lloj i poezisë, dhe të cilat manifestojnë një reduktim të skajshëm të shprehjes normale gjuhësore deri në analfabetizëm dhe në mangësi logjike.

Shembull tjetër do të ishte paraqitja e ligjërimit mendor të personazhit brenda ligjërimit të rrëfyesit. Ka studiues që mendojnë se transformimi i gjuhës në mendim të figurshëm është thelbi dhe esenca e fiktives, është gjuhë që nuk del në asnjë lloj ligjërimi përpos në letërsi. Çfarë gjuhë do të përzgjedhë rrëfyesi për ta shfaqur e jo për ta rrëfyer jetën mendore dhe emocionale të personazheve? Në një analizë më të gjatë të prozës të shkrimtarit Mehmet Kraja[8], kam përshkruar organizimin gjuhësor të teknikës letrare të këtij autori për ta prezantuar botën e brendshme të personazhit: rrëfyesi përqendrohet në individualizimin e personazhit duke e konstruktuar stilin e tij mendor brenda gjuhës së vet e jo të personazhit, dhe kështu i shmanget çështjes të raportit të standardit me dialektin, kur përshkruhen gjendjet e mjegullta psikike dhe ato të pavetëdijshme të personazhit. Vetëm në raste të përjetimeve shqisore të personazhit, dialekti i tij jepet përmes insertimit të ligjëratës së drejtë të lirë. Mendoj se kjo ka qenë një zgjidhje fatlume, e ndikuar edhe nga synimi i këtij shkrimtari që të na mundësojë një udhëtim fiktiv në botën e tjetrit pa ndërhyrjen e rrëfyesit, prandaj dhe arrin që t'i shmanget perspektivës rrëfyese autoritare dhe dominuese, tipike për stilin moralizues të letërsisë soc-realiste, përkundër faktit se rrëfen nga një pozicion homodiegjetik.

Për ta ilustruar më tej gjendjen e gjuhës shqipe në Kosovë, pa dalë nga suazat e këtij punimi, të përmendim edhe statusin ligjor të shqipes: sot, me Rregulloret e UNMIK-ut, anglishtja ka epërsi juridike ndaj shqipes, ndërkaq gjuha shqipe dhe ajo serbe ngelin gjuhë zyrtare me status të barabartë në institucionet e Kosovës. Çfarë qëndrimi do të marrë lexuesi i sotëm kosovar ndaj gjuhës së letërsisë shqipe, në një

[8] L. Tahiri, "Monologu: personazhi dhe autori", Qendra e Pen-it në Kosovë, fq. 75-173.

gjendje të këtillë të trajtimit të standardit dhe të trajtimit diskriminues zyrtar të gjuhës së vet amtare, të gjuhës përmes së cilës e formon identitetin e vet?

Së fundi të shohim një shembull të gjuhës poetike: poezinë e Sabri Hamitit, me titullin "Paskajore" dhe me nëntitullin "Dashuria paskajore me shqipen", që shfaqet brenda një teksti teorik[9]. Gjesti i insertimit të diskursit poetik brenda diskursit denotativ përforcohet me rolin metagjuhësor të titullit dhe nëntitullit, si ligjërim për ligjërimin që i kundërvihet ligjërimit represiv të gjuhës. Në rrafsh të mikrokomunikimit, të aktit të shqiptimit të gjuhës poetike, Hamiti e fton lexuesin të bashkëpunojë duke e pranuar shqiptimin e poezisë si pjesë të poezisë, pra, të shërbehemi me terminologjinë e gjuhësisë pragmatike, ai e bën të dukshëm aspektin ilokucionar të aktit të folurit poetik dhe e shquan këtë aspekt në rrafsh të makrokomunikimit, duke i sfiduar kështu shprehitë tipike të leximit të poezisë dhe duke kërkuar nga lexuesi vëmendje të veçantë për analizën e situatës ligjërimore. Gjuha nuk shndërrohet në himn poetik për dashurinë paskajore, por identifikohet me aktin e dashurisë pa skaj.

Përderisa me moton e fushatës politike Hamiti kërkon ta çlirojë diskursin politik nga roli ekskluzivisht propagandistik, me vjershën përbrenda kritikës dhe me fragmentet e stilit bisedor brenda po këtij teksti, si p.sh. "E pra thashë, po ik nga egërsia, nga mërzia e nga mungesat dhe nëpërmjet fantazisë po mërgohem e po strehohem në letërsi, së paku për të gjetur veten. Paradoksi doli se nuk kisha se si të shpëtoja nga vetvetja..." [10]kërkon ta çlirojë diskursin kritik nga roli ekskluzivisht interpretues, ndërkaq, me vetëreferencialitetin e gjuhës poetike përmes titullit dhe nëntitullit të vjershës "Paskajore" kërkon ta çlirojë gjuhën poetike nga roli ekskluzivisht figurativ, duke e demonstruar përmes aktit poetik rilindjen e pandalshme të kuptimeve dhe rikthimin në origjinën e gjuhës.

[9] Sabri Hamiti, "Tematologjia", Akademia e Shkencave, Prishtinë 2005, f. 221.
[10] Po aty, fq. 215.

Kolec TOPALLI

TRYSNIA IDEOLOGJIKE NË STUDIMET PËR HISTORINË E GJUHËS SHQIPE

Shkencat gjuhësore, në periudhën që zë gjysmën e dytë të shekullit XX, kanë njohur arritje të shënueshme në fusha të ndryshme. Për historinë e gjuhës shqipe përfshirja e gjuhëtarëve vendës në këto studime i dha kësaj fushe frymëmarrje të re, ku njohja e thelluar e gjuhës amtare u bashkua me interpretime dhe shpjegime më të plota të materialit gjuhësor, tashmë më të pasur. Arritjet më të mira në këtë periudhë qenë rezultat i bashkërendimit të studimeve të thelluara të fushave të veçanta të shkencave gjuhësore, sidomos i dialektologjisë, tekstologjisë, onomastikës etj., përkrah fushave të njohura të historisë së gjuhës. Ndër këto arritje meritojnë të vihen në dukje:

1) studimet dhe botimet e teksteve të vjetra, sidomos botimi kritik i librit të parë të shkruar në gjuhën shqipe, që u bë burimi më i rëndësishëm lëndor për studimet e historisë së shqipes;

2) studimet në fushë të etimologjisë, si vijuese e një tradite studimore prej më shumë se një shekulli, të cilat njohën plotësime e zgjerime sidomos me shtimin e materialeve burimore të gjuhës shqipe;

3) studimet analitike në fushë të fonetikës dhe të morfologjisë historike, si vijim i punës së nisur nga dijetarët e mëdhenj të shekullit XIX, si edhe botimet me karakter përgjithësues e sintetizues të kësaj disipline;

4) studimet në fushë të dialektologjisë historike dhe të onomastikës, të bazuara në një trashëgim të hershëm dhe në njohjen e thelluar të materialeve të mbledhura në terren;

5) studimet ballkanistike e romanistike, ilirologjike e trakologjike, të mbështetura në shpjegime shkencore dhe në interpretime të reja të të dhënave të gjuhëve të vjetra e të reja të Gadishullit Ballkanik.

Të gjitha këto arritje, pa dyshim të mëdha, janë, në radhë të parë, fryt i atij brezi studiuesish shqiptarë që gjuhësinë e kishin përvetësuar kryesisht në shkolla perëndimore, si: Eqrem Çabej,

Aleksandër Xhuvani, Selman Riza, Mahir Domi, si edhe të tjerëve që u formuan afërsisht në të njëjtën kohë me to në shkolla të ndryshme, por më tepër me studime të thelluara vetjake, si Idriz Ajeti, Rexhep Ismajli, Justin Rrota, Shaban Demiraj, Kolë Ashta, Besim Bokshi etj.

Por arritjet e kësaj fushe do të kishin qenë më të mëdha sikur mbi to të mos kishte ndikuar trysnia ideologjike e regjimit të kaluar totalitar, që shfaqej me forcë në të gjitha shkencat, po sidomos në shkencat shoqërore. Kjo trysni është shfaqur në forma të ndryshme, duke frenuar mendimin e lirë shkencor, që kufizohej nga objektiva të paracaktuara prej politikës dhe ideologjisë së partisë në pushtet dhe dogmatizmit shtetëror.

Në fushën e historisë së gjuhës, ajo shfaqej në kundërshtimin që u bëhej shkollave të ndryshme linguistike të Perëndimit, sidomos drejtimeve moderne të gjuhësisë së shekullit XX, që etiketoheshin si dekadente. Dijetarët duhej të pranonin rolin e vetëm drejtues të ideologjisë së rendit në fuqi, si busulla orientuese për të gjitha fushat studimore; përndryshe, ata nuk mund të punonin në institucionet shkencore dhe nuk mund të botonin asgjë në organet e shtypit, që ishin monopol i shtetit. Rast tipik është largimi i Selman Rizës nga Instituti i Gjuhësisë dhe degdisja e tij në Muzeun e Beratit, që pati si pasojë ndërprerjen e punës shkencore të këtij gjuhëtari, me pasoja negative për gjuhësinë shqiptare.

Politika e ndjekur nga shteti totalitar bëri që studimet e kësaj fushe të përqendroheshin në një numër shumë të kufizuar studiuesish, që punonin në institucionet shkencore shtetërore. Nëse studimet e historisë së gjuhës u përqendruan në aq pak emra sa mjafton një rresht për t'i cituar, kjo ndodhi për arsye se të tjerët përjashta mureve të këtyre institucioneve e kishin të vështirë të merreshin me këtë fushë, nga përndjekja, arrestimet e internimet, nga heqja e së drejtës së botimit, madje, edhe për arsyen e thjeshtë se baza materiale e kësaj pune për një pjesë të mirë të saj ishte e përqendruar, e rezervuar dhe jepej vetëm me autorizime të posaçme nga drejtues administrativë të institucioneve shkencore. Në indeksin e librave të rezervuara futeshin të gjithë ata, autorët e të cilëve nuk pajtoheshin me ideologjinë shtetërore ose ishin të padëshirueshëm për regjimin në fuqi për arsye politike. Në këtë indeks bënin pjesë edhe koleksione të tëra revistash, si "Hylli i Dritës", "Leka", "Visaret e Kombit", "Shêjzat" dhe shumë

të tjera, që ishin botuar para Luftës ose vijonin të botoheshin nga shqiptarë të mërguar. Ky monopolizim arrinte deri atje, sa as "Meshari" i Buzukut, vepra e parë e shkruar në gjuhën shqipe, nuk shitej lirisht nëpër librari. I grumbulluar në mijëra kopje në magazinat e Institutit të Gjuhësisë, ai mund të gjendej vetëm në librari të caktuara, ku shitej me autorizim. E megjithëkëtë, vetëm ky libër ishte i pamjaftueshëm për studime të kësaj fushe. E si mund të studiohet gjuha e Buzukut kur Bibla, nga e cila ka përkthyer shkrimtari ynë i parë, ishte tepër e rezervuar?

Punimet e shumë gjuhëtarëve, emrat e të cilëve ishin të padëshirueshëm për regjimin, mbaheshin të mbyllura nëpër arkiva, ku mund të hynin vetëm njerëz të besuar, të cilët në punimet e tyre ishin të detyruar të mbanin qëndrimin e paracaktuar nga shteti për të gjitha problemet. Trysnia ideologjike shfaqej edhe në mungesën e integrimit të punës shkencore të dijetarëve që punonin jashtë Shqipërisë, të cilët denigroheshin për arsye politike. Sa për shembull kujtojmë se gjuhëtari Martin Camaj nuk mund të citohej, ose lejohej të përmendej emri i tij vetëm për ta kundërshtuar. Një fat të tillë patën edhe gjuhëtarët që për pushtetin në fuqi ishin politikisht të papranueshëm. Emrat e Namik Resulit, Arshi Pipës e Mustafa Merlikës, emigrantë politikë, nuk mund të përmendeshin në studimet albanologjike. Nga informacionet që kemi, ky i fundit kishte bërë gati për botim një fjalor, por fati i tij ende nuk dihet. Një gjuhëtar tjetër, Nikollë Gazulli, që arriti të botojë më 1941 "Fjalorthin e ri", kishte mbledhur edhe 2000 fjalë të tjera, për të cilat deri më sot nuk dihet asgjë, meqenëse autori i tyre u pushkatua pa gjyq që në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist. Ka të dhëna se materiale të vlefshme për historinë e gjuhës dhe fjalorin e shqipes kanë mbledhur edhe studiues të tjerë, si Benedikt Dema, Aleksandër Sirdani, Bernardin Palaj, Viktor Volaj, dhe në fushën e toponimisë Mark Dushi e Gaspër Gurakuqi. Por nga tërë ky thesar vetëm një pjesë e vogël është botuar pas përmbysjes së komunizmit, sepse pjesa tjetër ose ka humbur, ose vijon të mbetet në errësirë.

Frika e regjimit komunist nga intelektualët e përgatitur në shkollat perëndimore që mund të mendonin ndryshe nga dogmat zyrtare, pati si pasojë përndjekjen fizike të tyre. Sjellim si shembull burgosjen e orientalistit të shquar Myqerem Janina në moshën 80-

vjeçare me akuzën "për agjitacion e propagandë". Një fat të tillë patën edhe dy orientalistë të tjerë të shquar, Vexhi Buharaja e Tahir Dizdari, që një pjesë të jetës së tyre e kaluan në burgjet komuniste dhe më vonë u detyruan të merreshin me punë të rëndomta për të siguruar mbijetesën, në një kohë që tërë jetën e tyre ia kishin kushtuar gjuhës shqipe. Një shembull tjetër të këtij persekutimi është Frano Illia, ky Shtjefën Gjeçov i dytë, i cili pasionin e tij për të mbledhur doke, zakone e tradita e pagoi me një kalvar të vërtetë vuajtjesh të pafund, sepse atëherë kur më 1967 dorëzoi për të botuar "Kanunin e Skenderbeut", e thirrën, jo për t'i botuar veprën, por për t'i vënë prangat në duar dhe pas 7 muaj torturash në birucat e Sigurimit të Shtetit, me një gjyq farsë, ku nuk munguan as duartrokitjet, e dënuan me vdekje.

Një fat të tillë patën edhe shumë dijetarë të tjerë, që u lanë në heshtje, u mënjanuan dhe kontributin e tyre shkencor e mbuloi pluhuri i harresës. Për shkak të mbylljes në vetvete, edhe studimet gjuhësore të shkencëtarëve që punonin në trevat e banuara nga shqiptarë jashtë Shqipërisë, si në Kosovë, Maqedoni etj., jepeshin me kufizime të mëdha, duke mbetur kërkimet e tyre shkencore pjesërisht të panjohura e pjesërisht të pashfrytëzuara. E kjo ndodhte kryesisht për arsyen absurde se vendi i botimit të tyre figuronte në ish-Jugosllavi, dikur mikja e madhe, por më vonë armikja e përjetshme e shtetit shqiptar. Vetëm pas viteve '80, kur filloi të ndryshojë kursi politik ndaj shqiptarëve që banonin jashtë kufijve shtetërorë, u bë e mundur përfshirja e kontributit të dijetarëve të trevave kufitare me Shqipërinë në gjuhësinë shqiptare. Për të njëjtën arsye, për shkak të izolimit politik, edhe kontributi i arbëreshëve të Italisë e të Greqisë ishte pak i njohur dhe mundësitë e studimit të tij me kontakte të drejtpërdrejta ishin shumë të kufizuara. Në rrethana të tilla, konferencat shkencore që zhvilloheshin brenda e jashtë vendit, ishin të mangëta në pjesëmarrje dhe në kontribute, meqenëse në to mungonin shumë personalitete të botës shkencore shqiptare, që për arsye politike nuk gëzonin miratim shtetëror për të marrë pjesë në to.

Krahas ndalimeve dhe kufizimeve në fushën e kontributeve të mirëfillta shkencore, dëme të tjera iu shkaktuan kësaj fushe edhe nga mosnjohja e shumë shkrimtarëve e poetëve, veprat e të cilëve përmbajnë materiale të shumta me vlera gjuhësore, që mund të

shërbejnë për ilustrimin e teorive dhe të tezave gjuhësore. Ndalimi i plotë i veprave të Gjergj Fishtës, Faik Konicës, Martin Camajt, Ernest Koliqit, Ethem Haxhiademit, Vinçenc Prendushit dhe shumë të tjerëve ka ndikuar edhe në egzemplifikimin e zbehtë të veprave gjuhësore, të cilat shpeshherë mbusheshin me shembuj të marrë nga shkrime politologësh a gazetarësh pa vlera të veçanta gjuhësore.

Të gjitha këto patën si pasojë që e vërteta shkencore të shtrembërohej dhe objektiviteti i saj të paraqitej i shformuar, duke u mbërthyer në prangat e ideologjisë dhe duke u thyer, ashtu sikur drita kur kalon në një prizëm. Kështu, në të gjithë jetën shkencore vepronte censura dhe filtri ideologjik, që edhe pa pasur organe përfaqësuese zyrtare, shfaqej në formën e autocensurës, meqenëse vetë autorët e dinin çfarë duhej e çfarë nuk duhej, cili autor mund të përmendej e cili jo dhe në çfarë konkluzioni duhej të dilte punimi i tij shkencor, që të ishte vepra e pranueshme nga regjimi në fuqi. Kjo bënte që shumë kontribute, të cilat vetë autorët i gjykonin të papërshtatshme për ideologjinë e kohës, të mbeteshin pa u botuar, të mbylleshin nëpër sirtare e të hynin në rrugën e harresës.

Por me gjithë trysninë e vazhdueshme ideologjike, është meritë e shkencëtarëve që punuan në fushë të historisë së gjuhës, që nuk iu bindën verbërisht politikave qendërzuese e totalitare të regjimit në fuqi. Të pajisur me kulturë perëndimore, në studimet e tyre ata nuk iu kundërvunë shkollave linguistike me të cilat punonte shkenca gjuhësore në të gjitha vendet e tjera. Megjithëse shkollat e gjysmës së dytë të shekullit XX, sidomos të gjuhësisë amerikane, të përfaqësuara nga Sapiri, Blumfildi, Çomski etj., mbetën jashtë vëmendjes së gjuhëtarëve tanë, teoritë e tjera gjuhësore, si ato të gramatikanëve të rinj, neolinguistika e Bartolit e Pisanit, shkolla sociologjike e Sosyrit, strukturalizmi, shkolla linguistike e Pragës etj. ishin të njohura nga historianët e gjuhës dhe parimet e këtyre shkollave aplikoheshin në studimet gjuhësore. Sa për shembull po shënojmë se Eqrem Çabej në studimet e tij etimologjike iu përmbajt parimeve të shkollës "Wörter und Sachen" të Hugo Shuhardtit, megjithëse zyrtarisht ndaj saj është mbajtur qëndrim kritik. Besim Bokshi në veprën "Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes" ndoqi dhe zbatoi në mënyrë tërësore dhe konsekuente parimet e shkollës së strukturalizmit në gjuhësi, e cila gjithashtu ishe e kritikueshme dhe e papranueshme për

ideologjinë marksiste. Studimet dialektologjike u mbështetën dhe zbatuan parimet e shkollës së gjeografisë linguistike të Zhileronit. Mbi parime, modele dhe koncepte të reja shkencore i kanë mbështetur studimet e tyre edhe shumë gjuhëtarë të tjerë, me kontributin e të cilëve shkencat tona gjuhësore në fushë të historisë së gjuhës nuk u shkëputën nga traditat më të mira, të kultivuara qysh në vitet e paraluftës. Kjo është edhe arsyeja që në studimet e kësaj fushe, me përjashtim të citateve të diktatorëve, që qëndrojnë si mish i huaj, prodhimi shkencor i kësaj periudhe nuk ka nevojë të rishikohet në rezultatet e tij themelore, ndryshe nga ç'ndodh me shkencat e tjera shoqërore, sidomos me historinë, kritikën letrare, filozofinë, sociologjinë etj., rezultatet e të cilave, për shkak të trysnisë ideologjike, janë të mbushura me shtrembërime të së vërtetës objektive, si rrjedhim, kanë nevojë të rishikohen me themel.

Pas viteve '90, me rënien e sistemit diktatorial, ra zyrtarisht edhe trysnia ideologjike dhe politike e atij regjimi. E megjithëkëtë, sot pas 15 vjetësh demokraci nuk janë zhdukur të gjitha ndikimet dhe pasojat e politikës totalitare e vetizoluese të sistemit diktatorial. Vërtet shkenca u çlirua nga të qenit "e rezervuar", por kontributi i shkencëtarëve që u ndaluan në regjimin e kaluar, nuk është studiuar sa duhet dhe nuk është përfshirë tërësisht në studimet e historisë së shqipes. Ende ka ngurrime dhe lënie në harresë të autorëve që nuk u përfillën në periudhën 50-vjeçare të regjimit totalitar ose u lanë me qëllim mënjanë. Duke ecur me njëfarë inercie në konceptimin e së kaluarës, ka ende shumë autorë dhe vepra, që deri sot janë ndriçuar vetëm përgjysmë. Edhe ndihmesa e gjuhëtarëve të huaj, sidomos i atyre që u lanë jashtë për shkak të kursit politik, nuk është bërë i njohur sa duhet. Sjellim si shembull rastin e studimeve shumëvëllimëshe të Zef Valentinit për historinë dhe gjuhën shqipe, të cilat deri në vitet '90 ishin tepër të rezervuara dhe vetëm vitet e fundit publiku shkencor mundi të njihej me to pjesërisht. Të gjitha këto ndodhin, sepse në shumë aspekte të jetës shkencore vazhdon mendësia komuniste dhe nuk është dënuar ende sa duhet politika e mbrapshtë që ndoqi për 50 vjet me radhë partia në pushtet, duke përjashtuar segmente të tëra të kulturës shqiptare, emra njerëzish të shquar, kontribute dhe vlera të vërteta shkencore dhe kombëtare.

Për të gjitha këto, brezin e shkencëtarëve të këtij fillimshekulli e presin sfida të mëdha. Me analiza të mirëfillta shkencore duhet të dalë në dritë i gjithë kontributi i lënë mënjanë për shkak të trysnisë ideologjike. Nëpër arkivat e ndryshme ka mjaft materiale me vlerë për shkencat gjuhësore, por ato presin një dorë të kujdesshme e të paanshme, që t'ua heqë pluhurin që i ka mbuluar e t'i nxjerrë nga skutat e errëta në dritë të diellit. Nga informacionet që kam mbledhur në Tiranë, Shkodër e Romë, ka mjaft materiale me vlerë shkencore, të mbledhur ose të krijuar nga dijetarë që janë luftuar nga regjimi i kaluar, por janë të panjohura për publikun. Botimi i këtyre dorëshkrimeve do të bëjë që emrat e autorëve të tyre, pak të njohur, të marrin dimensione të reja dhe pranë tyre të shtoheshin emra të tjerë, të panjohur deri më sot. Këto materiale ruhen nga të afërm të tyre, nëpër shtëpia, arkiva a biblioteka, por, nëse ato nuk shohin dritën e botimit, do të mbeten përgjithnjë të varrosura e të panjohura, duke i sjellë dëm kulturës kombëtare e shkencës shqiptare. Shumë arkiva e biblioteka shtetërore e private, sidomos jashtë vendi, kanë mbetur të pazbuluara për shkak të politikës vetizoluese të 50 vjetëve diktaturë. Në kryeqytetet e vendeve që kanë pasur marrëdhënie të hershme historike me Shqipërinë dhe shqiptarët, mund të ruhen dokumente e dorëshkrime me vlerë për kulturën e shkencat gjuhësore, në veçanti për historinë e gjuhës. Kërkimet duhet të drejtohen sidomos në Romë, Venedik, Stamboll, Vjenë, Dubrovnik e deri në Kopenhagen, ku kohët e fundit kanë dalë në dritë dokumenta me rëndësi për gjuhën e letërsinë arbëreshe.

Për të gjitha këto nuk mjafton pasioni e zelli i individëve që merren me studime të tilla. Është e nevojshme ndërhyrja dhe përkujdesja e shtetit nëpërmjet institucioneve shkencore, me një interesim të gjithanshëm të tij për të mos lënë asnjë kontribut të tillë të mbetet jashtë kulturës sonë.

Shefkije ISLAMAJ

FILOLOGJIA SHQIPTARE DHE TEKSTOLOGJIA

Botimet kritike të veprave të autorëve të mëdhenj dhe studimet e tyre tekstologjike sot janë një mungesë e madhe për historinë e letërsisë shqipe dhe për historinë e gjuhës shqipe

Filologjia shqiptare, me gjithë të arriturat e konsiderueshme, vazhdon të ketë mungesa të ndjeshme në disa fusha të saj. Ajo që i mungon ndjeshëm filologjisë shqiptare janë studimet tekstologjike. Mungesa e studimeve tekstologjike dhe, përgjithësisht, e botimeve kritike e ka rënduar hartimin e një historie të plotë të letërsisë shqipe, shumë të nevojshme për filologjinë shqiptare dhe ka vështirësuar edhe studimet e tjera, sidomos gjuhësore e stilistike. Ka vështirësuar edhe vlerësimet historiko-letrare, kritiko-letrare, teoriko-letrare, krahasimtare, me një fjalë vlerësimet letrare-shkencore në përgjithësi.

Metoda filologjike me përcaktimin e studimin tekstor, me gjetjen e varianteve e paraleleve, me hetimin e burimeve, më në fund me hulumtimin e hollësive biografike etj., përgatit lëndën për studime estetike dhe për të gjitha metodat e tjera me të cilat historia letrare shërbehet sot në studimet letrare. Siç dihet, kushti i parë për çdo shkencë është njohja e objektit studimor. Çdo shmangie nga ky përcaktim sjell rezultate të pasigurta ose kurrfare. Shikuar nga ky anëvrojtim duhet të shtrohen edhe pyetjet: a e njohim dhe sa e njohim letërsinë shqipe? A është botuar ajo e plotë? A e shoqërojnë atë studimet e nevojshme tekstologjike?

Mund të thuhet me siguri se studimet e letërsisë sonë të vjetër, pas fillimeve të mbara me studimet e Sami Frashërit për letërsinë e bejtexhinjve, me studimet e Osman Myderrizit e Abdullah Ferhatit, të Mark Harapit e të Ndre Mjedës, e sidomos të Justin Rrotës, më pas me studimet filologjike shumë serioze të Çabejt, Resulit, Rizës, dhe me plotësimet e tyre nga një numër studiuesish të tjerë si G. Svane, Sh. Demiraj, K. Ashta. M. Camaj, E. Sedaj, R. Ismajli, F. Altimari, Demiraj i Riu, M. Mandala, I. Fortino, A. Omari e të tjerë, sot janë në rrugë të mirë për të krijuar një godinë të qëndrueshme të studimeve

tona tekstore. Megjithatë, në këtë fushë studimesh filologjike na presin ende punë të mëdha e të ngutshme, sepse sado e studiuar dhe e botuar kjo letërsi, ende mbetet shumë për t'u bërë, për t'u studiuar nga ana filologjike dhe sidomos nga ana estetike. Zhvillimi i vonë i degëve si gjuhësi e tekstit dhe kritikë tekstologjike, po edhe ndikimi i faktorëve të tjerë jashtëfilologjikë, janë arsyet shtesë të mbetjes prapa të filologjisë shqiptare.

Botimi i plotë kritik i shoqëruar me studime tekstologjike i autorëve të vjetër, i autorëve të Rilindjes dhe i autorëve të shekullit 20, sidomos të pjesës së parë të këtij shekulli, mbeten prioritete për filologjinë shqiptare, jo vetëm për të plotësuar studimet e kësaj fushe, po edhe për të ndërruar edhe vlerësimet ekzistuese lidhur me aspekte të ndryshme të kësaj letërsie, për autorët, për veprat e për periudhat letrare. Shumë autorë ende nuk janë prekur nga studiuesit; na mungojnë edhe biografitë e bibliografitë e plota, për çka nuk e kemi ende një pamje të plotë ç'është bërë krejt në historinë tonë letrare, as një pamje të vazhdimësisë në fushën e studimeve. Na mungojnë studimet për periudha të caktuara letrare. Ne nuk e dimë çka është bërë në historinë tonë letrare që lidhet me periodikun letrar dhe për shumë dukuri e fenomene të tjera shoqëruese etj. Na mungon edhe një terminologji e metodologjisë.

Mund të thuhet se edhe biografitë e shkruara, sigurisht jo të gjitha, që i kemi për autorët e ndryshëm, shpesh nuk janë të burimeve të sakta a të besueshme. Në disa prej tyre mund të gjejmë pasaktësi të ndryshme, po edhe kundërthënie. Ende nuk i kemi veprat e plota as për autorët që konsiderohen të mëdhenj. Për autorë të caktuar nuk është përcaktuar madje as sa janë origjinalë e sa në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme janë ndikuar nga autorë të huaj. Vazhdojmë të kemi tekste për të cilat ka hamendjesime për autorësinë e vërtetë ose nuk njihet fare autori. Në tekstet tona të letërsisë barten gabimet lëndore për veprat e për autorët. Prandaj mund të thuhet se metoda filologjike, pra edhe tekstologjike, për studimet tona, vazhdon të mbetet metodë e domosdoshme studimi, në të vërtetë mbetet kushti i parë për historinë letrare si shkencë, në rend të parë për të mënjanuar shumë mëdyshje, për të sqaruar shumë paqartësi për autorë dhe vepra, për të përcaktuar autorësi për vepra a dorëshkrime, për të sqaruar origjinalitetin a falsitetin e dorëshkrimeve a veprave të caktuara, sepse

shumë nga ato janë të cenuara nga redaktorët, censorët ose botuesit. Kjo duhet të bëhet për të krijuar lëndën nga e cila duhet të ndërtohet shkenca jonë filologjike.

E kuptuar drejt metoda filologjike në këtë aspekt do të ndihmojë që të ajo të mos kuptohet si grumbullim të dhënash, shpesh të parëndësishme. Ajo duhet të zgjidhë çështjet themelore pa të cilat nuk mund të bëhet asnjë studim i vlefshëm dhe nuk mund të përdoret asnjë metodë tjetër, sepse për çfarëdo ndërtimi duhet lënda bazë dhe këtë e sigurojnë vetëm studimet e mirëfillta tekstologjike.

Sot puna e vlefshme e studiuesve arbëreshë Altimari, Fortino e Mandala dhe e kolegëve të tyre të vyeshëm, në përgatitjen dhe botimin e letërsisë arbëreshe ka hapur jo një shteg, po një rrugë të rrahur mirë për studimet tekstologjike shqiptare në rrafsh të gjerë. Lexuesit shqiptar, sidomos studiuesit shqiptar, po i paraqiten veprat e autorëve arbëreshë, por jo vetëm të atyre, sepse kemi tashmë një botim të vlefshëm, të plotë e të pandryshuar të "Bagëti e Bujqësisë" të Naim Frashërit nga Françesko Altimari, me transkriptim, me përkthim italisht dhe me konkordancat elektronike. Nga po i njëjti autor**1** kemi njoftimin për përgatitjen e botimit kritik të "Këngëve të Milosaos", tri edicioneve të Serafina Topisë se bashku me një edicion elektronik ne cd-rom, përgatitur nga Fiorella De Rosa, ndërkaq nga studiuesi Mateo Mandala kemi veprën e Zef Skiroit, nga Vinçenco Belmonte "Skanderbeku i pafan" në pesë vëllime. Nga Françesko Altimari po përgatiten kompleti i revistave të botuara nga De Rada – "Shqiptari i Italisë" dhe "Fjamuri i Arbërit", dy përmbledhje të rapsodive dhe vepra të tjera historike, kulturore, gjuhësore, arsimore, politike, letërkëmbime etj. Kemi njoftime se në rrugë të mirë për t'u realizuar janë edhe "Gjella e Shën Mërisë virgjër" e Jul Varibobës dhe "Vepra poetike" e Zef Sermbes, të dyja me fjalor elektronik dhe cd-rom.

Kohët e fundit janë realizuar edhe dy punë të vlefshme në fushën e filologjisë shqiptare: Anila Omari – "Pjetër Bogdani *Cunesus prophetarum* (Çeta e profetëve)"**2**, botim kritik, ASHSH, Tiranë, 2005 dhe Bardhyl Demiraj – "Gjon P. Nikollë Kazazi dhe *Doktrina* e tij"**3**, botim kritik, ASHAK, Prishtinë, 2006.

Shfrytëzimi i filologjisë klasike dhe i drejtimeve të reja të filologjisë moderne do të ndihmojë rindërtimin e procesit krijues të shumë autorëve tanë të traditës, do të ndihmojë njohjen e mjedisit

historik e social-kulturor kur shkruan e botuan autorë të caktuar, njohjen e rrethanave dhe kushteve që nxitën ato vepra, njohjen e rrugës dhe problemeve shoqëruese të botimeve, po sidomos çështje të receptimit të tekstit nga lexuesi i kohës dhe nga lexuesi i mëpastajmë, do të ndihmojë gjetjen dhe ndriçimin e të dhënave të rëndësishme e të parëndësishme që lidhen me jetën dhe me personalitetin e autorit, për të krijuar pamjen e plotë lidhur me pjesëmarrjen e tij në jetën kulturore e shoqërore, në të vërtetë pjesëmarrjen dhe ndikimin e tij në krijimin e mendimit intelektual të kohës kur jetoi e shkroi ai. Në këtë drejtim do të ndihmojë shumë sidomos teknika informatike. Zbatimi i teknologjive informatike do të mundësojë që përmes konkordancave të rritet siguria e rindërtimit të një teksti sa më të përpiktë, sa më autentik, për të ndjekur rrugën e vërtetë të procesit krijues të autorëve të marrë për shqyrtim.

II. Për të plotësuar objektivin e vështrimit tonë po shtrojmë pyetjen: a mund të bëhen studime të vlefshme letrare-gjuhësore e stilistike e të tjera pa studime paraprake tekstologjike dhe po përpiqem të jap një përgjigje të shkurtër mbështetur në përvojën time studimore.

E thamë se studimet tekstologjike sot janë të rëndësisë së dorës së parë për vlefshmërinë edhe të studimeve të tjera letrare-gjuhësore. Siç dihet tekstologjia studion historinë e tekstit, historinë e tij letrare e jashtëletrare, historinë krijuese dhe të gjitha momentet që kanë sjellë ndryshimet eventuale të tekstit të caktuar ose dëmtimet, përmirësimet, redaktimet, ndryshimet si rrjedhojë e censurimeve ose nga arsye të tjera objektive e subjektive, të autorit, apo të redaktorëve a botuesve.

Studimi i historisë së tekstit i siguron bazën objektive interpretimit të përmbajtjes dhe të formës së veprës. Historia e tekstit ndihmon që të shihet më mirë, e më thellë dhe në mënyrë tërësore çdo vepër artistike e jo artistike. Parimi krijues metodologjik i tekstologjisë bashkëkohore qëndron në faktin që historia e tekstit nuk studiohet përmes leximit të veçantë të pjesëve të saj, por përmes tërësisë së saj të njësishme. Analiza e varianteve, e versioneve të veçanta apo edhe e pjesëve të veçanta, nuk kryhet në mënyrë të veçuar dhe për ta përcaktuar formalisht tekstin autentik të autorit, por në mënyrë të shtresëzuar me qëllim që të studiohet historia e tekstit dhe të përcaktohen të gjitha etapat e jetës së tij. Prandaj tekstologjia duhet t'i paraprijë botimit dhe jo anasjelltas. Botimet kritike do të duhej të

përfshinin edhe të gjitha variantet e tjera të botuara e të pabotuara, edhe botimet fragmentare, bashkë me sqarimet për kriteret që janë përdorur me atë rast dhe studimet tekstologjike.

Shikuar nga ky prizëm një numër i madh studimesh të kryera në studimet tona letrare e gjuhësore mund të jenë jo të vlefshme nga pikëpamja shkencore.

Pse?

Sepse studimet tona në të shumtën e herës janë kryer mbi tekste letrare joautentike, pikërisht për arsyen e mungesës së botimeve kritike dhe sidomos për mungesën e studimeve tekstologjike. Dhe një punë të tillë po e bëj edhe unë. Ndërkaq, dihet se analiza e veprës letrare duhet të nisë me përcaktimin e tekstit autentik dhe me hulumtimin e historisë së tekstit e pastaj me interpretimin e tij. Studimet tekstologjike janë puna paraprijëse në shkencën e letërsisë, ndërsa tek ne ka ndodhur në të shumtën e kundërta.

Sa për ta konkretizuar problemin e ngritur po i referohem praktikisht përvojës sime në studimin e gjuhës së një shkrimtari të madh kombëtar – Gjergj Fishtës. Siç e dimë vepra e Fishtës këto dy dekadat e fundit ka njohur shumë botime. Për arsyet e gjithënjohura, botimi i saj është bërë me vonesa të mëdha, ndërkaq vazhdojmë të mos e kemi botimin kritik të veprës së tij, pra as studimet tekstologjike, sepse hulumtimi dhe studimi i veprës së tij nga ana kritike, nga ana gjuhësore dhe ajo tekstore, ka filluar me vonesa të mëdha.

Në studimin tonë për gjuhën e Fishtës një kapitull i është kushtuar gramatikës stilistike të Fishtës, në këtë kontekst edhe fonostilistikës. Brenda këtyre çështjeve vëmendjen e kemi përqendruar, pos të tjerash, edhe në modifikimet e qëllimshme fonetike në nivel të fjalës dhe në sekuencat ose përftesat tingullore. Në korpusin e modifikimeve të shumta në nivelin fonologjik, gjatë interpretimit gjuhësor e stilistik të tekstit, ka qenë vështirë të përdallohen me siguri të plotë format në të cilat autori ndërgjegjshëm, nga arsyet poetike e stilistike, shmanget nga etaloni, lëkundet nga forma standarde e gjuhës që përdor në veprën tij letrare. Gjatë gjithë studimit na ka ndjekur dilema nëse, në mungesë të botimeve kritike dhe studimeve tekstologjike, kemi sjellë vlerësime e përfundime të

vlefshme, sepse mundësia për të gabuar në vlerësimet është shumë e madhe në këto raste. Gabime të tilla do të gjejmë, sigurisht, edhe në studimet e autorëve të tjerë gjithmonë nëse studimet nuk paraprihen nga studimet tekstologjike e nga botimet kritike.

Në gjuhën e Fishtës, modifikimet, deformimet ose lëvizjet strukturore në nivelin fonologjik, por edhe në strukturën gramatikore të fjalës janë dukuri e zakonshme. Këto veprime ose këto modifikime janë të natyrës formale, sepse fjala është për rrënimin e organizimit shënjues të tekstit e jo për rrënimin e organizimit semantik. Në një tekst letrar, në një tekst poetik, siç dihet, këto modifikime bëhen me motive të ndryshme ose janë të vetvetishme. Në gjuhën e veprës letrare të Fishtës kemi vërejtur se shumë modifikime ose lëvizje strukturore në rrafshin fonologjik kanë bazë pikërisht motivimin ose nxitjen artistike.

Por shtrohet pyetja deri në ç'shkallë?

Sigurisht se një numër i madh i këtyre modifikimeve janë konsideruar të paqëllimshme, prandaj të pamotivueshme artistikisht, janë konsideruar si gabime, shmangie, pakujdesi ose si joparimësi në përdorimin e gjuhës. Por cilat janë ato? A janë përcaktuar drejt si të tilla, në mungesë të studimeve kritike e tekstologjike? Kemi sjellë përfundimin se motivimi artistik është mbizotërues dhe kjo ka qenë arsyeja, më në fund, pse një veprim të tillë të qëllimshëm të Fishtës e kemi konsideruar të vlefshëm për objekt të një studimi tonë pak më të thelluar. Po sa është i vlefshëm ky mendim? Fjalori i Fishtës që e kemi nxjerrë në formë elektronike na ka dëshmuar se Fishta përdor deri edhe katër a pesë variante a forma fonetike të një fjale. Studimi ynë ka dëshmuar, po kështu, se ky përdorim nuk përligjet gjithmonë me funksionin stilistik, ritmik ose eufonik.

Në studim jemi përpjekur të bëjmë edhe një tipologji të këtyre modifikimeve duke pasur parasysh gjithnjë motivimin artistik të krijimit të tyre. Kemi vërejtur se me këmbimin e fonometaformave të përdorura bie fjala *skjapi, krajlnitë, shkjavi* etj. të formave themelore *cjapi* a *capi* e *krajlitë* e *shkau,* me asgjë nuk ndryshohet informacioni diskursiv i kontekstit, po as i vetë vargjeve. Do të thotë se ndryshimi në organizimin shënjues dhe linjor të mesazhit nuk ka ndikuar në ndryshimin e rrafshit semantik. Kemi sjellë, po kështu, përfundimin se këto modifikime vetëm me një pjesë janë fonetike e fonologjike në

kuptimin linguistik, që do të thotë se vetëm me një pjesë janë përftuar me procese tingullore, ndërsa shumë nga ato janë rrjedhojë e proceseve morfologjike. Si të parat, ashtu edhe të dytat na dalin mjaft të larmishme. (Shih për këtë variantet fonetike *rranë, rrazë, rranë; lumoj, limo;, kaçabet, kaçube; kajmekam, kajmekan; kahmotit, kahmot; kahera, kaherë; kamadoras, kamandoras, kamandorës, kambandores;* ose reduktimet fonetike të karakterit të përgjithshëm a pozicional, siç janë rënia e tingujve *j, q, sh* pastaj *b* e *d*, *n* nga togjet *mb, nd, ngj,* reduktimi i *e*-së në togjet *ie, ue* etj., sidomos rënia e *ë*-së etj. (shemb.: *rrqasë, rrshas* për *rrëshqas, rep* për *rjep, bumllue* për *bumbullue, dhimë* për *dhimbë, da* për *nda, nokah* për *ndokah, grumllue* për *grumbullue, myllë* për *mbyll, gjaka* për *ngjaka n'per* për *nëpër*, pastaj rënia ose shtimi i h-së: *kamos, kjahmet, hecte, hylli, hika, harusha*; modifikimet e ndryshme të një numri fjalësh shumë frekuentuese me funksione të veçanta, si këto: *kanu-ja (kanuni), haru-ja (haruni*); ndërrimi i gjinisë ose numrit të emrave; plumja, qiella, motja, etj.; pastaj zgjerimet në fund të fjalëve të formave tipike gege, si *përkundun, ngujumun (i,e), filluene, suket, arvet*, etj., por edhe vendosja e ë-së në pozita të ndryshme edhe aty ku nuk e gjejmë në të folmet toske; këmbimi i tingujve: rr në vend të r – *arradha, arrsye, rrole*, p në vend të b – mprojtje në vend të mbrojtje etj., k në vend të g – *shtek, prak*, ç në vend të sh – *djelmoça, mërziçem*, s në vend të c – *pelset.* etj.; alomorfet e përftuara fonetikisht (*napin, japin, jepin, ngerdheshë, ngerdhucë, mjegull, ndjegull, nentrasha, nenshtrasha, ndeshtrasha, ndigio, ndigijo, ndigjo* etj.; formantet formuese semantikisht të zbrazëta; rrjedhojat rasore sinonimike (*synit-syut, miqve-miqe, pishave-pishash, druni-druje, nanash-nanave-nanavet* etj.); reduktimet e kushtëzuara, pak a shumë të krijuara si dukuritë dialektore (*njekso (sikur kjo), njeky (sikur ky), s'eperi (prej anës së epërme), s'vendit (prej vendit), s'kthjellti, (përsëkthjellti), shoshoit (shoqishoqit*) etj.).

Në korpusin shumë të gjerë të modifikimeve strukturore të Fishtës nuk është punë e lehtë të përdallohen me siguri të plotë format në të cilat autori ndërgjegjshëm, nga arsyet poetike e stilistike, shmanget nga forma bazë. Për këtë arsye shpesh, kemi qenë të detyruar të ndjekim intuitën tonë gjuhësore, sepse, pos të tjerash, shumëçka që sot e konsiderojmë të gjuhës popullore ose që ka

treguesin e moçme a arkaike në kohën e Fishtës nuk është konsideruar e tillë, domethënë është konsideruar asnjanëse nga ana e stilit. Në këtë kuptim as format si këto: *lukur, likur (lëkurë), djelm, djelmoça, djelmosha, djemoça, djaloça, djalosha (djem a djelm), argjan, argjandë, argjantë (argjend)*. as fjalët si këto *dritore* e *dritësore, balkue* e *balkoj, dardhaçor, dardhaçuer,* etj., në gjuhën e Fishtës nuk kanë shënjues stilistikë, në të vërtetë ato janë leksema asnjanëse gjuhësore. Ato ndihen si stilistike sot jo vetëm në raport me gjuhën standarde, po edhe me gegërishten e sotme. Sidomos janë poetikisht funksionale nëse me to arrihen rimime të një numri sa më të madh të togjeve ose formave.

Në veprën e Fishtës mbeten të pasqaruara shumë shmangie nga standardi i gegërishtes së kohës: nëse janë stilistike apo lëkundje të rastësishme formale, bie fjala, *mundash, mnash, mëndash* për *mëndafsh, rre* për *rrah, lvisë* për *lëvizë, frangi* për *frenxhi,* etj. Si format e shmangura, si format burimore, te Fishta, paraqiten përafërsisht me frekuencë të njëjtë.

Ç'është e vërteta, në veprën e Fishtës ndeshim edhe probleme të tjera jo lehtë të zgjidhshme, mëdyshje jo të vogla në rrafshe të ndryshme gjuhësore. Për këtë arsye studimi i historisë së tekstit të Fishtës, analiza e versioneve, përcaktimi i gabimeve në përshkrimet me dorë, i gabimeve në përshkrimet me makinë, i gabimeve në radhitjen në shtypshkronjë, i gabimeve të korrekturës, i gabimeve e shkarjeve të autorit, përcaktimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të qëllimshme, vëzhgimi i dorëshkrimeve, përcaktimi i shtojcave, përcaktimi i kopjeve, përcaktimi i raporteve të ndërsjella midis kopjeve, klasifikimi i teksteve, pastaj treguesit tekstologjikë, rikonstruktimi i teksteve, datimi i teksteve dhe çështje të tjera në objektivin e tekstologjisë, do të ishin një ndihmesë e madhe për studiuesin e Fishtës. Shkurt, botimi kritik i veprës së plotë të Fishtës dhe studimi tekstologjik do të kishin ndihmuar e lehtësuar shumë studimin tonë gjuhësor-stilistik e studimet e tjera që duhet të ndërmerren në këtë drejtim për Fishtën, po edhe për autorë të tjerë nga studiuesit e tjerë.

Për interpretimin e veprës së Fishtës sot ekziston interesim i madh linguistik, historik, fetar dhe filozofik. Për këtë arsye për fishtologjinë në përgjithësi dhe për filologjinë, botimi kritik i veprës

se tij është domosdoshmëri. Botimi kritik i veprës së Fishtës do të kishte për qëllim rikonstruktimin e tekstit të tij autentik, të botimit të parë dhe hetimin e dorëshkrimeve të tjera eventuale në arkiva të tjerë. Përmes aparaturës kritike do të krijohej pamja e plotë e tekstit të parë, e formës dhe e kuptimit të tij. Botimi kritik do të ndihmonte mënjanimin e gabimeve nga botimet e mëparshme, mënjanimin e ndërhyrjeve të paarsyetuara të redaktorëve të botimeve të mëparshme. Por, për një punë të tillë, për botimet kritike dhe për studimet tona tekstologjike, nevojitet punë institucionale e përkrahur prej shtetit, punë që kërkon kuadro dhe burime financiare.

Ne mund të gjykojmë drejt, objektivisht, pa ia bërë vetes qejfin, për të arriturat dhe shkallën e zhvillimit të filologjisë shqiptare vetëm duke e parë atë në krahasim me shkallën e zhvillimit dhe të arriturat e të tjerëve, qoftë edhe të fqinjëve ballkanikë, grekëve, bullgarëve, kroatëve, serbëve e rumunëve.

Por, fatkeqësisht, si në të gjitha fushat, ne vazhdojmë t'ia bëjmë vetes qejfin, ndërkaq dihet se shkenca zhvillohet në radhë të parë në sajë të vetëdijes kritike për ato që janë bërë dhe për ato që duhet të bëhen.

Fusnotat:

1. Intervistë me Françesko Altimarin, rev. Letrare "Ars" nr.13 Tiranë, 2003.
2. Anila Omari, "Pjetër Bogdani *Cunesus prophetarum* (Çeta e profetëve)", botim kritik, ASHSH, Tiranë, 2005.
3. Bardhyl Demiraj,"Gjon P. Nikollë Kazazi dhe *Doktrina* e tij", botim kritik, ASHAK, Prishtinë, 2006.

Mehmet Çeliku

ARRITJE, PROBLEME DHE DETYRA NË FUSHËN E KËRKIMEVE SINTAKSORE TË SHQIPES

Arritjet e sintaksës tradicionale në studimin e shqipes letrare janë të shënuara. Mund të përmenden këta autorë kryesorë: A. Xhuvani, J. Rrota, I.D. Sheperi, K. Cipo, S. Prifti, M. Domi, S. Floqi. Përveç Floqit, kontributet e tyre në fushë të sintaksës këta autorë i kanë përfshirë në tekste e gramatika kryesisht shkollore, tekste që kanë shërbyer për shkollën fillore, të mesme dhe të lartën. Disa prej tyre, kryesisht Domi e Floqi, por edhe të tjerë të mëvonshëm, kanë punë të veçanta, artikuj studimorë dhe monografi për çështje të përgjithshme teorike të sintaksës si dhe për tema të veçanta të saj. Xhuvani, Rrota, Sheperi dhe ndonjë albanalog i huaj i përkasin periudhës së Paraluftës, ndërsa të tjerët (Cipo, Prifti, Domi, Floqi) asaj të Pasluftës. Arritjet e këtyre autorëve mbajnë vulën e kohës dhe të shkollimit të tyre, në radhë të parë, në universitetet perëndimore si në Francë, Gjermani, Itali, por edhe në Lindje e Ballkan, si Rusi, Greqi etj.

Studimi i sintaksës së gjuhës letrare shqipe fillon në vitin 1922 me tekstin "Njohunit e para të Syndaksës Shqipe, Pjes' e parë për Klasët e Nalta të Fillores" prej A. Xhuvanit, botuar në Vlorë, në Shtypshkronjën "Vlora". Në këtë tekst jepen njohuritë e para të sintaksës shqipe, që, siç e thotë vetë autori, janë një shkurtim e një thjeshtim i leksioneve të sintaksës që u jepeshin nga autori nxënësve të klasës gatimore të Normales së Elbasanit katër vjet para botimit. Xhuvani njohuritë e para sintaksore të vitit 1922, por edhe botimet e mëvonshme i mbështet në një studim të gjatë e të veçantë të shqipes, në frymën e gjuhës sonë, duke shfrytëzuar gjithashtu edhe një literaturë të huaj të gjerë, tekste për shkollat fillore e të mesme të vendeve të ndryshme europiane, botuar në Vjenë më 1913 e 1918, në Paris më 1918 e 1920, në Romë dhe në Milano 1909. Materiali i studiuar nga Xhuvani është mbledhur nga gjuha e shkruar nga shkrimtarët tanë, si nga Sami Frashëri e Kristoforidhi, por edhe nga goja e popullit etj. Për herë të parë në historinë e studimeve sintaksore

të shqipes, në 48 faqe të këtij teksti, trajtohen në mënyrë të përmbledhur fjalia e thjeshtë dhe periudha, tipat kryesorë të fjalive të thjeshta dhe llojet e periudhave, llojet e kallëzuesit dhe të kryefjalës, gjymtyrët e dyta; në tekst trajtohen ndërtimet kryesore të shqipes, përfshirë ndërtimet analitike me parafjalë e me lidhëzat kryesore. Meritë e autorit është se na jep për herë të parë shumë terma të sintaksës, që i kanë qëndruar kohës, dhe se, nëpërmjet disa rregullave e shënimeve, trajton rendin e fjalëve dhe të sifjalive në periudhë si dhe pikësimin.

Njohuritë sintaksore të para të Xhuvanit, vijnë e plotësohen e thellohen më tej po prej tij në "Sintaksa shqipe, Pjesa II", Tiranë, 1934, si edhe nga I. D. Sheperi ("Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe sidomos e toskërishtes", Vlorë, 1927) dhe nga J. Rrota ("Sintaksa e gjuhës shqipe", Shkodër, 1942; "Analyzimi i rasavet t'emnit e zhvillimit historik i tyne", Shkodër, 1931). Tek këta autorë bie në sy vështrimi analitik, më i thelluar i disa kategorive sintaksore, siç është sintaksa e rasave, ose trajtimi i ndonjë çeshtjeje problemore që vazhdon të mbetet e tillë edhe në ditët tona, si edhe informacioni për shtrirjen e dukurive sintaksore në dy variantet letrare të shqipes etj.

Por pas Luftës, në veprën "Sintaksa", Tiranë, 1952 e K. Cipos shënohen arritje cilësore të reja në fushën e kërkimeve sintaksore. Numri i madh i strukturave të vështruara të shqipes, interpretimet teorike dhe materiali gjuhësor i gjerë, niveli i lartë teorik e bëjnë veprën në dy volume të Cipos (bashkë me "Gramatikën shqipe", Tiranë, 1949) një gramatikë akademike modeste të shqipes. Sintaksa e Cipos mund të quhet kodi paraprak i sintaksës së shqipes standarde.

Sintaksa tradicionale, me një shtrirje kohore afër 70-vjeçare, përmbyllet me "Gramatikën e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Tiranë, 1997, 684 faqe, vepër e një grupi specialistësh të mirënjohur, botim i ASHSH. Hartimi i veprës ka zgjatur shumë vjet dhe ka njohur disa botime si maket para vitit 1997. Në këtë vepër dinjitoze bëhen përgjithësimet e arritjeve të mëparshme në fushë të sintaksës së shqipes, nga autorë shqiptarë dhe albanologë të huaj, thellohet ndjeshëm hulumtimi shkencor e njohja e strukturës së shqipes letrare, zbatohen me objektivitet arritjet teorike të huaja, perëndimore e kryesisht lindore, në fushë të sintaksës. Realizimi i Sintaksës së

Akademisë u mundësua falë punës së M. Domit, bashkautor kryesor dhe kryeredaktor i volumit të dytë, por edhe kryeredaktor i Gramatikës së Akademisë në tërësi, i cili kishte botuar më parë, përveç sintaksës për shkollat tetëvjeçare e të mesme (1954; për shkollat pedagogjike më 1966) edhe një tekst të sintaksës së shqipes për shkollat e larta, në formë të një dispence me dy pjesë ("Sintaksa e gjuhës shqipe I, II", botim i Fakultetit të HF, Tiranë, 1972, 1975. Domi kishte botuar ndërkohë edhe disa artikuj me interes të veçantë, ndër të cilët do të përmendim "Çështje të përgjithshme të sintaksës", SF,3,1980; "Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore", SF, 4,1984. Sintaksa e Akademisë u mundësua, së dyti, falë punës së madhe të S. Floqit, një nga specialistët më të mirë dhe më prodhimtarë të vendit në fushë të kërkimeve sintaksore, punë që u kurorëzua me hartimin dhe botimin e disa monografive të para në fushë të sintaksës së shqipes, ku bëheshin objekt studimi tipa të ndryshëm të periudhës (siç janë: "Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme", SF, 1965, 2; "Periudha me fjali të varur kryefjalore në shqipen e sotme", 1965, nr. 3 e nr. 4; "Periudha me fjali të varur shkakore", SF, 1966, nr. 2 e nr. 3; 1967, nr 1; 1973, nr. 2.), si dhe në botimin e shumë artikujve që trajtonin probleme të përgjithshme të sintaksës së shqipes, ose tema të veçanta të saj, siç janë ato për togfjalëshin e për rendin e fjalëve e të fjalive. ("Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme", SF, 1, 1968; "Togfjalëshat mbiemërorë në gjuhën e sotme letrare shqipe", SF, 2, 1981; "Mbi disa çështje të fjalisë së përbërë në gjuhën shqipe", Buletin i SHSH, 1955, nr, 3; "Fjalia e përbërë e bashkërenditur në gjuhën e sotme shqipe", Buletin i SHSH, 1956, 2; "Disa tipa semantiko-strukturorë të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme", në Konferenca e Studimeve Albanologjike (nëntor 1962), Tiranë, 1965; "Mbi disa aspekte të zhvillimit të sintaksës së periudhës në shqipen letrare pas Çlirimit, SF, 1970, 2; "Disa vështrime për rendin e fjalive në periudhë", SF, 1976, 3, e tj.). Kontributi më i madh i Floqit i përket sintaksës së periudhës, themelet e qëndrushme të së cilës ai ka hedhur. Si Domi, ashtu edhe Floqi, ishin njëkohësisht njohës të teorive sintaksore tradicionale e bashkëkohore të Perëndimit dhe të Lindjes. (Domi kishte studiuar në Paris, por ishte edhe njohës e përdorues edhe i rusishtes; ai madje shpenzoi disa muaj për studime speciale në Rusi; ndërkaq dhe Floqi studimet e larta i nisi në

Jugosllavi dhe i përfundoi në Rusi, por përdorte shumë mirë frëngjishten, italishten, serbishten dhe rumanishten etj. dhe kishte një aftësi të veçantë për analiza të holla e të thella dhe një nuhatje e mprehtësi të jashtëzakonshme në analiza e interpretime. Këto detaje ndriçojnë faktin se Sintaksa e Akademisë nuk është mbështetur vetëm në teorinë sintaksore ruso-sovjetike, por edhe në atë perëndimore, megjithëse kjo e fundit para vitit 1990, në rrethana politike të caktuara, ishte e ndaluar për botën shkencore shqiptare. Por, që të jemi plotësisht të saktë, duhet shtuar se gjuhësia ruse ishte gjuhësi e një vendi të madh e me shumë interesa, ishte në nivele të përparuara dhe shfrytëzonte në shkallë të gjerë e flakë për flakë arritjet më të fundit të gjuhësisë perëndimore, duke pasur specialistë si gjermanistë, anglicistë etj, por edhe studiues e botime të shumta jo vetëm për gjuhët e Europës, por edhe më gjerë. Si përfundim, drejtëpërsëdrejti, apo nëpërmjet gjuhësisë ruse, gjuhësia perëndimore ishte e njohur në Shqipëri.

Me interes janë edhe punët e S. Priftit, sidomos dispensa e tij "Sintaksa e gjuhës shqipe,Pjesa I, Tiranë, 1959; pjesa II, Tiranë, 1962 për Institutin Pedagogjik, si dhe disa artikuj ("Klasifikimi i fjalive të varura", SF, 1972, nr. 2; "Përcaktori në gjuhën shqipe", SF, 1977, nr. 1; "Elipsa në sintaksën e fjalisë", SF, 1966, nr. 3; etj. Ky autor shquhet për disa mendime origjinale, por ishte nën ndikimin e sintaksës greke dhe aty-këtu kishte edhe gjurma të logjicizmit.

Sintaksa e Akademisë është vepra sintaksore më e plotë, me një material faktik e ilustrues shumë të gjerë dhe në nivelin më të mirë shkencor që kemi për gjuhën shqipe deri në ditët tona. Ajo u hartua me punë në ekip nga specialistët më të mirë në këtë fushë, përfshirë edhe disa studiues të tjerë më të rinj. Është njëherazi vepër akademike dhe universitare; është përdorur si tekst bazë në universitete për lëndën e sintaksës; gjithashtu kjo vepër është përdorur gjerësisht në dhjetra vite në studime të autorëve të tjerë dhe sidomos në hartimin e gramatikave e teksteve shkollore, nga autorë vendës e të huaj. Së fundi, dëshirojmë të theksojmë se së bashku me volumin e parë, Morfologjinë, Gramatika e Akademisë, përbën një nga tri veprat madhore kodifikuese të shqipes standarde. Kjo vepër përfaqëson një urë kalimi nga gjuhësia tradicionale në gjuhësinë bashkëkohore, e për këtë flasin trajtime aty-këtu sipas metodave e rrymave perëndimore.

Përveç Domit, Floqit e Priftit, në hartimin e Sintaksës së Akademisë u angazhuan edhe disa bashkëautorë më të rinj: R. Përnaska, M. Totoni, S. Mansaku e M. Çeliku.

R. Përnaska ka botuar tekstin "Gramatika e gjuhës shqipe, 2". Për shkollën pedagogjike, Tiranë, 1975 (me bashkautorë); Përnaska, gjuhëtar i përgatitur mirë teorikisht, është marrë për një kohë të gjatë me studimin e kundrinorit, duke botuar për këtë temë disa artikuj si dhe një vepër të rëndësishme, studim i gjerë monografik e me shumë risi, kushtuar kundrinorit, duke e zgjeruar mjaft këtë kategori sintaksore me ndërtime që shiheshin më parë si plotësa; ky autor ka hartuar dy krerë të Sintaksës së Akademisë (kundrinori e rrethanori); Përnaska ka botuar edhe studime për çështje të përgjithshme të sintaksës me interes të veçantë teorik e problemor, si: "Boshti ideologjik dhe lëndët gjuhësore", Revista Pedagogjke, Tiranë, 1972, nr. 1 ("Gjykimi dhe fjalia"); nr. 5 "Disa probleme të studimit të fjalisë (togfjalëshi)"; nr. 6 "Fjalia aspekti dinamik dhe statik"; "Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë dhe gjymtyrëzimi aktual në gjuhën shqipe", SF, 1986, nr. 2, etj. Bie në sy niveli i lartë teorik dhe vështrimi bashkëkohor i çështjeve, çka e ka mundësuar kontakti i gjatë me botën shkencore franceze.

M. Totoni ka hartuar për Sintaksën e Akademisë katër krerë për tema kryesore e me shumë çështje të diskutueshme, siç janë kallëzuesi, kryefjala, përcaktori kallëzuesor etj); është autor i veprës "Periudha me fjali …', dhe i disa artikujve për çështje të përgjithshme të sintaksës, herë-herë për çështje problemore e të kulturës së gjuhës: "Si duhet kuptuar njësia themelore sintaksore, SF, 1970, nr.2; "Çështje të gjymtyrëve të fjalisë", SF, 1981, nr.3, e tj. Totoni ka punuar edhe për hartimin e teksteve shkollore, si "Libri i gjuhës shqipe për klasë VII", Tiranë, 1971.

S. Mansaku ka hartuar për Sintaksën e Akademisë pesë krerë e pikërisht periudhat me fjali të varur mënyrore, qëllimore, kushtore, lejore e krahasore; ka botuar artikuj e studime me interes për ndërtime me folje modale dhe me forma të pashtjelluara të foljes, për mjete lidhëse sintaksore, për pkësimin etj. Ka botuar artikuj për raporte të ndryshme sintaksore të shqipes, për lokucione lidhëzore dhe për Rregullat e pikësimit (si: Format e shprehjes së raporteve kushtore në

shqipen e sotme letrare, SF, 1969, nr. 3; "Ndërtime me lokucionin lidhëzor "në vend që", SF, 1975, nr. 3).

M. Çeliku ka hartuar shtatë krerë të Sintaksës së Akademisë për tema pak të studiuara në traditën tonë, siç janë, ndër të tjera, gjymtyrët e veçuara, fjalitë njëkryegjymtyrëshe, të paplota e të pagjymtyrëzueshme, fjalët, togjet e fjalitë gramatikisht të palidhura etj; ka botuar një dispencë konspektleksionesh nga fusha e sintaksës për shkollat e larta, Gramatikën Praktike (me bashkëautorë), pjesën e dytë të së cilës e përbën sintaksa; vitet e fundit në dy monografi ka vështruar në rrafshin morfosintaksor format e pashtjelluara të foljes dhe të parafjalëve të shqipes, ka botuar edhe një tekst ushtrimesh sintaksore, shoqëruar me shënime teorike, probleme të pazgjidhura të sintaksës shqipe dhe qëndrime alternative, ka botuar edhe disa artikuj për togje e togfjalësha të shqipes etj.

Ndërkaq në Shqipëri, në Kosovë dhe në vende të ndryshme të Europës autorë shqiptarë dhe albanologë të huaj kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin ndihmesa të rëndësishme, duke botuar artikuj, studime, monografi e tekste shkollore nga fusha e sintaksës së shqipes. Këtu mund të radhisnim, ndër të tjerë, emrat e këtyre autorëve:

Th. Rushi në disa studime ka bërë objekt një temë shumë të rëndësishme siç është ajo e rendit të gjymtyrëve ("Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore", SF, 1983, nr. 1; "Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe", SF, 1983, nr. 4, etj.); M.Gero ka studiuar ndërtime të caktuara të strukturës së shqipes, përfshirë ato të prozës popullore; T.Topalli ka trajtuar ndonjë temë të sintaksës së përgjithshme midis të cilave emrat dhe grupet emërore në funksion sintaksor. L. Buxheli ka parë togfjalëshat me parafjalën **për** në gjuhën shqipe; Xh.Gosturani ka një monografi të gjerë për mohimin në gjuhën shqipe si dhe ndonjë artikull tjetër, si periudhën me fjali të varur lejore; J. Lukaj ka botuar artikuj për çështje të përgjithshme të sintaksës dhe për togfjalëshin.

Në fushën e kërkimeve sintaksore me vlerë janë gjithashtu arritjet e disa gjuhëtarëve kosovarë. Po përmendim këtu vetëm H. Aganin, T. Kelmendin, Isa Bajçincën, Sala Ahmetajn, Linditë Rugovën. Ndër punët e H.Aganit nga kjo fushë, me interes të veçantë është studimi prej rreth 30 faqesh, botuar në "Fjala" (1975) me titull "Ç'shoh të diskutueshme në "Çështje të teorisë së togfjalëshit në

shqipen e sotme". Autori, duke debatuar me S. Floqin. trajton çështje teorike të togfjalëshit, togfjalëshin predikativ, numrin e pjesëve shënuese të togfjalëshit, disa specifika të shqipes e tj. Problemet shihen duke analizuar me kompetencë faktet e shqipes sipas arritjeve teorike të kohës e në përqasje me gjuhë të tjera. Një tjetër autor kosovar me kontribute të shënuara është T. Kelmendi, i cili ka botuar një seri artikujsh për funksionet sintaksore të paskajores së gegërishtes, për përdorimet e saj në përqasje me lidhoren, për përshtatjen kohore të foljeve - kallëzues etj. (Shih psh studimin monografik:"Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në gjuhën popullore shqipe", punim magjistrature, Prishtinë, 1980.) Interpretimet nga autori bëhen sipas një koncepti teorik çuditërisht të qartë. Midis studiuesve të rinj bie në sy Linditë Rugova, e cila për punët e reja nga fusha e sintaksës ka referuar disa herë Seminaret Ndërkombëtare të Prishtinës. Tema më e fundit, trajtuar prej saj, "Sintagmat sintaksore të shqipes", që po bëhet gjithnjë e më shumë temë e ditës, synon njohjen e sintagmës si njësi e veçantë në sintaksën tonë dhe ndarjen e fjalisë në sintagma, çka lidhet me analizën në përbërës të drejtpërdrejtë, teori e përpunuar e disa gjuhëtarëve të mirënjohur perëndimorë, duke filluar me Sosyrin, Blumfildin e deri te Çomski. Përpjekje të ngjashme janë bërë edhe në Shqipëri. Po përmend vetëm punimin e Leonora Lumezit "Tipat strukturorë të frazave emërore në gjuhën angleze krahasuar me ato të gjuhës shqipe", Tiranë 2006 (mikrotezë për titullin master).

Ndihmesa në fushën e sintaksës sjellin edhe disa gramatika të botuara vitet e fundit në Shqipëri, në Kosovë dhe jashtë vendit, siç është ajo e W. Fiedler dhe O. Buchholz. Njëra prej tyre është "Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë" e B.Becit, pjesa e dytë e së cilës, sintaksa, zë 85 faqe. Autori ka skicuar aty temat e Sintaksës së Akademisë dhe nën ndikimin e sintaksës franceze përdor termin **folje** në vend të termit tradicional **kallëzues** (shumë rrallë përdoret prej tij edhe kallëzues), nuk njeh kallëzuesin emëror, por njeh kallëzuesorin e kryefjalës e të kundrinorit të lidhur me foljen **jam** a me folje të ngjashme me të, pranon si në frëngjishte grupet e fjalëve, si grup foljor, grup emëror etj. Thoma Dhima ka botuar tekstin "Gjuha shqipe, Sintaksa" (2005) për studentët e fakulteteve të gjuhëve të huaja dhe të shkencave të edukimit. Ky autor ka botuar edhe artikuj

teorikë nga fusha e sintaksës, ku trajton problemin e njësive sintaksore. (Shih "Probleme të njësive sintaksore (togfjalëshi dhe sintagma), Seminari Nd. Gj. L. K. SH., 24, 1, Prishtinë, 2005. Nën ndikimin e teorive perëndimore autori përpiqet të zbatojë në shqipe një teori të re, teorinë e sintagmës, prandaj herë përdor grup emëror, grup foljor, herë sintagmë emërore, sintagmë foljore për të zëvendësuar me to termin togfjalësh, të cilin e përdor vetëm për togfjalëshin e qëndrueshëm; fjalitë njëkryegjymtyrëshe të shqipes, nën ndikimin e anglishtes e frëngjishtes, i interpreton si të paplota, quan frazë fjalinë, nën ndikimin e anglishtes mbaresat shquese i merr si nyja, d.m.th. si fjalë të tjera, po ashtu ndan edhe kohët e përbëra; gramatikën e tij e paraprin një krye krejtësisht teorik, afër 35 faqe, që do t'i shkonte një sintakse teorike e jo një sintakse të shqipes. Por, nga ana tjetër, në këtë botim nuk është trajtuar një pjesë e mirë e lëndës së sintaksës së shqipes. Ndihmesa të rëndësishme në fushë të kërkimeve sintaksore sjellin edhe morfologët, studimet dialektologjike, autorët arbëreshë dhe albanologë të huaj.

Si në të gjitha shkencat albanologjike, edhe në fushë të sintaksës ka çështje teorike problemore të diskutueshme. Natyrisht, këto presin një zgjidhje shkencore objektive e sa më të pranueshme. Detyrë e rëndësishme dhe e ngutshme, që shtrohet aktualisht para sintaksologëve shqiptarë është njohja më e thelluar dhe shfrytëzimi me frytshmëri i arritjeve teorike të huaja, kryesisht perëndimore, por edhe miratimi e përfshirja në kodet sintaksore i arritjeve të gjuhëtarëve shqiptarë. Ka çështje problemore nga fusha e sintaksës që presin një trajtim të ri shkencor e rrahje mendimesh; madje problemet e sintaksës së shqipes janë rrahur shumë më pak sesa ato të morfologjisë. Ka kohë që kërkimet sintaksore në gjuhësinë e vendeve amerikane europiane-perëndimore si edhe në vende të tjera, janë shtrirë edhe në ligjërimin aktual, te thënia si mjet konkret i drejtpërdrejtë i këtij ligjërimi. Përpjekjet e tanishme të disa gjuhëtarëve tanë për njohjen e zbatimin e teorive perëndimore në gjuhësinë shqiptare janë për t'u përshëndetur. Por edhe më parë janë bërë përpjekje nga disa autorë për të zbatuar në truallin e shqipes elementë të kësaj teorie gjuhësore perëndimore që nuk është aq e re, sepse nga Sosyri deri te Çomski, madje deri në ditët tona, janë dashur mbi 80 vjet që kjo teori të formësohet. Kujtoj se edhe teoria e togfjalëshit paraprin në mënyrën e vet teorinë e

sintagmës, a të grupit të fjalëve apo të frazës. Teoria e togfjalëshit në të vërtetë nuk është teori e gjuhësisë ruse, por është teoria e sintagmës e interpretuar nga autorët rusë. Është plotësisht e vërtetë se togfjalëshi është një lloj, vetëm një tip, sintagme. Koncepti i sintagmës ka evoluar nga një gjuhëtar tek tjetri në perëndim, nga gjuhëtarët e perëndimit tek ata të lindjes dhe nga ata të lindjes tek sintaksologu i mirënjohur shqiptar S. Floqi. Prandaj tani kërkohen studime të thelluara dhe zbatim me maturi në sistem dhe në mënyrë krijuese të teorive bashkëkohore në fushë të shqipes dhe në përputhje me natyrën tipologjike të gjuhës sonë. Një ndërmarrje e tillë kërkon kujdes të veçantë, sepse zbatimi mekanik në shqipe i skemave të huaja, do të ishte i dëmshëm.

Më lejoni tani të radhis më poshtë vetëm disa nga çështjet problemore në fushë të sintaksës së shqipes që presin një zgjidhje në të ardhmen (disa prej tyre nuk janë vetëm të shqipes):

Cilat janë njësitë sintaksore (a duhen njohur **fjala**, **sintagma** apo **togfjalëshi, gjymtyra, fjalia, periudha, fraza** njësi sintaksore)? Po termi **përbërës** ç'përfaqëson në sistemin e njësive? Mos duhet parë periudha si variant i njësisë **fjali?** Pjesët e periudhës a do të vazhdojmë t'i emërtojmë me termat e shumtë të sintaksës tradicionale: **fjali** (fjali kryesore, fjali të bashkërenditura, fjali e nënrenditur, e varur), **pjesë** (pjesë kryesore, pjesë plotësuese), **njësi kallëzuesore, njësi e varur kallëzuesore, bërthamë kallëzuesore** a **predikative**, që përdoren në gramatika të ndryshme, madje edhe Sintaksën e Akademisë, apo do të pranojmë në vend të këtyre një term të përshtatshëm e të vetëm, pikërisht termin e ri **sifjali**, i cili ka filluar të përdoret në gjuhësinë tonë e që i përgjigjet termit **clause** të anglishtes? A do të vazhdojmë ta njohim si njësi të veçantë sintaksore **togfjalëshin,** nocion dhe term i gjuhësisë sonë të pasluftës, që i përgjigjet termit **sllovosoçjetanie** të rusishtes, apo do ta zëvendësojmë atë me nocionet e termat e gjuhësisë bashkëkohore perëndimore sintagmë, grup fjalësh, frazë, shoqëruar këta me ndryshimet konceptuale e terminologjike përkatëse, që i përdorin në veprat e gramatikat e tyre autorë amerikanë, anglezë, francezë, gjemanë e që në disa raste kanë filluar të përdoren edhe në gjuhësinë tonë? Apo do të njihet termi togfjalësh vetëm për një tip të caktuar sintagme? Si mund të përcaktohet objektivisht kufiri semantik i gjymtyrës në fjalinë e

thjeshtë? A do të pranojmë si gjymtyrë kryesore të fjalisë së thjeshtë vetëm kallëzuesin (foljen), apo edhe kryefjalën dhe kallëzuesin, apo edhe kryegjymtyrën e respektivisht grupin e kryefjalës, grupin e kallëzuesit dhe grupin e kryegjymtyrës? A do të vazhdojmë të pranojmë termin **kallëzues**, apo do ta zëvendësojmë atë me termin morfologjik **folje?** A do të vazhdojmë ta njohim kallëzuesin emëror e nëse po, a do të njohim vetëm kallëzuesin emëror me këpujën **jam**, apo edhe me folje të tjera të ngjashme të desemantizuara, duke mënjanuar kallëzuesorin si gjymtyrë të veçantë të fjalisë së thjeshtë? Apo, përkundrazi, nuk do ta njohim fare kallëzuesin emëror, duke interpretuar foljen **jam** si kallëzues dhe do të zgjerojmë kategorinë e kallëzuesorëve? A do të përqafojmë qëndrimin e fundit të GrA që fjalët një, ca/ disa i sheh vetëm si fjalë emërtuese (përemër, numëror), apo do t'i njohim këto edhe si nyja joshquese para emrave të pashquar? A do të vazhdojmë t'i njohim trajtat e shkurtra të përemrave si gjymtyrë fjalie, apo thjesht si formante me vlera të ndryshme gramatikore? Cili është statusi i formave të pashtjelluara të foljes, a do të njihen këto forma si kallëzues vetëm në raste të caktuara, apo vetëm si gjymtyrë të dyta të fjalisë së thjeshtë e si elemente përbërëse të një kallëzuesi të përbërë a të një kryegjymtyre dhe në disa raste edhe si bërthama predikative me vlerë fjaliore? A do të vazhdojmë t'i njohim në gjuhën tonë si tip të veçantë semantik-gramatikor fjalitë njëkryegjymtyrëshe, tip ky me një larmi ndërtimore e kuptimore shumë të gjerë në këtë gjuhë, apo do t'ia mohojmë ato shqipes siç vepronte më parë sintaksa tradicionale dhe siç mendon ndonjë autor në ditët tona nën ndikimin e strukturave të gjuhëve të tjera, duke i barazuar fjalitë njëkryegjymtyrëshe me të paplotat? Në fushë të terminologjisë sintaksore ka një luhatje të theksuar: kallëzues apo folje; fjalë përcaktuese apo individualizues; togfjalësh i përbërë apo i zgjeruar; periudhë apo fjali e përbërë apo frazë; fjalë kryesore, fjalë bosht a shtyll apo kokë; marrëdhënie kallëzuesore, predikative apo kanë kuptime të ndryshme; sintagmë apo grup fjalësh a frazë, frazë apo fjali etj. Th. Dhima për pjesën e periudhës përdor: njësi, pjesë, njësi kallëzuesore, bërthamë kallëzuesore, pjesë e nënrenditur, pjesë e varur, fjali e nënrenditur, fjali kryesore pjesë plotësuese.

Për këto pyetje e të tjera si këto, autori e shpreh qëndrimin e tij në botimet: "Gramatika praktike e gjuhës shqipe", Tiranë 1998

(botimi i katërt 2007) si dhe në "Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde (pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura"), Tiranë 2007. (Për ndonjë nga këto qëndrime shih p.sh. fq. 16, ose 17 e në vijim të Hyrjes, ose Përfundimet e "Tekstit të ushtrimeve…"). Por kjo nuk mjafton. Duhen edhe studime të tjera dhe një debat shkencor e objektiv.

Lidhur me teoritë strukturaliste, gjenerativiste etj., siç e thashë më sipër, mendoj se duhen jetësuar e shfrytëzuar sa më shpejt e sa më mirë. Në këtë kuadër edhe për sintagmën (a grupin e fjalëve, frazën) studimet duhen thelluar dhe në përputhje me natyrën e shqipes të merren në konsideratë. Tashti për tashti teoria e togfjalëshit nuk mendoj se duhet zëvëndësuar.

Bibliografi:

A.Xhuvani,…Njohunit e Para të Syndaksës Shqipe, Pjes' e Parë për Klasat e Nalta të Fillores, Vlorë, shtypsh. "Vlora", 1922.
ASHSH,…Gramatika e Gjuhës Shqipe II (Sintaksa), Tiranë,1997.
Rami Memushaj,…Gjuhësia Gjenerative, Tiranë, 2003.
Mahir Domi,…Çështje të përgjithhme të sintaksës, SF, 1980, 3.
Mahir Domi,…Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore, SF, 1984, 4.
S.Floqi,…Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme, SF, 1969, 1.
S.Floqi,…Togfjalëshat mbiemërorë në gjuhën e sotme letrare shqipe, SF, 1981, 2.
F. de Saussure, Kurs i gjuhësisë së përgjithshme, përkthim i R. Ismajli, 2002.
N.Chomsky,…Syntactic Structures, Paris, 1971.
H.Agani,…Ç'shoh të diskutueshme në "Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme", Fjala, Prishtinë,1975.
J.Rrota,…Sintaksa e gjuhës shqipe, Shkodër, 1942.
I.D.Sheperi,…Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskërishtes, Vlorë, 1927.
K.Cipo,…Sintaksa, Tiranë, 1952.
R.Përnaska,…Boshti ideologjik dhe lëndët gjuhësore, Revista pedagogjike, Tiranë, 1972, 1 (Gjykimi dhe Fjalia); Nr. 5, Disa probleme të studimit të fjalisë (togfjalëshi); Nr. 6, Fjalia, aspekti dinamik dhe statik.
S.Prifti,…Sintaksa e gjuhës shqipe, Dispencë, Pjesa I,Tiranë 1959; Pjesa II, Tiranë, 1962.
S.Prifti,…Elipsa në sintaksën e fjalisë, SF, 1966, nr.3.
M.Gero,… Mbi disa arritje në fushën e sintaksës së shqipes së sotme letrare, Bulet. Shken., Shkodër, 1982, nr.1.
T.Kelmendi,…Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në gjuhën popullore shqipe (sipas folklorit), (punim magjstrature), Prishtinë, 1980.
Th.Rushi,…Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore, SF, 1983, nr.1.
Xh.Gosturani,…Mohimi dhe mënyrat e shprehjes së tij në gjuhën shqipe, SF, 1975, nr.1; SF, 1976, nr.2, 4; SF, 1977, nr.1, 4; SF, 1979, nr. 3.

M.Totoni,…Çështje të gjymtyrëve të fjalisë, SF, 1981, nr.3.
M.Totoni,…Si duhet kuptuar njësia themelore sintaksore, FF, 1970, 2.
M.Çeliku,…Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde (Pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura), Tiranë, 2007.
M.Çeliku,…Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe, Tiranë, 2000 (bot. II, 2006).
Th.Dhima,…Gjuha shqipe Sintaksa, Tiranë, 2005.
Th.Dhima,…Probleme të njësive sintaksore (Togfjalëshi dhe Sintagma), Seminar Ndërkombëtar për GJLKSH, vëll. 24/1, Prishtinë.
T.Topalli, Emra dhe grupe emërore në funksion sintaksor (morfosintaksë), SNGJLKSH, Prishtinë, gusht, 2007.

Mustafa IBRAHIMI

DREJT OBJEKTIVAVE MADHORE NË SOCIOLINGUISTIKËN SHQIPTARE

1. Hyrje

Filozofët, kritikët, historianët etj. kanë treguar interes të madh për gjuhën dhe rolin e saj në gjirin e kulturës në përgjithësi, megjithatë mbetej gjithnjë një boshllëk ndërmjet disiplinave të ndryshme, ndërmjet historisë, gjuhësisë dhe sociologjisë (përfshirë këtu edhe antropologjinë sociale). Ky boshllëk mund dhe duhet të plotësohet nga historia shoqërore e gjuhës. (Burke 1990:3-31). Ky lloj interesimi, është tipik për sociolinguistikën, si shkencë bashkëkohore, e cila u përkufizua dhe u mëkëmb si disiplinë e veçantë aty nga gjysma e viteve ’50 në SHBA e gjetkë, porse zhvillimi i saj lulëzoi në dekadën e shtatë të shek.XX.

Sociolinguistika mund të definohet edhe si shkencë e stratifikimit shoqëror të gjuhës, gjegjësisht e kovariacioneve të strukturave gjuhësore dhe sociale. (Bugarski 1975:21) Në vende të ndryshme të Evropës e më gjerë, qysh në shek. XV ka pasur njerëz që gjuhën e kanë quajtur “*dukuri thelbësore shoqërore”* dhe kanë bërë edhe vëzhgime me karakter sociolinguistike shumë të mprehtë. Në fushën e saj hyjnë dialektologjia sociale, dygjuhësia, problemet rreth shkrimit, gjuhët standarde dhe letrare, normimi dhe politika gjuhësore, pastaj lojaliteti gjuhësor, pyetjet rreth formave të ndryshme, varianteve dhe stileve të gjuhës amtare etj.

Marrë në përgjithësi, nëse sot në çdo mjedis nuk ka interesim për studimet abstrakte të diturive rreth gjuhës me të cilën karakterizohet njeriu, është e sigurt se çdo shtet, cili më pak e cili më shumë ka probleme urgjente sociolinguistike. Me një fjalë e tërë bota ka qenë dhe është një arenë e madhe sociolinguistike. Një vetëdije sociolinguistike të ngjashme mund të gjejmë që nga dijetarët dhe filozofët e vjetër grekë, diskutimet për këtë çështje kanë vazhduar nëpër Romën e vjetër, pastaj në empirizmin anglez, racionalizmin

francez etj. e deri te filozofët dhe semiologët amerikan si Ç.S. Pers (C.S.Peirce) dhe Ç.Moris (C.Morris). (Radovanoviq 1979:95). Kontribut mjaft të madh kanë dhënë edhe evropianët duke filluar nga veprat e Shekspirit, të Molierit, të Goldonit etj., si dhe në shumë romane të shek. XVIII, qysh nga Zhorzh Elioti e Lev Tolstoi e deri te linguistët dhe semiologët e shek.XX, duke filluar nga F. De Sosyri, A. Meje (A.Meillet), A. Martine (A.Martinet) etj.

Elementet themelore të individit dhe shoqërisë janë kundruar edhe në krijimtarinë shkencore të disa gjuhëtarëve shqiptarë të gjysmës së parë të shek. XX. Gjuhësia shqiptare është e gjerë dhe ende e pashtruar mirë duke ofruar studime empirike dhe teorike edhe në fushën e sociolinguistikës. Ide të hershme për një qëndrim a konceptim sociolinguistik të gjuhës ka pasur edhe në radhët e gjuhëtarëve shqiptarë. Këtu mund të përmendim disa ide të Atë Justin Rrotës rreth mundësisë që ka njeriu për ta "*dredhë giuhën"* sipas rastit e bashkëbiseduesit (Rrota 1931:121-133). Që prej viteve 1964 e më vonë edhe në sociolinguistikën shqiptare u përcollën tema të cilat ishin pjesë e një orientimi e programi të ri gjuhësor. Sociolinguistika jonë filloi të thithë nga ky potencial që në nëntor të vitit 1972, në Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, ku prof. E. Çabej mban kumtesën me titull: "*Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes"*. Qe pikërisht koha kur në Shqipëri pat filluar një proces industrializimi. Çabej do të jap edhe një kontribut tjetër, *Mbi lidhjen e gjuhës dhe seksit në të ashtuquajturën prej tij* " *të folët e grave"* (Çabej 1978:IV), megjithëse politika gjuhësore e viteve të parapluralizmit, këto punime i trajtonte si "qëndrim idealist" (Shkurtaj, Gj. 1998:87).

Në veprat e mëvonshme ndeshim prurje të gjuhësisë moderne që kanë të bëjnë me identitetin fizik, psikologjik, gjeografik, etnik, shoqëror, kontekstual. stilistik të folësit (Ismajli 2001:241-248); ballafaqohemi me tezat se në kushtet e dy e shumëgjuhësisë për shqipen letrare nevojitet koncepti i gjuhës së hapur dhe dinamike (Lloshi 2001:263-274); por edhe pasurimi i identitetit kombëtar në këtë botë të globalizmit (Qosja 2003:36-41); njohim hulumtuesit që të dhënat e të folmeve e të folësve shqiptarë u dhanë mundësinë të përcaktojnë e të shpjegojnë pikëtakimin midis izoglosave e izoergeve; takojmë dijetarët që në shpjegimin e strukturave gjuhësore dhe në

trajtimin e lëndës folklorike, etnografike marrin parasysh faktorë gjuhësorë e jogjuhësorë. Në hullinë e këtyre prurjeve lindën studiuesit e zëshëm e të rinj, si R. Ismajli. Gj. Shkurtaj, Sh. Sejdiu, R. Memushaj, M. Ymeri, J. Shpuza, A. Ballhysa. B. Rugova. A. Haxhi, A. Doko etj. (Lamaj 2005:429). Me këtë edhe gjuhësia shqiptare e pati "orën e saj fatlume" kur mund ta rrokte e ta tejçonte këtë disiplinë, asokohe ende të re në botë.

Shtjellimi më serioz i lëndës etno-sociogjuhësore nisi me kursin teorik të viteve '93-94 në universitetet shqiptare, gjeti trajtim shumëplanësh në simpoziumin shkencor "Probleme të studimeve sociolinguistike shqiptare" (prill 1995) *të Universitetit të Tiranës,* ku jo vetëm *u përshkrua rruga e kalimit nga gjeografia gjuhësore tek dialektologjia urbane* (Shkurtaj 1996), por u trajtuan edhe *gjendja shoqërore e gruas, sjellja e të folurit të saj* (Asenova 1996/1), *problemet e alfabetizmit dhe standardizimit të gjuhëve* (Memushaj 1996/1), *prirjet endocentrike të shkencave shoqërore* (Rrokaj 1995), *norma gjuhësore etj. e erdhi kështu në mjediset studentore teksti universitar "Sociolinguistika",* që u ribotua disa herë. (Shkurtaj 1996b).

Në këtë hulli u zhvillua dhe sesioni shkencor *i Universitetit të Gjirokastrës,* i cili mori në shqyrtim dukurinë e bilinguizmit. Në këtë veprimtari shkencore studiuesit shqiptarë dhe ata të huaj sollën në kumtesat e tyre përvojën e arsimimit e të edukimit gjuhësor në mjedisin arbëresh e në shkollat e pakicës greke (shih Kërkime universitare 2001/5), sipas tri realiteteve: autoritetit shtetëror (legjislacioni), mësuesit (tekstet) dhe bashkësisë së nxënësve.

Realitetet antropologjike e etno-sociolinguistike janë parashtruar e shqyrtuar edhe në seanca të veçanta apo si pjesë përbërëse e trajtimeve të larmishme gjuhësore edhe në *Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare,* i cili është zhvilluar e zhvillohet në Prishtinë e në Tiranë. Vlen të përmendet, p.sh. Seminarin XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, ku një seancë e veçantë iu kushtua problemeve të sociolinguistikës: ligjërimit rinor, normës sociolinguistike në shtyp e radiotelevizion, funksionit të gjuhës në masmedia etj.

Sociolinguistika shqiptare lindi për të mpiksur në një truall të vetëm tharmin e strukturalizmit në gjuhësi dhe vëmendjen gjithnjë në rritje të sociologëve e antropologëve lidhur me komunikimin njerëzor.

Të gjithë këta u orvatën t'i studiojnë raportet dhe veprimet midis dukurive gjuhësore dhe shoqërore, duke u bazuar në studimet lidhur me gjuhën individuale në një shoqëri (mikrosociolinguistika), si dhe në gjuhën e një shoqërie ose pjesëve të saj (makrosociolinguistika). Në punën e saj sociolinguistika më tepër interesohet për përdorimin e gjuhës sesa njohuritë teorike të saj.

2. Formulimi i problemit

Një kthesë në mënyrën se si dhe për çfarë shqiptarët po e përdorin gjuhën, ndodhi pas rënies së mureve ideologjike kur u vë re binomi gjuhë shqipe – shoqëri shqiptare. Kthesa e sipërthënë e ka zanafillën në migrimet e mëdha të jashtme dhe të brendshme, të shkaktuara qoftë nga modeli i ri i zhvillimit social-ekonomik, ashtu edhe ngaqë sot lëvizja demografike nuk pengohet më. Si rezultat i kësaj paraqitet braktisje e zonave të tëra, përmbysje të fuqishme të strukturave demografike të vendit, pështjellime të forta në etnokulturat e veçanta, në zakonet apo mënyrën e të menduarit dhe për rrjedhim shfaqjen e një dinamizmi social të theksuar, me gjithë efektet anësore që ai sjell.

Migrimi i brendshëm në distanca ose hapësira të vogla, si dyndja ndër qytete e banorëve të fshatit, apo e banorëve të qendrave me tregues ekonomikë më të ulët drejt qendrave më të begata; këto lëvizje të fundit janë frymëmarrje të domosdoshme për gjuhën, meqë në trajtën e shkëmbimeve dhe integrimeve çojnë drejt një lloj nivelimi të të folmeve lokale. Studimet e ardhshme duhet të fokusohen në studimet e tyre të thelluara duke e vendosur standardin pritës në kontakt të vazhduar me variantet gjuhësore, të cilat, sigurisht, përveç dialektizmave të panumërta, përmbajnë edhe fjalë të shumta e të nevojshme, që pragmatizmi i jetës urbane i ka mpirë, i ka zëvendësuar me huazime ose i ka bërë të duken si të panevojshme.

Kërkimet e ardhshme në fushën e sociolinguistikës shqiptare

Qyteti dhe gjuha

Jeta në qytet gjithmonë ka ndikuar në shprehjet gjuhësore të njerëzve, megjithatë vështirë është të definohet pikërisht kështu "gjuha e qytetit". Ka të bëjë me gjuhën e rëndomtë me të cilin qytetarët shërbehen për t'i kryer punët e përditshme. Këtu mund të përfshihet edhe gjuha e folur dhe e shkruar që përdoret në situata që kërkojnë afrim me normën letrare. Në këtë gjuhë dallohen elemente gjuhësore që lidhen pikërisht me aktivitetet e përditshme në qytet. Elemente të tilla ka shumë, dhe nuk janë të gjithë të rëndësishme, por mund t'i numërojmë këto: *zhargonet e grupeve të ndryshme profesionale, për shembull administrata ose sporti; gjuha e mediave, radiotelevizionit, filmit, teatrit; gjuha e letrarëve të qytetit; aspektet të aktiviteteve më të gjera politiko-shoqërore; ndikimi i gjuhëve të huaja; krijimtaria gjuhësore e brezave të rinj në shkollë, në rrugë dhe në vende të tjera.* (Bugarski, 1975:202).

Ashtu si gjithçka në gjuhë, edhe gjuha e qytetit ka strukturën e vet qendrore, duke filluar nga argotë, gjuha e mirë e të folmes qytetare dhe gjuha letrare. Megjithatë këto vlerësime në një mënyrë janë të parëndësishëm, sepse mund të mjegullojnë problemet e vërteta të gjuhës së qytetit. Kjo gjuhë paraqet një dukuri të ndërlikuar, ajo së pari duhet të studiohet mirë në të gjitha komponentët e saj dhe më pas mund të jepen shkallët e vlerësimit. Nëse në këtë drejtim definojmë kështu gjuhën e qytetit, atëherë parashtrohet pyetja, vallë kjo gjuhë qëndron peng në gjuhën shqipe. Pyetja e parë : A ka te ne gjuhë të vërtetë të qytetit? Në shikim të parë, kjo pyetje mund të merret si e tepërt, por po të shikojmë pak më thellë, megjithatë ekzistojnë probleme. Një prej tyre është se vallë gjuha në qytet dallohet nga të folmet popullore dhe ajo letrare? Me fjalë tjera vallë gjuha e qyteteve tona në masë të duhur është autentike. Ndikimi i jetës moderne në shoqëri mundësoi konflikte të shpeshta midis të folmeve popullore, pra midis tradicionales dhe asaj moderne, duke depërtuar edhe në thelbin e gjuhës, e cila edhe përpos rezistencës është e detyruar të adaptohet me mundësitë e reja.

Nëse i marrim dialogët qoftë në film, teatër ose në krijimet letrare, do shohim se nëse ikim nga tradita popullore, sipas një rregulle të pashkruar dialogu bëhet i dobët. Në këtë mënyrë, gradualisht ose gjithmonë ndryshojnë edhe elementet e rëndësishme të gjuhës si: sistemi gramatikor, fjalori, spektri semantik etj. Kjo është një dukuri komplekse dhe duhet të ndiqet nga aspekti historik.

Zhvillimi ekonomik dhe kulturor i Tiranës, Prishtinës, Tetovës, Shkodrës, Durrësit apo të ndonjë qyteti tjetër gjatë historisë ka ndikuar si në të folmet e tyre ashtu edhe në gjuhën letrare. Zejtaria, industria, zhvillimi tregtar, komunikacioni, jeta kulturore-shkencore, mediat-titujt kjo ku më pak e ku më shumë është e lidhur me zhvillimin e qytetit dhe vetvetiu kuptohet se ka ndikuar edhe në gjuhën.

Në indin gjuhësor të rëndësishëm janë edhe proceset tjera; p.sh vallë në atë proces gjuhësor, të themi në morfologji kanë qenë produktive dhe janë krijuar prapashtesa të reja, ose janë zhdukur disa të vjetra, a kemi rigrupim të kohëve foljore, ose në cilëndo paradigmë morfologjike vallë është ndryshuar struktura sintaksore e fjalisë, a krijon gjuha jonë idioma të pakrahasueshme me ata që janë përdorur në një kohë të kaluar?

Një pyetje që parashtrohet para dialektologëve dhe hulumtuesve tanë është edhe stili i gjuhës. Pastaj, si kanë ndihmuar ndryshimet shoqërore nga Lufta II Botërore në gjuhën shqipe, veçanërisht në gjuhën e qyteteve. Duke mos dashur t'u lëshohemi supozimeve se vallë gjuha e qytetit do të ndahet sa më shumë nga përdorimi tradicional i gjuhës popullore, duke krijuar një gjuhë të përbashkët letrare, ose do të krijojë një hapësirë ku do të zhvillojë dhe mësojë individualitetin e saj. Por për të mos prejudikuar për të ardhmen, na nevojiten analiza të situatës së sotme. Kurse atë analizë ne sot nuk e kemi. Ne thjesht sot nuk dimë si flasim nëpër qytete. Ekzistojnë studime për të folmet e ndryshme krahinore, por edhe të folmet e ndonjë fshati të skajshëm, porse si flitet në Tiranë ose në Prishtinë mund të informohemi me dëgjimin dhe shikimin nga ajo çfarë dëgjojmë. Megjithatë,na i lidh duart mungesa e studimeve për këtë çështje, pra për të folmen e qyteteve. Ne s'mund të flasim as për një të folme të veçantë të qytetit, apo ndoshta kemi aq të folme të gjuhës së qytetit, sa kemi qytete të mëdhenj.

Me rëndësi është të gjejmë edhe përgjigjen në pyetjen: vallë Tirana, Prishtina, Tetova kanë gjuhën e tyre specifike të qytetit? Përshkrimi i tillë, bazuar në materialin e pasur foljor në një qytet, pastaj i bazuar në gjuhën e letrarëve të sotëm të atij qytetit do të mund të paraqesin bazën e nevojshme për hulumtim të mëtutjeshëm. Ky hulumtim mund të ndikojë në drejtime të ndryshme - ndaj të folmeve, gj. letrare ndaj dialekteve e tjerë. Mund të jep konkluzione edhe për përkatësinë etnike, moshën e deri te gjeografia e gjerë e rajoneve të qytetit. Rruga për të arritur deri këtu është në mbledhjen dhe përpunimin e materialit. Atë që dimë deri tani është se duhet të punohet.

Zhargonet tek të rinjtë

Një nga tiparet e strukturës së sotme shoqërore evropiane është *veçimi i studentëve si grup më vete.* Sociolinguistika e vlerëson zhargonin studentor apo ligjërimin rinor si "varietet në raport me përdoruesin (Coveri: 1992:60); Zhargoni i sotëm i të rinjve në përgjithësi, (gjimnazistët në veçanti) është krijuar më së shumti nga ata vetë. Një pjesë janë fjalë të gjuhëve të huaja, fjalët e tjera krijohen nga fjalët ekzistuese, por me përdorim të ndryshuar. Shpeshherë, zhargonet rëndohen deri në masën për të krijuar një gjuhë të tyre të rrethit shoqëror, për të mos u dalluar apo dhe për të mos u kuptuar nga pjesa tjetër, e cila nuk bën pjesë në këtë rreth. Nuk përjashtohen dhe rastet kur këto fjalë përhapen si virus mes gjimnazistëve, sepse konsiderohen trend apo në modë... Pjesa më e madhe e fjalorit që përbën këtë zhargon ngjizet nga fjalë që përgjithësisht konsiderohen vulgare.

Përveçse fjalëve në shqip, në zhargonin e gjimnazistëve zënë një pjesë të madhe dhe huazimet nga gjuhët e huaja, kryesisht ato nga italishtja, anglishtja, frëngjishtja dhe në nivel më të ulët nga greqishtja, apo turqishtja. Duhet theksuar që kohët e fundit, pjesë e zhargonit të tyre janë bërë dhe fjalë nga spanjishtja dhe kjo për shkak të telenovelave.

Por a është i shmangshëm ky fenomen i cili në pamje të parë duket si fjalor vulgar dhe i pakuptueshëm? Jo, kjo është e

pashmangshme, thonë psikologët. Më kot duhet të mundohen të rriturit të eliminojnë fjalorë të tilla tek fëmijët e tyre në moshën e adoleshencës për shkak se për momentin, në shkolla, niveli arsimor dhe edukativ nuk është në shkallën e duhur. Por fenomeni i ka rrënjët më thellë. Është pikërisht mosha e adoleshencës, mosha e cila ka predispozicionin e mohimit të vlerave. Sipas psikologëve, kjo ndodh për shkak se kjo është mosha kur adoleshenti lufton të formojë identitetin e tij dhe këtë ai e bën duke mohuar vlerat e shoqërisë, duke formuluar fjalë të cilat i di vetëm ai, fjalë me të cilat merret vesh vetëm ai dhe që janë shpikje e tij. Kjo situatë paksa egoiste nga ana e tyre zgjat për sa kohë, që adoleshenti ndjen se ka formuar identitetin e tij, megjithatë, psikologët shpjegojnë se zhargone dhe fjalë të tilla, shumë rrallë lënë gjurmë dhe vlera negative tek ata. Është një fenomen momental, kalimtar dhe pa pasoja shpjegojnë psikologët. Andaj sado që gjuhëtarët e kontestojnë, këto dukuri nuk e dëmtojnë gjuhën.

Është vështirë në mungesë të fjalorëve të flasim për leksikografinë speciale shqiptare të zhargoneve. Kjo situatë krijon edhe nevojën për krijimin e kritereve me të cilët do të vlerësohen ato fjalë dhe fjalorë. Janë bërë disa përpjekje studimi për mbledhjen e zhargoneve tek të rinjtë, si: *Ligjërimi rinor i studentëve të viteve '90* (Ymeri 1999: 275-282); *Gjuha e fshehtë e të rinjve të Prishtinës* (Rugova 1999:364-369). Nga këto studime është arritur në përfundimin se ligjërimi studentor me prirjet narciziste (të admirimit për vetveten) e kriptike (ndjenja e maskimit), ludike (konsiderimi komunikimit si lojë), shpreh lidhjet midis realitetit dhe identitetit me procedime retorike në nivelin e tropeve, me anë të fjalëformimit të shpejtë etj. (Lamaj 2005:437).

3. Përfundime

Rezultatet e deritashme nga hulumtimet sociolinguistike, edhe më tutje janë parciale. Në institucionet tona diçka po botohet, por vështirë të gjejë vend pohimi se kjo disiplinë e ka kaluar pragun e rëndë të shqipes, pjesa më e madhe e tyre është para nesh. Kjo parashtron nevojën për t'u njohur me hulumtimet më të reja nga fusha

e sociolinguistikës në suaza botërore, dhe të shërbehemi me përvojën duke i vërejtur anët pozitive dhe negative të hulumtimeve të tilla. Sipas këtij mëtimi, në artikujt dhe librat shkencorë të viteve të ardhshme kërkohet një formim më i mirë gjuhësor prej zyrtarëve e pushtetarëve, gazetarëve, medias elektronike e të shkruar.

Meqë në kushtet e një shqipeje të pambrojtur si duhet nga institucionet e lartpërmendura, sociolinguistika nuk arriti të paraqitet si disiplinë që sot e do kohë dhe të arrijë t'i mbulojë gjerë dhe thellë problemet gjuhësore që ka shqipja. Megjithatë me metodologjinë e saj të studimit sinkronik *shkak-pasojë*, hulumtimet e ardhshme duhet të fokusohen që me sukses t'u paraprijnë proceseve e dukurive gjuhësore në vijim. Kjo është një nga mënyrat që hulumtimet sociolinguistike të hyjnë në përpjekjet e përbashkëta të gjuhëtarëve dhe forcave të tjera progresive të shoqërisë sonë shqiptare për ta realizuar pluralizmin gjuhësor, i cili nuk pranon asnjë hierarki midis gjuhës dhe kulturës.

Fillimi i vërtetë i sociolinguistikës shqiptare në kuptimin e shkruar do të bëhet atëherë kur do të merren aktivitete linguistike të ngjashme si në SHBA dhe Evropë, kur do fillojnë të paraqitën përmbledhjet e punimeve, monografitë, veprat sintetike, të mbahen konferencat shkencore, të botohen revistat dedikuar posaçërisht problematikës sociolinguistike etj.

Menjëherë duhet të fillohet me hartimin e bibliografisë sociolinguistike shqiptare, si për nevojat tona ashtu edhe për bibliografinë ndërkombëtare. Gjithsesi do të hasen shumë vështirësi lidhur me natyrën e përmbajtjes, duke ditur se sociolinguistika në gjirin e vet përfshin shumë fusha heterogjene dhe difuze. Vallë do të përfshihen vetëm ato punime me përmbajtje të pastër sociolinguistike, apo edhe ato punime ku përmenden disa komponentë të tilla, duhet të merren njerëz profesional dhe institucione përkatëse. Kjo erë për gjuhësinë shqiptare mund të jetë era e mbarë e sociolinguistikës.

Referencat:

Asenova, P. (1996) Gruaja monolinge në Ballkan, në Studime albanalogjike, 1.
Beci, B. (1976, 1995) E folmja e qytetit të Shkodrës në dy sisteme fonologjike. Tiranë.
Bugarski, R. (1975) Lingvistika o čoveku. Beograd, BIGZ.
Bugarski, R. (2002) Lica jezika. Beograd, BIGZ.

Bugarski, R. / Hawkesworth, C. (eds) (1992) Language Planing in Yugoslavia. Columbus, Ohio: Slavica Publishers.
Bugarski R. (2006) Zargon. Beograd.
Burke, P. (1990) Lingua, societa' e storia..
Çabej, E. (1976) Disa eufemizma të shqipes, në Studime gjuhësore, IV, 17, Prishtinë.
Coveri, L. (1992) Gli studi in Italia: // linguagio giovante degli novanta, 60.
Fridman, V. (1993) Dialect variacion and questions of standardization in Macedonia: Macedonian, Albanian and Romany. Zbornik Matice srpske za filologiju i linguistiku. Novi Sad.
Gosturani, Gj. (1980) E folmja e qytetit të Elbasanit. Tiranë.
Haxhihasani, Q. (1964) Për të folmet shoqërore. Studime Filologjike. Tiranë,1.2.3;
Hudson, A. R. (2002) Sociolinguistika. Tiranë, Dituria.
Ibrahimi, M (2003) Gjuha zyrtare në shtetet shumëgjuhësore të botës dhe aplikimi i tyre në Maqedoni. Interpretime dhe studime gjuhësore. Shkup, Interlingua.
Ibrahimi, M. (2005a) Multilingualism as the Main Segment of Multiculturalism. Multiculturalism in Macedonia: an emerging model. Skopje, Soros, 103-114.
Ibrahimi, M. (2005b) Bilinguizmi te fëmijët shqiptar në mërgim. Simpozium Ndërkombëtar me temë "Emigracioni prej fillimi deri sot", Strugë 2005. Shkup, Interlingua.
Ibrahimi, M. - Xhaferi H. (2006) Dallimet gjuhësore midis gjinive dhe figura e gruas në poezinë popullore. Tetovë, UEJL.
Ismajli, R. (2002) Statusi, realitetet sociolinguistike, identiteti.... "Seminari XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare- gusht 2001". Prishtinë, 241-248.
Ismajli, R. (2003a) Gjuha, ndikimet dhe ndryshimet, në Standarde dhe identitete. Prishtinë 136.
Ismajli, R. (2003b) Shqipja standarde dhe shkolla, në Standarde dhe identitete. Prishtinë, 159.
Lamaj, A. (2005) Prurja dhe shqyrtimet etno-sociogjuhësore shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. "Seminari XXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare - gusht 2005". Prishtinë, 24/1, 429-437.
Lloshi, Xh. (2001) Gjuha shqipe standarde në rrethanat e dygjuhësisë. Seminari XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare- gusht 2001". Prishtinë, 20/1, 263-274.
Memushaj, Rr. (1996) Planifikimi gjuhësor si objekt i sociolinguistikës, në Studime albanalogjike, 1.
Osmani, T.; Pepa, S. (1995-1996) Pasqyrimi i eufemizmave në letërsinë gojore dhe artistike, BSH, Shkodër;
Radovanovic, M. (1979) Sociolingvistika. Beograd, BIGZ.
Rrokaj, Sh. (1995) Shkencat e gjuhës - hapësirë dhe kufij, në Revista letrare, 3, Tiranë.
Rrota, J. (1931) Gjuha shkon tue bam ato ndryshimet e veta. Në "Hylli i Dritës", nr.3.
Rugova, B. (1999) Gjuha e fshehtë e të rinjve të Prishtinës, në Seminarin XXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 364 - 369, Prishtinë.
Sejdiu, Sh. (2002) Sisteme e struktura, raporte, Prishtinë.

Shamku-Shkreli, L. (2005) Për një sociolinguistikë funksionale. Seminari XXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare - gusht 2005. Prishtinë, 24/1, 438-445.

Shpuza, J. (1998) Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve, Shkodër.

Ymeri, M. (1999) Ligjërimi rinor i studentëve të viteve '90, në Seminarin XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 275-282, Tiranë.

Zhugra, A. (2001) Rreth normave të sjelljes gjuhësore dhe kritereve të gojtarisë, Gjurmime albanologjike. Prishtinë.

Zhugra, A. (2003) Etnolinguistika në veprën Çabejt, UGJ.

Shkurtaj, Gj. (1969) Disa shqyrtime rreth zhvillimeve e ndryshimit të të folmeve popullore në disa zona të Malësisë së Madhe. Studime filologjike 4, 162.

Shkurtaj, Gj. (1981) E folmja e qytetit të Lezhës. Studime filologjike 1-3, 155-163.

Shkurtaj, Gj. (1984) Shtresime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës, në SF, 2.

Shkurtaj, Gj. (1996a) Nga gjeolinguistika tek dialektologjia urbane. Studime albanologjike, 1. Tiranë.

Shkurtaj, Gj. (1996b) Sociolinguistika, Tiranë.

Shkurtaj, Gj. (1998a) Disa shqyrtime rreth eufemizmave të shqipes sipas ideve të Çabejt. Eqrem Çabej personalitet i shkencës dhe kulturës shqiptare. Shkodër. 87.

Shkurtaj, Gj. (1998b) Gjuha shqipe dhe trysnia shoqërore, në "Gjuha dhe ligjërimi në shkollë", 10, 48, Shkodër.

Shkurtaj. Gj.; Memushaj, Rr. (1998c) Shkolla dhe shqipja letrare, Gjuha jonë, 1-4.

Shkurtaj, Gj. (2000) Disa dukuri të së folmes së Kurbinit në dritën e sociolinguistikës. Tiranë 5-3-4, 142.

Shkurtaj, Gj. (2001) Onomastikë dhe etnolinguistikë. Tiranë, SHBLU.

Shkurtaj, Gj. (2002) Fjalori i rënduar i medias. Tiranë, Antena.

Shkurtaj, Gj. (2003) Sociolinguistika. Tiranë, SHBLU.

Shkurtaj, Gj. (2004) Etnografia e të folurit të shqipes, Tiranë.

Bahri BECI

PËRFAQËSUESIT E GJUHËSISË ZYRTARE TË PASLUFTËS PËR LËVRIMIN E SHQIPES SË SHKRUAR

Dua të sqaroj që në fillim që emërtimin "përfaqësues të gjuhësisë zyrtare të pasluftës" e përdorim në kuptimin "përfaqësues të mendimit të pranuar ose të paraqitur pas luftës si zyrtar".

Lidhur me qëndrimin ndaj shqipes së shkruar, përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare të pasluftës kanë mbrojtur pikëpamjen se forcat kombëtare, pas vitit 1912 ishin ndarë në demokratike dhe antidemokratike.

Sipas tyre, në njërën anë, u radhitën forcat demokratike, fryt i përpjekjeve të të cilëve ishte lëvrimi i gjuhës shqipe me synime konvergjente. Kundër tyre, nxorën krye disa pikëpamje divergjente, lokaliste e partikulariste, antikombëtare e antidemokratike e njëkohësisht edhe antihistorike. Flamurin e këtyre forcave reaksionare, sipas tyre, e morën sidomos krerët e urdhrave katolike.[1]

Dhe ne shtrojmë pyetjen: A është e vërtetë që në lëvrimin e shqipes pas vitit 1912 kemi dy drejtime të kundërta, një konvergjent nga të ashtuquajturat forca demokratike dhe një tjetër divergjent nga të ashtuquajturat forca reaksionare të kryesuara nga krerët e urdhrave katolike.

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e kanë dhënë prej kohësh E. Çabej dhe Namik Resuli.

E. Çabej dallonte brenda literaturës shqiptare dy periudha kryesore, periudhën parakombëtare (që nga fillimet deri në shekullin XIX) dhe periudhën kombëtare që fillon në shekullin XIX me Rilindjen tonë kombëtare. Për E. Çabejn "Më së pari na dalin në dukje trajtat e ndryshme, pastaj këto konvergojnë në njësinë letrare".

[1] A. Kostallari, "*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*", *Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe (20-25 nëntor 1972)*, Tiranë, 1973, f. 69-71. Sh. Demiraj, Buletin për shkencat shoqërore, Tiranë, 1952, f. 269-272).

Komponentja fisnore - regjionale dhe komponentja fetare me gjithë jetën kulturore e sociale përkatëse na "japin së fundi rezultanten nacionale". E. Çabej në asnjë rast dhe për asnjë periudhë nuk bën aluzion për kundërvënie, po për prirje konvergjente në njësinë nacionale. Kjo është, sipas tij, prirja e përgjithshme që ka karakterizuar gjuhën dhe letërsinë shqipe në periudhën kombëtare dhe në mënyrë të veçantë në gjysmën e parë të shekullit XX.[2]

Edhe N. Resuli, duke dashur të karakterizojë prodhimin letrar të periudhës para Lidhjes së Prizrenit, shkruante se është sporadik e krejt krahinor, lindur e zhdukur në qendra katolike, ortodokse e myslimane të Shqipërisë pa njësi, pa qëllime të caktuara e sidomos pa "pasoja". Sipas tij, me Shoqërinë e Stambollit nis literatura jonë e vërtetë, literatura e përbashkët. Prej asaj kohe katolikë, ortodoksë, myslimanë nuk shkruan më vetëm për bashkëfshatarët e tyre, por për mbarë Shqipërinë, për mbarë shqiptarët". Megjithatë pranon se edhe gjatë kësaj periudhe u përvijuan dy rryma të cilat i përfytyron si dy ingranazhe sahati të cilat edhe pse lëviznin secili për hesap të vet, kishin një qëllim të vetëm shënimin e orëve.

Qarku ku lëviz ingranazhi i parë, sipas tij, përfshin krahinat "më të largëta të jugës gjer përtej Fushës së Krujës". Ajo përfaqësoi në fillim kombin shqiptar pa dallim fisi a feje, d.m.th. gjithë toskët e gegët që gjendeshin brenda qarkut..., myslimanë e të krishterë... ".

Qarku i lëvizjes së ingranazhit të dytë nuk del përtej kufijve të Shkodrës. Po, pohon ai, edhe ky ingranazh "frymëzohej nga të njëjtat ndjenja, parime e qëllime[3]. Kjo provohet edhe nga ata që ka shkruar Engjëll Radoja, njëri nga autorët fetar shkodranë i përfolur se shkruante në dialektin shkodran pa u kujdesur as për mënjanimin e turqizmave: "Jam mundue me shkrue, tuj çalltis, nderi (deri) kû kam mujtë, m'u shporrë fjalve të gjuhëve të huajve, e tuj bâ gajret edhé, qi fjalët qi këndohen këtu, të jenë marrun vesht prej Shqyptarit të soçëm"[4]. Pra, nuk është e vërtetë se u bë bipolarizimi i forcave, se në njërën anë u radhitën forcat demokratike, fryt i përpjekjeve të të cilave

[2] E. Çabej, "Për gjenezën e literaturës shqipe" (botuar në vitet 1938-39 në revistën *"Hylli i Dritës"*), ribotuar në vëllimin *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Tiranë, 1994, f. 55-56.

[3] N. Resuli, "Gegërishtja apo toskërishtja", *Shkëndija*, Tiranë, 1940, nr. 2, f. 11-18.

[4] Shih *Shkrimtarët shqiptarë*, I, Tiranë, 1941, f. 155.

ishte lëvrimi i gjuhës shqipe me synime konvergjente dhe në anën tjetër forcat reaksionare me pikëpamje divergjente, lokaliste e partikulariste, antikombëtare e antidemokratike dhe antihistorike, flamurin e të cilave e paskan mbajtur krerët e urdhrave katolike.

Përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare shqiptare të pasluftës, kanë insistuar që nga Rilindja e gjer më 1944, dialekti më i shkruar e mi përhapur me shkrim në vendin tonë ka qenë gjatë gjithë kohës dialekti i jugut.[5]

Sipas tyre koineja letrare jugore, jo vetëm gjatë Rilindjes, por edhe në dhjetëvjetorët e mëpastajmë, ka pasur një përhapje më të gjerë në shkrim se sa dy bashkëvariantet veriore[6].

Po kërkimet më të reja në fushën e gjeografisë dhe sociologjisë së letërsisë shqiptare çfarë të dhënash statistikore ofrojnë lidhur me përdorimin e toskërishtes letrare dhe të gegërishtes letrare në letërsinë artistike?

Për këtë po i referohemi studimit "*Prijës për gjeografinë dhe sociologjinë e letërsisë shqiptare*" të botuar më 1997 nga S. Çapaliku.

S. Çapaliku lidhur me rolin e dialekteve në gjuhën e shkruar shqipe ka shkruar se opinioni shqiptar i pesëdhjetë viteve të fundit ka qenë tejet i dezinformuar në lidhje me raportet e vërteta në mes dy dialekteve bazë të shqipes.... Kështu, që në vitin 1952, janë bërë përpjekje për t'i mbushur mendjen lexuesit shqiptar se dialekti jugor ishte dialekti m'i shkruar shqip, duke sjellë shifra të falsifikuara. Kjo frymë ka zgjatur deri në ditët tona në Shqipëri, ose duke besuar apriori të dhënat e pavërteta, ose duke pasur dëshirë për t'i deklaruar si të vërteta.

Sipas tij, shkrimi shqip fillon me gegërishten dhe pak dekada më vonë, me Matrëngën në Itali, nis edhe shkrimi në toskërisht. Shkrimin në toskërisht, sa i takon numrit të veprave, e ndihmon kontributi letrar i bashkësisë arbëreshe të Italisë. Përndryshe, raportet në mes dy dialekteve të shqipes, nxjerrë prej librash të botuara e të shkruara brenda Shqipërisë, rezultojnë në favor të gegërishtes letrare.

---

[5] Dh. Shuteriqi, *Buletin për shkencat shoqërore*, IV, 1952, f. 7-9.

[6] A. Kostallari, "Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë", *Studime filologjike*, Tiranë, 1970, 2, f. 14.

"Shekulli XVII, shkruan ai, është shekulli i gegërishtes (6 vepra në gegërisht dhe 1 vepër në toskërisht). Për shekullin XVIII ka shkruar se rritet ndjeshëm numri i veprave në toskërisht (15 vepra në toskërisht dhe 8 vepra në gegërisht). Për shekullin XIX ka shkruar se i përket toskërishtes (131 vepra toskërisht dhe 43 gegërisht), kurse për shekullin XX jep shifrat 412 vepra gegërisht dhe 318 toskërisht, çka flet për superioritet të gegërishtes në këtë shekull në raport me toskërishten[7].

Pra, të dhënat statistikore të sjella për të vërtetuar mbizotërimin e njërit dialekt mbi tjetrin janë të diskutueshme, për të mos thënë të manipuluara nga pozita krahinore e politike të caktuara. Gjithsesi në përcaktimin e të dhënave statistikore janë përdorur metoda krejt të pasigurta që as për së largu nuk mund të vlerësohen si objektive. E dyta, insistimi në të dhënat statistikore dhe vënia e këtyre të dhënave pastaj në bazë të argumentimit të procesit të formimit të shqipes letrare, flet për mungesë argumentimesh të tjera, çka i vë krejtësisht në dyshim edhe përfundimet e arritura. Së treti, bërja objekt analizash statistikore herë e letërsisë publicistike herë e librit etj. është subjektive dhe nuk krijon mundësi për njohjen e tërësisë së problemeve që dalin në këtë drejtim. Nuk bëhet asnjë dallim ndërmjet publicistikës dhe letërsisë artistike për sa i përket rolit që kanë luajtur në kristalizimin e shqipes letrare. I jepet një rol ekskluziv mbizotërimit të publicistikës së shkruar në toskërishten letrare sikur ajo të përbënte çelësin e art të zgjidhjes së problemit. Gjithçka, pra, niset e përcaktohet nga parapëlqimet subjektive të studiuesit. E vërteta është se gegërishtja letrare dhe toskërishtja letrare deri më 1944 janë zhvilluar paralelisht me dallime sigurisht edhe sasiore, po këto kurrsesi nuk kanë luajtur rol përcaktues për zgjidhjen përfundimtare të problemit.

Sipas përfaqësuesve të gjuhësisë zyrtare të pasluftës ishte krijuar një koine letrare gjithëjugore e cila mbizotëroi jo vetëm nga përhapja, por sidomos nga niveli mjaft i lartë i njësimit.

[7] S. Çapaliku, *Prijës për gjeografinë dhe sociologjinë e letërsisë shqiptare*, cit., f. 71-73.

Si duhet vlerësuar pikëpamja se ishte krijuar një koine letrare gjithëjugore që prej kohësh i kishte pacaktuar trajtat e saj dhe kishte përforcuar, plotësuar e zgjeruar më tej tiparet e njësimit.[8]

I parë në vetvete ky pohim duket i drejtë. Është fjala për evolucion të një dialekti të shqipes që zhvillohet në kohë e që normalisht shkon drejt unifikimit e normalizimit. Mirëpo, në të njëjtën kohë, për gegërishten ata pohonin të kundërtën, thoshin shprehimisht se nuk u krijua dot një gegërishte e vetme e shkruar. Bëhet aluzion i hapët sikur në Shqipëri funksiononin dy praktika gjuhësore të kundërta, një në jug me prirje të forta njësimi dhe një në veri me prirje jo unifikuese.

Pa dashur të hyjmë në hollësirat e këtij diskutimi mendojmë se analizat që ka bërë N. Resuli për veçoritë e gjuhës së shkruar të autorëve me origjinë jugore hedhin dritë të mjaftueshme mbi këtë problem.

N. Resuli theksonte se: "Rregulla që ka dominuar në shekuj ndërmjet toskëve ka qenë, secili të shkruajë në të folmen e tij...". Kështu Perikopea e Ungjillit është shkruar në toskërishte jugore, Kavalioti dhe Danieli kanë shkruar në të folmen e Voskopojës (zona e Korçës), Muhamet Çami në të folmen e Çamërisë, vëllezërit Frashëri, Samiu dhe Naimi dhe nipi tyre Mithati kanë shkruar në të folmen e zonës Frashër - Korçë, Çajupi në atë të Zagorisë.

Po të dhënat nga gjuha e letërsisë artistike e gjysmës së parë të shekullit XX a e mbështesin pikëpamjen mbi praninë në letërsinë shqipe të shkruar të "një koineje letrare gjithëjugore me një bazë të gjerë" dhe me "një nivel të lartë të njësimit"?

Për këtë do t'i drejtohemi të dhënave të sjella nga N. Resuli për gjuhën e Frashërllinjve dhe të Konicës.

"Pavarësisht se edhe Konica ishte shprehur në favor të një gjuhe të përbashkët shqipe, që duhej të formohej nëpërmjet shkrirjes së dialekteve kryesore, ashtu siç kishin menduar letrarë të tjerë të Rilindjes, shkruan Resuli, megjithatë në praktikë, ai mendoi që t'i

[8] Dh. Shuteriqi, *Buletin për Shkencat Shoqërore*, Tiranë, 1952, IV, f. 4-12. *Buletin për Shkencat Shoqërore*, Tiranë, 1952, I, f. 54. A. Kostallari, "Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë", *Studime filologjike*, Tiranë, 1970, 2, f. 12-14.

afronte atij që shkruante, së pari një toskërishte të përbashkët në vend të një shqipeje të përbashkët. Për të arritur këtë ai i ktheu krahët nëndialektit toskë juglindor të Frashërllinjve dhe zgjodhi dialektin veriperëndimor, e më saktësisht të folurën që dëgjohet në Berat e në rrethinat e tij".

Qe një zgjedhje e drejtë, vazhdon Resuli, me të cilën Konica tregoi një intuitë të rrallë filologjike, sepse kjo e folme edhe në se fonetikisht është larg gegërishtes, në disa pika themelore i afrohet shumë së parës.

N. Resuli jep tetë tipare gjuhësore të së folmes së Dangëllisë që karakterizojnë toskërishten e shkruar të Frashërllinjve dhe që e dallojnë nga dialekti veriperëndimor, ose më saktësisht nga e folura që dëgjohet në Berat e në rrethinat e tij.

Resuli jep gjithashtu gjashtë tipare themelore të së folmes së Beratit të dëshmuara në veprën e Konicës.[9]

Në këto rrethana është e vështirë të përligjet pretendimi i përfaqësueseve të gjuhësisë zyrtare shqiptare të pasluftës mbi praninë e "një koineje letrare gjithë jugore me një bazë të gjerë" dhe me "një nivel të lartë të njësimit". Përkundrazi të dhënat nga gjuha e veprave të letërsisë artistike provojnë se në periudhën deri në vitin 1944, në sistemin e toskërishtes letrare ishin përvijuar dy variante themelore të toskërishtes letrare, ai i Frashërllinjve dhe ai i Konicës.

Edhe K. Cipo ka pranuar se "Naimi shkroi në dialekt të kulluar dhe bëri mirë, se dialekti është gurra e gjallë e popullit, se aty janë fshehur thesaret e gjuhës".[10] "Proza e Naimit bashkë me atë të Vretos, të Mitkos e të tjerëve shkrimtarë toskë të Rilindjes, shkruante A. Xhuvani, formon toskërishten e vjetër, kurse ajo e mbas kësaj periudhe formon toskërishten e re".[11]

Edhe pohimet për **"një nivel të lartë të njësimit"** të toskërishtes letrare janë të diskutueshme. Për veprën e Naimit kjo mund të quhet e

[9] N. Resuli, "Parathënie", f. XXXIV, në *Gramatika shqipe*, Bulogna, 1985; K. Cipo, "Lulet e Verësë (Mendime)", në *Illyria*, I, 37, 3, Tiranë, 4 janar 1936; "Naimi për gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1971, 3, f. 105.

[10] K. Cipo, "Lulet e Verësë (Mendime)", në *Illyria*, I, 37, 3, Tiranë, 4 janar 1936; "Naimi për gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1971, 3, f. 105.

[11] A. Xhuvani, "Naimi si poet e si prozator», në Literatura jonë, I, 3-4, Tiranë, maj-qershor 1947, f. 9-30.

provuar. Kështu për shembull studiuesit e Naimit kanë vërejtur shumë lëkundje në gjuhën e Naimit.[12]

Të gjitha këto nuk flasin për "një nivel të lartë njësimi" të toskërishtes letrare. Edhe të tjerë kanë pranuar se në bazë të gjuhës së Naimit është nëndialekti i Dangëllisë. Mbeten për t'u parë me këtë sy veprat e të gjithë autorëve jugorë. Ne, pa dashur të hymë në detajet e kësaj problematike e cila do të kërkonte shumë vend, do të lejohemi të sjellim vetëm dy fragmente të shkurta nga dy autorë toskë të së njëjtës kohë afërsisht:

Mithat Frashëri (Lumo Skendo) (1880-1949)

Të mukëtit

Brënda në t'errët shikoj nga finestra perëndimnë. Drita humbet, ca nga ca t'errëtit shtohetë, botën e mbulon një mjegull e zezë: n'atë kohë që tfaqetë nga perëndimi një flak' e hollë majë malevet, pandeh njeriu se drita, dita po vdesën për gjithënjë.T'errëtit si tym i zi më hyn' në shpirt dhe në zëmrë.

Mejtohem; pse lint dielli çdo mëngjes dhe pse shuhetë çdo natë! Them: pse pas dritësë na vjen kjo cip' e zezë!

Ca nga ca pushimi bëhetë m'i thellë, çdo gjë bje më një qetim. Ahere syt'e yjvet çelen dhe shikojnë dhen'e nxirë, të pikëlluarë.

Them: pse shikojnë kështú këtá yj? a po duanë të hedhinë pak' gaz mi dhet të nxirë, mi njerëzit. Këta sy ngjajnë më syt' e tu, o njeri. Po të tutë qeshin, qajnë, gëzohen, helmohen, çkëlqejnë, dhe shuhenë. Ata sipër atje në qiell, ata janë gjithënjë të çkëlqyerë.

[12] N. Resuli, "Parathënie", f. XXXIV, në *Gramatika shqipe*, Bulogna, 1985; K. Cipo, "Lulet e Verësë (Mendime)", në *Illyria*, I, 37, 3, Tiranë, 4 janar 1936; "Naimi për gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1971, 3, f. 105; Gj. Shkurtaj, "Disa vërejtje rreth gjuhës së Naim Frashërit", *Studime filologjike,* 1971, 3, f. 102.

Faik Konica (1875 -1942)

Letërsia e shekullit njëzet (*Fragment*)

Në shekullin njëzet, kemi disa vepra të dalluara që mund të cilësohen si letërsi e vërtetë, nëse me letërsi kuptojmë një zgjedhje artistike të fjalëve për të shprehur mendime dhe ndjenja. Para së gjithëve do të përmendja Gjergj Fishtën, një frat françeskan i lindur në Zadrimë, i cili është shumë më shumë se poet: për një çerek shekulli ai ka qenë një prijetar impresiv intelektual. Atë Fishta ka provuar të gjitha degët e letërsisë dhe gjithnjë me sukses poezinë, dramën, komedinë. Por, jashtë Shqipërisë, ai është i njohur vetëm si autor i Lahutës së Malcisë, një epi pastoral dhe heroik, për të cilin përkthimi gjerman i botuar në Laipcig, para disa vjetësh, jep një mbresë të kufizuar, meqë muzika e ritmit të Fishtës dhe ngjyra e tij e fjalëve, nuk mund të përkthehen.

Në Jug, Anton Zako, në një libër të quajtur "Baba Tomorri" (Tomorri është mali më i lartë në Shqipëri), ka përmbledhur një varg të vjershave të tij lirike. Sikur kur shkruan për bariun, duke i rënë fyellit pas stuhisë, sikur kur kredhet në mendime mbi kalueshmërinë e jetës dhe afrimin e vdekjes, vargu i tij ka gjithmonë një ritëm të butë magji pushtuese. Zako, që ishte njeri i kamur, kaloi njëzet vjetët e fundit të jetës së vet në Heliopolis, Egjipt, në vetminë e një vile, pa asnjë mik tjetër pos një dashnoreje dhe librave të tij.

Sipas përfaqësuesve të gjuhësisë zyrtare të pasluftës që "nga Rilindja e këndej nuk u krijua dot një gegërishte e vetme e shkruar, po dy: ajo e Shkodrës e ajo e Elbasanit" ose që varianti letrar verior ishte i përbërë nga dy bashkëvariante, bashkëvarianti letrar verior i mesëm, që ishte bashkëvarianti mbizotërues, dhe bashkëvarianti skajor (veriperëndimor) ose, siç është quajtur nganjëherë, "shkodranishtja" letrare me një përhapje mjaft të ngushtë.

Për të provuar këtë pikëpamje është sjellë si argument që gjatë viteve 1878-1910 janë botuar 234 libra, nga të cilat 60,60% në toskërisht (pa arbërishten) e 33,75% shkodranisht (pa të folmet e

ndryshme gege, të cilat përfaqësohen me 1%)".[13] Pra, shkodranishtja 33,75%, kurse të folmet tjera gege 1%. A nuk vërteton kjo se nga Rilindja e këtej nuk funksiononin dy gegërishte, ajo e Shkodrës dhe ajo e Elbasanit. Po kështu për periudhën 1800-1910 jepet shifra prej 4.33% për shkallën e përdorimit të të folmeve të tjera të gegërishtes, përjashtuar shkodranishten, rreth 33%.[14] Po kjo shifër çfarë tregon? Është e qartë, pra, se statistikat e sjella nga vetë përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare të pasluftës provojnë se në Shqipëri funksiononte vetëm një gegërishte ajo veriore a veriperëndimore.[15]

Këtu është me interes të shënohet gjithashtu që E. Çabej, kur shënon që letërsia jonë kombëtare vjen si rrjedhojë e derdhjes në lumin e letërsisë kombëtare të shekullit XIX e tri qarqeve parakombëtare siç janë Qarku katolik i Shqipërisë Veriore, Qarku italo-shqiptar dhe Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore, nuk lë kurrfarë dyshimi për mundësinë e pranisë së një qarku të Shqipërisë së Mesme apo të Elbasanit. Pra, në Shqipëri, përveç letërsisë së Qarkut katolik të Shqipërisë veriore të shkruar mbi bazën e gegërishtes veriore a më mirë veriperëndimore nuk ka pasur letërsi të një qarku tjetër të shkruar në elbasanishte.

Janë kuptimplote lidhur me këtë problem diskutimet e bëra në mbledhjet e Komisisë Letrare Shqipe në Shkodër më 21 nëntor 1916, pra tre muaj pas fillimit të aktivitetit të KLSH.

Sipas Sotir Pecit, *sot për sot të shkruem janë vetëm dialekti i Shkodrës edhe i Toskënis*". Për Fishten *mungonte një letërsie në dialektin e Elbasanit*, kurse për Gurakuqin *letërsia e shkruar në dialektin e Elbasanit përfaqësohej nga shkrimet e Kristoforidhit***.** Kurse Gjergj Pekmezi e Sotir Peci mendonin se shkrimet e Kristoforidhit ishin *ndë nji gjuhë gegnishte të përzime* etj.

Po më mirë le t'i drejtohemi edhe një herë statistikave. Numri i shkrimtarëve me origjinë nga Shqipëria veriore në raport me ata me origjinë nga Elbasani për shekujt XVI-XIX është 24/2. Po të fusim në

[13] Dh. Shuteriqi, *Buletin për Shkencat Shoqërore*, Tiranë, IV, 1952, f. 4.
[14] Dh. Shuteriqi, po aty.
[15] Dh. Shuteriqi, Buletin për Shkencat Shoqërore, Tiranë, I, 1952, f.52-54, IV, 4-6. A. Kostallari, Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, cit., f. 3-14; Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj, cit., f. 66-72.

një grup me shkrimtarët me origjinë nga Elbasani edhe ato me origjinë nga Tirana dhe Durrësi raporti do të ishte 22/4. Në shekullin XIX qendrat e tjera gege, përveç Shkodrës, ishin shuar.[16] Pra, duhet pranuar që në Shqipëri në periudhë 1860-1912, po edhe më vonë funksiononin dy variante të shqipes së shkruar toskërishtja në jug dhe gegërishtja veriore a veriperëndimore në veri. Sigurisht që brenda tyre, pra të gegërishtes dhe toskërishtes letrare vihen re dallime. Ne deri tani kemi arritur të veçojmë brenda toskërishtes letrare dy variante themelore atë të Naimit dhe atë të Konicës, po edhe këto pohime kërkojnë vështrime të tjera më të përafërta. Prania e dy bashkëvarianteve veriore nuk del e vërtetuar. Kështu që duhen të dhëna të tjera për të vërtetuar tezën e pranisë së dy bashkëvarianteve veriore. Pra, të dhënat e letërsisë artistike nuk i konfirmojnë pohimet e përfaqësueseve të gjuhësisë zyrtare të pasluftës që "nuk u shkrua një gegërishte, po... dy: ajo e Shkodrës e ajo e Elbasanit..." ose se varianti letrar verior ishte i shprehur "në dy bashkëvariante - në bashkëvariantin e mesëm e në atë veriperëndimorin".

Sipas përfaqësuesve të gjuhësisë zyrtare të pasluftës në pragun e çlirimit koineja letrare jugore kishte thithur e bluar në strukturën e saj një varg elementesh të bashkëvarianteve letrare veriore dhe që kjo ishte bërë një dukuri e vetëdijshme. [17]

Është e vërtetë që në veprën e Naimit, për shembull, janë vënë re disa elemente nga dialekti i veriut ose edhe ndonjë shkodranizëm, po kjo nuk mund të interpretohet kurrsesi si "thithje" e aq më pak "bluarje" në strukturën e toskërishtes letrare "të një vargu elementesh të bashkëvarianteve letrare veriore" për një arsye fare të thjeshtë që ato edhe në rastin më të mirë nuk janë bërë pronë e toskërishtes letrare. Kështu për shembull janë me interes shfaqjet e paskajores gege të tipit *me+pjesore* në veprën e Naimit në funksione të pjesëve të nënrenditura shkakore, qëllimor etj., po ato nuk janë bërë pronë e toskërishtes letrare në përgjithësi, pra nuk e gjejmë në mënyrë

[16] S. Çapaliku, Prijës për gjeografinë dhe sociologjinë e letërsisë shqiptare, cit., f. 43.
[17] Dh. Shuteriqi, "Sesioni i parë shkencor i Institutit të shkencave për vitin 1952", në *Buletin i Institutit të Shkencave*, Seria e shkencave shoqërore, janar-mars, 1952, Nr. 1, f. 54. A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, cit., f. 69; *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, cit., f. 14.

sistematike tek asnjë autor me origjinë jugore para dhe pas Rilindjes. Kur flasim për elemente të bashkëvarianteve letrare veriore, kemi parasysh ata elemente që vlerësohen nga studiuesit si tipare dalluese të dy dialekteve të shqipes dhe jo fjalë a forma me shtrirje të kufizuar dialektore që nuk mund të vlerësohen si raste të bashkëveprimit të dy dialekteve të shqipes. Pra, është për t'u marrë me rezervë ose më mirë nuk qëndron pretendimi i përfaqësueseve të gjuhësisë zyrtare të pasluftës se "Në pragun e çlirimit koineja letrare jugore kishte thithur e bluar në strukturën e saj edhe një varg elementesh të bashkëvarianteve letrare veriore" ose se "Thithja e këtyre elementeve, që filloi të dukej pak a shumë qartë sidomos aty nga mesi i viteve 30 të shekullit tonë si një dukuri e vetëdijshme në hallka të veçanta të gjuhës së shkrimit, në vitet 40 u zgjerua më shumë".

Përfundime

Të dhënat e letërsisë provojnë se në Shqipëri funksiononin gegërishtja letrare dhe toskërishtja letrare. Në themel të gegërishtes letrare ishte gegërishtja veriperëndimore me shfaqjet e veta specifike nga njëri autor tek tjetri. Pra në bazë të gjuhës së shkruar të Fishtës, të Koliqit, të Migjenit, të Mekulit po edhe të të tjerëve më të hershëm si D. Nd. Nikajt, Nd. Mjedës, Prenushit ishte gegërishtja veriperëndimore e cila pas vendimeve historike të Komisisë Letrare të Shkodrës synonte gjithnjë e më shumë drejt formave më të përgjithshme, po gjithmonë brenda makrosistemit dialektor të gegërishtes.

Edhe për toskërishten letrare mund të thuhet pa frikë e njëjta gjë. Pra, edhe toskërishtja e Konicës, e M. Frashërit, e Nolit, e A. Asllanit, e Poradecit, e Kutelit, e Spasses etj. po shkonte drejt formave gjithnjë e më të përgjithshme, po gjithmonë brenda makrosistemit dialektor të toskërishtes, pa thithur e bluar siç pretendojnë përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare të pasluftës në strukturën e saj elemente të bashkëvarianteve letrare veriore. Pra, në gjysmën e parë të shekullit XX deri në prag të Luftës "në Shqipëri funksiononin dy variante letrare themelore, gegërishtja letrare me bazë të folmet veriperëndimore të shqipes dhe toskërishtja letrare me bazë toskërishten veriore të cilat shkonin paralelisht drejt formave më të përgjithshme, po gjithnjë secila brenda

kuadrit të makrosistemit të vet dialektor. Duke qenë se baza dialektore e gegërishtes së shkruar ishte më e përthyer dhe me më shumë inovacione, sidomos fonetike, të zhvilluara në periudhën pas shek. XV, autorëve veriorë iu desh të bënin dhe bënë një punë të veçantë të vetëdijshme për mënjanimin nga gegërishtja letrare e shkruar të formave nëndialektore në të mirë të formave më të përgjithshme e më të vjetra, po gjithnjë në kuadrin e makrosistemit të gegërishtes, të cilat praktikisht ishin ose të njëjta ose të afërta me toskërishten letrare të shkruar. Vendimet e Komisisë Letrare të Shkodrës më 1916-1917 kanë qenë vendimtare në këtë proces. Ata, edhe pse pranuan si parim themelor që "orthografia e gjuhës të jetë, për sa të mundet fonetike" dhe që si bazë për të të merrej "dialekti i Elbasanit me disa përmirësime", me vendimet që morën u larguan mjaft prej këtij parimi. Pas këtyre vendimeve që u morën në sajë të largpamësisë, të kompetencës dhe të tolerancës së personaliteteve të tilla të shquara, do të theksoj, shumica dërrmuese e të cilëve ishte nga Shqipëria e Veriut, si Gj. Pekmezi, A.Xhuvani, L. Gurakuqi, Gj. Fishta, N. Mjeda, H. Mosi etj. u mënjanuan pothuajse përfundimisht variantet nëndialektore sidomos në sistemin fonetik të gegërishtes së shkruar. Pas këtyre vendimeve dallimet në sistemin fonetik po edhe morfologjik të dy varianteve të shkruara të gjuhës letrare paraqiteshin minimale dhe nuk krijonin asnjë vështirësi për komunikim. Kjo ishte vetëm njëra anë e problemit. Ana tjetër, ndoshta edhe më e rëndësishmja ishte se të dy variantet, duke u ushqyer secili nga gurra e vet popullore kishin përpunuar e po përpunonin gjithnjë e më shumë mjete të posaçme shprehëse përmes zhvillimit sidomos të letërsisë artistike. Pra, në mënyrë krejt të natyrshme të dy variantet e gjuhës letrare të shkruar po shkonin drejt niveleve të reja, pra po modernizoheshin. Një letërsi moderne, siç po emërtohet me të drejtë letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX, nuk mund të konceptohet pa një gjuhë moderne. Pra, paralelisht me modernizimin e letërsisë shqiptare po modernizohej edhe gjuha shqipe e shkruar në dy variantet e saj themelore. Për të ilustruar për shembull evolucionin e gegërishtes së shkruar po sjellim një fragment nga vepra Shkodra e rrethueme (1913) e Ndoc Nikajt (1862-1951) dhe një fragment nga tregimi i mirënjohur i Millosh Gjergj Nikollës, Migjenit (1911-1938) Legjenda e misrit (1936):

Ndoc Nikajt

KNDOISIT

Pershkimet e ktyne diftimeve qi po çfaqim janë teper t'shpeita e nen kuitim t'gjith atyne qi kan per t'i kndue n'mnyrë qi se i cilli mundet me dhanë gjikimin e vet per mîi dreitii t' tyne.

Mêrret vesht prejë vedit se êmnat e gjindve t' permendun janë t' ndryshuem aq saa mos me zblue çiltas raasa t'nollme n'gjytet ku se i cilli kishte me mûitë me daa me gisht atê e ktê t'permêndun, pse ndoshta s'kishte me i pasë ânde m'u diit saa do qi nderim e jo poshtnim kishin me pasë prejë komtarve per shkase t'komsiis t'diftueme nder kohë t' vshtira aq saa me bâa flii vehten e dashtniin e zmrave veta per komsii e lirii Shqyptare.

N' kioftë se ndonji randsii munden me pasë kta diftime faqe t'komtarve t' onë, nji t'vetme kan e kio âsht ndoshta e vetme qi nên tingllim t'topave, nên vishkullim t'gjyleve qi kaluene mîi krye e nên ushtimë t' pushkve qi krisne per rreth saa Shkodra met n'rrethim t'gjitha u shkruene.

Nji t'falun komtarve

Migjeni

LEGJENDA E MISRIT

Misër! Misër!

Në shekullin e njëzet s'ka apoteoza perëndish, por ka apoteoza misri. Bjeshkët tona, që dikur qenë lterët e apoteozave perëndish, sod janë lterët e apoteozës së misrit.

Një kokërr misri asht kokërrz dhimbje kur ka shumë u e aspak misër.

Fjala misër përmban në vete legjenda të linduna nga dëshira për jetë. Dëshira për jetë asht e madhe dhe e mahnitëshme sa edhe malet tona që hapin gjitë për me varrosë njerzit e unshëm. E në lartësinë e malevet vigane, legjendë asht dhe lindja, legjendë asht dhe

jeta, legjendë asht dhe vdekja. Dhe kjo legjendë i idhtë dhe plot vuejtje historike në shekullin e njëzet asht e thekshme, zemërbrese dhe të ban të qajsh.

Misër! Misër!

Thirrja për shpëtimin e jetës. Apoteozë e shekullit të njëzetë! Emën perëndish sot nuk zejnë me gojë fëmitë që posa kanë fillue të belbëzojnë - por misër! - misër! - asht fjala e ditës, asht sinonim i jetës për banorët legjendarë të këtyre malevet të egra.

Ushtojnë luginat e malevet nga fjalët e malsorëvet t'unshëm, që varg, njeni tjetrit, ecin të ngarkuem me ka një gjysëm thesi misër. Vargu i tyne asht i gjatë, pa fund, si asht e gjatë e pa fund vuejtja e tyne. Mbi kurriz të vet barin ka një gjysmë thesi misër, barin jetën e vet, barin perëndin'. Perëndi i vërtetë - misër i dëshiruem!

Pikërisht zhvillimi e përpunimi i tyre i mëtejshëm duhej të ishte dhe duhej të bëhej edhe pas Luftës problem themelor i një politike gjuhësore që pretendonte se ishte shkencore e kombëtare. Po të vazhdohej në këtë rrugë vetvetiu, në mënyrë të natyrshme e në kohën e duhur do të shtrohej e zgjidhej "me të marrë vesh" siç thoshte Konica edhe problemi i mënjanimit përfundimtar të atyre pak dallimeve që kishin mbetur në sistemin fonetik e morfologjik të tyre. Po çfarë ndodhi? Në të vërtetë me rrugë administrative ju pre rruga zhvillimit të natyrshëm variantit verior ose gegërishtes letrare të shkruar. Si pasojë e kësaj strategjie, si edhe e gjenocidit që u vendos ndaj një pjese të mirë të trashëgimisë letrare e gjuhësore të shkruar nga autorë veriorë, gradualisht u shkëputën pothuajse plotësisht lidhjet me pasurinë gjuhësore e kulturore të shkruar në gegërishten letrare çka nuk mund të ishte pa pasoja në zhvillimin e përparimin e vetë shqipes letrare.

Shefki SEJDIU

ÇABEJ I DISKUTIMEVE NË KONGRESET DHE KONFERENCAT SHKENCORE

Përpara se të parashtroj disa mendime rreth diskutimeve të Çabejt në tubimet shkencore, temë kjo jo aq e rëndomtë për analiza dhe vlerësime rreth kontributit të një personaliteti të shquar të dijes shqiptare, do t'i thoja disa fjalë rreth institucionit të tubimeve shkencore pa hyrë në imtësia rreth karakterit dhe rangut të tyre.

Tubimet shkencore si forma organizimi e pune janë të një rëndësie të veçantë informimi e interkomunikimi shkencor. Ekziston mendimi i arsyeshëm se shkenca më së shumti përparon përmes tubimeve shkencore dhe separatëve[1]. Në këto tubime zhvillohen edhe aktivitete interkomunikimi intelektual e hulumtues interesash e formash të shumëllojta.

Format e komunikimit dalin nga vetë natyra e punës dhe aktorëve që alternativisht bëhen edhe dhënës e marrës të mesazheve, që presupozon rolin e folësve, përkatësisht dëgjuesve, në këtë rast të kumtesave e të debatit. Nëse një referues trajton çështje të ndryshme, pjesëmarrësi dëgjues mund të motivohet e të cytet të reagojë ndaj kumtesës të një a më tepër referuesve dhe mendimeve të parashtruara. Këtë kompleksitet problemesh e trajtimi imponon shumësia e universit preferencial kognitiv që kurdoherë është në qendër të vëmendjes së hulumtuesve.

Gjatë procesit të komunikimit shkencor qoftë ky edhe i institucionalizuar siç është edhe i tubimeve shkencore, paraqiten forma institucionalisht e motivisht të ngarkuara që shprehen si diskutime, intervenime (ndërhyrje), respektime (sqarime), debatime, polemizime, qortime (të buta e të ashpra) e grindje, që krijojnë paradigmë edhe hierarkike nocionesh komunikimi.

[1] Me termin tubim shkencor nënkuptoj punën e organizuar dhe të programuar, ku parashtrohen idetë dhe rezultatet, si dhe përfaqësimin e të arriturave shkencore-hulumtuese personale, institucionale, por edhe kombëtare.

Konferencat shkencore kanë qenë pjesë e pandashme e veprimtarisë së frytshme shkencore të Çabejt. Ai përfaqësoi gjuhësinë shqiptare në vend dhe jashtë vendit. Çabej i konsideronte diskutimet shkencore të një rëndësie të veçantë. Diskutimin në Kuvendin e Parë të Studimeve Ilire (1972) e ka filluar me fjalët që meritojnë të shënohen: "Besoj, thotë Çabej, se DISKUTIMET e djeshme dhe të sotmet na kanë vërtetuar më së miri që në kongrese e në kuvende DISKUTIMET e SHKËMBIMET e mendimeve shpeshherë dalin më të frytshme se kumtesat, ligjëratat e referatet"[2].

Në saje të formimit të tij intelektual e shkencor Çabej ka ndërtuar një sistem pune e veprimi në tubime shkencore nivelesh të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare ku janë trajtuar çështje albanologjike të periudhave të ndryshme që nga lashtësia deri në gjysmën e dytë të shekullit XX.

I bindur për kompleksitetin e çështjes, Çabej iu kushtua çështjes me seriozitetin më të madh (e, për çështje të tilla është e nevojshme pjesëmarrja e hulumtuesve shqiptarë me kumtesa e me diskutime) sepse duhej përballuar me ide e pikëpamje jo gjithherë shkencore të bazuara, subjektive e simpliciste, intencionale e me referenca jo të plota e jo reale. E, dihet tanimë se fusha apo aksi i *referencës* është hapësirë ku rrahen mendimet për hulumtimin dhe gjetjen e reales, të cilën pra duhet hetuar, gjetur, veçuar, njohur e vlerësuar brenda universit kognitivo-referencial. Por, kur realja, e vërteta, e kërkuara perceptohet dhe konceptohet e shtyrë nga motive intencionale, subjektiviste e individualiste, ky lloj perceptimi shpie tek shumësia e mendimeve që provokojnë debat. Mbi këtë bazë motivuese edhe qëndrojnë ndërhyrjet e Çabejt rreth kumtesave e diskutimeve të dhjetëra studiuesve të njohur si V'. Georgiev, Katiçiq, Desnickaja, Gëlëbov, Rich, Al. Roseti, Mihaescu, Galdin, V. Pisani, C. De. Simone, Bonfante, St. Mann, Z. Skiro, Ajeti, Ceka, Z. Sako, Demiraj, Lafe etj.

Po, si duket paraqitja e Çabejt në diskutimet në vend dhe jashtë vendit, përkatësisht në raport me vendorët dhe të jashtmit?

[2] E. Çabej, Diskutim në Kuvendin I të Studimeve ilire, mbajtur në Tiranë, në shtator '72.

Me bashkëkombësit e tij Çabej është kolegjial, didaktik e principiel; me të huajt (mysafirë) tek Çabej vërehet ndjenja e mikpritjes, e përgjegjësisë dhe e respektit, por edhe e parimësisë dhe konsekuencës.

Jashtë vendit, Çabej me bashkëkombësit e tij është i afërt, i kujdesshëm dhe metodik, kurse me të huajt është i matur, i paimponueshëm, serioz, dinjitoz, principiel, me një ndjenjë të theksuar kompetence, përfaqësimi e përgjegjësie intelektuale.

Te Çabej edhe si diskutues duket i qartë formimi dhe informimi si në fushë të gjuhësisë njashtu edhe në disiplina të tjera konverguese që lidheshin me origjinën, atdheun, historinë dhe gjuhën e popullit shqiptar.

Çështjet rreth të cilave Çabej ka debatuar në konferenca janë nga më të ndryshmet: si ato rreth origjinës së popullit, të gjuhës dhe vendit të formimit rreth autoktonisë dhe argumenteve dhe dëshmive të sjella nga disiplina të tjera konvergjuese diakronike, rreth fenomenit të ambiguitetit, apriorizmit, simplifikimit, rreth fiksimit të kritereve, rreth subjektit gjuhësor, rreth shtresimeve dhe krahasimeve midis gjuhëve (mesapishtes e shqipes), rreth ndarjes kentum-satem, rreth marrëdhënieve kelto-ilire, rumuno-shqiptarëve, rreth kontakteve dhe ndikimeve lashto-greko-proto-shqiptare, latino (proto) shqiptare, rreth evaluimit të tingujve, rreth geminanteve në shqipe, rreth ndikimit të faktorëve të jashtëm në karakterin ballkanik të shqipes, rreth nyjave, rreth leximit dhe interpretimit të mbishkrimeve etj.

Në të gjitha këto çështje të trajtuara nga të tjerët, qoftë në formë kumtese apo diskutimi, Çabej në ndërhyrjet e veta tregohet njohës i mirë i problemeve me sens të theksuar të çështjes interdisiplinare, induktivit e komparativist, që mjeshtërisht shfrytëzon evidencat gjuhësore dhe kontekstet e ndryshme për njohjen e çështjeve që trajtoheshin.

Në diskutime Çabej qorton qasjet simpliciste, arbitrare, improvizuese, intencionaliste, si dhe rekonstruktimet dhe gjeneralizimet e bazuara në të dhëna ekskluzivisht të izoluara e eksterne (Vl. Georgiev). Përkujton kritere e parime universale e specifike, vlerësuese, saktësuese (E. Lafe); sugjeron përcaktimin e

vlerave të koncepteve si p.sh., invencion, konservacion gjuhësor (Sh. Demiraj).

Shikuar nga aspekti metodologjik Çabej ndjek rrugën e argumentimit dhe arsyetimit: nuk e qorton autorin (e kumtesës apo diskutuesin), por idenë e tij të shfaqur *hic et nune;* në disa raste pa e shfaqur në mënyrë eksplicite mospajtimin me referuesin apo diskutuesin, Çabej ia kundërvë mendimin e vet (si te Borssin). Ndodhë që të pajtohet me mendimin e referuesit për çështje të caktuara (Roseti, Ajeti), por me qëllim përforcimi e potencimi sjell edhe mendime të ngjashme të të tjerëve, pra përforcon hipotezën. Ka raste kur duke mbrojtur mendimet që aty shfaqen (A. Desnickaja) mbron edhe të vetat, kështu që (shpeshherë) përdor edhe mënyra indirekte komunikimi (Georgiev: Desnickaja: Çabej).

Ndodh që referuesit a diskutuesit Çabej t'ia pranojnë njërën anë të sqarimit të çështjes, por gjatë diskutimit Çabej jep sqarime edhe për pjesën tjetër (tek Bonfante). Diskutimi i tij shpeshherë është sqarues a mjaft diskursiv, pra edhe argumentues me elemente krijimtarie spontane të dala nga një situatë ad hoc; shumë diskutime të Çabejt u ngjajnë kumtesave të shkurtra me rezultate të dukshme.

Bie në sy edhe realizimi gjuhësor, përkatësisht strukturimi formal e përmbajtësor për këtë lloj komunikimi shkencor. Toni dhe ritmi si dhe struktura e tekstit janë të stilit akademik dinjitoz (V. Georgiev: centracionist, kategorik, autoritar = Çabej: decentracionist, relativist, tolerant)[3].

Çabej në rrafshin preferencial përdor referenca të plota dhe joekuivoke dhe jointencionale, eviton struktura të tipit elokutor, si: them, kundërshtoj, hedh (poshtë), korrigjoj e, në vend të tyre përdor modelet: më duket, mendoj, supozoj, saktësoj, etj.

Përdor veten e parë të shumësit për rezultate, suksese, kurse veten e parë të njëjësit e përdor tepër rrallë që sugjeron modesti dhe vetpërgjegjësi. Në *diskursin* debatues të Çabejt më shpesh del veta e tretë e njëjësit apo pavetësorja si forma objektive e depersonalizuese (Traimer, Ajeti).

[3] I krahasova këto personalitete, ngase i takonin të njëjtës hapësirë (ballkanike, por lindje perëndim), të njëjtës moshë (1908) dhe të njëjtës shkollë (vjeneze).

Gati gjithherë emrat e individëve qofshin ata autorë të kumtesave, diskutues apo reflektues janë të paraprirë nga titujt, thirrje dhe struktura të tjera honorifike.

Në Diskursin debutues të Çabejt në konferenca shkencore më së shpeshti hasën nocionet dëgjim, observim, mendim, pritje, dëshirë, urim, përgëzim, kurajim, pohim, saktësim, sqarim, plotësim, prurje, përzgjedhje, krahasim, argumentim, vlerësim, konkludim, të artikuluara me struktura verbale, rëndom në vetën e parë shumës, struktura këto që përbëjnë një lloj paradigme konceptuale ndërkomunikuese e vlerësuese shkencore.

Dhe për fund do të shtoja se në shumë raste Çabej nuk i hesht as ngatërrimet (e që dalin me qëllim apo pa të) midis primares e sekondares, universales e partikulares, esenciales e formales, kreatives e improvizueses, shkencores e arbitrares, kompatibiles e inkompatibiles - kategori këto kundërvënëse akriologjikisht dhe epistemiologjikisht relevante.

Gjovalin SHKURTAJ

NGJYRESA KRAHINORE TË STANDARDIT SI TREGUES TË RELATIVIZMIT TË NORMËS DHE KAHEVE TË MUNDSHME PËR PASURIM E PËRDITËSIM TË MËTEJSHËM[1]

Para se të parashtroj sa kam për të thënë në kumtesën time modeste e pikërisht për t'u kuptuar më mirë nga të pranishmit, e ndjej për detyrë të shpreh edhe njëherë vlerësimin tim se gjuha letrare shqipe e njësuar (apo *shqipja standarde*, siç po quhet tashti së voni nën trysninë e terminologjisë amerikane) është fitore e pallogaritshme e përbashkësisë shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve.

Në librin tim "Sociolinguistika" (SHBLU, Tiranë, 1999) kam trajtuar enkas e mjaft gjerë pikërisht ngjyresën krahinore të gjuhës letrare, duke prurë edhe shumë të dhëna nga hulumtimet e vëzhgimet e mia tashmë shumëvjeçare në lëmin e dialektologjisë, pastaj edhe të sociolinguistikës, por duke pasur kurdoherë si pikënisje kundrimin: nga dialekti tek gjuha standarde apo, me një formulë të sociolinguistikës së sotme italiane, duke mëtuar të kalojmë nga "dialektologjia hapësinore" në "dialektologjinë urbane".[2]Aty, me sa ka qenë e mundur nga hulumtimet e derisotme, **i kam dhënë rëndësi pikërisht nxjerrjes në pah të ngjyresës krahinore si fazë e ndërmjetme drejt gjuhës letrare**. Unë i mbahem mendimit se zhvillimi i sotëm i të folmeve popullore apo përgjithësisht i dialekteve shqiptare nuk mund të shihet i shkëputur nga rrjedhat e zhvillimit dhe kaheve të përgjithshme kulturore dhe mendore të bashkësisë shoqërore shqiptare shtetërore e më gjerë. Në mënyrë të veçantë ka luajtur rol shtrirja e gjerë e arsimimit, shtimi i peshës së mjeteve të informimit masiv (shtypit, radiotelevizionit) dhe i lirisë së fjalës publike. Disa

[1] Këtë tematikë, në fakt, e kemi trajtuar edhe më parë, sidomos në kumtesën e mbajtur në Konferencën Shkencore me temë "Gjuha standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002, porse ajo nuk është botuar as në "Aktet " as në ndonjë organ tjetër.

[2] Gj. Shkurtaj, *Ngjyresa krahinore si fazë ndërmjetëse drejt gjuhës letrare*, në "Sociolinguistika", Pjesa II, Shqyrtime thelluese dhe mbështetëse, SHBLU, Tiranë, 1999, f. 205-228.

prej dukurive që ndeshen në këtë zhvillim gjuhësor ne i kemi pasë përfilluar disi qysh në vitet '70 në trajtimet e marrëdhënieve të sotme gjuhë letrare-dialekt në disa treva veriore të zonës së Koplikut[3], pastaj edhe më gjerë në kundruellsinë e trajtave dialektore dhe letrare në të folmen e qytetit të Lezhës[4]. Aty kam shprehur bindjen time (por që s'është e s'ka si të ishte vetëm e imja) se vetëm një gjuhë e vetme, vetëm një varietet standard me normë të njëjtë drejtshkrimore të përbashkët për të gjithë bashkëkombasit shqiptarë dhe me strukturë gramatikore e leksikore të përcaktuar nga norma të gjalla e të studiuara mirë, mund të përballojë nevojat kaq shumë të shtuara të shprehjes dhe të krijimit që u dalin sot shqiptarëve, se vetëm një gjuhë e tillë, e fuqishme dhe e përpunuar, po edhe e mbrojtur përkushtimisht nga rreziqet gjithashtu aq të shumta po edhe të shtuara dukshëm në ditët tona, mund të shpërfillë edhe ndarjen në shtete, edhe mbylljen e kufijve ndërmjet shqiptarëve të Republikës së Shqipërisë nga trojet shqiptare jashtë saj në shtetet fqinje apo në diasporë; është pikërisht kjo gjuhë jona e përbashkët që ka treguar e dëshmon se kombi ynë shqiptar ka qenë dhe është një dhe i vetëm, qoftë edhe pse i ndarë në disa shtete në Ballkan e në gati të gjithë botën në formë diaspore. Sa kohë që edhe shqiptarët e shprishur nëpër dhera të tjera vijojnë ta quajnë vetën të tillë, sa kohë që edhe ata, njësoj si ne në trojet tona të moçme, ndonëse janë larg me trup, përbetohen e shprehen për shqiptarinë dhe vijojnë t'i duan gjuhën shqipe e traditat shqiptare, e kemi për detyrë që t'i përfillim e t'i lidhim të gjithë sa janë në një fill të përbashkët të komunikimit: në gjuhën shqipe të njësuar e të përpunuar sa më hijshëm.

Gjuha letrare standarde dhe të gjitha varietetet e ndryshme brenda saj kanë qenë dhe do të mbeten kurdoherë në lidhje e ndërveprim me njëra-tjetrën dhe, po të shprehemi me një figurë letrare, ato janë si lëngjet në „enët komunikuese". Ajo çka vjen nga anët dhe rrethinat (periferitë), qoftë edhe e turbullt apo e pakulluar, herë do të zbrapset nga vrulli më i fuqishëm i ujërave të gjuhës letrare të njësuar, herë (përkundrazi) do të shkrihet, përzihet e, me kohë, do të

[3] Gj. Shkurtaj, *Rreth ndryshimeve në gjuhën e fshatit të sotëm të Veriut* (mbështetur në të dhëna të zonës së Koplikut), "St. fil.", 1969, nr. 4, f. 162.

[4] Gj. Shkurtaj, *Vëzhgime mbi shtresat leksikore dialektore dhe letrare në të folmen e Lezhës*, "St. fil.", 1981, nr.3, f. 155-163 dhe *Shtresësime dhe risi gjuhësore në qytetin e Lezhës*, në "St. fil.", 1984, nr. 2, f. 75-93.

kthjellohet në përbërjen e gjuhës letrare të përbashkët. Gjatë më se 34 vjetëve, qysh nga „Konsulta e Prillit“ në Prishtinë (1968) dhe sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972), u pa shumë qartë se si, gjuha letrare shqipe standarde (apo zyrtare) sidomos në formën e saj të folur, shkon në dy kahe afërsisht sipas dy arealeve të ditura dialektore: njëra, arealja gege, që, ndërsa mbështetet tek norma e shkruar dhe mëton ta zbatojë gjuhën letrare, e realizon atë mjaft mirë, porse **me një ngjyresë fonike gegizuese** (p.sh. shqiptimi i /ë/ si /ê/: *bêj, nê:n, bêra, rêra, zêri* etj.); tjetra, arealja toske, që nuk kënaqet me ndonjë „qethje“ sado të pjeshme të bërë nga „Rregullat e drejtshkrimit“, **tërheq nga hipertoskizmi** (p.sh. shqiptimi me **/ ë/** të prapme i fjalëve me **/e/**: *vënd, mëndje, mëndoj, qëndër, fëmër, zëmër* etj). Për arsye të kohës nevojisht të kufizuar të kësaj kumtese po ndalem vetëm në një pohim që më intereson të theksohet: ndaj këtyre dy kaheve, që janë të dukshme, të prekshme dhe të ditëpërditshme, gjuhësia shqiptare (por edhe krejt shoqëria shqiptare e sotme në të gjitha hapësirat kombëtare), duhet t'i hapë sytë më mirë. Mendimi im është se *hipertoskizmat duhen krasitur e mënjanuar,* ndërsa timberve gege dhe sidomos *pasurisë leksikore të gegërishtes u duhen çelur më shumë shtigjet*. Ka ardhur koha të marrim parasysh më mirë e më shumë marrëdhëniet e normës së kodifikuar dhe të „goditjeve“ që vijnë në dyert e saj nga krahinat apo, thënë ndryshe, t'ua vëmë veshin më shumë „thyerjeve“ që po shtohen e që synojnë të fitojnë statusin e normës. Teorikisht është thënë dhe të gjithë e përsërisim shpesh se „normat e çdo gjuhe janë të gjalla e në lëvizje“, porse praktikisht po tregohemi të mefshët e të pazotët për t'i shqyrtuar ashtu siç meritojnë edhe prurjet që mund të mos jenë njësoj me normën drejtshkrimore, por që përbëjnë prirje të përshtashme ndaj zhvillimit të gjuhës shqipe të sotme. Mbyllja vetëm në „guaskën“ e asaj që është parashikuar si normë para 35 vjetëve, mbështetur në treguesit e atëhershëm, sot, në dritën e disa trysnive që na sjellin zbatimet (në fakt: moszbatimet a thyerjet) e ditpërditshme do të ishte jodobiprurëse[5].

[5] Shih më gjerë sa kemi shprehur në kumtesën tonë "Një tezë e Selman Rizës për gjuhën letrare shqipe" (Ngjyresa dialektore e gjuhës letrare shqipe në trevat veriore), botuar në "Phoenix", 2002) si dhe në kreun "Ngjyresa krahinore si fazë ndërmjetëse drejt gjuhës letrare", në librin tonë "Sociolinguistika", SHBLU, Tiranë, 1999, f.205-228.

Pas këtij pohimi të palëkundshëm, të cilin, qysh se kam mbajtur kumtesën time në Kongresin e Drejtshkrimit e deri sot, në të gjitha rastet e mundshme kur kam kumtuar, si dhe në artikuj për shtypin e në disa prej librave të mi, e kam mbrojtur e theksuar pa asnjë ngurrim, le të më lejohet të them se, ndërkaq, **shqipja standarde ka nevojë për përpunim e shqyrtim edhe më të kujdesshëm të disa aspekteve të normës**. Në mënyrë të veçantë duhet ta mbrojmë, ta pastrojmë nga ndikimet e huaja dhe ta pasurojmë me fjalë të bukura të trojeve tona. Mendoj se është e domosdoshme që, pa bjerrë mot, t'i bëhen disa përmirësime drejtshkrimit si dhe t'i rishikojmë më gjerë disa trajta a aspekte të pjesshme të normës, të cilat, me sa duket, në prerjen e parë (sado dorëmbarë e të lëvdueshme), nuk kanë gjetur trajtimin që duhet. Është pikërisht koha të mënjanohen nga norma drejtshkrimore dhe morfologjike disa hipertoskizma të panevojshme, për të cilat ka pasur e ka edhe mendime e propozime konkrete prej nesh[6], e prej gjuhëtarëve të tjerë, ndërsa norma leksikore duhet të jetë edhe më e hapur ndaj elementeve e pasurisë së madhe të gegërishtes.

1. Gjuha letrare kombëtare shqipe, e njëjtë dhe e përbashkët për të gjithë shqiptarët, së pari, ka nevojë **të mbrohet e të vlerësohet** ashtu siç e meriton nga të gjitha institucionet shtetërore e shoqërore, nga shtypi i shkruar e nga mediat e folura publike dhe private, po ajo duhet edhe të pasurohet me fjalë, frazeologjizma dhe mënyra të thëni të bukura që vijnë nga krahinat, duke u hapur edhe më shumë shtigje sidomos prurjeve nga trojet veriore e verilindore të shqipes. Nuk mund të mos kujtojmë, me këte rast, se kultura shqiptare prej atyre trevave trashëgon një nga pasuritë më të vyera, siç është Eposi i kreshnikëve - përmendore e paçmueshme e kulturës së të folurit dhe e pasurisë shprehëse të shqipes- që ka shërbyer e do të shërbejë edhe për shumë mot si gurrë e gjedhe e fjalës së thënë bukur, prej së cilës kanë përfituar të gjithë krijuesit më në zë, sidomos Gjergj Fishta, poeti që iu qas aq shumë e me aq dashuri dhe e pati si gjedhe për poemën e tij madhore "Lahuta e Malcis".

[6] Më gjerë për këtë jemi shprehur në trajtesat tona "Trajta foljore të gabuara apo "trokitje në dyert e normës" (në librin "Ta duam dhe ta ruajmë gjuhën tonë të bukur", SHBLU, Tiranë, 1998, f. 71-2) si dhe në kumtesën "Trysni gege që meritojnë të pranohen në gjuhën letrare të përbashkët", mbajtur në Konferencën shkencore kushtuar 60-vjetorit të vdekjes së N. Joklit, Universitati i Shkodrës "L. Gurakuqi", qershor 2002.

2. Së dyti, dua të theksoj se shqipja standarde sot, ndryshe nga 35 vjet më parë, **zbatohet e përdoret në një kohë kur, për gëzimin e harenë e shqiptarëve, shpatullat e shqiptarisë e të rrezatimit të gjuhës shqipe nuk kanë qenë kurrë kaq të gjera e me mëtime përbashkuese gjithëkombëtare** sa sot. E kemi për detyrë parësore që këtë rast fatlum të kombit shqiptar: mundësinë e shkëmbimeve dhe të komunikimeve të lira e të shumëllojshme njerëzore, ekonomike, shkencore, letrare e kulturore të bashkësive të ndryshme shoqërore ku janë sot shqiptarët në Ballkan, të mos e lëmë pa shfrytëzuar edhe për ndonjë rivështrim e përmirësim të normës drejtshkrimore e përgjithësisht për t'u hapur më shumë shtigje prurjeve të vlefshme e të domosdoshme në gjuhën letrare kombëtare të përbashkët edhe nga gegërishtja. Në mënyrë të veçantë duhet t'u qasemi pasurisë, larmisë dhe forcës shprehëse të leksikut e të frazeologjisë së krahinave të Veriut, të cilat, qoftë në masën që na janë fiksuar në letërsinë e autorëve që kanë shkruar në variantin letrar të gegërishtes, qoftë edhe nga gurra e gjallë e gegërishtes së folur apo nga folklori i Veriut, **duhen vlerësuar e vështruar kurdoherë si burime të freskisë dhe prurjeve të domosdoshme për gjuhën letrare të përbashkët**. Në ditët tona, plot 35-vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, pas gjithë asaj pune të frytshme që kemi bërë e që na nderon faqe breznive të gjalla e atyre që do të vijnë, puna më e mirë është që, **pa asnjë ngurrim e paragjykim krahinor**, ta shpiem edhe më tej njohjen e thesarit leksikor të shqipes truallësore, t'i ndjekim edhe më ngultas përfaqësuesit e vjetër e të rinj të gjeografisë letrare shqiptare, duke marrë parasysh më shumë e më mirë lëndën që ndejnë botimet dhe ligjërimi publik në krejt hapësirat etnike e kombëtare shqiptare dhe, në përputhje me prirjet e kahet e zhvillimit të sotëm arsimor e kulturor të të gjitha trevave shqiptare në trojet kompakte ballkanike e, madje, deri në diasporën arbëreshe, **t'u çelim shtigjet e nevojshme prurjeve më të vlefshme qoftë edhe kur na vijnë nga krahinat veriore.**

3. Përvoja e zbatimit të gjuhës letrare shqipe standarde në mbarë hapësirat shqiptare, tashmë pa kufijtë dhe pengesat e ditura politike dhe ideologjike, bashkë me demokratizimin e jetës, kanë sjellë gjithandej edhe demokratizimin e fjalës shqipe, kanë çelur hapësira të reja për t'i zgjeruar bashkëveprimin e ndërndikimet ndërmjet

krahinave anësore e qendrave të mëdha qytetare e kulturore, që nuk mund të merreshin me mend as kur u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit e kur u miratua Rezoluta e tij (1972), as kur u hartuan dhe u botuan "Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe" (1973) dhe veprat e tjera normative të ditura. Kam bindjen se, ashtu siç kanë bërë e bëjnë të gjithë popujt e qytetëruar, edhe ne duhet të ecim duke mos i mbyllur sytë përpara asaj që na sjell përvoja e zbatimit konkret të gjuhës shqipe standarde në mbarë hapësirat shqiptare. P. sh. këshillohet si normë fjala *shtatëzënësi-a* (Shih: *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 636) dhe lihet jashtë norme *shtatzani-a*. Kjo e fundit, vërtet vjen nga gegërishtja, porse përdoret gjerësisht nga mjekët, mamitë dhe në popull; pa asnjë dyshim, ajo është më e pranueshme për t'u përgjithësuar. Në mos tjetër, le të jepet si variant normativ, përderisa vjen prej një nënstandardi me hapësira të gjera. Dhe shembuj të tillë ka shumë.

Në mënyrë të veçantë, u duhet bërë vend fjalëve nga gegërishtja që mund t'i vlejnë saktësimit dhe diferencimit kuptimor, pa të cilat shpesh shqipja do të varfërohej e shëmtohej padrejtësisht. P.sh. në shqipen, ndryshe nga gjuhë të tjera, kemi fjalë të veçanta për të shënuar procesin e vdekjes tek njerëzit: *vdes / des-vdiqa / diqa, vdekur / de:k a dekun* dhe tek kafshët: *ngordh-ngordha-ngordhur, cof-cofa-cof a cofun.* Po ashtu, *çmendem -u çmenda -çmendur* për njerëzit, kurse për kafshët përdoret *ndërkrehet-ndërkrye-ndërkryer*, prandaj nuk duhet thënë *lopa e çmendur* (përkthim i panevojshëm nga it. *mucca pazza*), sepse ne kemi në shqipen popullore pikërisht një fjalë të posaçme për procesin e ndërkyerejs së kafshëve. Këtë fjalë shqipe e ndeshim edhe në veprat e Kadaresë: "...me studimin e trurit *të ndërkryer* të njeriut ballkanas" (Ra ky mort e u pamë, f.44). Fshatarët qeshin e shkrihen gazit kur dëgjojnë të thuhet në mediat tona *lopa e çmendur*, si një përkthim shatra-patra nga it. mucca pazza; apo *kafshë të vdekura, shpend të vdekur* (?!) kur kemi fjalët shqipe përkatëse: *kafshë të ngordhura, shpendë të ngordhur.*

Kohët e fundit, në letërsinë artistike shqiptare (përfshirë aty edhe përkthime të ndryshme nga gjuhë të huaja) dhe në publicistikën serioze kanë filluar të bëjnë udhë mjaft fjalë të bukura, të cilat origjinarisht janë të gegërishtes popullore apo të letrarishtes gege, si: *kaherë* si ndajfolje dhe *kahershëm,-e* (i,e) si mbiemër, foljet *rrekem,*

mëtoj, mëkushtem "vë bast", *përdjersem* "djersitem", *vëndoj* (që vjen si dysor i vendos, por me një cilësim më të mirëpërvetuar nga shqipja, si dhe me një rigjallërim të "fisnikëruar fonetikisht" të geg. *vnoj* < vendoj "vë, vendos") etj.; forma fjalësh me -**n**-ndërzanore të parotacizuar, ku krahas termave normativë tashmë të ditur si *zanore-ja* (<geg. *za-ni* "zëri"), *ranishte-ja* (<geg. *rana* "rëra"), mund të shtojmë edhe *brezni-a* (që po përdoret mjaft këndshëm në vend të fjalës së huaj gjeneratë), *hyjni-a, hyjneshë-a, hyjnor-e, hyjnizoj* e *hyjnizim, hyjnisht*, si fjalë të fesë që po rikthehen e gjallërohen pas një tkurrjeje e mënjanimi shumëvjeçar të censurës ateiste; *drunohem* "bëhem dru, mpihem", *drynoj* "mbyll brenda me çelës", *gërhanoj* "kreh me gërhanë", *ndërsynoj* "ballafaqoj, vë sy më sy" e që mund të përkthejë plotësisht it. confrontare; po ashtu foljet *dreqnoj, përdreqnoj, përhinoj, përpajnoj, pllenoj* dhe, sidomos, *përçudnoj* "shëmtoj, bëj të çudun", bashkë me mbiemrat e formuar me atë rrënjë *përçudnuar* (i,e). Kjo e fundit, madje, mesa po shohim nga leximet më të reja, ka dalë edhe në logun e gjerë të letërsisë, si fjalë e pëlqyeshme dhe pa asnjë lloj ngjyrese krahinore. "Në rininë time, unë shpesh kam ulëritur kundër këtij sistemi *të përçudnuar* ku, midis dy kandidatëve…"(*Identitete vrastare*, përkthyer nga A. Kumbaro, Onufri, 2001, f.160). Këtu e kanë vendin edhe *synoj* e *synim*, *pikësynoj* e *pikësynim* tashmë të tumiruara e të përdorshme gjithandej në shqipen e njësuar. Nganjëherë, madje, në gjuhën e shkrimit po afrohen si sinonime të vlefshme stilistike, po edhe ngjyresore, disa prej fjalëve që normativistët e ftohtë mund t'i shihnin thjeshtë si dysorë dialektorë. Kështu, nëse ndër dysorët *lëm-i / lami* nuk ka asnjë mëdyshje se tek *lami* kemi një formë fonetike gege që duhet mënjanuar, tek shumësat *lëmenj-t* dhe *lamie-t* (prej nga edhe një njëjës hibrid *lëmijë-a*) mund të shohim një mjet të efektshëm për të sjellë edhe një diferencim kuptimor. Pra, *lëm-i* me shumësin *lëmenj-t*, kur është fjala për lëmin si vend konkret i shirjes së drithit, krahas shumësit *lëmie* kur është fjala për fusha të punës mendore apo (thënë ndryshe) kur fjala *lëmi* ka kuptim të figurshëm. Madje, me sa kemi vënë re, mjaft dendur në letërsinë shkencore të Kosovës e më gjerë të anëve verilindore, po bën udhë forma *lëmijë-a* si një shumës i singularizuar me efekte vërtetet të pamohueshme e gjithsesi vetëm të tumirueshme në qoftë se ia duam të mirën bashkarisë e përbashkësisë

gjuhësore të mëtejme të mbarë bashkësisë etnike e kombëtare shqiptare. Një gjë të tillë mund të shihnim edhe tek dysori *djalëri-a / djelmëni-a*, ku, ndonëse në zanafillë kemi të bëjmë me shumësin e emrit djalë-i, në kohët e reja, fjala djalëri ka marrë kryesisht kuptimin e moshës së re, moshës kur njeriu është djalë, ndërsa forma *djelmëni-a* ka vijuar të ruajë më të theksuar kuptimin e tërësisë së djemve të një vendi a krahine (*djelmnia e Shalës*), në përngjasim e duke hyrë në sistem me *trimni-a*.(Kujtoni edhe vargun e poezisë atdhetare të P. Vasës: "Para se t'hupet kështu Shqypnia, me pushkë n'dorë le t' desë *trimnia"*).

Nga gegërishtja po hyjnë me fryt e gjithnjë e më dendur edhe përemri i pacaktuar *do* "disa, ca" dhe shprehje ndajfoljore të formuara me të, si "...kemi *do djem* luanë që mund t'i dalin Serbisë tej për tej" (I. Kadare, *Ra ky mort e u pamë*, f.32); "Në *do raste* duhen ngritur "barrierat" institucionale…" (*Identitete vrastare*, përkthyer nga A. Kumbaro, Onufri, 2001, f.160), *para do kohe* "kohë më parë, ca kohë më parë": "Ngaqë ka pasur një parrullë që vringëllinte *para do kohe*, duke shkaktuar konfuzion…" (*Identitete vrastare*, përkthyer nga A. Kumbaro, Onufri, 2001, f.158); *tash e mbrapa* "tani e tutje", *tashmë* si dysor, gjithsesi më i pëlqyeshëm se *tanimë* që është në normë, *prapë* si dysor i *përsëri*, por që do ta lehtësonte dendurinë tejet të madhe të kësaj të fundit; (i,e) *mbrapshtë* dhe *mbrapshti-a,* që duken më të pëlqyeshëm se dysorët normativë (përkatësisht: (i, e) prapët, prapësi-a; *urti* si dysor i *urtësi, dije, padije* si dysorë të *dituri*, *padituri* por edhe me mundësi për diferencim sado të lehtë kuptimor. Të njëjtën gjë mund ta thoshim edhe për dysorët *i rrejshëm, e rrejshme*[7] dhe *i rremë, e rreme*; po kështu edhe parafjala *kah* në krahasim me normativen *nga*: ngarkesa shumë e madhe dhe denduria e parafjalës *nga* në shqipen standarde, duke i bërë vend simotrës krahinore *kah*, së paku në disa kontekste e përdorime ku ajo edhe merr një kuptim kryesisht të drejtimit: *kah teoria*, *kah përmirësimi, kah malësia* do të shkarkohej disi nga stërdenduria që ka.

Shkrimtarët shqiptarë më të lexueshëm e më në zë, si dhe përkthyesit më seriozë dhe hartuesit e fjalorëve dygjuhësh (shqip-gjuhë e huaj apo gjuhë e huaj-shqip) përditë e më shumë e kanë ndjerë

[7] Tek libri i Kadaresë "Ra një mort e u pamë", ndeshim disa herë: *mit i rrejshëm* (f.104), *çdo i idhull të rrejshëm* (f.194)

të domosdoshme të qëmtojnë fjalë e mënyra të thëni të gegërishtes, që jo vetëm e pasurojnë dhe e begatojnë shqipen, po edhe i vlejnë përpikmërisë së të thënit dhe larmisë e shprehësisë stilistike të saj. Po japim vetëm ndonjë shembull më të thekur: Libri i I. Kadaresë "*Ra ky mort e u pamë*", si edhe gati të gjithë librat e tij të këtyre dhjetë-pesëmbëdhjetë vjetve të fundit, gjithnjë e më shumë po marrin fjalë e mënyra të thëni të gegërishtes dhe këto, jo vetëm për ngjyresë vendi e karakterizim mjedisi, po edhe thjesht si fjalë shqipe që shkrimtarit i duken më të përshtatshme për shprehjen e ideve e që përfshihen natyrshëm në indin gjuhësor të prozës së tij mjeshtërore. Po përmendim, ndër të tjera, fjalë të gegërishtes veriore e verilindore si: *drojë* "frikë, ndruajtje" ("...kam *drojë* nga mamuthi i shpërfilljes..." (f.41) "...redaksia pati *drojë*"[8] (f.90), *orë e ligë*[9] ("...në *orën e ligë* ata kanë ditur gjithmonë..." (f.10); *rrekem*[10] ("Nga një anë *u rrek* t'i hipnotizonte shqiptarë..." (f.23); *trandem* "tundem, tronditem, lëkundem" ("...ashtu siç e *trand* tërmeti krejt ngrehinën morale të kombit", f.19); *ag-u* "agim, koha e të zbardhurit të ditës" ("...që pa gdhirë në agun e zymtë" f.29, "...pra, në pesë të agut " f.45), *terr-i* "errësirë", një nga fjalët shumë të pëlqyeshme të I. Kadaresë dhe (besojmë, prej ndikimit të tij) me përhapje tashmë tejet të gjerë edhe tek gati të gjithë shkrimtarët e tjerë: "...mbetet përherë në *terr*" (f.45). Përherë e më dendur fjala *terr* po përdoret në letërsinë bashkëkohore dhe në përkthimet e kohëve të fundit në Prishtinë, Shkup etj. "Sipas saj fati njerëzor është tragjik patjetër, kurse *terri* dhe hiçi janë

[8] Fjala *drojë* vjen nga folja *drua* "trembem, kam frikë", e dendur në gegërishten, e cila, gjithashtu, ka të ngjarë të hyjë në gjuhën letrare, qoftë edhe me një formë disi të shartuar (druaj) nën ndikimin e tipit luaj, porse ajo shkon me tipin *dua-desha-dashur: drua, dresh(t)a, drashur.* Emri drojë-a "frikë, ndruajtje" ka përdorim të gjerë në gegërishten, duke u shtrirë edhe në onomastikë, si *Droja* e lumi i *Drojës*. Në thelb, droja, drua shkojnë në të njëjtën çerdhe me mbiemrat (*i,e) ndrojtur,(i,e) ndruajtur* t të përdorshëmsi toskërishten ashtu edhe në gjuhën letrare të përbashkët.

[9] Zanat dhe orët, sikundër dihet, janë figura mitologjike që e kanë vatrën kryesisht në Shqipërinë Veriore, prej nga edhe shprehjet e ditura të Veriut: *me orë çue, njeri me orë*, apo mallkimet malësore. *ligtu ora* "t'u ligtë ora", *dekte ora* "të vdektë ora". Kadareja i ka përthithur qysh herët k¨to elemente leksiko-frazeologjike dhe etnologjike dhe, me ëndje, u ka bërë vend thurjen e ligjërimit të veprave të veta.

[10] Le të kujtojmë vargun e famshëm të epikës legjendare "*Keq me fjalë trimat shoshojnë po e rrekin*".

rezultatet finale të përpjekjeve njerëzore për t'u gjetur shtegu." (A. Izetbegoviq, *Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit*, përkthyer nga Ekrem Kryeziu, Logos, 2000, f.98); *i ngratë* "i mjerë, i shkretë, i pamirë" ("...kjo përkon me shijen *e ngratë* të këtyre njerëzve", f.101), *i mbrapshtë* "jo i mbarë, i keq, i prapët" ("...u jepte serbëve ekstazën e *mbrapshtë*..." f.123); po kështu edhe *mbrapështi-a* "punë e keqe, jo e mbarë, prapësi" ("...kulmi *i mbrapështisë* është një shkrim i Paolo R. "f.142); *vrujon* "buron, del nga një burim i nëndheshëm" ("... vrujon tërbimi kundër një populli..." f.148); *kumt-i*[11] "lajm, njoftim vdekjeje" ("*Kumti*, ashtu si sfida, lexohet hapur" f.15); djerrinë-a ("një *djerrinë* e mallkuar" f.72); *në zgrip* "në buzë të greminës, në prag të vdejkjes, në rrezik" ("Shqipëria në zgrip të humnerës", f.76), *gremç-i* "degë e shtrembër" ("U lidh pas një gremçi..." f.115); vjegë-a "verigë, kërrabë për të varur diçka" ("Për të gjetur një vjegë ankimi..." f.210) etj.

4. **Dialektet** në çdo vend të botës, edhe kur nuk janë vënë në bazën kryesore të letrarishtes, **kanë shërbyer e vlejnë kurdoherë si gurra të pasurimit e të larmisë shprehëse të gjuhëve të njësuara**. Vënia e njërit nga dialektet në bazën a themelin e gjuhës së njësuar zyrtare pikërisht për arsye njësuese ka të bëjë në radhë të parë me zgjedhjen e trajtave fonetike e morfologjike, porse kjo nuk ua pret udhën aspak prurjeve të fjalëve, shprehjeve dhe mënyrave të të thënit nga krahinat e dialektit tjetër. P.sh.: në gjuhën e njësuar shqipe normë është fjala *zjarr-i* (*ndez –in, ra-, i zjarrtë* etj.), porse, ndërkaq, ndërsa nuk pranohen si normative format fonetike dialektore (përkat. *ndez zjarmin, ra -, i zjarmtë*), duhet t'u bëjmë vend me kënaqësi fjalëformimeve që kanë në bazë rrënjën *zjarm*, si *zjarmi-a* "temperaturë e lartë", *zjarmëtar-i* "ai që ndez zjarrin", *zjarmishtë-a* "dhomë ku ndizet zjarri për ngrohje e gatim".Të njëjtën gjë kemi vëne re e pohuar me kohë për dysorin *errësirë-a / terr-i.* Që të dy kanë një rrënjë të përbashkët (*err*), prandaj edhe normativistët kishin paraparë që *terr-i* të mbetej jashtë normës leksikore. Deri nja dhjetë vjet më parë, fjala terr-i në gjuhën e shkruar përdorej vetëm nga Ismail Kadareja dhe ndonjë poet tjetër kryesisht në stilin poetik, mirëpo viteve të fundit kjo fjalë doli nga "zinxhirët" krahinorë të gegërishtes

[11] Mbi këte rrënjë janë formuar edhe termat shkencorë *kumtoj, kumtim, kumtes*ë, të cilat tashmë mënjanojnë plotësisht termat e huaj përkatës: komunikoj, komunikim, komunikatë.

dhe u lëshua mjaft dendur në gjuhën e shkrimit, duke u shpeshtuar në ligjërimin artistik të shumë shkrimtarëve, që nga I. Kadareja e deri tek brezi i krijuesve më të rinj, të cilët i qasen fjalës terr për arsye të shkurtisë po edhe për arsye të vlerave të tjera, sidomos për nevoja ritmi, rime në vjershëri, ndërsa në stilin politiko-shoqëror fjala terr po pëlqehet edhe për një diferencim të karakterit terminologjik. (Kujtoni togfjalëshin *terri informativ* që aq dendur e me aq dobi u përdor nga opozita në betejën për barazinë e shprehjes e të pasqyrimit në televizionin publik).

Nevoja për fjalë, sidomos folje dhe mbiemra prejfoljorë të gegërishtes, ndihet më shumë në hartimin e fjalorëve dygjuhësh. Kështu, nga një shqyrtim përqasës i fjalësit shqip të ”*Fjalorit italisht-shqip dhe shqip-italisht*” të F. Lekës e Zef Simonit, mund të nxjerrim një sasi të madhe foljesh nga gegërishtja, të cilat janë më se të domosdoshme në shqipen e sotme letrare sepse u përgjigjen fjalëve të italishtes për të cilat nuk ka ndonjë sinonim a dysor tjetër të përshtatshëm. Të tilla janë: *asnjanësoj* ‚neutralizare’*, baltoj* ‘infangare’, (krahas e në konkurrencë me baltos ‘infangare’), *barohet* ‘coprirsi d’erba’, *befasoj* ‘sorprendere’, *befasohem* ‘sorprendere’, *bëzaj* ‘dire, chiamare’, *bigëzoj* ‘biforcare’, *bigoj* ‘biforcare’, *biroj* ‘forare, bucchellare’, *birrem* ‘perdersi’, *bishtnoj* ‘eludere’, *bjerr* ’perdere’, *bjeshkoj* ‘alpeggiare’, *blatoj* ‘offrire’, *blegëron* ‘belare’ (krahas e në konkurrencë me blegërin ‘belare’), *brijohet* ‘pronto a cozzare’, *brimoj* ‘buccare, forare’, *brumoj* ‘impastare’ (krahas e në konkurrencë, po edhe me një dallim kuptimor, me *brumos* ‘temprare’, *bubërroj* ‘lavoracchiare, stuzzicare’, *bubullon* ‘tonare, ecchegiare’ (krahas e në konkurrencë me bubullin ‘tonare, ecchegiare’), *buçatem* ‘gonfiarsi”, *bukoj* ‘mangiare, desinare’, *bulmej* ‘condire con burro’, *bulon* ‘gemmare’, *burbulet* ‘far assaggiare’, *burbuletem* ‘assaggiare’, *burgëtohem* ‘rinchiudersi’, *burgëtoj* ‘rinchiudere’, *burgoj* ‘imprigionare’ (ndonëse dihet që është aq e gjallë gjithandej edhe folja sinonime burgos ‘incarcerare’); *burmoj* ‘avvitare’, *butohet* ‘impregnarsi d’ acqua’, *butoj* ‘impregnare d’ acqua’, *cakërroj* ‘sbattere’, *cangëloj* ‘sospendere’, *ciknos* ‘ubbriaciacchiare’, *ciknoset* ‘ubbriaciacchiarsi’, *cubnoj* ”briganteggiare”, *cuboj* ‘accorciare’, *curroj* ‘rizzare’, *çobanoj* ‘fare il pastore’, *daltoj* ‘scolpire’,*djerroj* ‘parlare a vanvera’, *dreqnoj* ‘rovinare’ (krahas *dreqos*, por edhe me

një dallim kuptimor ‘pasticciare’), dritoj ‘illuminare’ (krahas e në konkurrencë me dritësoj ‘illuminare’), *dromcoj* ‘sbriciolare’, *drua* ‘temere’, *drunohem* ‘lignificarsi’ (krahas e në konkurrencë me *drusohet* ‘lignificarsi’), *drynoj* ‘chiudere’, *errem* ‘oscurarsi’ (krahas errësoj ‘oscurare’), *faroj* ‘sterminare’ (krahas e në konkurrencë me *faros* ‘sterminare’), *fërfëlloj* ‘frullare’, *fërgoj* ‘friggere’ (krahas e në konkurrencë me skuq), *fjaloj* ‘parlare’, (krahas e në konkurrencë me *fjalos* ‘parlare’), *flatroj* ‘frullare, volare’, *fraqohet* ‘gela’, *fraqoj* ‘seccare, abbrustolire’, *fshaj* ‘sospirare’ (krahas e në konkurrencë me psherëtij), *fugoj* ‘correre’, *fundërron* ‘sedimentare’, *fundohem* ‘affondare’, *fundoj* ‘affondare’, (krahas e në konkurrencë me *fundos* ‘affondare’), *furem* ‘soffocare’, *furem* ‘avventarsi’, *fytafytem* ‘lottare corpo a corpo’, *galdoj* ‘esultare’, *gandoj* ‘ferire’, *gërhanoj* ‘cardare’, *gërmusem* ‘ingobbirsi’(krahas e në konkurrencë me *gërmuqem* ‘ingobbirsi’), *gradohem* ‘avvanzare di grado’, *gradoj* ‘graduare’, *grah* ‘spronare, condurre’, *gropoj* ‘ infossare’(krahas e në konkurrencë me *gropos* ‘infossare’), *gjegj* ‘rispondere’, *gjegjem* ‘rispondere’, *gjerb* ‘sorseggiare’, *gjerboj* ‘sorseggiare’, *gjethohet* ‘mettere le foglie’, *hapërdahem* ‘sparpagliarsi’, *hapërdaj* ‘sparpagliare’, *imshtoj* ‘macinare’, *imtoj* ‘sminuzzare’, (krahas e në konkurrencë me imtësoj ‘sminuzzare’), *irnoj* ‘illividire’, *kacafytem* ‘azzuffarsi’, *kacagjelohem* ‘ingalluzzirsi’, *kacarrohem*, arrampicarsi’, *kacavarem*, arrampicarsi’, *kapërdij* ‘inghiotire’, *kaploj* ,coprire’, *kaptoj*, pasare, valicare’, *keqem* ‘peggiorare, litigare’, *këndell* ‘vivificare’, *këndellem* ‘vivificarsi’, *kërleshem* ‘rizzarsi’, *kokrroj* ‘cogliere a chicchi’, *kollem* ‘tossire’ (krahas e në konkurrencë me *kollitem*, tossire’), *korit* ‘disonorare’, *koritem* ‘disonorarsi’, *kotem*, dormicchiare’, *kreloj* ‘arricciare’, *krenohem* ‘inorgogliarsi’, *kreshmoj* ‘osseravare la quaresima’, *kujdesohem* ‘curarsi’, *kurmoj* ‘affettare’, *kuvendoj* ‘conversare’,*lajmoj* ‘avvissare’ (krahas e në konkurrencë me *lajmëroj* ‘avvissare’), *latoj* ‘digrossare’ (krahas e në konkurrencë me *gdhend* ‘digrossare”), *lenoj* ‘alleggerire’, *ligështohem* ‘indebolirsi’, *ligështoj* ‘deprimere’, *logoj* ‘spianare’, *luloj* ‘fiorire’ (krahas e në konkurrencë me lulëzoj ‘fiorire’), *marroj* ‘far impazzire’ (krahas e në konkurrencë me marros ‘far impazzire’), *mbarështoj* ‘governare’, *mbërrij* ‘arrivare’ (krahas e në konkurrencë me arrij “arrivare”), *mej* ‘cessare’, *mjeroj* ‘immiserire’, *mrizoj* ‘meriggiare’, *mujshoj* ‘agire con prepotenza’,

muroj ‘murare’, (krahas e në konkurrencë me *muros* ‘murare’), *ndërdyhem* ‘esitare’, *ndërkrehem* ‘imbizzarrire’, *ndërkrej* ‘imbizzarrire’, *ndryj* ‘chiudere a chiave’, *ngij* ‘sazziare’ (krahas e në konkurrencë me *ngop* ‘sazziare’), *ngujohem* ‚rinchiudersi’, *ngujoj* ‚chiudere’, *nguroj* ‘indurire’, (krahas e në konkurrencë me *nguros* ‘indurire’), *ofshaj* ‘sospirare’, *paqoj* ‘quietare’, (krahas e në konkurrencë, po edhe me një dallim të lehtë kuptimor, me *paqësoj* ‘pacificare’), *përbuj* ‘alloggiare’, *përçudnoj* ‘imbruttire’, *përdreqnoj* ‘rovinare, mandare al diavolo’, *përhimnoj* ‘inneggiare’, *përkryej* ‘perfezionare’ (krahas e në konkurrencë me *përsos*), *përpajnoj* ‘propagginare’, *përqafem* ‘abbracciarsi’ (krahas e në konkurrencë me *përqafoj* ‘abbracciare’), *përqurrem* ‘smoccicare’, *përskeqem* ‘arrabbiarsi, adirarsi’, *përspjet* ‘arrivare all’improviso’,*plakem* ‘invecchiare’ (krahas e në konkurrencë me *mplakem* ‘invecchiare), *pluhnoj* ‘polverizzare’ (krahas e në konkurrencë me *pluhuros* ‘polverizzare’), *pllenoj* ‘fecondare’, *praj* ‘cessare’, *praj* ‘invettare’, *prangoj* ‘ammanettare’ (krahas e në konkurrencë me *prangos* ‘ammanetterae’), *pravulloj* ‘esporre al vapore’, *prozhmoj* ‘sparlare, difamare’, *qafoj* ‘abbracciare’, *qellem* ‘tradare’, calmare’, *qetoj* ‘tranquilizzare (krahas e në konkurrencë me *qetësoj* ‘tranquillizzare, calmare’), *syzoj* ‘confrontare, mettere a confronto’, *sheqeroj* ‘inzuccherare’ (krahas e në konkurrencë me *sheqeros* ‘inzuccherare’), *shitohem* ‘rimanere incantato’, *shitoj* ‘incantare, ferire’, *shpendloj* ‘spennare, spiumare’, *terroj* ‘oscurare, ottenebrare’, *terrohet* ‘oscurarsi (krahas e në konkurrencë me errësohet’ossuscarsi’), *trand* ‘far tremare’, *trandem* ‘tremare, commuoversi’, *trenohem* ‘impazzire, arrabbiarsi’, *trenoj* ‘far impazzire, impazzire,’ *trupoj* ‘troncare, attraversare’, *trys* ‘impastare, comprimere’, *trus* ‘impastare, comprimere’, *tuboj* ‘raccogliere, radunare’, *tufoj* ‘fare un mazzo (di fiori ecc.) (krahas e në konkurrencë me *tufëzoj* ‘fare un mazzo (di fiori ecc.), *vajoj* ‘oliare’ (krahas e në konkurrencë me *vajos* ‘oliare’), *vrujon* ‘scaturire, sgorgare’.

Në përfundim, dua të ritheksoj se, duke pohuar e vënë në dukje sa është mbërritur deri më sot në zbatimin e gjuhës letrare të njësuar, koha jonë e bën të domosdoshëm edhe rivështrimin e pjesshëm të disa rregullave të gjuhës sonë letrare të përbashkët, gjithmonë me qëllimin e mirë që, për ndonjë zgjidhje që është prerë më ngushtë, tashti që

shtrirja e përdorimit të standardit ka marrë me të vërtetë përmasat plotkombëtare si gjeografikisht, ashtu edhe përsa u përket stileve funksionale, duhet të mblidhet një Komision Kombëtar, siç është p.sh. Këshilli Ndërakademik i krijuar tri vjet më parë, i cili të ketë si kompetencë të vendosë për të bërë edhe ndonjë ndryshim e sidomos disa përmirësime të rregullave drejtshkrimore e përgjithësisht të normave të gjuhës standarde.

Tiranë, 19 nëntor 2007

Thoma DHIMA

MBI SUBJEKTIN E FORMAVE TE PASHTJELLUARA FOLJORE

Çështja e subjektit të formave të pashtjelluara foljore të shqipes ka të bëjë me funksionin e tyre sintaksor, nëse ato duhen trajtuar si gjymtyrë të fjalisë së thjeshtë apo si fjali (kryesisht të nënrenditura). Statusi sintaksor i formave të pashtjelluara në gjuhën shqipe ka qenë dhe mbetet një nga çështjet më të diskutueshme në sintaksë. Janë mbajtur dhe mbahen qëndrime të ndryshme në lidhje me këtë status dhe me natyrën e formave të pashtjelluara në përgjithësi. Kontributin më të rëndësishëm për format e pashtjelluara e ka dhënë M. Çeliku me studimin e tij "Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe", SHBLU, Tiranë 2000.

Në gramatikat tona të paraviteve pesëdhjetë ndërtimet me forma të pashtjelluara janë trajtuar si fjali. M. Domi i trajton si fjali të varura të pashtjelluara dhe rallë si gjymtyrë, vetëm kur ato dalin më vete dhe të pazgjeruara[1]. S. Floqi i trajton si "gjymtyrë të përbëra". Sipas tij as kur kanë kryefjalë të vetën nuk formojnë fjali, se nuk kanë strukturën e fjalisë dhe nuk shprehin ndonjë mendim relativisht të plotë[2]. Në Gramatikën e Akademisë II (Sintaksa) në lidhje me funksionin e formave të pashtjelluara foljore mbahet një qëndrim i dyanshëm. Nga njëra anë, kur lidhen me një emër a përemër në rasën emërore me të cilin hyjnë në marrëdhënie kallëzuesie, trajtohen si fjali. Nga ana tjetër, (te sintaksa e periudhës) thuhet se këto ndërtime sipas rasteve anojnë herë nga gjymtyra, herë nga fjalia. Kur janë mjaftësisht të zgjeruara dhe të zëvendësueshme me fjali të ndryshme të varura mund të merren si ndërtime sinonimike me këto fjali e të studiohen krahas tyre[3]. Pra, sipas Gramatikës, format e pashtjelluara funksionojnë si

[1] M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe II*, konspekt leksione, Tiranë, 1972 (bot. I 1969), f. 44.

[2] S. Floqi, *Disa tipare semantiko-strukturorë të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*, Konf. e Parë e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962), Tiranë 1965.

[3] ASHRSH, *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Tiranë 1997, f. 180, 489-490.

gjymtyrë kur janë të pazgjeruara, funksionojnë si kallëzues dhe si rezultat si fjali kur kanë pranë një emërore në funksion të kryefjalës dhe kur janë të zgjeruara. Po të nisemi nga ky qëndrim ato në shumicën e raseve dalin si fjali. Për M. Çelikun, në punimin e sipërpërmendur, format e pashtjelluara të varura nga një fjalë drejtuese me ose pa emërore të shprehur, të zgjeruara apo të pazgjeruara, të zëvendësueshme lehtë me fjali apo jo, funksionojnë vetëm si gjymtyrë dhe si gjymtyrë të veçuara të fjalisë së thjeshtë[4]. Çeliku në punimin në fjalë u njeh formave të pashtjelluara edhe funksionin e fjalisë së thjeshtë të pavarur në këto raste: fjali njëkryegjymtyrëshe pavetore me paskajore të pavarur (rasti i gegërishtes: *Me shkue, o burra!*); fjali një kryegjymtyrëshe pavetore me paskajore a pjesore të varur nga folje modale *duhet me shkue* dhe *duhet/do shkuar*; sifjali të bashkërenditura me dy përcjellore pohore pa ose me emërore absolute: *Duke parë e duke bërë*; sifjali të bashkërenditura me dy a më shumë gerunde: *Një të vajtur në shtëpi, një të fjetur* dhe kallëzues i dytë i shprehur me përcjellore pohore a mohore të pavarur: *Rrezet e diellit hynin brenda* ***duke ndriçuar dhomën***. Ndërtimet me emërore të shprehur ***Pa u çliruar Atdheu****, u hapën shkollat e para* i merr si **gjymtyrë të dyta komplekse**[5]. Siç shihet nga këto radhë që iu referuam veprave e autorëve që kanë trajtuar funksionin e formave të pashtjelluara, qëndrimet janë të ndryshme në të mirë ose jo të pranimit të ndërtimeve me forma të pashtjelluara si fjali.

Ndërtimet me forma të pashtjelluara foljore kanë disa karakteristika të dallueshme nga të tjerat, që thuajse janë vënë në dukje në Gramatikë dhe në punime të ndryshme për to, po disa prej tyre na duhet t'i rimarrim këtu. *Së pari*, ato janë ekuivalente me fjalitë me folje në mënyrën lidhore. Prandaj edhe në gramatika të ndryshme format e pashtjelluara janë quajtur mënyra të varura në kundërvënie me mënyrat e tjera.

(1) Agimi i premtoi djalit *për të takuar* nënën**/që** *të takonte* nënën.

(2) Agimi e këshilloi djalin *për të takuar* nënën**/që** *të takone* nënën.

[4] M. Çeliku, *Format e pashtjelluara foljore në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë 2000, f. 85.

[5] Po ai, *po aty*, f. 94-95

Së dyti, në gjuhën shqipe, si edhe në gjuhë të tjera, subjekti i formave të pashtjelluara foljore nuk shprehet, por ai është gjithmonë i nënkuptuar. Në rastet më lart pranë formave të pashtjelluata të paskajores (së re) nuk mund të shprehet as subjekti *Agimi* që i takon së parës, as subjekti *djali* që i takon së dytës. Nuk mund të thuhet: **Agimi i premtoi djalit për të takuar Agimi nënën*, as **Agimi këshilloi djalin për të takuar djali nënën*. Në gjuhën shqipe format e pashtjelluara, kur dalin në funksionin e fjalive të nënrenditura e janë ta varura nga një folje tjetër, në shumicën e rasteve, dalin me subjekt të përbashkët me foljen e fjalisë kryesore, si në rastet më lart. Në raste të tjera atyre mund t'u përgjigjet një subjekt i ndryshëm nga ai i fjalisë kryesore: *Dëshira **për ta takuar** i qe shtuar shumë*. Dhe së fundi, sidomos me disa forma të pashtjelluara (*me + emër foljor* dhe *pa + pjesore*), po edhe me të tjerat, pas tyre del një emër a përemër në emërore me funksion subjekti, i ndryshëm nga subjekti i foljes kryesore: *Do t'ia kthente **me të ikur*** beu *nga fshati*. Subjekti i formave të pashtjelluara foljore qoftë i shprehur, qoftë i pashprehur nuk është i njëjtë me subjektin e pashprehur të frazave flektive, sepse nuk kanë karakteristika të njëjta. *Së treti*, siç dihet, format e pashtjelluara foljore nuk kanë fleksion, ato s'kanë sa kohë, as vetë, as numër dhe si rezultat me to nuk ndodh bashkëpërshtatja, siç ndodh me format flektive. Përveç këtyre veçorive, duhet pasur parasysh edhe marrëdhënia midis subjektit dhe fleksionit, që fleksioni kërkon një subjkt në pozicionin e specifikuesit të tij, edhe kur ky nuk ngop valencën e foljes. Nga ana tjetër, lidhja midis subjektit dhe fleksionit është akoma më e fortë, sepse vlen edhe e kundërta e asaj që thamë më lart: subjekti për të qenë i shprehur kërkon fleksionin që të përshtatet. Në mungesë të fleksionit, si në rastin në fjalë të formave të pashtjelluara, argumenti i jashtëm e foljes, subjekti, mbetet detyrimisht i nënkuptuar[6]. Ky element që nuk ka përmbajtje fonetike quhet në gramatikën gjenerative **PRO** (me të mëdha) për ta dalluar nga subjekti i nënkuptuar i gjuhëve me subjekt zero **pro** (me të vogla). Atëhere paraqitja sintagmatike e një fraze me folje në paskajore: *Agimi i premtoi djalit **për të takuar nënën** do të ishte*:

[6] K. Donati, *Sintassi elementare*, Carocci, Roma 2005, f. 129



Kur format e pashtjelluara kanë subjekt të shprehur, atëhrë ai vendoset tek nyja SE në vend të PRO. Ndryshimi midis këtyre frazave dhe frazave me folje flektive me subjekt zero, është se këto nuk kanë fleksion dhe mund të barazohen me një sintagmë të thjeshtë foljore, qoftë kur kanë subjekt të shprehur, qoftë kur kanë subjekt të pashprehur. Ndërsa frazat me folje flektive nuk janë dhe nuk mund të barazohen me një sintagmë foljore. Këto fraza paraqiten në sintaksën gjenerative si një sintagmë, koka e së cilës është sintgma e fleksionit (*Sfleks*) dhe në vendin e specifikuesit të saj del subjekti, i cili ka lëvizur nga vendi i specifikuesit të SF dhe ka ardhur në vendin e specifikuesit të Sfleks për të marrë rasë ose për t'u përshtatur me fleksionin.

Qenia e subjektit PRO të formave të pashtjelluara në gramatikën gjenerative gjen shpjegim duke u mbështetur edhe te *teoria e roleve tematike (ose semantike)*. Kriteri tematik thotë se një argumenti mund

t'i caktohet një dhe vetëm një rol tematik[7]. Në fjalinë e sipërpërmendur: *Agimi i premtoi djalit për të ndihmuar nënën*, SE *Agimi* e merr rolin tematik nga folja *premtoj* dhe nuk mund të marrë një rol tjetër tematik nga folja *ndihmoj*, se do të shkelej parimi tematik që cituam më lart. Pra, fjalisë me folje në paskajore dhe argumentit të saj i mungon një subjekt të cilit folja *ndihmoj* duhet t'i caktojë rolin e vepruesit. Ky subjekt pra, është PRO. Po të krahasohen ndërtimet me forma të pashtjelluara me ndërtimet ekuivalente me forma të shtjelluara më poshtë:

(1) I thashë *për t'u takuar* në mbrëmje/**që** *të takohemi* në mbrëmje (ne)

(2) I thashë *për të më takuar* në mbrëmje/**që** *të më takonte* në mbrëmje (ai)

(3) I thashë *për ta takuar në mbrëmje*/**që** *ta takoja* në mbrëmje (unë)

duket se format e pashtjelluara me argumentet e brendshme *për të **më** takuar, për t**a** takuar, për t'**u** takuar* kërkojnë të marrin një rol tematik, atë të argumentit të jashtëm që e cakton folja bashkë me argumentin e brendshëm (kundrinorin), brenda hapësirës së strukturave me forma të pashtjelluara e jo jashtë tyre, gjë që e tregon krahasimi me ndërtimet me forma të shtjelluara. Dhe ky argument s'ka ç'të jetë tjetër veçse PRO.

Ndërtimet me folje të fjalisë së varur në infinitiv janë analizuar në gjuhët me infinitiv si *ndërtime me kontroll*. Teoria e kontrollit merret me elementet PRO në pozicionin e subjektit të fjalive me infinitiv. Në ndërtimet me kontroll kontrolluesi në fjalinë kryesore kryefjalë ose kundrinor duhet të kontrollojë të kontrolluarin kryefjalë të fjalisë së varur. Në: ***Agimi** i premtoi mësuesit për të ndihmuar shokun* kemi kontrollin nga subjekti *Agimi* i cili kontrollon subjektin e fjalisë së varur që është PRO. Kontrollues i PRO mund të jetë edhe kundrinori i drejtë ose edhe i zhdrejti i fjalisë kryesore: *E mësova **djalin** për të ngarë makinën, I dhashë **fëmijës** për të pirë qumësht*. Pra subjekti PRO nuk është i drejtuar, siç është subjekti i foljeve të shtjelluara i drejtuar nga fleksioni i tyre, sepse format me PRO nuk kanë fleksion. Pra, themi se PRO zë pozicionin e subjektit të fjalive që

[7] N. Chomsky, *Lectures on Government and Binding*, Dordrecht, Foris, 1981

kanë forma të pashtjelluara foljore. Është një përemër i mangët, sepse nuk është i lirë të zgjedhë një person nga konteksti dhe ka një kontrollues[8].

Së fundi, qenia e PRO pranë formave të pashtjelluara përligjet edhe nga teoria e lidhjes. Disa nga parimet e teorisë së lidhjes janë këto: *Sintagmat emërore që nuk janë përemra janë gjithmonë të lira. Anaforat janë detyrimisht të lidhura brenda një hapësire kufizuese ku ndodhen* (Më thanë se *djali* dëmtoi *veten*). *Përemrat mund të jenë të lidhur, por mund të jenë edhe të lirë. Kur janë të lidhur praprijësi i mundshëm i tyre gjendet gjithnjë jashtë fjalisë së thjeshtë ku ndodhet vetë përemri*[9]. Në fjalitë:

(1) Studenti i tha profesorit për t*a* sqaruar.

(2) Studenti i tha profesorit për t'*u* përgjigjur.

në qoftë se paskajoret këtu do të trajtoheshin si gjymtyrë fjalie e jo si fjali, trajta e shkurtër *e* në fjalinë e parë nuk do të lidhej as me SE *studenti*, as me SE *profesori* se të dyja këto sintagma emërore ndodhen brenda së njëjtës fjali të thjeshtë. Mirëpo sipas teorisë së lidhjes paraprijësi i mundshëm i përemrit gjendet gjithmonë jashtë fjalisë së thjeshtë ku ndodhet vetë përemri. Në fjalinë e dytë pjesëza përemërore (vetvetore) *u* do të lidhej me të dyja SE *studenti* dhe *profesori*, meqenëse paraprijësi i anaforave është gjithnjë brenda fjalisë së thjeshtë ku ato ndodhen. Në qoftë se format e shtjelluara më lart do të trajtoheshin si fjali me subjekt zero PRO, atëherë do të përligjej lidhja e trajtës së shkurtër *e* me SE *studenti* që është jashtë fjalisë së thjeshtë ku ndodhet trajta e shkurtër, ndërsa pjesëza përemërore-vetvetore do të lidhej me subjektin zero PRO që ndodhet brenda fjalisë së thjeshtë ku ndodhet kjo pjesëz.

Pra, sipas teorisë gjenerativiste format e pashtjelluara janë fjali me subjekt të pashprehur PRO. Si fjali një pjesë e mirë e tyre trajtohen edhe në sintaksën e Akademisë dhe në punime të tjera për to.

[8] J. Mita, *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë 2005, f. 162
[9] G. Graffi, Sintassi, il Mulino, Bologna 1994, f. 315

Begzad BALIU

SPROVË PËR NJË HISTORI TË ALBANOLOGJISË

Gjendja dhe orientimet

Nëntëdhjetë vjet më parë, më 1917 Norbert Jokli ka botuar studimin "Shqiptarët"[1], që në gjuhën shqipe është përkthyer me titull "Populli shqiptar dhe gjuha e tij[2]". Kjo ishte një sprovë serioze e tij për të shkruar një histori të albanologjisë, dhe përtej saj një histori të qytetërimit shqiptar. Prej këtij viti e deri në ditë tona në studimet shqiptare nuk ka munguar përpjekja e albanologëve vendorë apo të huaj për të shkruar një histori të albanologjisë në përgjithësi dhe një histori të gjuhësisë shqiptare në veçanti, sado jo në përmasat në të cilat ata janë angazhuar për të përgatitur dhe botuar vëllime për historinë e letërsisë, për antologjitë apo edhe për historinë e popullit shqiptar.

Trajtesa të karakterit historiko-gjuhësor e kjo do të thotë albanologjik, me synim kryesisht përgjithësues, gjatë shekullit XX kanë shkruar edhe albanologët e gjysmës së dytë të shekullit XX, që nga Mahir Domi, Idriz Ajeti, Shaban Demiraj, David Luka e deri te Francesko Altimari, ndërsa një monografi përgjithësuese me karakter albanologjik gjysmë shekulli më parë e ka shkruar albanologia Agnia Vasilievna Desnickaja[3]. Në studimet e tyre albanologët kanë bërë përpjekje për të sjellë arritjet e kohës në fushë të studimit të albanologjisë (Mahir Domi), për të orientuar studimet albanologjike në disa nga fushat e caktuara (Idriz Ajeti e Shaban Demiraj), për të

[1] *Albanisch.* Grundriß der indogerm. Sprach- und Alterumskunde 3 = Geschichte der indogerm. Sprachwissenschaft, hrsg. von W. Streitberg. II. Die Erforschung der indogerm. Sprachen. III. Slavisch-Litauisch, Albanisch. Straßburg, Karl J. Trübner 1917. VI, 154 S. 8°.

[2] *Populli shqiptar dhe gjuha e tij* "Hylli i Dritës", 1943, 9-12, f. 325-334; 1944, 6-7, f. 53-62.

[3] *Historia e studimit të gjuhës shqipe* (dorëshkrim), Tiranë, 1959?). Sipas Profesor Jup Kastratit, kjo monografi është punuar nën përkujdesjen e Aleksandër Xhuvanit, Eqrem Çabejt, Mahir Domit, Selman Rizës dhe Spiro Floqit. Ky i fundit dorëshkrimin e Desnickajes e ka përkthyer në gjuhën shqipe në 112 faqe te daktilografuara.

dhënë një pasqyrë të përgjithshme të saj për nevojat studentore (David Luka)[4], për të shprehur shqetësimet e tyre rreth gjendjes së studimit të saj brenda institucioneve shkencore (Robert Elsie e Begzad Baliu)[5], si dhe për "nevojën dhe domosdoshmërinë e një përtëritjeje të gjithanshme dhe rrënjësore në studimet albanologjike" (Francesco Altimari)[6]. Një pamje të veçantë për gjendjen e studimeve albanologjike deri në vitet '60 e ka dhënë edhe Androkli Kostallari[7].

Prej kësaj kohe e deri më sot albanologjia si dije i ka kaluar kufijtë politikë të organizimit të saj në procesin e orientimit të projekteve të reja nacionale dhe në kontekst të shtrirjes së saj etnografike, jo vetëm shtetërore.

Pas përpjekjeve prej shumë dekadash që albanologjia të bëhet dije e brendshme e shkollës shqiptare, institucionet në Tiranë dhe në Prishtinë, në gjysmën e dytë të shekullit XX, bëhen njëkohësisht qendrat kryesore të këtyre kërkimeve.

Në shekullin XXI studimet albanologjike hyjnë jo vetëm si dije që kanë trashëguar shkollën europiane të shek. XIX apo konceptet

[4] *Histori e gjuhësisë shqipe (albanologji)*, Shkodër, 2005.

[5] Shih, intervistën e albanologut Robert Elsie, *Albanologjia ndërmjet revolucionit dhe vdekjes*, në të përmuajshmen për kulturë "Sheshi", nr. 69-70, gusht-dhjetor 2003, Prishtinë, f.1, 5; si dhe kumtesën tonë: *Studimet gjuhësore në Kosovë në gjysmën e dytë të shekullit XX: shkollat, domenet, problemet, metodat*, në Sesioni shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, 50-vjet përpjekje për studimin e albanologjisë, Prishtinë, më 18-19 nëntor 2003; botuar në vëllimin "50 - vjet studime albanologjike", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004, f. 231-236.

[6] Francesco Altimari, *Ndihmesa e disa drejtimeve të reja metodologjike për përtëritjen e albanologjisë bashkëkohore: Leksikografia Tekstuale e Kompjuterizuar,* në konferencën "Le prospettive dell'albanologia: il contributo degli Albanesi di Sicilia e di Calabria", (a cura di Antonio Guzzetta), *Atti del XX Congresso Internazionale di Studi Albanesi,* Palermo 26-28 ottobre 1994, Instituto di Lingua e Litteratura Albanese, Facolta di Lettere e Filosofia dell'Università di Palermo, Centro Internazionale di Studi Albanesi "R. Petrotta", në radhorin "Albanica", 11, Palermo, 1996. f. 11-16.

[7] Androkli Kostallari, "Gjendja e Studimeve Albanologjike në Shqipëri, probleme dhe detyra të reja" Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, Universiteti Shtetëror i Tiranës –Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë 1965, f.15-59. Brenda një kumtese të gjerë janë diskutuar çështjet: Një vështrim mbi zhvillimin e shkencave albanologjike përpara çlirimit të Shqipërisë (15-17); Shkencat historike (17-23); Shkencat filologjike (23-31); Rezultatet kryesore të kërkimeve albanologjike në Republikën Popullore të Shqipërisë dhe vijat e zhvillimit të tyre të mëtejshme (31-32); Cilat janë rezultatet kryesore të kërkimeve albanologjike në Shqipëri në periudhën e pasçlirimit? (32-36).

nacionale – ideologjike të gjysmës së dytë të shekullit XX, por si shkencë e linguistikës europiane dhe metodave kërkimore të saj, pothuajse në të gjitha fushat e dijes humaniste: nga arkeologjia e mitologjia deri te antropologjia e semasiologjia. Nga aspekti i organizimit institucionet shkencore albanologjike, kudo që janë, kanë informacione të plota koordinuese dhe prani të përhershme të personaliteteve shkencore në të gjitha projektet kombëtare.

Shkenca e albanologjisë i ka tejkaluar tashmë disa çështje, të cilat vetëm disa dekada më parë i konsideronte themelore në projektet nacionale të saj kryesisht ideologjike.

- **Në fushë të historisë,** problemin e dikurshëm të gjenezës së popullit shqiptar, albanologjia e konsideron të mbyllur dhe të pranuar në institucionet ndërkombëtare pa domosdoshmërinë e mitizimit të saj; çështjen e formimit të kombit shqiptar tashmë e diskuton në kontekst të identitetit të saj europain; projektimin e historisë së popullit shqiptar e konsideron jo si një histori të Shqipërisë, që në të vërtetë ishte histori e kufijve shtetërorë e politikë, po si një histori kombëtare e popullit shqiptar në kufijtë e saj etnografikë. Brenda këtyre zhvillimeve pritet të realizohet projekti i ri i historisë së popullit shqiptar, enciklopedisë së popullit shqiptar etj., ndonëse për arsye të caktuara në periudhën tranzitore të kësaj kohe në Tiranë kanë përfunduar të ashtuquajturat projekte kalimtare *Historia e popullit shqiptar* deri në vitin 1912 dhe *Fjalori enciklopedik shqiptar*.

- **Në fushë të filologjisë,** albanologjia ka tejkaluar studimin me çdo kusht të problemeve gjuhësore me karakter historik dhe madje me metodologji historiciste, ndërsa gjithnjë e më shumë merret me çështje pragmatike të nevojave të saj: fjalorët elektronikë, fjalorët terminologjikë, diskutimin e standardit gjuhësor në kontekst të rrethanave të reja, problemin e standardizimit të onomastikës etj. Qendrat e studimeve albanologjike në Prishtinë tashmë janë pjesë e projekteve mbarëkombëtare, sikur është Komisioni Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, në të cilin tash sa kohë po diskutohen, jashtë prirjeve ideologjike dhe dogmatike, disa çështje të standardit të shqipes, ndërsa pas disa vjetësh pune një komision ekspertësh në shkallë Kosove i ka dhënë fund draftit të parë të standardizimit të emërvendeve të Kosovës.

- **Në fushë të letërsisë,** përveç kthimit të autorëve të ndaluar, në Tiranë është zgjeruar metoda shkencore e studimit, ndërsa në Prishtinë gjithnjë e më shumë madje edhe nga brezi i ri i studiuesve po provohet i ashtuquajturi "studim personal" i autorëve dhe veprave letrare.

- **Seminari.** Në fushë të ndërkombëtarizimit të albanologjisë Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare paraqet institucionin më të rëndësishëm nacional, përmes të cilit bëhet i mundur popullarizimi i albanologjisë si shkencë dhe historisë e kulturës shqiptare si pjesë e kulturës universale.

Përpjekjet e gjertanishme për periodizimin e albanologjisë

Pavarësisht nga përpjekjet e shumë albanologëve për të sjellë sinteza, me qëllim periodizimin e albanologjisë, siç do të shihet prej botimeve të gjertanishme dhe atyre në dorëshkrim, përgatitja e një vepre të këtij karakteri nuk ishte as e lehtë as e mundshme për albanologët vendorë apo të huaj. Rrethanat politike që i përcillnin institucionet shkencore shqiptare në Tiranë dhe përvoja krejt e re kërkimore - shkencore e institucioneve studimore në Prishtinë, si dhe synimet individuale të disa albanologëve në qendrat kërkimore shkencore të Europës apo edhe më gjerë, nuk siguronin kushte të mjaftueshme për një projekt kaq të madh dhe kaq kompleks.

Në këto rrethana, një histori të plotë të albanologjisë ka provuar ta shkruaj njëri prej albanologëve më të njohur të gjysmës së dytë të shekullit XX, Jup Kastrati[8], ndonëse sikur ka ndodhur me pjesën më të madhe të nismave individuale, edhe ky projekt nuk ka përfunduar.

Pjesa e parë e *Historisë së albanologjisë* e Jup Kastratit përfshinë periudhën 1497-1853, apo studimet parashkencore të albanologjisë; pjesa e dytë përfshin periudhën 1854-1942 dhe përbëhet prej dy vëllimeve, që hapen me indoeuropeistin Franc Bopp dhe përfundojnë me albanologun e madh Norbert Jokli[9]; ndërsa pjesa e tretë-- përfshin periudhën 1943-1997,

[8] *Historia e albanologjisë (1497-1997).* Vëllimi i parë (1497-1853). Shtëpia botuese "Argeta –LMG", Tiranë 2000. / Vëllimi i parë: "Periudha parashkencore e studimit të gjuhës shqipe (1497-1853).

[9] Meqenëse kjo pjesë e historisë së albanologjisë, përkatësisht dy vëllimet e saj në dorëshkrim nuk janë botuar ende, dhe meqë Profesor Jup Kastrati për të gjallë të tij më ka dërguar *treguesin e lëndës,* këtu po theksoj se: *Historia e albanologjisë,*

të cilën nuk e ka përfunduar së realizuari, me përjashtim të disa prej pjesëve të saj. Këtë pjesë të historisë së albanologjisë Jup Kastrati e kishte menduar në tri vëllime: albanologjia në Shqipëri[10], albanologjia në Kosovë, përkatësisht në ish-Jugosllavi[11] dhe albanologjia në botë, e brenda saj edhe albanologjia ndër arbëreshët e Italisë[12]. *Historia e albanologjisë* e Jup Kastratit, më parë se sa një vepër sintezë, do të mund të quhet tërësi e studimeve të Profesor Jup Kastratit në fushë të albanologjisë[13].

Me përjashtim të kapitullit XVI dhe kapitullit XXIII, në të cilët janë përfshirë vlerësime për dy kongrese gjuhësore të arbëreshëve dhe kontributet gjuhësore të revistave me të rëndësishme të kohës, në të gjitha vëllimet janë radhitur në mënyrë kronologjike albanologët, ballkanologët, romanistët, sllavistët, helenistët, gjermanistët, indoeuropeistët etj. që në një mënyrë a një tjetër, më pak apo më shumë, i kanë kontribuar gjuhësisë shqiptare.

Një përpjekje për ta bërë periodizimin e historisë së albanologjisë, madje për herë të parë, Jup Kastrati e ka bërë, qoftë edhe me faktin e vetëm se atë fillimisht e ka ndarë në albanologjinë parashkencore (nga Piccolomini, 1473 deri te Hahn-i, 1853) dhe shkencore (nga Franz Bopp, 1854 deri në vitin 1997). Brenda periudhës së parë e ka vlerësuar në mënyrë të veçantë rolin e Lajbnicit (1705) dhe sidomos të Hahn-it, ndërsa brenda periudhës së dytë vend të veçantë i ka dhënë gjuhëtarit të shekullit XIX Gustav Majerit dhe atij të arbëreshëve të Italisë Dhimitër Kamarda.

Vëllimi II (1854-1942), hapet me kreun e XV dhe mbyllet me kreun e XXXI. Brenda tij janë përfshirë studimet monografike për 159 albanologë, kontributet e 12 klubeve, revistave e shoqërive të kohës, Kongresi i Manastirit, si dhe kontributi i dy kongreseve gjuhësore të arbëreshëve të Italisë.

[10] Janë përfunduar studimet monografike për albanologët: Aleksandër Xhuvani, Mahir Domi, Eqrem Çabej, Kostaq Cipo, Dhimitër S. Shuteriqi, Shaban Demiraj, Tomor Osmani. Monografi të tjera janë në gjendje skedash.

[11] Janë përfunduar ose kanë mbetur në fazën e sintetizimit studimet për albanologët: Selman Riza, Idriz Ajeti, Latif Mulaku, Hilmi Agani, Rexhep Ismaili, Besim Bokshi, Shefki Sejdiu, Ruzhdi Ushaku, Shefkije Islamaj dhe Zenun Gjocaj.

[12] Në këtë vëllim dihet se janë përfunduar studimet për albanologët Maximilian Lamberc, Vaclav Cimochovski dhe sidomos albanologët në radhët e arbëreshëve: Marko la Piana (1883 – 1958), Mateo Shambra (1914 – 1967), Françesko Solano (1914 – 1999), Antonio Belushi (1934 -), Emanuil Jordani (1963).

[13] Shih, *500-vjet të studimeve albanologjike,* në "Gjurmime albanologjike" - seria e shkencave filologjike", nr. 30-31 / 2000-2001, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003.

Po në këtë periudhë u ka bërë vend edhe albanologëve Taliavini dhe Jokli, të cilëve iu ka kushtuar nga një kapitull, prej 150 deri në 400 faqe makine, ndërsa një vend i veçantë, sikur ka theksuar disa herë, në gjysmën e dytë të shekullit XX, i takon Eqrem Çabejt.

Një përpjekje të veçantë për periodizimin e *Historisë së albanologjisë*, tash së fundit e ka bërë edhe profesor David Luka, i cili, ndonëse i liruar krejtësisht nga periodizimi dogmatik i saj, nuk ka mundur të lirohet njëkohësisht edhe nga periodizimi pozitivist. Sipas tij, historia e albanologjisë ndahet në tri periudha: I. Nga Frang Bardhi deri te gjysma e parë e shekullit XIX; II. Nga Fillimi i Rilindjes Kombëtare (1950) deri te Shpallja e Pavarësisë (1912) dhe nga viti 1912 deri ne fund të Luftës së Dytë Botërore (1944); III. Nga viti 1944 deri në vitin 1954 dhe nga 1954 deri më 1980. Nga disiplinat me te arrira studiuesi Luka dallon: leksikografinë, etimologjinë, gramatologjinë, dialektologjinë dhe onomastikën.

Për arsye se një periodizim përgjithësues, parashkencor dhe shkencor i albanologjisë, si dhe për arsye se edhe vendosja e kufijve nga njëri albanolog te tjetri, duket tepër i thjeshtëzuar dhe jo i plotë për një monografi, e cila do të duhej ta plotësonte në mënyrë sa më të tërësishme historinë e albanologjisë, dëshiroj që këtu të sjell një sprovë gjithsesi të diskutueshme për një histori të albanologjisë, një kapitull i së cilës tashmë po shkruhet.

Në sprovën time *Histori e albanologjisë* quhet historia e hapësirës gjeografike, e institucioneve shkencore, e seminareve dhe konferencave shkencore tradicionale, të organizuara nga ato, si dhe e revistave shkencore të tyre. Brenda saj është përfshirë tipologjia e koncepteve teoriko-shkencore me të cilat kanë punuar albanologët e kohës apo bartësit politikë të projekteve shkencore, domenet e fushat e studimit, natyrisht duke trajtuar studimin e brendshëm dhe të jashtëm të saj. Në vëllime të veçanta janë planifikuar përfaqësuesit kryesorë të albanologjisë. Kështu më është bërë e mundur që studimet albanologjike t'i vlerësoj në rrafshin e sinkronisë dhe në rrafshin e diakronisë. Ky projekt përfshin veprat themelore të karakterit shkencor, duke mos përjashtuar as dokumentet dhe botimet më me ndikim të veprave divulgative, kryesisht të gramatikave për qëllime pedagogjike, por duke iu bërë vend anësor, kryesisht në fusnotë dhe në pjesën e burimeve e të kronikave.

Një vend më vete paraqet identifikimi dhe saktësimi, jo vetëm i vendosjes kronologjike të veprave, ideve e arritjeve shkencore në fushë të albanologjisë por edhe i autorësisë së teksteve të tyre[14]. Periodizimi i saj mbështetet në disa parime metodologjike, konceptet për të cilat nuk janë mbyllur. Cilat janë këto paradigma: dokumentare, historike apo gjuhësore dhe etnografike.

I. MODELI I PARË

Historia e albanologjisë fillon me Arnold von Farffin (1497) apo me Pjetër Mazrrekun (1633) dhe periudha e parë e saj përfundon me Laibnicin (1705), Tunmanin (1774) apo Hahnin (1853). Mes këtyre përfaqësuesve, në të vërtetë të koncepteve shkencore të tyre unë kërkoj arbëreshin Gjergj Guxeta (Gjergj Guzzetta) me Kolegjin Arbëresh të Shën Mitër Koronës në Kalabri dhe Seminarin Shqiptar të Palermos në Sicili (1734).

Në kërkim të vendosjes së kufijve periodizues të historisë së albanologjisë çështje të veçantë për diskutim paraqet, sikur shprehet Jup Kastrati periodizimi i albanologjisë shkencore, një term edhe ky për diskutim. Kjo periudhë fillon me albanologun më të madh të shekullit XIX Gustav Majer (1881) apo edhe më herët, me njërin prej indoeuropeistëve më të shquar të kësaj kohe Franc Bopp (1854).

Meqenëse, periodizimi i historisë së albanologjisë nuk mbështetet në periudha shekullore, në përfaqësues vendorë e të huaj, por në vlera

[14] Dosje të tëra të Arkivit Shtetëror në Tiranë dhe jo vetëm atje, por edhe të shumë arkivave të tjera personale, do të thonë shumë në të ardhmen. Sot vetëm mund të merret me mend mënyra se si është përvetësuar vepra e Selman Rizës, si është vjelë dorëshkrimi (madje në Prishtinë, Shkup dhe Tiranë) i veprës së Profesor Jup Kastratit *Faik Konica*, si është përdorur *Vepra filologjike e De Radës*, ndonëse ende nuk e ka parë dritën e botimit, si është keqpërdorur vepra leksikografike e Benedikt Demës dhe e Tahir Dizdarit dhe si është 'cituar' *Fjalori i orientalizmave* të tij dhe fjalorë të tjerë në dorëshkrim që para Luftës së Dytë Botërore, si janë përvetësuar pjesë të studimeve në dorëshkrim të Filip Fishtës e të tjerëve, si është mbishkruar dorëshkrimi për *Epikën,* e Veis Sejkos, që me dekada pritën apo prisnin botimin e tyre. Shqetësimet në këtë temë ka kohë që i kanë shprehur Anastas Dodi (rreth keqpërdorimeve të arkivit të Eqrem Çabejt), Rexhep Ismaili (prej "burgosjes deri te mohimet zyrtare dhe përvetësimet e veprës së Selman Rizës"), Begzad Baliu (mbi autorësinë e *Bibliografisë së Skënederbeut)* etj., por një pasqyrë e plotë ende pret të bëhet.

dhe arritje shkencore të kësaj kohe, një referencë të veçantë paraqet Holger Petersen (fillimi i shekullit XX), apo *Fjalori* i 'humbur' i Norbert Joklit (1940) dhe mbyllet me *Studimet etimologjike në fushë të shqipes* të Eqrem Çabejt (1976).

Sikur mund të shihet, ky është një model i rishikuar i profesor Jup Kastratit, në të cilin referencës autoriale i mënjanohet paradigma kohore (përkatësisht shekullore) dhe etnike, por mbetet paradigma e arritjeve teorike-shkencore dhe individuale e tyre.

II. MODELI I DYTË

A mund të periodizohet historia e albanologjisë në mbështetje të arritjeve shkencore në fushë të albanologjisë brenda studimeve vendore dhe ndërkombëtare? Ky model do të identifikohet me autorët dhe ngjarjet më të rëndësishme që kanë shënuar studimet albanologjike, sikur është teoria e prejardhjes së popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, institucionet etj.

1497: *Fjalorthi* i Arnold Von Harfit.

1705-1734: Teoria e prejardhjes ilire e Laibnicit apo Seminari arbëresh i Palermos.

1854-1864: Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane dhe ne studimet ballkanologjike (Bopp-Mikloshiq).

1908: Kongresi i Manastirit.

1927-1936: Teoria e prejardhjes trake e gjuhës shqipe e Gustav Veigandit (1927), apo kërkesa e Eqrem Çabejt për përjashtimin e teorisë pellazgjike, sikur shkruan ai "së paku nga tekstet shkollore".

1968-1972: Konsulta e Prishtinës – Kongresi i Drejtshkrimit (1968-1972), sipas parimit "një komb, një gjuhë".

Sikur mund të shihet ky model mbështetet në arritjet e reja albanologjike, më pak gjuhësore dhe më shumë identitare në rrafshin krahasues, me përjashtim të dy ngjarjeve historike, të cilat gjithashtu kanë pasur ndikim të veçantë në ndërtimin e identitetit kombëtar, brenda kontekstit gjuhësor.

MODELI I TRETË

Historia e albanologjisë – Kapitulli i Kosovës

Histori e albanologjisë, kapitulli për Kosovën, do të quhet historia e institucioneve shkencore, konferencave shkencore, si dhe e revistave shkencore të tyre. Aty bëhet tipologjia e koncepteve teorike - shkencore me të cilat kanë punuar albanologët e kohës dhe domenet e fushat e studimit: studimi i brendshëm dhe i jashtëm i saj. Në një vëllim të veçantë janë planifikuar përfaqësuesit kryesorë të saj, që në rrethana të tjera, pra të një historie akademike integrale të albanologjisë, përfaqësohen në vëllimin përkatës kronologjik të albanologëve të gjysmës së dytë të shekullit XX.

Cilat janë referencat institucionale, historike, kulturore, gjuhësore dhe përfaqësuesit kryesorë të këtij projekti:

Hyrje: Kosova - Një histori e shkurtër etnokulturore dhe politike prej vitit 1912 e deri në kohën tonë.

INSTITUCIONET

Universiteti i Zagrebit, 1910-1916. Filologu Florshyc ligjëron gjuhën shqipe. Në vitin 1913 Shuflai boton vëllimin e parë *Acta et diplomata.*

Seminari i Albanologjisë – Beograd, ose riorganizimi i albanologjisë nën premisat politike të kohës.

Biblioteka Kombëtare ose nacionalizimi i shkencës, e brenda saj edhe i albanologjisë.

Instituti Albanologjik i Prishtinës ose nacionalizimi i albanologjisë.

Fakulteti Filozofik, përkatësisht Fakulteti i Filologjisë ose orientimet metodologjike të albanologjisë.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare ose ndërkombëtarizimi i albanologjisë.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ose shtetëzimi i albanologjisë.

Rilindja. Redaksia e botimeve. Botimi i veprave të trashëgimisë gjuhësore (*Fjalori* i Konstantin Kristoforidhit, *Fjalori i Bashkimit, Vepra* e Aleksandër Xhuvanit), i arritjeve gjuhësore të kohës (Eqrem Çabej, Selman Riza) dhe përkthimeve teorike - gjuhësore të Rexhep Ismajlit në fillim të viteve '70 (Sosyri, Martine).

Revistat: "Rilindja" (gazetë), "Përparimi" (revistë), "Jehona" (revistë), "Gjurmime albanologjike – seria e shkencave filologjike", revistë e Institutit Albanologjik të Prishtinës; "Filologjia", revistë e Fakultetit të Filologjisë – Universiteti i Prishtinës, "Studime", revistë e Akademisë së Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

SHKOLLAT dhe DOMENET

Shkolla tradicionale, historiko – gjuhësore: Idriz Ajeti, Hilmi Agani etj.

Strukturalizmi: Selman Riza (prej logjikës deri te gjuhësia sosuriane), Besim Bokshi, Rexhep Ismaili, Shefki Sejdiu etj.

Sociolinguistikë: Rexhep Ismaili, Shefkije Islamaj, Isa Bajçinca etj.

Etnolinguistikë: Shefki Sejdiu, Ruzhdi Ushaku etj.

Semasiologji: Shefki Sejdiu etj.

FUSHAT E STUDIMIT

Zhvillimet e brendshme të shqipes

Histori e gjuhës shqipe: Selman Riza, Idriz Ajeti, Rexhep Ismajli, Fadil Raka, Fadil Sulejmani, Murat Blaku, Shaqir Barani, Zenun Gjocaj, Qemal Murati, Gjystina Shushka-Cacaj, Shpresa Hoxha etj.

Ortografi: Selman Riza, Idriz Ajeti, Rexhep Ismajli, Petro Janura etj.

Fonetikë – fonologji: Rexhep Ismaili, Halit Halimi etj.

Morfologji historike dhe aktuale: Selman Riza, Besim Bokshi, Fadil Sulejmani, Raip Mulaku, Nuhi Veselaj, Hava Shala etj.

Sintaksë: Tafil Kelmendi, Sala Ahmeti etj.

Leksikografi: Murat Bejta, Sylejman Drini, Mikel Ndrecaj, Shefkije Islamaj, Kruno Kërstiq, Abdullah Zymberi, Mehmet Ahmetaj, Qemal Murati etj.

Leksikologji: Hilmi Agani, Ruzhdi Ushaku, Shefkije Islami, Zenun Gjocaj etj.

Dialektologji: Idriz Ajeti, Latif Mulaku, Fadil Sulejmani, Fadil Raka, Mehmet Ahmetaj, Mehmet Halimi, Qemal Murati, Imri Badallaj etj.

Onomastikë: Idriz Ajeti, Skënder Gashi, Rexhep Doçi, Shefki Sejdiu, Ruzhdi Ushaku, Zef Mirdita, Qemal Murati, Bahtijar Kryeziu, Begzad Baliu etj.

Etimologji: Idriz Ajeti, Shefki Sejdiu etj.

Standardologji: Selman Riza, Idriz Ajeti, Shefkie Islamaj, Rexhep Ismajli, Fadil Raka, Shefki Sejdiu, Qemal Murati, Isa Bajçinca, Begzad Baliu etj.

ZHVILLIMET E JASHTME TË SHQIPES

Shqipja dhe ballkanistika: Aleksandër Stipçeviq (ilirologji), Idriz Ajeti (histori e gjuhës), Besim Bokshi (morfologji), Shefki Sejdiu (fitonimi), Rexhep Ismajli (standard) etj.

Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët sllave: Idriz Ajeti (me serbishten), Murat Blaku (me sebishten e shkruar), Qemal Murati (maqedonishten) etj.

Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët romane: Shefki Sejdiu, Murat Bejta, Ruzhdi Ushaku, Gani Hoxha etj.

Marrëdhëniet e shqipes me gjuhën angleze: Veselaj Nuhiu etj.

Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët orientale: Feti Mehdiu. Mehdi Polisi etj.

Tash së fundit janë ofruar mjaft projekte për marrëdhëniet e shqipes me gjermanishten, por rezultatet e tyre nuk më janë të njohura sepse paraqesin projekte kryesisht magjistrature e doktorate.

Përfaqësuesit kryesorë
(Studime monografike)

Selman Riza, Idriz Ajeti, Besim Bokshi, Shefki Sejdiu, Rexhep Ismajli[15].

Duke përfunduar. Ka ardhur koha të përgatitet dhe botohet *Historia e albanologjisë,* një vepër integrale akademike, e cila sikur është provuar deri më tash, vështirë është të përfundohet me përpjekje individuale, e pretendimi për ta bërë këtë nga një grup historianësh të albanologjisë, do të duhej t'i nënshtrohej një diskutimi paraprak në rrafshin e metodologjisë së kërkimit dhe sintezës.

Prishtinë, 2007

[15] Në një projekt më të gjerë të historisë së albanologjisë për Kosovën, brenda po këtij vëllimi do të mund të hynin edhe albanologët: Hilmi Agani, Latif Mulaku, Ruzhdi Ushaku, Shefkie Islamaj, Fadil Raka, Fadil Sulejmani, Qemal Murati.

Dhurata SHEHRI

SYNIMI I AUTORITETIT NË RRETHANAT E IZOLIMIT DHE DEFORMIMIT IDEOLOGJIK

Operacioni i synimit të vendosjes së një autoriteti dhe hierarkie të re, së pari ideologjike, në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore duhet ndarë në dy faza:

Faza e parë: Synimi i autoritetit në rrethana të izolimit dhe ideologjizimit.

Kjo fazë karakterizohet nga 'spastrimi' i hierarkisë nga autoritetet e mëparshme, nga autoritet bashkëkohore të huaja dhe nga autoritetet shqiptare që vepronin jashtë kufijve. Çdo vepër e re mund të ndryshojë hierarkinë e së shkuarës, na mëson Eliot-i, por në kulturën shqiptare të pas Luftës së Dytë Botërore, kjo ndodhi me sëpatë në dorë.

Operacioni filloi me nxjerrjen e librave jashtë qarkullimit duke synuar në një fazë të dytë nxjerrjen edhe nga sistemi i vlerave dhe i hierarkisë. Detyra mbetej e vështirë në një moment të parë, pasi dija e prodhuar dhe e përcjellë prej tyre ekzistonte në qarkullim dhe elitat intelektuale, aktive ose jo në sistemin e ri politik, ishin formuar mbi atë dije dhe ishin bartës të asaj dijeje. Shembullin tipik të këtij operacioni e ndeshim që në parathënien e *Historisë së letërsisë* të vitit 1959, historia e parë zyrtare e sistemit komunist:

"Është e para herë, në jetën kulturale të popullit tonë, që bëhet një përpjekje kaq e gjerë për hartimin e një teksti të letërsisë shqipe." [1]

"Puna e bërë në të kaluarën në fushën e studimit të historisë së letërsisë shqipe ishte e paktë, me kritere të përcipta ose edhe të shtrembëta idealiste. Mungonte një histori e letërsisë shqipe e ndërtuar mbi baza shkencore." [2]

[1] Hsitoria e letërsisë shqptare, 1959, f. VII
[2] Po aty, f. IX

Ndërhyrja direkte mbi autorët dhe veprat, shoqërohej me një proces shoqëror "deklasimi" ku intelektualët bartës të dijes a autoritetit shfaqeshin si përfaqësues të botës së vjetër dhe shiheshin me armiqësi, (zhdukej autori, zhdukej vepra ose e anasjellta). Humbin statusin si në institucione, ashtu dhe në publik. Paralelisht me hierarkinë formohet edhe marrësi i saj. Mbi atë kryhet një operacion ideologjizimi, ai bëhej armiqësor ndaj gjithçkaje, në përputhje me ideologjinë. Pak nga pak, zhduken nga hierarkia autorë si.

1. Anton Harapi,
2. Brano Merxhani,
3. Krist Maloki,
4. Gjergj Fishta,
5. Ernest Koliqi
6. Faik Konica e shumë të tjerë.

Deri në fund të këtij procesi, një pjesë e mirë e autoriteteve të mëparshme zhduken bashkë me veprën e tyre. Një pjesë tjetër neutralizohen (këtë fat do ta kenë Poradeci, Kuteli, Çabej) në mënyrë që, në një fazë të dytë, të zëvendësohen me autoritete të reja. Tipik për këtë operacion është përkëmbimi i autoritetit të Eqrem Çabejt, i cili anashkalohet si kritik letërsie dhe i njihet vetëm autoriteti si gjuhëtar i gjuhësisë historike. Del nga qarkullimi studimi i tij mbi epikën e Fishtës dhe shmanget autoriteti i tij si historian i letërsisë me veprat *Për gjenezën e literaturës shqipe* dhe *Elemente të gjuhësisë e të letërsisë shqipe*. Për të hartuar këtë veprën e fundit, Çabej përfaqësues i modelit të *autoritetit bartës*, pranon se është mbështetur në modelin e Petrotës.

Por e gjitha kjo nuk ndodh menjëherë. Deri në *Historinë e letërsisë* të 1959, vazhdojnë të citohen "përpjekjet e Sqiroit, për historinë e letërsisë", "puna kryesore që bëri Faik Konica për fillimet e kritikës letrare", "organet e klerit katolik si *Hylli i dritës* dhe *Leka* të Shkodrës dhe organet e tjera që ishin nën ndikimin e tyre që përpiqeshin t'i jepnin tonin kritikës letrare dhe gjer në një farë vendi ia arrinin këtij qëllimi". Po ashtu, përmenden, ndonëse si pa ndonjë vlerë të veçantë tekstet e historisë së letërsisë së Justin Rrotës, Eqerem Çabejt, *Shkrimtarët shqiptarë*.

Ndërsa në parathënien e botimit të *Historisë së letërsisë* më 1983, asnjë nga këto nuk përmendet më. E referueshme pozitivisht është tashmë *Historia e letërsisë* e vitit 959.

"Në këto rrethana, - kritikut i mbeten vetëm dy funksione- shprehet Steiner - është një interpretues i dogmës së partisë dhe një zbulues i kujdesshëm herezish"[3].

Faza e dytë: Krijimi i autoriteteve, sistemit të ri të vlerave, '60-'85

1. **Shndërrohet dija ekzistuese e nxjerrë jashtë sistemit**. Ajo rimerret dhe bëhet e përshtatshme për ideologjinë duke u deformuar, duke mos u cituar autorët dhe duke u vetëpromovuar si autoritete të dijes së re. Hierarkia e vendosur bën edhe që të shtrembërohen idetë e interpretimet e autorëve duke i futur në një kontekst tjetër ideologjik. Një nga shembujt është interpretimi i krijimtarisë së Migjenit. Siç dihet, Migjeni është përzgjedhur nga kritika për të qenë ura lidhëse mes prirjeve sociale të letërsisë së para Luftës së Dytë dhe realizmit socialist, për t'i mëshuar idesë se realizmi socialist i ka rrënjët në zhvillimet e brendshme të kulturës shqiptare dhe nuk është produkt i importuar. Për këtë arsye, njoftimet mbi biografinë e bibliografinë e Migjenit duket sikur janë të plota. Por, çuditshëm anashkalohet një letër e Migjenit drejtuar redaksisë së *Botës së re*[4] ku pikëpamjet e tij duket se ndryshojnë edhe nga prirja sociale e kësaj reviste, e natyrisht janë fare të largëta nga realizmi social që i mvesh kritika letrare e pas '45-së. Anashkalimi i "detajeve" të tilla bën që pohimi i kritikës marksiste se Migjeni është poet i mjerimit të duket shtrembërim i pohimit të Pipës se "Migjeni është poet i të mjerëve. Nji simpati e fortë – vazhdon Pipa - e anon nga këta të dënuem, kah këto viktima të shoqnis. Kush asht aj tekembramja? Nji mësues katundi, nji i sëmundë qi nuk mund të shërohet se nuk ka pare..."

Edhe gjatë rrokjes kritike të poezisë "Shkëndija", aq fort të keqpërdorur ideologjikisht në kritikën shqiptare, në fakt, ndeshemi me

[3] G. Steiner, Linguagio e silenzio, f. 237

[4] Këtë letër e gjejmë të botuara nga G. Entrej më 1973 dhe më pas botohen me shkurtime në "Kritika letrare" 1979. (Citojmë sipas I. Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983).

një interpretim tjetër, me shkëndija të tjera interpretuese: "Shkëndija, tue u vërsulë në liri, shkëputet nga votra dhe zen vendin e hanës. Ky vrull kah liria asht aq i fortë sa me shkëputë çdo lidhje me traditën, këtu e shëmbëllyeme me votrën" – shprehet Pipa. Migjeni është "profet i jetës së re ndër agonitë e dritës së Prendimit... ku Prendimi qi aj ka hymnue asht dhe prendimi i jetës së tij!... Migjeni nuk asht rreze dielli qi len, por rreze dielli qi prendon. Asht lajmtar i kohës së re, jo fillues i saj. Bir, jo i shekullit të ri, por ma i mbrami bir rebel i shekullit të vjetër".

2. Mungesa e citimeve nga autorët "e deklasuar" dhe transferimi mbi vete i një pjese të dijes së tyre

a- Përdorimi i dijes së grumbulluar në fushë të gjuhësisë pa e cituar për dallimet mes gegërishtes e toskërishtes nga Justin Rrota, apo me çështjet e gramatikës së Osman Myderrizit.

b- Shembull tjetër është transferimi i dijes, sidomos pjesa e dijes klasike, të botuar në veprat *Literatura shqipe* (Justin Rrota), *Visaret e Kombit* (Bernardin palaj, Donat Kurti), shkrimet kritike të Zef valentinit, Vangjel Koçës, Branko Merxhanit etj. tek autoritetet e reja.

c- Zhdukja e emrit dhe e autoritetit të përkthyesve. Një pjesë e mirë e moshatarëve të mi dhe disa breza para e pas nesh e kanë lexuar, disa mund ta dinë përmendsh prozën poetike *Zgalemi* të Maksim Gorkit, por të paktë janë ata që e dinë se përkthyesi është Sejfulla Malishova. Madje nuk njihen as përkthyesit e veprave të klasikëve të marksizmit, as i Kapitalit të Marksit. Një pjesë e mirë e kryeveprave të letërsisë botërore fillimisht kanë dalë pa emrin e përkthyesit, prandaj ndoshta është kaq e lehtë edhe sot që të mos u njihet as autoriteti, po as pronësia intelektuale. Duke zhdukur emrin dhe duke dënuar me anonimat punën e shumë personaliteteve të kulturës shqipe, në një shoqëri të izoluar e deformuar ideologjikisht, në fakt dëmtohet modeli i përkthyesit, si ai i ndërmjetësit shembullor mes kulturave.

Fondi rezervat

Janë të rrallë ata njerëz të letrave që nuk kanë dëgjuar për Fondin rezervat – ose fondin që shfaqet me R të kuqe në skedat e bibliotekës kombëtare. Ishte fondi i librave të ndaluar, libra të traditës dhe libra të literaturës botërore që nuk lejoheshin të merreshin për t'u lexuar nga të gjithë. Pronësia e intelektualëve shqiptarë mbi dijen që ndodhej në librat e këtij fondi ishte e dyfishtë. Ata që kishin leje kalimi për aty ishin jo vetëm të pacënueshëm nga "ideologjia e vjetër, borgjeze e reaksionare" dhe mund t'i lexonin lirshëm librat e fondit në fjalë, por edhe kishin dorë të lirë për të transferuar mbi vete pjesë, faqe, argumenta, ide.

"Marksizëm-leninizmi dhe regjimet politike të ngritura në emër të tij e marrin seriozisht, tmerrësisht seriozisht letërsinë. Kjo duket edhe në një pohim të Trockit që shprehet se "evoluconi i artit është prova më e lartë e vitalitetit dhe vlerës së çdo epoke"[5]. Ndoshta këtu duhet kërkuar edhe themeli i modelit të synimit të autoritetit mbështetur në izolim e deformim ideologjik, që gjithsesi nuk ka qenë i vetmi edhe në atë sistem.

3. Sistemi i vlerave botërore

Ndodhi i njëjti transferim edhe me një pjesë të vlerave botërore. Së pari, u mbyll rruga e komunikimit të vlerave. U bë deklasimi edhe i kulturës botërore e sistemi i vlerave botërore të pranuara nga regjimi u ngushtua. Gjithsesi, dija botërore vazhdoi të shfrytëzohej po pa i përmendur autoritet e kulturës botërore. Izolimi dhe transferimi nga burimi tek autoritet e brendshme çonte në promovimin abuziv të disa autoriteteve. Në disa vepra të fushave teorike të mendimit për artin, letërsinë, stilistikën etj., citohen autorët ideologjikë si maskim për të mos cituar esencialisht autorët e shfrytëzuar. Autoritetet kryesore botërore të disa disiplinave teorike, edhe pse shfrytëzohen në mënyrë integrale si në rastin e Jakobsonit, denigrohen. Rastet janë të shumta

[5] G. Steiner, Linguagio e silenzio, f.254

dhe të identifikuara por po sjell vetëm një për të mos i dhënë kësaj kumtese tonet e akuzës, pasi qëllimi i saj është analiza e një dukurie.

Ndonëse në kufijtë e dominimit për një periudhë të caktuar, ky nuk ka qenë modeli i vetëm i krijimit të autoriteteve në kulturën shqipe. Një pjesë e mirë e saj ka ndjekur modelin e mirënjohur në kulturën botërore si për të vendosur autoritetin e ri, ashtu edhe për të ndryshuar hierarkinë. Janë shumë të njohur si shembujt e marrëdhënieve prej dishepujsh, ku nxënësi pasardhës bëhej bartës dhe përtëritës i dijes së mjeshtrit, ashtu dhe shembujt e afirmimit përmes kundërshtimit të një autoriteti pararendës të dijes. Në kulturën shqiptare pararendëse, modeli i bartësit dhe përtëritësit të dijes ka funksionuar shumë mirë në vitet '30; në kulturën shqiptare të Kosovës duke filluar nga vitet '60-70 dhe në një pjesë jo të vogël të kulturës shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore me personalitete të tilla si Buda, Cabej, Xhuvani, Mancaku, Dado për të përmendur vetëm disa. Modelit trashëgues dhe bartës të Todorovit me formalistët rusë në kulturën shqipe i përgjigjen: Branko Merxhani me bartjen në kulturën tonë të Durkheim-it, August Komt-it dhe në përgjitjësi të filozofisë pozitiviste; Krist Maloki me Frojdin dhe pikëvështrimin psikanalitik; Eqerem Cabej me kritikën komparatistike, filologjinë kulturoro-historike, shkollën shpirtëroro-historike gjermane[6]; Ernest Koliqi me de Sanctis-in; Arshi Pipa me metafizikën e Bergsonit dhe të Kroçes. Në këtë pikë, të duket sot gati e habitshme prania në faqet e "Përpjekjes shqiptare" të shkrimeve të Raymond Aronit që në vitet 1937-38. Edhe vetë Shuteriqi i atyre viteve është bartës si i filozofisë së artit të Ipolit Tenit, ashtu edhe i tezave të revistës frënge *Commune*[7].

I njëjti model përtërihet në kulturën shqiptare në Kosovë në vitet '60-'70 me personalitete që e ndërtojnë së pari autoritetin e tyre duke qenë bartës dhe përtëritës të dijes bashkëkohore botërore. Raifi, Ismajli, Hamiti, Rugova, bëhen përtëritësit e bartësit e R. Barthes-it, Genette-it, Martinet-së, Sausure-it, Lotman-it.

Ndjeshmëria ndaj të drejtës së autorit është shembull i mbijetesës deri sot në kulturën shqiptare në Shqipëri të modelit të

[6] I. Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, f.138-140
[7] Po aty, f. 158

synimit të autoritetit në rrethana ideologjike dhe të izolimit. Mjafton të përmendim se në statusin dhe rregulloren e Shtëpisë Botuese të Librit Universitar, një nga strukturat e mbetura nga infrastruktura e kohës së komunizmit, nuk ekziston mekanizmi i marrjes së të drejtës së autorit.

Duket sikur nuk i përket kjo detyrë, por me dekonstruktimin e këtij modeli autoriteti duhet të merret sot pikërisht filologjia. Ajo përcaktohet si shkenca që ka në qendër autenticitetin e teksteve të shkruara. E, "tekst vjen nga latinishtja "textus", që fjalë për fjalë, do të thotë veshje... Asocimi me veshjen i përshtatet shumë mirë edhe punës së filologut. Teksti prishet dhe dëmtohet lehtë, njësoj si çorapet e të brendshmet e na duhet pastaj ta arnojmë duke i rilidhur fijet ose duke i vendosur një arnë të fortë, por me ngjyrën e duhur"[8]. Por detyra e filologjisë nuk mbaron këtu, të paktën jo detyra e filologjisë shqipe. Përveçse të arnojë edhe të rilidhë, ajo duhet të guxojë të thotë kur ta dojë rasti, edhe se "mbreti është lakuriq".[9]

[8] L. Çezarini Martinelli, Filologjia, f. 17
[9] M-J. Mondzain, Le commerce des regards, Paris 2003

Enver GJERQEKU

NË 70-VJETORIN E BOTIMIT TË "YLLIT TË ZEMRËS" TË LASGUSH PORADECIT

Poeti i gjuhës së zjarrtë lindi më 1900 në Poradec dhe më dymbëdhjetë tetor të vitit 1989 i mbylli sytë e vet plot mallë e dashuri njëri nga shkrimtarët më të mëdhenj e më të dalluar të letërsësë shqiptare, poeti dhe mësuesi – LASGUSH PORADECI. Pushoi së rrahuri zemra e tij plot mallë dhe etje për bukuritë e amshueshme të jetës dhe të qenies sonë kombëtare; u shua ajo mendje që bredhte nëpër fshehtësirat më të thella të rruzullit tokësor dhe të gjithsisë, duke kërkuar përherë si zog i qiejve yllin e vet të pangushëlluar dhe kuptimin e jetës së vet; u ngri për një çast ajo gjuhë dhe ajo fjalë, që në mënyrë magjike shprehte botën tonë shpirtërore dhe vlerat e saj njerëzore.

Dhe në çastin e frymës së fundit të agonisë së vet, ndoshta e ka ndjerë dhe hetuar se ai po shkëputet si meteor nga orbita e zemrës së kësaj jete dhe po kalon në orbitën e re të amshimit – të vdekjes, duke hyrë në vallën e yjeve e duke u bërë edhe vetë yll, për të ndriçuar me vjetë e shekuj si flakada në qiellin tonë kombëtar.

Ai edhe në krijimtarinë edhe në jetën e vet bukur të gjatë besonte dhe ëndrronte se poeti është një misionar i dërguar për të përhapur verbin hyjnor mbi dhé e jetë, që të arrinte të identifikohet me yllin e vet prijatar, duke u njëjsuar në të njëjtën kohë me fatin e jetën e popullit dhe të atdheut, në të cilin e ndjente prore në këngën e lashtë e jetike. "Këngën pleqërishte" "llahtarisht" të bukur.

Kur vdesin poetët e mëdhenj si Lasgushi, nuk vdes edhe vepra e tyre; përkundrazi, ajo vjen duke u përtritur e duke u ringjallur si feniks nga hiri i trupit të tyre, duke u pështpëritur në çaste të dhëmbjeve apo të gazmendit, duke u kënduar me mburrje nga goja e zemra e brezave, që dinë të shijojnë tingujt mahnitës të kësaj gjuhe dhe porosinë e urtë të saj.

E poeti ynë, që në jetën e vet nuk përjetoi vetëm çaste të qeta dhe të hareshme, por edhe çaste dëshprimi e mohimi, - sa vinte e bëhej

më i moshuar, poezia e tij vinte duke shpërthyer e çelur në shumë nuanca e ngjyra me më shumë degë e rrënjë dhe, sa më shumë në ballin dhe fytyrën e tij shtoheshin rrudhët e mbi kokë e vetulla fjollat e thinjura, aq më shumë përtëritej poezia e tij, duke hapur shtigje të reja edhe në veprat e studiuesve të tij.

Mund të themi me gjithë mend se fjala poetike e Lasgushit po vjen edhe në këto ditët tona, në të vërtetë, në këto tri dekadat e fundit, duke pësuar e përjetuar një rilindje të vërtetë e të vazhdueshme, që nga ato fjalët e para zemërdhënse të shkencëtarit e mendimtarit albanologut tonë më të madh Eqrem Çabejt, i cili hetoi tiparet dhe prirjet e njëmendta krijuese poetike të Lasgushit, të cilin e krahasonte me poetët më të mëdhenj shqiptarë dhe poetët modernë evropianë, që nga Skënder Luarasi që vargjet e Lasgushit i quante si vargje të përsosura, që nga pasthënia analitike e sintetike e Mitrush Kutelit, që është deri më sot një nga studimet më shkoqitse e më të thella për poezinë e Lasgushit, studim ky që u ka shërbyer edhe kritikëve edhe historianëve të letërsisë shqiptare si bazë e shëndoshë për studime të mëtejshme, e deri te qasjet e trajtesat e reja bashkëkohore e moderne dhe të tjerëve, të cilët kanë hetuar tërë bukurinë e magjinë e poezisë së Lasgushit. Ka pasur në një kohë edhe t'atillë, që duke u mbështetur në parime të ndryshme jashtëpoetike, e kanë vënë në dyshim vlerën e madhe të poezisë së Lasgushit, por ata tash më gati janë harruar e janë zbehur tërësisht përballë studimeve të njëmendta letrare-estetike. Tani ne po përjetojmë edhe në shekullin njëzet e një triumfin e poezisë së tij.

Lasgush Poradeci është një fenomen i rrallë i poezisë shqiptare në veçanti, por edhe i poezisë evropiane në përgjithësi. Në një fazë të zhvillimit të letërsisë sonë, veçanërisht të poezisë, kur njerëzit tanë – lexuesit e studiuesit ishin të ngopur me tingujt e vargje të romantikëve të lodhur e të vonuar, që përsëritnin refrenet e veta monotone pa gjak dhe prirje individuale krijuese me një shprehje deklarative e bombastike. Lasgushi në vitet e njëzeta, e veçanërisht n'ato të tridhjetat u shfaq si një krijues i poezisë, si një individualitet poetik i formuar, që nuk përfill nevojat momentale të ditës, që janë zakonisht kërkesa joletrare. Ai kërkon shumë më tepër nga poeti dhe poezia, duke kërkuar dhe ndjekur verbin e vet poetik në gurrat e një shprehjeje dhe të një metaforike të re e moderne, duke depërtuar në palcën dhe në

eshtrat e qenësisë sonë, duke depërtuar në rrënjët dhe në bërthamën e entitetit tonë kombëtar dhe njerëzor. Ai nuk u kënaq me këngën e vjetër e të demoduar, që prekte vetëm syprinën e jetës shqiptare dhe të njeriut në kuptimin më të gjerë të fjalës; ai depërtoi në bukurinë e brendshme të xhevahirëve tanë, në vlerat më të spikatura të lashtësisë dhe të qëndresës sonë, të natyrës shpirtërore e materiale, të elegjisë e të romansës sonë, me një fjalë, gjithnjë duke bërë përpjekje që, me fjalën e vet magjike, të nxjerrë në shesh tiparet më të qenësishme të hapërimit tonë nëpër shtigje e kohëra, të cilat për ne qenë bukur shpesh të pamëshirshme, të mbushura me shtrëgata e gjemba.

Lasgush Poradeci krijimtarinë e vet e filloi që kur ishte djalosh nëntëmbëdhjetëvjeçar. Natyra e kishte dhuruar e pajisur me prirje të rralla për poezi e pikturë. Kur lindi, më 1900 hapi syçkat e vet në një bukuri të rrallë magjepse dhe frymëzuese – në Poradec, ku, tash më, prehet trupi i tij, ngjit me buzët virgjër dhe ujin e kthjelltë si bulza loti të liqenit, që aq shumë e deshi, e më shpesh e më fuqishëm e këndoi dhe e përjetësoi në vjershat: *"Dremit liqeri", "Zemra e liqerit", "Dritë fshehtësije", "Poradeci"* e tjerë. Duke çmuar lart gjuhën e poetit – *"Gjuhën e zjarrtë"*, si *"këngë të shëntëruar"*, si *"zjarr që përflakët"*, si *"yll vetëtimtar"*, ai këtë gjuhë e ndjeu thellë në veten e vet *"posi kullim i gjakut që rreh në zemër time"*, thotë Lasgushi, duke përfunduar me një refleks madhështor, që shpreh gurrën e pashterrshme të kësaj gjuhe në vargun: "O gjuhë e zemrës sime, o mos e kuvenduar", gadi si ai përfundimi mahnitës i Naimit: *"E ku shkruhen në kartë, fjalëtë e gjuhës së zjarrtë"*. Gjuhën e poezisë Lasgushi nuk e ndau nga gjuha e popullit, nga gjuha amnore, por i bashkëdyzoi si në *"Këngën pleqërishte"*, *"vjershën e vendit tem",* atë *"fjalë dhe atë gjuhë që të bën ujem, në hije të kasollës, që nxin atje mbi mal, si breshër i thermuar, si lot i përvëluar"*... këndoi Lasgushi.

Lasgushi në vitet e tridhjeta botoi dy vëllime poezish: *"Vallja e yjeve"* 1933 dhe *"Ylli i Zemrës"* 1937. Në ciklet e vjershave të këtyre veprave Lasgushi hyn në lashtësinë dhe figurat e shndritshme të saj, në mallin e natyrën e njeriut tonë, në dashurinë e dhembjet, në zemrën dhe bukurinë e vendit të vet, duke krijuar vargjet më subtile dhe më polifonike të lirikës së vet, duke i dhënë fjalës shqipe një fuqi të veçantë shprehëse, me një sistem të ri dhe individual metaforik, me fjalë e kompozita të reja, të cilat e begatuan dhe e çuan më tutje

gjuhën letrare shqipe. Si poet i pajisur me një kulturë të gjerë letrare dhe gjuhësore, me një orientim të ri krijues, me një simbolikë të thellë, por të qartë, ai krijoi poezi të vlerave të përhershme siç janë: *"Vdekja e Nositit", "Gjeniu i anijes", "Lundra e fjamuri",* e të tjera. Edhe pse shpesh për rapsoditë e veta, për baladat dhe disa vjersha të tjera, siç është *"Vasha e trimi"* u frymëzua nga poezia popullore, duke ngjizur edhe vargje të saj në veprën e vet, këtë e bëri me një sensibilitet të rrallë poetik, duke dashur që edhe veprën e vet ta lidhë sa më shumë me poezinë e popullit. Ky është më shumë qëndrim i një koncepti krijues, që i jep dorë edhe poetit.

Poezinë deskriptive Lasgushi e krijoi si një tog tabllosh pitoreske, me nuanca e ngjyra të gjalla, që kanë tiparet e një simbolike e të një personifikimi, të meditimeve e të reflekseve poetike, që depërtojnë thellë në fshehtësirat e mugtirat prej kah del drita e një shkëndije të re, shkëndija të gjakut njerëzor e kombëtar, të tragjikës personale dhe kolektive.

Lasgush Poradeci gjatë formimit të vet si poet krijimtarinë e vet e mbështeti në disa gurra e shtresa të brendshme dhe të jashtme, në ato kombëtare dhe në ato botërore. Mirëpo, ai nuk u bë epigon i tyre, përkundrazi pat fuqi krijuese dhe prirje që ato t'i nënshtrojë dhe t'i asimilojë në poetikën e vet. Ato të brendshmet lidhen për letërsinë popullore dhe veprat e klasikëve tanë, në radhë të parë të Naim Frashërit, ndërsa ato të jashtmet me rrjedhat moderne të poezisë së M. Emineskut dhe Koshbukut, poetë rumun, të romantikëve dhe simbolistëve më të dalluar. Si poet me një ndjeshmëri të hollë, me një refleks meditativ të thellë, me një vizion poetik largpamës, që hap horizonte dhe shtigje të reja e të parrahura, ai shfrytëzoi gati tërë potencialin e vet akumulues kreativ, brenda një kohe relativisht të shkurtë në jetën e tij të gjatë. Dhe në një fazë të jetës së vet, kur hetoi, si duket, dhe u bind se fjala e tij nuk e ka më atë fuqi të nevojshme për poezi, se nuk e ka më atë vrull rinor dhe atë lëng e gjak jetësor, atë thellësi të ndjenjës e të mendimit, më tepër heshti se sa shkroi, i bindur se ka arritur zenitin e krijimtarisë së vet dhe të poezisë shqiptare në përgjithësi.

Ka krijues që çmohen për qëndrueshmërinë e tyre, që me ngulm vazhdojnë krijimtarinë deri në fund të jetës së tyre, e ky qëndrim lëvdërohet e çmohet si vullnet i pathyeshëm dhe dëshirë e pashuar.

Mirëpo po ashtu cilësohet si virtyt dhe urtësi e rrallë momenti, kur vetë krijuesi e heton se kur duhet "të heshtë". Këtë cilësi që mund të themi se hyn në kategorinë e tipareve të larta etike e njerëzore krijuese e kishte edhe Lasgush Poradeci. E për ne, për kulturën, për poezinë dhe gjuhën tonë, do të ishte shumë më e dobishme, sikur të kishte vazhduar shtigjet e "Valles së Yjve" dhe "Yllit të Zemrës", duke i pasuruar me të arritura të reja, sepse, edhe ashtu të pasur me veprën e tij, do të ishim më të mëdhenj dhe më të fuqishëm edhe për disa vlera të tij. Poeti ynë ishte si ata vullkanët, që për një kohë shpërthejnë me një erupcion të fuqishëm, e mandej prajnë. Nuk ishte nga ata që vazhdimisht tymosin dhe nxjerrin nga një xixë të rrallë.

Lasgush Poradeci si poet e krijues ishte edhe mësues i disa brezave të poetëve shqiptarë, të cilët poezinë e tij e patën edhe si udhërrëfyese, madje edhe si frymëzim të pashterrshëm. Ai u bë edhe vetë frymëzim për shumë vargje e poezi, që me admirim i kushtohen poetit tonë të madh.

Për veprën e madhe e të vlefshme dhe për të gjitha ato pekule e kujtime, që na i la trashëgim, në fund mund të themi: Lasgush Poradeci është metaforë e pashterrshme e frymëzimit poetik, e hulumtimeve të reja dhe e përjetimeve të vlerave të kësaj poezie, që na ngashnjen e na bën më të pasur shpirtërisht e kombëtarisht.

Për disa personalitete të jashtëzakonshme thurën edhe legjenda. Lasgush Poradeci ishte vetë legjendë. Atë nuk e bëri të këtillë as lufta – luftëtar, as revolucioni – revolucionar, as ndonjë zbulim shkencor – shkencëtar, por ndjenja dhe shpirti i tij *poet të kulluar* të gjuhës dhe të poezisë shqiptare, u bë figure markante me artin e vet të begatë. E Shqipëria me adhurim e krenari ngriti shtatoren e Tij me fytyrë kah Liqeni i Pogradecit, të cilin aq madhërisht e këndoi me poezitë e veta.

Sala AHMETAJ

FOLJET KËPUJORE DHE FOLJET FUNKSIONALE NË GJUHËN SHQIPE

Para gjuhësisë shqiptare sot shtrohen disa kërkesa:

1. Që të hartohet një strategji kombëtare për gjuhën

2. Që të bëhet një standardizim dhe unifikim i terminologjisë gjuhësore, sidomos në gramatika

3. Hartimi i një gramatike standarde me kritere unike

Sot ballafaqohemi me vështirësi jo të vogla gjatë punës pikërisht për mungesë të një teorie. Në fushë të sintaksës p.sh. përkufizimet për gjymtyrët dhe funksionet e tyre nëpër gramatika bëhen sipas kritereve të ndryshme.

Ç'kuptojmë me fjalën gjymtyrë varet nga mënyra se si i qasemi përimtimit të thënies. Në gjuhësinë bashkëkohore ndiqen rrugë dhe metoda të ndryshme për gjymtyrimin. Në fjalorin e terminologjisë franceze[1] gjymtyrët përshkruhen si një pjesë e një konstituenti, ose një konstituent i një njësie të një rangu më të lartë. Në literaturën shqipe tash vonë është dhënë një përkufizim për gjymtyrën. Në të gjymtyra shihet njësi sintaksore e rangut më të ultë dhe që përmbush një funksion të caktuar në fjali. Por përmbajtja e gjymtyrës mund të jetë e nduarnduartë. Si gjymtyrë mund të dalë një fjalë (e kuptimtë) e shoqëruar ose jo me elemente tjera. Po si gjymtyrë mund të dalin edhe bashkime të caktuara fjalësh që shprehin një nocion.

Kriteret, natyrisht, dalin si pasojë e një drejtimi në gjuhësi sepse sot bëhen edhe analiza gjenerative, analiza teksti, analiza funksionale sintaksore dhe formale etj. Sipas këtij gjymtyrimi një element gjuhësor me një formë të caktuar kryen gjithmonë të njëjtin funksion, pavarësisht çfarë përmbajtje ka. Për gjymtyrimin sintaksor ne parapëlqejmë pikëpamjet e Dykrosë[2]. Sipas tij të bësh një analizë të

[1] Dictionnaire dde Linguistique Larausse, Par Jan du Bois etc. Paris, 1984.

[2] O. Dykro, S. Todorov, Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit, Prishtinë, 1984, f. 377.

një fjalie (analizë të quajtur gramatikore) do të thotë t'i shënosh funksionet që kanë fjalët ose grupet e fjalëve në fjali (pra ta përkufizosh ç'është kryefjala, kallëzuesi etj.).

Tërësia e fjalisë a frazës nuk është një grumbull fjalësh të hedhura dosido. Përkundrazi, elementet në mes veti dhe secili element me frazën shpreh marrëdhënie të caktuara sintaksore. Fraza e marrë si tërësi ka një finalitet ku secili përbërës dallon nga të tjerët për nga roli që luan në përmbushjen e këtij finaliteti. Dhe, në këtë mënyrë çdo anëtar i frazës duhet të japë ndihmesën e vet specifike në realizimin e qëllimit të përbashkët[3]. Rolin e njërit anëtar nuk mund ta përmbush anëtari tjetër, p.sh. funksionin e kallëzuesit mund ta kryejë një folje, një mbiemër, një emër etj. (Kur aktualizohen me mbaresa të mirëfillta (zgjedhohen) ose kur aktualizohen me folje këpujore ose folje funksionale dhe pjesa emërore). Këto të dhëna dëshmojnë për *pavarësinë e funksionit sintaksor*. Por, përkufizimi i funksioneve sintaksore në gramatikat tona shpesh shkakton huti dhe paqartësi pikërisht për mungesë të një kriteri unik. P.sh. në Gramatikën e akademisë pjesërisht dhe sintaksa e Th. Dhimës (e botuar në Tiranë më 2005) kallëzuesi përkufizohet kështu. "Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë e shprehur me folje që hyn në marrëdhënie e lidhje kallëzore me kryefjalën" (f. 74). Po, në qoftë se pranohet ky përkufizim si i plotë dhe që shpreh krejt çka nënkuptojmë me kallëzuesin, atëherë si t'i shpjegojmë ose ç'funksion do t'u japim ndërtimeve si *marr në shqyrtim, marr në konsiderim, vë në lëvizje, vë në përdorim, marr arratinë* etj., ose ndërtimeve të tjera si *është e bukur, është në shtëpi, qe të premten* etj.

Ne do të pohonim se kallëzuesi si qendër organizuese e fjalisë nuk hyn në marrëdhënie e në kundërvënie vetëm me kryefjalën po edhe me gjymtyrë tjera. *Kallëzuesi me formën dhe përmbajtjen e tij ua lejon, mundëson ose kufizon mundësinë e daljes ose jo të gjymtyrëve tjera*. T'i rikthehemi edhe një herë çështjes që po diskutojmë. Cili kriter duhet të përfillet për përkufizimin e kallëzuesit, sidomos kur është fjala për elementet përbërëse të tij. Të merret si kallëzues vetëm folja apo folja bashkë me fjalën me të cilën shpreh një nocion të pandashëm. Prandaj, e pamë të arsyeshme të shtrojmë për diskutim

[3] Po aty, f. 295.

edhe një herë disa ndërtime emërore me foljen bartëse (siç quhen në terminologjinë frënge ose bashkime me foljen funksionale sipas terminologjisë gjermane) dhe ndërtimet me foljet këpujore dhe funksioni i tyre. Në gramatikat e shqipes për ndërtimet si *marr në shqyrtim, shtrihet buzë malit, paraqitet në foltore, ndodhi të dielën* etj., nuk kemi gjetur shpjegime argumentuese dhe shteruese për funksionin e tyre sintaksor.

Ne përfillim pikëpamjen sipas së cilës në shembujt e mësipërm emrat (ose mbiemrat etj.) janë aktantë të detyrueshëm për foljen, janë plotës të strukturës bërthamore (termin plotës e kemi përdorur në përputhje me teorinë e Llajonsit). Në gjuhësinë shqiptare nuk ka unitet pikëpamjesh për këto ndërtime dhe për foljet këpujore. Disa autorë këto folje (foljet këpujore) i trajtojnë si kallëzues të thjeshtë sikur edhe të gjitha foljet tjera që kanë kuptim të plotë leksikor. Të tjerët (Cipo dhe Përnaska) i marrin si këpuja që shërbejnë për të ndërtuar kallëzuesin emëror a kallëzuesorin ose e marrin si këpujë vetëm foljen *jam*. (p. sh. Totoni). Për Totonin dhe Dhimën humbja e ndonjë komponenteje semantike nuk e zbeh kuptimin leksikor. Për ta folja vetëm është kallëzues pavarësisht a i ka apo jo të gjitha komponentet semantike. Ne kujtojmë se pikërisht zbehja e kuptimit leksikor të foljes dëshmon për pamundësinë e përmbushjes së funksionit të kallëzuesit pa elementin shtesor (që mund të jetë emër, mbiemër, etj.). Pohimet se nga pikëpamja logjike dhe psikologjike përcaktori kallëzuesor është predikat, sepse shpreh të renë në fjali na duket i pambështetur për faktin se e reja (ose rema) në fjali mund të koincidojë edhe me kryefjalën sintaksore. Edhe lidhja dyanësore e kallëzuesit nuk mund të merret si argument për përcaktimin e funksionit. Për ne, p.sh. *duket i kaltër* është sinonimike me *u kaltërua* ose *kaltëron*, *doli mësuese - diplomoi*. H. Agani me të drejtë pohon se përcaktori kallëzuesor do të duhej të shikohej në bazë të aftësisë ose paaftësisë së foljes kallëzues që të kryejë funksionin e vet në fjali[4]. Kurse O. Bucholz[5] foljet e tilla i sheh si këpujore sikur edhe folja *jam*. Kurse Jon Llajons problemin e foljeve këpujore e trajton në një plan

[4] H. Agani, Rreth një sinkretizmi në gjuhën shqipe, GJA, nr. 7, Prishtinë, 1978, f. 106.

[5] O. Bucholz, Kallëzuesori në gjuhën shqipe (në krahasim me gjermanishten, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqipe, nr. IX, Prishtinë, 1984, f. 53.

më të gjerë e më të thellë. Sipas tij, foljet këpujore shtrihen e përdoren edhe me plotës kohorë e vendorë[6]. Këpuja kohore konsiderohen edhe foljet *ngjan, ndodh, paraqitet, jetoi, ekzistoi* etj., bie fjala, jetoi e kufizuar për kryefjalë të rendit të parë (njerëzish) *Agimi qe të dielën*, *manifestimi ngjau, ndodhi të dielën* (si këpuja kohore) ose *manifestimi qe në park ose ndodhi në park* (si këpuja vendore).

1. Foljet këpujore do të duhej të pranoheshin si të tilla[7]. Fjala që shoqëron këto folje bart kuptimin themelor, e këpuja me kuptimin e saj të zbehur leksikor është bartëse e treguesve gramatikorë të kohës, mënyrës dhe vetës. Nga kjo del se folja këpujore dhe fjala që e shoqëron krijojnë një tërësi semantike dhe sintaksore, prandaj s'ka arsye që të mos konsiderohen si një gjymtyrë e vetme fjalie.

Bashkimet me foljen funksionale shpesh ngatërrohen me shprehjet foljore (ose frazeologjizmat) që kanë vlerën e një fjale të vetme, p.sh. *marr vesh - kuptoj* etj. Por, ndërtimet si *marr në shqyrtim*, *marr në konsiderim*, *marr arratinë* etj., janë ndërtime të lira sintaksore për të cilat nuk kemi gjetur asnjë shpjegim në gramatikat tona. Varësisht nga prodhimtaria e formimit të shprehjeve sipas të njëjtave gjedhe strukturore si dhe varësisht nga shkalla e qëndrueshmërisë gjatë përdorimit sintaksor shprehjet folje + (parafjalë) + emër do të ndaheshin në dy grupe. Në grupin e parë do të përfshiheshin shprehjet e tipit frazeologjik si: *bëj zë, marr vesh, ngul këmbë* etj. Në grupin e dytë do të përmblidheshin shprehjet që ndërtohen me emra abstraktë si *marr vendim, marr nën kujdes, vë në lëvizje* etj. Këto ndërtime për t'i dalluar nga togfjalëshat frazeologjikë do të propozojmë të quhen bashkime me foljen funksionale ose me foljen bartëse, në pajtim me terminologjinë më të përdorur në gjuhët që kanë dukuri të ngjashme.

Ndërtime të tilla i gjejmë edhe në fjalorë të gjuhës shqipe. Duke i krahasuar me togfjalëshat frazeologjikë që kanë struktura të njëjta a të ngjashme, për bashkimet me foljet funksionale çdo zhvendosje e vendit të përbërësve nuk çon në prishjen e kuptimit siç ndodh p.sh. me togfjalëshat frazeologjikë, sepse mundësia e realizimit në planin leksikor të pjesëve përbërëse është më e lirë. Një liri të tillë e ka

[6] J. Lyons, Introduction to Theoritical Linguistics, Combridge 2, et, 1969.
[7] Sala Ahmetaj, Foljet këpujore në gjuhën shqipe, Dardania Sacra, nr. 2, Prishtinë, 2000 (f. 345-355).

përbërësi emëror i bashkimit, por as folja nuk i ka gjithmonë të kufizuara mundësitë e një zhvendosjeje të tillë.

Dallimi më i rëndësishëm që ekziston në mes të togfjalëshave frazeologjikë dhe bashkimit me foljen funksionale qëndron në faktin se togfjalëshat frazeologjikë në çdo kontekst dhe në çdo situatë funksionojnë si një gjymtyrë e vetme (si kallëzues i thjeshtë foljor), kurse bashkimet me foljen funksionale paraqiten vetëm në kushte të caktuara sintaksore, p.sh. (*marr vesh – kuptoj*, është frazeologjizëm) dhe *marr në shqyrtim*, është bashkim me foljen funksionale, kurse *marr librin* është kallëzues i thjeshtë foljor dhe kundrinor i drejtë.

Te bashkimet me foljen funksionale *kuptimi leksikor i emrit është i plotë dhe ai e bartë ngarkesën e përmbajtjes semantike të tërë bashkimit, kurse folja shërben për të bartur kategoritë e modalitetit, kohës dhe vetës*. P. sh. *marr në shqyrtim – nis ta shqyrtoj* ose *po e shqyrtoj, vë në lëvizje* (emri *lëvizje* është ai që e bartë kuptimin). Ajo që dallon këta kallëzues (vë në lëvizje, marr vesh etj.) nuk është as kuptimi as natyra e plotësve por statusi i tyre morfologjik dhe forma e aktualizimit të tyre. Një kallëzues foljor aktualizohet me mbaresa të mirëfillta (zgjedhohet) kurse kallëzuesi me foljen funksionale aktualizohet me foljet funksionale *marr, vë* etj.

Përfundim. – Ne kujtojmë se kallëzuesi nuk është *një me foljen*. Ndonjëherë *folja* dhe *fjala* që e shoqëron kuptimisht është e pamundur të ndahen dhe ato shprehin një nocion, prandaj edhe një gjymtyrë.

Sipas nesh kallëzuesi del me *folje* ose *me një tog foljor*. Kushtimisht po e quajmë *tog*. Ky tog foljor do të ketë në qendër foljen[8] dhe kuptimisht është i pandashëm, shpreh një nocion. Me këtë përkufizim do të mënjanoheshin shumë dilema dhe vështirësi në përcaktimin e funksionit të ndërtimeve të tipit *marr në shqyrtim* etj. Te këto ndërtime ndeshim një paralelizëm funksional me ndërtimet me foljen këpujore si *u bë e hijshme, duket i kaltër* etj.

[8] Bucholz, O., Fiedler, W., Albaniche Gramatik, Leipzig, 1987.

Rrahman PAÇARIZI

PARAMETRAT PSIKOLINGUISTIKË TË NXËNIES SË GJUHËS STANDARDE DHE NDIKIMI I TYRE NË PRODHIMIN GJUHËSOR

Çështja e të nxënit të gjuhës është mjaft komplekse, për shkak të faktorëve të shumtë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë që ndërthuren në këtë proces të vështirë. Ndër faktorët që ndikojnë në këtë janë **faza e caktuar jetësore në të cilën mësohet standardi**, **mekanizmat që duhen aktivizuar për mësimin e standardit janë mjaft të kufizuar**, dhe **faktorët jashtëgjuhësorë, para së gjithash ata socialë,** si dhe **faktorët biologjikë** të cilët kanë ndikim të jashtëzakonshëm në këtë fazë jetësore të zhvillimit të aktivitetit psikomotorik të fëmijës.

Janë disa faza nëpër të cilat kalon të nxënit e gjuhës nga fëmijët, të cilave psikolinguistët u qasen në mënyra të ndryshme, por të gjithë pajtohen se në moshën gjashtë apo shtatëvjeçare përmbarohet arkitektura bazike e të nxënit të gjuhës, por kjo kohë jo në të gjitha rastet përputhet me takimin e parë intensiv të fëmijës me gjuhën standarde.

Koha e nxënies së standardit në shumicën dërrmuese të rasteve është e lidhur ngushtë me kohën kur fëmija nis të mësojë leximshkrimin, si një variant tjetër gjuhësor nga ai të cilin e kanë mësuar ngadalë dhe me shumë mund, por natyrshëm. Preokupimi i fëmijës me "fotografimin" e kodit vizual, të kuptuarit e tij dhe shndërrimin e atij sinjali vizual në koncept mendor e pastaj edhe transformimi në sinjale akustike të lidhura që në vete përmbajnë një koncept mendor, që është i ngjashëm, në mos i njëjtë, me konceptin mendor të shprehur në fillim përmes sinjaleve akustike, është një ngarkesë për fëmijën. Njëkohësisht me të mësuarit e një kodi tjetër gjuhësor, fëmija duhet të mësojë edhe trajta të tjera për të njëjtin koncept mendor, apo së paku formante ndajshtesore të ndryshme të të njëjtës fjalë. Prandaj gjatë prodhimit të të folurit, zgjerohet sasia e bashkaktivizimit të leksemave

gjatë përzgjedhjes leksikore[1] dhe domosdo zgjatet faza e latencës. Në këtë fazë, fëmija nuk e ka ndjenjën e realizimit të komunikimit, por përmes gjuhës ai synon të realizojë nevojat e veta, prandaj dështon të ndërtojë paradigma për përdorimin e formanteve të caktuara. Qëllimet komunikuese për të cilat fëmijët kërkojnë forma të shprehjes mund të dalin në forma primitive nga nevojat dhe mendimet. Çfarëdo që të jetë burimi i synimit të komunikimit të fëmijës, ai ose ajo duhet ta kërkojë një mënyrë të të shprehurit efektiv, qoftë në të dhënat gjuhësore, qoftë në historinë e regjistruar të interaksionit me të rriturit, (Eckerman & Stein, 1982)[2]. Mirëpo, kjo ndryshon me moshën. Tani, fëmijët e moshës katër dhe pesëvjeçare që shkojnë në kopshte, ku bëhen së paku përpjekje për të folur gjuhën standarde, ndeshen me standardin, të cilin nuk e mësojnë si nevojë, por më shumë se pjesë përbërëse të lojës dhe situatës formale. Ashtu siç fëmijët pavarësisht nga ambienti ku e mësojnë gjuhën ndërtojnë struktura krejt të veçanta që nuk i kanë dëgjuar ndonjëherë, për t'i imituar[3], ata po ashtu krijojnë ndjenjën për situatat dhe për domenet e përdorimit të gjuhës, siç do të shohim më poshtë.

Pra, në fazat parashkollore të të nxënit të gjuhës, fëmijët mësojnë t'i realizojnë konceptet mendore në aspektin akustik, ashtu siç i kanë dëgjuar nga prindërit, ndërkohë që aktivizojnë edhe mekanizmin e tyre të brendshëm gjuhësor.[4] Në këtë aspekt, të mësuarit e gjuhës në ambient ku nuk përdoret gjuha standarde paraqet një pengesë vështirë të kapërcyeshme për fëmijët, të cilët as në fazat parashkollore nuk arrijnë të ndeshen me një ambient që e aplikon përdorimin e gjuhës standarde në situata joformale. Në këtë mënyrë, te

[1] Levelt, W. J, *Spoken Word Production, A theory of lexical acces*, PNAS, 2001, vol.98, no. 23, fq. 13465.

[2] Cituar sipas (Ninio, A., & Snow, C. (1988). *Language acquisition through language use: The functional sources of children's early utterances*. In Y. Levy, I. Schlesinger, & M.D.S. Braine (Eds.), *Categories and processes in language acquisition* (pp. 11-30). Hillsdale, NJ: Erlbaum).

[3] Scovel, Thomas, *Psycholinguistics*, Oxford Introduction to Language Study, OUP, New York, 1998.

[4] Psikolinguistët thonë se fëmijët kanë një mekanizëm të brendshëm gjuhësor, përmes të të cilit ndërtojnë trajtat për fjalët që i kanë mësuar paraprakisht nga ambienti i tyre i mësimit të gjuhës. Kështu, fëmijët e mësojnë fjalën djalë nga prindërit apo nga kujdestarët e tyre, mirëpo trajtat i ndërtojnë vetë mbështetur mbi paradigma të ndërtuara vetë (Chomsky, Levelt, Field, Aitchison, Scovel, et. al.).

fëmija në mënyrë të pavetëdijshme ndërtohet botëkuptimi për domenet në formën se ekzistuakan dy gjuhë të ndryshme, njëra që flitet në shtëpi dhe në rrugë dhe tjetra që mund të jetë gjuhë e shkollës, e librave dhe e televizionit.

Rrethanë lehtësuese për mësimin e standardit është fakti se dialektet e shqipes janë të ndërkuptueshme (mutually intelligible) dhe me pak përpjekje fëmija nuk ka nevojë që ta përjetojë standardin si gjuhë të huaj, mirëpo ai duhet ta mësojë distribuimin e formanteve ndajshtesore në raportet e tyre paradigmatike. Domethënë, për të ndërtuar emra prejfoljorë ose për të ndërtuar pjesoren e foljeve, fëmija duhet të ndërtojë dy lloje paradigmash dhe është vështirë që të aplikohet automatikisht përdorimi i tyre i duhur për situata dhe domene të caktuara, aq më pak kur fëmija vështirë arrin ta kuptojë dallimin ndërmjet këtyre situatave dhe i duhen rrethana komplete për të bërë shiftingun ndërmjet domeneve dhe situatave të ndryshme. Në këtë fazë, fëmija imiton situatat (formale-joformale).

Në anë tjetër fëmija nuk gjen një ambient tjetër të përshtatshëm social për mësimin e gjuhës, sidomos në gjendjen e tashme të shoqërisë shqiptare.

Dallimi i madh i shkallës së akceptimit të gjuhës standarde në gjuhën e shkruar në njërën anë dhe në gjuhën e folur në anën tjetër, dëshmon se mungesa e komunikimit direkt është faktori kryesor që ka ndikuar për mosakceptimin e kënaqshëm të gjuhës së folur standarde në Kosovë.

Të shkruarit ka përparësi - rregullat drejtshkrimore dhe faktin se ky lloj prodhimi gjuhësor realizohet nga njerëzit e shkolluar që standardit i qasen nga pikëpamje intelektuale, shkencore e kombëtare, duke parë në të mësuarit dhe në përdorimin e standardit, zgjerim të tregut për prodhimet e tyre. Mirëpo fëmijët që janë në fazën e përballjes së tyre me standardin nuk e kanë privilegjin e nxënies përmes të të shkruarit. Gabimi që bëhet në institucionet parashkollore është se fëmijës në moshën e tij kritike tre deri katërvjeçare i servohet standardi përmes këngëve dhe vjershave ritmike. Kjo ndikon që fëmija ta përjetojë standardin jo si mjet komunikimi, por më shumë si një formë komunikimi, njëjtë si edhe këngën.

Çështja e nxënies së gjuhës është trajtuar që në fillim të shekullit të kaluar nga Lev Vigotsky, Jean Piaget, Noam Chomsky[5] e të tjerë dhe është vazhduar nga psikolinguistët edhe sot e kësaj dite[6]

Hulumtimet mbi aftësinë e fëmijëve për të ndërtuar lidhjen ndërmjet fjalëve dhe kuptimeve të tyre janë përqendruar te fëmijët e moshës dy dhe pesëvjeçare[7] dhe janë cilësuar si periudhë e magjisë së mësimit të fjalëve. Dëshmitë tregojnë se fëmijët e moshës parashkollore nganjëherë mësojnë fjalë të reja në shtëpi pasi t'i kenë dëgjuar ato një herë të vetme në shtëpi.

Nëse janë të sakta teoritë që fëmija në moshën gjashtëvjeçare e ka përsosur nxënien e gjuhës dhe është mësuar të ndërtojë koncepte të tëra, atëherë të pakta janë gjasat që fëmijët që janë rritur në ambientet ku flitet varianti i ndryshëm nga standardi gjuhësor apo nga varianti më afër standardit, të nxënë të folurit standard në nivelin e gjuhës native.

Rrethana vendimtare që ndikojnë në të nxënit e standardit janë raporti i bashkësisë folëse të dialektit të caktuar me gjuhën standarde dhe shkalla e arsimimit të ambientit në të cilin fëmija e mëson gjuhën.

Mbështetur në këtë kriter, në rastin e shqipes ndërtohen dy grupe subjektesh që nxënë gjuhën - fëmijët që e mësojnë gjuhën në ambientin që flet dialektin toskë dhe të dytët janë fëmijët që e mësojnë gjuhën në ambientin që flet dialektin gegë.

"Nuk ka qenë e vështirë të hetohet se ata që kanë lindur në mjedis që në familje flet toskërisht në shumë aspekte e kanë pasur më lehtë ta zotërojnë shqipen standarde, për aq sa ajo mbështetet në toskërishten, dhe me këtë qysh në fillim bëhen më të favorizuar në shumë segmente të jetës"[8], konstaton Rexhep Ismajli. Qoftë fëmijët toskë, qoftë ata gegë, të folurit e mësojnë në variante, qofshin ato të folme, dialekte apo ndonjë variant substandard, së paku deri në moshën, kur nis socializmi i detyrueshëm i fëmijës përmes dërgimit në çerdhe, kopshte apo institucione të tjera parashkollore, ku ekziston njëfarë përpjekjeje që fëmijëve t'u flitet në standard, edhe pse kushtet

[5] Chomsky, konsiderohet si baba i teorive nativiste.
[6] Bickerton, D. (1981). Roots of language. Ann Arbor, MI: Karoma.
[7] Carey, S.1978, *The child as word learner*. In M. Halle, J. Bresnan & G. Miller, Lingusitic theory and psychological reality, Cambridge, MA, MIT Press.
[8] Rexhep Ismajli*, Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005, f. 27.

e mësimit të gjuhës nuk janë të kënaqshme në ambiente të tilla. Fëmijët të shumtën e rasteve mësojnë të flasin në ambiente të zhurmshme, ku u duhet të shfrytëzojnë dijen paraprake që t'u ndihmojë për të interpretuar sinjalet e synuara.

Një argument tjetër që shkon në dëm të mësimit të mirë të të folurit standard është edhe leksiku i kufizuar që mësohet në këto institucione. Në një emision për fëmijë, transmetuar në RTK më 6 maj 2006, fëmijët përdornin standardin kur recitonin vjersha, apo kur tregonin përralla të mësuara në çerdhe, mirëpo, kur ata bënin të folur të zakonshëm, duke mos e pasur (si fëmijë) ndjenjën e të folurit formal, të folurit e tyre ishte krejtësisht dialektor apo ndonjë substandard që flitej eventualisht në familjet ku ata kishin mësuar të flisnin. Kjo dëshmon, përveç të tjerash edhe për rëndësinë dhe rolin e pazëvendësueshëm të familjes për mësimin e gjuhës së folur te fëmijët.

Mirëpo, çfarë ndodh kur fëmija nis të shkojë në shkollë? A mësohet standardi në shkollë, kjo është pyetje së cilës nuk mund t'i jepet përgjigje e thjeshtë me po ose jo. Fëmija e mëson në shkollë standardin e shkruar, por jo edhe standardin e folur. Duke qenë gjuha standarde kontakti i parë me një formë të kodit gjuhësor, gjuha e shkruar edhe përjetohet tani si e tillë – si gjuhë që përdoret në një domen dhe situatë të caktuar, si gjuhë e shkrimit, por jo detyrimisht edhe si gjuhë e të folurit. Këtu qëndron edhe shpjegimi për epërsinë e nxënies së standardit të shkruar në raport me standardin e folur. Domethënë, deshëm apo s'deshëm, edhe pse tingëllon paksa rëndë, fëmijët e përjetojnë standardin e shkruar si një gjuhë tjetër nga ajo që e kanë mësuar në shtëpi (flasim për ambientet ku fëmija mëson të folur dialektor, në variantin që është më larg gjuhës standarde). Në vetëdijen gjuhësore të fëmijës ngulitet fakti se gjuha e shkruar është diçka tjetër nga gjuha e folur dhe kjo pastaj e përcjell folësin tërë jetën

Vëzhgimi i të folurit të fëmijëve në shkollë, në situatë formale kanë dhënë rezultate interesante renditur në këtë kapitull. Hulumtimi është bërë përmes shpjegimit apo interpretimit të një përralle të njohur të Hans Kristian Andersenit "Rosaku i vogël i shëmtuar"[9]. Nxënësit e

[9] Versioni i tregimit të përshtatur sipas të cilit kanë shpjeguar dhe bashkëbiseduar fëmijët me mësuesen është në *Libër leximi për klasën II*, Libri shkollor, Prishtinë, 2005.

klasë së dytë, herë kanë shpjeguar drejtpërdrejt e herë përmes interaksionit me mësuesen e tyre. Në dukje të parë, e folura e këtyre fëmijëve (të cilët vetëm dy vjet janë përballur me gjuhën standarde dhe nuk kanë pasur fare ose kanë pasur tepër pak kontakt të folur me folës burimor që janë më afër me gjuhën e shkruar standarde shqipe mbi të cilën edhe mbështetet të folurit), dëshmon për rezultatet mjaft të larta të zotërimit të gjuhës standarde e në disa raste edhe të shqiptimit që mendohet më i afërt me dialektin burimor të shqipes standarde.

Le ta shohim me kujdes, tash, interaksionit ndërmjet mësueses dhe fëmijëve, kur nis të bjerë intensiteti i shkallës së zotërimit të gjuhës standarde e sidomos i përdorimit të saj:

Mësuesja: Kur erdhi pranvera?

Fëmija 1: Kur erdhi pranvera rosaku i vogël ishte ritur dhe aj shkoj, aj i hapu krahët dhe fluturoj te disa mjellma...

Mësuesja: Ku e pa veten rosaku?

Fëmija 1- Në sipërfaqen e ujit. Aj ishte bërë një mjēllm e bukur.

Përdorimi i gjuhës standarde, si i aspektit morfologjik, ashtu edhe realizimi fonologjik zbehen tërësisht dhe pothuajse dalin nga kontrolli, me gjithë përpjekjet e vërejtshme të fëmijës, në fund të interaksionit:

Mësuesja: Çka na tregon kjo përrallë?

Fëmija 1: Kjo na tregon s'bën me ngūc njãnin pĭ çysh doket nga jasht, ***çysh doket nga jasht*** *por nga brenda, çysh sjellet...*

Deri në këtë interaksion apo bashkëbisedim, pyetjet e mësueses kërkonin të nxirrnin shpjegime, të cilat i përmbante edhe vetë tregimi. Mirëpo, në këtë pjesë të fundit, mësuesja kërkoi nga fëmijët të bënin një vlerësim të cilin nuk e kanë parë në libër. Domethënë, në këtë pikë fëmija i vëzhguar nuk mund të mbështetej më në formën e përdorimit të gjuhës në libër, por iu desh që vetë të prodhonte një fjali. Ky prodhim i shkurtër gjuhësor, dëshmon një shkallë tepër të ulët të nxënies së standardit gjuhësor në të gjitha elementet e tij.

Një tjetër aspekt që dëshmon ky monitorim, ky vëzhgim, siç u përmend pak më parë, është atituta pozitive e fëmijëve përballë gjuhës standarde, që dëshmohet edhe nga përpjekjet e tyre për të realizuar ku

e ku një shqiptim, i cili për botëkuptimin e mbjellë në ta nga ambienti ku e kanë mësuar gjuhën, përbën një shqiptim të drejtë të shqipes standarde.

Pra, familja si ambient ku fëmija përballet jo vetëm me mësimin e gjuhës së parë, që edhe sipas Fergusonit[10] zakonisht është vernakulari si variant i ulët (L), por edhe me kërkesën e fëmijës për ta nxënë standardin, apo gjuhën që e flet mësuesi apo mësuesja në shkollë, mbështet pikëpamjen sipas të cilës shqiptimi i drejtë është ai që vjen nga Shqipëria, i mbështetur në shqiptimin e toskërishtes. Kjo shihet edhe nga rasti kur fëmija në vend që të thotë "i hapi krahët", thotë "i hapu krahët". Ky shembull, për këtë moshë është edhe një dëshmi për ekzistimin e një mekanizmi te fëmijët, i cili aktivizohet për të ndërtuar përmes paradigmash trajtat e duhura.

Fëmija 4, që ka moshë të njëjtë, shkon në klasë të njëjtë, jeton në të njëjtën lagje me fëmijët e tjerë, mësohet nga e njëjta mësuese, ka prindër arsimimi i të cilëve është i përafërt me të fëmijëve të tjerë të klasës, nuk bën shumë përpjekje për realizim morfologjik, por përpjekjet e tij i mbështet vetëm në shqiptim:

Kishte një mac edhe një pul edhe që aj rosaku i bën vēz, kur e ka pa që nuk ka bo vēz, e ka përzur, tani aj...

Mësuesja: Shumë bukur, domethãn e përzuni rosakun për arsye se nuk bënte?

Fëmija 4: Vēz. Edhe rosaku ka vazhdu më tutje, edhe ka notu, ka notu, ëëë, derisa...

Siç mund të shihet, fëmija as ka bërë ndonjë përpjekje që në ndonjë rast të ndërtojë pjesoren e gjuhës standarde, por në të gjitha rastet e ka realizuar atë të reduktuar, me rastin e formimit të trajtave të përbëra të kohës së shkuar: *ka mendu, ka vazhdu, e ka pa, ka notu*. Fëmija 4 gabon në të vetmin rast duke u përpjekur ta realizojë pjesoren standarde: *ka përzur* (në vend të *ka përzënë / ka përzã*).

Interesant për t'u analizuar është fëmija 8, vajzë, e cila bën përpjekje mjaft të suksesshme për shqiptim të drejtë, sidomos të fonemave që përbëjnë variabla që e dallojnë variantin e folur të vernakularit të Prishtinës nga varianti i folur i shqipes standarde.

[10] Charles Ferguson, *Word*, 1959.

Fëmija me këtë rast është treguar i shkathët duke e mësuar mësimin pothuajse përmendsh.

Mësuesja: Çfar bëri masandej rosaku?

Fëmija 8: Masand... Pastaj plaka e largoi nga shtëpia dhe rosaku, erdhi dimri dhe rosakun e mbloi akulli

Edhe pse mësuesja përdor një fjalë që nuk "tingëllon" si letrare në dukje të parë, dhe edhe pse fëmija nis ta imitojë mësuesen, duke e pasur modelin e vetëm interaktiv të gjuhës standarde (*masand...*) fëmija i kthehet trajtës së normuar *"pastaj*". Jo pse fëmija është i vetëdijshëm se mësuesja e ka përdorur një fjalë dialektore në një rast, por në vetëdijen e fëmijës për gjuhën standarde fjala "*pastaj*" është fjala që del në libra (që janë burimi i të mësuarit të trajtave standarde) dhe eventualisht fëmija ka mundur të mësohet ta zëvendësojë fjalën *masandej* që është tepër e zakonshme të vernakularin e Kosovës, i ndikuar nga një shpjegim eventual që i kanë bërë prindërit kur ka pyetur për kuptimin e fjalës *"pastaj",* që normalisht për fëmijët në Kosovë është formë e panjohur.

Ndërrimi i kodeve (switchingu) ndodh rregullisht në moshat e tilla *do të bënte/ zbëjke*

Mirëpo, pothuajse në secilin rast që përgjigja e fëmijëve kërkohej të mos ishte e mbështetur në formulat e dhëna në libër, ose humbej filli logjik i fjalisë ose bëheshin gabime në formë, siç u pa kohë më parë[11]...

Mësuesja: - Cila është porosia, mesazhi i kësaj prralle?

13. Se nuk duhet ta çmōjm njeriun nga pamja e jashtme por nga jashti e, por ka pamja e brendshme

Grupimi i dytë mbështetet në kriterin e nivelit arsimor të familjes që shërben si ambient për mësimin e gjuhës, në këtë rast të të folurit standard. Sërish duhet t'i kthehemi përqendrimit të madh të popullsisë kosovare nëpër fshatra dhe shkollimit relativisht të vonuar në Kosovë, por edhe në viset e tjera në Shqipëri, përjashtuar ndoshta Tiranën, Shkodrën dhe Korçën që kanë një traditë më të gjatë shkollimi. Në zonat rurale sigurisht se nuk mund të bëhet fjalë për nivele të larta arsimore të prindërve që rrisin fëmijë dhe që përbëjnë

[11] Gabime në të folur.

modelin e të folurit. Fëmijët, para së gjithash, e mësojnë gjuhën nga prindërit, të cilët e qortojnë apo shpërblejnë fëmijën për trajtat e drejta apo të gabueshme që përdorin. Fëmija, para së gjithash, së paku fjalët e parme i mëson nga prindërit, ndërkohë që imiton tërësisht kodin fonologjik që përdorin prindërit gjatë realizimit të të folurit. Prindërit që nuk e nxënë në nivel të kënaqshëm standardin e folur, apo nuk e përdorin për arsye të ndryshme, pastaj familjet ende të mëdha në fshatra, ku fëmijëve nuk u kushtohet kujdesi i duhur i përcjelljes së zhvillimit të tyre gjuhësor, bëjnë që fëmijët në fazat më të rëndësishme të formimit të tyre gjuhësor, të mos përballen pothuajse fare me të folurit standard, të cilin eventualisht e dëgjojnë në televizor dhe e përjetojnë si gjuhë të huaj apo si një formë e të folurit që përdoret në televizion dhe në vjershat që eventualisht mund t'u mësohen nga prindërit. Pjesa tjetër, përrallat, formulat dhe njësitë frazeologjike, fëmijëve në fshatra u mësohen në të folur dialektor, apo në ndonjë variant më të ulët në kuptim të formacionit gjuhësor. Kështu, fëmija përballet për herë të parë me të folurit standard në moshën gjashtë apo shtatëvjeçare, kur tashmë e ka përmbyllur fazën më të rëndësishme të të nxënit të gjuhës. Psikolinguistët thonë se gjuhë native (native language) mund të konsiderohet secila gjuhë që fëmija e mëson deri në moshën gjashtëvjeçare, ndërsa gjithçka tjetër është gjuhë e huaj (second language, third language...). Nisur nga kjo, dhimbshëm duhet të konstatojmë se ndeshjen, njohjen me standardin, fëmija sidomos në fshatra e përjeton si mësim të një gjuhe të dytë, pasi duhet të kalojë rishtas nëpër të gjitha proceset psikolinguistike të realizimit gjuhësor, përfshirë prodhimin (morfologjinë, fonetikën dhe leksikun) dhe të kuptuarit, me ç'rast vështirë se ato arrijnë të akceptohen deri në masën e realizimit të komunikimit intim, emocional. Kjo mungesë i përcjell folësit e dialektit më të largët nga gjuha standarde deri në fundin e jetës së tyre, nëse ata nuk do të kalojnë kohë të gjatë në kontakt me folësit e gjuhës standarde në nivele të larta arsimore, apo së paku nëse nuk janë në kontakt me folës që janë më afër burimit[12] të dialektit më të afërt me gjuhën standarde.

Kështu akceptimi i pamjaftueshëm dhe i pakujdesshëm i gjuhës standarde nga fëmijët lë pasoja të cilat fillimisht manifestohen me gabime në formantet ndajshtesore, ndërsa në faza të mëvonshme

[12] Shih më gjerësisht Rexhep Ismajli, 2005, Janet Byron 1979.

manifestohen përmes inferioritet gjuhësor, që evoluon jo më në gabime të të folurit, apo latenca të zgjatura si pasojë e sasisë së morfemave të bashkaktivizuara, por në çrregullime psikologjike të të folurit dhe të gjuhës që manifestohen përmes afazisë, apraksisë, disleksisë e çrregullimesh të tjera.

Nëse pas 35 vjetësh ky standard nuk e ka arritur shtrirjen e duhur, për këtë nuk mund të fajësohet vetëm sistemi arsimor, meqë problemet e tilla lidhur me të nxënit e standardit nuk janë shfaqur në Kosovën e cila ka sistem të ndarë arsimi nga ai Shqipërisë, por edhe në zonat gegëfolëse të Shqipërisë ku ka një sistem unik të arsimit. Zotërimi ose jo i standardit, prandaj, nuk ka të bëjë krejtësisht me arsimin, por më shumë me vetë standardin. Shqyrtimi i standardit, duke marrë parasysh parametrat psikologjike dhe sociologjike të gjuhës është një detyrë emergjente e gjuhësisë si pjesë e filologjisë.

Hava QYQALLA

FORMAT FOLJORE PERIFRASTIKE TË SHQIPES NË VEPRËN E PJETËR BOGDANIT

Shqipja me një sistem foljor sintetik të trashëguar nga indoeurpianishtja evoluoi në sistem të përzier sintetiko-analitik të krijuar brenda zhvillimit historik të saj. Pra, shqipja gjatë zhvillimit të saj, nga një ndërtim sintaksor i lirë,përmes gramatikalizimit apo morfologjizimit, krijoi ndërtime perifrastike a analitike foljore me veçori semantike e funksionale të veçanta. Këto ndërtime në shqipen e sotme, për nga struktura janë të përbëra nga elemente, njëra me kuptim të zbehur leksikor por me funksion të theksuar gramatikor, kurse tjetra me funksion të zbehur gramatikor, por me kuptim të theksuar leksikor. Në strukturën e formave perifrastike funksionin e elementit me kuptim të zbehur leksikor e kanë:

- Foljet ndihmëse **kam** dhe **jam**
- foljet gjysmëndihmëse me vlerë modale **mund** dhe **duhet**
- pjesëza **do** me origjinë nga folja dua
- foljet që shprehin mënyrën e veprimit (filloj, nis, mbaroj, pushoj)
- pjesëza aktualizuese **po** etj.

Folja ndihmëse **kam** në relacione heterosintagmatike me pjesoren pasive të së kryerës, të cilat relacione trajtohen në mënyrë shterruese jo vetëm me pjesoren, por edhe me elemente të tjera, në librin e akademik Besim Bokshit, pjesorja e shqipes në vështrim diakronik, Prishtinë, 1998, formon ndërtime analitike a perifrasike me vlerë të së kryerës veprore.

Kurse në raporte me paskajoren e të dy tipave, asaj gege **me bam** dhe të shqipes standarde **për të bërë** si dhe me lidhoren, formon ndërtim perifrastik me vlerë të së ardhmes fillimisht me modalitet detyrimi a domosdoshmërie.

Folja ndihmëse **jam** në raporte me pjesoren pasive të së kryerës formon formë perifrastike me vlerë të së kryerës joveprore, kurse duke u gramatikalizuar me formën e pashtjelluar të përcjellores formon ndërtim perifrastik foljor me vlerë të vazhdimësisë së veprimit në të tashmen (**jam duke punuar**), të pakryerën (**isha duke punuar**) në aorist (**qeshë duke punuar**).

Foljet gjysmëndihmëse me vlerë modale **mund** dhe **duhet**, siç vërtetohet në gramatikat e shqipes, krijojnë ndërtime të cilat nga ana sintaksore përbëjnë njësi të vetme kallëzuesore,[1] kurse nga ana morfologjike nuk emërtohen ende ndërtime perifrastike, por ndërtimi me to dhe format e pashtjelluara të pjesores e paskajores si dhe të lidhores shpreh kuptime modale të mundshme ose të lejueshme, të detyrueshme a të domosdoshme.[2] Vlera dhe përdorimi i tyre është trajtuar gjerësisht në punimin e S. Mansakut.[3]

Pjesëza **do** me origjinë nga folja dua në ndërtime me lidhoren do të punoj formon kohën e ardhme me modalitet dikur dëshire, për t'u përvetësuar sot në një formë të së ardhmes së mirëfilltë të të dy dialekteve.

Me folje që shprehin mënyrën e veprimit formohen togfjalësha të ngurosur për të shprehur fillimin, vazhdimin, rritjen progresive të veprimit si dhe mbarimin e veprimit të emërtuar nga folja ndjekëse.[4]

Pjesëza **po** përdoret para foljeve në të tashmen dhe të pakryerën e dëftores dhe të habitores për të formuar ndërtim perifrastik me vlerë të aktualizimit të veprimit

Në këtë kumtesë do të trajtohen format perifrastike të gramatikalizuara me pjesëzën aktualizuese po dhe ndërtimet foljore me ndihmësen kam të gramatikalizuara me paskajoren në veprën e P. Bogdanit.

Pjesëza **po** është proklitike dhe nuk mund të ndahet nga folja ndjekëse me asnjë element, përveç trajtave të shkurtra të përemrave, dhe pjesëza mohuese vendoset para pjesëzës po.

---

[1] Gramatika e gjuhës shqipe 1, f. 261.
[2] Gramatika e gjuhës shqipe I, f. 265.
[3] Seit Mansaku, Ndërtimet me foljet modale ***mund*** dhe ***duhet***, te Gj. Buzuku, Studime filologjike, 1979/3.
[4] Gramatika e gjuhës shqipe I, fq. 265.

Të tashmen dhe të pakryerën e dëftores me pjesëzën aktualizuese **po** i gjejmë të përdorura në veprën e Bogdanit me po ato funksione me të cilat përdoren edhe në shqipen e sotme. Si u tha më lart kjo formë kryen veprim të individualizuar, të caktuar i cili shihet në këta shembuj nxjerrë nga vepra e Bogdanit;

Ja kingji i Hyjit, ja aj qi **po hjek** mpkatet e shekullit. (pjesa II, fq.43)

Aj qi anshtë dërguem anshtë aj qi **po flet**, e se anshtë Zotynë se ndë çast flet. (pjesa I, fq.15)

Në shembujt e poshtëshënuar forma perifrastike me pjesëzën **po** shpreh veprim të aktualizuar, i cili bashkohet dhe me ndajfoljen tash;

Ndë këto mote anshtë paam nji njeri fort i vertytshëm e i mirë, i silli tashti **po gjelli** ndër nee. (pjesa II, fq.36)

Tash **po lëshon** shërbëtuerrë tand o Zot, posi fjala jote ndë paaq. (pjesa II, fq.29.)

Forma perifrastike me pjesëzën **po** gramatikalizuar me të tashmen e dëftores përdoret edhe me funksion të se ardhmes;

Ja **po vinjënë** ditt' e vjett (thotë Zotynë) dhe **po dërgonj** nji të madhe u përmbi dheet; jo un e bukësë as etn e ujit po të fjalësë Tinezot, e kanë me u lëkundunë prej nji deti mbë tjetrit….. (parathënja)

Këtu, pra forma **po vinjënë** dhe **po dërgonj** shpreh një veprim i cili ka nisur një kohë përpara, vazhdon në çastin e ligjërimit dhe zgjat edhe në të ardhmen.

Pjesëza aktualizuese **po** përdoret edhe me të pakryerën e dëftores dhe të habitores të cilat i kemi gjetur edhe te Bogdani;

Zu fill mej kallëzuem, qish **po vepronte** Zotynë ndë tan… (pjesa I, fq.13)

Diogjeni Cinik thej peharë qi bajtëke me mengitunë hetn tue paam se nji njeri **po pij** me grushta… (pjesa II, fq.31)

Sokrati ndë nji Panagjyr tue paam se njerëzit **po bajtëkëshinë** kual,

Armë…qoj duert prej Qiellshit tue thanë falemi Tinëzot. (pjesa II, fq.31)

Folja ndihmëse kam e gramatikalizuar me paskajoren formon ndërtim perifrastik me modalitet të detyrimit të ardhshëm: kam me punu dhe kam për të punuar në gegërishte dhe në mbarë shqipen, dhe kam të punoj tek arbëreshët e Italisë. Kjo formë në veprat e letërsisë së vjetër përdoret me vlerë të së ardhmes me një përdorim të gjerë që nga Buzuku gjer tek Bogdani. Dhe siç ka vërejtur S. Mansaku,[5] te Buzuku, përveç së tashmes së lidhores, e ndonjë rast edhe të dëftores, forma kam me bam është e vetmja formë që shpreh veprim në të ardhmen. Kurse në veprën e Bogdanit, përveç formës kam ma bam përdoret edhe forma kam për të bam, e cila siç është konstatuar në, Morfologjinë historike të shqipes, pjesa I dhe II, fq.286, përdorimin e parë të saj e ka në veprën e Bogdanit. Por, krahasuar me formën kam me bam, kjo ka një përdorim shumë më të ngushtë, dhe sipas statistikave që kemi nxjerrë në këtë vepër e ardhmja e tipit kam me bam përdoret rreth 85%, kurse e ardhmja e tipit kam për të bam rreth 10%, sepse siç do të shihet nga disa shembuj nxjerrë nga vepra e Bogdanit, kjo formë përdoret më tepër me modalitet të detyrimit (domosdosë), siç shpjegohet tek akad. B. Bokshi.[6]

Folja ndihmëse kam përdoret me paskajoren për të punuar në funksion kallëzuesor, funksion që "është përftuar nga funksioni i saj përcaktor i cili realizonte kuptimin e qëllimit" dhe gjithnjë sipas Bokshit "nga funksioni qëllimor i të dy formave të pashtjelluara pas foljeve ndihmëse janë krijuar format përkatëse analitike të futurit".

Por siç shihet edhe te Bogdani forma kam për të bam e ruan më tepër modalitetin e qëllimit (detyrimit), të cilën e ilustrojmë përmes këtyre shembujve;

A ti jee qi **ke për t'ardhunë** a të presmë tjetër? (pjesa II, fq.48)

E mbasi të jenë mbushunë, **kam për të kthyem** ke aj qi më ka dërguem. (pjesa II, fq.50-51)

Pra në këta shembuj e në të tjerë që kemi hasur te Bogdani, shprehet më shumë funksioni i qëllimit me modalitet domosdoshmërie a detyrimi dhe mund të ndërkëmbehen me ndërtim me foljen modale duhet; A ti je ai i cili duhet të vish a të presim tjetër?

[5] Seit Mansaku, Ndërtime me foljen ndihmëse kam + paskajore tek autorët e vjetër, Studime filologjike, 1980/2, fq. 139.

[6] Besim Bokshi, Pjesorja e shqipes, Vështrim diakronik, Prishtinë 1998, fq. 165-166.

Forma perifrastike përveç me foljen **kam** në kohën e tashme + paskajore, krijohen edhe me të pakryerën **kisha** + paskajore. Kjo formë ka vlerën e së ardhmes së të shkuarës dhe në konteste të caktuara të mënyrës kushtore.

Edhe kjo formë me këto funksione është vërtetuar, se është konsoliduar qartë në veprën e Bogdanit siç shihet përmes këtyre shembujve;

…urdhënoj Engjelli Joakinit qi të dahej asi vendi e të vej ndë kishë të Jeruzalemit, se aty kish me gjetun Anënë shoqen e vet… (pjesa II, fq.4)

…**e lume kjeshë me kjanë** kur të munë shërbenje si nja ma e vogëla shërbëtore, lum ajo vajzë, së sillësë kanë me i thanë Ama e Tinëzot… (pjesa II, fq.12)

Ajo grue tue ndiem Jezu Krishtin po vej ndë shtëpi të t'parit Sinagoesë tha ndër vetëhe; Të mundinjë me prekunë skanjn' e skundimit të Shelbuesit tim **keshe me u shëndoshunë**, e me këta shpresë duel me u pjekunë me Jezu Krishtin… (pjesa II, fq.56)

Folja kam në forma perifrastike me paskajoren tek Bogdani është përdorur edhe në aorist;

…nukë **pat me pasunë** nevojë petëkash e dveshunë nukë **pat me pasunë mbarre**. **Pat me kjanë** zanë ndë bark të s'amësë pa dhunë e të lemitë tinaj kish me kjanë pa ndonji të dhimtunë. (pjesa I, fq.45)

Pra, siç vërehet nga shembujt e nxjerrë nga vepra e Bogdanit, format e së ardhmes kryesisht shprehen me kam të gramatikalizuar me paskajoren e të dy tipave, nuk është hasur askund forma me kam +lidhore, kurse me numër të kufizuar është përdorur futuri me pjesëzën do gramatikalizuar me lidhoren.

Në të dy pjesët e veprës së Bogdanit kam gjetur gjithsej 5 forma perifrastike me këtë formë, nga të cilat 4 dalin me funksion të së ardhmes së tashme;

Kush **do të pie** kësi uji përsëri ka me i ardhunë et,… (pjesa I, fq.58)

E kuj **do të lanë** bëgatit e vet, kish për ti dhanë njiqind për nja;… (pjesa II, fq.83)

Ty kam me të dhanë dryenat e regjenisë qiellet; qish **do të lidhish** përmbi dhet, ka me kjanë lidhunë ende mbë qiellt,… (pjesa II, fq.72)

Ashtu ende nukë **do të hahetë** ziem? (pjesa I, fq.57)

Kurse një formë e tillë është përdorur në funksion të së ardhmes së përparme të së shkuarës e cila shpreh një veprim të mundshëm të së shkuarës.[7]

Herodoti me të madh kujdes… thirri… të tre regjenijtë,e mbasi muer bukurë fjalë tue u porositunë atyne qi kthejin atypari tue i kallëzuem ku **do të kishinë gjetunë** atë regj të ri… (pjesa I, fq.28)

Tek Bogdani kemi hasur edhe formën **do + paskajore me punue**, në të cilën shihet qartë modaliteti i dëshirës, ku vërehet se folja **do** nuk është çsemantizuar dhe ruan modalitetin e dëshirës me ç'rast vërtetohen mendimet e Bokshit[8] se këtu folja do nuk është gjysmëndihmëse modale, por është në njërin nga kuptimet e saj primare, duke mbajtur paskajoren në funksion të fjalive të varura kundrinore:

Tue kjanë Jezu Krishti kështu afërë mortsë **do me baam** fjalë… (pjesa II, fq.120)

…nukë **do me idhnuem** ma fort se ish,… (pjesa II, fq. 120)

…e aty **doj me ngranë** kijnë… (pjesa II, fq.92)

Dhe kjo folje duke qenë pikërisht me këtë kuptim është shndërruar në pjesëz të formës së futurit do të punoj, në formë të ngurosur të vetës III sipas M.Domit, E.Çabejt, I.Ajetit, apo të vetës II sipas Sh.Demirajt.[9]

Duke hulumtuar kronologjinë dhe gjenezën e formave perifrastike të së ardhmes së të dy tipave është konstatuar se të dy tipat, **ai kam +** paskajore dhe **ai do +** lidhore, mbështetur në të dhënat e shqipes së shkruar, janë të një moshe të vjetër. Forma **me kam** ndeshet me të madhe në veprat e para të shkruara që nga Buzuku, por edhe forma **me do** është vërtetuar se përdorej edhe në të folmet veriore, dëshmi e së cilit është Fjalori i Arnold Von Harfit ku është

[7] Gramatika e gjuhës shqipe I, fq. 318.
[8] Besim Bokshi, Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik), fq. 165-166.
[9] Shaban Demiraj, Gramatika historike e shqipes, Prishtinë 1988, fq. 830-31.

hasur forma **do ta ble** në funksion të së ardhmes. Prandaj, do të jetë një çështje e vështirë për të menduar për vjetërsinë më të madhe të njërës apo tjetrës formë, sipas të dhënave të një gjendjeje të mëhershme dhe nga përdorimi i saj sot.

Kurse sa i përket gjenezës së këtyre formave, edhe pse pranohet mendimi se nga pikëpamja tipologjike janë të krahasueshme me format e tipit roman sipas modelit latin **paskajore + kam**, forma e shqipes **kam + paskajore,** dhe me greqishten forma **do + lidhore**, për ç`arsye disa studiues të huaj si G. Vaigand dhe K. Santfeld kanë pranuar një ndikim nga këto gjuhë.

Këto mendime me të drejtë janë kundërshtuar nga studiues vendës si M. Domi, J. Gjinari, I. Ajeti, Sh. Demiraj, B. Bokshi, S. Mansaku, të cilët pohojnë se të dy tipat janë përftuar në mënyrë të pavarur gjatë zhvillimit historik të shqipes nga togfjalësha dikur të lirë **kam + paskajore** me ngjyresë modale të detyrimit (futurum necessitatis) dhe **dua + lidhore** me ngjyresë modale të dëshirës (futurum voluntatis).

Këto ngjyresa janë ruajtur deri vonë në shqipen, por me kalimin e kohës këto u bënë të vetmet forma për të shprehur veprim në të ardhmen me distribucion të ndryshëm nëpër të folme të shqipes. Forma **do + lidhore** në të folmet jugore, por edhe në ato gege, kurse forma **kam+ paskajore** e gegërishtes në të folmet veriore.

Mirëpo me gjithë desemantizimin e foljeve **dua dhe kam**, në konteste të caktuara të dy format e krijuara në një masë ruajnë ende ngjyrimin modal të dëshirës dhe të detyrimit. Këto ngjyresa duken qartë në frazën e S.Rizës[10] marrë nga amvisja gjakovare "Dje kishna me gatu, po s'gatova. Edhe sod kam me gatu, po s'po gatuj se po pritoj".

Këtu forma e parë shpreh detyrim, kurse e dyta shërben si e ardhme, por jo pa nuancë dëshire.

[10] Selman Riza, Tri monografina albanologjike, Vepra I, Prishtinë 1996, fq. 128.

Bardh RUGOVA

DIZAJNI I AUDIENCËS

Në një hulumtim të gjuhës së gazetave, të bërë dy vjet më parë kemi mundur të vërenim se ndonjëherë gjuha e përdorur në gazetat e Kosovës dhe të Shqipërisë, kryesisht e viteve tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë, po edhe më përpara, ka më shumë tipare karakteristike të gjuhës së përrallave, se sa të asaj që në botë njihet si gazetari e re, themelues i së cilës konsiderohet shkrimtari Normal Mailer që ndërroi jetë para disa ditësh (më 9 nëntor).

Hulumtimi tregon se si elemente të tilla gjuhësore, siç është njësia e këndvështrimit si njësi përbërëse e tekstit - si qëndrim fizik ose mendor, nga i cili dërguesi ia bart mesazhin marrësit në një proces komunikimi dhe ndaj të cilit ai i lidh të gjitha referimet e veprimit – nuk ndryshojnë shumë as në përzgjedhjen mes një shkrimi objektiv dhe subjektiv.

Veta, kohët e foljeve, mënyra janë disa nga kategoritë, të cilat, sipas hulumtimit, shpeshherë përputhen në gjuhën e gazetave dhe të përrallave.

Një ndër arsyet mund t'i gjejmë në përpjekjet e viteve shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë për "afrim sa më të madh me gjuhën popullore" (Kostallari 1989:30).

"Është e domosdoshme të bëhen kërkime e studime të thelluara, në radhë të parë, në sintaksën popullore të shqipes", shkruante Androklli Kostallari. "Bie në sy (gjithashtu), përmirësimi i gjuhës së shtypit tonë nga një vit në tjetrin, afrimi i saj me gjuhën popullore, demokratizimi i ndërthurur edhe me intelektualizmin e saj, në kuptimin e ngritjes së përgjithshme gjuhësore... Sot del nevoja që në të gjitha mjetet e informimit të përmirësohet më tej zbatimi i normës së drejtshkrimit, të thellohet puna për fjalën shqipe e për ndërtimet shqipe, të mënjanohen tërësisht frazat stereotipe, me shumë fjalë e me pak mendime dhe në përgjithësi, të ketë një gjuhë më të thukët e më të përpiktë, e cila të mishërojë më mirë njësinë e formës me përmbajtjen në rubrikat e në emisionet e ndryshme" (Kostallari 1989:31).

Këto mendime të Kostallarit mund ta zbulojnë edhe thelbin e problemit të hulumtimit të para dy vjetëve.

Në të vërtetë, një vështrim i zakonshëm i komunikimeve të njeriut do të mjaftonte për të vërejtur se njerëzit shpeshherë ia përshtatin të folurit e tyre dëgjuesve të ndryshëm. Joshua Fishman e ka trajtuar këtë si dukuri më vete gjatë trajtimit të marrëdhënieve të mikro dhe makrosociolinguistikës në studimin kush flet çfarë gjuhe, me kë dhe kur të vitit 1971. ("The Relationaship between Micro- and Macro-Sociolinguistics in the Study of Who Speeks What Language to Whom and When", në Sociolinguisics, Penguin Books, Middlesex, England, 1971).

Në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë Howard Giles dhe kolegë të tij kanë nxjerrë një koncept të quajtur teori e akomodimit, që është në thelb një teori sociolinguistike. Akomodimi shqyrton përpjekjet e dërguesit që të përafrohet sa më shumë me marrësin, në mënyrë që ta lehtësojë komunikimin.

Mirëpo, për ta trajtuar më tutje këtë fenomen, Allan Bell (Bell, 1984), ka propozuar idenë e quajtur dizajni i audiencës, duke hulumtuar se si dërguesit ia përshtatin gjuhën e tyre audiencës për të shprehur qoftë afërsi, qoftë distancë me të, meqë strategjitë e komunikimit ndonjëherë nuk janë vetëm reagime ndaj marrësit, por mund të jenë edhe iniciativë për ta përcaktuar marrëdhënien me audiencën.

Sipas Bellit, ndryshimi i stilit është një variant brenda ligjërimit të një individi që e flet një gjuhë të caktuar. Variantet e tilla, sipas studimeve të ndryshme, kanë përfshirë shumë nivele gjuhësore, duke përfshirë ndryshimin nga një gjuhë në një gjuhë tjetër në situata bilinguale, zgjedhjen e përdorimit të shumësit gjatë adresimit për të shprehur respekt, strategjitë e ndryshme të mirësjelljes e deri te ndryshimet sasiore të stilit.

Punim fundamental në studimet e sociolinguistikës që studion ndryshimin e stilit është vepra pioniere e Uiliam Labovit, (The Social Stratification of English in Neë York City, Center for Applied Linguistics, Washington, 1966, njëzet e sa vjet para punimit të Kostallarit). Që atëherë në gjuhësi ka nisur të vërehet ndryshimi ndërmjet ndërfolësit dhe brendafolësit. Me termin ndërfolës Labovi

përfshinte dimensionin shoqëror, sfondin shoqëror të folësit (mosha, gjinia, klasa shoqërore), ndërsa brendafolësi përfshin atë që Bell do ta quante dizajn i audiencës – pra, gjuha e dërguesit ndikohet nga marrësi.

Bell kujton se thelbi i stilit është që folësit e kanë parasysh audiencën e tyre (Bell 1991:105) dhe kjo manifestohet nëpërmjet ndryshimit të stilit të një dërguesi, për të qenë më afër (ose më larg) me marrësin.

Në këtë kumtesë jemi të interesuar t'i trajtojmë mënyrat se si dërguesi reagon ndaj audiencës së tij në gazetat kosovare.

Për këtë kumtesë kemi zgjedhur të trajtojmë mënyrën se si stili i përshtatet audiencës vetëm nëpërmjet një ndryshoreje.

Hulumtimi trajton përdorimin e mbiemrave në disa gazeta kosovare.

Vlerësimi dhe cilësimi janë dy koncepte të diskutueshme në gjuhën e gazetave, sidomos në raportet me lajm, ku mëtohet objektivitet. Raporti me lajm i takon tipit narrativ të teksteve. Si gjini klasifikohet në shkrimet objektive.

Teoria propozon që si parim i të shkruarit në një raport me lajm të jetë përdorimi i kufizuar dhe me kursim i ndajfoljeve dhe i mbiemrave (Whitaker 2004:101).

Mbiemrat dhe ndajfoljet shërbejnë për të sqaruar, por edhe për të kualifikuar dhe, së këndejmi, janë edhe mjete që do të mund të shërbenin për vlerësim dhe cilësim, të dyja këto koncepte subjektive që nuk do të përshtateshin me natyrën e raportit me lajm.

Hulumtimi përfshin vetëm pjesën informative të gazetës.

Në gramatikën e gjuhës shqipe (Gramatika I 1995:155) klasifikimi i mbiemrave sipas kuptimit të tyre leksikor është ndarë në mbiemra cilësorë dhe ata marrëdhëniorë. Mbiemrat cilësorë, më tutje mund të jenë mbiemra që shprehin tipar të drejtpërdrejtë dhe mbiemra që shprehin tipar të përfytyrueshëm.

Mirëpo, në gramatikën e shqipes, brenda mbiemrave cilësorë nuk është marrë parasysh fare qëndrimi i dërguesit. Duke e marrë parasysh qëndrimin e folësit, mbiemrat cilësorë do të mund të ndaheshin në mbiemra që, thjesht, e përcaktojnë një tipar dhe, në

mbiemra që shprehin qëndrim. Së këndejmi, te shembulli *djali* ***i verbër***, mund të jetë mbiemër cilësor që jep tipar, në rast se flitet për një djalë që nuk sheh, por te rasti *arbitër* ***i verbër*** mund të shprehet një qëndrim, në rast se flitet për një arbitër, i cili, sipas mendimit tonë, nuk ka dashur ta shohë një dukuri të caktuar.

Prandaj, në këtë hulumtim do të trajtohet përdorimi i mbiemrave të tillë që shprehin qëndrim të dërguesit. Mbiemrat e tillë, të quajtur në terminologjinë angleze si cilësorë ekspresivë, janë semantikisht joresktriktivë (Huddleston 2002:558).

Mbiemrat cilësorë janë pjesë e sintagmave emërore.

(Në këtë kuadër hyjnë edhe disa mbiemra në dukje të parë marrëdhëniorë, por që, në të vërtetë, për shkak të qëndrimit të folësit, japin një qëndrim dhe kalojnë në cilësorë p.sh. skuadër kombëtare (marrëdhënie) dhe veprimtari kombëtare (qëndrim i folësit si cilësim).

Korpusi për këtë studim e kemi kufizuar me një mostër të rastësishme të dy gazetave kosovare ("Zëri' dhe "Bota sot" gjatë periudhës shkurt, mars, prill 2006).

Të dhënat kanë treguar se në një faqe gazete në Kosovë mesatarisht përdoren 24 mbiemra dhe 29 ndajfolje.

Megjithatë, jo të në të gjitha rastet bëhet kujdes që këta mbiemra të mos diskreditojnë objektivitetin e dërguesit ndaj marrësit në një raport me lajm.

Sipas vëzhguesve ndërkombëtarë, shprehur në Doracakun e mediumeve të Evropës Juglindore 'Zëri' konsiderohet në mesin e gazetave cilësore të Kosovës (South East Europe Media Handbook 2003/2004 2004:197).

"Bota sot", titullit ia shton edhe mbiemrin "kombëtare" dhe, në kohën e hulumtimit, mbante një politikë editoriale, me të cilën, haptazi i drejtohej një grupi të caktuar politik. Si e tilla, kjo gazetë e synon një audiencë të caktuar të veten, "kombëtare" dhe të orientuar drejt lexuesit që i përket një grupi të caktuar politik.

Mediumet zakonisht nuk kanë një lexues tipik (Mallet 1999:38). Megjithatë, dallimet e përmbajtjes, të stileve vizuale rëndom pasqyrohen edhe në gjuhën e mediumeve.

Hulumtimi ka treguar rezultate të dukshme. Gazeta "Zëri" ka numër shumë më të vogël të mbiemrave cilësorë që shfaqin qëndrim, ndërsa "Bota sot" ka numër më të madh të mbiemrave përgjithësisht dhe posaçërisht të mbiemrave që shfaqin qëndrim në raporte me lajm.

Secila nga gazetat ka mesatarisht nga 1400 fjalë në një faqe, që të dyja janë të formatit të njëjtë të shtypit.

Sipas hulumtimit gazeta "Zëri" përdor brenda një faqeje 24 mbiemra, prej të cilëve 3 mund të konsiderohet cilësorë që shprehin qëndrim.

"Bota sot" përdor 62 mbiemra, prej të cilëve 22 shprehin qëndrim: përmasa serioze, burim i sigurt, forma brutale, proces jonjerëzor, dashuri e zjarrtë, preventivë e fortë, aborte të shumta.

Konceptet e stilit kërkojnë që në një raport me lajm, të përshkruhet e të mos tregohet.

Kjo nuk është, thjesht, një ndarje në dy grupe të gazetave, por dëshmon se gazetat qenkan të grupuara në bazë të profileve të lexuesve të tyre.

Lexueshmëria e gazetave dhe e profilit të lexuesve zakonisht është e qëndrueshme, për çfarë dëshmojnë edhe hulumtimet dhe anketat që bëhen nga disa herë në vjet në Kosovë. Gazetat mëtojnë të përshtaten në kategoritë ekzistuese dhe mbajnë profile të ngjashme të lexuesve.

Hulumtimi i parashtruar tregon se përdorimi ose jo i cilësorëve me qëndrim si ndryshore gjuhësore, e diagnostifikon shtresimin shoqëror të audiencës së gazetave.

Ndryshoret e tjera mund të japin rezultate të ngjashme.

Kështu, mediumet e ndryshme arrijnë stile të ndryshme. Këto ndryshime stili që i përshkruam këtu ekzistojnë kudo. Dallimet mes "Zërit" e "Botës sot" e pasqyrojnë gjendjen në Kosovë dhe për të njëjtën arsye edhe dallimet e audiencës që mund të shfaqen aty.

Bibliografia:

Fishman J. (1971), The Relationship between Micro- and Macro-Sociolinguistics in the Study of Who Speaks What Language to Whom and When, në Sociolinguistics, Pinguin Books, Middlesex, England.

Bell A. (1984), Language Style as Audience Design, Language in Society 13/2:145 – 204.

Bell A. (1991), The Language of News Media, Blackwell, Oxford.

Labov W. (1966), The Social Stratification of English in New York City, Washington, DC: Center for Applied Linguistics.

Gramatika e Gjuhës Shqipe I (1995), Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

Mallet M. (red.) (1999), Manual për gazetarët e Europës Qendrore dhe Lindore, Dituria, Tiranë.

Whitaker W. (2004), Mediwritting: Print, Broadcast and Public Relation, Laërence Erblaum Associates Inc., Mahëah NJ USA.

Huddleston R. dhe Pullum G. (2002), The Cambridge Grammar of the English Language, Cambridge University Press.

- Kostallari A. (1989), Gjuha letrare shqipe dhe epoka jonë, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë.

Shaban DEMIRAJ

VLERA E SHUMANSHME E DEFTERËVE OSMANË TË REGJISTRIMIT TË POPULLSISË

Mungesa e burimeve të shkruara për periudhat e lashtësisë dhe të mesjetës së hershme të historisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe është plotësuar në njëfarë mase me të dhënat e zbulimeve arkeologjike, me të dhënat e autorëve të vjetër grekë e romakë, si edhe me ato që nxirren nga shqyrtimi diakronik i huazimeve të shqipes nga greqishtja e vjetër dhe e mesme, nga latinishtja dhe nga gjuhët sllave të Ballkanit. Por një burim tjetër i rëndësishëm për periudhën e mesjetës janë defterët osmanë të regjistrimit të popullsisë së trevave shqiptare. Siç dihet, administrata osmane pas pushtimit të trevave shqiptare si edhe të vendeve të ndryshme të Ballkanit për qëllimet e saj lidhur me vjeljen e taksave nga popujt e pushtuar ka organizuar herë pas here edhe regjistrimin e popullsisë së vendeve të pushtuara dhe fatmirësisht defterët e këtyre regjistrimeve janë ruajtur në Arkivat e Stambollit. Por ky burim i rëndësishëm informacioni nuk është shfrytëzuar sa duhet nga studiuesit shqiptarë dhe vetëm gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit vihet re një interesim deri-diku i kënaqshëm sidomos nga disa historianë dhe aty-këtu edhe nga ndonjë gjuhëtar. Dhe pikërisht dëshira për të tërhequr vëmendjen e autoriteteve shkencore shqiptare në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni me synimin që t´i kushtojnë më shumë rëndësi kësaj çështjeje, më nxiti të përgatis këtë kumtesë mbi vlerën e atyre defterëve. Përmasat e një kumtese të shkurtër nuk të lejojnë të ndalesh gjerë e gjatë mbi vlerat e shumanshme të defterëve osmanë, duke përfshirë edhe treguesit ekonomikë e fetarë, si edhe treguesit e evolucionit të popullsisë gjatë shekujve, ashtu siç pasqyrohen në ata defterë, të krahasuar me gjendjen e sotme. Prandaj do të ndalem shkurt vetëm në heshtjen e përkatësisë etnike të banorëve të disa zonave periferike të Jugut, në kohën e pushtimit të tyre nga turqit, për të parë se si ka ndryshuar gjendja e tyre etnike me përhapjen e vazhdueshme të greqishtes gjatë periudhës së sundimit osman. Do të ishte mirë që një punë e tillë të bëhej edhe për zonat e tjera dikur shqipfolëse, ku gjatë shekujve është

vërtetuar një dukuri e ngjashme me zëvendësimin e shqipes nga gjuhët sllave.

Siç dihet, autoritetet osmane gjatë regjistrimit të popullsisë në vendet e pushtuara shënonin në defterët e tyre emrat e vendbanimeve (qytete, fshatra, lagje etj,) si edhe emrat e kryefamiljarëve, që do të paguanin detyrimet ndaj shtetit kryesisht me prodhime bujqësore e blegtorale, apo edhe me të holla. Nga emrat e kryefamiljarëve të një fshati, lagjeje a qyteti nuk është vështirë të kuptohet edhe përkatësia etnike e fetare e pjesëtarëve të familjeve të tyre dhe nga detyrimet ndaj shtetit kuptohet edhe gjendja e tyre ekonomike e shoqërore. Me shumë interes do të ishte të shqyrtohej edhe toponimia e viseve të ndryshme sot shqipfolëse, ashtu si pasqyrohen sidomos në defterët osmanë më të vjetër. Por në këtë kumtesë të shkurtër, siç e përmenda pak më sipër, unë do të ndalem vetëm në çështjen e përkatësisë etnike të disa viseve periferike të Shqipërisë Jugore. Dhe po e nis me banorët e dy zonave të tilla si *Dropulli*[1] dhe *Vurgu* i Delvinës, ku sidomos gjatë shekujve të fundit greqishtja ka ardhur duke e zëvendësuar gjithnjë e më shumë gjuhën shqipe si gjuhë amtare. Dhe kjo duket qartë jo vetëm nga përdorimi i greqishtes si gjuhë e familjes në fshatrat e këtyre dy zonave, por edhe nga emrat vetjakë me trajta të ndikuara nga greqishtja si *Jani, Jorgo a Jorgji, Pavli, Petro* etj.

Po ta krahasojmë këtë gjendje me atë të shekujve të parë të sundimit osman, duket qartë se atëherë përbërja etnike e banorëve sot greqishtfolës të këtyre dy zonave ka qenë e ndryshme. Le të marrim, sa për shembull, fshatrat *Goranxi e Sipërme*, *Derviçan* e *Sofratikë* nga zona e *Dropullit* dhe katër fshatra nga *Vurgu* i Delvinës. Në defterin osman të shekullit XVI gjendja paraqitet ndryshe. Në atë defter emrat e krishterë të lartpërmendur dalin më fort me trajta karakteristike mbarëshqiptare. Këtu do të përmendim vetëm disa prej tyre, si emrin *Gjon*, që e ka burimin tek trajta latine *Joánnes* nga hebraishtja *Jochanan / Johanna* dhe që nga evolucioni i tij në gjuhën shqipe ka ndryshuar shumë fonetikisht nga gjegjësit e tij në gjuhë të tjera, si italisht *Giovanni*, frëngjisht *Jean*, anglisht *John*, greqisht *Jani(s),* serbokroatisht *Jovan*, rusisht *Ivan* etj. Ky emër ka qenë mbarëshqiptar,

[1] *Dropull*, siç e kemi sqaruar në një punim tjetër, e ka burimin tek *Hadrianoúpolis*, qytet i (perandorit) Hadrian.

për çka dëshmon prania e tij edhe në Krisobullat e Deçanit të shekullit XIV: *Gjon* Bushat, *Gjon* Mëhill.[2]

Sipas regjistrimit osman të vitit 1519 – 1520 në fshatin *Goranxi e Sipërme* (me 170 kryefamiljarë) trajta karakteristike shqiptare *Gjon* del 30 herë si emër vetiak apo si mbiemër (llagap): *Gjon* Sima, *Gjon* Braili, *Gjon* Petra, *Gjon* Martini (2 herë), *Gjon* Guma (2 herë), *Gjon* Tupe, *Gjon* Gjini (2 herë), *Gjon* Brati, *Gjon* Thanasi, *Gjon* Nika, *Gjon* Pali, *Gjon* Leka (2 herë), Dhima *Gjoni*, Leka *Gjoni* (2 herë), Deda *Gjoni* (2 herë), Kava *Gjoni*, Guma *Gjoni*, Sima *Gjoni*, Martin *Gjoni*, Zoja (Zota) *Gjoni,* Vreto *Gjoni*, Stamad *Gjoni*, Gjin *Gjoni,* Gjika[3] *Gjoni*.

Po në atë fshat del shpesh (24 herë) edhe emri tjetër tipik shqiptar *Gjin: Gjin* Leka (2 herë), *Gjin* Dedushi, *Gjin* Dhima (2 herë), *Gjin* Gjoni, *Gjin* Isheri, *Gjin* Muzhaqi, *Gjin* Martini, *Gjin* Deda, *Gjin* Boga, *Gjin* Kondi, Lush (Losh?) *Gjini*, Gjon *Gjini* (2 herë), Leka *Gjini* (2 herë), Deda *Gjini*, Stoja *Gjini*, Nika *Gjini,* Andre *Gjini*, Dhima *Gjini*, Kond *Gjini*, Shtin *Gjini.* Do shënuar se ndër kryefamiljarët e atij fshati nuk del asnjë herë trajta *Jani,* e ndikuar nga greqishtja.

Emrat *Gjon* e *Gjin* si edhe emra të tjerë shqiptarë janë të pranishëm në të njëjtin defter - ku më shumë e ku më pak - edhe në fshatrat e tjerë të Dropullit, duke përfshirë edhe fshatin *Derviçan* afër Gjirokastrës, që në atë defter paraqitet me një popullsi mjaft të madhe për kohën dhe që, me sa duket, ka qenë mjaft i ndikuar nga kultura greke. Kështu, edhe në atë fshat gjejmë emra karakteristikë të përdorur nga banorët, si: Jani *Gjini*, *Gjin* Spato, *Gjon* Jorgji, Jorgo *Gjoni*, Nako *Bard(h)i,* Jorgo *Babi*, Mano *Çuni*, Dartho *Çuni*, Jani *Çuni*, Kosta *Lula*, Mano *Shpata*, Lluka *Prushi,* Dhimo *Prushi*, Jani *Dragoi* etj.[4] Kurse në *Sofratikë* (me 61 kryefamiljarë) del vetëm një herë emri *Gjin* (*Gjin* Pavllo), dhe dy herë emri *Gjon* në fund të kryefamiljarëve: "Bashtina

---

[2] Shih R. Ismajli: *Disa çështje të onomastikës mesjetare.* Në: *Onomastika e Kosovës*. Prishtinë 1979, f. 52, 53.

[3] Edhe *Gji-kë* < *Gjin-kë* është një emër tipik shqiptar, që ndeshet dendur në Shqipërinë e Jugut jo vetëm ndër të krishterët, por (si mbiemër familjeje) edhe ndër myslimanët.

[4] Shih Duka, Ferit, *Realiteti etnik i Dropullit në burimet historike të shekullit XVI (Defteri osman i regjistrimit të pronave dhe të popullsisë së sanxhakut të Vlorës i vitit 1520).* Në rev. "Studime historike" 3-4/1991 ff..171vv.dhe 192vv.

e vejushë Maries, e bija e *Gjonit*, në dorën e *Gjonit*."[5] Në këtë fshat ka edhe emra të tjerë shqiptarë si: Niko *Ballçi,* Jorgo *Ballçi*, Dhimo *Ballçi*, Mano *Ballçi*, Vreto *Leka*, Niko *Papileka*, Staso *Dimali*. Ndër kryefamiljarët e atij fshati mbizotërojnë emra prej burimi grek si *Jani, Jorgo, Pavllo, Aleks* etj. Por këta emra prej burimi grek si ndër kryefamiljarët e këtij fshati ashtu edhe ndër ata të fshatrave të tjerë të Dropullit nuk janë shënuar me fundoren /-s/ karakteristike për emrat e greqishtes, si *Janis, Jorgos, Pavllos* etj.

Emrat e njerëzve me trajta tipike shqiptare ndeshen edhe në Defterin e Sanxhakut të Delvinës të vitit 1431-32 për *Vurgun*, që është quajtur kështu nga fjala e greqishtes së re *vurkos* "vend i ulët, moçalishte". Në atë defter atëherë janë dëshmuar vetëm katër fshatra: *Finiki* (Finiqi), *Vurgo*, *Jeromi* dhe *Krajna* (Kranéja) me shumë pak banorë[6]. Edhe në ato fshatra janë dëshmuar emra tipikë shqiptarë si: *Gjin* Reçi, *Gjin* Panariti, *Gjin* Zagorino, *Gjin* Krali (Frali), Leka *Gjini* (2 herë), Kozha *Gjini*, *Gjin* Vija, Zhupa *Gjin, Gjini* Spiri, *Gjin* Andrea, Kont *Gjin* Andrea, *Gjon Dorza, Gjon Zhurmo,* Meksh *Gjoni,* Polimer *Gjoni*, por edhe *Jani* Jagop*, Jani* Katan**i***, Jani* Kosta, *Jani* Bogdani, Luka *Jani, Jani* Ispatari, Nika *Jani* (Finiq), *Gjin* Ilia, *Gjin* Pelegri, *Gjin* Kasnesi, *Gjon* Pelegri, Dhimo *Gjini, Gjon* Martini, Martin *Gjoni,* Deda *Gjoni* (Krane)[7]. Por, sipas Shkurtit[8], në zonën e Vurgut më 1927 janë regjistruar 25 fshatra: *Çukë, Pal*, *Aliko, Çaush*, *Tremul, Kasëmallajbej, Kaliveshush, Jermë, Halo, Kalivepasha, Krané, Ymerefend, Finiq, Vrion, Memushbej, Hajdëragas, Qenurjo, Karalibej, Vromero, Karahaxh, Mavropull, Metoq* e *Gjashtë,, Rahullë, Shijan, Muçopolit, Mullamus,* që në vitin 1927 kishin një popullsi të përgjithshme prej 3262 banorësh. Pra, shumica e këtyre fshatrave duhet të jenë themeluar pas regjistrimit osman të shekullit XV. Madje, sipas Shkurtit[9], disa nga fshatrat e rinj të Fushës së Vurgut janë krijuar në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX. Një pjesë e mirë e banorëve të këtyre fshatrave të rinj janë sjellë si bujq nga krahina greqishtfolëse prej Omer Pashë Vrionit, nga i cili ka marrë

[5] Shih Duka, Ferit, *po aty*, f. 198v.
[6] Shih Shkurti, Spiro: *Vurgu. Vështrim etnografik.* Tiranë 1987, faqe 24.
[7] Shih *po ai*, *po aty,* faqe 27 – 29.
[8] Shih *po ai*, *po aty*, faqe 46v.
[9] *Po* ai, *po aty*, faqe 43.

emrin edhe fshati *Vrion*[10], si edhe prej Ali Pashë Tepelenës. Por një pjesë tjetër kanë ardhur ose janë sjellë me forcë edhe nga zona shqipfolëse. Për sjelljen me forcë të një pjese të kësaj popullsie në kohën e Ali Pashë Tepelenës, na dëshmon edhe ish-konsulli francez në Janinë, Pouqueville-i[11], i cili përshkruan një episod të tillë të vitit 1815: "… Ndërsa këta kolonë pleq linin pas varret e etërve të tyre, arrinin në këtë vend nga jugu i Epirit një pjesë e popullsisë së krishterë të Prevezës, grupe të tëra njerëzish nga Thesalia dhe Maqedonia, që i kishin zhvendosur si kope të ulëta, për të ripopulluar një vend, të cilin zemërimi i tiranit më hakmarrës po e shkatërronte."

Si rrjedhim, duhet pranuar që një pjesë e popullsisë greqishtfolëse të zonave të Dropullit dhe të Vurgut janë të ardhur në kohë relativisht të vona dhe në këtë rast është fjala për shtresën më të vjetër të popullsisë greqishtfolëse të atyre zonave, ndërsa një pjesë tjetër e tyre kanë qenë burimisht shqiptarë, që me kohë janë helenizuar. Mendimi që popullsia greqishtfolëse e fshatrave të Dropullit është e ardhur në kohë të hershme nga Athina nuk ka asnjë mbështetje historike. Një mendim i tillë është parashtruar në një dorëshkrim në formën e një "*kronike*", që i dha në Gjirokastër më 1806 peshkopi i Drinopolit konsullit francez pranë Oborrit të Ali Pashë Tepelenës, Pouqueville, i cili e botoi atë në fund të vëllimit V të veprës së tij *Voyage dans la Grèce* bashkë me përkthimin frëngjisht më 1821[12]. Ky dorëshkrim, të cilit i mungon edhe fillimi edhe fundi si edhe emri i autorit, sipas Pouqueville-it (*vep. e përm*. f. 357), duhet të jetë shkruar aty nga fillimi i shekullit XVII. Sipas të dhënave të kësaj "*Kronike"*, banorët e parë të Dropullit paskëshin qenë një grup të shpërngulurish nga Athina për arsye të paqarta në një kohë mjaft të hershme, por të papërcaktuar. Ata pas disa peripecish qenkëshin vendosur në disa vise të pabanuara të luginës së Dropullit të sotëm, ku për 64 vjet paskëshin jetuar duke u ushqyer me mjaltin, që bletët e egra depozitonin nëpër zgavrat e lisave të pyjeve dhe vetëm pastaj, pas disa konfliktesh me popullsinë vendëse (Mollosët dhe Ajdonatët), paskëshin filluar të mbillnin bimë ushqimore. Ata, sipas kësaj

[10] *Po ai*, *po aty,* faqe 35, 43.

[11] Shih Pouqueville, *Voyage de la Grèce*, vol. II (deuxième édition. Paris 1926), faqe 27.

[12] Shih Pouqueville, F. –C., -H., *Voyage dans la Grèce*., vol. V, Paris 1821, 318 – 355.

"*Kronike"*[13], më në fund paskëshin themeluar edhe një vendbanim a qytet, të cilit i paskëshin vënë emrin *Druinópolis* „qytet prej lisi a lisash" nga greqishtja *dryínos*[14] „i lis-të, prej lisi" dhe *polis* „qytet". Ky shpjegim në trajtë legjende, pa ndonjë mbështetje dokumentare historike, nuk është përfillur nga studiues të tillë si Hammond-i, Cabanes-i etj. dhe nuk është përfshirë as nga vetë Pouqueville-i në ribotimin e veprës së tij me titullin *Voyage de la Gréce* në vitin 1826. Siç shihet, ky shpjegim i fundit është i mbuluar me një vello misteri, pa ndonjë mështetje historike.

Por të dhënat e defterëve osmanë të dhjetvjeçarëve të parë të shekullit XVI dëshmojnë qartë se luginat e Dropullit dhe të Vurgut në atë kohë ishin të banuara nga popullsi shqipfolëse dhe se greqishtja atje ka ardhur duke u përhapur gjithnjë e më shumë gjatë shekujve të fundit. Rrethanat, që kanë bërë të mundur këtë dukuri në këto dy zona, unë i kam trajtuar në një punim tjetër. Këtu do të ndalem pak vetëm në sqarimin e pyetjes: A ka qenë popullsia shqipfolëse e këtyre zonave në shekullin XVI e ardhur nga vise të tjera më veriore dhe të ketë mundësuar kështu zëvendësimin e greqishtes me shqipen gjatë shekujve të mëparshëm? Një pyetje e tillë është e pashmangshme, po të kihet parasysh mendimi i Jireçekut, sipas të cilit pas pushtimit romak të Ballkanit në pjesën veriore të këtij gadishulli mbizotëroi latinishtja, ndërsa në gjysmën jugore të tij mbizotëroi greqishtja. Megjithëse ky mendim tashmë është kapërcyer, sepse ngatërronte përhapjen e ndikimit të kulturës latine dhe greke me përhapjen e latinishtes, përkatësisht të greqishtes, prapë nuk mungojnë edhe sot studiues, që mbështesin mendimin për përhapjen e dikurshme të greqishtes, të paktën, në viset e të ashtuquajturit *Epiri i Ri* a *Vorioepir*. Për të mos u zgjatur pa nevojë për këtë problem mjaft të rrahur, mjafton të shqyrtohen shkurt rrethanat, që do të kishin mundësuar përhapjen e greqishtes apo të shqipes në zonat e lartpërmendura dhe

[13] Shih Pouqueville, *po aty*, f. 318.

[14] Nuk është e qartë se si duhet ta ketë shqiptuar autori i kësaj "*Kronike"* shkronjën /d-/ në këto fjalë, si mbylltore (okluzive) të zëshme /d-/ apo si fërkimore (frikative) të zëshme /dh-/, sepse greqishtja qysh para erës së re mbylltoret e zëshme kishte nisur t´i shqiptonte si fërkimore të zëshme (shih Rix: *Historische Grammatik des Griechischen*. Darmstadt 1976, faqe 83). Si rrjedhim, në greqishten e sotme mungojnë mbylltoret e zëshme /b, d, g/, të cilat në rast nevoje riprodhohen me anë dyshkronjëshash, përkatësisht /mp, nt, nk/.

në Shqipërinë e Jugut në përgjithësi në shekujt e mesjetës së hershme dhe të vonë. Siç dihet, pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë më 395 të erës sonë, pjesa më e madhe e Ballkanit, duke përfshirë edhe viset e banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve, u vunë nën sundimin e Perandorisë Lindore a Bizantine, e cila dalngadalë e zëvendësoi latinishten si gjuhë zyrtare me greqishten, dhe kjo e fundit aty nga shekulli VI mbeti si e vetmja gjuhë zyrtare e asaj perandorie. Në atë ndërkohë një tjetër faktor i rëndësishëm mori të përhapur në Gadishullin Ballkanik, përhapja e krishtërimit, që në shumicën e vendeve ballkanike filloi të shkëputej dalngadalë nga Vatikani dhe të varej nga kisha e lindjes, e quajtur ndryshe Kisha Ortodokse, e cila në tekstet dhe në shërbesat fetare përdorte greqishten. Dhe dihet se sa i madh ka qenë ndikimi i Kishës Ortodokse në vendet ballkanike, sidomos në Shqipërinë Jugore. E ky ndikim ka qenë edhe më i fuqishëm në viset më jugore të Epirit, i cili nën ndikimin e kësaj kishe dhe të propagandës së qarqeve të ndryshme greke në përgjithësi, sidomos pas krijimit të shtetit grek më 1821, iu nënshtrua një procesi të fuqishëm helenizimi me përhapjen e greqishtes dhe me mënjanimin e shqipes. Por për këtë çështje, që e kemi bërë objekt shqyrtimi në një punim tjetër, nuk do të ndalemi më gjatë dhe le t'i kthehemi pyetjes së parashtruar pak më sipër mbi gjuhën amtare të popullsisë së dikurshme në zonën e Dropullit dhe në atë të Vurgut.

Rrethanat e përshkruara shkurt pak më sipër mbi gjuhën zyrtare të Perandorisë Bizantine dhe të Kishës Ortodokse tregojnë qartë se nuk mund të favorizonin mënjanimin e greqishtes dhe përhapjen e shqipes në zonat e Dropullit dhe të Vurgut si edhe në Shqipërinë Jugore në përgjithësi, por të kundërtën. Megjithatë, për viset më jugore të të ashtuquajturit Epir mund të parashtrohet dyshimi që popullsia shqipfolëse e asaj treve mund të jetë e ardhur dhe të ketë zëvendësuar një popullsi të mëparshme greqishtfolëse a të helenizuar. Një dyshim i tillë gjen njëfarë mbështetjeje në pozicionin gjeografik të këtyre viseve shumë afër trevave greke, pra shumë të ekspozuar ndaj ndikimit të fuqishëm grek. Mjerisht, edhe në këtë rast mungojnë dëshmitë historike, që mund të hidhnin dritë për ndonjë shpërngulje të tillë popullsie në trevën e Epirit, apo që mund ta përgënjeshtronin një mundësi të tillë. Megjithatë, nuk kanë munguar pohime për një dyndje shqiptarësh edhe në zonën e Epirit. Kështu, D. Nicol-i në artikullin

Epirus as an independent „state“ të botuar në vëllimin *Epirus – 4000 years of Greek history and civilization*[15], faqe 211v., duke bërë fjalë për arsyet e dyndjes së arvanitëve (a më saktë të arbëreshëve) në trevat greke në shekullin XIV pohon se ato ishin pasojë e politikës së Stefan Dushanit për të zgjeruar mbretërinë e tij edhe më në jug dhe për këtë qëllim ai "inkurajoi shqiptarët që ta kryenin këtë punë për të duke u futur në *Epir* dhe Thesali". Në përgjithësi, dihet se në shekullin XIV si edhe më herët e më vonë kanë ndodhur shtegtime shqiptarësh në viset greke, sidomos në Thesali, Atikë, Beoti e Peloponez si edhe në disa ishuj grekë të Egjeut, si Eubea, Hidra, Salamina etj. Arsyet e atyre shtegtimeve, që si të tilla dalin jashtë synimeve të kësaj kumtese, janë trajtuar bindshëm në veprën e P. Xhufit, *Dilema e Arbërit* (2006, ff. 357 – 369), ku vihen në dukje edhe zonat greke, ku u vendosën shtegtarët arbëreshë dhe veprimtaria e tyre atje.

Por për popullsinë e fshatrave të Dropullit dhe të Vurgut nuk mund të mendohet që të ketë ardhur në kohën e Stefan Dushanit e të ketë zëvendësuar një popullsi të mëparshme greqishtfolëse. Në një rast të tillë më parë duhej vërtetuar që atje popullsia fliste greqisht dhe që u asimilua brenda një kohe të shkurtër nga një grup shqiptarësh të ardhur nga vise më veriore. Por për shtegtime të tilla nuk ka asnjë dëshmi historike, megjithëqë dihet se vëmendjes së kronikanëve grekë të periudhave të ndryshme nuk u kanë shpëtuar ngjarje të tilla. Përkundrazi, siç u përmend pak më sipër, dëshmohen ardhje ose sjellje bujqish grekë dhe shqiptarë në ato vise sidomos gjatë shekujve XVIII dhe XIX.

Ka edhe dëshmi të tjera për ardhje shqiptarësh në ato vise. Por shqiptarët e ardhur në fshatrat e Dropullit dhe të Vurgut me kohë janë helenizuar. E një proces i tillë helenizimi ka përfshirë më parë edhe shumë vise të Epirit jugor, si krahinat e *Janinës, Prevezës* dhe *Nartës* a *Artës*, që kanë qenë më të ekspozuara ndaj ndikimit grek, sidomos gjatë shekujve të fundit, kur shteti grek, sidomos nëpërmjet kishës greke, ka bërë një propagandë të madhe për t'i paraqitur ortodoksët shqiptarë si grekë përkundrejt myslimanëve, që i paraqiste si turq dhe si të tillë këta të fundit në valë të ndryshme i shpërnguli nga trojet e tyre për në Turqi, Shqipëri etj. Për praninë e gjerë të dikurshme të elementit shqiptar në ato krahina dëshmojnë gjithashtu defterët turq si ai i vitit 1580-81 për

[15] Botuar në Athinë më 1997.

vilajetin e Janinës, që është transkriptuar nga Vexhi Buharaja dhe ndodhet në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë. Nga shqyrtimi i materialit të pasur të atij defteri del se emrat e kryefamiljarëve të qyteteve të *Janinës, të Prevezës* dhe të *Artës* a *Nartës* dalin më fort me trajta të ndikuara nga greqishtja, megjithëse nuk mungojnë edhe trajta karakteristike shqiptare si *Gjoni, Gjini, Leka* etj. Këto të fundit shfaqen sidomos nëpër fshatrat e atyre trevave.

Gjithnjë për të mënjanuar zgjatjen e panevojshme të kumtesës, nuk po ndalem më tej në përmendjen e emrave karakteristikë shqiptarë në ato vise. Por dëshiroj ta mbyll kumtesën me shënimin që në defterin në fjalë qyteti i *Artës* është shënuar rregullisht në trajtën *Nartë* (me një *N*- protetike). Në përgjithësi, mendohet se *Arta*, ish-*Ambrakia,* ishte një koloni e themeluar nga korinthasit rreth vitit 657 para erës së re[16]. Dhe, siç dihet, grekët e vjetër themelonin "koloni" tregtare në vende të banuara nga popullsi jogreke. Emri *Arta* a *Artë* prej kohësh del në trajtën *Nartë*, ku elementi i parë burimisht ka qenë një parafjalë, që kishte në përbërjen e saj tingullin /n-/. Pas gjithë gjasash, ky tingull lidhet me parafjalën shqipe *në*, pra *Nartë* ka dalë nga togu (Po shkoj) *në Artë*. Ka më pak gjasë që në këtë rast tingulli protetik /n-/ të lidhet me parafjalën greke *en* "në", po të kihet parasysh se në një rast të ngjashëm grekët kanë përdorur parafjalën *eis* "në, drejt", siç del nga emri i *(I)stambulit*, që ka dalë nga evolucioni i togfjalëshit *eis tēn polin* [= is tin polin] "(po shkoj) *në qytet* a *drejt qytetit*").

Edhe nga sa u paraqit shkurt në këtë kumtesë, del qartë rëndësia e defterëve osmanë për historinë e trojeve shqiptare dhe të mënjanimit të gjuhës shqipe në zonat periferike të Shqipërisë Jugore në mesjetën e vonë. E një gjë e ngjashme ka ndodhur edhe në zonat veriore dhe lindore të trojeve të banuara dikur nga shqiptarë. Prandaj autoritetet shkencore sidomos në Shqipëri e në Kosovë duhet të organizojnë sa më parë një fushatë ndërgjegjësimi për nevojën e grumbullimit, të deshifrimit dhe të botimit të këtij thesari burimor të paçmuar për të gjitha trojet shqiptare. Dhe për këtë qëllim është i domosdoshëm bashkëpunimi midis institucioneve shkencore shqiptare në Shqipëri, Kosovë dhe kudo që ka forca shkencore shqiptare, që mund të ndihmojnë për një qëllim të tillë të rëndësishëm.

[16] Shih Hammond, N.G.L., *Epirus*. Oxford 1967, f. 425.

Enver HYSA

FJALA E MBYLLJES

Të dashur e të nderuar miq e kolegë!

Kam kënaqësinë që në emër të organizatorëve të them pak fjalë në mbyllje të konferencës sonë *"Studime filologjike shqiptare"*, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, si mikpritëse, dhe nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Kjo konferencë është fryt i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet dy Akademive, të Tiranës dhe të Prishtinës, bashkëpunim që po zgjerohet gjithnjë e më shumë dhe që synon jo vetëm në organizimin e konferencave shkencore si kjo që u zhvillua gjatë këtyre dy ditëve, por dhe në hartimin e realizimin e projekteve shkencore në fusha të ndryshme të shkencës, ndërmjet të cilave do të veçoja si një nga më të rëndësishmit, projektin për *Enciklopedinë shqiptare*.

Konferenca jonë, pas dy ditësh pune intensive, po i mbyll punimet me sukses të plotë. Në konferencë ishin paraqitur 50 referime dhe u mbajtën mbi 40 të tilla nga fusha të ndryshme të filologjisë, të gjuhës dhe të letërsisë.

Vend të gjerë në këtë konferencë zunë problemet e gjuhësisë, të fushave të historisë së gjuhës e të gramatikës historike, të gramatikës së sotme, të morfologjisë, të sintaksës e formimit të fjalëve, të historisë së formimit të shqipes letrare, të planifikimit gjuhësor në etapën e sotme, të sociolinguistikës etj.

Vend të veçantë zunë problemet e filologjisë, si studim e botim kritik i teksteve, të cilat, me të drejtë e vuri në dukje këtu një nga kolegët tanë, mund të kishin zënë një vend edhe më të gjerë, por bashkërisht mund të mendojmë për një simpozium të veçantë për to.

Mendoj se gjerësisht u rrahën këtu dhe çështje të ndryshme të letërsisë e të historisë së studimeve letrare, të kritikës letrare, të metodave të studimit në këto fusha etj.

Tematika e kësaj konference, si shihet, ishte mjaft e larmishme dhe gjerë. Në referimet e paraqitura u synua që të bëhej një bilanc i rezultateve të arritura nga studiuesit e filologjisë shqiptare në fushat e gjuhësisë dhe të letërsisë në kuptimin e gjerë të fjalës, u bënë përpjekje për të nxjerrë në pah të metat e vështirësitë që kanë pasur studimet shqiptare të këtyre fushave, si dhe u hodhën mjaft ide për studime e projekte të reja, të cilat do të bëjnë të mundur të rritet më tej niveli e cilësia e kërkimit shkencor, larg diletantizmit në shkencë, të realizohen studime me metoda shkencore të reja e të avancuara, sidomos me metoda të gjuhësisë strukturore e gjenerativiste në studimet për gjuhën shqipe e letërsinë shqiptare, duke synuar që të kërkohet të njihet e vërteta për objektin që studiohet me të gjitha mjetet e metodat shkencore në dispozicion, sepse shkencëtari nuk mund të bëjë shkencë pa të vërtetën. Arsyeja dhe të menduarit e arsyeshëm duhet të mbizotërojnë mbi emocionet në gjykimet e argumentimet për objektin e studimit, duke mënjanuar çdo lloj paragjykimi që mund të shkaktojë po aq dëm sa dhe politizimet e së kaluarës jo të largët.

Në këto kushte sot ndjehet nevoja më shumë se kurrë e një bashkëpunimi të ngushtë e më të shpeshtë ndërmjet studiuesve të shqipes e të filologjisë shqiptare për të synuar e për të bërë objekt studimi probleme themelore të këtyre fushave e për të hartuar vepra të rëndësishme për gjuhësinë e filologjinë shqiptare, për krijimin, forcimin e modernizimin e bazave të të dhënave etj.

Këto synime mund të bëhen realitet me projekte të përbashkëta në të cilat të angazhohen studiuesit e specialistët më në zë të fushave përkatëse, por edhe me afrimin në këto projekte të studiuesve të rinj që do t'i çojnë më përpara studimet filologjike shqiptare.

Konferenca "*Studime filologjike shqiptare*", që po i mbyll punimet sot, ishte një tjetër dëshmi e bashkëpunimit të komunitetit të studiuesve të filologjisë shqiptare, të qendrave shkencore më në zë të këtyre fushave, të Tiranës, të Prishtinës, të Tetovës e të Shkupit, të Kozencës e të Palermos, të Sankt-Petërburgut e të Polonisë, të Gjermanisë e të mjaft kolegëve të tjerë që jetojnë e punojnë në vende të ndryshme. Në emër të organizatorëve dua t'i falënderoj me gjithë zemër të gjithë referuesit, po në mënyrë të veçantë studiuesit e këtyre

qendrave që iu përgjigjën ftesës dhe me pjesëmarrjen e tyre aktive i dhanë një hapësirë te re konferencës sonë.

Mendoj se kam dhe pëlqimin tuaj që të falënderoj në mënyrë të veçantë mikpritësin tonë, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për barrën më të madhe në organizimin e konferencës dhe për kushtet shumë të mira e komode të krijuara për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e saj.

Duke përfunduar, do të dëshiroja t'u uroja të gjithë pjesëmarrësve suksese në punën e tyre shkencore dhe mirupafshim në konferenca të tjera shkencore të filologjisë shqiptare.

STUDIME FILOLOGJIKE SHQIPTARE
Konferencë shkencore

Botues
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Shefqet Riza

Redaktor teknik:
Valon Fetahu

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 30¾ tabakë shtypi
Tirazhi: 500 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
GRAFOPRINT
Prishtinë

Katalogimi në publikim - (**CIP**)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

801.7(=18)(063)

Studime filologjike shqiptare : konferencë shkencore, 21-22 nëntor 2007 / Redaksia Besim Bokshi...[et al.]. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ; Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008 . - 491 f. ; 24 cm.

Titulli paralel në gjuhën angleze

1. Besim Bokshi

ISBN 978-9951-413-68-8